

ENVER HOXHA

VEPRA

13

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

13

SHTATOR 1955 — QERSHOR 1956

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1973

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 13

Vëllimi i 13-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të periudhës shtator 1955 — qershor 1956, ku ndër të tjera hyjnë: Fjala në Plenumin X të Komitetit Qendror të BRPSH (8 shtator 1955), Fjala në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik (26 shtator 1955), Përshëndetja në Kongresin e katërt të BGSH (13 tetor 1955), Fjala në Plenumin XVI të KQ të PPSH (28 dhjetor 1955), Fjala në Plenumin XVIII të KQ të PPSH (7 prill 1956), Fjala në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës (15-16 prill 1956), Raporti në Kongresin III të PPSH (25 maj 1956), si dhe letra udhëzuese, diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH etj. Shumica e dokumentave të këtij vëllimi botohen për herë të parë.

Veprat e shokut Enver të kësaj periudhe flasin për përpjekjet e mëdha të masave punonjëse nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin socialist të vendit.

Realizimi me sukses i detyrave të planit të parë pesëvjeçar krijoi kushte të tilla që vendi ynë të hynte në periudhën e pesëvjeçarit të dytë në rrethana ekonomike, organizative dhe politike shumë më të favorshme nga ato që ishin në fillim të pesëvjeçarit të parë. Ky bilanc

u bë në Kongresin III të PPSH, i cili aprovoi direktivat e planit të dytë pesëvjeçar për vitet 1956-1960 detyrë kryesore e të cilit ishte zhvillimi i industrisë, sidomos i industrisë minerare dhe i bujqësisë. Kongresi dha direktivën për zgjerimin e kolektivizimit të bujqësisë me qëllim që të përfundohej ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit dhe të sigurohej një zhvillim i shpejtë e i gjithanshëm i fshatit.

Në këto materiale trajtohen dhe probleme që lidhen me përvojën e çmueshme që kishte grumbulluar Partia në drejtimin e shtetit, të ekonomisë, të kulturës, të arsimit si dhe të veprintarisë aktive të masave në jetën e vendit, në luftën politike e ideologjike kundër armiqve të klasës jashtë dhe brenda vendit si edhe kundër oportunizmit të djathtë.

Veprat e këtij vëllimi janë shkruar në kohën e sulmit të ashpër, që shpërtheu grupi i Hrushovit në Kongresin XX kundër parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe kundër vijës së përgjithshme marksiste-leniniste, që pati ndjekur PK e BS nën udhëheqjen e J. V. Stalinit.

Kongresi XX i PK të BS u dha zemër e i vuri në lëvizje edhe elementët antiparti e armiq në vendin tonë, të cilët përpiqeshin që të krijonin atmosferën në Parti për revizionimin e vijës politike marksiste-leniniste e për rehabilitimin e elementëve antiparti dhe armiq të Partisë e të popullit.

Kështu në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës disa elementë antiparti, duke shpërdoruar demokracinë e brendshme të Partisë, filluan sulmin kundër vijës dhe udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë dhe kri-

juan një gjendje të nderë në konferencë. Kjo është periudha kur luhej me fatin e së ardhshmes, të vijës politike të socializmit dhe të vetë Partisë. Çështja kryesore ishte në ç'rrugë duhej të ecte Partia? Në atë të Kongresit XX të PK të BS apo në rrugën e vet marksiste-leniniste? Ndërsa për shumë parti komuniste e punëtore në vende të ndryshme kjo periudhë përbën një lthesë nga kursi revolucionar në kursin revizionist, për Partinë tonë kemi një zhvillim të pandërprerë të vijës së saj revolucionare që kishte vazhduar edhe më parë. Shoku Enver Hoxha në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës demaskoi qëllimet e revizionistëve dhe parashtoi qëndrimin e vendosur të PPSH për ruajtjen e pastërtisë së vijës së saj marksiste-leniniste. Delegatët e mbështetën plotësisht këtë qëndrim të Partisë. Veprimtaria armiqësore e elementëve antiparti në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës u dënua me vendosmëri edhe në Kongresin III të PPSH. Kongresi aprovoi plotësisht vijën politike dhe veprimtarinë praktike të Komitetit Qendror të PPSH.

TE NGREMË NË NJË NIVEL MË TË LARTË CILËSINË E PUNËS IDEOLOGJIKE, KULTURALE DHE ARËSIMORE ME RININË

*Nga fjala e mbajtur në Plenumin X të Komitetit Qendror
të BRPSH*

8 shtator 1955

Desha të them disa fjalë në lidhje me çështjet ideologjike. Plenumi i Komitetit Qendror të Rinisë bëhet me vonesë, por sipas informatave që kemi, komitetet e rinisë e kanë filluar më përpara punën për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë mbi çështjet ideologjike. Në vendimin e Komitetit Qendror të Partisë çështja e edukimit ideologjik, e ngritjes ideologjike të Partisë, të rinisë dhe e të gjitha masave të popullit zë një vend të rëndësishëm. Ju keni parasysh se në këtë fushë janë bërë përparime, por këto nuk janë të mjaftueshme. Në bazë të kësaj situatë përgjegjësitë e Partisë dhe të rinisë duhet të jenë të mëdha. Rinia, natyrisht, është në gjendje që t'i zbatojë direktivat e Partisë për ngritjen ideologjike, arësimore e kulturele dhe mundësitë janë krijuar nga Partia e shteti. Mirëpo në orga-

nizimin e këtij problemi kaq të madh kemi mjaft të meta, të cilat të përpiqemi t'i kapërcejmë. Flas për të metat teknike, gjithashtu edhe për cilësinë e dhënies së arësimit, të kulturës e të punës ideologjike. Kushtet që ta përmirësojmë anën teknike i kemi. Kjo luan një rol të madh, vetëm se duhet kujdes që mjetet të shfrytëzohen akoma më mirë dhe pa përjashtim. Nga ana tjetër kuadrot duhet të kuptojnë se nuk janë të mjafta përpjekjet që kanë bërë për përvetësimin e marksizëm-leninizmit, për lidhjen e teorisë me praktikën. Mundësitë që ka krijuar Partia nuk shfrytëzohen në maksimum. Në kurset dhe në shkollat e Partisë, qoftë të ditës e të natës apo me korrespondencë dhe në studimin individual, puna nuk shkon me atë ritëm që e kërkojnë nevojat e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Shokët tanë janë bërë praktikienë dhe mund të them që ata në praktikë bëjnë një luftë të madhe dhe japin rezultate të mira. Ky është një plus. Gjatë këtyre viteve ata kanë fituar një eksperiencë të mirë. Këtu vërej se ju jeni mjaft të lidhur me jetën e rinisë dhe me zhvillimin e situatës brenda në vend sidomos me ndërtimin e socializmit, me çështjet ekonomike. Keni kuptuar si t'i lidhni mësimet e Partisë me praktikën, por duhet të keni vullnet më të madh në mësim, ta përvetësoni kulturën, ta zhvilloni atë në rrugë të drejtë. Praktika, shumë herë, të tërheq zvarrë. Thuhet që «nuk kemi kohë të lexojmë, nuk na del koha për studim dhe mësim». Në fillim të vitit shumë kuadro regjistrohen me zell në shkolla, por pastaj ritmi shkon duke u ngadalësuar dhe, kur vjen puna e provimeve, shohim që një sërë kuadrosh u bëjnë bisht. Prandaj këto të meta në mësim, në

edukimin marksist-leninist dhe në zhvillimin tuaj kulturual duhet të jeni shembull ju në radhë të parë që t'i luftoni.

Për ngritjen ideologjike ju duhet të studjoni me vëmendje marksizëm-leninizmin. Duhet të ndiqen me vëmendje kurset, leksionet, shkollat, të vazhdoni studimin individual. Kemi njerëz që kanë luftuar, por që janë të ulët ideologjikisht dhe pse janë të ulët nga ana ideologjike bëjnë edhe gabime. Mirëpo Partia i këshillon një herë, dy herë, por pastaj detyrohet të marrë edhe masa kundrejt tyre. Gjithashtu vendimet e Komitetit Qendror të Partisë nuk trajtohen si duhet në shkollat politike.

Kuadrot duhet të kuptojnë mirë bazën teorike të vendimeve të Partisë dhe qëllimet e tyre në praktikë. Dhe kur ta kuptojnë mirë këtë gjë, ata do ta kenë më lehtë të lidhin anën teorike me anën praktike të tyre. Po të mos kuptohen thellë këto anë e në kuptimin marksist-leninist, kuadrot, kur të venë në praktikë për t'i zbatuar, do të bien në kundërshtim me to, sepse baza shpesh ka probleme të koklavitura e që duhen zgjidhur aty; p.sh. fshatari çështjet i shikon nga pikëpamja e tij individuale dhe, duke qenë kështu, ai nuk është i zoti t'i shpjegojë e t'i zbatojë si duhet. Prandaj vendimet e Partisë duhet t'i kuptojmë nga ana teorike që t'ua shpjegojmë dhe të tjerëve.

Tani nuk jemi në statet e para. Nga rinia kanë dalë me mijëra e mijëra kuadro që kanë mësuar, që kanë fituar kulturë të mesme, kanë kryer shkolla të larta, kanë përvetësuar teknikën moderne dhe kanë pasur rezultate shumë të mira. Problemi i kuadrit është i madh.

Dhjetë vjet çlirim është një kohë e shkurtër. Megjithkëtë kanë dalë kontingjentet e para dhe mund të themi se kemi krijuar një numër të madh kuadrosh, të cilët janë një thesar i madh dhe, me një punë të organizuar mirë, mund të ecet me hapa të mëdhenj.

Në organizatën tuaj ka sektarizëm; këtë Komiteti Qendror i PPSH e ka ngritur shumë herë. Ne nuk mund të themi se në këtë drejtim nuk janë bërë përpjekje. Ka luftë dhe ka përmirësime. Organizata e rinisë është zgjeruar, por duhet të bëhet akoma më shumë në këtë drejtim. Statistikat dhe evidencat tregojnë se sidomos në radhët e të rejave organizata e rinisë duhet ta zgjerojë influencën e saj. Të kemi kurdoherë parasysh karakterin e organizatës së rinisë. Organizata e rinisë nuk ka atë disiplinë të fortë dhe organizim shumë rigoroz që ka Partia, ku anëtarët e Partisë, me të marrë direktivat, duhet t'i zbatojnë ato. Me rininë duhet një punë e madhe bindëse dhe ajo mobilizohet në rast se e ndjen thellë detyrën, në të kundërtën, do t'i bëjë bisht. Të mos kënaqemi me rezultatet e arritura. Organizata e rinisë i zbaton në një rreth të ngushtë direktivat e Partisë. Në qoftë se ecet në këtë rrugë, nuk jemi në rregull dhe në rast se nuk i tërheqim ne të rinjtë, rrymat armike do të influencojnë në ta. Sa dëm i bëhet pushtetit popullor në rast se organizata e rinisë mbetet e ngushtë, sektare! Duhet të mbështetemi në të gjithë rininë. Të rinjtë janë patriotë, por nuk mund të mendojnë të gjithë si mendojnë komunistët. Detyra jonë është që t'i afrojmë ata. Këto i dini ju, por në praktikë ka sektarizëm. Nuk është e drejtë që një të riu, që flet disa fjalë çapraz, t'i futet shqelmi e të izohet përnjëherë. Një gjë

të tillë as Partia nuk e bën, pse ka parasysh përbërjen, ngritjen kulturele të anëtarëve të Partisë. Ka njerëz që gabojnë ose që janë dembelë, por që të gjithë këta janë të ndershëm. Partia t'i ndreqë, t'i këshillojë, të bëjë përpjekje që t'i bëjë zbatues të vijës së Partisë. Këto janë parimet e Partisë në lidhje me kuadrin. Me rininë të jemi ca më të gjerë, qëllimi është që të rinjtë ta kuptojnë vijën e Partisë.

Mua më duket se organizata e rinisë sikur nuk i konsideron të saj të ata kuadro që mbarojnë shkollat. Mbaroi shkollën një i ri, bëhet inxhinier ose agronom dhe ky menjëherë shkëputet nga kontakti me organizatën e rinisë. Këtë gjë as ju as Partia nuk duhet ta lejojë. Për të gjithë këta kuadro të moshës së rinisë duhet të shumëfishohet interesimi nga organizata e rinisë. Komitetet e rinisë, këta njerëz t'i mbajnë shumë afër. Në konferenca e në mbledhjet e komiteteve të rinisë, edhe pa qenë anëtarë të komiteteve, t'i thërrisni këta. T'i lidhni me organizatën e rinisë, t'i lidhni këta, pse i lidh vetë jeta dhe pavarësisht se janë kuadro, ata janë të rinj e pse janë të rinj, pra, janë dhe të organizatës së rinisë, kudo që punojnë, në fabrikë ose në arë. Është interesi ynë që këta njerëz të jenë të lidhur me veprimtarinë e gjerë e të gjallë të rinisë. Mbështetjen kryesore këta duhet ta kenë në fshat, te brezi i ri, te të rinjtë. Në rast se këta nuk shkojnë në organizatën e rinisë, nuk marrin pjesë aktive në mbledhjet e saja, në konferenca etj., direktivat e Partisë nuk mund t'i çojnë në masa, nuk do të mund të luftoheshin mentalitetet e vjetra. Është shumë më vështirë t'i mbushësh mendjen një plaku për kotësinë e fesë se sa një të riu.

I riu e kupton më shpejt, më lehtë dëmin e mentaliteteve të vjetra.

Sukseset, që kanë pasur Partia dhe pushteti, ne duhet t'ua detyrojmë në radhë të parë të rinjve dhe kur them të rinjve, nënkuptoj jo vetëm ata që janë në organizatën e rinisë, por dhe ata që janë 30 vjeç e që mund të kenë tre fëmijë. Në rast se rinia jonë do të ishte një rini e prapambetur, nuk do të ishin arritur këto suksese. Ka komitete partie që çështjen e rinisë e lënë mënjanë, e quajnë si një gjë të veçantë, nuk e vlerësojnë drejt punën e saj. Puna e rinisë në fshat duhet të konsiderohet si një kontribut i madh në punën e Partisë sonë. Dihet se rinia në fshat bën punën kryesore dhe ka suksese, po ashtu edhe në fabrika janë të rinjtë që i realizojnë planet. Kush e bën punën më të pastër dhe punon më me hov në fshat dhe kush i kryen këshillat agroteknike? Janë të rinjtë në radhë të parë. Prandaj Partia duhet t'i vërë një kujdes të madh organizatës së rinisë. Unë jam i bindur se të gjitha kritikrat që iu bënë Komitetit Qendror të Rinisë nga ana juaj janë të drejta.

Ka burokraci të madhe. Ju të rinjtë duhet të jeni të parët që ta luftoni burokracinë. Në rast se Komiteti Ekzekutiv i Elbasanit p.sh. mban një njeri në parkun e pionierit vetëm pse luan e është futbollist, komiteti i rinisë duhet të ndërhyjë e t'i thotë atij, që është caktuar për këtë punë: Ose rri këtu të punosh me pionierët, ose po u solle andej-këtej ne s'të paguajmë.

Qeveria ka vënë fonde të mëdha për kulturën, por fondi i paraparë në buxhet prej 147 milion lekësh për shpenzime kulturore nuk është realizuar. Këtu ka fonde

dhe për rininë. Megjithatë kritikata tuaja në këtë plenum janë të drejta. Kërkesat e rinisë Partia dhe pushteti nuk po i plotësojnë; ju duhet të kërkonit, të luftoni më shumë dhe në qoftë se nuk jua vënë veshin, të vini deri në Komitetin Qendror të PPSH. Unë bisedova me shokun kryeministër dhe ne ramë dakord që shumë gjëra t'jua plotësojmë; jemi gati që t'i rishikojmë kërkesat dhe, për shumë gjëra që duan pionierët, si lodra etj., do të japim ndihmë. Ministria e Arësimit dhe Komiteti Qendror i Rinisë të na paraqesin kërkesat konkrete dhe ne do të marrim masat. Por këto gjëra, për të cilat shpenzohet kaq shumë, duhet të mbahen mirë. Në rast se nuk i mban mirë dhe nuk i shfrytëzoni këto mjete, fondet shkojnë kot. Ju e kuptoni situatën. Mos kërkojmë të bëjmë gjëra të mëdha, por të bëjmë edhe të vogla. Unë nuk di, pasi nuk i kam vizituar këto parqe, por kam parë se në Bashkimin Sovjetik ka gjëra të mëdha, po ka dhe të thjeshta për pionierët, që edhe te ne ka mundësi të bëhen me pak shpenzime. Nuk kursen shteti për këtë. Ka gjëra që mund të planifikohen, por ka dhe gjëra që nuk mund të planifikohen. Në Kombinatin e Drurit në Elbasan ka mbeturina druri që shkojnë kot, por që mund të shfrytëzohen; po atje ka organizata rinie e të rinjtë me këto mbeturina mund të bëjnë stola, lodra e shumë gjëra të tjera. Por vetëm duhet iniciativë nga ana juaj.

Në sektorin e kulturës janë bërë përparime të mëdha, por ka akoma boshllëqe në studimin e letërsisë politike e në leximin e letërsisë artistike. Ritmi i zhvillimit të kulturës është akoma i ngadalshëm. Kemi përparime, por mund të bëjmë akoma më shumë, prandaj

kësaj çështjeje duhet t'i vëmë rëndësi të madhe, sidomos rinia. Ajo ka marrë përsipër ta përhapë librin. Rinia duhet të jetë ajo që të përpiqet që njerëzit të lexojnë e të mësojnë sa më shumë.

Ju jeni përpara detyrave aktuale të mëdha; grumbullimi i misrit, i pambukut, i panxhar sheqerit duhet zgjidhur shpejt. Koha na favorizoi dhe prodhimet duhet të jenë të mira; organizata e rinisë duhet të luajë një rol të madh që prodhimet të hyjnë sa më parë në hambarët e shtetit. Organizata e rinisë duhet të luajë rolin vendimtar, pasi janë të rinjtë ata që punojnë në sektorë të ndryshëm. Fabrikat duhet të punojnë me kapacitet të plotë. Rinia duhet të shpikë, duhet të gjejë metoda që plani të realizohet më me lehtësi. Të mos qëndrojmë skllëvër të disa metodave kur nuk i përshtaten një rrethi ose një fabrike. Rinia duhet të mobilizohet që të bëhet një punë me metoda dhe me forma më të mira, pse ka shumë burokraci në këtë drejtim, prandaj duhet të jeni krijues. Partia verifikon çdo gjë; koha tregon, vërteton se cila është e mirë dhe cila është e gabuar. Pra, drejtuesit e rinisë duhet të jenë të zgjuar në këtë drejtim.

Kemi fushatën e zgjedhjeve të pushtetit në fshatra që mund të bëhen nga nëntori. Rinia duhet të luajë një rol të madh në çështjet e pushtetit. Ka direktiva për këtë. Por deri ku janë zbatuar ato, sa është siguruar pjesëmarrja e gjallë e të rinjve në pushtet? Në këtë drejtim organizata e rinisë nuk e ka bërë detyrën. A është arritur në atë shkallë që të kaluarit nga mosha ta çmojnë rininë? Ka shumë nga ata që akoma nuk e çmojnë, rinia duhet ta arrijë këtë.

Përpiquni që në shkollat tona, ku edukohet brezi i ri, të zhduken të metat që ekzistojnë. Sidomos mësimet të mësohen me zell, të ndiqen shkollat me kujdes, të përvetësohet lënda. Janë me mijëra vetë që s'kanë kaluar klasën. Ka të meta nga arësimtarët dhe nga ana materiale ka mungesa, por mua më duket se ne kemi një rini të gatshme për t'i kapërcyer këto vështirësi; mirëpo forca e organizatës së rinisë në shkolla nuk është ajo që kërkon Partia. Prandaj duhet të forcohet puna në këtë drejtim. Në rast se lejohet që mësuesit t'i merret «erzi» orë e çast, mbaroi. Po të krijohet mendimi se mësuesi s'qenka gjë, atëhere ai do të flasë kot. Ky është dhe një shkas që nxënësi të mos mësojë. Ne kemi mësues të vjetër, me pikëpamje jo të drejta, por këto pikëpamje t'i dijë organizata e rinisë, t'i ndreqë e t'i edukojë këta me mësimet e marksizëm-leninizmit. Këta mësues nuk i kemi mbajtur për sytë e bukur, por sepse nuk kemi kuadro të mjaftueshëm. Kjo nuk do të thotë që organizata e rinisë të mos punojë me ta, ajo duhet t'i edukojë, t'u verë në dukje gabimet, por pa i diskredituar.

Familja luan një rol të madh në çështjen e edukimit të fëmijëve. Rinia duhet të influencojë rrënjësisht në familje. Familja ka bërë përparime, por edukimi në shkollë, forca e organizatës së rinisë në shkollë duhet të jenë vendimtare dhe kjo frymë të shkojë në familje nga anëtari i Partisë dhe nga anëtari i organizatës së rinisë. Prandaj kësaj duhet t'i vëmë rëndësi të madhe.

Një çështje tjetër, është që të rinjtë të edukohen me frymën e patriotizmit e të besnikërisë, të mbrojnë interesat e atdheut, interesat e kampit tonë, ta duan

kampin tonë dhe Bashkimin Sovjetik me gjithë shpirt: në këtë drejtim Partia jonë, rinia jonë janë mbrujtur si duhet. Por të mos harrojmë se kemi armiq, të cilët përpiqen që kjo miqësi, ky patriotizëm të dëmtohet. prandaj rinia duhet t'i shikojë këto në frymën e direktivave të Partisë, të jetë në dijeni për të gjithë situatën që po zhvillohet. Kjo situatë duhet sqaruar mirë e gjerë, të mos ketë keqkuptime dhe direktivat e Partisë duhet të kuptohen thellë nga të gjithë dhe jo në mënyrë të përciptë, ndryshe do t'u lihet shteg armiqve që të thonë se «edhe komunistët nuk janë të qartë». Ju jeni në korrent të situatës ndërkombëtare që po zhvillchet. Ka shpresa që me frymën e Konferencës së Gjenevës të ketë ndonjë farë ulje të mëtejshme të tensionit ndërkombëtar. Nga ana e kampit tonë janë bërë vazhdimisht përpjekje për uljen e tensionit ndërkombëtar dhe arritjen e paqes. Vendet imperialiste janë vënë në pozita të vështira të shtyra nga popujt e tyre. Masat që u morën në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore për çmobilizimin e një pjese të ushtrisë janë masa me rëndësi. Kjo tregon se politika e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të demokracisë popullore është për paqen. Në vendin tonë me vendim të Këshillit të Ministrave çmobilizuam 9 mijë vetë. Ç'tregon kjo? Kjo tregon se situata e jashtme nuk është aq e nderë, siç ishte më parë dhe na e lejon një veprim të tillë, por kjo nuk do të thotë se ne nuk jemi vigjilentë; ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë. Vendimi që u muar ka rëndësi edhe nga ana ekonomike. Këta 9 mijë vetë që u çmobilizuan, midis të cilëve ka kuadro oficerë, do të shkojnë të punojnë në prodhim, kështu edhe bu-

xheti i shtetit do të lehtësohet. Këta kuadro do të punojnë në dobi të zhvillimit të ekonomisë. Të gjithë këta, të disiplinuar dhe me kulturë, do të forcojnë organet e Partisë, të rinisë, do të forcojnë drejtimin e SMT-ve, drejtimin e kooperativave, do të kalojnë në pushtet, do të krijojnë një situatë akoma më të favorshme për pushtetin tonë dhe gjithë kjo, në sajë të politikës paqësore të Partisë e të shtetit tonë.

Shoku Enver Hoxha pasi foli mbi disa çështje të zhvillimit të situatës ndërkombëtare përfundoi:

Tani çështja është që të mobilizohen organizatat bazë të rinisë për këto detyra që u diskutuan. Të përpiqemi të organizojmë më mirë punën. Në zbatimin praktik të direktivave të jemi shembull ne udhëheqësit dhe gjithë komunistët e rinia të ecin nën shembullin tonë

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI ZHVILLIMIN E ARTIZANATIT NË QARKUN E KUKËSIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 shtator 1955

Për të zhvilluar artizanatin, përveç të tjerave duhet të përfitojmë edhe nga eksperiencia e të tjerëve. Më lejoni t'ju pyes për një çështje konkrete: A i keni parë ndonjëherë qylymat e Korçës? Në qoftë se po, a nuk ka mundësi që të prodhoni si ata? Unë them se ka mundësi. Prandaj të bëhen ndryshime në veglat e punës dhe të jepen modelet përkatëse, me qëllim që qylymat të prodhohen në mënyrë joprimitive, por sa më të mirë dhe t'i shërbejnë si duhet eksportit. Në rast se ne i eksportojmë qylymat, do të marrim valutë dhe do të bëjmë propagandë për vendin tonë.

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua rreth relacionit «Mbi gjendjen e ndërmarrjeve ekonomike dhe të kooperativave të artizanatit në qarkun e Kukësit» paraqitur nga Drejtorja e industri-ndërtimit pranë aparatit të KQ të PPSH.

Ju keni afër edhe Shkodrën. A keni vajtur ndonjëherë në këtë qytet? Merrni eksperiencë edhe nga artizanët shkodranë. Mësoni se si luftojnë ata për të siguruar bazën materiale, duke shfrytëzuar mbeturinat e ndryshme që ndodhen në vend. Në Shkodër ka një artizanat shumë të zhvilluar, ndërsa në Kukës nuk e gjen këtë. Duhet bërë përpjekje që të ecet përpara. Po ashtu duhet të vini edhe në Tiranë dhe të fitoni eksperiencën e artizanëve të saj.

Ka shumë mundësi që të sigurohen kuadrot e nevojshëm, në qoftë se dihen nevojat e popullit, të cilat janë nga më të ndryshmet. Populli ka nevojë për sëpata, plugje etj. Kur fshatarët, për shembull, paraqesin kërkesa për këto vegla pune, atëhere bisedohet me ta dhe u thuhet se për të plotësuar këto nevoja, duhen kuadro, specialistë, zanatçinj; farkëtari ka nevojë për nxënës, prandaj duhen çuar fëmijët që të mësojnë, kështu do të mund të plotësohen kërkesat e popullit, në këtë mënyrë mund të zgjidhet mungesa e kuadrit që ngrihet nga ana juaj.

Është e domosdoshme që Kukësi të dërgojë njerëz në kurse dhe qendra t'ju ndihmojë që të mësojnë e të përgatiten kuadro. Jemi disa vjet pas çlirimit dhe duhet të kuptohet drejt se nuk mund të detyrojmë njerëz që të vijnë e të punojnë në Kukës, prandaj ju takon juve që të siguronit kuadro nga vendi.

Të marrim për shembull prodhimin e qylymave dhe të sixhadeve: sa gra e sa vegla ka që punojnë, sa vegla prej këtyre ndodhen nëpër shtëpi dhe sa nga këto gra punojnë në shtëpi? Çfarë detyra dalin për të përmirësuar cilësinë, çfarë duhet bërë për të kaluar normën etj?

Ose të marrim farkëtarët: studjoni nevojat e qarkut tuaj dhe pastaj bëni një plan për të plotësuar këto nevoja jo vetëm për sot, por edhe për perspektivën, duke u bazuar në pregatitjen e kuadrit me njerëzit tuaj, pa pritur t'ju vijnë nga rrethe të tjera. Po kështu duhet menduar e duhet vepruar edhe për kuadrot e ndërtimit. Si do t'i siguron këta kuadro? Në qoftë se ju do të kërkonit të merrni karpentjerë dhe qyinyrxhinj nga Korça, gaboheni. Nuk duhet ecur me mendimin që t'ju dërgohen kuadro nga qarqe të tjera. Partia të luftojë kundër këtyre mendimeve të gabuara. Kjo mund të arrihet me një planifikim të mirë dhe me luftë këmbëngulëse për zbatimin e tij.

Unë nuk them se në qendër nuk ka gabime, por këtu analizohet puna e qarkut tuaj dhe duhet të shohim në radhë të parë dobësitë e tija. Ja për shembull: Pse kërkonit maqina me korrent, kur nuk i shfrytëzoni si duhet? Pse në sharra nuk punohet me 3 turne? Te ju ka edhe një fabrikë për krehjen e leshit, për të cilën duhet treguar gjithashtu një interesim i madh. Dikasteret bëjnë gabim të madh që mbajnë në Kukës mjete që nuk shfrytëzohen dhe nuk i çojnë ato atje ku ka nevojë e mund të shfrytëzohen më mirë. Edhe lart ka burokratizëm, kundër të cilit duhet të luftojmë të gjithë e kudo që shfaqet.

Përveç këtyre, mendoj se duhet të shikoni më mirë edhe përbërjen e Partisë. Në qoftë se nuk përmirësoni këtë, nuk keni për ta forcuar punën e Partisë në përgjithësi. Është më mirë të pranohen në Parti njerëz nga fshati malor Kalis, se sa ndonjë shitës që vjedh. Rezulton se në Kukës ka pasur shumë vjedhje, bile edhe nga

ndonjë komunist; a nuk duhet ta lërheqë kjo më shumë vëmendjen e Partisë?

Mendoj se për të gjitha këto që u thanë këtu duhet të organizoni një mbledhje të veçantë ku të shqyrtoni problemet e artizanatit. Kjo mbledhje të pregatitet me kujdes nga komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv i qarkut. Në studimin që do të bëni, të analizoni nevojat e qarkut tuaj, mundësitë që keni dhe punën që bëhet për t'i kthyer në realitet këto mundësi.

Unë kam besim se këto të meta do t'i korrigjoni dhe artizanatin në Kukës do ta zhvilloni më tej. Për këtë, vini më tepër përpara përgjegjësisë shokët e komitetit ekzekutiv. Grumbullimi për ju ka rëndësi vërtet, por edhe artizanati nuk duhet lënë pasdore. Mundësi e rezerva keni. Te ju ka edhe pyje të tëra me gështenja dhe kumbulla. Merrni masa për mbledhjen e tyre. Organizoni mirë punën që t'i dilni në krye situatës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT
TË PËRGJITHSHËM TË FRONTIT DEMOKRATIK
ME RASTIN E HAPJES SË FUSHATËS SË
ZGJEDHJEVE TË KËSHILLAVE POPULLORE
TË FSHATRAVE DHE MBI DETYRAT
E FRONTIT DEMOKRATIK**

26 shtator 1955

Shokë,

Presidiumi i Kuvendit Popullor ka dekretuar që më 20 nëntor të këtij viti të bëhen zgjedhjet e këshillave popullore të fshatrave. Këto zgjedhje kanë një rëndësi të madhe në jetën e vendit.

Fronti Demokratik i Shqipërisë, kjo organizatë e madhe politike e udhëhequr nga Partia e Punës, duhet natyrisht të zhvillojë një aktivitet të madh politiko-organizativ, një fushatë të gjerë politike, që do të kurorëzohet me fitoren e kandidatëve të Frontit, me forcimin akoma më tej të bashkimit dhe të dashurisë së popullit tonë ndaj Partisë së Punës, qeverisë së Republikës dhe Frontit Demokratik, me forcimin akoma më tepër të pushtetit popullor. Duke marrë parasysh këtë fushatë të madhe dhe detyrat e rëndësishme që na dalin për-

para, Kryesia e Frontit Demokratik e gjeti të nevojshme të thërresë Këshillin e Përgjithshëm të Frontit në mbledhje të gjerë, për të diskutuar dhe për të marrë vendimet e nevojshme, të cilat t'i shërbejnë organizatës sonë të Frontit Demokratik për orientim dhe veprim gjatë fushatës së zgjedhjeve të këshillave popullore të fshatrave.

Është plotësisht e kuptueshme që populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij heroike e Punës, t'i kushtojë një vëmendje të madhe dhe një kujdes të posaçëm forcimit të vazhdueshëm të pushtetit popullor. Ka disa njerëz që mendojnë se zgjedhjet e këshillave janë një ngjarje e thjeshtë dhe e zakonshme. Natyrisht këta gabohen. Krijimi i pushtetit popullor ka qenë një nga fitoret më të shkëlqyera që ka korrur populli ynë nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë së tij të Punës. Krijimi i këtij pushteti mbi gërmadhat e pushtetit feudo-borgjez, që ishte arma shtypëse e ish-klasave sunduese dhe e fashistëve kundër popullit, u bë me shumë sakrificë. Ky pushtet duhej të forcohej, të bëhej i përsosur e me të vërtetë demokratik, që të mund të ruante fitoret e revolucionit popullor, t'i zhvillonte më tej me sukses këto fitore dhe të shtypte pa mëshirë çdo orvatje të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të atdheut tonë të lirë dhe sovran. Në vendin tonë ndërtohet me sukses socializmi dhe pra, pushteti ynë është pushteti i popullit, që nuk njeh tjetër interes përveçse atë të punonjëseve, që punon për të mirën e popullit. Populli shqiptar e do pushtetin se e ka të tijne, e ka fituar me gjak, me luftë e me sakrificë. Partia na mëson të jemi vazhdimisht vigjilentë për ruajtjen e fitoreve të popullit nga

sulmet e armiqve, të cilët përpiqen në çdo kohë dhe në çdo rast t'ia rrëmbejnë nga duart këto fitore popullit. Është e natyrshme, pra, që populli të jetë vigjilent dhe ta mbrojë pushtetin e tij, duke ditur se mbeturinat e klasave të përmbysura feudoborgjeze në pamundësi ta rrëzojnë pushtetin popullor me anë të forcës, përpiqen me plot mënyra ta dobësojnë nga brenda. Pra fushata për zgjedhjet e këshillave popullore, të cilat Lenini i ka quajtur

«... baza e përhershme dhe e vetme e gjithë pushtetit shtetëror, e gjithë aparatit të shtetit...»¹,

nuk mund të ketë vetëm një karakter thjesht manifestiv. Përkundrazi kjo fushatë e rëndësishme ka një qëllim të thellë politikō-organizativ, ku duhet të aktivizohen jo vetëm agjitorët dhe aktivistët e Partisë dhe të Frontit Demokratik, siç kuptohet disa herë, por duhet i gjithë populli, i madh e i vogël, të marrë pjesë gjallërisht. Këshillat popullore të pushtetit tonë të ri janë gjaku i popullit, janë format dhe organet e pushtetit që drejtojnë të gjithë aktivitetin e vendit, që kontrollojnë të gjithë aparatit shtetëror. Duke e parë çështjen me këtë sy, kuptohet lehtë sa e rëndësishme është fushata e zgjedhjeve për këshillat popullore të fshatrave dhe sa i interesuar është populli në këtë fushatë të madhe. Pushteti i ri popullor, që farkëtoi me luftë të përgjakshme Partia jonë e lavdishme, ka një veçori të rëndësishme, nga më të rëndë-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 543.

sishmet, që ai është lidhur shumë ngushtë, si mishi me thoin, me masat e gjera punonjëse të vendit. Kjo do të thotë që pushteti ynë është i popullit dhe vetëm i popullit dhe siguron plotësisht pjesëmarrjen aktive, të gjerë, të masave punonjëse në drejtimin e drejtëpërdrejtë të shtetit. Kjo do të thotë gjithashtu, se pushteti ynë është nga më demokratikët. Një demokraci e vërtetë popullore e karakterizon pushtetin tonë popullor për arsye se ai është i lëri në duart e popullit, pse ai kontrollohet nga populli, pse ai vazhdimisht përtërihet me gjak të ri, të shëndoshë, pse ai është armiku i betuar i formave burokratike dhe pseudodemokratike. Pushtetin tonë e karakterizon gjithashtu hovi dhe guximi për krijim dhe përparim, pse, duke qenë i lidhur ngushtësisht, i drejtuar dhe i kontrolluar nga masat e gjera të popullit, ka vulën e iniciativës së madhe dhe të krijimtarisë së masave punonjëse.

Natyrisht do të jetë gabim të mendohet se pushteti ynë popullor, se aparatet e pushtetit tonë, kanë arritur përsosmërinë, se çdo gjë shkon mirë në to. Partia jonë na mëson që të luftojmë pa pushim për zhdukjen e një sërë të metash e dobësish që shfaqen në drejtimin e pushtetit, dobësi që e kanë burimin në shkallën akoma të ulët të kulturës, jo vetëm në kuptimin e personave të veçuar, siç theksonte Lenini, por në tërësi, në shkallën më të lartë të kulturës. Këtë dobësi, është e kuptueshme, nuk mund ta zhdukësh përnjëherësh dhe sidomos në vendin tonë ku para 10 vjetëve mbretëronte errësira dhe injoranca. Për të arritur atje ku thotë Lenini duhen vite, duhet dhe një punë e palodhur. Ne kemi arritur rezultate shumë të mëdha në këtë drejtim, që janë in-

kurajuese dhe bazë e sigurtë për suksese më të mëdha në të ardhshmen. Partia jonë, e udhëhequr nga marksizëm-leninizmi, na mëson vazhdimisht dhe na udhëheq në punën tonë për përmirësimin e vazhdueshëm të punës së pushtetit popullor, nga ku varet, natyrisht, ritmi i shpejtë i ngritjes së mirëqenies materiale dhe kulturele të punonjësve të Republikës dhe sigurohet ritmi i shpejtë dhe i sigurtë i ekonomisë dhe i kulturës socialiste në vendin tonë. Në punët e pushtetit tonë, në aparatet e tij, ka akoma shumë formalizëm dhe burokraci, të cilat ne duhet t'i luftojmë me këmbëngulje, pse këto janë sëmundje të rënda dhe të rrezikshme që e kanë burimin në mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve. Këto do të zhduken me një luftë këmbëngulëse të Partisë dhe të Frontit Demokratik, me një kontroll të rreptë në drejtim të zbatimit të ligjeve të shtetit tonë, me një kontroll të rreptë të aparateve dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme nga ana e masave të gjera të popullit. Kontrolli i masave të gjera të popullit mbi të gjithë veprimtarinë shtetërore është i domosdoshëm. Lenini thotë se

«Burokratizmi mund të luftohet deri në fund, deri në fitoren e plotë kundër tij vetëm atëhere, kur gjithë popullsia do të marrë pjesë në qeverisjen e vendit»¹.

Duhet të luftohen pikëpamjet burokratike të disa elementëve që mendojnë se vetëm aparatet shtetërore janë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 196.

forma të qeverisjes. Me këtë ata vihen në rrugën e nënvleftësimit në parim dhe në praktikë të qeverisjes së popullit, të pjesëmarrjes së të gjithë popullit në qeverisje, vihen në rrugën e nënvleftësimit të bazës kryesore të pushtetit popullor që janë këshillat popullore, të shkeljeve të kompetencave të këshillave, të formalizmit dhe të mosaktivizimit sa duhet të këshillave në drejtimin e punëve të shtetit. Një pikëpamje e tillë e gabuar të çon në një demokraci formale, mbytyt inisiativën krijuese të masave, mbytyt kritikën dhe autokritikën dhe dobëson kontrollin e popullit. Kur, më tepër se në rastin e zgjedhjeve për bazat e pushtetit popullor që janë këshillat, duhet të ngrihen këto çështje me forcë dhe të luftohen të gjitha këto shtrembërime, këto të meta, këto gabime? S'ka dyshim se elementët armiq luajnë rolin kryesor në dobësimin e pushtetit popullor dhe këtyre duhet t'u bëhet një luftë e ashpër e të mos u zerë këmba vend si thotë populli, por aspak nuk duhet harruar të spastrojmë me këmbëngulje dhe me durim mbeburinat mikroborgjeze edhe në ndërgjegjen e njerëzve të mirë e të devotshëm. Njerëzit duhet të kuptojnë se çdo gjë e huaj për popullin dhe për ndërtimin e socializmit duhet të spastrohet, pse, në rast të kundërt, kjo pa asnjë dyshim çon ujë në mullirin e armikut.

Fushata e zgjedhjeve duhet të shërbejë, pra, në radhë të parë për të forcuar akoma më shumë pushtetin tonë popullor, të shërbejë për të përmirësuar punën e këshillave si udhëheqje kolegjiale dhe të këshilltarëve veç e veç, të shërbejë për t'i lidhur sa më ngushtë këshillat popullore me masën e popullit, duke ush-

truar një kontroll të vazhdueshëm dhe të shëndoshë të popullit mbi këshillat dhe mbi gjithë aparatit shtetëror.

Ne mund të themi me siguri se që nga zgjedhjet e kaluara e deri sot këshillat popullore të fshatrave janë forcuar, janë mobilizuar, i kanë kuptuar më mirë detyrat e tyre të larta dhe kanë merituar besimin e popullit. Problemet e fshatit janë shumë të rëndësishme, por edhe të koklavitura. Këshillat popullore, duke ndjekur dhe duke zbatuar direktivat e Partisë dhe të qeverisë, kanë punuar me ndërgjegje dhe kanë drejtuar e organizuar problemet ekonomike dhe kulturele në fshatrat e tyre. Kjo gjë ka bërë që autoriteti i këshillave dhe i shumë këshilltarëve të ngrihet dhe planet e shtetit të realizohen me sukses. Me gjithë këto suksese që kemi arritur në fshat, ne nuk mund të kënaqemi dhe do të gabohemi në rast se nuk i shohim me sy kritik çështjet në fshat, siç na mëson Partia, dhe të përmirësojmë punën, pse atje ka akoma shumë të meta. Duke u ndalur në punën e këshillave të fshatit, ne mund të themi se ato nuk tregojnë atë gjallëri, atë inisiativë, atë këmbëngulje që duhet në drejtimin e qeverisjes dhe në zgjidhjen e problemeve ekonomike, kulturele dhe shoqërore të fshatit. Këshilltarët, si të zgjedhurit e popullit, nuk zhvillojnë një punë drejtimi kolegjial si duhet dhe të zgjidhin problemet e fshatit, jo vetëm nga platforma e interesave personale të çdo fshatari, por edhe nga platforma e interesit të përgjithshëm të fshatit dhe e interesit të përgjithshëm të Republikës. Është e natyrshme, që detyra e këshilltarit është të ketë lidhje të vazhdueshme me zgjedhësit, të dëgjojë me vëmendje më të madhe ha-

llet, këshillat, vërejtjet e porositë e zgjedhësve dhe të veprojë në rrugën e drejtë të zgjidhjes së tyre. Por kjo nuk është e mjaftueshme në rast se interesat e çdo fshatari veç e veç nuk i harmonizon me interesat e përgjithshme të fshatit dhe të Republikës. Mjaft herë këshilltarët kapen pas gjërave të vogla, harrojnë detyrën e tyre të madhe dhe bien në pozitë të tarafeve, të miqësive personale. Natyrisht, zgjidhja e çështjeve në këtë mënyrë, është në dëm të interesit të përgjithshëm të fshatit. Fshatari, nga natyra e tij, lehtë mund të bjerë në këto pozita në rast se Partia dhe organizata e Frontit Demokratik nuk zhvillojnë një punë të palodhur në këtë drejtim për edukimin e fshatarësisë dhe veçanërisht të këshilltarëve. Natyrisht, këshillat e fshatrave dhe këshilltarët e popullit duhet të ndihmohen shumë nga lart që të kuptojnë mirë detyrat e tyre moralo-politike, të kuptojnë mirë ligjet dhe urdhëresat që të mundin t'i zbatojnë ato pa u gabuar. Këshilltarët e fshatit duhet të njohin si duhet çështjet e bujqësisë dhe të mos mjaftohen vetëm me njohuritë e tyre praktike. Fshati ynë po përparon si nga ana ekonomike ashtu edhe kulturele. Fshatari ynë është politikisht shumë i ngritur, ka një ndjenjë e një nuhatje shumë të stërholluar të kuptimit të drejtë të situatave të ndryshme politike dhe kjo i detyrohet, si në çdo sektor tjetër, aktivitetit të palodhur të Partisë, sqarimeve të saja të drejta politike, të cilat kanë bërë të shtohet dhe të gjallërohet patriotizmi e dashuria për atdheun dhe për çdo gjë që është e re dhe përparimtare. Por duhet të themi, dhe veçanërisht për këshilltarët, se këta nuk bëjnë shumë përpjekje në drejtim të ngritjes kulturele të tyre. Fajin nuk mund t'ua

hedhim krejt atyre, pse edhe nga Partia edhe nga Fronti Demokratik nuk bëhen të gjitha përpjekjet, nuk merret me kujdes dhe me këmbëngulje nga dora këshilltari dhe të drejtohet në mësim. Fshatari ynë, ka një zgjuarësi të madhe, ka një praktikë të madhe në punët e bujqësisë, ka vullnet, por ka një të keqe që disa herë kënaqet me pak. Fshatari ynë, duke krahasuar të kaluarën e tij të zezë me të tanishmen, sheh se në jetën e tij janë bërë përparime shumë të mëdha dhe kënaqet. Për këtë ai ka plotësisht të drejtë, por kjo kënaqësi nuk është e mirë në qoftë se ai qëndron në vend. Fshatari ynë s'është aspak budalla, përkundrazi. Këtu është çështja që diçka e frenon të hidhet përpara me një hov akoma më të madh. Këto pengesa janë mbeturinat e së kaluarës, hezitimet, paragjykimet, fanatizmi etj. Këto duhet t'i luftojmë që të çlirohet fshatari. Këto zhduken me një punë të palodhur revolucionare, këto do t'i luftojë dituria, kultura. Në këtë drejtim, me gjithë sukseset e arritura, nuk duhet të kënaqen as shokët e Partisë as anëtarët e Frontit as këshilltarët dhe as fshatarët vetë. E thashë edhe më lart, kjo s'mund të arrihet shpejt e shpejt, por me këmbëngulje dhe me punë sistematike ne duhet ta rrahim çekanin në këtë pikë të rëndësishme dhe do të shohim se këshillat popullore të fshatrave, të rretheve dhe të qarqeve do të shkojnë vazhdimisht duke u forcuar.

Drejtimi kolegjal ka një rëndësi vendimtare kudo. Ky siguron zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të çështjes a të problemit, mënjanon gabimet dhe i ndreq shpejt në rast se vërtetohen, siguron zbatimin e drejtë të vendimit dhe kontrollin e përpiktë të këtij vendimi,

siguron demokracinë e plotë në diskutimin e problemeve, nxit insiativën e njerëzve, edukon njerëzit, është një shkollë e madhe ku gjithsecili sjell kontributin e vet në zgjidhjen e çështjes, zhvillon kritikën dhe autokritikën dhe nuk lejon imponimin e vullnetit të njërit apo të tjetrit, lufton mendjemadhësinë dhe tarafet, lufton ambiciet etj. Sa rëndësi ka, pra, për këshillat popullore të fshatrave puna kolegjiale dhe sa përpara do të kishin shkuar punët në fshat në rast se puna kolegjiale e këshillave do të shikohej si duhej me këtë sy. Ne duhet të njohim, se në këtë drejtim jemi akoma prapa, mjaft prapa. Në shumicën e rasteve punët i drejton dhe mundohet t'i kryejë vetëm kryetari ose sekretari, kurse anëtarët e tjerë të këshillave qëndrojnë formalë, të paaktivizuar. Natyrisht, kjo është një anë shumë e dobët në shokët e Partisë dhe të Frontit Demokratik, prandaj duhet të punojmë që të zhduken këto dobësi.

Njerëzit që zgjidhen në këshillat popullore luajnë një rol vendimtar në zbatimin e drejtë të direktivave të Partisë dhe të qeverisë, në zbatimin e ligjeve dhe të urdhërësive, në zbatimin e vullnetit të popullit. Është pra e domosdoshme që në këshillat popullore të vijë njerëzit më të mirë të popullit. Fronti Demokratik do të dalë me kandidatët e vet. Paraqitja e listave të kandidatëve është një çështje me shumë rëndësi dhe këto duhet të hartohen me kujdesin më të madh. Organizatat e Partisë dhe të Frontit në hartimin e listave të luftojnë me vendosmëri kundër orvatjeve të atyre njerëzve që mund të tërhiqen nga hatëret, nga tarafet, nga pikëpamjet nënvleftësuese ose përçmuese të rolit të këshillave. Populli, Partia, Fronti, ka me qindra mijë burra dhe

gra heroike, të zgjuar, punëtorë, organizatorë dhe organizatore të mira, bujq përparimtarë, ish-ushtarë dhe oficerë të ushtrisë sonë të lavdishme. Këta të zgjidhen me kujdesin më të madh, të zgjidhen ata që e meritojnë më shumë nga besnikëria ndaj qështjes së popullit dhe të Partisë, nga zgjuarësia, nga dituria, nga aftësitë e tyre organizative, nga disiplina e hekurt dhe ndërgjegjia në zbatimin e vullnetit të popullit, nga pjekuria dhe gjakftohtësia, nga dashuria dhe simpatia që ata kanë në popull. Hartimi i listave të kandidatëve të Frontit të karakterizohet nga një diskutim i gjerë, i shëndoshë dhe me syrin kritik. Kjo të jetë shosha e parë, që listat me propozime për kandidatët të kënaqin popullin, por fjalën e fundit, fjalën vendimtare duhet ta ketë vetë populli, me format më demokratike të vendosë dhe të zgjedhë ata, për të cilët ai ka besimin e plotë. Kandidati më i përshtatshëm është ai që zgjedh populli, është ai që do populli. Ky është kandidati më i mirë i Partisë dhe i Frontit Demokratik. Kandidati më i mirë, nuk mund të jetë as ai kandidat që propozon ndonjë komunist ose ndonjë ish-kryetar pushteti o kryetar fronti, të shtyrë nga hatëre dhe miqësi personale. Njerëzit e Partisë dhe të Frontit, në diskutimin e kandidaturave në asnjë mënyrë nuk duhet të flenë. Të mos harrojmë, dhe këtë e theksova në fillim, se armiqtë e popullit do të përpiqen si kurdoherë ta pengojnë forcimin e pushtetit me një-mijë mënyra, duke diskredituar njerëzit e mirë, duke propozuar njerëz të plogësht (mund që këta të mos jenë të këqinj, por e keqja e tyre është se janë të plogësht dhe pushteti s'ecën përpara, problemet nuk zgjidhen) e plet forma të tjera. Komunistët dhe njerëzit e Frontit,

kanë të gjitha të drejtat të argumentojnë me fakte bindëse meritat e njërit ose të tjetrit kandidat dhe me fakte bindëse të shkallmojnë ngatërresat e kulakëve, të dallaveraxhinjve, të tarafxhinjve etj. Populli le t'i gjykojë vetë të gjitha faktet që parashtrohen nga cilido qoftë dhe pastaj le të votojë lirisht dhe demokratikisht për cilin të dojë. Vetëm zgjedhje të tilla dhe njerëz me garanci të tilla, do të sjellin në këshillat popullore gjak të ri; ato do të forcohen vazhdimisht, fshati dhe vendi ynë do të bëjnë hapa të mëdhenj përpara. Vetëm kështu këshillat tona popullore do të lidhen akoma më ngushtë me masat, vetëm kështu ato do të japin si duhet llogari para masës dhe do të kontrollohen si duhet nga masa, do t'i kryejnë si duhet detyrat e tyre të larta. Ne kemi bindjen se Fronti Demokratik i Shqipërisë, i udhëhequr nga Partia jonë heroike, do t'i kryejë me nder këto detyra kaq të mëdha përpara kësaj fushate të madhe dhe me kaq rëndësi për vendin tonë.

Në të gjitha fushatat me karakter politik, ekonomik dhe kultural populli ynë vazhdimisht e ka treguar sa i lidhur ngushtë e përjetë është ai me Partinë e tij të dashur, besnike e marksizëm-leninizmit, sa i lidhur ngushtë është ai me qeverinë e tij. Populli ynë e ka fare të qartë se në saje të udhëheqjes vendimtare dhe të urtë të Partisë së tij të Punës, ai fitoi përgjithmonë lirinë dhe pavarësinë, se atdheu ynë është sovran dhe ndërtohet me sukses socializmi. Partia dhe qeveria jonë, vazhdimisht dhe me konsekuencë luftojnë për t'i siguruar popullit një të ardhshme të lumtur dhe më të begatshme, luftojnë me këmbëngulje për mbrojtjen e paqes në botë. Për punën e madhe që është bërë në vendin tonë në kë-

të dekadë tregojnë veprat e kryera në industri e miniera, në bujqësi, në transport, në elektrifikim, në arsim e kulturë etj., tregon jeta e popullit që është përmirësuar dhe që vazhdimisht po përmirësohet. Populli, me besim të madh te Partia, u hodh me guxim në rindërtimin e jetës së tij të re, për të ndërtuar një jetë të begatshme dhe të kulturuar. Shqipëria s'njihet nga e kaluara, ajo është zbukuruar dhe zbukurohet përditë. Shqipëria s'kishte fare industri, sot ajo ka një industri të fuqishme. Shqipëria kishte një bujqësi të mjerucshme, tani kjo ka bërë përparime të mira dhe çdo ditë ecën përpara, Shqipëria s'kishte shkolla, ose kishte shumë pak, tani shkolla dhe mësimi janë bërë buka dhe ajri i domosdoshëm i punonjësve më të thjeshtë. Të mos flasim për zhvillimin e artit dhe të kulturës në të kaluarën. Nga errësira më e madhe dje, sot gjendja ka ndryshuar rrënjësisht dhe po lulëzojnë arti e kultura e re. Mjaft njerëz nuk kishin besim se do të realizoheshin gjithë këto gjëra, ata dyshonin, lëkundeshin, influencoheshin nga shpifjet e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Edhe këta njerëz kanë ndryshuar. Nuk janë më të parët, rruga e drejtë e Partisë dhe e qeverisë sonë, vullneti i madh i popullit që bëri dhe do të bëjë mrekulli, jeta që ndryshon përpara syve të tyre, i bëri këta njerëz më realistë. Dhjetë vjet kanë kaluar nga koha që jemi çliruar dhe kjo ka qenë edhe për këta njerëz një provë e madhe. Gjithë këto ndryshime të mëdha që janë vërtetuar në vendin tonë nuk mund të mos influencenin pozitivisht në shpirtin dhe në ndërgjegjen e çoroditur të mjaft njerëzve që deri dje kanë mbajtur qëndrime jo të mira. Është një sukses i Partisë dhe i pushtetit popu-

llor dhe një kënaqësi e madhe, kur shikon se përpjekjet nuk shkojnë kot, se shpejt ose vonë shumë njerëz bëjnë kthesë, gjejnë rrugën e vërtetë, bashkohën me përpjekjet e popullit, rehabilitohen dhe fillojnë punën si njerëz të rinj, si njerëz që dalin vonë nga errësira, por më mirë vonë se sa kurrë. Nuk duhet të ngatërrohet sektarizmi me vigjilencën. Vigjilenca duhet vazhdimisht të shtohet në popull, kundër armiqve të Partisë dhe të popullit, të fshehtë dhe të hapët, të brendshëm dhe të jashtëm dhe ndaj këtyre armiqve të mos hezitohet që të merren masat më të rrepta që parashikojnë ligjet e pushtetit tonë popullor. Çdo zbutje e vigjilencës është një humbje e konsiderueshme, është një thikë që i futet trupit të atdheut tonë. Këtë asnjë qytetar i Republikës nuk e dëshiron dhe nuk duhet ta lejojë. Asnjëri nuk këshillon që t'u hapen dyert e pushtetit dhe të aktiviteteve politike, ekonomike e shoqërore njerëzve që nuk kanë garanci, njerëzve që nuk kanë dhënë prova dhe që nuk japin prova, ose që nuk qëndrojnë konsekuentë në rrugën e drejtë të popullit. Jo, duhet të ruhem nga lëshime oportuniste të tilla që dëmtojnë çështjen e popullit. Por të jesh gjithashtu sektar, të mos shikosh çështjen konkretisht në zhvillimin historik të ngjarjeve, të mos ndihmohesh ata që kanë gabuar ose që gabojnë dhe që kërkojnë të ndërrojnë rrugën e gabuar e që japin prova në këtë drejtim, ky është një qëndrim i gabuar, që i sjell dëm çështjes së përgjithshme. Marksizëm-leninizmi na mëson se karakteri dhe natyra e njerëzve është e ndryshueshme dhe këtë e vërteton realiteti ynë. Partia jonë, me prova të mëdha, me edukatën e saj, me politikën e saj, me qëndrimet e saj të urta dhe të matura, ka ndry-

shuar faqen e Shqipërisë, fatet e Shqipërisë, pra, krahas me këto kanë ndryshuar e ndryshojnë dhe përmirësohen edhe njerëzit. Njerëz të thjeshtë Partia i edukoi dhe i bëri heronj që dhanë jetën për atdheun, njerëz të prapambetur, i zgjoi, iu dha dritën, mësimin dhe sot ata i shërbejnë me devocion popullit. Interesat e larta të atdheut e duan që armikut të popullit të mos i lihet asnjë fushë veprimi, t'i shkatërrohet atij çdo shpresë dhe çdo ëndërr, të izolohet armiku dhe të mbetet lakuriq dhe i neveritshëm nga të gjithë, edhe prej atyre që deri dje i shikonin çështjet krejt ndryshe. Armiqtë, tradhëtarët, nuk do t'i pushojnë as shpifjet as gënjeshttrat. Përballë këtyre ne kemi faktet, kemi veprat, kemi më në fund dhe ligjet e shtetit tonë për t'i dërmuar kur ata do të guxojnë të veprojnë kundër interesave të popullit. Fronti Demokratik në këtë drejtim duhet të ndjekë mësimet e Partisë dhe të luftojë sektarizmin e disave që janë dritëshkurtër dhe nuk arrijnë dot t'i gjykojnë realisht situatat që ndryshojnë përpara tyre. Të meta serioze vërtetohen në këtë drejtim në punën e organizatave të Frontit, për pranimin e anëtarëve të rinj, për dhënien e kartave të Frontit, për aktivizimin në detyrat e Frontit të të gjithë qytetarëve të Republikës. Ka akoma raste që në disa organizata të Frontit veprojnë hatëret, intrigat e vogla etj.

Zgjedhjet tona zhvillohen në një frymë hareje dhe në mënyrën më demokratike. Asnjë njeri s'ka votuar me përdhunë në të gjitha zgjedhjet e ndryshme të pushtetit e të tjera që janë zhvilluar në vendin tonë, siç na shurdhojnë veshët radiot e Perëndimit dhe tradhëtarët shqiptarë që shërbejnë në këto radio kundër atdheut të tyre.

Natyrisht, zgjedhjet e lira dhe demokratike që bëhen në vendin tonë, ata i gyykojnë sipas tyre, pse dhuna dhe ryshfetet, intrigat e kërcënimet ngjasin vetëm në vendet e tyre ku sundojnë klikat kapitaliste dhe imperialiste. Që t'u besojë njeri këtyre shpifjeve, duhet që të tilla gjëra të ngjasin në vendin tonë. Për fat të keq të atyre, këto gjëra nuk ngjasin dhe nuk do të ngjasin kurrë dhe kurrë populli ynë nuk do t'ua vërë veshin këtyre shpifjeve. A ka pasur njerëz në votimet tona që kanë votuar kundër? Ka pasur. Numri i tyre ka qenë jashtëzakonisht i vogël. Mbi 99 për qind kanë votuar për Frontin Demokratik, për politikën e drejtë të Partisë dhe të qeverisë sonë. Me siguri, dërmuese do të jetë edhe këtë herë pjesëmarrja në votime për këshillat popullore të fshatrave dhe dërmuese do të jetë përqindja e votimeve për kandidatët e Frontit Demokratik. Dhe kjo ka arësye të shëndosha. Populli shqiptar hodhi tej përgjithmonë zgjedhën shekullore të feudalëve, të borgjezisë gjakpi-rëse, të okupatorëve fashistë, ai krijoi pushtetin e tij popullor, ai rindërtoi vendin e tij të shkatërruar, ai ndërton socializmin dhe jetën e lumtur në atdheun e tij të lirë, të pavarur dhe sovran. Populli shqiptar u bëri ballë me sukses furtunave të pasluftës, u rezistoi me sukses shantazheve, kërcënimeve, sulmeve të qarqeve reaksionare të Perëndimit. Populli shqiptar po realizon me sukses planin e tij të parë pesëvjeçar dhe po harton planin e dytë pesëvjeçar në kushte akoma më të favorshme të brendshme dhe të jashtme se pesë vjet më parë. S'është nevoja të ripërsëritim sukseset e arritura në vitet e kaluara, por le të përqëndrohemi shkurtimisht në realizimet e tetëmujorit të këtij viti. Rezultate të

rëndësishme janë arritur në realizimin e planit të shtetit të këtij viti. Gjatë këtyre tetë muajve, vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial është realizuar 102,4 për qind kundrejt planit. Plani tetëmujor për disa degë të industrisë është realizuar si vijon: Në industrinë e naftës dhe të bitumit 107,3 për qind, në qymyr guri 99,8 për qind, në energjinë elektrike 109,1 për qind, në industrinë mekanike 104 për qind, në industrinë e lehtë 100,9 për qind etj. Plani i industrisë lokale është realizuar 103,4 për qind dhe plani i prodhimit të kooperativave të artizanatit — 102,7 për qind.

Në bujqësi fushata e mbjelljeve të pranverës me gjithë vështirësitë klimaterike u realizua me sukses. Mbjelljet, si vit bujqësor në krahasim me periudhën korresponduese të vitit të kaluar, u realizuan 100,6 për qind. Mbjelljet në përgjithësi janë kryer në kushte të mira agroteknike. Prodhimi i të lashtave këtë vit ka qenë i kënaqshëm dhe më i mirë se vitin e kaluar, me gjithë dëmtimet nga kushtet atmosferike. Rezultate të mira dhe të kënaqshme parashikohen për misrin, pambukun, duhanin, panxharin si dhe për të gjitha kulturat e tjera të vona. Gjatë këtij viti është rritur shumë më tepër mekanizimi i punimeve bujqësore. Vëllimi i punës së kryer nga SMT-të në unitet hamullor gjatë gjashtëmujorit të këtij viti, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, është rritur 47,1 për qind. Është rritur pra, ndihma e shtetit në sektorin e bujqësisë. Krediti agrar, dhënë fshatarësisë vetëm me rastin e mbjelljeve të pranverës, ka qenë 56 për qind më shumë se vitin e kaluar, farëra të seleksionuara — 41 për qind, plugje — 109,8 për qind, kultivatorë — 3,4 për qind,

lesa hekuri — 188,5 për qind, plehra kimike — 114,8 për qind etj.

Suksese të rëndësishme në realizimin e planit gjatë kësaj periudhe janë arritur edhe në sektorët e tjerë. Gjatë këtyre tetë muajve vëllimi i punimeve në ndërtim është realizuar 105,4 për qind, nga i cili ndërtimet e kryera nga ndërmarrjet nacionale të ndërtimit janë realizuar 106,3 për qind, nga ato lokale — 102,9 për qind. Gjatë kësaj periudhe u ndërtuan dhe u vunë në shfrytëzim fabrika e çimentos, kompleksi i Koplikut për ujitjen e duhanit, kanali ujitës Vjosë-Levan-Fier etj. Njëkohësisht vazhdojnë punimet me ritmet e duhura për të përfunduar në afatet e caktuara, Rafinerinë e Naftës në Cërrik, Hidrocentralin mbi lumin e Matit, Fabrikën e Konservave të Peshkut në Vlorë, emisarin¹ për tharjen e liqenit të Tërbufit e të tjera objekte të rëndësishme.

Gjatë këtyre tetë muajve janë transportuar 1 milion e 243 mijë ton mallra ose 122,6 për qind kundrejt planit. Po të krahasojmë realizimin e planit si gjashtëmuor të këtij viti me atë të vitit të kaluar përsa i përket transportit të mallrave, do të shohim se është realizuar në ton/km 22,4 për qind më shumë.

Si rezultat i realizimit me sukses të planit në mjaft sektorë dhe degë të ndryshme të ekonomisë është gjallëruar dhe më shumë tregu dhe është përmirësuar furnizimi. Gjatë këtyre tetë muajve i janë shitur popullsisë nëpërmjet tregëtisë socialiste mallra të ndryshme me një vleftë prej 7 miliard e 401 milion lekë. Në krahasim

¹ Kanali kryesor (kolektor) për kullimin e ujërave.

me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti tregëtia socialiste ka furnizuar popullatën me më shumë: sheqer 26,5 për qind, makarona 4,3 për qind, djathë e gjizë 36,7 për qind, fasule e oriz 92,6 për qind, mish e peshk 39,9 për qind, yndyrna 18,3 për qind, vajguri 14,4 për qind, të pambukta 1,5 për qind, të leshta 52,7 për qind, këpucë 49,8 për qind.

Këtë vit mbaruan shkollat fillore 26 405 nxënës, shkollat 7-vjeçare — 7 594 nxënës, shkollat e mesme — 1 800 nxënës dhe institutet e larta — 186 studentë.

Këto rezultate të rëndësishme në realizimin e planit të shtetit i detyrohen politikës së drejtë dhe tejpamëse të Partisë dhe të qeverisë dhe mobilizimit heroik të masave punonjëse. Këto rezultate e kanë kënaqur popullin, i cili i prek çdo ditë me duart e veta të mirat që i sjellin Partia e tij e dashur dhe pushteti popullor. Por a kemi ne vështirësi, pengesa, mungesa, të meta në punën tonë? Sigurisht kemi. Ne mund të bënim dhe duhet të bëjmë edhe më shumë, vetëm duke punuar më mirë, duke e organizuar punën më mirë. Partia lufton në krye të punonjësve që të zhduken të metat dhe gabimet në punë, të edukojë njerëzit në punë dhe jashtë punës, t'i pajisë ata me kulturë dhe t'i bëjë më të zot. Qeveria jonë punon me të gjitha forcat që të vendoset një disiplinë e hekurt në realizimin e planeve, që të shfrytëzohen në maksimum mundësitë dhe rezervat e brendshme që janë akoma shumë të mëdha, të shtohet rendimenti në punë, të ulët kostua e mallrave dhe të përmirësohet cilësia e prodhimeve. Në këto drejtime ne kemi arritur suksese, por kemi akoma shumë për të

bërë. Po hartohet plani i dytë pesëvjeçar, i cili bazohet në realizimet e shëndosha që ka arritur ekonomia jonë popullore. Investime të mëdha do të bëhen në sektorët prodhues. Është e nevojshme më tepër se kurrë, të mobilizohen të gjithë njerëzit, ndershmërisht e me ndër-gjegje, të jenë realistë në kërkesat dhe në hartimin e planeve, ta kursejnë sa më shumë lekun e popullit dhe të investohet atje ku i sillen dobi më të mëdha popullit. Të luftohen fantazitë, planet e fryra dhe pa baza, të luftohet për thjeshtësinë dhe për shfrytëzimin e plotë të të gjitha mundësive që ekzistojnë në çdo sektor. Megjithëse në këtë drejtim janë arritur mjaft suksese, është krejt e palejueshme që ndërmarrjet ekonomike të mos shfrytëzojnë akoma më shumë maqineritë moderne dhe të vjetra, të mos zbulojnë dhe të mos shfrytëzojnë rezervën më të vogël të tyre të brendshme, të mos ulin më shumë koston, të mos ngrenë më shumë rendimentin e punës dhe të mos luftojnë për cilësinë e prodhimit. Pesëvjeçari i dytë jo vetëm që na gjen me fabrika dhe maqineri moderne sovjetike etj. në duar, por ne kemi krijuar dhe me mijëra kuadro të lartë dhe të mesëm, të cilët kanë vite që po punojnë me këto maquina dhe, natyrisht, janë më të ngritur e më të perfeksionuar. Prandaj ne duhet medoemos të shënojmë përparime gjatë planit të dytë pesëvjeçar.

Në bujqësi gjithashtu duhet në radhë të parë fshatarësia të shfrytëzojë në maksimum veprat e mëdha që ka kryer pushteti i saj popullor në favor të bujqësisë. Fshatarësia të mobilizohet e tëra, të shfrytëzojë në maksimum SMT-të, farërat e zgjedhura, plçhrat kimike, kanalet ujitëse. Të mendohet realisht që këto investime

kolosale duhet të shtojnë rendimentet dhe të përmirësojnë cilësinë. Në qoftë se këto nuk shfrytëzohen realisht nga fshatarësia punonjëse, në qoftë se fshatari kënaqet me pak, relativisht me mundësitë e mëdha që i janë krijuar, atëherë ekonomia jonë popullore do të dëmtohet, do të dobësohet aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë. Çështja e përdorimit të kanaleve ujitëse, të metodave të reja agroteknike, të sistemimeve agrare, të seleksionimit të farërave etj. janë detyra dhe nevoja të domosdoshme për fshatarësinë, për ekonominë e saj individuale, për ekonominë kooperativiste dhe për ekonominë e Republikës si tërësi. Prandaj fshatarësia jonë patriote dhe punonjëse duhet t'i bëjë plotësisht të sajat këto probleme dhe të mobilizohet e tëra për t'i zgjidhur këto. Partia dhe qeveria do ta ndihmojnë pa pushim fshatarësinë në organizimin e punës me anë të mjeteve, me anë të kredive etj. Është një ditë e bardhë për klasën punëtore që udhëheq fatet e vendit tonë dhe për të gjithë punonjësit e Republikës, që fshatarësia jonë po del me guxim nga prapambetja. Ajo do të ketë vazhdimisht përkrahjen e fuqishme të Partisë dhe të klasës punëtore. Bujqësisë do t'i vihen të gjitha forcat, do të investohen miliarda lekë të tjerë në bujqësi për pesëvjeçarin e dytë dhe këto investime, me siguri do ta përmirësojnë akoma më shumë jetën e popullit tonë. Fshatit ka nevojë të madhe për njerëz të mësuar dhe të sakrificës që të shkojnë në fusha dhe ta edukojnë fshatarin në organizimin e punës. Partia dhe qeveria po mësojnë në shkollat njerëz dhe vazhdimisht po i dërgojnë në fshat. Por këta s'janë të mjaftë. Shumë kuadrove, shumë njerëzve të mësuar, shumë njerëzve që janë organizatorë, u

ka hipur sëmundja e zyrave, me vështirësi ata shkojnë të punojnë në fshat. Këta njerëz preferojnë të futen nëpunësa nëpër zyra, në vend që të hidhen atje ku janë vështirësitë, atje ku është lufta. Këta njerëz duhet të ndërrojnë pikëpamje. Kursimi i lekut të popullit do të bëhet edhe me shkurtimin akoma më shumë të aparateve shtetërore në qendër dhe në bazë, do të kërkohet sigurisht kualifikim më shumë dhe do të normalizohet më mirë trajtimi i punonjësve në bazë të rendimentit të secilit në punë.

Të shërbejë, pra, fushata e zgjedhjeve të këshillave popullore të fshatrave, për të forcuar pushtetin tonë popullor, për t'i bërë akoma më të qarta dhe të kuptueshme në masat e popullit shumë çështje dhe probleme, të luftohen shumë mbeturina të së kaluarës që pengojnë ritmin e zhvillimit tonë përpara, të qërohen shumë ferra dhe pengesa të panevojshme dhe të mërzhitshme në punën tonë frutdhënëse. Me rastin e fushatës së zgjedhjeve të këshillave popullore të fshatit, Fronti, në mënyrë të organizuar, të mobilizojë njerëzit më të mirë të tij, punëtorët, intelektualët dhe t'i dërgojë ata në fshat, jo vetëm të shfaqin skeçe dhe t'u bien veglave muzikore, por t'u flasin, t'u shpjegojnë fshatarëve problemet aktuale të vendit tonë, ta ndihmojnë fshatarin konkretisht të kuptojë shumë gjëra, si punon dhe zhvillohet puntoria jonë, përpjekjet konkrete të saja, si rritet dhe zhvillohet rinia, përparimet e vendit tonë e perspektivat e së ardhshmes dhe metodat që duhet të përdorim për të korrur suksese të mëtejshme në punën tonë ndërtimtare. Njerëzit e qytetit dhe ata të fshatit, me këtë rast të njohin më mirë njëri-tjetrin, të zhvillojnë

bisedime, të shkëmbejnë mendime shoqërisht mbi nevojat e njëri-tjetrit dhe mbi detyrat e gjithsecilit në ndërtimin e Shqipërisë së re. T'u rishpjegojnë fshatarëve rëndësinë e madhe që kanë për fshatin dhe për gjithë Republikën problemet sezonale të bujqësisë. Sigurisht fshatari e di dhe e kupton sa rëndësi kanë për të vjelja dhe grumbullimi me kohë i misrit, i pambukut, i duhanit, i panxharit të sheqerit. Por është fakt që shumë fshatarë i shikojnë këto çështje në prizmin e ngushtë personal dhe nuk arrijnë të kuptojnë sa humbet ekonomia e tij dhe gjithë ekonomia popullore, në rast se misri kalbet në arë, në rast se pambuku kalbet dhe bie në tokë, në rast se duhani nuk manipulohet në bazë të kërkesave të fabrikës dhe të klientëve të jashtëm. Në rast se të gjitha këto detyra nuk shihen me këtë sy nga ana e fshatarësisë, natyrisht, s'ka se si të mos ndjejë edhe fshatarësia mungesë në furnizimin e mallrave të fabrikuara, pse do të mungojë lënda e parë, do të vuajnë investimet që bëhen në bujqësi, shteti nuk do të jetë në gjendje t'u plotësojë fshatarëve nevojat e tjera me kredi, me farëra, me kafshë pune, me mjete të mekanizuara. Të gjitha këto probleme organizata jonë e Frontit Demokratik duhet t'i ngrejë në kuptimin e gjerë, me rastin e fushatës së zgjedhjeve, e cila të kthehet në një manifestim dhe në një shkëmbim pikëpamjesh të shëndosha, që të shërbejë dhe të ketë për qëllim forcimin akoma më shumë të vendit tonë, të pushtetit tonë, të aleancës në mes të klasës punëtore dhe të fshatarësisë, t'u japë një hov dhe një gjallëri akoma më të madhe punës sonë ndërtimtare dhe kryerjes me sukses të detyrave të mëdha për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar.

Fushata e zgjedhjeve të këshillave popullore do të bëhet në kushte shumë më të favorshme si nga ana e brendshme, ashtu edhe nga ana ndërkombëtare. Situata e brendshme e vendit tonë, nga çdo pikëpamje është forcuar shumë. Këtë ia detyrojmë udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë dhe ndihmës së Bashkimit Sovjetik. Dashuria e popullit tonë për Bashkimin Sovjetik, është e thellë dhe e sinqertë, pse Bashkimi Sovjetik na ndihmoi të çlirohemi, na ndihmoi dhe na ndihmon në mënyrë vëllazërore të ndërtojmë jetën e re në Shqipërinë e re të popullit. Ndjenjat e larta vëllazërore që ka shqiptari për popujt sovjetikë, t'i çelnikosim, t'i mbajmë të pastra dhe të paprekshme. Gjithë njerëzve të Shqipërisë u vihet për detyrë, në interes të popullit dhe të atdheut, që ndihmat e shumanshme qoftë në lëmin ekonomik, qoftë në arësim, kulturë, qoftë në fushën ndërkombëtare, që Bashkimi Sovjetik i jep vendit tonë, të shfrytëzohen në maksimum në interesin e mirëqenies së popullit, në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Prandaj punëtorët, fshatarët, intelektualët t'i shfrytëzojnë në maksimum të gjitha mundësitë e mëdha që na ka krijuar ndihma e Bashkimit Sovjetik, të përdorim sa më mirë maqineritë në interes të popullit, të shfrytëzojmë si duhet ndihmën që Bashkimi Sovjetik i jep dhe do t'i japë bujqësisë sonë, të mësojmë pareshtur nga Bashkimi Sovjetik, për të ngritur kulturën në vendin tonë dhe ta vëmë këtë kulturë në shërbim të popullit, në shërbim të përmirësimit të jetesës së popullit. Populli ynë shpejt do të festojë 10-vjetorin e njohjes së qeverisë sonë nga qeveria sovjetike. Për popullin tonë kjo është një datë e shënuar në historinë tonë, pse popujt sovjetikë i dhanë

dorën Republikës sonë të re, i dhanë zemër një populli të vogël që luftoi heroikisht në shekuj për t'u çliruar. Fushata e zgjedhjeve duhet të shërbejë që të rritet akoma më shumë miqësia e madhe që ushqen populli ynë për Bashkimin Sovjetik. T'ua bëjmë akoma më shumë të qartë punonjësve të Shqipërisë, jetën e lulëzuar të njerëzve sovjetikë, sukseset kolosale të Bashkimit Sovjetik në të gjitha fushat e jetës. Të njohë populli ynë luftën dhe përpjekjet e mëdha që bën Bashkimi Sovjetik në krye të kampit të paqes dhe të socializmit, për uljen e tensionit ndërkombëtar, për mbrojtjen e paqes.

Një miqësi shumë e madhe dhe e sinqertë e lidh popullin tonë me popullin e madh vëlla kinez dhe me popujt vëllezër të vendeve të demokracisë popullore. Popujt e vendeve tona janë si një familje e madhe që duhen dhe ndihmojnë përzemërsisht njëri-tjetrin. Sukseset e njëri-tjetrit janë suksese të përbashkëta që gëzojnë zemrat e popujve tanë. Populli ynë si pjesëtar i kësaj familjeje të madhe ndihmohet bujarisht nga popujt e vendeve të demokracisë popullore. Kjo ndihmë ka ndikuar në përmirësimin e jetës së popullit tonë, ka ndikuar në ndërtimin e bazave të socializmit, ka ndikuar në forcimin e pozitive të brendshme dhe ndërkombëtare të atdheut tonë. Këtë miqësi ne duhet ta ruajmë dhe ta forcojmë çdo ditë. Ta njohim popullin tonë akoma më shumë me realizimet dhe jetën e vëllezërve tanë të vendeve të demokracisë popullore, të përfitojmë sa më shumë nga eksperiencia e popujve të këtyre vendeve, nga ndihma që ata na japin.

Ne jemi për miqësinë me popujt vëllezër të Jugos-

llavisë. Popujt jugosllavë kanë qenë dhe janë të dashur për ne. Ne luftuam së bashku me vëllezërit jugosllavë për lirinë e pavarësinë kundër okupatorëve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit. Ne fituam së bashku lirinë dhe të drejtat që të rronim në miqësi, të lirë, të pavarur dhe sovranë. Me Jugosllavinë ne kemi lidhur marrëdhënie ekonomike. Këto marrëdhënie do të forcohen akoma më shumë në të ardhshmen. Ne do të shkëmbejmë delegacione kulturele, sportive etj. Ne kemi bindjen se marrëdhëniet tona do të zhvillohen në frymën e miqësisë, bashkëpunimit dhe leverdisë reciproke si dy shtete të lira dhe sovrane.

Mbrojtja e paqes është sot një detyrë e madhe e kampit tonë të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye dhe e gjithë popujve të botës. Këto dy vjetët e fundit, si rezultat i politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe i vendeve të tjera që duan dhe luftojnë për paqe, është dukur një ulje e tensionit në marrëdhëniet ndërkombëtare, gjë që është në interes të mbrojtjes dhe të forcimit të paqes. Përfundimi me sukses i Konferencës së Gjenevës të të katër të mëdhenjve solli si rezultat uljen e mëtejshme të tensionit ndërkombëtar dhe tregoi qartë se është e mundur që disa çështje me karakter ndërkombëtar mund të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve dhe negociatave. Konferenca e Gjenevës tregoi gjithashtu se është e domosdoshme të krijohet besimi reciprok në mes të shteteve në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare, të braktiset politika nga «pozitat e forcës» e predikuar nga qarqet imperialiste luftënxitëse dhe të zhduket «lufta e ftohtë» e predikuar dhe e vënë në zbatim po nga këto qarqe impe-

rialiste. Pas Konferencës së Gjenevës Bashkimi Sovjetik ka marrë një sërë masash të rëndësishme dhe konkrete që ndihmuan në uljen e tensionit ndërkombëtar në marrëdhëniet ndërkombëtare, për krijimin e besimit reciprok dhe të bashkëpunimit midis shteteve, për ndalimin e luftës në të cilën duan ta hedhin botën qarqet imperialiste reaksionare të Perëndimit. Propozimet e Bashkimit Sovjetik për çarmatimin, për ndalimin e armëve bërthamore të shfarosjes në masë, propozimi i Bashkimit Sovjetik për krijimin e një pakti të sigurimit kolektiv në Evropë, propozimet e drejta të Bashkimit Sovjetik për bashkimin e Gjermanisë, sigurimi i pavarësisë dhe i neutralitetit të Austrisë etj., kanë kontribuar në uljen e tensionit ndërkombëtar dhe kanë hapur perspektiva të reja dhe shpresëdhënëse në përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes ndërkombëtare. Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore japin çdo ditë prova konkrete të luftës së tyre të vazhdueshme në uljen e tensionit ndërkombëtar. Bashkimi Sovjetik i hoqi dhe i çmobilizoi forcat ushtarake që gjendeshin në Austri. Bashkimi Sovjetik, siç dihet, vendosi çmobilizimin dhe pakësimin e forcave të armatosura në numër prej 640 000 vetësh. Një veprim të tillë bënë edhe vendet e demokracisë popullore. Gjithashtu qeveria jonë mori vendimin që të pakësojë forcat e armatosura të vendit tonë në numër prej 9 000 vetësh.

Populli ynë, Partia dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë përshëndetin dhe përkrahin fuqimisht të gjitha masat që kanë marrë Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera paqedashëse për uljen e tensionit ndërkombëtar. Vendi ynë ka ndjekur dhe do të ndjekë

vazhdimisht një politikë paqësore dhe fqinjësie të mirë. Duke e ndjekur këtë politikë paqësore të fqinjësisë së mirë, qeveria e Republikës sonë ka arritur rezultate në marrëdhëniet me Italinë në interes të të dy vendeve. Në mes të dy vendeve janë lidhur marrëdhënie tregëtare, u përfunduan me sukses bisedimet mbi çështjet e detyrimeve të Italisë ndaj vendit tonë në lidhje me Traktatin e Paqes. Nga ana jonë u liruan ata italianë që vuanin dënimin e tyre për krimet që kishin bërë gjatë luftës kundër vendit tonë. Ne mendojmë se çdo gjë mund të zgjidhet në bazë të parimit të ruajtjes së lirisë, pavarësisë e sovranitetit dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Qeveria jonë, ka qenë dhe është kurdoherë gati, duke u mbështetur në këto parime, të përmirësojë marrëdhëniet edhe me fqinjët e Jugut, grekët. Ne kemi menduar dhe mendojmë se marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me grekët, janë në interesin e të dy vendeve dhe të forcimit të paqes në botë dhe veçanërisht në Ballkan.

Ulja e tensionit ndërkombëtar, që është rezultat i politikës paqësore dhe i përpjekjeve të vazhdueshme të Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë dhe i vendeve të tjera paqedashëse, duhet të na bëjë që të mobilizohemi edhe më shumë për të dhënë kontributin tonë në uljen e mëtejshme të këtij tensioni. Mbrojtja dhe forcimi i paqes është sot detyrë e madhe për çdo patriot, për çdo njeri të ndershëm, që do lirinë dhe pavarësinë e atdheut dhe që lufton për të mirën e popullit.

Të mobilizohet, pra, i gjithë populli, i grumbulluar në Frontin Demokratik, i udhëhequr nga Partia e Punës. e Shqipërisë, për të luftuar me të gjitha forcat për-

realizimin e këtyre detyrave të larta. I gjithë populli të punojë me të gjitha forcat për ta bërë më të fuqishme dhe më të begatshme Republikën tonë Popullore, e cila së shpejti mbush 10 vjet jetë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 232 (2185), 27 shtator 1955

Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA
AMBASADA E REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS
NË TIRANË ME RASTIN E 6-VJETORIT
TË SHPALLJES SË REPUBLIKËS
POPULLORE TË KINËS**

1 tetor 1955

Sot populli vëlla kinez feston 6-vjetorin e shpalljes së Republikës. Kjo është një datë e një rëndësie të jashtzakonshme për popullin kinez dhe për gjithë njerëzimin. Republika Popullore e Kinës u shpall pas një lufte legjendare që bëri populli i Kinës kundër okupatorëve militaristë japonczë, kundër klikës së Gomindanit të shitur te imperialistët dhe kundër imperialistëve, të cilët me çdo mjet u përpoqën ta mbanin nën zgjedhë popullin kinez prej 600 milionësh.

Përpjekjet e armiqve të popullit shpejt ose vonë, natyrisht do të dështonin edhe në Kinë, sikundër dështuan. Një vend dhe një popull i madh, me tradita të lashta e të shkëlqyera kulturale, me tradita të mëdha heroizmi kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, jo vetëm që do t'i thyente zinxhirët e robërisë, sikundër i theu, por ai do të luajë një rol nga më të rëndësishmit në botë dhe veçanërisht në Azi. 600 milion njerëz, u udhë-

hoqën nga Partia Komuniste e lavdishme e Kinës, nga Komiteti Qendror i saj dhe shoku Mao Ce Dun, në rrugën e fitores së plotë dhe sot ata udhëhiqen në rrugën e ndritur të socializmit.

Populli heroik vëlla kinez doli nga errësira në dritë. Kapitalizmi atje u mposht. Imperializmit botëror iu shkëput nga kthetrat e tija një vend i madh, me një numër të madh njerëzish të cilët i shfrytëzonte pa mëshirë. Me çlirimin e Kinës së madhe kampi ynë i socializmit dhe i paqes u forcua. Vendosja e regjimit popullor në Kinë, ngjalli shpresat e mëdha të çlirimit në të gjithë Azinë. Popujt e Azisë shohin te populli kinez, një mbrojtës të fuqishëm të interesave të tyre legjitime, të lirisë dhe të pavarësisë, shohin rrugën e sigurtë të daljes nga zgjedha e imperialistëve, shohin rrugën e vërtetë të ndërtimit të një jete të lumtur, të lirë, sovrane për popujt e tyre. Është pra, e natyrshme që popujt, akoma të robëruar, ta duan dhe ta admirojnë popullin kinez, është gjithashtu e natyrshme që klikat imperialiste ta urrejnë dhe ta luftojnë Republikën Popullore të Kinës.

Lufta që i bëhet Republikës Popullore të Kinës për të drejtat e saja legjitime, siç janë pjesëmarrja në Kombet e Bashkuara dhe kthimi i tokës së saj të Taiwanit, jo vetëm që do të dështojë dhe Kina do të fitojë të drejtat e saja, por popujt e botës po shohin qartë fytyrën e egër të qarqeve imperialiste në këto veprime arbitrare, grabitqare, të padrejta dhe antidemokratike. Është e natyrshme se simpatia dhe përkrahja e të gjithë popujve që luftojnë për paqen dhe miqësinë janë në anën e popullit vëlla kinez. Çështjet në botë nuk mund

të zgjidhen pa pjesëmarrjen e Kinës. Kina e madhe duhet ta thotë dhe do ta thotë kurdoherë dhe kudo fjalën e saj dhe fjala e saj peshon shumë në fatet e njerëzimit. në fatin e paqes në botë, në shkuarjen përpara drejt përparimit.

Miqësia në mes të popujve të lavdishëm sovjetikë dhe kinez, është një nga fitoret e mëdha të njerëzimit. Kjo u detyrohet Partive Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Kinës, i detyrohet leninizmit, që bashkoi njerëzit e ndershëm dhe të thjeshtë me vullnet të mirë, në një rrugë të ndritur, të paqes dhe të socializmit, që bashkoi zemrat dhe forcat e njerëzve në një vullnet të hekurt, për të rrojtur në miqësi me njëri-tjetrin, për të ndihmuar pakursyer njëri-tjetrin në ndërtimin e shteteve të tyre popullore e të lira, në ndërtimin e jetës më të mirë e të begatshme.

Bashkimi Sovjetik i çliroi të gjithë popujt tanë nga fashizmi, nga robëria. Me ndihmën e tij të madhe, në Kinë e në vendet tona të demokracisë popullore, po ndërtohet socializmi. Politika paqësore e Bashkimit Sovjetik, përkrahet dhe mbrohet nga të gjithë popujt tanë të kampit të socializmit dhe të paqes si dhe nga të gjithë njerëzit e thjeshtë të botës. Këto janë suksese të mëdha, të lidhura ngushtësisht me jetën e popujve tanë, me të ardhshmen e tyre.

Dashuria e popullit tonë për popullin vëlla kinez është shumë e madhe dhe e sinqertë. Ajo s'njeh as kufi as largësi. Nuk mund të ketë kurrë kufi në mes të dy vendeve tona aq ngushtësisht të lidhura, me ideale dhe qëllime të njëjta. Zemrat tona janë të bashkuara, janë afër njëra-tjetrës. Gëzimet dhe fitoret e popullit kinez

janë njëkohësisht tonat, ato na gëzojnë dhe na forcojnë ne. Populli shqiptar është për atë që kjo miqësi e ngrohtë, e hapët, e sinqertë, që nuk njeh pengesa, që nuk njeh dete dhe oqeane, të forcohet dhe të çelnikoset. Sa larg ishte për ne Kina, kur te ne dhe në Kinë sundonte çizmja e okupatorit dhe e tradhëtarëve, dhe sa afër janë Kina dhe Shqipëria sot, kur populli është në fuqi. Ne po e njohim dita-ditës më shumë njëri-tjetrin. Populli shqiptar krenohet me sukseset e punëtorit, të fshatarit dhe të intelektualit kinez. Ne mësojmë shumë nga populli i talentuar e guximtar kinez, me kulturë të lavdishme e me zgjuarësi të madhe. Ndihma bujare e popullit vëlla kinez ka kontribuar dhe kontribuon fuqimisht në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Ne u jemi shumë mirënjohës vëllezërve dhe shokëve kinezë. Marrëdhëniet ekonomike dhe kulturele po zhvillohen me sukses në mes të dy vendeve tona. Këto do të zgjerohen çdo vit e më shumë. Popujt e të dy vendeve tona po njihen vazhdimisht me artin e kulturën e njëri-tjetrit. Përfaqësuesit e artit, të muzikës dhe të valleve popullore shqiptare janë pritur me përzierje të madhe në të gjithë Kinën. Në vendin tonë, kanë ardhur disa herë, përfaqësues të artit dhe të kulturës kineze. Populli shqiptar i ka pritur me krahë hapët dhe i ka pëlqyer jashtëzakonisht shumë shfaqjet e tyre të mrekullueshme. Ne kemi fatin të kemi në mes tonë një grup të madh e shumë të talentuar të përfaqësuesve të muzikës, të këngëve e të valleve të popullit kinez. Ne i falenderojmë përzierësisht këta për punën e tyre të palodhur e fisnike, që do të kontribuojë në çimentimin e dashurisë së madhe që lidh

popujt tanë. Shumë i kanë pëlqyer popullit tonë arti, muzika, zotësia dhe talenti i madh i mjeshtërive të artit kinez. Shumë kanë mësuar njerëzit tanë të artit e të kulturës nga shokët kinezë dhe me siguri në repertorët e koreve, të valleve dhe të orkestrave tona do të zërë një vend të rëndësishëm krijimtaria artistike kineze, e cila do t'i shërbejë popullit tonë për t'u njohur më mirë me artin dhe me muzikën kineze, për të kënaqur punonjësit e Republikës sonë dhe për forcimin e miqësisë dhe të dashurisë në mes të popujve tanë.

Ne i urojmë nga zemra popullit vëlla kinez suksese akoma më të mëdha në ndërtimin paqësor të vendit të tij, ne urojmë nga zemra që të forcohet dhe të lulëzojë Republika Popullore e Kinës, ne urojmë me gjithë zemër dhe do të punojmë me të gjitha forcat që të forcohet çdo ditë e më shumë miqësia në mes të popujve tanë.

Ju lutem të ngremë një dolli për miqësinë tonë të madhe, për popullin e lavdishëm kinez, për Partinë heroike Komuniste të Kinës, për Komitetin Qendror të saj, për qeverinë dhe për udhëheqësin e lavdishëm të popullit kinez, shokun tonë të dashur, Mao Ce Dun.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA
AMBASADA GJERMANE NË TIRANË ME RASTIN
E 6-VJETORIT TË KRIJIMIT TË REPUBLIKËS
DEMOKRATIKE GJERMANE**

7 tetor 1955

Jemi mbledhur sot këtu për të festuar me gëzim së bashku ditën e 6-vjetorit të shpalljes së Republikës Demokratike Gjermane. Kjo është një datë e rëndësishme historike për popullin gjerman, sepse ai për herë të parë, me ndihmën e çlirimtarit tonë, Bashkimit të madh Sovjetik, pas përmbysjes së regjimit gjakatar hitlerian, mori në dorë fatet e tij dhe vendosi në pjesën lindore të Gjermanisë një pushtet me të vërtet demokratik, duke realizuar kështu idealet e larta për të cilat kanë luftuar gjatë gjithë jetës së tyre njerëzit më të shquar të popullit të talentuar gjerman.

Ndryshime të mëdha janë bërë në gjendjen e popullit gjerman pas mbarimit të Luftës së dytë botërore. Për herë të parë në historinë e popullit gjerman u ngrit një shtet i ri, që po e çon popullin e Gjermanisë demokratike përpara me sukses në ndërtimin e tij demokratik dhe paqësor. Punëtorët, fshatarët dhe intelektualët e Republikës motër Demokratike Gjermane, janë bërë

sot zotër në vendin e tyre dhe me entuziazëm e dashuri të madhe po ndërtojnë atdheun e tyre të lirë dhe po e bëjnë atë çdo ditë e më të bukur.

Në Republikën Demokratike Gjermane është zhdukur militarizmi dhe forcat paqedashëse të vendit që ndjekin një politikë paqësore po rriten dita-ditës. Kështu Republika Demokratike Gjermane është bërë sot mburoja e paqes dhe vatra ku punohet me të vërtetë për realizimin e dëshirës së zjarrtë të popullit gjerman për bashkimin e tij në një shtet të vetëm demokratik dhe paqedashës.

Por kundër këtij qëllimi fisnik, punojnë dhe luftojnë qarqet kapitaliste dhe fashiste të Gjermanisë Perëndimore, të përkrahura nga qarqet imperialiste të Perëndimit me imperializmin amerikan në krye, që duan ta futin popullin gjerman në rrugën e aventurave të reja, të rrezikshme dhe t'i shkaktojnë kështu atij dhe gjithë popujve të botës fatkeqësi të reja shumë më të mëdha nga ato të parat.

Nuk ka dyshim se planet e imperialistëve nuk do të kenë sukses, sepse forcat paqedashëse në Gjermani dhe kudo në botë po rriten dhe po bëhen një pengesë serioze për imperialistët. Republika Demokratike Gjermane është bërë shpresa e së ardhshmes së popullit gjerman për realizimin e aspiratave të tija të drejta për bashkimin e vendit. Republika Demokratike Gjermane është pjesë e pandarë e familjes së madhe të vendeve që bëjnë pjesë në kampin e paqes dhe të socializmit që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik. Republika Demokratike Gjermane gëzon sot simpatinë e gjithë njerëzimit, paqedashës dhe prestigji i saj ndërkombëtar çdo ditë

po rritet, prandaj ajo nuk mund të dëmtohet lehtë dhe të pengohet në rrugën e saj. Përkundrazi ajo do të vazhdojë të ecë përpara, të forcohet dhe të lulëzojë, pavarësisht nga qëllimet e këqia që ndjekin qarqet reaksionare të sotme të Gjermanisë Perëndimore dhe padronët e tyre me imperializmin amerikan në krye.

Populli shqiptar gëzohet për sukseset e mëdha që ka korrur populli vëlla i Gjermanisë demokratike dhe i uron atij suksese të mëtejshme në punën e tij të frutshme për ndërtimin e socializmit, për forcimin e republikës së tij të re dhe për realizimin e dëshirës së tij legjitime, bashkimin e popullit gjerman në një shtet të vetëm, të pavarur, demokratik dhe paqedashës. Populli shqiptar i është mirënjohës Partisë së Bashkuar Socialiste dhe Qeverisë së Republikës motër Demokratike Gjermane për ndihmat që i kanë dhënë dhe i japin vendit tonë për ndërtimin e bazave të socializmit. Miqësia midis vendit tonë dhe Republikës Demokratike Gjermane do të forcohet edhe në të ardhshmen çdo ditë e më shumë sepse të dy vendet tona ndjekin një rrugë të përbashkët që u përgjigjet plotësisht interesave të popujve tanë, rrugë që ndriçohet nga feneri i pagabueshëm i marksizëm-leninizmit.

Le ta ngremë këtë doli për forcimin dhe lulëzimin e mëtejshëm të Republikës Demokratike Gjermane, për forcimin e miqësisë së popullit tonë me popullin paqedashës gjerman, për Partinë e Bashkuar Socialiste dhe Qeverinë e Republikës Demokratike Gjermane, për udhëheqësin e shquar të popullit gjerman, Presidentin e Republikës Demokratike Gjermane, mikun dhe shokun

e dashur, Vilhelm Pik, për Kryetarin e Këshillit të Ministrave të Republikës Demokratike Gjermane, shokun dhe mikun tonë, Oto Grotevol.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJA NË KONGRESIN E KATËRT TË BASHKIMIT TË GRAVE TË SHQIPËRISË

13 tetor 1955

Të dashura shoqe,

Jam shumë i gëzuar t'i sjell kongresit tuaj dhe gjithë grave punonjëse të Shqipërisë përshëndetjet më të nxehta të Komitetit Qendror, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe t'ju uroj përzemërsisht suksese në punën tuaj shumë të frutshme.

Kongreset tuaja në të kaluarën, ashtu dhe ky që mbahet sot, kanë luajtur dhe do të luajnë një rol të madh në zhvillimin dhe në përparimin e shoqërisë sonë, në ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe kanë ndihmuar në mbrojtjen e paqes në botë. Kongreset tuaja janë shfaqje madhështore të hovit revolucionar të gruas shqiptare, ato janë shprehje të pjesëmarrjes suaj të gjallë në jetën politike të vendit, të forcës së madhe që përfaqësojnë gratë e vendit tonë, forcë, e cila, po të mos vihet në lëvizje, po të mos marrë pjesë në qeverisje, në prodhim dhe në të gjitha aktivitetet shoqërore e kulturele, nuk mund të bëhet fjalë as për

ndërtimin e socializmit as për pushtet popullor as për demokraci të vërtetë. Punët tuaja nuk janë «punë grash», siç don t'i cilësojë borgjezia, ose siç duan t'i nënvleftësojnë disa injorantë dhe të krimbur me mbe-turina mikroborgjeze. Punët dhe vendimet tuaja janë punime e vendime serioze të aktivitetit të Republikës sonë popullore dhe fjala juaj ka një peshë shumë të madhe pse ju përbëni gjysmën e popullsisë së Republi-kës, pse Republika nuk mund të forcohet dhe të për-parojë pa ju.

Kështu vihet çështja e gruas në Republikën tonë popullore dhe vënia e çështjes në këtë mënyrë është rezultati i Luftës nacional-çlirimtare që udhëhoqi Partia jonë e lavdishme e Punës, besnike e ideve të pavdekshme të Marksit-Engelsit-Leninit-Stalinit, është rezultati i revolucionit popullor, i cili përmbysi feudalizmin dhe borgjezinë, çliroi vendin nga okupatorët, solli popullin në fuqi dhe çliroi përgjithmonë gruan nga robëria. I gjithë populli vuante nën zgjedhë në të kaluarën, por gruaja shqiptare vuante akoma më rëndë. Mbi gruan rëndonin ligjet feudoborgjeze që e bënë atë një skllave të vërtetë. Kanunet e sheriatit dhe të kishës, të lidhura ngushtë me ligjet e borgjezisë, e bënë gruan një plaçkë, një send që blihej dhe shitej nga mashkulli, që shfrytëzohej pa mëshirë, që s'guxonte të hapte gojën për të thënë një mendim o një fjalë, por që kishte vetëm të drejtë: të lindte fëmijë dhe të punonte ditë e natë si skllave. Ashtu siç e kishte bërë borgjezia punëtorin, proletarin e saj, ashtu e kishin katandisur gruan edhe zakonet e egra, të vjetra të sheriatit, të kishës, të feudalizmit dhe të borgjezisë, proletaren e burrit. Partia

jonë heroike, ashtu si çliroi proletarin nga kthetrat e borgjezisë, fshatarin nga kthetrat e feudalizmit, çliroi edhe gruan nga kthetrat e ligjeve skllavëruese, të zakonëve të egra, prapanike. Ligjet e shtetit tonë popullor dhe demokratik zhdukën çdo gjë që pengonte gruan në ushtrimin e plotë të të drejtave të saja, e bënë atë të barabartë në çdo gjë me burrin, e bënë atë qytetare të lirë dhe të nderuar të Republikës. Ligjet e pushtetit tonë zhdukën çdo gjë që krijonte inferioritetin e gruas.

Gruaja shqiptare në të kaluarën ka qenë e varur dhe e shfrytëzuar ekonomikisht dhe shoqërisht. Leninizmi na mëson se «vartësisë shoqërore duhet t'ia kërkojmë origjinën në vartësinë ekonomike». Të ndalemi te çështja e gruas. Në të kaluarën ajo varej tërë jetën ekonomikisht nga burri, edhe kur puna e saj e lodhshme, siç ndodhte në më të shumtat e rasteve, qoftë brenda në shtëpi ose në arë, ishte më e rëndë se e burrit. Kur vajza rritej, asaj i thuhej vazhdimisht nga babai: «Unë të ushqej, unë të mbaj frymën gjallë». Kur vajza bëhej nuse dhe shkonte te burri, ky, po atë këngë i këndonte: «Unë të ushqej, unë të mbaj frymën gjallë». Kur plakej gruaja po këtë gjë i thoshte dhe djali. Kush është ajo grua që nuk e ka ndjerë inferioritetin para mashkullit në familje? Vajza në familje kishte vlerë të paktë. Mëma ndjente të njëjtën dashuri si për vajzën ashtu edhe për djalin, por e vlerësonte më shumë djalin, sepse konsiderohej «shtylla e shtëpisë», kurse vajza thuhej se «është për derën e botës».

Vartësia ekonomike dhe vartësia shoqërore e gruas nga burri për një kohë kaq të gjatë dhe të lashtë, u bë si zakon, si ligj i shoqërisë, si gjë e natyrshme. Kaq

është e vërtetë kjo gjë sa akoma në shoqërinë tonë të re, këto mbeturina të rënda të së kaluarës vazhdojnë të jenë të gjalla në meshkuj dhe femra, bile edhe në mjaft komunistë të paformuar akoma si duhet. Megjithatë edhe tani që gruaja e Shqipërisë së re e di fare mirë se ligjet tona dhe zhvillimi i jetës socialiste i sigurojnë asaj të gjitha të drejtat, i sigurojnë në çdo gjë barazinë me burrin, ka gra që e pranojnë në ndërgjegjen e tyre pabarazinë si një gjë të natyrshme dhe shumë herë të drejtë. Ka plot njerëz që vazhdojnë të mendojnë për gruan si në kohën e feudalizmit, por për fat të keq ka edhe nga ata që hiqen si të përparuar, që flasin fjalë bombastike për të drejtat dhe liritë e gruas, por në ndërgjegjen e tyre, në jetën e tyre të brendshme sillen si zotër të plotfuqishëm ndaj gruas. Ç'i shtyn disa gra dhe vajza të Shkodrës dhe të Kavajës që të dalin akoma me perçe? A mos vallë është dëshira e tyre që të errin fytyrën me një copë të zezë dhe ta shohin gjithë botën të zezë? Jo, s'është dëshira e tyre, pse po t'i vësh re, këto gra shkojnë në punë, në sport, në kinema, në teatër dhe e zbulojnë fytyrën, por pasi shohin një herë rreth e rrotull se mos ka ndonjë të njohur. Disa thonë se është forca e zakonit dhe mbeturinat fetare. Kjo është e vërtetë. Por përveç kësaj nuk duhet harruar se është edhe frika e burrit, e babait ose e vëllait. Mashkulli në këto familje e gjen të drejtë të dalë i lirë, të shkojë i lirë në punë, të punojë së bashku me gra të tjera të zbuluara, të vejë në kinema, në teatër, në klub, në kafene, por gruas, motrës ose vajzës së tij nuk ua jep këtë të drejtë. S'ka grua që të mbajë perçe në fytyrë në rast se babai, burri ose djali i thotë femrës «hiqe

perçen, pse është një gjë e tmerrshme për ty, për jetën tënde, për shëndetin tënd dhe perçja nuk të bën aspak më të ndershme se gruan e zbuluar. Nderin gruas nuk ia ruan perçja prandaj flakia në fytyrë perçen otomanëve që e kanë shpikur». Po t'u thuhet atyre grave të pakta që mbajnë akoma perçe, të tilla këshilla nga prindi, burri o vëllai dhe duhet t'u thuhet, në Shqipëri perçja zhduket pa nishan. Vartësia ekonomike e gruas nga burri e mbyllte gruan brenda katër mureve të shtëpisë dhe i njihte asaj vetëm funksionet si mëmë, të lindte dhe të rriste fëmijët, të bënte punët e shtëpisë, t'i lajste dhe t'i shtypte këmbët burrit, vjehrrit dhe vjehrrës dhe kur ajo nuk i pëlqente më burrit ose vjehrrit dhe vjehrrës, burri e çonte gruan me një bohçe me plaçka te babai, duke i dërguar pas pusullën, siç thonë andej nga Jugu, domethënë ndarjen. Ngjiste që burri e ndante gruan për të vetmen arsye se nuk i lindte djalë, po vetëm vajza. Shumë herë nuk e ndante, po martohej edhe nja dy-tri herë të tjera, në mos më shumë dhe kështu e kthente shtëpinë në një harem skllavërie. Për ta mbajtur gruan në këtë gjendje të mjerueshme prej skllavi, përveç despotizmit të burrit, ndërhynte në çdo moment dhe feja, e cila e përforconte këtë despotizëm me anën e ligjeve të saj të egra, të cilat e dërmonin gruan shpirtërisht, e mbanin në errësirën më të madhe, e tmerrnin me frikën imagjinare të zotit, të mëkateve etj. E tillë ishte shkurtimisht jeta e gruas shqiptare në të kaluarën. Kuptohet se ç'brenja dhe ç'mjerime kishte në zemrën e vajzës, të gruas, të mëmës. Kuptohet lehtë sa keq ishte e lidhur dhe sa keq ishte e harmonizuar familja në kohët e kaluara.

Kuptohet lehtë ç'fole injorance dhe të këqias, ç'vuajtje dhe ç'mjerime ekonomike fshiheshin në gjirin e familjes së vjetër, që feudalizmi dhe borgjezia përpiqeshin ta mbanin në këmbë dhe ta idealizonin. Këtë robëri të atdheut, të familjes, të gruas, kërkonin ta mbanin në këmbë dhe kërkojnë ta rikthejnë borgjezia dhe mbeturinat e saja.

Pse Partia jonë e dërmoi këtë të kaluar të hidhur të popullit tonë dhe veçanërisht të gruas, prandaj atë e do populli, e do gruaja shqiptare me gjithë shpirt. Dhe për këtë arsye Partia jonë urrehet dhe luftohet nga borgjezia dhe nga tradhëtarët.

Borgjezët dhe feudalët thoshnin se «gruaja s'duhet të dalë prej shtëpisë, atë e ushqen burri». Partia jonë thotë jo. Gruaja duhet të dalë nga muret e shtëpisë, ajo duhet të ushqehet vetë, të bëhet e pavarur ekonomikisht, sepse vetëm kështu ajo do të jetë e lirë në shoqëri dhe do të zhdukë me guxim të gjitha paragjykimet e këqia të së kaluarës që e kanë burimin në varësinë ekonomike, në mizerjen, në injorancën. Ajo duhet ta fitojë vetë jetën, sepse ndryshe qëndron skllave e mashkullit. Për borgjezinë dhe për feudalët «harmonia dhe dashuria në familje» qëndronin në skllavërimin e një pjese të familjes nga pjesa tjetër. Partia thotë jo. Vetëm në atë familje ku ka barazi në mes të burrit dhe gruas, ku ka liri dhe të drejta të plota si për burrin dhe për gruan, atje ka dashuri të vërtetë, atje ka harmoni, atje ka mirëkuptim dhe jeta është e gëzuar, atje rriten fëmijë të shëndoshë trupërisht dhe shpirtërisht.

Borgjezët dhe feudalët thoshnin se «detyra e gruas është vetëm të lindë dhe të rritë fëmijë». Partia thotë

jo, s'është plotësisht ashtu sepse atëhere edhe meshkujt duhet të kenë vetëm funksionin e burrit dhe të babait. Por meshkujt, funksioni i tyre si burrë dhe baba as që i ndalon të jenë punëtorë, bujq, doktorë, veterinerë, administratorë, traktoristë etj. Pra ne themi, se edhe gratë që kanë misionin e lartë të lindin jetën, s'duhet të pengohen të jenë punëtoare, bujkeshja, traktoriste, administratore, gjykatëse, këshilltare, njerëz të shkencës dhe të artit, deputete etj.

Borgjezët dhe feudalët thoshnin se «gratë janë leshgjata dhe mendjeshkurtëra». S'do shpjegime për të vërtetuar sa e poshtër, sa fyese dhe shpifëse është kjo thënie e tyre. Komunistët janë realistë dhe njohin këtë të vërtetë se burrat përgjithësisht, fizikisht janë më të fortë se gratë, por kjo s'është kurrë e vërtetë përsa i përket intelektit, zgjuarësisë, zotësisë, vullnetit etj. Është e vërtetë të thuhet se në vendin tonë nga ana e diturisë dhe e kulturës, gruaja është akoma prapa nga burri dhe kjo jo për fajin e saj, por për arësyen e së kaluarës së errët që e ka mbajtur gruan në padituri. Ka njerëz në pushtet dhe në ndërmarrjet tona ekonomike që, megjithëse hiqen sikur i kuptojnë mirë problemet e gruas dhe gjoja janë shkundur nga mbeturinat e së kaluarës, kur vjen puna në praktikë, atyre u merrren këmbët dhe pengohen nga këto mbeturina. Shumë herë me zor i marrin gratë në punë dhe sjellin si arësye se gjoja fizikisht s'e bëjnë dot atë punë. Në shumë raste çështja fizike nuk është pengesë, por pengesë janë mbeturinat e këtyre njerëzve në ndërgjegjen e tyre. Ka disa të tjerë që hezitojnë të marrin gra në punë, duke thënë se «ajo bën shumë mungesa meqenëse lind

dhe mua nuk më realizohet plani i këpucëve ose i ndërtimit». Këta njerëz, me fjalë të tjera, i thonë gruas «ktheu në të katër muret e shtëpisë, lind dhe rrit vetëm fëmijë». Këta njerëz mendojnë shumë shtrembër. Partia jonë dhe shoqëria jonë e re lindjen e fëmijëve e konsiderojnë si gjënë më të shenjtë, më të çmueshmen në botë, kurse ata na e barazojnë krijimin e jetës me planin e këpucëve ose të ndërtimit. Ata nuk mendojnë se shteti ynë i ka krijuar kaq favore nënës që kur lind dhe derisa rrit kalamanin, pikërisht për ta ndihmuar, për ta lehtësuar e për ta inkurajuar, për ta nderuar në këtë mision të lartë e jetëdhënës. Prandaj pikëpamjet e dëmshme e prapanike nën çdo formë që ato të paraqiten, duhen luftuar pa mëshirë dhe njerëzit që i kanë këto mbeturina duhen edukuar. Nuk mund të jetë e logjikshme që të marrësh një grua analfabete dhe ta vësh përnjëherë të drejtë prodhimin e naftës, kjo bile do të jetë e dëmshme. Por lufta e Partisë dhe e pushtetit tonë popullor ç'na tregon? Ajo na tregon se me qindra mijë gra marrin pjesë aktivisht në prodhim dhe ato tregojnë zotësi të mrekullueshme. Si ai uji i rrëmbyer që zbret nga burimet dhe i bën fushat pjellore, kështu ka shpërthyer edhe gruaja shqiptare në të gjitha kanalet e aktivitetit të jetës së vendit tonë dhe ajo ka sjellë gjak të ri, gjak të shëndetshëm në punë. Forca e saj mendore, fizike, prodhuese është aq e madhe, sa s'mund të përshkruhet. Forca e zakonit të vjetër flet vetëm për burrin në fusha, flet për «pater familias», të cilit në më të shumtat e rasteve i atribuohen nderimet dhe dekoratat, kurse për gruan heshtet në një kohë kur ajo është hedhur në ara dhe punon me heroizëm. Andej

nga Jugu thonë një fjalë të urtë, «dhentë e dhitë e Zeres, nami i Hasan Qeres». Këto gjëra duhet të marrin fund. Disave mund t'u vijjë hidhur këto të vërteta, por pak punë na prish, pse të vërtetën dhe të drejtën e gruas e mbrojmë dhe do ta mbrojmë me të gjitha forcat, në parim dhe në jetën praktike. Zakonet e këqia, padrejtësitë, shtrembërimet nuk do t'i luftojmë kurrë duke i spërkatur me gjylap.

Shikoni, shoqe të dashura, sa e madhe është forca bindëse e Partisë, sa e drejtë është rruga e saj! Me mijëra vajza ndjekin shkollat fillore, të mesmet, universitetet, me mijëra punojnë në fabrika nga më modernet. Këto deri dje s'dinin nga venin lopët, tani ato prodhojnë me të tilla mjete moderne që grave në vendet e tjera u janë dashur me gjenerata të tëra t'i fitojnë këto zotësi. Me qindra mijë gra, që punojnë në fushat e atdheut tonë, janë bërë bujkësha të dalluara. Ne kemi tani shumë gra mjeke, mësuese, pedagoge, inxhinierë, drejtore fabrikash dhe kombinate, administratore, artiste të talentuara, deputete të popullit. Këto janë gratë e Shqipërisë së re që edukon Partia, janë ato gra që reaksionarët i quanin «leshgjata e mendjeshkurtëra». Kështu thoshnin armiqtë e popullit edhe kur punëtorët e fshatarët tanë morën në dorë drejtimin e vendit: «Me këta reckamanë s'bëhet gjëkafshë, këta janë xhahilë, këta s'kanë asnjë fije shkollë dhe as do të mësojnë kurrë, këta s'dinë të administrojnë» e të tjera profka të këtij lloji, kurse «zotërinjtë borgjezë ishin të vetmit për këto gjëra, i kishte lindur perëndia apostafat të udhëhiqnin fatet e popullit».

Ç'ngjau që prej çlirimit e deri sot në një periudhë kaq të shkurtër kohe? Shiheni dhe shkruajeni vetë

Shqipërinë si e ka ndryshuar faqen, si është zbukuruar e si përparon dhe këtë Shqipëri e zbukuruan, e ndërtnuan dhe e drejtojnë ata dhe ato që deri dje ishin të shtypur, të shfrytëzuar. Por si e drejtojnë dhe e drejtojnë Shqipërinë këta njerëz? Natyrisht këta kanë eksperiencën e madhe të popullit, këta kanë mësuar dhe mësojnë pa pushim, janë edukuar dhe edukohen vazhdimisht nga Partia dhe kështu i dalin zot dhe në sukses çdo gjëje e çdo pune. E ashtuquajtura zotësi e zotërinjve borgjezë dhe e feudalëve tanë, përpara zotësisë së njerëzve të popullit shqiptar, i përngjet asaj dritës së zbetë të hënës, përpara dritës së zjarrtë e të shkëlqyeshme të diellit.

Edukimi i gjithanshëm i gruas shqiptare është një nga problemet më të rëndësishme për Partinë dhe për pushtetin tonë popullor. Kjo gjë ka një rëndësi të jashtëzakonshme për shoqërinë tonë dhe për fatet e vendit. Gruaja duhet të dalë krejtësisht nga prapambetja dhe nga injoranca sidomos gruaja e fshatit. Me këtë nuk dua të them se gruaja e qytetit duhet të lidhë duart duke menduar se ajo çdo gjë e ka arritur. Jo. Në fakt ajo është diçka më përpara nga shoqja e saj e fshatit dhe këtë diçka ajo duhet ta vërë në shërbim, në çdo mënyrë, në çdo formë dhe në çdo rast për të ndihmuar shoqet e saja të fshatit, të cilat kanë nevojë edhe për ndihmë edhe për shembull. Dituria s'ka fund, mësimi dhe edukimi i vazhdueshëm i përngjet ushqimit të përditshëm që, po mungove ta marrësh në kohë, të shkaktón turbullira në shëndet dhe në mendje. Kështu ngjët edhe për ata dhe për ato që kanë mësuar të shkruajnë e të këndojnë dhe nuk ecin përpara, por kënaqen me atë që kanë arritur. Shpejt

këta njerëz do të kthehen në analfabetë. Gjithashtu ata dhe ato që mbarojnë një shkollë dhe nuk vazhdojnë të mësojnë, të mësojnë dhe të mësojnë vazhdimisht, shpejt bëhen të prapambetur dhe mund t'i quajmë injorantë para atyre që ecin përpara. Socializmi, që të ndërtohet, kërkon që njerëzit të jenë të mësuar dhe jeta e lumtur nuk mund të ndërtohet duke mësuar vetëm disa njerëz, ose të mësojnë vetëm burrat dhe gratë të qëndrojnë në vend. Jeta ndërtohet e bukur për të gjithë, frutet e mundit dhe të djersës i gëzojmë të gjithë. Kur të gjithë të përvetësojmë diturinë dhe teknikën, që bëjnë të shtohet prodhimi, atëhere do të kemi prodhime më shumë, do të rrojmë më mirë dhe jeta do të jetë më e gëzuar. Në qoftë se ngritja kulturele dhe politike e gruas nuk bëhet me atë ritëm të shpejtë dhe të sigurtë që kërkon zhvillimi i vetë jetës, atëhere gruaja do të bëhet një barrë e rëndë dhe kjo do të pengojë ecjen tonë përpara, pse s'mund të ketë përparim pa pjesëmarrjen e gruas. Merrni pak me mend sa e trishtueshme mund të bëhet jeta në familje kur gratë qëndrojnë në errësirë, në një kohë kur burrat zhvillojnë intelektin e tyre. Ka shumë burra edhe gra që kësaj çështjeje nuk i vënë rëndësi. Fajtorë janë burrat në radhë të parë, por edhe gratë nuk mbeten pa faj. Lufta nacional-çlirimtare dhe revolucionari ynë popullor krijuan raporte të reja në mes të klasave edhe në vetë familjen. Me mijëra njerëz të popullit u dalluan, u edukuan, gra edhe burra ecën përpara. Ata janë të devotshëm për çështjen e popullit, heroikë në luftën dhe në ndërtimin e socializmit. Ka disa prej tyre që janë martuar me vajza të ndershme, patriotë, fshatare ose qytetare punonjëse, por ngritja kul-

turale dhe politike e këtyre grave është e ulët dhe e keqja është se vazhdojnë të qëndrojnë në një gjendje të tillë, duke krijuar kështu një disnivel në ngritjen kulturale dhe politike në mes të burrit dhe gruas. Nga ana tjetër, në mjaft raste të tilla burri punon, gruaja rri pa punë. Natyrisht, shpejt ose vonë në këtë familje, në një gjendje të tillë, do të krijohen mosmarrëveshje, që fillojnë nga gjërat e vogla dhe shkojnë duke u trashur. Populli thotë: «fukarallëku krijon grindje», jo vetëm fukarallëku nga pikëpamja ekonomike, por edhe nga pikëpamja intelektuale e politike. Këta njerëz që përmenda më lart nuk para i shikojnë me kujdes këto çështje. Nuk ka kujdes nga burrat në radhë të parë, të cilët i mbajnë gratë në shtëpi, pa shkollë, pa punë dhe gjoja këtë e justifikojnë se «kanë fëmijë», «kanë mëmën plakë» etj. Edhe gratë nga ana e tyre s'kanë asnjë iniciativë, mendojnë si në kohërat e lashta se vetëm në atë mënyrë do ta mbajnë burrin të lidhur. Mirëpo, një mëngjez, papritur dhe pakujtuar ndryshojnë punët në një familje të tillë. Burrit i rëndohet barra e shtëpisë, ai kërkon më shumë nga gruaja e tij, të cilën kurrë nuk ka marrë mundimin që ta edukojë dhe ta nxjerrë nga errësira, ai shikon se nga gruaja e tij, e ndan një botë e tërë, se ai nuk gjen në shtëpi atë që kërkon jeta e kulturuar që po zhvillohet përpara tij. Kështu fillojnë pastaj mosmarrëveshjet që arrijnë ngandonjëherë deri edhe në divorc. Shumë të lumtura dhe të gëzuara janë ato familje ku burri dhe gruaja, të dy mësojnë dhe punojnë, pse duke qenë të ngritur dhe duke qenë ekonomikisht të pavarur nga njëri-tjetri, që të dy kontribuojnë së bashku në zbukurimin e jetës së tyre dhe të familjes.

Emancipimi i gruas nuk mjafton të trumbetohet vetëm me llafe, por të punohet në jetë e me durimin më të madh për këtë çështje. Dituria nuk fitohet në një ditë. Duhet të luftojnë njerëzit për ta fituar këtë. Paragjykimet fetare, që janë më të theksuara në gratë, nuk zhduken shpejt dhe nuk zhduken as me të bërtitura, as me dekrete. Burimin ato e kanë në errësirën dhe duhet të luftohen me propagandë shkencore, me sqarime.

Motra të dashura,

Kongresi juaj me të drejtë mund të cilësohet një kongres i madh pune dhe me siguri ai do t'i japë një hov të madh gruas shqiptare në punë, në misionin e saj të lartë që ajo ka bashkë me burrat, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Për ta çliruar atdheun nga robëria shekullore, burrat dhe gratë e vendit tonë luftuan me heroizëm dhe gjaku e mundimet e tyre u kurorëzuan me sukses. Për rindërtimin e gërmadhëve të atdheut tonë të djegur dhe të rrënuar nga lufta na u desh të bënim shumë sakrifica, se pa mundime dhe pa punuar asgjë nuk krijohet. Vullneti dhe heroizmat e popullit tonë i kapërcyen vështirësitë që na delnin përpara. Shqipëria e popullit u rindërtua dhe u bë shumë më e bukur nga ç'ishte më përpara. Jeta e popullit u përmirësua nga të gjitha anët. Ne ecim të sigurtë, me forca të shumëfishuara drejt një të ardhshmeje më të lumtur dhe më të begatshme. Kjo i detyrohet politikës së drejtë të Partisë dhe të qeverisë sonë që përfaqësojnë dhe realizojnë në jetë dëshirat dhe shpresat e popullit punonjës të vendit

tonë. Drejtësinë dhe urtësinë e politikës së Partisë e vërtetoi Lufta nacional-çlirimtare, e vërtetojnë realizimet e mëdha ekonomike dhe kulturalë, e vërtetën bashkimi i çelniktë i popullit rreth Partisë dhe qeverisë së tij.

Në një periudhë të shkurtër prej 10-11 vjetësh në vendin tonë janë bërë transformime të mëdha. Kanë përparuar ekonomia jonë, kultura dhe arësimi. Sot vendi ynë ka një industri të fuqishme që prodhon për popullin: naftë, krom, bitum, qymyr, tekstile, sheqer, çimento, këpucë e shumë sende të tjera të konsumit të gjerë. Krahas me industrinë zhvillohet dhe perfeksionohet artizanati, i cili me kooperativat e tija është bërë një ndihmës i mirë i industrisë. Rëndësi ka këtu dhe veçanërisht duhet të theksojmë pjesëmarrjen e gruas në industri dhe në artizanat. Ç'ndryshime të mëdha nga e kaluara! A mund të vihej në lëvizje gjithë kjo maqineri pa pjesëmarrjen aktive të gruas, pa pjesëmarrjen e saj në prodhim? Jo, nuk mund dhe kjo do të thoshte që këto fabrika dhe uzina, këto kooperativa të artizanatit të mos prodhonin me rendiment të plotë. Shikoni ç'humbje do të kishte ekonomia jonë sikur të mos merrnin pjesë gratë në prodhim. Në Kombinatin e Tekstileve «Stalin» 55,9 për qind të punonjësve janë gra, në trikotazhin e Korçës — mbi 60 për qind, në NISH Goma Durrës — mbi 90 për qind, në Fabrikën e Këpucëve në Tiranë — mbi 60 për qind. Me mijëra gra punojnë në industrinë e naftës, në kombinatin e sheqerit, në kombinatin e drurit, në uzinat e zhveshjes së pambukut, në fabrikat e duhanit dhe të cigareve, në fabrikat e makaronave e shumë të tjera. Në kooperativat

e artizanatit po e njëjta gjë. Shikoni ç'forcë e madhe grash është hedhur në prodhim, forcë që deri dje ishte e mbyllur dhe e ndrydhur në të katër muret e shtëpisë dhe priste nga duart e burrit. Këtej të nisemi për të matur sa hapa të mëdhenj përpara ka bërë gruaja shqiptare drejt përparimit, sa sukses ka pasur politika e drejtë e Partisë në drejtim të zhdukjes së injorancës dhe të paragjykimeve që mbretëronin në të kaluarën në burrat dhe në gratë. Si punojnë këto gra në prodhim? Ato punojnë në mënyrë të mrekullueshme megjithëse për një kohë relativisht të shkurtër. Ato s'dinin gati asgjë përpara, ato shpejt mësuan të drejtojnë me mjeshteri të rrallë maqina të ndërlikuara sovjetike nga më modernet, ato janë bërë luftëtarë të dalluara për realizimin e planit, ato sulmojnë përpara si punëtore të pararojës, njësoj si burrat, në mos disa herë më mirë, ato thyejnë normat. Shihni gratë dhe vajzat shembullore të Shqipërisë së re si: Fone Kitën, Haxhire Spahiun, Vitore Shkrelin, Antoneta Zallëmin, Shazije Izollarin, Alije Ymerin. Po të rrish t'i numërosh të tëra gratë e dalluara, sulmuese dhe punëtore të pararojës, që janë krenaria e vendit tonë, të duhet një ditë e tërë. Vetë përfaqësueset e grave punonjëse të vendit tonë që janë këtu në kongres do të tregojnë sa të lumtura dhe sa të gëzuara janë ato në punë, si iu çelën atyre sytë, si e ndryshuan jetën e tyre, si e zbukurojnë jetën e tyre dhe të familjes. Le t'u shërbejë si nxitje shembulli i 28 mijë grave që janë në prodhim, pa folur këtu për gratë punonjëse të fshatit, si edhe gratë e tjera që për një arësye ose për një tjetër hezitojnë akoma të futen në punë. Lenini na mëson se

«...duhet që gratë punëtore të marrin pjesë gjithnjë e më shumë në drejtimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe në qeverisjen e shtetit»¹.

Të mos kemi aspak frikë se ato nuk dinë. Njeriu nuk lind i ditur, por mëson dhe shembullin e kemi të gjallë në jetën tonë. Puna në Republikën tonë popullore, ku ndërtohet socializmi, konsiderohet nder i madh, prandaj gratë duhet të sulmojnë për punë në të gjithë sektorët, pa përjashtim. Sigurisht, është më e nderuar dhe e respektuar në Republikën tonë mëma plakë, Fatime Kruja, që vazhdon të punojë në një kohë kur të dy djemtë e saj kanë mbaruar universitetet në Bashkimin Sovjetik dhe janë me detyra të rëndësishme, se sa gruaja e nëpunësit të lartë, që më rri në shtëpi dhe s'më zë punë me dorë, kur ndërtimi i ekonomisë socialiste kërkon njerëz në fabrika, në ndërtime, në arësim, në bujqësi e gjetkë. Shteti ynë e ka përkrahur dhe do ta përkrahë vazhdimisht pjesëmarrjen e gruas në prodhim. Kodi i punës dhe sigurimet shoqërore e favorizojnë shumë pjesëmarrjen e gruas në punë. Kopshte dhe çerdhe fëmijësh janë hapur dhe do të shtohen akoma, por gruaja duhet që këto kopshte dhe çerdhe t'i marrë më shumë dhe më seriozisht nën drejtimin e kujdesin e saj. Por s'mjafton vetëm që gratë të marrin pjesë në prodhim, ato vazhdimisht duhet të perfeksionohen në zbatimin e tyre, të bëhen shumë të afta, të ngrenë cilësinë e punës. Për këtë gratë janë në gjendje, atyre u janë krijuar të gjitha mundësitë nga ana e Partisë dhe e

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 423.

shtetit. Me siguri pas këtij kongresi gratë e vendit tonë do të hidhen akoma më shumë në punë e në prodhim. Mund të bëjë pyetjen ndonjë, a ka punë për të gjitha këto gra dhe për të gjithë këta burra? Punë ka sa të duash në Republikën tonë Popullore për atë që dëshiron të punojë. Ne kemi deficite të mëdha për fuqi punëtore në prodhim. Shumë burra që punojnë në prodhim, kanë zënë vendin e grave, kanë përfituar ngaqë gratë ngurrrojnë të futen në punë. Tani gjendja ka ndryshuar. Forcë e madhe ka zbritur nga fshati, ka lënë bujqësinë dhe punon në qytete, por kjo forcë që duhet t'i përvishet bujqësisë për të shtuar prodhimet bujqësore dhe blegtorale, pjesërisht duhet të zëvendësohet nga qytetet. Shumë njerëz duhet të ndërrojnë profesionet, të tjerë duhet të fillojnë të mësojnë profesionet e tyre. Kjo është e natyrshme. Në industrinë e tekstileve, të këpuçëve, në prodhimet ushqimore, në shërbimet për popullin, në shëndetësi, në arësim etj. shumica dërmuese duhet të jenë gra. Rrallë do të gjesh qytetarë dhe qytetare të punojnë në ndërtim. Atje shumica janë fshatarë, sikur të ishte vetëm ky zanati i tyre. Për qytetarin sikur është bërë zakon të kërkojë të futet në ndonjë zyrë, të bëhet ndonjë shitës dyqani. Kjo, natyrisht, duhet të marrë fund një herë e mirë dhe më duket se ka ardhur koha të marrë fund. Me gjithë ndërtimet e mëdha që bëhen për banesa në qytete, përsëri ne kemi vështirësi për strehim dhe ky problem nuk mund të zgjidhet menjëherë. Por të mendojmë pak më thellë. Është për t'u lavdëruar që vajza të reja kanë ardhur nga të katër anët e Shqipërisë dhe punojnë në Kombinatin e Tekstileve «Stalin» dhe në të gjitha ndërmarrjet e krye-

qytetit. Ato krijojnë familjet e tyre dhe duhen strehuar dhe po strehohen. Po të numërohen ndërtimet e bëra në Tiranë gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare mund të thuhet se gati një Tiranë e dytë është ndërtuar. Por vihet re se me mijëra qytetare të Tiranës rrinë pa punë për një arësye ose për një tjetër dhe këto s'dinë gjë tjetër të thonë «të na strehojë shteti, se jemi ngushtë», në vend që të futen në punë e në prodhim dhe ato fshatare të tepërta t'i përvishen bujqësisë, apo nuk e kanë zanat ato bujqësinë, apo nuk dallohen fshataret në bujqësi, apo nuk i jep rëndësi të jashtëzakonshme Partia dhe shteti bujqësisë.

Nga ana tjetër, qytetari me origjinë fshatare ose fshatari a fshatarja të ardhur rishtas në qytet, i thërret nga i ka dhe nga s'i ka prindërit, vëllezërit, motrat, deri te hallat dhe tetot nga fshati në qytet, u prish atje ekonominë bujqësore, i heq këta njerëz nga puna dhe nga prodhimi, mbliidhet me ta në një ose në dy dhoma, i ushqen të gjithë vetë, kërkon t'i futë nëpër zyra, kërkon t'u sigurojë triska nga shteti dhe në kurriz të shoqërisë. Këto s'janë veprime të urta, ato dëmtojnë ekonominë shtetërore dhe ekonominë individuale të gjithsecilit. Më duket se këto gjëra duhen sheshuar e duhen ndrequr. Pushteti duhet të marrë masa dhe të mos lejojë fryrjen e panevojshme të qyteteve. Gratë vetë duhet të luajnë një rol të madh në zgjidhjen e drejtë të këtyre problemeve të rëndësishme shoqërore.

Të shikojmë fshatin. Atje gruaja është bërë një forcë e madhe në prodhim dhe në jetën shoqërore. Ajo kurdoherë ka qenë një ndihmë e fuqishme e burrit, megjithëse në të kaluarën nuk njiheshin meritat e saja.

Pushteti ynë popullor e nxori atë në jetë e vuri krahas me burrin. Mund të themi pa frikë se tani gruaja e fshatit, përsa i përket pjesëmarrjes në prodhim, qëndron më përpara se gruaja e qytetit dhe me siguri kjo pjesëmarrje revolucionare e gruas në fshat, në prodhim, në politikë dhe në drejtimin direkt të pushtetit është garancia më e madhe dhe më e sigurtë e përparimit të saj, e zhdukjes së errësirës dhe të prapambetjes, është një faktor vendimtar i përmirësimit rrënjësor të jetës së fshatarit. Partia dhe qeveria i kanë vënë dhe do t'u vënë një rëndësi të madhe bujqësisë dhe blegtorisë dhe ne shohim rezultatet e kënaqshme të kësaj politike të drejtë. Fshatarësia jonë tani është e zonja e tokës, ajo punon dhe prodhon shumë më mirë se në të kaluarën; shteti i jep fshatit një ndihmë të madhe, të shumanshme dhe vendi çdo vit ka më shumë drithë, më shumë pambuk, duhan, panxhar sheqeri dhe prodhime blegtorale. Ky prodhim do të shtohet akoma më shumë në planin e dytë pesëvjeçar, që Partia dhe qeveria jonë po përgatitin. Ne mund të themi, pa u gabuar, se pjesa dërmuese e grave të fshatit janë hedhur në prodhim. Gruaja e fshatit është thirrur të luajë një rol të madh për rritjen e rendimenteve. Përveç eksperiencës së saj praktike që ka në bujqësi, atë duhet ta njohim me metodat e reja dhe të sprovuara agroteknike sovjetike që kanë dhënë rezultate të mira në vendin tonë. Edukimi me format e reja të prodhimit në bujqësi dhe në blegtori duhet të përhapet gjerësisht, jo vetëm në fshatarët, por edhe në fshataret. Fshatari ynë duhet të ketë përkrah tij në punë, jo vetëm një bashkëzbatues të detyrave bujqësore, por edhe një shoqe të kualifikuar, krijuese të

së resë dhe të mirëqenies. Kjo do të arrihet vetëm duke i dhënë një rëndësi akoma më të madhe edukimit të grave fshatare. E dëgjuat sa përpara dhe ç'prodhime bujqësore dhe blegtorale të larta kanë marrë gratë e dalluara si: Elisaveta Nasi, Athina Zafiri, Mihane Bilali, Dafina Kondakçiu, Sheqere Elezi e qindra gra të tjera. Këto shoqe janë gra të thjeshta të popullit. Këto nuk kanë shkolla dhe universitete, por janë të zgjuara si të gjitha gratë fshatare dhe kanë mësuar nga metodat e reja në bujqësi dhe në blegtori, tregojnë shumë kujdes në punë dhe marrin prodhime të mëdha. Pse është e shquar në Shqipëri Mihane Bilali, rritësja e viçave? Ajo është e dalluar, sepse atë e mësuan me kujdes dhe ajo vetë tregoi shumë kujdes. Gratë nga natyra janë shumë të kujdesshme, pra, u vihet si detyrë njerëzve të bujqësisë që të vënë më shumë kujdes për t'i mësuar me durim gratë e fshatit. Si të punosh tokën dhe si t'u bësh shërbim bimëve ashtu do të të japin edhe ato, thotë fshatari. Atëhere t'ua mësojmë fshatarëve dhe fshatareve si të punohet më mirë toka dhe si t'u bëhen më mirë shërbimet bimëve. Fshatari e shikon mirë interesin e tij, atëhere t'ia bëjmë akoma më të qartë se interesi i tij dhe ai i përgjithshmi e lypin që ai të mos qëndrojë në metodat e vjetëruara të punimit të tokës dhe të shërbimit të bimëve. Për këtë qëllim njerëzit e bujqësisë në fshatra, sipas kulturave që mbjell fshati, të organizojnë më shumë kurse, konferenca, konsultime me burrat dhe me gratë e fshatit dhe t'u mësohet këtyre konkretisht si të përmirësojnë zanatin. Dituria në fshat nuk është vetëm të mësosh të shkruash dhe të lexosh siç mendojnë disa gra. Jo, ajo është vetëm fillimi, ose abecëja që të hap

rrugën dhe të jep mjetin të zhvillohesh me shpejtësi. Me dhjetëra mijëra vajza fshatare kanë mbaruar shkollat fillore dhe 7-vjeçare. Ato duhet të jenë pionieret, ndihmëset e fuqishme të mësuesve, të agronomëve, të veterinerëve dhe të gjithë punonjësve të tjerë të shtetit që merren me përhapjen e së resë në fshat. Fshatrat tona duhet të kenë mësueset, infermieret, tekniket bujqësore të vetat, të dalë nga fshati i tyre dhe jo vetëm nga një, por shumë. Pushteti ynë popullor i ka krijuar të gjitha mundësitë dhe këto mundësi duhet t'i shfrytëzojmë në maksimum. Partia ka bindjen e plotë se gruaja fshatare, sikundër dhe ajo e qytetit, do të ecin akoma më me vrull përpara për të fituar kalanë e diturisë dhe të shkencës dhe do ta vënë këtë në shërbim të forcimit të Republikës sonë popullore, për zbukurimin e jetës së popullit tonë.

Ju, shoqe të dashura, keni organizatën tuaj të gjerë politike që udhëhiqet nga mësimet e Partisë. Është vendi të thuhet se organizata juaj, Bashkimi i Grave të Shqipërisë, i ka shërbyer shumë atdheut në ngritjen politike të gruas, në mobilizimin e gjerë të saj, në pjesëmarrjen në të gjitha aktivitetet e jetës së vendit tonë. Organizata juaj është e dashur për gratë e vendit tonë, pse konkretisht ajo interesohet për problemet e gruas, ajo është një ndihmëse e fuqishme e Partisë në veprën madhështore të edukimit politik të masave të gjera punonjëse të grave. Prandaj duhet akoma më shumë ta forcojmë dhe të kujdesemi të gjithë për organizatën tuaj, që ta bëjmë punën e saj më të frutshme. Shumë njerëz dhe mjaft komunistë nuk e kuptojnë aq sa duhet rolin e madh të kësaj dhe bëjnë lëshime në ndihmën që duhet

t'i jepet asaj. Shumë punonjëse që bëjnë pjesë në bashkimet profesionale, të cilat janë shkolla e komunizmit, pak kontribut japin në organizatën e gruas, e quajnë këtë si të huaj, të atyre që s'janë të sindikuara. Të mendojnë pak se shumica e grave të vendit tonë janë në fshat dhe ato kanë nevojë të madhe për ndihmën e punëtoreve tona dhe ndihma që ato duhet të japin, rruga më e mirë, më e drejtë, më e efektshme, është të jepet nëpërmjet organizatës së gruas. Kur mendojmë se ne kemi një numër të madh vajzash dhe grash në prodhim, siç përmenda më lart, kur mendojmë se në arësim gratë përbëjnë 45 për qind të të gjithë punonjësve, në shëndetësi — 45,8 për qind, në tregëti — 40 për qind, ne kemi të drejtë të mendojmë dhe të shpresojmë se kemi një forcë të madhe grash të mësuar, të edukuara që duhet t'i japin një gjallërim të madh organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Organizatat e Partisë duhet të tregojnë akoma më shumë kujdes për forcimin dhe mbarëvajtjen e organizatës së gruas, ta ndihmojnë atë pa pushim dhe ta bëjnë një nga levat e tyre të fuqishme. Problemet ekonomike dhe shoqërore të gruas janë shumë të rëndësishme dhe delikate dhe po të neglizhohen, i sillt një dëm i jashtëzakonshëm atdheut. Vetëm po të mendojmë mirë rolin vendimtar që luajnë gratë në rritjen dhe në edukimin e fëmijëve, në pjesëmarrjen aktive në qeverisjen e vendit, në pjesëmarrjen e gjallë në prodhim, atëhere nuk duhet të na zërë gjumi dhe t'i neglizhojmë problemet e mëdha të gruas dhe rolin e organizatës së gruas. S'ka aktivitet jetik të vendit tonë, ku të mos ndërhyjë çështja e gruas dhe çfarë ndërhyrjeje, rrënjësore. Në qoftë se edukimi i

më mirë njëri-tjetrin, të përfitojmë nga eksperiencia dhe ndihma e njëri-tjetrit. Populli ynë i do të gjithë popujt përparimtarë të botës, prandaj ai lufton me të gjitha forcat për mbrojtjen e paqes. Të forcojmë solidaritetin me gratë përparimtare të botës në gjirin e Federatës suaj të madhe Ndërkombëtare të Grave për mbrojtjen e paqes.

Mëma! Ne jemi kundër luftërave imperialiste, ne duam paqen, ne s'duam as të na digjet atdheu, as të djegim atdheun e të tjerëve. Ne nuk duam të na vriten bijtë dhe bijat tona dhe as të vrasim bijtë dhe bijat e të tjerëve. Ne duam të ndërtojmë në paqe jetën e lumtur dhe të gëzuar për popullin tonë, ne duam dhe luftojmë që fabrikat tona të prodhojnë sa më shumë dhe sa më mirë për popullin, ne duam dhe luftojmë që fushat dhe kopshtet tona të lulëzojnë dhe të prodhojnë sa më me bollëk për popullin, ne duam dhe luftojmë që të zhvillohet dhe të përparojë arësimi dhe kultura në vendin tonë. Ne do të punojmë, por në të njëjtën kohë edhe do të vigjilojmë për të mbrojtur fitoret tona nga çdo armik. Ne duam të kemi marrëdhënie miqësore me të gjitha shtetet e botës në bazë të respektit reciprok dhe të të drejtave legjitime të çdo populli. Kjo politikë paqësore e popullit tonë përqafohet dhe mbrohet nga i madh e i vogël në vendin tonë. Kjo nuk tregon aspak dobësinë tonë, por forcën e shtetit dhe të popullit tonë. I gjithë populli ynë do të luftojë me mish e me shpirt për mbrojtjen e paqes në botë, do të luftojë me të gjitha forcat për forcimin dhe lulëzimin e Republikës Popullore të Shqipërisë. Për këtë arësye populli ynë, burra e gra, i madh e i vogël, i bashkuar si një trup rreth Partisë dhe

qeverisë së tij punon me heroizëm për të mbyllur me sukses realizimin e planit të parë pesëvjeçar. Mëma dhe motra, punë e madhe dhe suksese të mëdha na presin në të ardhshmen. Plani i dytë pesëvjeçar do ta zbukurojë akoma më shumë Republikën tonë popullore, do ta bëjë jetën e popullit tonë e të kalamanëve tanë akoma më të lumtur, më të gëzuar, më të begatshme.

Të rrojë dhe të lulëzojë Republika jonë Popullore!

Të rrojë Partia e lavdishme e Punës, udhëheqësja e urtë dhe heroike e popullit shqiptar!

Rrofshin gratë heroike të atdheut tonë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 247 (2200), 14 tetor 1955

Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI SISTEMIMIN NË PUNË TË USHTARAKËVE TË ÇMOBILIZUAR

*Letër udhëzuese drejtuar sekretarëve të parë
të komiteteve të Partisë në qarqe*

29 tetor 1955

KOMITETIT TË PARTISË TË QARKUT

Sekretarit të parë

Siç jeni në dijeni ju dhe komiteti ekzekutiv i qar-
kut, Partia dhe qeveria kanë marrë vendime për çmo-
bilizimin e 9 mijë vetëve nga forcat e armatosura të
Ushtrisë Popullore, nga organet e punëve të brendshme
dhe për thjeshtimin e aparatit shtetëror. Porositim që
këto masa shumë të rëndësishme duhet të kuptohen
drejt dhe mirë nga të gjithë ju, komitetet e Partisë në
qarqe e në rrethe dhe nga organizatat bazë të Partisë.
Ato të vlerësohen në shkallën e duhur si hapa të rëndë-
sishëm e të domosdoshëm për forcimin e ushtrisë, të
aparateve shtetërore dhe të ekonomisë popullore në të
gjitha fushat, për shpejtimin e ritmit të ndërtimit të
bazave të socializmit në vendin tonë. Ato duhet të kup-

tohen si vazhdim i orientimit marksist-leninist në politikën e brendshme e të jashtme të Partisë e të shtetit tonë.

Është po aq e rëndësishme dhe e domosdoshme që këto masa në të njëjtën kohë të shoqërohen me një punë të madhe sqaruese me të gjithë kuadrin e veçanërisht me komunistët oficerë që çmobilizohen dhe me ata që mbeten jashtë organikave shtetërore. Të bëhen të gjitha përpjekjet për t'i bindur këta shokë që me krenari të shkojnë në prodhim, sidomos në fshat, në kooperativat bujqësore, duke e kuptuar çështjen si një detyrë të lartë patriotike që u ngarkon Partia dhe shteti ynë.

Të luftohen me vendosmëri dhe me kujdes të gjitha tendencat dhe pikëpamjet mikroborgjeze që mund të shfaqen në disa nga këta kuadro për-t'u futur vetëm në punë zyre.

Për një numër kuadrosh, sidomos oficerë të çmobilizuar, të cilët për një kohë të gjatë kanë kryer me ndërgjegje detyrat e ngarkuara në ushtri dhe në pushet, të mbahet parasysh vendosja e tyre menjëherë në punët e caktuara nga lart dhe në punë të tjera ku ka dobësi, duke zëvendësuar njerëzit e paaftë e të padëshirueshëm dhe që janë bërë pengesë në realizimin e planit të shtetit.

Mjaft nga kuadrot oficerë, kanë një pjekuri të mirë politike, kanë eksperiencë pune dhe besnikëri ndaj kauzës së Partisë e të shtetit tonë, prandaj duhet të mendoni që me këta kuadro të forconi aparatet e Partisë dhe ato shtetërore në qark, rreth e deri në fshat, po ashtu dhe në kooperativat bujqësore e SMT-të dhe të punoni që në të ardhshmen ata të mund të zgjidhen në forumet e organeve të sipërpërmendura.

Natyrisht, duhet të keni parasysh se ata vijnë nga një ambient ushtarak dhe nuk i njohin hollësitë e natyrës së punës në pushtet e në terren e mund të bëjnë edhe ndonjë gabim të vogël ngaqë nuk i njohin mirë problemet, prandaj është detyra juaj që të mos nxitoheni në marrjen e masave, por me durim e besim t'i mësoni ata si të punojnë në këta sektorë të rinj për ta.

Porositeni që këtë problem të madh të Partisë e të shtetit, ta studjoni në të gjitha hollësitë dhe të merrni masa konkrete organizative që asnjë prej oficerëve të çmobilizuar që vijnë në qarkun tuaj dhe nëpunësit që shkurtohen nga organikat, të mos mbeten pa punë, strehim dhe jashtë kujdesit tuaj të gjithanshëm. Ata të mbahen afër, si tani edhe në të ardhshmen, për t'i kalitur në punë ashtu si gjithë punonjësit e tjerë të Republikës që ndërtojnë me vetëmohim socializmin. Vetëm kështu masat e Partisë dhe të shtetit do të japin efektin e tyre të plotë pozitiv.

Komiteti Qendror i PPSH kërkon nga ana juaj, komitetet e Partisë në qarqe e në rrethe si dhe nga gjithë organizatat bazë të Partisë, zbatimin e përpiktë dhe rigoroz të detyrave që ju ngarkohen nga kjo letër.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DREJTUAR OFICERËVE TË FORCAVE
TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS
POPULLORE TË SHQIPËRISË
QË KALOJNË NË REZERVË**

8 nëntor 1955

Të dashur shokë,

Me rastin e lirimit tuaj nga radhët e forcave të armatosura dhe kalimit në oficerë rezervë, në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe timin personal, ju transmetoj përshëndetjet dhe falenderimet më të përzemërta për shërbimet e mëdha dhe shumë të çmueshme që i keni bërë atdheut dhe popullit, si gjatë Luftës nacional-çlirimtare, ashtu dhe pas çlirimit në organizimin, forcimin dhe modernizimin e forcave të armatosura të vendit tonë.

Ju, shokë, dilni në lirim si rrjedhim i shkurtimit të forcave të armatosura që bëri qeveria jonë në interes të uljes së tensionit ndërkombëtar dhe të paqes. Ju duhet ta kuptoni mirë e drejt këtë masë. Gjithashtu, duhet ta kuptoni mirë dhe drejt edhe situatën në të cilën merren këto masa të rëndësishme. Ju e dini se i gjithë kampi i

paqes, i demokracisë dhe i socializmit, ku bën pjesë edhe vendi ynë, me Bashkimin Sovjetik në krye, bën një luftë aktive për uljen e tensionit ndërkombëtar dhe për mbrojtjen e paqes. Shkurtimi i forcave të armatosura nga vendet tona në situatën e sotme, është pjesë e kësaj lufte aktive, është prova më e mirë e politikës sonë paqësore dhe patjetër do t'i sjellë asaj fitore të reja në interes të popujve tanë dhe të popujve të mbarë botës.

Kjo masë është e lidhur, veç kësaj, me dëshirën dhe me interesat e rritjes, të zhvillimit dhe të forcimit më të madh të ekonomisë popullore, të rritjes së vazhdueshme të standardit të jetës materiale dhe kulturele të popullit tonë heroik dhe punëtor. Shkurtimi i forcave të armatosura bëhet në një kohë kur Partia dhe qeveria kanë vënë para popullit detyra të rëndësishme në lidhje me zbatimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar dhe të detyrave të reja të planit të dytë pesëvjeçar, ku është shumë e nevojshme pjesëmarrja aktive e të gjitha masave punonjëse. Në situatën e sotme Partia dhe qeveria i japin një rëndësi të veçantë edukimit të masave punonjëse, rritjes së ndërgjegjes së tyre me qëndrimin socialist ndaj punës, ndaj ligjeve të shtetit, pronës shoqërore dhe të gjitha detyrave që u ngarkohen. Partia dhe qeveria shtrojnë me forcën më të madhe ngritjen e rendimentit në punë, forcimin e regjimit të kursimit dhe zbulimin e shfrytëzimit e vazhdueshëm të rezervave të brendshme. Ato sot shtrojnë si detyrë imediate drejtimin e komunistëve dhe të gjithë popullit në prodhim, në industri, në ndërtim, në bujqësi, në fshat. Ky është një nga frontet kryesore sot. Këtu duhet të tregohet gatish-

mëria e komunistëve dhe e të gjithë punonjësve, pse këtu prodhohen të mirat materiale.

Në të njëjtën kohë Komiteti Qendror i PPSH kërkon nga ju, nga i gjithë efektivit i forcave të armatosura si dhe nga gjithë populli, që me shkurtimin e efektivit të mprehet edhe më shumë vigjilenca revolucionare për ruajtjen e pavarësisë dhe të lirisë, për ruajtjen e kufive të atdheut, për mbrojtjen e jetës dhe të fitoreve të popullit.

Nën udhëheqjen e Partisë sonë, forcat tona të armatosura kanë korrur dhe do të korrin suksese në perfeksionimin e tyre.

Partia dhe qeveria jonë si gjithmonë dhe në të ardhshmen, kanë marrë të gjitha masat që fuqia mbrojtëse e atdheut të forcohet edhe më shumë.

Efektivit të forcave të armatosura i shtrohet detyrë që të punojë edhe më shumë, edhe më mirë, për forcimin e disiplinës ushtarake, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pregatitjes luftarako-politike. Komiteti Qendror i PPSH kërkon nga ju si dhe nga i gjithë populli që, paralel me punën për ndërtimin e vendit, të ndihmoni vazhdimisht në modernizimin e forcave të armatosura.

Shokë, ju, duke u larguar nga radhët e forcave të armatosura mbani parasysh mësimet dhe këshillat e Partisë. Ato do t'ju jenë të vlefshme në tërë jetën tuaj, ato do t'ju ndihmojnë ju në të gjitha aspektet e jetës.

Ju punuat dhe u edukuat me vite të tëra në radhët e ushtrisë, u rritët bashkë me të. Ajo ju rriti ju dhe ju atë. Më të shumtët nga ju keni qenë partizanë të Ushtri-

së sonë të lavdishme Nacional-Çlirimtare, që qysh në moshën e vogël luftuat për çlirimin e atdheut. Ju të gjithë keni përballuar shumë vështirësi, si në luftë dhe në punën e madhe që keni bërë për zotërimin e artit luftarak, të teknikës së re dhe të disiplinës ushtarake. Ju atje u kalitët si ushtarë dhe qytetarë të denjë të atdheut tonë shumë të dashur. Ju keni pasur, keni dhe do të keni një dashuri të madhe për ushtrinë dhe kjo është e natyrshme se ajo është një thesar i madh. Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria do t'i kenë gjithmonë parasysh këto.

Besimi dhe bindja juaj në udhëheqjen e Partisë, në direktivat e saja, ka qenë dhe është, si për të gjithë kuadrot dhe popullin tonë, burimi i sukseseve në jetën e punën tuaj. Këshillat e Partisë ju kanë ndritur rrugën, ato do të ndriçojnë gjithashtu rrugën tuaj për të ardhshmen në detyrat e reja. Pra, filloni nga detyrat e reja me entuziazëm, për të cilin jeni karakterizuar gjithmonë dhe me hovin tuaj revolucionar, me vullnetin tuaj të çelniqtë shkoni në radhët e para të ndërtuesve të bazave të socializmit, në prodhim, në frontin e punës, ku nxirren të mirat materiale, për t'i dhënë atdheut më shumë bukë, ushqime, fabrika, mjete prodhimi, veshmbathje, shtëpi banimi, shkolla etj.

Vajtja juaj në këta sektorë është e nevojshme dhe e drejtë, jo vetëm si nevojë dhe detyrë imediate, që është gjëja kryesore, por edhe pse këta janë sektorë më të gjerë, ku mund të rregulloheni më shpejt dhe ku perspektivat e ecjes suaj përpara janë më të çelura dhe të afërta. Ju do të gjeni aty ushtrinë e punës që e ka rritur dhe e ka edukuar Partia ashtu siç ka bërë edhe

me ju. Ju do të rrethoheni nga një ambient i ngrohtë e i dashur i njerëzve që i kanë dhënë me duart e tyre popullit dhe shtetit të gjitha këto të mira në ndërtimin e bazave të socializmit. Ju do të gjeni aty shokë të kalitur në zjarrin e punës me një eksperiencë të madhe pune. Ju do të gjeni aty shokë të luftës së çlirimit, të cilët dje, si ju sot, i janë drejtuar prodhimit atje ku i thirri Partia. Atje i mësoni njëri-tjetrit eksperiencën më të mirë, gjërat më të mira. Bëjeni këtë pa drojtje, pa turp, mësoni nga ata eksperiencën e praktikës së punës dhe ata le të mësojnë nga ju rregullin dhe disiplinën që karakterizon ushtarakun tonë.

Natyrisht, ju duhet të keni të qartë se jo të gjitha gjërat do të jenë të rregulluara, se mund të ndodheni edhe përpara ndonjë vështirësie. Kjo të mos ju demoralizojë, përkundrazi t'i shtoni përpjekjet tuaja për zgjidhjen e tyre, në radhë të parë vetë dhe pastaj me ndihmën e komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive të vendeve ku ju do të shkoni.

Luftoni pa mëshirë thashethemet e ndonjë mikroborgjezi që gjoja do t'ju qajë hallin. Ju keni Partinë, e cila, ashtu si për të gjithë punonjësit e lavdishëm të ndërtimit të socializmit, do të ketë sytë dhe kujdesin më të madh për ju. Ajo do t'ju ndihmojë, ajo do të jetë gjithmonë afër jush. Ju mund t'i drejtoheni Partisë kurdoherë e sa herë të doni dhe ajo pa vonesë do t'i shikojë problemet tuaja.

Komiteti Qendror ju këshillon që largimi juaj nga ushtria të mos ju ndajë prej saj. Ju duhet ta doni, ta

ndihmoni kudo dhe kurdoherë jo vetëm ushtrinë në tërësi, por dhe repartin ose armën ku keni shërbyer. Është detyra juaj dhe e shokëve tuaj që mbetën në radhët e forcave të armatosura që të punoni për zhvillimin dhe forcimin e miqësisë dhe të dashurisë ushtarake midis njëri-tjetrit, midis popullit e ushtrisë.

Partia dhe qeveria kanë marrë qysh tani një sërë masash për t'ju lehtësuar nga ana ekonomike. Gjithashtu u janë dhënë udhëzime komiteteve të Partisë në qarqe që të tregojnë kujdes të veçantë, por nga ana juaj, kërkohet që të tregoheni të matur, të pjekur e të ndërgjegjshëm në pretendimet, duke mos harruar parimin e Partisë që meritat e çdo njeriu të ne çmohen jo vetëm nga e kaluara që kjo sigurisht është shumë e rëndësishme, por edhe nga qëndrimi i sotëm ndaj punës dhe shoqërisë.

Komiteti Qendror dhe unë personalisht shprehim bindjen e plotë se ju do t'i kuptoni drejt të gjitha këto këshilla dhe do t'i përvisheni punës me vendosmëri.

Partia dhe qeveria kanë besim se ju, shokë të dashur, njerëz me kulturë dhe me vullnet të madh, bij besnikë të popullit dhe të Partisë, në sektorët e punës ku do të shkoni, do të karakterizoheni në punën tuaj, ashtu sikurse edhe në të kaluarën, nga një vullnet i madh, nga një vendosmëri dhe disiplinë e fortë, nga një vrull revolucionar ashtu siç i ka hije njeriut të ri në vendin tonë.

Duke përfunduar ju urojmë, shokë oficerë, suksese

të reja në punë, për të mirën tuaj, të familjes suaj, për
të mirën e atdheut dhe të popullit tonë të dashur!

Për Komitetin Qendror të PPSH
Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumenta Kryesore të
PPSH», vëll. II, botimi i
dytë, f. 549*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**FJALA E MBAJTUR NË CEREMONINË E
ORGANIZUAR ME RASTIN E DORËZIMIT TË
DEKORATËS «YLLI I ARTË GARIBALDIN»
NGA PARTIA KOMUNISTE ITALIANE¹**

1 dhjetor 1955

I dashur shok Xhankarlo Pajeta,

Më lejoni që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të shokëve të mi dhe në emrin tim personal, të falenderoj nga zemra Partinë Komuniste Italiane, Komitetin e saj Qendror dhe nëpërmjet saj popullin italian, për nderin e madh që ata na bëjnë sot, duke na dekoruar me medaljet e Partisë Komuniste Italiane. Këto medalje janë të çmu-eshme për ne dhe do t'i mbajmë me nder, pse ne e dimë se këto i përkasin popullit shqiptar e Partisë heroike të Punës të Shqipërisë dhe na jepen nga ana e Partisë Komuniste Italiane e popullit italian si shenjë dashurie dhe vëllazërimi, në frymën e internacionalizmit proletar.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë

¹ PKI dekoroi disa nga udhëheqësit e Luftës nacional-çlirimtare. Shokut Enver Hoxha iu dha dekorata «Ylli i artë Garibaldi», ndërsa shokëve: Haxhi Lleshi, Mehmet Shehu, Hysni Kapo, Beqir Balluku, Myslim Peza dhe Shefqet Peçi iu dha dekorata «Ylli Garibaldi».

kanë ndjekur me admirim luftën e Partisë Komuniste Italiane për çlirimin e popullit italian nga fashizmi italian dhe nazizmi gjerman, luftën heroike të saj për çlirimin e Italisë nga kthetrat e imperializmit dhe të kapitalit të huaj, luftën që ajo po bën për lirinë e pavarësinë e Italisë, për demokracinë, socializmin dhe paqen. Partia Komuniste Italiane, që themeloi Antonio Gramshi, që në ditët e para të lindjes së saj luftoi me vetëmohim për lirinë e popullit italian, sepse ajo u mbryjt e u kalit me idetë e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit; ajo në beteja të përgjakshme e mbajti lart flamurin e internacionalizmit proletar. PKI që në vitet e para të themelimit të saj luftoi dhe fitoi kundër deviatorëve të marksizëm-leninizmit në radhët e saja, prandaj dhe u rezistoi me heroizëm sulmeve barbare të fashizmit musolinian. Partizanët italianë, me brigadat dhe divizionet e tyre, luftuan me heroizëm në të gjithë Italinë, kundër hordhive të Musolinit dhe pushtuesve gjermanë. Partia Komuniste Italiane e udhëhoqi popullin italian në fitoren e çlirimit. Sakrificat e panumërta të komunistëve italianë, politika marksiste-leniniste e PKI në luftën për çlirimin e popullit italian, e bënë kokën drejtuese të popullit punonjës të Italisë. Është fakt i pamohueshëm dhe i padiskutueshëm që Partia Komuniste Italiane, u bë partia më e fuqishme në Itali dhe e vetmja që mbron me konsekuencë dhe me heroizëm interesat e popullit punonjës italian. Proletarët, fshatarët dhe intelektualët patriotë italianë shohin në politikën e Partisë Komuniste Italiane dhe në luftën e saj konsekuente, aspiratat dhe dëshirat e tyre, prandaj ata shtërngojnë dhe shumëzojnë çdo ditë e më shumë radhët

rreth saj. Ne gëzohemi pa masë, shokë të dashur komunistë italianë, për fitoret që ka korrur Partia juaj për të mirën e popullit vëlla italian. Ne, komunistët shqiptarë dhe i gjithë populli ynë, i urojmë, partisë suaj dhe gjithë popullit italian suksese të mëtejshme.

Të dy vendet tona janë fqinj, të dy popujt tanë janë miq, prandaj ata duhet të rrojnë në fqinjësi të mirë, të rrojnë si miq. Kjo është dëshira e popullit e qeverisë dhe e Partisë sonë. Ne s'kemi asnjë dyshim se kjo është dhe dëshira e popullit italian, e komunistëve dhe e të gjithë demokratëve konsekuentë italianë. Ne, shqiptarët, kemi simpati për popullin vëlla italian, ne e çmojmë shumë atë për cilësitë e tija, për zemrën e tij të mirë, për talentet e tij.

Imperialistët dhe fashistët italianë kanë dashur kurdoherë ta skllavëronin popullin tonë, ta kolonizonin Shqipërinë. Ata na kanë sulmuar shumë herë, na kanë vrarë, na kanë djegur, por kurrë s'na kanë mundur, përkundrazi, ne i kemi mundur dhe i kemi hedhur në det ata. Megjithëse populli shqiptar ka qenë vazhdimisht në luftë me imperialistët dhe fashistët italianë, ai asnjëherë nuk i ka konfunduar imperialistët e fashistët italianë me popullin italian. Populli ynë vazhdimisht e ka dashur popullin italian, ndërsa fashizmin italian e ka konsideruar si një murtajë të tmerrshme në kurriz të popullit italian, të popullit tonë dhe të popujve të tjerë. Ne shpresojmë se lufta e përbashkët e popullit tonë dhe e popullit italian kundër të njëjtit armik, fashizmit italian dhe nazizmit gjerman, do t'u ketë shërbyer qarqeve imperialiste italiane dhe aleatëve të tyre që t'i vënë gishtin kokës se kohërat e kaluara kur ata luanin me fatin e po-

pullit tonë kanë perënduar përgjithmonë. Por sidoqoftë ata le ta dëgjojnë edhe një herë, se Shqipëria e popullit është më e fortë se kurrë ndonjëherë tjetër, ajo ka Partinë e Punës dhe pushtetin popullor që e mbrojnë, ajo ka aleatë dhe miq të fuqishëm dhe besnikë, ajo bën pjesë në kampin e paqes dhe të socializmit që kryesohet nga Bashkimi Sovjetik.

Ne jemi për bashkëjetesën paqësore, ne dëshirojmë dhe luftojmë që të kemi marrëdhënie fqinjësie të mira me Italinë, të bëjmë tregëti me njëri-tjetrin në interes të të dy popujve tanë, të kemi shkëmbime kulturele. Ne kurrë s'jemi përzierë në punët e brendshme të Italisë dhe kurrë s'do ta bëjmë një gjë të tillë. Këtë gjë kërkojmë edhe nga ana e qeverisë italiane. Në konstatojmë se marrëdhëniet në mes të dy vendeve tona janë normalizuar dhe shkojnë duke u përmirësuar çdo ditë, por ne nuk mund të mos themi se nga ana e qeverisë italiane duket një zvarritje e pajustificueshme në konkretizimin e problemeve të mbetura pezull deri tani. Ne propozuam të parët dhe nënshkruam me Italinë një marrëveshje për shkëmbime tregëtare këtu e 11 muaj. Vetëm muajin e fundit qeveria italiane vendosi ta ratifikojë këtë marrëveshje. Sidoqoftë më mirë vonë se kurrë. Ne kemi rënë gjithashtu dakord për çështjen e reparacioneve dhe restitucioneve që Italia i detyrohet Shqipërisë dhe që duhet të na i japë në lidhje me Traktatin e Paqes. Ne i kemi bërë mjaft lëshime qeverisë italiane në këtë çështje, pse dëshira jonë është që të likuidohet sa më parë ky problem, por qeveria italiane përsëri i zvarrit këto çështje duke nxjerrë arësye të kota. Ne i kemi riatdhesuar italianët që kanë dashur të kthehen në

atdheun e tyre, ne i kemi liruar dhe i kemi riatdhesuar të gjithë kriminelët e luftës italianë që kanë qenë dënuar nga gjykatat tona, ne kemi pranuar që qeveria italiane t'i tërheqë eshtrat e ushtarëve italianë që kanë luftuar me ushtrinë e Musolinit kundër nesh dhe çdo masë ndihmëse në këtë drejtim është gati nga ana jonë. Unë përfitoj nga rasti t'i përmend këto gjëra, përpara jush, shoku deputet Pajeta, që populli italian t'i dijë këto çështje si qëndrojnë dhe të njohë edhe një herë dëshirën dhe gatishmërinë e popullit shqiptar dhe të qeverisë së tij për të forcuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Italinë, në interes të të dy popujve tanë dhe të paqes në botë.

Ne i urojmë me gjithë zemër lumturi popullit vëlla punonjës italian dhe suksese akoma më të mëdha Partisë Komuniste motër të Italisë në misionin e saj historik. Edhe një herë do t'ju lutem, që në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në emrin e shokëve dhe timin personal, t'i transmetoni partisë suaj, Komitetit Qendror të saj dhe shokut Palmiro Toliati falenderimet dhe mirënjohjen tonë për nderin që na u bë nga ana e partisë suaj.

Rroftë populli vëlla italian!

Rroftë Partia Komuniste Italiane dhe Komiteti Qendror i saj me shokun Palmiro Toliati në krye!

Rroftë miqësia e singërtë në mes të popullit shqiptar dhe popullit italian!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 291 (2244), 2 dhjetor 1955

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM FALENDERIMI DREJTUAR DY MIQVE
TË SHQIPËRISË, ZOTËRINJVE ZHYSTEN GODAR
DHE ADMIRAL MULEK, PËR URIMET ME RASTIN
E 11-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT TONË**

2 dhjetor 1955

ZOTËRINJVE
ZHYSTEN GODAR DHE ADMIRAL MULEK

Paris

Falenderojmë nga zemra Ju dhe nëpërmjet Jush miqtë e Shqipërisë në Francë për urimet e bëra me rastin e 11-vjetorit të çlirimit të atdheut tonë.

Populli shqiptar ndjek me simpatí të madhe përpjekjet heroike të popullit francez në luftën e tij fisnike për forcimin e paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë luftë populli i Francës ka miq të shumtë kudo në botë, prandaj ajo do të kurorëzohet me sukses në favor të bashkëjetesës paqësore midis popujve.

Pranoni me këtë rast, të dashur miq, urimet tona më të nxehta për suksese të mëtejshme në punën tuaj

fisnike, për forcimin e miqësisë në mes të popullit shqiptar dhe popullit vëlla francez.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA E MBAJTUR NË PLENUMIN XVI TË KQ
TË PPSH «MBI REALIZIMIN E DETYRAVE TË
PLANIT TË SIITETIT PËR VITIN 1955 DHE MASAT
PËR SIGURIMIN E REALIZIMIT TË PLANIT TË
SHTETIT TË VITIT 1956»**

28 dhjetor 1955

Lidhur me raportin e Byrosë Politike¹ mbi problemet e planit dhe diskutimet që u bënë desha të theksoj dhe unë disa çështje që duhen pasur parasysh. Raporti i Byrosë Politike u plotësua nga diskutimet, në të cilat u dhanë mendime shumë të vlefshme, vetëm duhet kuptuar edhe situata në të cilën do të kryhen detyrat e planit të vitit 1956.

Sikurse u tha, viti 1956 është viti i parë i planit të dylë pesëvjeçar, d.m.th. tani hymë në një etapë të re që kërkon shumë përpjekje, nga ana e Partisë në radhë të parë dhe e të gjithë punonjësve të Republikës Popullore të Shqipërisë. Byroja Politike në këtë mbledhje do t'i paraqesë plenumit edhe propozimin për datën e mbajtjes së Kongresit III të Partisë ku do

¹ Raporti i Byrosë Politike të KQ të PPSH u mbajt nga Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu.

të aprovohet plani i dytë pesëvjeçar. Sipas nesh, Kongresi mendohet të mbahet aty nga muaji maj i vitit të ardhshëm.

Por ne duhet të kemi parasysh situatën e favorshme të brendshme që është krijuar në vendin tonë në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë e të përpjekjeve heroike të masave punonjëse të udhëhequra nga komunistët, si dhe situatën e favorshme politike ndërkombëtare që është krijuar si rezultat i politikës paqësore të kampit tonë të socializmit dhe të paqes, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik. Pra, ne hymë në një etapë të re në kushte më të favorshme nga ajo kohë kur filluam planin e parë pesëvjeçar. Është e qartë se gjatë periudhës së planit të parë pesëvjeçar, Partia, që udhëhoqi popullin në rrugën e socializmit është forcuar nga të gjitha pikëpamjet, nga ana politike dhe organizative, Kuadrot e Partisë dhe punonjësit pa parti kanë fituar një eksperiencë shumë të madhe në punë, ata janë ngritur nga ana kulture, politike dhe teknike. Kjo ka bërë që, me gjithë vështirësitë që u thanë edhe në raport, me gjithë mungesën e eksperiencës, me gjithë gabimet që janë vërtetuar në hartimin e planit të parë pesëvjeçar, Partia ka arritur suksese të mira dhe ato janë një avantazh, një plus, një mbështetje e fuqishme për të ecur përpara. Përveç kësaj Partia jonë ka mësuar shumë gjatë këtyre vjetëve nga gabimet që janë vërtetuar në punën tonë. Këto na kanë dhëmbur, na kanë djegur, por edhe na kanë mësuar dhe armatosur më shumë, sepse njerëzit e Partisë sonë të rritur në luftë e në vështirësi, të edukuar me frymën e leninizmit i kanë parë gabimet,

të metat dhe vështirësitë në sy, i kanë njohur dhe janë përpjekur me të gjitha forcat që këto të mos përsëriten. Ky është një avantazh shumë i madh për edukimin e kuadrove të Partisë sonë. Prandaj në një situatë të tillë, të gjithë kanë bindjen dhe kështu do të ngjasë, që plani i dytë pesëvjeçar do të jetë një plan real, i mbështetur mirë, i mbështetur shumë më mirë se plani i parë pesëvjeçar. Për këtë ne do të kemi ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve miko të demokracisë popullore. Është një çështje me rëndësi të madhe po të marrim parasysh situatën ndërkombëtare, që favorizon një zhvillim shumë më të mirë të ekonomisë dhe të mirëqenies së popullit.

Situata ndërkombëtare po zhvillohet në dobi të kampit të socializmit dhe të paqes. Unë nuk do të zgjatem në rëndësinë që pati Konferenca e Gjenevës e katër kryetarëve të qeverive të mëdha, e cila i dha një grusht të fortë «luftës së ftohtë» që bëjnë qarqet imperialiste kundër kampit tonë të socializmit. Dëshira e kampit tonë të socializmit është që jo vetëm në teori, por edhe në praktikë të bëhen të gjitha përpjekjet për bashkekzistencën paqësore sipas mësimëve të Leninit.

Pastaj erdhi Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme, e cila, me gjithë përpjekjet e mëdha që u bënë nga ana e Bashkimit Sovjetik, nuk dha rezultatet e kërkuara. Megjithatë edhe kjo Konferencë e Ministrave të Punëve të Jashtme ka pluset e saj, sepse e gjithë bota pa pozitë të Bashkimit Sovjetik, të kampit tonë dhe qëndrimin e shteteve Perëndimore. Por ne nuk mund të themi se nuk ka dhe nuk do të ketë në

Perëndim clementë dhe udhëheqës që përpiqen e do të përpiqen të mbajnë gjallë «luftën e ftohtë». Popujt e botës, popujt kolonialë dhe gjysmë të varur e kanë përkrahur politikën për ruajtjen dhe për mbrojtjen e paqes. Qarqet imperialiste të Perëndimit me qarqet imperialiste amerikano-angleze në krye janë të tronditura. Në vendet e tyre shumë njerëz, jo vetëm nga ata të qarqeve përparimtare, por edhe nga njerëzit e tyre kanë filluar ta atakojnë politikën e udhëheqësve amerikanë ose anglezë, ata po tregojnë se nuk mund të ecet më me politikën e frikësimeve dhe të shantazhit dhe me pikëpamjen se me dollarë mund të blihen popujt.

Natyrisht, të gjitha këto kanë rëndësi në çështjet ndërkombëtare. Le të marrim p.sh. çështjen jugosllave. Marrëdhëniet e vendeve tona me Jugosllavinë tani po zhvillohen dhe po forcohen, sido që në këto marrëdhënie ka shumë çështje si nga ana teorike, ashtu edhe nga ana praktike për të cilat ne nuk jemi dakord me ta. Por ne jemi dakord që marrëdhëniet miqësore dhe tregëtare të zhvillohen në rrugë të drejtë dhe kjo është në interesin tonë dhe të atyre. Ne do të punojmë dhe do të luftojmë në këtë drejtim.

Shkurtimeq që u bënë në forcat tona të armatosura, jo vetëm kanë bërë një përshtypje të madhe në të gjithë botën, por kanë treguar se kampi ynë nuk ka vetëm fjalë, por edhe vepra.

Të gjitha këto masa janë shumë pozitive dhe do të ndihmojnë për një zhvillim akoma më të fuqishëm të ekonomisë dhe për përparimin e mëtejshëm të vendit tonë.

Gjithashtu edhe situata e brendshme e vendit tonë është forcuar shumë si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ana politike. Ne shohim se me gjithë vështirësitë, planet tona janë realizuar dhe jeta e popullit tonë është përmirësuar shumë. Natyrisht, këto duhet të na bëjnë të jemi kurdoherë realistë, t'i shohim drejt sukseset tona dhe të mos kënaqemi kurrë me aq sa kemi bërë. T'i shohim drejt dhe seriozisht të metat tona dhe të luftojmë që t'i ndreqim ato. E theksoj këtë, se mund të ketë ndonjë rrezik nga kjo anë, që duke e parë këtë situatë të favorshme ndërkombëtare dikush mund të mendojë se tani mund të ecet përpara me përpjekje më të pakta. Ky do të ishte një gabim shumë i rëndë nga ana jonë. Me gjithë përmirësimin e situatës ne nuk duhet të harrojmë detyrat tona, neve nuk na lejohet të ulim vigjilencën, pasi rreziku ekziston kurdoherë dhe ai nuk është i vogël, po shumë i madh. Prandaj vigjilenca jonë kundër armiqve, përkundrazi, duhet të mprehet edhe në këtë situatë të favorshme. Gjithashtu lufta e klasave duhet të zhvillohet dhe të mos na zërë gjumi mbi dafina, ndryshe do të vuajnë ekonomia, shteti dhe liria e popullit tonë. Këto gjëra, pra, duhet t'i kemi parasysh që edhe në këtë situatë të mundim të ndërmarim dhe të kryejmë këto detyra kaq të mëdha.

Natyrisht, këto çështje në kongres do të zhvillohen më gjerë. Kongresi III i Partisë do të jetë një shkollë e madhe, ashtu sikurse kanë qenë edhe Kongresi I dhe II. Byroja Politike mendoi drejt që me mbarimin e vitit të fundit të planit të parë pesëvjeçar të mbahej ky Plenum i Komitetit Qendror, ku të bëhej analiza

e rezultateve të arritura dhe të hidheshin gjithashtu edhe disa detyra kryesore për të ardhshmen, të cilat janë të domosdoshme, me qëllim që Partia të pregatitet qysh tani për Kongresin III, për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar dhe për zgjidhjen e të gjitha atyre problemeve që u ngritën këtu.

Tani unë dua të theksoj disa çështje:

Çështja e bukës. Kjo është një nga problemet më kryesore për vendin tonë, në mos më kryesorja. Ju e dini se shteti ynë importon çdo vit sasi të mëdha drithëra buke dhe mund të themi se megjithëqë kemi kapërcyer prodhimin e paraluftës, megjithëse kemi hapur shumë toka të reja, megjithëse kemi bërë investime mjaft të mëdha në bujqësi, prapëseprapë nuk po e ulim importin e drithërave të bukës, po vazhdojmë të sjellim nga jashtë ... ton drithë në vit. Ka qenë, është dhe do të jetë akoma e vështirë për disa vjet që ne të shpëtojmë nga importi i drithit. Vetëm duhet t'i vëmë detyrë vetes që t'i zbatojmë si duhet këto detyra që kemi. Ju e dini dhe këtë na e mëson Stalini dhe eksperiencia e Bashkimit Sovjetik, se ekonomia e vogël nuk ka mundësi të prodhojë drithin e mjaftueshëm për treg, megjithëse në llogaritë që bëjmë ne shohim se prodhimi i bukës për Republikë është shtuar; prapëseprapë ne jemi të detyruar të importojmë drithëra, sepse shteti, praktikisht, nuk ka mundësi që me drithin që blen në tregun e brendshëm të evitojë këtë import të bukës. Prandaj këtë problem ne duhet ta zgjidhim dhe Partia këtë çështje të mos e lerë në spontaneitet, të kënaqet vetëm me planifikimin dhe pastaj njerëzit të justifikohen me fjalët, «ja nuk u bë, jo fsha-

tari kështu, jo fshatari ashtu, jo bëri thatësirë ose ra shumë shi» etj.

Unë mendoj se këtë çështje do ta zgjidhë në radhë të parë, kolektivizimi në masë i bujqësisë. Prandaj përsa i përket bujqësisë kjo do të jetë një nga çështjet kryesore në kongres, por edhe Byroja Politike po e jep këtë orientim për krijimin e ekonomive kolektive të mëdha, të cilat do të prodhojnë më shumë drithë dhe shteti do të ketë mundësi të blejë më shumë se tani që kemi ekonomi të vogla, individuale. Por, përveç kësaj, duhet qortuar shumë Ministria e Bujqësisë dhe shokët e NBSH-ve sepse nuk është kaq kollaj të thuhet vetëm se hapen toka të reja në Sukth në sasi të konsiderueshme, se për këtë dhe për atë harxhuam kaq të holla dhe sasi të konsiderueshme mjetesh dhe pastaj të themi se bëmë gabim që nuk mbollëm misër, por grurë dhe nuk morëm as farën. NBSH-të duhet të prodhojnë kryesisht drithëra, por ato, nga ana e tyre, duhet t'i kryejnë mirë detyrat, sepse sikurse thanë shokët, ato nuk i janë përgjegjur detyrës për dorëzimin e drithit, nuk e kanë marrë seriozisht këtë çështje kaq të rëndësishme. Atëhere përse të jemi kaq ekzigjentë dhe rigorozë ndaj atyre fshatarëve individualë që nuk e bëjnë bukën dhe nuk i shlyejnë në kohë detyrimet ndaj shtetit, kurse me ndërmarrjet shtetërore bujqësore të jemi liberalë? Kjo nuk është serioze dhe e drejtë. Pastaj e tha drejt një shok që ne, po t'i presim kallamishtet, mund të arrijmë të fitojmë edhe 500 mijë kv. misër. Po a është kjo një sasi e vogël? Jo, kjo është një sasi shumë e

madhe. Derisa themi se fshatari është i gatshëm të ecë në rrugën e kolektivizimit dhe ai ka bërë kaq hapa përpara, pse nuk e aktivizojmë këtë fshatar të luftojë për zhdukjen e kallamishteve që janë mbajtëse të parazitëve që na dëmtojnë prodhimin? Mua më duket se Partia nuk lufton sa duhet në këtë drejtim.

Unë do të flas edhe për diçka tjetër që nuk u fol. Këtu u diskutua problemi vetëm nga ana teknike. Kjo është pozitive dhe tregon se Partia ka ecur përpara edhe në këtë drejtim. Por mua më duket se duhet folur edhe për edukimin e njerëzve, sepse në rast se fshatari nuk e bën këtë apo atë punë, jo se nuk e bën nga përtacia, por sepse ai nuk e kupton çështjen politikisht dhe nuk i kupton përfitimet ekonomike që do të kemi prej saj. Me këtë dua të them që çështjes së bukës t'i vëmë rëndësinë më të madhe dhe të mos themi se fshatari duke prashitur misrin harron bimët industriale. Fshatarit t'i themi se ti bën shumë mirë që prashit misrin, por në të njëjtën kohë atë duhet ta bindim pse duhen prashitur edhe bimët industriale. Bimët industriale janë bimë të reja në vendin tonë e megjithatë fshatari ka filluar tani t'i dojë ato dhe në këtë drejtim po ecet më mirë. Këto bimë kanë rëndësi të madhe për ekonominë tonë, sepse me anë të tyre ne do të sigurojmë lëndën e parë për industrinë, por, në asnjë mënyrë nuk duhet të harrojmë bukën. Atë duhet ta prodhojmë vetë dhe ta ekonomizojmë se deri tani nuk e kemi ekonomizuar. Ç'është e vërteta bukë kemi dhënë boll. Tani qeveria do të marrë disa masa d.m.th. do ta shkurtojë dhënien e bukës, për një kategori

njerëzish. Atyre që nuk do t'u jepet bukë dhe që do t'i përmend më poshtë, të mos u jepen triskat. Po mund të thotë dikush se ne kemi dhënë përpara bukë, pse të mos vazhdojmë të japim tani. Mirë kemi bërë atëherë, se ashtu kanë qenë situatat, kurse tani nuk mund t'i japim bukë cilitdo. Këto masa që do të marrim tani, kanë anën e tyre pozitive, sidomos nga ana ekonomike, mirëpo ato kanë edhe anën negative, prandaj duhet bërë shumë punë edukative me njerëzit që nuk do të marrin më triska. Njerëzit që tani nuk do të marrin triska si klerikët, gratë e reja që nuk duan të punojnë dhe disa të tjerë, edhe do të pëshpëritin; shumë prej tyre do të mbeten edhe të pakënaqur. Shteti ata i ka siguruar me bukë 10 vjet me radhë, po tani situata ka ndryshuar. Tani shteti i ka hapur perspektiva çdo njeriu, secilit i sigurohet punë, prandaj kush do le të vejë të punojë dhe ta nxjerrë bukën. Partia duhet të punojë më thellë për edukimin e njerëzve që të mos pëshpëritin kot, ajo duhet të punojë për të ngritur ndër-gjegjen e njerëzve, që këta t'i kuptojnë politikisht çështjet, ashtu si duhet. Kjo është një detyrë e rëndësishme e Partisë. Çështja e bukës duhet të jetë një problem i madh.

Ne e kuptojmë rëndësinë që ka kolektivizimi i bujqësisë dhe Byroja Politike ka qenë plotësisht dakord që në pesëvjeçarin e dytë bujqësia të ketë perspektiva të qarta për të zgjeruar kolektivizimin, dhe në radhë të parë në fusha, për arësyet që dihen. Këtë na e tregon edhe eksperiencia e Bashkimit Sovjetik dhe e Republikës Popullore të Kinës. Duke lexuar raportin e

shokut Mao Ce Dun¹ ne shohim se në Kinë kolektivizimin e kanë edhe me plan. Mua më duket se edhe Komiteti ynë Qendror ka kohë ta studjojë këtë çështje. Disa shokë mund të thonë se duke planifikuar kolektivizimin, mund të shkelim parimin leninist të vullnetarizmit. Në asnjë mënyrë ne nuk e shkelim këtë parim. Komiteti Qendror ka theksuar se edhe tani që ngremë kooperativa të reja bujqësore duhet të shkojmë me një perspektivë. Tani ne dimë se në ç'vend është pjekur situata, ose Partia thotë se në atë fshat ku situata paraqitet e mirë të shtohen përpjekjet dhe të krijohet një kooperativë bujqësore e shëndoshë. Pra, pa shkelur parimet leniniste për kolektivizimin, ne mund të bëjmë parashikime dhe kështu kolektivizimi të zhvillohet me plan në fusha. Këtë e them se çështja e krijimit të kooperativave bujqësore nuk është një çështje e thjeshtë. Tani te ne situata është që të kalojmë në detyra të reja për planin e dytë pesëvjeçar dhe pa dyshim do të kemi sukses në lëmin e kolektivizimit. Kështu bujqësia do të ecë përpara, puna jonë në bujqësi do të përqëndrohet në çështjen e kolektivizimit dhe frutet do të jenë të mëdha. Por Partia duhet të dijë se këto punë nuk bëhen me «frymën e shenjtë». Partia duhet të luftojë dhe do të luftojë shumë për këtë çështje. Ndryshe nuk do të kemi sukses, nuk duhet të hidhemi në masa administrative për të futur fshatarët në kooperativë. Në këtë mbledhje asistojnë

¹ Raport në Plenumin II të KQ të zgjedhur nga Kongresi VII I PKK (5 mars 1949). Vepra të zgjedhura, botim shqip, vëll. V, f. 469-485.

kuadrot më të lartë dhe dikush nga ne mund të thotë se nuk do të hidhemi në masa administrative. Por, kur vemë poshtë, veprohet ndryshe. Unë bile mund të them se edhe deri tani, që kemi ecur ngadalë në kolektivizimin e bujqësisë, janë marrë masa administrative e jo më tani që jepet ky orientim i ri për zgjerimin e kolektivizimit. Edhe tani ka rrezik të veprohet me masa administrative. Dua të theksoj se detyrat që do të na vërë Kongresi III dhe që po i shtron që tani ky plenum, kërkojnë nga Partia një punë të madhe politike dhe organizative, pse edhe sikur ta zëmë se fshatari ynë është i gatshëm për të hyrë në kooperativë me një të rënë të trumbetës, ne nuk duhet të harrojmë se fshatarët kanë në kokën e tyre mbeturina mikroborgjeze dhe ne do të hasim vështirësi të jashtzakonshme në forcimin organizativ politik dhe ekonomik të kooperativave bujqësore, pavarësisht se ata janë futur atje me vullnet të mirë. Fshatarët kanë shumë mbeturina që Partia duhet t'ua luftojë. Pra që kooperativat bujqësore të formohen të shëndosha, Partia duhet të bëjë një punë bindëse jashtëzakonisht të madhe.

Shteti ynë ka bërë shumë investime në bujqësi dhe nuk kemi bërë keq. Të tjera investime të mëdha ai do të bëjë edhe në të ardhshmen. Ne kemi bërë kanalizime, që kanë sjellë rezultate të mira, por në shumë raste rendimenti i prodhimeve akoma nuk u përgjigjet kujdesit dhe masave që janë marrë. Tani vazhdojmë të bëjmë kanale të mëdha tharjeje e ujitjeje për t'u dhënë ujë fshatarëve. Ne duhet të synojmë që gjatë këtyre kanaleve të mëdha të ngrihen kooperativa

të reja bujqësore. D.m.th. kooperativat të ngrihen atje ku Partia ka shpenzuar lekët dhe djersën e popullit. As fshatari individual, të cilin Partia i ka dhënë gjithë këto mundësi, nuk duhet të prodhojë më 11 kv. për ha., por 18 kv. për ha. Ndryshe nuk kemi si ta prodhojmë bukën në vend. Atje ku e kemi të siguruar ujitjen të mos marrim 4 kv. pambuk për ha., por 7-8 kv. për ha. e më shumë. Prandaj ngritja e kooperativave të reja bujqësore lyp një studim të hollësishëm nga Komiteti Qendror, nga qeveria dhe Ministria e Bujqësisë, veçanërisht nga organet përkatëse në rrethe. Për këtë gjë ne duhet të hartojmë një plan të mirë të punës politike, ekonomike dhe organizative në mënyrë që të gjitha këto të përputhen në një plan të vetëm. Kështu do të kemi suksese, do të ngrihet më lart bujqësia dhe do të zhvillohet më tej ekonomia jonë. Prandaj ne mund dhe duhet t'i parashikojmë këto gjëra në këtë drejtim. Ne duhet të kalojmë në situata të reja.

Gjatë kësaj periudhe, që ne do ta zgjerojmë kolektivizimin, të mos mendojmë se u ngritën kooperativat dhe nuk do t'i kërkohet më ndihmë shtetit. Ne duhet të punojmë mirë që të jenë kooperativat ato që t'i japin bukë shtetit dhe jo shteti t'u japë bukë atyre. Ndryshe nuk kemi bërë gjë. Shteti duhet t'u japë atyre mjete, kredi dhe unë jam dakord që kredia për kooperativat bujqësore të shtohet, natyrisht kjo duhet të zhvillohet në dinamikën e saj. Deri tani kredia u është dhënë kryesisht fshatarëve individualë dhe mirë kemi bërë, por ne u kemi dhënë kredi edhe kooperativave bujqësore. Tani ne duhet të vazhdojmë t'u japim kredi

fshatarëve të varfër, po kjo kredi do të pësojë disa ndryshime. Në radhë të parë propaganda e Partisë me fshatarët individualë që kanë afër kooperativa bujqësore, duhet të jetë aq e fuqishme saqë fshatari i varfër kredinë më të mirë ta shohë në futjen e tij në kooperativë. Por, mund të ketë edhe fshatarë të varfër që nuk e kanë kuptuar akoma interesin që kanë për t'u futur në rrugën e kolektivizimit. Partia këta fshatarë t'i ndihmojë me kredi, por të punojë me perspektivë me ta që të futen në kooperativë. Fshatarëve të mesëm, që janë afër kooperativave bujqësore dhe ekonomia e tyre është e ngritur, të mos u jepet kredi, të paguajnë vetë çdo gjë dhe nga puna politike e Partisë të nxiten për t'u futur në kooperativë. Ka pastaj fshatarë të zonave malore dhe fshatarë të varfër blegtorë që ne duhet t'u japim kredi dhe ndihmë. Është e vërtetë se për ne çështja kryesore është kolektivizimi i fushës, po edhe në malësi ka shumë popullsi dhe shtetit i intereson që edhe këto ekonomi të zhvillohen dhe të pasurohen e si rezultat të forcohet ekonomia e përgjithshme. Pastaj do të vijë koha që edhe atje të zhvillohet kolektivizimi. Kështu në çështjen e kredive ruhet parimi i përgjithshëm që ka caktuar Komiteti Qendror d.m.th. që të ndihmohen fshatarët e varfër dhe kooperativat bujqësore në mënyrë më të organizuar.

Për kooperativat bujqësore nuk duhet të llogaritim vetëm kërkesat nëse kanë mjete apo jo. Këto nevoja ashtu sikurse edhe kërkesat për kuadro duhet t'i planifikojmë. Shoku Rrapo Dervishi e shtroi çështjen në mënyrë shumë pozitive se ata kanë menduar për

këto probleme dhe kanë dërguar për të pregatitur kuadro jo vetëm për kryetarë e llogaritarë, por edhe për teknikë e agronomë. Çështja nuk është vetëm të formohet kooperativa bujqësore. Pas kësaj, më e rëndësishmja është që atje duhet të organizohet prodhimi me mjete moderne. Këto në përgjithësi kooperativistët nuk mund t'i përdorin, me gjithë vullnetin e mirë që mund të kenë. Ata që kanë praktikë duhet t'i futim edhe në shkollë. Kështu për kolektivizimin ka një sërë çështjesh të cilat duhet të planifikohen që të kemi sukses. Këtë detyrë ne do ta kryejmë. Partia e ka forcën mobilizuese dhe organizuese, kuadrot e Partisë sonë tani kanë mjaft eksperiencë dhe do ta kryejnë me sukses këtë detyrë, por edhe ne nga lart të analizojmë mirë këtë problem dhe të marrim vendime të drejta.

Çështja tjetër që u tha këtu në plenum është se kooperativat bujqësore nuk japin teprica, kurse ato duhet të japin. Kjo tregon se Partia nuk punon sa duhet në këtë drejtim, prandaj edhe vazhdojnë të ekzistojnë pikëpamje shumë të theksuara mikroborgjeze. Po kur të zgjerohet edhe më shumë kolektivizimi ç'do të bëhet me tepricat? Këto kanë rëndësi për shtetin dhe po të vazhdohet kështu, nuk është e drejtë. Eksperiencia e Bashkimit Sovjetik na mëson se kur nuk ishte bërë kolektivizimi i bujqësisë, fshatrat angazhoheshin në mënyrë kolektive për të lehtësuar punën e grumbullimit. Natyrisht, në rast se Partia bën përpjekje për t'i ngritur njerëzit që t'i kuptojnë çështjet në mënyrë politike, nën prizmin e interesit të përgjithshëm të popullit dhe të Republikës, detyrat kryhen më

mirë. Prandaj në këtë frymë duhet të forcohet Partia në fshat. Në radhë të parë në fshat duhet të bëhet një punë e madhe për të ngritur ndërgjegjen e shokëve të Partisë dhe për të ngritur nivelin kultural të vetë fshatarëve. Ne mund të themi se Partia ka korrur suksese në fshat, po ka edhe mjaft për të bërë. Atje ka akoma shumë të meta serioze në punën e Partisë.

Disa ditë më parë Byroja Politike mori në shqyrtim dhe vendosi çështjen e adaptimit të orientimit të ri të Partisë në lidhje me ndryshimet organizative dhe diskutoi rreth shumë varianteve, përsa i përket çështjes së instruktorëve. Varianti më i përshtatshëm është që udhëheqja të lidhet ngushtë me bazën. Sekretarët nuk kanë vetëm detyrën funksionale, por kanë edhe një zonë të caktuar për të cilën janë përgjegjës përpara komitetit të Partisë. Por, Byroja Politike është e mendimit se duhet të vazhdojmë akoma edhe për një kohë me këtë ndarje funksionale, sepse kuadrot tanë akoma nuk janë të ngritur që të mund të drejtojnë mirë në terren të gjitha problemet e Partisë. Tani ne i kemi kështu sekretarët dhe ata nuk e bëjnë detyrën si duhet, sepse Partia që udhëheq në bazë nuk i edukon dhe nuk i orienton si duhet njerëzit. Eksperiencia nuk tregon atë që thotë shoku J.P., por është ashtu si thotë «Zëri i Popullit» në artikullin ku flet për shokët e Burrelit që marrin instruktorin dhe e bëjnë nëpunës të grumbullimit. Ashtu si çdo sektor edhe grumbullimi ka rëndësi të madhe, por kjo punë duhet bërë me kuadro që të jenë njerëz partie, të edukuar me frymën e Partisë. Por organizata bazë nuk merr kurdoherë atë ndihmë që duhet të marrë nga Komiteti i Partisë.

Prandaj nuk është nevoja që të vejë sekretari e të rrijë 10-15 ditë në një fshat për të realizuar detyrimet. Nuk është e drejtë që një sekretar të veprojë kështu. Atëhere ç'i mbetet të bëjë asaj organizate bazë? Asgjë, sepse të gjitha ia bën sekretari i Komitetit të Partisë. Po nga ky sekretar presin 40 organizata bazë për t'u ndihmuar. Prandaj duhet të përdorim mirë të gjitha format dhe aftësitë që të arrijmë në metoda më të drejta pune, për të lidhur sa më mirë udhëheqjen me bazën dhe për ta ndihmuar atë në zgjidhjen e të gjitha problemeve që ka përpara. Çështjen e kam këtu që Partia si në fshat, ashtu edhe në qytet, duhet t'i edukojë njerëzit, t'i ngrejë ata nga ana politike, ideologjike dhe profesionale. Në qytet, e dimë se thelbi, baza, palca e kurrizit, është klasa punëtore. Unë e vë theksin te interesi i Partisë për edukimin komunist të klasës punëtore që duhet të jetë i vazhdueshëm. Por kjo punë bëhet me shumë të meta, prandaj një gjë e tillë nuk mund të lejohet. Punëtorët ne duhet t'i ngremë politikisht, t'i çelmosim teorikisht, të punojmë pa u lodhur që të zhdukim mbeturinat mikroborgjeze që ekzistojnë dhe shfaqen në ndërgjegjen e tyre. Ne kemi arritur shumë rezultate në kualifikimin teknik të punëtorëve. Kjo është një gjë shumë e bukur dhe pozitive, megjithëse jo e plotë, sepse po ta krahasojmë këtë me ngritjen e tyre si komunistë kemi shumë për të bërë. Shkollat e natës nuk frekuentohen nga punëtorët. Ç'presin këta njerëz, kush do ta marrë atë edukatë, apo djemtë e borgjezisë? Punëtorët duhet të jenë në ballë të kësaj pune, por vërejmë se nga ana e Partisë bëhen lëshime në drejtim të edukimit komunist të klasës pu-

nëto. Këtë çështje duhet ta marrin në dorë të gjithë shokët e Partisë dhe jo vetëm sekretarët, sepse secili prej nesh duhet ta ketë të qartë se më parë je komunist, je anëtar partie, pastaj drejtor. Detyra jote s'është t'i ngresh njerëzit, me parti ose pa parti qofshin vetëm nga ana teknike, por t'i ngresh në një nivel të lartë politik që t'i kuptojnë si duhet detyrat e tyre. Atëhere je me të vërtetë një drejtor si duhet. Kështu na mëson Stalini.

Këtë detyrë nuk e bëjmë të gjithë si duhet. Ne konstatojmë me kënaqësi që ju, kuadrot kryesorë, shumë mirë i kuptoni çështjet. Shoku Sali Angoni foli shumë drejt këtu, por si komunist unë nuk e di se me sa forcë i ka shtruar ai këto probleme të rëndësishme në organizatën bazë ku ai jeton. Nuk di gjithashtu nëse këto çështje me rëndësi që ai nuk i ngre për herë të parë, i ka diskutuar me shokun Josif Pashko, me shokun Adil Çarçani, me të gjithë punëdhënësit. Këto i keni marrë si gjëra të rastit, të zakonshme dhe të zanatit dhe jo si probleme të mëdha partie. Pastaj të mos flasim për Drejtorinë e Industri-Minierave në aparatën e Komitetit Qendror që merret me këto çështje, për atë këto janë të huaja që të shtrohen në Parti. Çështjet nuk mund të ecin, po të mos shtrohen dhe po të mos kuptohen si duhet nga komunistët dhe jo në frymë dikasteriale. Secili, kur bën një punë duhet të reflektojë më përpara si njeri partie. Atje ku kemi të meta, t'i zbulojmë, t'i diskutojmë në kolektiv, të marrim vendime dhe pastaj t'i zbatojmë. Kështu zgjidhen këto gjëra në rrugë të drejtë partie. Problemet duhet të bëhen çështje partie, por akoma nuk bëhet kështu. Pse të ekzistojnë këto të

meta në sektorët tuaj, kur ju këto çështje i kuptoni si duhet? Kjo vjen, sepse ju ndihmën nuk e jepni si duhet, si njerëz partie, por mendoni se në organizatën bazë mund të hidhet një kritikë, një thumb andej-këtej dhe të mos ngrihen këto probleme që preokupojnë Partinë. Po të veprohet si thotë Partia, punët do të ecin shumë përpara, do të ngrihet prestigji juaj si drejtorë, do të shtohet dashuria e kolektivit ndaj jush. Edhe për udhëheqjen do të jetë mirë, sepse kjo pa ju nuk mund të udhëheqë. Kjo është e domosdoshme. Në qoftë se masa sheh që drejtori nuk flet fare në organizatën bazë, nuk i shtron aty problemet dhe nuk kërkon ndihmën e organizatës, të jeni të sigurtë se vendimet e saj janë formale, të këqiat nuk mund të zhduken dhe besimi i bazës te ju nuk mund të jetë i shëndoshë. Prandaj duhet që Partia në radhë të parë të jetë e lidhur me detyrat e reja, të forcojë punën dhe kur themi Partia, duhet të kuptojmë anëtarët e Partisë. Në rast se të gjithë këta njerëz që janë në komitetet e Partisë dhe në aparatit e Komitetit Qendror i edukojmë në këtë frymë, atëhere të gjithë do të punojnë mirë. Prandaj që t'i zbatojmë këto detyra duhet të mos harrojmë ngritjen politike të komunistëve, farkëtimin e tyre politik dhe moral, në shkallën që ata të kuptojnë situatat, të luftojnë për vendimet që do të marrë Komiteti Qendror. Komiteti Qendror do të marrë shumë vendime të rëndësishme dhe këto vendime disave do t'u vijnë thartë, por po t'i gyykojmë mirë, ato janë plotësisht të drejta. Të marrim çështjen e normave ose për uljen e kategorizimeve. Ato janë të drejta të zbatohen, po do të ketë njerëz që do të thonë pse na u bë kjo gjë. Prandaj për

t'i bërë të qarta masat që po merr Byroja Politike dhe qeveria Partia duhet të punojë medoemos në atë mënyrë që ato të kuptohen drejt.

Këtu u tha se në industri kemi pasur suksese. Kjo është e vërtetë, por në këtë sektor kemi edhe të meta. Detyrat e planit të dytë pesëvjeçar do të jenë të tilla që industrinë ekzistuese ta shfrytëzojmë si duhet. Prandaj çështja e edukimit të kuadrit, e perfeksionimit të tij dhe e shfrytëzimit të maqinerisë të çdo lloji si dhe të rezervave të brendshme, janë detyra kryesore jo vetëm nga ana teknike, po edhe politike. Partia duhet të punojë paralelisht në këtë drejtim. Edhe mbi masat që do të marrim siç është prerja e triskave për familjet e punëtorëve që vijnë nga fshati, për gratë e reja që nuk marrin pjesë në prodhim etj. duhet të punojmë shumë, sepse në rast se Partia nuk bën punë sqaruese ato do të na bëhen probleme shoqërore. Vjen një shok dhe më thotë se ka papunësi në Korçë. Unë i them atij se nuk ka papunësi në Shqipëri. Punë ka kudo, vetëm se korçari e do ta ketë punën nën hundë. Është e vërtetë se tani shumë punë u shkurtuan në administrata, sepse u shkurtuan aparatet edhe normat u rritën, kurse në Korçë ose në Shkodër një kategori njerëzish janë mësuar të vijnë rrotull. Kjo do të thotë se Partia duhet të punojë më mirë politikisht në këtë drejtim. Të gjithë duhet ta kuptojnë se punë ka në Shqipëri, prandaj detyra e tyre si patriotë është të shkojnë atje ku është puna, kjo do të jetë edhe në interesin e tyre ekonomik. Ne kemi thënë edhe herë të tjera se do të na dalë përpara çështja e gruas si edhe këtë radhë. Ne nuk do t'u japim triska grave të reja që nuk punojnë, po tani duhet që edhe

atyre t'u gjendet punë. Po si do t'u sigurohet puna? Komiteti Qendror e ka dhënë orientimin. Shumë burra në qytete nuk e kanë vendin atje ku janë. Ata le të dërgohen në punë më të rënda jashtë qyteteve. Këtë masë duhet ta marrin pushteti dhe Partia bashkërisht. Të zëvendësohen me gra burrat që punojnë në punë të lehta. Që tani grave duhet t'u jepet një farë instruksioni për profesione të ndryshme. Gruaja, sigurisht, nuk mund të përballojë dot punët e rënda në hidrocentrale, por korçari dhe gjirokastriti të shkojnë e të punojnë atje. Ata, përpara kanë vajtur deri në Amerikë e në Australi dhe jo të mos venë nga Korça në Mat. Prandaj duhet t'i spastrojmë njerëzit nga këto pikëpamje dhe t'i bëjmë ata që t'i kuptojnë politikisht situatat dhe interesat e tyre ekonomike dhe nga ana tjetër, gratë t'i edukojmë që të mësojnë dhe të marrin profesione. Këto gjëra ne duhet t'i parashikojmë se do të na zënë këmbët.

Gjithashtu duhet treguar kujdes edhe për maqineritë që u ngrit këtu se nuk përdoren. Shumë shokë i dhanë nga një lustër kësaj çështjeje, por tani ka ardhur koha t'i shfrytëzojmë sa më mirë maqineritë, sepse kemi shumë dhe pak po i shfrytëzojmë.

Duhet të ngremë kudo përgjegjësinë personale, si domos te njerëzit e industrisë, të minierave, te kuadrot udhëheqës të Partisë, te të gjithë komunistët. Me një fjalë të gjithë ta ndiejnë përgjegjësinë e punës për të cilën na ka ngarkuar shteti, ta kryejnë atë me ndërgjegje dhe të ruajnë si duhet materialet që na ka vënë në dorë shteti. Në këtë drejtim ne jemi shumë prapa dhe këtë të metë serioze që shkakton vështirësi të jashtzakonshme në realizimin e planit, në shfrytëzimin

e paktë dhe prishjen e materialeve, ta shikojmë drejt në sy. Ne të gjitha këto materiale po i sjellim nga jashtë me vështirësi të mëdha, sepse sjellja e tyre kërkon devizë dhe mjete të tjera; me gjithë këtë na vijnë me vonesë të madhe. Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi maksimal i tyre do të bëhet vetëm në rast se Partia vë të gjitha forcat për ngritjen e ndërgjegjes së punonjësve. Kësaj çështjeje ne duhet t'i vëmë rëndësi të madhe. Kjo bëhet vetëm me anën e edukimit, me anën e kujdesit të veçantë dhe atëror të Partisë. T'u qëndrohet në kokë komunistëve, t'u luftohen atyre anët e këqia se kjo i pengon ata në dhënien e shembullit të tyre personal. Prandaj në këtë drejtim ne duhet të marrim masa.

Duhet të marrim gjithashtu masa edhe për pesëvjeçarin e dytë përsa i përket edukimit të intelektualëve nga radhët e klasës punëtore. E theksova edhe më lart çështjen e arësimit për klasën punëtore. Këto probleme duhet ta preokupojnë shumë Partinë, të mos kënaqemi me rezultatet e arritura, megjithëse ato janë të mira.

Punëtorët tanë janë të zgjuar, kanë guxim, po duhet treguar kujdes i vazhdueshëm për ta. Partia duhet t'i shtyjë përpara ata, sepse ne duhet të ngremë elementët e klasës, t'i edukojmë ata. Komiteti Qendror dhe qeveria kanë marrë shumë masa lehtësuese, po nga Partia duhen bërë më shumë përpjekje në këtë drejtim.

Masat që do të marrë Komiteti Qendror dhe qeveria në lidhje me shkurtimet në aparatet administrative u theksua se janë të nevojshme. Unë them që edhe ato

duhen kuptuar mirë, ndryshe pas pesë muajsh do të vijmë prapë atje ku ishim. Ne kemi bërë shkurtime edhe herë të tjera, por pas 6-7 muajsh kemi ardhur prapë atje nga u nisëm, kështu aparatet prapë janë fryrë. Këto shkurtime janë të nevojshme të bëhen, se rëndojnë ekonominë e vendit tonë, rëndojnë nivelin e jetesës së punonjësve tanë, prandaj janë plotësisht të drejta. Në rast se Partia i përtyp mirë këto detyra, edhe vendimet që do të marrë Komiteti Qendror në këtë plenum populli do t'i aprovojë, do të mobilizohet t'i zbatojë dhe do të nxitet që të japë më tepër për të përmirësuar ekonominë e tij dhe ekonominë në përgjithësi. Ndryshe do të kemi vështirësi të mëdha. Partia nuk lejon që vështirësitë ta pengojnë, sepse mundësitë janë të gjitha.

Prandaj punimi i vendimeve të drejta të këtij plenumi dhe zbatimi i detyrave do të jetë një sukses i madh për Partinë tonë. Tani, në prakun e Kongresit III ne duhet të mobilizojmë të gjitha forcat dhe gjatë tre muajve të parë të vitit që vjen duhet jo vetëm të realizojmë planet tona, por edhe t'i tejkalojmë që të vemë në kongres me suksese të reja. Të forcojmë organizimin në punë dhe kjo kohë që na ndan nga Kongresi III i Partisë të jetë një aksion i madh i Partisë dhe i punonjësve për forcimin, organizimin e mirë të punës dhe për realizimin e tejkalimin e planeve të shtetit.

Byroja Politike ka besim të plotë se anëtarët e Partisë do t'i kryejnë me nder këto detyra, se ata do ta udhëheqin Partinë sipas direktivave të Komitetit

Qendror në rrugën e socializmit. Prandaj në emër të Byrosë Politike i uroj Partisë, popullit dhe juve, kuadrove kryesorë, një vit të ri të gëzuar, të lumtur dhe plot punë vetëmohuese për realizimin e detyrave që na vë Partia.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**KUADROT E ORGANEVE TË PUNËVE TË
BRENDSHME TË JENË SHOKË LUFTE E PUNE,
KOMUNISTË TË MIRË, ME KULTURË TË LARTË
E MORAL TË PASTËR**

*Letër drejtuar organeve të Ministrisë së Punëve
të Brendshme*

5 janar 1956

ORGANEVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Komiteti Qendror i Partisë së Punës, duke i çmuar detyrat tuaja shumë delikate dhe misionin e lartë që ju ka ngarkuar Partia, disa herë ka marrë në analizë problemet e punës suaj me qëllim që t'ju ndihmojë në kapërcimin e vështirësive dhe arritjen e sukseseve të mëtejshme.

Në mënyrë të veçantë Komiteti Qendror është preokupuar për zgjedhjen e kuadrit, përgatitjen dhe vendosjen e tij.

Partia dhe Komiteti Qendror kanë pasur gjithmonë parasysh që për organet e punëve të brendshme të sigurojnë kuadro të kalitur në luftë dhe në punë, nga

komunistët më të mirë, shokë me ndërgjegje, moral e kulturë të lartë e të pastër, që shquhen për vullnetin, dinamizmin, trimërinë e besnikërinë në punë, që kanë talent dhe perspektivë për t'i shërbyer kauzës së popullit sa më mirë në këtë sektor delikat. Në të njëjtën kohë ata i kanë kushtuar një vëmendje të posaçme punës për forcimin dhe kalitjen e këtyre cilësive mbi bazën e një edukimi të shëndoshë dhe të vazhdueshëm ideo-politik marksist-leninist.

Partia dhe Komiteti Qendror, duke e vlerësuar faktin se organet e punëve të brendshme në tërësi dhe kuadrot e saj në veçanti, kanë qenë e janë një objekt shumë i rëndësishëm, ku armiqtë e vendit, të popullit e të Partisë sonë, synojnë të godasin me çdo mjet dhe të ushtrojnë një presion ideologjik të fortë e të vazhdueshëm, ju kanë porositur herë pas here që ta keni në qendër të vëmendjes këtë gjë dhe të jeni vigjilentë e të gatshëm për të qëlluar me kohë e si duhet mbi çfarëdo shfaqje të huaj që do të vërtetohet. Për rëndësinë që ka kjo çështje po ju kujtojmë edhe një herë.

Si rezultat i kësaj ju i keni kuptuar drejt e vlerësuar mjaft mirë ndihmën e porositë e Partisë dhe të Komitetit Qendror dhe jeni përpjekur që ta justifikoni besimin që ju është dhënë me rezultate sa më të mira në punë. Keni bërë hapa të mëdhenj përpara si në pregtitjen profesionale, ashtu edhe në atë ideo-politike dhe edukative, duke e përmirësuar mjaft punën në cilësi, në sasi dhe në perspektivë, duke zhdukur një sërë të metash e gabimesh si në punë ashtu dhe në jetën tuaj private.

Nga ky përparim është e qartë se kontributi juaj në

zhvillimin e përgjithshëm të jetës së vendit tonë, ka qenë i vlefshëm dhe është mirëpritur nga populli ynë, kundrejt të cilit keni fituar akoma më shumë respektin dhe dashurinë, gjë kjo që shpjegon një realitet pasi, siç dihet, populli ynë është shumë objektiv në vlerësimin e gjërave.

Komitetet e Partisë në qarqe e në rrethe gjithashtu, janë njohur më mirë me jetën, punën e problemet tuaja dhe kanë ndihmuar më konkretisht në zgjidhjen e mjaft çështjeve që ju kanë preokupuar. Ato janë përpjekur e kanë pasur rezultate më të mira në forcimin e rolit të organizatave bazë të Partisë në këto organe dhe në edukimin ideo-politik e kultural të tyre, fakt ky që shpjegohet në të gjitha sukseset që keni arritur në punë.

Por, me gjithë rezultatet që keni arritur, konstatohet se ju akoma nuk i përgjigjeni zbatimit të plotë të detyrave ashtu siç ka kërkuar dhe kërkon Partia, shkaku kryesor i të cilave qëndron në moszbatimin e përpiktë të vendimeve e të porosive të Partisë dhe të Komitetit Qendror nga ana e një numri kuadrosh dhe në mosshfrytëzimin e të gjitha mundësive për zhdukjen e të gjitha të metave dhe të dobësive që ekzistojnë.

Natyrisht, këto të meta e dobësi paraqiten me raste, por megjithatë këto kanë ushtruar një influencë serioze në dëm të punës dhe të autoritetit të organeve të punëve të brendshme, në dëm të ligjshmërisë socialiste dhe të vijës së Partisë në vendet ku janë shfaqur.

Burimi i këtyre të metave e dobësive është fryma e familjaritetit të sëmurë, që ka ekzistuar dhe ekziston te disa kuadro, të cilët e nënvleftësojnë këtë ose nuk e

çmojnë fare si një nga shfaqjet shumë të rrezikshme që mbyl kritikën dhe prish ndërgjegjen dhe karakterin e njerëzve.

Duhet të kuptohet se familjariteti i sëmurë nuk lindi rastësisht, ai ka bazën e vet dhe arrihet kur pajtohen një numër shfaqjesh të dëmshme të një ose më shumë personave, me ato të një ose më shumë personave të tjerë. Zakonisht në fillim ky shfaqet me forma që duken jo shumë të rëndësishme, siç janë pakënaqësia, mendjemadhësia, disharmonia, rryshfeti, tarafi etj., nga të cilat pastaj bëhen të zakonshme lëshimet për njëri tjetrin, dekonspirimet, grindjet, abuzimet e të gjitha këto të këqia, më në fund, të çojnë në kundërshtim me ligjet e shtetit dhe me vijën e Partisë.

Raste të shfaqjeve të familjaritetit të sëmurë në Drejtorinë e Punëve të Brendshme të qarkut të Gjirokastrës dhe të Durrësit, janë tipike dhe vërtetojnë në praktikë rrezikshmërinë e këtyre shfaqjeve, nga të cilat duhet të nxjerrim mësim për të mos lejuar që të përsëriten më.¹

Në Drejtorinë e Punëve të Brendshme të qarkut të Gjirokastrës janë vërejtur shfaqje të huaja si: karririzmi, pakënaqësia, ambicia dhe thashethemet te disa shokë drejtues ndaj drejtorit të punëve të brendshme të këtij qarku. Bisedat prapa krahëve dhe pakënaqësitë ndaj drejtorit u shtuan dhe duke i lidhur këto edhe me disa dobësi të tij, çuan në prishjen e harmonisë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit jo vetëm midis tyre dhe drejtorit, por edhe të familjeve të tyre. Tërë kjo

¹ Nga paragrafet e mëposhtme janë hequr emrat.

veprimtari jo në rrugë partie solli që puna të pengohej, urdhërat e drejtorit të diskutoheshin e autoriteti i tij të merrej nëpër këmbë në një rreth më të gjerë punonjësish të drejtorisë. Ata mbronin pikëpamjet e njëri-tjetrit në diskutimet, si brenda ashtu edhe jashtë organizatës bazë, kur dikush guxonte t'i kritikonte, qoftë edhe drejtori. Këta shokë shkuan edhe më larg, deri atje sa nuk e përfillën ndihmën e organizatës bazë, të komitetit të Partisë dhe të udhëheqjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme. Për të gjitha këto, ndaj tyre u morën masa.

Gjithashtu edhe në Drejtorinë e Punëve të Brendshme të qarkut të Durrësit dhe në shokët drejtues të Degës së Punëve të Brendshme të Peqinit dhe të Kavajës janë dukur shfaqje të një familjariteti të sëmurë dhe shfaqje të tjera të huaja, të papajtueshme me moralin tonë komunist. Këta shokë, duke e konsideruar veten se janë njerëzit që meritojnë më shumë në rrethin e tyre, ranë në kurthin e matrapazëve, hanin ryshfete, ngrinin shtëpi të mira, merrnin prodhime të disa dynymeve tokë që i punonin krahët e fshatarëve, merrnin stimulacione nga ta, blinin lopë e siguronin komoditete, duke shkarë kështu nga një gabim në tjetrin. Në këtë rrugë dallaveresh, gjithmonë duke shfrytëzuar pozitën që kishin, ata bënë falsifikime procesesh, lëshonin deklarata false për elementë vjedhës, dekonspironin sekretet e shtetit etj.

Për këto faje të rënda mban përgjegjësi drejtori i Drejtorisë së Punëve të Brendshme të qarkut të Durrësit, që nuk ka mbajtur qëndrim, por duke u treguar i butë dhe oportunist është pajtuar me servilizmin e

tyre, gjë që u la rrugë të lirë këtyre veprimeve të vazhdonin për disa kohë dhe të zmadhoheshin deri në atë shkallë. Nga ana tjetër zëvendës drejtori i çarkut, me qëndrimin e tij hipokrit para drejtorit, pa pikë vigjilence për këtë problem dhe me dinakëri, u përpoq ta shfrytëzojë këtë rast për qëllimet e tij karrieriste, në një kohë kur kjo çështje po zgjidhej nga Partia.

Si përfundim familjariteti i sëmurë, u prishi ndërgjegjen ose i kanosi t'ua prishte disa kuadrove të këtyre drejtorive vetëm për faktin pse nuk u bë kritika në kohën e duhur, vetëm për mungesë të vigjilencës së komunistëve e të organizatave bazë ku ata kanë bërë pjesë.

Natyrisht, për të gjitha gabimet e mësipërme janë marrë masa, por siç shihet, shokë, ky është një problem serioz dhe i rëndësishëm që duhet të kuptohet mirë nga të gjithë kuadrot e organeve të punëve të brendshme.

Partia e di mirë se vetëm masat administrative nuk i zgjidhin problemet, sidomos kur janë kaq të rëndësishme. Prandaj ka kërkuar dhe kërkon që të zhvillohen pa ndërprerje kritika dhe autokritika në organizatat bazë, të forcohet akoma më shumë roli i tyre në organet e punëve të brendshme, në mënyrë që të metat e gabimet të eliminohen qysh në lindje pa u bërë ato të rrezikshme.

Rastet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi të rëndë organizatat bazë ku kanë bërë pjesë këta shokë, sepse kanë lejuar që ata të shkojnë në këto gabime që kanë prekur interesat e shtetit dhe vijën e Partisë.

Për të gjitha këto që kanë ndodhur, mbajnë për-

gjegjësi edhe komitetet e Partisë të këtyre qarqeve e rretheve, sepse nuk kanë punuar sa duhet dhe si duhet me organizatat bazë të tyre, nuk i kanë ndihmuar e kontrolluar ato se si t'i kapnin e si t'i zgjidhnin problemet me kohë.

Kryesisht mban përgjegjësi udhëheqja e organeve të punëve të brendshme, e cila ka bërë lëshime të pajustificuara kundrejt shfaqjeve të konstatuara dhe kështu ka influencuar në përhapjen dhe përsëritjen e tyre. Drejtorja e kuadrit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në radhë të parë, duhet ta ketë parasysh mirë këtë, po ashtu edhe organet politike të ministrisë.

Duke ditur se shfaqje si këto ose të një natyre tjetër, janë dukur edhe në disa kuadro të tjerë të drejtorive të punëve të brendshme të qarqeve të tjera, si p.sh. në atë të qarkut të Tiranës ku kryetari i degës së rrethit të Krujës, ofendon dhe arreston për qëllime ambicieje dhe thjesht personale të plotfuqishmin e grumbullimeve të rrethit që gëzon dhe imunitet si anëtar i këshillit popullor të rrethit; ose në Drejtorinë e Punëve të Brendshme të qarkut të Beratit, ku janë përhapur shumë pakënaqësi kundër drejtorit të qarkut etj., del e nevojshme që nga analiza që duhet t'i bëjnë organizatat bazë të Partisë punës së tyre në këto organe të zbulohen dhe të goditen me kohë këto të meta e dobësi.

Po, për të bërë një analizë të plotë, organizatat bazë të Partisë duhet të ndihmohen më konkretisht dhe të kontrollohen nga ana e komiteteve të Partisë. Ato duhet të tërheqin vëmendjen më tepër në forcimin e edukimit ideo-politik dhe në zhvillimin sa më të gjerë të

kritikës dhe të autokritikës konstruktive, ta gjallërojnë dhe ta bëjnë më luftarake jetën e brendshme të organizatës bazë, të kërkojnë më tepër llogari për punën e secilit komunist, duke goditur me guxim dhe ashpërsi të metat të kujtdo qofshin, ashtu si na mëson Partia. Një qëndrim i tillë nuk na dobëson, por përkundrazi na forcon për punën tonë të ardhshme. Heshtja ndaj gabimeve e dobësive është oportuniste dhe e papajteshme me frymën dhe me vijën e Partisë.

Udhëheqja e organeve të punëve të brendshme në qendër, në qarqe e rrethe, duhet të ndihmojë dhe të kontrollojë më shumë vartësit dhe të kërkojë zbatimin sa më të përpiktë të detyrave që u janë ngarkuar. Të forcojë punën politike, të luftojë më me këmbëngulje që të rritet e të zhvillohet ndërgjegjia në punë dhe krenaria e kuadrove të punëve të brendshme në frymën e Partisë sonë.

Sot, kur përpara popullit tonë, Partia e qeveria kanë ngritur me forcë realizimin e planeve të shtetit për ndërtimin sa më të shpejtë të bazave të socializmit në vendin tonë, detyra të rëndësishme u ngarkohen edhe organeve të punëve të brendshme, kuadrove të saj të cilët duhet t'i shumëfishojnë energjitë e veta për arritjen dhe kalimin e vendit tonë nga fitorja në fitore.

Partia ka qenë dhe është e bindur se misioni që u është ngarkuar organeve të punëve të brendshme do të kryhet me sukses, sepse në gjirin e organizatave bazë të Partisë në këto organe, në udhëheqje e në bazë, mendojnë dhe punojnë shokë të sprovuar të Partisë sonë heroike, që janë kalitur në luftë dhe në përpjekje të përditshme të revolucionit tonë popullor. Ajo ka besim dhe shpreh bindjen e plotë se edhe ato do të bëjnë që

ekzistojnë akoma do të zhduken dhe aftësitë tuaja do të rriten e do të zhvillohen më tej, ashtu si e kërkojnë interesat e popullit, të atdheut dhe të Partisë sonë.

Partia edhe në të ardhshmen, si në qendër ashtu edhe në bazë, do t'u japë të gjitha ndihmat e saja organeve të punëve të brendshme, për t'i zhdukur të metat e gabimet që ekzistojnë e për ta kryer detyrën me nder.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA E MBAJTUR NË KONSULTËN E
PËRFAQËSUESVE TË PARTIVE KOMUNISTE
DHE PUNËTORE TË VENDEVE SOCIALISTE
TË EVROPËS MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK
DHE KOORDINIMIN E PLANEVE**

7 janar 1956

Shokë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë e pritën me kënaqësi të madhe propozimin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për të mbajtur këtë mbledhje¹ të rëndësishme. Është hera e parë që bëhet një mbledhje e tillë. Kjo mbledhje ka rëndësi shumë të madhe për të gjithë kampin tonë socialist dhe pa dyshim që do të ketë si rezultat forcimin akoma më shumë të lidhjeve të ngushta e të sigjerta dhe të marrëdhënieve socialiste që ekzistojnë midis vendeve tona. Ne falenderojmë me gjithë zemër dhe me mirënjohje Bashkimin Sovjetik në radhë të parë dhe vendet e demokracisë popullore për ndihmën që i

¹ Mbledhja u mbajt në Moskë prej 6 deri 10 janar 1956.

kanë dhënë popullit tonë për ndërtimin e bazave të socializmit.

Ne e mbaruam pesëvjeçarin e parë. Kushtet në të cilat ne kemi punuar në pesëvjeçarin e parë kanë qenë shumë të rënda. Kuadrot tanë nuk kishin eksperiencë, populli ynë detyrohej që nga njëra anë të ndërtonte e të prodhonte dhe nga ana tjetër të mbrohej, meqë është i rrethuar nga shtete kapitaliste. Dhe në hartimin e planit të parë pesëvjeçar ne kemi pasur gabime ngaqë parashikimet tona nuk kanë qenë thellësisht të studjuara dhe të bazuara mbi mundësitë reale të vendit tonë. Këto gabime ne i kemi ndrequr gjatë realizimit të planit të parë pesëvjeçar.

Në vitin 1955, prodhimi i përgjithshëm industrial është 330 për qind në krahasim me vitin 1950, ose 12 herë më i madh se në vitin 1938. Gjatë pesëvjeçarit të parë 1951-1955, prodhimi i përgjithshëm industrial është rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 27 për qind; prodhimi i mjeteve të prodhimit është rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 29,5 për qind dhe prodhimi i mallrave të konsumit është rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 25,5 për qind. Pesa specifike e prodhimit të mjeteve të prodhimit është 39 për qind mbi prodhimin e përgjithshëm industrial.

Sipërfaqja e mbjellë në vitin 1955 ka arritur në 375 000 ha. ose 13,4 për qind më shumë se në vitin 1950 dhe gati 70 për qind më shumë se në vitin 1938. Prodhimi i drithërave të bukës në vitin 1955 është rreth 50 për qind më shumë se në vitin 1950 ose 63 për qind më shumë se në vitin 1938. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në vitin 1955 është 40 për qind më i madh se

në vitin 1950. Kjo do të thotë që në pesëvjeçarin e parë rritja mesatare vjetore e prodhimit bujqësor ka qenë 7 për qind.

Qarkullimi i mallrave në tregëtinë socialiste në vitin 1955 është 200 për qind kundrejt vitit 1950. Në sektorin e arësimit dhe të kulturës janë arritur rezultate të rëndësishme.

Numri i punëtorëve në vitin 1955 është 82 për qind më i madh se në vitin 1950 dhe numri i punëtorëve të kualifikuar dy herë më i madh. Në vitin 1955 rendimenti i punës është më i madh se në vitin 1950 në këtë masë: në industrinë e naftës 57 për qind, në industrinë e qymyr gurit 46 për qind, në industrinë ushqimore 69 për qind, në industrinë e lehtë 14 për qind dhe në industrinë elektrike 51 për qind.

Gjatë pesëvjeçarit të parë popullsia është shtuar mesatarisht çdo vit në masën 28 për mijë¹.

Me gjithë sukseset e arritura deri sot, ne duhet të themi se gjendja ekonomike e Republikës Popullore të Shqipërisë është akoma mjaft e vështirë.

Së pari, ne nuk kemi mundur të nxjerrim nga prapambetja bujqësinë. Nga 170 000 ekonomi bujqësore individuale që ka Shqipëria, rreth 50 000 prej tyre nuk kanë asnjë kafshë pune për tërheqje. Ne nuk prodhojmë plehra kimike dhe importimi i tyre ka qenë shumë i kufizuar. Gjithashtu, në pesëvjeçarin e parë numri i

¹ Shifrat që jepen për rezultatet e arritura në pesëvjeçarin e parë (1951-1955) janë parashikim i pritshëm, prandaj kanë disa ndryshime nga ato që janë dhënë më vonë si realizim në fakt.

traktorëve ka qenë shumë i kufizuar, kanë munguar farëra të cilësisë së lartë, rendimenti i kulturave bujqësore dhe prodhimtaria e blegtorisë kanë qenë mjaft të ulëta. Gjatë pesëvjeçarit të parë bujqësia jonë është dëmtuar rëndë nga thatësitrat e shumta. Prapambetja e bujqësisë është bërë pengesë kryesore në zhvillimin me ritëm të shpejtë të industrisë dhe në përmirësimin e gjendjes materiale të popullit. Prandaj, në pesëvjeçarin e dytë 1956-1960, ne i kemi vënë si detyrë kryesore vetes të nxjerrim bujqësinë nga prapambetja, me anën e zgjerimit të kolektivizimit të saj, duke zgjeruar mekanizimin e bujqësisë, duke bërë punime të mëdha bonifikimi, duke shtuar sipërfaqet e mbjella etj.

Së dyti, si rrjedhim i prapambetjes së bujqësisë dhe të disproporcionit të madh që ekziston midis ritmit të zhvillimit të industrisë dhe ritmit të zhvillimit të bujqësisë, gjatë pesëvjeçarit të parë ne kemi importuar prodhime bujqësore si drithëra buke, oriz, yndyrna, fasule, pambuk etj., me një vlerë prej rreth 95 milion rubla¹, që është baraz me 40 për qind të të gjithë eksportit të vendit tonë gjatë pesëvjeçarit të parë. Prandaj, në pesëvjeçarin e dytë ne i kemi vënë si detyrë kryesore vetes që ta prodhojmë bukën në vend dhe të shtojmë prodhimin e bimëve industriale për të përballuar nevojat e industrisë me lëndë të para dhe për të shtuar eksportin. Gjithashtu, në pesëvjeçarin e dytë ne i kemi shtruar si detyrë vetes që të përmirësojmë bazën ushqji-

¹ Një rubël e sotme është e barabartë me 4,44 rubla të vitit 1956, ose 100 rubla të sotme janë të barabarta me 444 rubla të vitit 1956.

more të blegtorisë, të përmirësojmë racën e saj, të zhvillojmë frutikulturën, sidomos agrumet dhe ullinjtë, të zhvillojmë kulturat industriale, sidomos duhanin, pambukun e panxharin e sheqerit.

Së treti, industria jonë është varur dhe do të varet edhe për disa kohë në të ardhshmen nga importi i materialeve dhe i lëndëve të para si hekur, alumin, kimikate, vegla këmbimi, goma, karburante etj., të cilat nuk mund të sigurohen në vend. Me gjithë përpjekjet tona të derisotme ne nuk kemi mundur akoma që të sigurojmë një rezervë minimale për këto mallra dhe materiale të importit, që i nevojiten ekonomisë sonë popullore. Përveç kësaj, mosardhja kurdoherë në kohë e materialeve të importit ka penguar realizimin ritmik të planit.

Së katërti, gjendja ekonomike e vështirë nuk na ka lejuar deri sot që të heqim sistemin e triskëtimit në furnizimin e popullit. Me gjithë sukseset e rëndësishme që ne kemi arritur në përmirësimin e gjendjes materiale të popullit, këto suksese janë mjaft relative. Kështu p.sh., në vitin 1955 popullsia e vendit tonë është furnizuar mesatarisht për çdo frymë në këtë masë: sheqer 4,9 kg., sapun 1,6 kg., tekstile të leshta 0,45 metra, tekstile të pambukta 8,3 metra dhe këpucë e opinga 0,6 palë. Në vjetët e mëparshëm, furnizimi ka qenë edhe më i ulët.

Komiteti Qendror i PPSH dhe qeveria morën vendim për të hequr triskat e artikujve industrialë që nga fillimi i këtij muaji. Për të hequr triskat e veshmbathjes ne kemi marrë masa të rëndësishme për të shkurtuar sa më shumë shpenzimet administrative dhe joprodhues-

se, për të formuar kështu rezervat minimale prej 3-6 muajsh në mallrat e konsumit. Në këto masa hyjnë: shkurtimi i organikave të aparateve administrative, shkurtimi i organikave të organeve ekonomike, shkurtimi i forcave të armatosura në masën 9 mijë vetë, zëvendësimi i tregut reciprok me sistemin e kontraktimit, ulja e çmimit të blerjes nga shteti të drithërave në treg të lirë, ulja e stimulacionit të kulturave industriale, rritja e tarifave të transportit, kinemave dhe teatrit, heqja e triskave të ushqimit për disa kategori njerëzish që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin etj.

Masat që kemi marrë për kursimet, janë maksimalja e asaj që mund të bëhet sot dhe këto masa arrijnë një vlerë prej më tepër se 2 miliard lekë në vit, kurse buxheti i shtetit në vitin 1955 ka qenë rreth 11 miliard lekë. Këto kursime, që bën shteti, rëndojnë pak më shumë se gjysma mbi klasën punëtore dhe pjesa tjetër mbi fshatarësinë. Në vitin 1956 ne parashikojmë të bëjmë një ulje çmimesh.

Me gjithë shkurtimet që ne kemi bërë në aparatet administrative, raporti midis numrit të punëtorëve të prodhimit, personelit arësitor, të shëndetësisë e personelit të shërbimeve nga një anë dhe numrit të punonjësve të aparateve administrative joprodhuese nga ana tjetër është 6 : 1, d.m.th. në 7 vetë që janë në marrëdhënie pune me shtetin, 1 prej tyre është joprodhues. Kjo gjendje e rëndon shumë shtetin. Por tani për tani shkurtimi i mëtejshëm i aparateve administrative është gati i pamundshëm.

Së pesti, ne nuk kemi mundur që të heqim triskat edhe në prodhimet ushqimore sepse nuk i kemi siguruar

akoma rezervat shtetërore në drithëra buke; po ashtu edhe rezervat e domosdoshme në prodhimet e tjera ushqimore. Kështu mbetja në fuqi e sistemit të triskëtimit për prodhimet ushqimore vështirëson gjendjen ekonomike të popullit tonë, i cili po jeton me sistemin e triskëtimit që nga viti 1941, që në kohën e okupacionit italian. Prandaj këtë sistem ne duhet ta heqim që në vitet e para të planit të dytë pesëvjeçar.

Për të hequr sistemin e triskëtimit në artikujt ushqimorë, ne do të na duhej të importonim mbi atë që është planifikuar të importohet në vitin 1956, edhe rreth 50 mijë ton drithëra buke, rreth 3 mijë ton yndyrna etj. që arrijnë pothuajse 25 milion rubla.

Sadoqë nuk kemi të dhëna të sakta, por duke u mbështetur në ato që ne dimë, niveli i jetesës së popullit tonë është shumë më i ulët se niveli i jetesës së vendeve te demokracisë popullore.

Së gjashti, detyrimet e vendit tonë ndaj vendeve miq janë të mëdha. Ne kemi marrë deri sot nga Bashkimi Sovjetik, Çekosllovakia, Polonia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Republika Demokratike Gjermane dhe Republika Popullore e Kinës shumë kredi, të cilat, në bazë të marrëveshjeve ekzistuese, duhet të shlyhen deri në vitin 1980.

Perspektiva e shlyerjes së këtyre detyrimeve është e rëndë për ne. Këto detyrime ne do të fillojmë t'i shlyejmë kryesisht që nga viti 1959. Për të respektuar marrëveshjet ekzistuese në shlyerjen e detyrimeve tona kundrejt vendeve miq që na kanë dhënë kredi, vendi ynë është i detyruar të qëndrojë, të paktën deri në vitin 1980, në një nivel jetese të ulët dhe nuk do të jetë në

gjendje të sigurojë ritmin normal të zhvillimit të ekonomisë popullore, po qe se nuk do t'i jepen kredi të reja.

Së shtati, gjendja ekonomike e vështirë deri sot na ka detyruar që rreth 44 për qind të vëllimit të kredive për pesëvjeçarin e parë t'i përdorim për importimin e mallrave të konsumit të gjerë, të lëndëve të para, të metaleve, të karburanteve, të drithërave të bukës etj. Por ne kemi qenë të detyruar të vepronim kështu për shkak të gjendjes ekonomike të vështirë në të cilën jemi ndodhur dhe për shkak të pamundësisë që të siguronim importimin e këtyre mallrave me anën e eksportit tonë.

Për pesëvjeçarin e dytë ne do të marrim të gjitha masat që të kufizojmë në maksimum përdorimin e kredive për blerjen e mallrave që nuk janë investime. Por megjithatë, do të jetë e domosdoshme për ne që me kreditë e reja të importojmë edhe materiale e lëndë të para, pjesë këmbimi, goma dhe karburante, që janë të nevojshme për ekonominë tonë popullore dhe që ne nuk i sigurojmë dot as me prodhimin e vendit dhe as me anën e eksportit.



Shokë,

Ne theksuam këtu përpjekjet e popullit tonë dhe vështirësitë ekonomike të vendit tonë, me qëllim që t'ju informojmë ju më qartë mbi gjendjen tonë, me qëllim

që ju të jeni më në gjendje të vlerësoni mundësitë tona. Partia, qeveria dhe populli ynë janë plotësisht të vendosur që t'i kapërcejnë të gjitha vështirësitë dhe t'i realizojnë me nder të gjitha detyrat që i kanë vënë vetes përpara si dhe të gjitha detyrimet ndaj miqve.

Në pesëvjeçarin e dytë 1956-1960 detyra jonë kryesore në lëmin e prodhimit industrial ka për të qenë përvetësimi i teknikës dhe i teknologjisë së prodhimit, shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimi i cilësisë së prodhimit, krahas me këto edhe zhvillimi i mëtejshëm sasior i prodhimit industrial. Në lëmin e prodhimit bujqësor, detyra jonë kryesore në pesëvjeçarin e dytë ka për të qenë nxjerrja e bujqësisë nga prapambetja, me qëllim që të sigurohet buka në vend, të sigurohet industria me lëndë të parë, të sigurohet furnizimi normal i popullit me prodhime bujqësore dhe të shtohet eksporti.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë 1956-1960¹, prodhimi i përgjithshëm industrial do të rritet 58 për qind kundrejt vitit 1955 dhe mesatarisht çdo vit — 9,6 për qind, nga i cili prodhimi i mjeteve të prodhimit do të rritet mesatarisht çdo vit 10,7 për qind dhe prodhimi i mallrave të konsumit do të rritet mesatarisht çdo vit 9 për qind. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në vitin 1960 do të rritet 45 për qind kundrejt vitit 1955.

Në pesëvjeçarin e dytë prodhimi i naftës do të rri-

¹ Detyrat që parashikohen në shifra ose përqindje për pesëvjeçarin e dytë (1956-1960) janë paraprake, ato kanë ndryshime me detyrat dhe shifrat që aprovoi Kongresi III i PPSH.

tet 43 për qind, prodhimi i bitumit fluksat — 283 për qind, prodhimi i qymyr gurit — 67 për qind, prodhimi i mineralit të kromit — 50 për qind, prodhimi i mineralit të bakrit — 61 për qind, prodhimi i energjisë elektrike — 60 për qind, sipërfaqja nën kulturë — 12 për qind, prodhimi i drithërave të bukës — 31 për qind, i orizit — 36 për qind, i pambukut — 80 për qind, i duhanit — 28 për qind, kapaciteti i SMT-ve do të rritet 70 për qind etj.

Në pesëvjeçarin e dytë investimet do të jenë 12 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë dhe nga këto investimet për industrinë do të kenë peshën specifike 38 për qind mbi të gjitha investimet, kurse për bujqësinë 21 për qind mbi të gjitha investimet, ndërsa në pesëvjeçarin e parë industria ka pasur 50 për qind të të gjitha investimeve dhe bujqësia 16 për qind të të gjitha investimeve. Në këtë mënyrë, në pesëvjeçarin e dytë investimet në bujqësi rriten 44 për qind. Një ndarje e tillë e investimeve do të bëjë që bujqësia të zhvillohet me ritëm më të shpejtë se deri sot, pa penguar zhvillimin normal të industrisë.

Nga investimet që do të bëhen për industrinë në pesëvjeçarin e dytë, industria e rëndë do të ketë rreth 31 për qind dhe industria e lehtë rreth 7 për qind të të gjitha investimeve si Republikë.

Në pesëvjeçarin e dytë qarkullimi i mallrave të tregëtisë do të rritet 36 për qind, fuqia blerëse e popullsisë — rreth 34 për qind, fondi i pagave — 25 për qind dhe numri i punonjësve — 11 për qind. Rendimenti i punës në pesëvjeçarin e dytë do të rritet 52 për qind në industri, 45 për qind në ndërtim, 25 për qind në transportin

automobilistik, 40 për qind në artizanat etj. Kostoja do të ulet 18 për qind në prodhimin e industrisë kombëtare, 25 për qind në prodhimin e industrisë lokale, 25 për qind në prodhimin e artizanatit, 18 për qind në SMT-të, 20 për qind në sektorin shtetëror të bujqësisë, 15 për qind në organizatat e kooperativave të konsumit dhe 15 për qind në transport.

Në pesëvjeçarin e dytë vëllimi i eksportit do të jetë 73 për qind më i madh, kurse vëllimi i importit do të jetë 10 për qind më pak se në pesëvjeçarin e parë. Për të përballuar nevojat në import dhe në investime të pesëvjeçarit të dytë, ne do të na duhej një kredi e re nga vendet miq prej rreth 250 milion rublash, e cila të përdorej për investime të reja, gjithashtu edhe për materiale e lëndë të parë deficitare, vegla këmbimi, goma e karburante. Kredia nuk do të përdoret për të blerë mallra të gatshme të konsumit të gjerë. Këto kredi ne do të na duhen për të siguruar planin e dytë pesëvjeçar, por pa përfshirë në këtë plan nevojat për kredi për zgjerimin e kërkimeve gjeologjike, për vënien në shfrytëzim të vendburimeve të mineralit të hekur-nikelit, për ngritjen e një fabrike për plehra kimike azotike, për zgjerimin e rrjetit hekurudhor dhe për shtimin e prodhimit të çimentos, sepse këto çështje nuk i kemi përfunduar së studjuari; kur të përfundojmë studimin e tyre mund të vendosim ndoshta për të shtuar planin e dytë pesëvjeçar në këto drejtime dhe, si rrjedhim, do të na duhet të kërkojmë kredi të veçanta për këto objekte, përveç atyre që përmendëm më sipër.



Disa çështje të tjera.

1. — *Mbi sigurimin e ekonomisë popullore me metale të zeza.* Ne nuk prodhojmë metale të zeza. Nevojat tona për metale të zeza në pesëvjeçarin e dytë do të jenë rreth 110 mijë ton ose rreth 63 milion rubla. Këto mendojmë t'i sigurojmë nga vendet e kampit tonë me kredi dhe klering.

2. — *Mbi metalet me ngjyra.* Nga metalet me ngjyra, vendi ynë sot prodhon vetëm bakër blister, prodhimi i të cilit në vitin 1955 ka qenë 960 ton. Në vitin 1956 ne do të hapim një vendburim të ri të mineralit të bakrit e në fund të pesëvjeçarit të dytë prodhimi i këtij minerali do të jetë 61 për qind dhe prodhimi i bakrit blister do të jetë rreth 25 për qind më i madh se në vitin 1955. Të gjithë bakrin blister ne e eksportojmë në vendet e kampit tonë. Në pesëvjeçarin e dytë ne mendojmë të gjejmë të paktën edhe një vendburim tjetër të mineralit të bakrit. Për zgjerimin e kërkimeve gjeologjike të këtij minerali ne kemi kërkuar ndihmën e qeverisë sovjetike.

Metale të tjera me ngjyra ne nuk prodhojmë. Nevojat tona për metale me ngjyra në pesëvjeçarin e dytë janë rreth 3 mijë ton ose rreth 9 milion rubla. Këto mendojmë t'i sigurojmë në vendet e kampit tonë me kredi dhe klering.

Në vendin tonë ka mineral të hekur-nikelit. Gjatë pesëvjeçarit të dytë, në bashkëpunim dhe me ndihmën e Republikës Çekosllloake ne do të bëjmë të gjitha

punimet përgatitore dhe do të fillojmë nxjerrjen e mineralit të hekur-nikelit. Mineralin e hekur-nikelit do ta eksportojmë në Çekoslovakia dhe në vendet e tjera të kampit tonë.

Në vendin tonë janë diktuar shënjat e boksitit. Në pesëvjeçarin e dytë ne do të bëjmë kërkime gjeologjike për boksitet dhe për këtë na ka premtuar të na ndihmojë Qeveria e Republikës Popullore të Hungarisë.

3. — *Mbi zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së qymyr gurit.* Ne sot kemi tri miniera qymyr guri. Në vitin 1955 prodhimi i qymyr gurit arriti në 198 mijë ton dhe në fund të pesëvjeçarit të dytë do të arrijë në 300 mijë ton. Për të shtuar rezervat industriale të qymyrit ne kemi kërkuar ndihmën e Qeverisë së Republikës Popullore të Polonisë për zgjerimin e kërkimeve gjeologjike në pesëvjeçarin e dytë.

4. — *Mbi zhvillimin e industrisë së naftës.* Sot ne kemi dy vendburime për nxjerrjen e naftës. Në vitin 1955 prodhimi i naftës brut arriti në 210 mijë ton dhe në vitin 1960 do të jetë 300 mijë ton. Nga rezervat industriale të njohura deri sot, këto dy vendburime sigurojnë nxjerrjen e naftës me leverdi ekonomike për industrinë tonë të përpunimit deri në vitin 1960. Kemi kërkuar ndihmën e qeverisë sovjetike për të zgjeruar kërkimet gjeologjike gjatë pesëvjeçarit të dytë për të shtuar rezervat industriale të naftës.

Në vitin 1956 futet në prodhim rafineria e re e naftës, e cila do të përpunojë rreth 170 mijë ton naftë në vit. Megjithatë, edhe me vënien në përdorim të rafinerisë së re të naftës, ne do të na duhet të importojmë në pesëvjeçarin e dytë rreth 1/3 e sasisë së përgjithshme

të benzinës dhe gazoilin për konsumim të brendshëm, si edhe të gjithë vajgurin ndriçues, për arsye se rafineria e re nuk përballon dot të gjitha nevojat e vendit me karburante.

5. — *Mbi zgjerimin e kërkimeve gjeologjike.* Ne sot kemi vendburime aktive të naftës, qymyr gurit, kromit, bakrit dhe bitumit natyral. Gjithashtu kemi diktuar se kemi mineral të hekur-nikelit me shumicë dhe të cilësisë së lartë, boksit, magnezit, kaolinë, sqfur, gips, kobalt etj. Të dhënat që ne disponojmë na bëjnë të besojmë se nëntoka jonë është e pasur dhe po ta zhvillojmë industrinë minerare me ritëm të shpejtë, ajo në vitet e ardhshme, pas pesëvjeçarit të dytë, mund të bëhet dega kryesore në ekonominë popullore dhe të luajë rolin vendimtar për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha degëve të tjera të ekonomisë sonë popullore.

Ne mendojmë se pasuria e nëntokës sonë, mineralet që janë gjetur dhe që mund të gjenden në vendin tonë, kanë rëndësi jo vetëm për Republikën Popullore të Shqipërisë, por edhe për vendet e tjera të kampit socialist. Ne mendojmë se do të ishte më e leverdisshme për kampin tonë që të investojë për të shfrytëzuar në radhë të parë të gjitha rezervat e brendshme të kampit e të importojë nga vendet kapitaliste vetëm ato lëndë të para që nuk gjenden brenda përbrenda kampit tonë, se sa të importohen nga vendet kapitaliste lëndë të para, të cilat gjenden në vendet tona, por që nuk shfrytëzohen. Në nëntokën e Shqipërisë fshihen sasi të konsiderueshme lëndësh të para shumë të vlefshme për industrinë e kampit tonë. Prandaj, ne lutemi që të na ndihmoni në

zgjerimin e kërkimeve gjeologjike dhe në zhvillimin me ritëm të shpejtë të industrisë së minierave të vendit tonë, sepse kjo është në interes si të ekonomisë popullore të Shqipërisë, ashtu edhe në interes të të gjithë kampit socialist.

6. — *Mbi bilancin e lëndëve të para të industrisë së lehtë.* Në pesëvjeçarin e dytë, me masat që do të marrim, ne do të shpejtojmë ritmin e zhvillimit të bujqësisë, që do të ketë si rrjedhim sigurimin e industrisë sonë të lehtë me lëndë të para të prodhimit të vendit dhe njëkohësisht shtimin e eksportit të disa prodhimeve bujqësore, si duhan, agrume etj. Në pesëvjeçarin e dytë ne parashikojmë një sërë masash për mekanizimin e artizanatit dhe për forcimin e industrisë së lehtë. Në pesëvjeçarin e dytë ne do të kemi nevojë për të importuar lëndë të para për industrinë tonë të lehtë, si p.sh. kauçuk, lëkurë për këpucë etj., me një vlerë prej rreth 12 milion rublash.

7. — *Mbi mundësitë e prodhimit të drithërave të bukës në vend.* Në vitin 1955 ne prodhuam rreth 300 mijë ton drithëra buke. Në vitin 1960 ne parashikojmë të prodhojmë rreth 400 mijë ton drithëra buke, në këtë mënyrë do të sigurohet buka në vend, fara dhe pjesërisht një sasi drithi për ushqimin e kafshëve. Gjatë pesëvjeçarit të dytë ne mendojmë ta mbarojmë kolektivizimin e tokave fushore, të cilat përbëjnë rreth gjysmën e sipërfaqeve të mbjella të Republikës. Kolektivizimi i tokave fushore sot është në masën 20 për qind të sipërfaqes së mbjellë dhe 18 për qind të numrit të ekonomive bujqësore në tokat fushore. Gjatë pesëvjeçarit të dytë ne mendojmë ta rritim fuqinë e mekanikës bujqë-

sore nga 1 500 traktorë (15 kuaj-fuqi), në rreth 2 600 traktorë (15 kuaj-fuqi), ta kryejmë sistemimin agrar të të gjitha tokave fushore si edhe bonifikimin e fushës sonë kryesore prej 35 mijë ha. Njëkohësisht do të marrim edhe masa të tjera plotësuese, si seleksionimin e farës, rritjen e sipërfaqes së plehruar etj.

8. — *Mbi nevojën e prodhimit të plehrave kimike në vend.* Ne nuk prodhojmë sot plehra kimike, por ne kemi shumë nevojë për ato. Për të gjetur bazën minerale për plehra kimike dhe për të bërë kërkimet gjeologjike në këtë drejtim ne kemi kërkuar ndihmën e Republikës Demokratike Gjermane. Ne do t'i luteshim Qeverisë së Republikës Demokratike Gjermane që të studjojmë bashkërisht mundësitë e ngritjes së një fabrike të plehrave azotike në Shqipëri si edhe mundësitë e ndihmës materiale nga ana e Republikës Demokratike Gjermane, në rast se ngritja e një fabrike të tillë do të jetë e mundshme dhe rentabël.

9. — *Mbi transportimin e mallrave për në Shqipëri dhe nga Shqipëria.* Vëllimi i transportit të mallrave të eksport-importit tonë llogaritet në rreth 500 mijë ton, nga i cili 200 mijë ton import.

Me gjithë ekzistencën e marrëveshjeve përkatëse, transportimi i këtyre mallrave bëhet me ngadalësi, gjë që ka influencuar negativisht në realizimin ritmik të planit. Shpeshherë mallrat tona qëndrojnë nëpër porte për një kohë të gjatë, sidomos në portet e Detit të Zi.

Lutemi të rishqyrtohet nga organet kompetente të vendeve miq transportimi ritmik dhe me precedencë i mallrave për në Shqipëri, pasi ekonomia jonë, siç dihet, varet shumë nga importi.



Shokë,

Ne ju sigurojmë se do të vëmë të gjitha forcat tona për të përmirësuar metodën e drejtimit të ekonomisë, për të përfituar sa më shumë nga eksperiencia e çmueshme e vendeve tuaja, do të vëmë të gjitha forcat për t'i realizuar me sukses detyrat e planit të dytë pesëvjeçar, për t'i kapërcyer vështirësitë dhe për t'i likuiduar të metat që kemi. Ne do të qëndrojmë kurdoherë besnikë të rrugës sonë marksiste-leniniste. Ne do të vëmë të gjitha forcat për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm të ekonomisë sonë popullore dhe për të përmirësuar nivelin material e kultural të popullit tonë. Ne jemi të sigurtë se ju do t'i shqyrtoni propozimet tona me vëmendje të madhe dhe do t'u jepni atyre zgjidhjen më të drejtë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE PËRMIRËSOJMË UDIHËHEQJEN E PARTISË NË SEKTORIN SHETËTOR BUIQËSOR

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

3 shkurt 1956

Autokritika që dëgjuam nga sekretarët e komiteve të Partisë të rretheve të Vlorës e të Fierit nuk është konstruktive. Gjendja në NBSH-të dhe në SMT-të e këtyre rretheve është e dobët. Si pasojë shembulli i tyre ndaj fshatarësisë së kooperuar dhe individuale nuk është në lartësinë e duhur. Rendimentet e NBSH-ve në kulturat bujqësore dhe në frutikulturë kanë qenë më të ulëta nga mesatarja e rendimenteve të arritura prej fshatarësisë. Është krijuar kështu një deficit i madh në fondin e shtetit. Kush e mban përgjegjësinë për këtë gjendje të pakënaqshme? Kjo përgjegjësi bie në radhë

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua rreth raportit të paraqitur nga ekipi i aparatit të KQ «Mbi gjendjen e SMT-ve dhe NBSH-ve në ish-qarkun e Vlorës».

të parë mbi organizatat e Partisë, që nuk kanë kapur çështjet kryesore ekonomike të ndërmarrjeve, nuk kanë ushtruar si duhet të drejtën e kontrollit mbi administratën, veçanërisht për organizimin e brendshëm të punës. Komitetet e Partisë të rretheve Vlorë e Fier nuk kanë organizuar si duhet zbatimin e vendimeve të Partisë e të qeverisë për SMT-të e NBSH-të, kanë lejuar që të metat të përsëriten vazhdimisht dhe nuk kanë ditur të përfitojnë nga ndihma e aparatit të Komitetit Qendror dhe ekipeve që janë dërguar prej tij. Veç kësaj, komitetet e Partisë të këtyre rretheve kanë lejuar qëndrimin indiferent të komiteteve ekzekutive për SMT-të dhe sidomos për NBSH-të.

Ndihma e dhënë nëpërmjet ekipeve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë nuk është e mjaftë në rast se nuk merren masa për të organizuar punën në praktikë për përmirësimin e gjendjes. Ndryshe direktivat dhe udhëzimet e Partisë mbeten pa u zbatuar. Prandaj, kur aparati i KQ kontrollon dhe ndihmon me anën e një ekipi, duhet që vetë sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit të mendojë se si ta organizojë punën e si ta ndjekë zbatimin e detyrave. I tërë komiteti i Partisë duhet të mobilizohet, që të ndjekë e të udhëheqë zbatimin e të gjitha vendimeve të Komitetit Qendror dhe të qeverisë. Organet e Partisë e të pushtetit në rreth janë në dijeni të vendimeve të Komitetit Qendror dhe të qeverisë, prandaj ato nuk duhet të presin udhëzimet nga aparatet e Komitetit Qendror apo të qeverisë për të vepruar. Përkundrazi, të punohet me inisiativë e përgjegjësi dhe të luftohet deri në fund për zbatimin e direktivave. Në këtë proces, komiteti i Partisë, kur vë re

se të tjerët nuk bëjnë detyrën, ta zëmë Ministria e Bujqësisë, bisedon me ministrin dhe e shpie problemin deri në Komitetin Qendror. Problemet zgjidhen me luftë në bazë e në qendër. Prandaj, të nxiten edhe ministrat që të zbatohen detyrat e ngarkuara. Kur e lyp nevoja të merren edhe masa në interes të punës.

Puna në SMT-të dhe NBSH-të do të vejë mirë në rast se ne, udhëheqësit, drejtuesit dhe punëtorët e aparateve të Partisë marrim kontakt me traktoristët dhe punonjësit e tjerë, që kanë eksperiencë, dëgjojmë zërin e tyre dhe mësojmë nga ata. Eksperiencën e bazës ne duhet ta marrim dhe ta përhapim. Nuk duhet të jemi të përciptë në drejtim, por të thellë, konkretë dhe njerëz praktikë. Të tillë mund të bëhemi në qoftë se nuk shkëputemi nga masat, nga puna dhe jeta e tyre. Prandaj të vemë në bazë me plan, ta mësojmë atë dhe të mësojmë prej saj.

Në këtë frymë duhet të punohet nga Partia edhe për kolektivizimin e mëtejshëm të bujqësisë, ku SMT-të dhe NBSH-të, kanë një rol të veçantë. Kontaktet tona në SMT-të dhe në NBSH-të nuk duhet të jenë vetëm me sekretarin e organizatës bazë dhe me kryetarin e këshillit popullor atje, por me masën, me fshatarësinë. Pa e bërë këtë punë, edhe fjala e tyre nuk do të zërë vend si duhet. Metodën e konsultimit me masat duhet ta përdorë në radhë të parë komiteti i Partisë, sekretarët e tij, të cilët, kur venë në bazë, të mbajnë kontakt jo vetëm me udhëheqjen, por edhe me organizatën bazë, me kolektivin.

Duke punuar kështu, do të forcohet udhëheqja e Partisë edhe në sektorin shtetëror bujqësor në Vlorë e

në Fier. Në këtë drejtim Ministria e Bujqësisë duhet të futet më thellë dhe të ndihmojë më tepër sidomos në çështjet e organizimit dhe të drejtimit konkret të punës. Punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë kur shkojnë në bazë, ta ndihmojnë më konkretisht atë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

LETËR MBI DISA PROBLEME TË KUADRIT

7 shkurt 1956

GJITHË ORGANIZATAVE BAZË TË PARTISË

Nga shqyrtimi i herëpashershëm që i është bërë punës së kuadrit si në qendër, qarqe e rrethe, ashtu edhe në seminarin që u organizua në aparatën e Komitetit Qendror të PPSH më 20 janar 1956, rezulton se me gjithë përmirësimet që janë bërë, në punën me kuadrin vihen re edhe të meta.

Me anën e kësaj letre duam të tërheqim vëmendjen e organizatave të Partisë dhe të komiteteve të Partisë mbi disa probleme të rëndësishme në punën e Partisë me kuadrin.

1. — Akoma disa organizata dhe organe të Partisë nuk po e kuptojnë sa duhet përgjegjësinë e plotë që kanë për kuadrin. Nuk zbatohet gjithnjë drejt parimi marksist-leninist i zgjedhjes dhe i vendosjes së kuadrit në bazë të besimit politik dhe të aftësive në punë. Disa organe shtetërore bëjnë lëvizje kuadri pa marrë më parë dhe mendimin e Partisë siç ka vepruar Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe organizatat e Partisë

kanë heshtur. Duhet të kuptohet një herë e mirë ajo që ka thënë Komiteti Qendror se Partia ka përgjegjësinë kryesore në punën e kuadrit dhe se pavarësisht nga nomenklatura, organet shtetërore për çdo lëvizje që mendojnë të bëjnë duhet gjithnjë, para se të vendosin, të marrin mendimin e Partisë.

Eksperienca e deritanishme ka treguar se atje ku shkelen udhëzimet e Partisë, ku mungon vigjilencia dhe kontrolli i Partisë, atje bëhen gabime. Merren njerëz të padëshirueshëm e armiq në punë si në Durrës, në Elbasan e gjetkë, vendosen njerëz pa dokumenta siç kanë vepruar Shkodra, Durrësi, Saranda etj. Këto gabime i kanë kushtuar rëndë Partisë, shtetit dhe popullit. Organizatat dhe komitetet e Partisë duhet të ndalen para këtyre gjërave e jo t'i kalojnë lehtë dhe të marrin masa ndaj atyre që i bëjnë, pa marrë parasysh postin. Prandaj të respektohen pikë për pikë udhëzimet që ka dhënë Partia.

Shpesh dëgjojen ankime se nuk ka kuadro, por detyra e organeve dhe e organizatave të Partisë nuk është të ankohen, por t'i gjejnë kuadrot e t'i përgatitin ata me kujdes. Në sistemin tonë shoqëror ku marrin pjesë gjithë masat punonjëse në administrimin e shtetit dhe në luftën për ndërtimin e socializmit, ku janë dhënë të gjitha mundësitë për zhvillimin e inisiativës krijuese, ka me qindra e mijëra njerëz që mund të drejtojnë sektorë të ndryshëm pune. Por kjo s'mund të arrihet në mënyrë spontane e burokratike. Në qoftë se ka një punë që s'mund ta durojë burokratizmin është pikërisht puna me njerëzit. Shpesh vihet vërdallë rreth një numri të kufizuar njerëzish dhe këta lëvizin sa andej-këtej. Kur

duan t'i ngrënë u bëjnë karakteristika të mira dhe kur duan t'i ulin ua nxijnë fare. Njerëzit nuk njihen mirë në punë, sepse kontrolli e ndihma jo vetëm që janë të dobëta, por shpesh këto bëhen dhe të shkëputura nga njerëzit, sepse nuk punohet me perspektivë dhe nuk i vendosin njerëzit sipas profilit më të përshtatshëm, për këto arsye bëhen shumë lëvizje të kuadrove. Kështu p.sh. Komiteti i Partisë i hidrocentralit të Matit, gjatë vitit 1955 lëvizi 57,3 për qind të kuadrit dhe nga këta — 10,2 për qind me ulje e 51,2 për qind paralelisht. Ministria e Shëndetësisë po ashtu lëvizi 23,1 për qind të kuadrit dhe nga këta — 17,1 për qind me ulje dhe 70,1 për qind paralelisht etj. Një praktikë e tillë dëmton punën dhe vetë kuadrin, nuk i lë ata të perfeksionohen në punë, të njohin zanatin, prandaj edhe i kryejnë me të meta detyrat e ngarkuara.

Puna për përgatitjen e për ngritjen e kuadrit punëtor të prodhimit është krejt e pamjaftueshme. Në disa qarqe si në Shkodër, Korçë etj. këtë vit janë më pak punëtorë në aparatet e Partisë se sa kishte në vitin 1954. Kjo është një e metë e madhe nga e cila rrjedhin shumë dobësi në punën tonë. Prandaj duhet punuar me kujdes të veçantë e me perspektivë për të ngritur në përgjegjësi kuadro punëtorë të prodhimit në organet udhëheqëse, në aparatet e Partisë e të shtetit, duke i përgatitur në kurse e në shkolla dhe duke i ndihmuar e duke i aktivizuar në punë konkrete.

Ndodh që disa drejtues ndërmarrjesh e dikasteresh insistojnë të mbajnë në poste të ndryshme kuadro që njohin, megjithëse kanë një tok të meta e dobësi dhe nuk pranojnë propozimet që bëjnë organet e Partisë, pa asnjë

arësye, vetëm pse nuk i njohin ose pse nuk kanë «eksperiencë» thonë. Duhet kuptuar se Partia në qark ose në rreth i njeh më nga afër kuadrot, prandaj ajo është më në gjendje të bëjë propozime për një shpërndarje më të drejtë të tyre. Nga ana tjetër duhet punuar me më tepër perspektivë. Shumë shokë të dikastereve kanë duruar e mbajtur në punë nga nevoja elementë të papërshtatshëm e armiq, kurse tani nuk kanë durimin e kurajën për të ngritur e mësuar një element punëtor ose një oficer të liruar të cilët tani me të vërtetë nuk kanë eksperiencë, kanë pak njohuri teknike, por që brenda një kohe relativisht të shkurtër do të bëhen kuadro shumë të mirë. Duhet pranuar se nga një mentalitet i tillë janë mbajtur në punë elementë që s'e meritojnë. Prandaj organet shtetërore dhe ekonomike të tregohen të kujdesshme në këtë drejtim. Nga ana e tyre organizatat dhe organet e Partisë duhet të tregohen këmbëngulëse e të pjekura kur janë të bindura se kanë vepruar drejt duke e ngritur zërin deri në Komitetin Qendror.

Për të bërë një politikë të drejtë kuadri nuk mjafton vetëm mendimi i superiorëve, por ka rëndësi të madhe edhe mendimi i vartësve, i bazës. Kjo do të thotë që kur ngrihet një shok në postin e drejtorit p.sh. duhet i gjithë kolektivi ta aprovojë se e ka merituar plotësisht këtë ngritje. Kështu duhet të ndodhë edhe kur shkarrohet. Dhe kjo do të ngjasë kështu, atëhere kur ne do të mbështetemi më tepër në kolektivin punonjës, kur do të dëgjojmë me vëmendje zërin e masës, kur kritika dhe autokritika do të zhvillohen hapur e pa drojtje.

Komiteti Qendror edhe herë të tjera u ka tërhequr vëmendjen organizatave të Partisë për të luftuar me

forcë kundër vendosjes së kuadrit në rrugë familjare e akraballëku. Megjithkëtë ka pasur komitete partie që nuk e kanë pasur sa duhet parasysh këtë çështje. Kështu p.sh. Komiteti i Partisë i Elbasanit kishte lejuar që në kooperativën e Librazhdit 7 vetë të ishin vëllezër e kushërinj dhe që të 7 vodhën sa u ngopën dhe më në fund dogjën dhe kooperativën. Një politikë e tillë është shumë e dëmshme për punën dhe vetë kuadrin, këtu s'ka kritikë dhe autokritikë, pra s'ka luftë për ta çuar përpara punën, por miqësi, akraballëk dhe pastaj vjedhje e shpërdorime. Prandaj në këto raste nuk duhet bërë asnjë lëshim. Kurrsesi të mos lejohet që qendrat tona të prodhimit e të shërbimit të bëhen një grumbull miqsh e farefisi, por të vendosen kuadro besnikë e të aftë që të luftojnë me heroizëm për ta çuar sektorin përpara.

2. — Përditë po shtohen kërkesat ndaj kuadrove si dhe kërkesat për kuadro të rinj. Veçanërisht tani që vendi ynë po hyn në luftën për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar këto kërkesa bëhen akoma më të mëdha. Prandaj, tani bëhet edhe më e madhe detyra e organeve dhe e organizatave të Partisë si dhe e organeve shtetërore për përgatitjen dhe edukimin e kuadrit.

Për këtë duhet të njihen mirë nevojat, të jetë e qartë perspektiva ku duhet të arrijmë brenda pesëvjeçarit të dytë me kuadrot që kemi, sa të tjerë duhet të përgatitim dhe si do t'i përgatitim. Kurset dhe shkollat janë bazë për përgatitjen e kuadrit, prandaj gjithë kuadrot duhet të ndjekin shkollat me korrespondencë, duhen bërë plane perspektive për shokët që do të kalojnë në kurse dhe në shkolla duke u shkëputur nga puna etj. Organizatat e Partisë të forcojnë kontrollin mbi punën

e çdo kuadri në drejtim të edukimit të tij ideo-politik, kultural dhe profesional. Ndërmarrjet dhe kooperativat duhet të luftojnë shumë më tepër se deri sot për përgatitjen dhe për kualifikimin e njerëzve të tyre.

T'i edukosh kuadrot në mënyrë bolshevike do të thotë para së gjithash t'i armatosësh ata me teorinë marksiste-leniniste, me aftësitë që të udhëhiqen nga kjo teori për zgjidhjen e detyrave praktike. Prandaj organizatat e Partisë të tregojnë për këtë problem një kujdes të veçantë, të forcohet ndërgjegjia dhe disiplina për studim dhe të mos lejohet të spekulohet në parimin e vullnetarizmit për t'i shpëtuar kontrollit për studim. Është e drejtë që çdo komunist duhet ta zgjedhë vullnetarisht formën më të përshtatshme që do të ndjekë, por pasi ta ketë zgjedhur formën, atëhere për të është detyrë partie e caktuar me statut ndjekja në rregull dhe përfitim sa më shumë prej saj.

3. — Në përgjithësi kuadrot tanë i karakterizon besnikëria, gatishmëria e vendosmëria për të zbatuar vijën e Partisë. Kjo ka qenë një nga faktorët e rëndësishëm për të realizuar me sukses detyrat e planit të parë pesëvjeçar. Por në disa kuadro ka dobësi e qëndrime të papajtueshme me interesin dhe me vijën e Partisë.

Disa kuadro i kuptojnë dhe mundohen t'i zgjidhin gjërat jo në bazë të interesit të Partisë, por sipas interesit të ngushtë dikasterial ose sipas interesit të tyre personal. Harrojnë principialitetin komunist, harrojnë se janë njerëz politikë, njerëz partie dhe veprojnë në dëm të shtetit. Kështu ngjet që për shkak pse janë zënë midis tyre drejtorët e dy ndërmarrjeve, pengojnë realizimin e planeve të njëri-tjetrit, ose gënjejnë Partinë

dhe shtetin duke fshchur kapacitetin e vërtetë të ndërmarrjes, ose duke dhënë shifra joreale të realizimit të planit siç ndodhi në SMT-në e Krujës, në Ndërmarrjen minerale të kromit në Bulqizë etj., ose thyejnë si pa gjë të keq disiplinën e Partisë e të shtetit duke rezistuar të shkojnë atje ku i cakton Partia dhe shteti, sidomos kur është fjala për të shkuar në rrethe të largëta ose në fshat e qendra pune. Ka shokë të tjerë që pa shikuar interesat e përgjithshme mendojnë të mbahen në punë njerëz që s'bëjnë, vetëm sepse «është gjynah» ose sepse «ka një tufë fëmijë» etj. etj. Të tjerë, dhe këta janë kuadro të cilëve Partia u ka dhënë shkollë e kulturë, nuk pranojnë të bëjnë asnjë punë shoqërore me baza vullnetare për të përfutur dhe të tjerët nga dijet e tyre, por për çdo aktivitet kërkojnë të shpërblehen materialisht etj.

Duhet patjetër t'u jepen fund qëndrimeve dhe shfaqjeve të tilla, të huaja për kuadrot tanë. Në organizatat bazë të Partisë të kritikohen pa mëshirë dhe që në embrion këto shfaqje. Dhe kritikës së ashpër, por të drejtë të organizatës bazë duhet t'i nënshtrohen të gjithë, pa përjashtim, me çfarëdo përgjegjësie qofshin. Jo të ngjasë që para organizatës bazë të nxirren qindra justifikime dhe të mos pranohen kritikët, kurse para organeve më të larta pranohen ato me «si urdhëron» e pa bërë zë fare.

Të gjithë kuadrot tanë duhet ta kuptojnë mirë se në tërë veprimtarinë e tyre duhet të udhëhiqen gjithnjë nga politika e Partisë, nga interesat e larta të Partisë, të shtetit, të popullit.

Edhe herë të tjera Komiteti Qendror ka tërhequr vëmendjen mbi disa qëndrime të dobëta të disa shokëve lidhur me familjen. Ka shokë që nuk e kanë të qartë

rolin e familjes në shoqërinë tonë dhe me qëndrimet e tyre të padrejta bëhen shkaktarë për prishjen e familjes... Këto raste jo vetëm që nuk po dënohen e nuk po goditen me forcë nga organizatat e Partisë, por për më tepër, ka shokë që i përkrahin duke dalë edhe dëshmitarë të rremë para gjyqeve, kurdisin lloj-lloj gjërash për të bindur organet gjyqësore etj. Kështu ndodhi në Peqin ku 4 anëtarë partie dolën dëshmitarë të rremë para gjyqit me qëllim që miku i tyre SH.K. të ndajë gruan pas 20 vjetëve pse «nuk bënte djem». Disa i ndajnë gratë se gjoja nuk shkojnë mirë me prindërit, ose sepse ekziston midis tyre disnivel kultural duke harruar edhe detyrën që kanë këta për të edukuar gratë dhe familjet e tyre me durim, ashtu siç ka vepruar e vepron Partia me ta.

Për këto raste organizatat e Partisë nuk duhet të qëndrojnë në pozita të mosndërhyrjes, por të mbajnë qëndrim ndaj këtyre shokëve dhe t'i ndihmojnë për t'i kuptuar drejt dhe për t'i forcuar marrëdhëniet në mes të bashkëshortëve.

Të kuptohet mirë se familja është bërthama e shoqërisë sonë dhe Partia është e interesuar që kjo të jetë e shëndoshë.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet të kenë në qendër të vëmendjes së tyre punën me kuadrin duke e konsideruar këtë si problemin më kryesor të tyre.

Ato duhet t'i edukojnë kuadrot me një disiplinë të lartë partie kudo që punojnë. Disiplina e Partisë dhe e shtetit është një dhe e pandarë dhe e njëllotë për të gjithë kuadrot pavarësisht nga përgjegjësia dhe sektori ku punojnë. Kjo duhet të qëndrojë në themelin e tërë punëve tona.

Të edukohen kuadrot që të jenë kurdoherë ekzigtentë, të edukohen ata me frymën e respektit dhe të ruajtjes së interesave të Partisë dhe të shtetit, me frymën e vigjilencës revolucionare dhe të ruajtjes së sekretit të Partisë dhe të shtetit.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumenta Kryesore të
PPSH», vëll. II, botimi i
dytë, f. 584*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

MBI DISA TË META NË LIDHJE ME PËRPARIMIN NË MËSIMET DHE DISIPLINËN SHKOLLORE E JASHTËSHKOLLORE

*Letër drejtuar organizatave të Partisë të studentëve
e kursantëve që studjojnë jashtë shtetit*

13 mars 1956

Partia jonë, qysh gjatë Luftës nacional-çlirimtare, i kushtoi një vëmendje të posaçme ngritjes kulturele e arësimore të masave të gjera të popullit tonë si në rradhët e forcave partizane, ashtu dhe në zonat e çliruara. Në këtë drejtim ajo aktivizoi inteligjencien progresive dhe gjithë shokët që kishin njohuritë minimale në këtë sektor dhe hodhi bazat e para të luftës kundër prapambetjes që armiqtë e vendit tonë qëllimisht ia kishin imponuar popullit.

Pas çlirimit, në bazë të programit të Partisë për ndërtimin e socializmit, çështja e kulturës dhe e arësimit u bë një nga problemet shumë të rëndësishme dhe imediate. Për këtë qëllim Partia e qeveria jonë morën të gjitha masat për krijimin e inteligjencies së re nga rradhët e klasës punëtoare dhe të fshatarësisë punonjëse.

Filloi dhe përfundoi me sukses lufta e madhe kundër analfabetizimit. U ngritën kurse, shkolla fillore e 7-vjeçare në të katër anët e atdheut. U shtuan në mënyrë të pakrahasueshme me të kaluarën shkollat e mesme e teknikumet dhe për herë të parë u ngritën institutet e larta. Po ashtu, nga viti në vit, janë dërguar e dërgohen për specializim e studime të larta në Bashkimin Sovjetik e në vendet e demokracisë popullore një numër i konsiderueshëm punonjësish e nxënësish nga shkollat e ndryshme të vendit tonë.

I gjithë ky zhvillim që është arritur në këto vjete të çlirimit, tregon se masat tona punonjëse kanë bërë një revolucion të vërtetë në përgatitjen e tyre kulturalo-arsimore e tekniko-profesionale. Kjo tregon patriotizmin e lartë të popullit tonë dhe është një garanci për ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Ju, ashtu si dhe qindra studentë e kursantë që kanë mbaruar fakultetet, shkollat e kurset, si brenda dhe jashtë atdheut, po përgatiteni që në të ardhshmen të bëheni kuadro të vlefshëm, që kulturën dhe eksperiencën tuaj që keni fituar e do të fitoni nga kurset, shkollat, institutet dhe jeta shoqërore e vendit ku studjoni, t'i vini në dispozicion të interesave të popullit e të atdheut tonë.

Partia, populli e vendi ynë, presin nga të gjithë kuadrot që janë në punë ose që përgatiten për punë që të realizojnë me sukses detyrat që u janë ngarkuar dhe konkretisht nga ju, presin që të mësoni sa më tepër për t'u bërë të aftë në profilin që vazhdoni të ndiqni dhe pjesëtarë të inteligjencies së re, që rritet e zhvillohet në shoqërinë tonë socialiste.

Komiteti Qendror i PPSH, ka ndjekur me kujdes të veçantë jetën, përparimin dhe aktivitetin tuaj shkollor e jashtëshkollor dhe vëren me kënaqësi se ju i keni kuptuar mjaft mirë detyrat që juve ju janë ngarkuar, si përsa u përket rezultateve në mësim duke ngritur mesataren e notës dhe duke dhënë mjaft provime të prapambetura dhe të përsëritura, ashtu edhe në jetën shoqërore duke shtuar në mënyrë të kënaqshme aktivitetin kulturalo-shoqëror.

Të gjitha këto suksese, që janë arritur, në radhë të parë janë rezultat i punës së mirë që kanë bërë organizatat bazë të Partisë, të cilat kanë forcuar jetën e brendshme të tyre duke u njohur më mirë me problemet që u dalin, kanë zhvilluar më mirë kritikën e autokritikën konstruktive duke goditur më me objektivitet të metat e gabimet dhe kanë organizuar më me sistem aktivitetin shoqëror si në popullarizimin e vendit tonë, ashtu dhe në punën për forcimin e miqësisë së popullit tonë me popujt e tjerë.

Edhe ambasadat, që përfaqësojnë Partinë e shtetit tonë në shtetin ku ju studjoni, kohët e fundit kanë qëndruar më afër jush dhe ju kanë ndihmuar më tepër në çështjet që juve ju janë paraqitur.

Por me gjithë sukseset që keni arritur, është e nevojshme që ju t'i shtoni akoma më shumë përpjekjet, sepse vërtetohen akoma mjaft dobësi e të meta, si përsa i përket përparimit në mësim, ashtu edhe përsa i përket disiplinës shkollore e jashtëshkollore.

Në radhë të parë duhet të keni parasysh se burimi i të metave dhe i dobësive tuaja qëndron në një numër shfaqjesh të huaja që janë dukur te disa studentë

e kursantë, siç janë p.sh. nënvleftësimi i mësimëve, mendjemadhësia e shfaqje të tjera në kundërshtim me moralin tonë komunist.

Vetëm fakti se gjatë vitit 1955 u është prerë bursa 12 studentëve e kursantëve për shfaqje të tilla, bën të qartë edhe pasojat që kanë sjellë me vete këto.¹

Gjithashtu vihet re se mjaft studentë e kursantë, duke u tërhequr nga interesat e tyre personale, gabojnë në dëm të shëndetit të tyre, të rezultateve në mësim dhe të detyrave të tjera që kanë ndaj shoqërisë. Këto gabime konsistojnë përgjithësisht në blerjen e plaçkave e të sendeve të tepërta nga bursa e tyre shkollore, në martesat që bëjnë me shtetaset e huaja pa u thelluar e pa e studjuar në mënyrë të gjithanshme këtë veprim dhe në indiferentizmin që tregojnë për jetën kolektive.

Nga këta shembuj e konstatime, organizatat bazë, të gjithë komunistët, duhet të nxjerrin konkluzione dhe detyra për forcimin në shkallën e duhur të luftës kundër mbeturinave mikroborgjeze, duke i mbështetur këto detyra në luftën e sakrificat e mëdha që bën populli ynë në të gjitha fushat.

Partia e di se për pajisjen e intelektualëve të rinj

¹ Më poshtë bëhet fjalë për këta studentë që u është prerë bursa, sepse kanë qenë të padisiplinuar, mendjemëdhënij dhe të prapambetur në mësim, si dhe për studentë e kursantë të tjerë, të cilët, me sjelljet e tyre jokorrekte në jetën shkollore e jashtë-shkollore, kundrejt ambasadave tona, qytetarëve e ligjeve të shtetit ku studjojnë, i kanë detyruar organizatat bazë të Partisë që të marrin masa ndëshkimore ndaj tyre.

me virtute të larta, siç e kërkon shoqëria jonë e re, duhet të bëhet një punë e madhe, këmbëngulëse dhe e vazhdueshme; këtë detyrë Partia ua ka ngarkuar organizatave bazë të Partisë e përfaqësive tona jashtë shtetit. Prandaj është e domosdoshme që ato të shtojnë ndihmën e kontrollin në punën e komunistëve dhe të gjithë studentëve e kursantëve, duke shfrytëzuar në të njëjtën kohë të gjitha format e edukimit marksist-leninist, si domos vendimin e Plenumit të Komitetit Qendror të muajit prill 1955 «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj».

Kongresi III i Partisë që do të mbahet në muajin maj të vitit në vazhdim, ku do të paraqitet bilanci i rezultateve të punës plot sukses të kryer gjatë planit të parë pesëvjeçar, si dhe perspektivat e detyrat lidhur me planin e dytë pesëvjeçar, duhet t'ju mobilizojë dhe t'ju vërë në garë njëri me tjetrin si individë dhe si organizata që të merrni angazhime për të mësuar sa më shumë e për t'u dhënë fund dobësive e të metave që ekzistojnë, ashtu si po angazhohen të gjitha masat tona punonjëse përpara kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme për Partinë, popullin e atdheun tonë.

Komiteti Qendror i PPSH, i mbështetur në forcat e organizatave bazë të Partisë aty, që janë të gjalla e të shëndosha, ashtu si edhe në tërë Partinë tonë e në ndihmën që do t'ju japin ambasadat dhe trupi mësimor i shkollave dhe i instituteve, shpreh bindjen e plotë se do të mund t'i zhdukni edhe ato të meta e gabime që keni.

Komiteti Qendror i PPSH nga ana e tij do t'ju japë të gjithë ndihmën e nevojshme që ju të siguronit re-

zultatet e dëshiruara dhe është i sigurtë se këtë ndihmë do ta vlerësoni e do ta përdorni në dobi të luftës sonë të madhe për ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**NE KEMI NEVOJË PËR NJË PLAN MË TË LIDHUR
ME JETËN, MË AFËR REALITETIT DHE
KËRKESAVE TË POPULLIT**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

19 mars 1950

Para së gjithash dëshiroj të bëj disa vërejtje të përgjithshme në lidhje me projektplanin e dytë pesëvjeçar që po shqyrtojmë.

Edhe unë jam dakord me shokët e Byrosë Politike, se Komisioni i Planit të Shtetit këtë radhë ka vepruar më mirë se herët e tjera dhe na ka paraqitur një projekt më të punuar. Megjithatë, edhe në këtë projektplan ka të meta, një nga të cilat, siç e tha edhe Gogua e shokët e tjerë, qëndron në atë se plani është shumë pak i lidhur me jetën, me realitetin dhe me nevojat e vendit.

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH gjatë tri ditëve u rrahën mendime për të përgatitur hartimin e planit të dytë pesëvjeçar, sipas projektit të paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit.

Kjo është një e metë serioze, jo vetëm për shokët e Komisionit të Planit të Shtetit, por edhe për vetë Partinë, për ministritë dhe për ndërmarrjet. Ne kemi nevojë për një plan më të lidhur me jetën, që të jetë më afër realitetit dhe kërkesave të popullit.

Baza, e cila krijon, dërsin dhe hap perspektiva pune, nuk dëgjohet sa duhet për mendimet që jep, në vend që të inkurajohet të marrë inisiativa dhe, këto mendime e inisiativa të saja të bëhen objekt studimi për dikasteret dhe Komitetin Qendror të PPSH. Këtu e ka burimin edhe vërejtja që bëri Spirua, i cili tha se studimi dhe përpunimi i shifrave në bazë është bërë në mënyrë burokratike, duke u bazuar në propozimet e drejtorive dhe jo, si duhet, në ato të punëtorëve, të cilat shpeshherë nuk merren parasysh. Kontaktet e udhëheqjes së Partisë e të shtetit me bazën, me punëtorët e novatorët, që janë krijuesit e të mirave materiale, si dhe dëgjimi i zërit të tyre, kanë një rëndësi të madhe parimore. Çdo qëndrim tjetër është antimarksist e antishtetëror dhe ne nuk do ta lejojmë. Novatorët tanë numërohen me mijëra, janë njerëz të thjeshtë dhe bëjnë mrekullira. Pse atëherë nuk kemi shumë propozime prej tyre? Sepse në punën tonë ka sektarizëm dhe burokratizëm, gjë që na sjell dëme të mëdha. Prandaj këtë çështje duhet ta shohim mirë, pse jemi përpara detyrave shumë të rënda, që kanë për qëllim ngritjen e nivelit të jetesës së popullit. Realizimi i këtij qëllimi të madh të Partisë, nuk arrihet vetëvetiu, por me një sërë masash politike dhe organizative, me inisiativën e masave të gjera të popullit që punojnë dhe luftojnë me vrull për t'i kapërcyer vështirësitë në çdo sektor dhe korrin gjithnjë fitore.

Për hartimin e këtij plani duhet të kihet parasysh edhe eksperiencia e grumbulluar nga sukseset dhe gabimet që kemi pasur deri tani në fushën e planifikimit. Kjo është theksuar edhe në mbledhjet e plenumeve të Komitetit Qendror, por me sa duket nuk ka gjetur zbatimin e duhur. Të marrim çështjen e përpjesëtimeve të zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë.

Orientimet e plenumeve të Komitetit Qendror dhe ideja e Byrosë Politike kanë qenë që me planin e dytë pesëvjeçar t'i jepej një hov i madh zhvillimit të bujqësisë, që të ecë më përpara dhe të sigurohen kështu kushte më të mira jetese për popullin. Njëkohësisht nuk duhet të lihej pasdore zhvillimi i industrisë, përkundrazi, ta kompletim atë me disa fabrika të vogla dhe të merrnim të gjitha masat që industria ekzistuese të punojë me një rendiment më të madh. Këto masa do të zvogëlonin më tej disproporcionin midis industrisë dhe bujqësisë dhe do të përgatitej terreni për t'u hedhur përpara me forca më të mëdha. Por lidhur me zhvillimin e industrisë, Byroja Politike dhe Komiteti Qendror kishin vënë në rendin e ditës çështjen që gjeologjisë t'i jepnin rëndësinë më të madhe. Të gjithë i shohim perspektivat e reja që po hapen për zhvillimin e këtij sektori, por në këtë projektplan nuk duket një gjë e tillë. Këtu shënohen dy hidrocentrale të mëdhenj, dy fabrika për hekur, një fabrikë për metalurgjinë e nikelit dhe një linjë e tensionit të lartë! Pra, nuk është mbajtur si duhet parasysh orientimi i drejtë që kanë dhënë Komiteti Qendror dhe Byroja Politike për një planifikim më të harmonizuar të këtyre çështjeve.

Gjithashtu, ne nuk duhet të harrojmë luftën e

madhe që kemi për të bërë kundër prapambetjes së bujqësisë. Por edhe kjo nuk gjen si duhet shprehjen e vet në projektplanin që na paraqitet.

Është e domosdoshme të kuptohet mirë se në këtë pesëvjeçar duhet t'i japim rëndësi të madhe zhvillimit të bujqësisë. Një projektplan i tillë nuk mund të financohet në mënyrë normale, edhe për faktin se ne kemi deficite. Po të pranojmë një projektplan si ky, atëhere ne duhet të jemi të bindur se nuk mund ta realizojmë dot, këtë tregojnë edhe lëkundjet që u dukën në disa diskutime. Atëhere ku po shkojmë, shokë? Popullit nuk po i japim ushqimet që i duhen. Mendimi ynë është se fshatarësia jonë nuk po ushqehet mirë. Për shembull, më duket se ajo ha më pak mish se sa punëtorët. Por nuk është vetëm çështja e mishit, këtë duhet ta shohim më konkretisht dhe jo vetëm në disa familje, po në të gjithë popullin. Prandaj Partia dhe qeveria në hartimin e planeve duhet të kenë parasysh që niveli i jetesës duhet të ngrihet jo vetëm për klasën punëtore, po edhe për fshatarësinë që prodhon të gjitha të mirat bujqësore dhe blegtorale. Mund që fshatarët të kenë më shumë të holla nga punëtorët, unë këtë nuk e përjashtoj. Te fshatari ekziston besimi në pushtetin popullor, në ecjen tonë përpara, por te ai ka edhe një farë mentaliteti të vjetër, atë e shtyn tradita të mbajë më shumë të holla në xhep. Mirëpo paraja nuk e ushqen fshatarin, ai tërhiqet më shumë nga gjendja e tregut, nga çmimet. Fshatari mund të ketë 2 kg. gjalpë në shtëpi, por kur shoh se ai ka vajtur, ta zëmë 600 lekë kg. nuk ua jep fëmijëve ta hanë, por e shet. Të gjitha këto duhet të na bëjnë që plani ynë në radhë të parë të jetë real dhe të ketë si

qëllim përmirësimit e vazhdueshëm të jetës së popullit. Kjo do të thotë që bujqësia të ngrihet, që industria të forcohet dhe të përgatiten bazat për një industrializim më të fuqishëm në pesëvjeçarin e tretë.

Në lidhje me kolektivizimin e bujqësisë dhe me orientimin që duhet të japim mbi këtë problem të madh në direktivat e planit të dytë pesëvjeçar duhet theksuar se kolektivizimi është detyra më serioze, më e rëndësishme dhe vendimtare për bujqësinë tonë. Plani i dytë pesëvjeçar do të hyjë në historinë e Partisë sonë si plani i kolektivizimit të bujqësisë në pjesën më të madhe të Shqipërisë. Kjo ide duhet të dalë si duhet në plan, po ashtu edhe çështja e organizimit të kooperativave bujqësore, e kuadrove të tyre kryesorë si kryetarë, llogaritarë etj., futja e metodave të reja agroteknike, e mekanizimit etj., sepse këto çështje janë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me kolektivizimin, prandaj me të drejtë Partia jonë ka caktuar objektiva, po merr masa dhe bujqësia me siguri do të hedhë hapa të mëdhenj përpara.

Edhe ulja e çmimeve, huatë shtetërore dhe stimulacionet e bimëve industriale që parashikohen në plan, më duket se janë shumë të ngjeshura dhe jeta do të na tregojë se nuk do t'i realizojmë plotësisht. Prandaj më do të lejtojmë ca planet në mënyrë që ulja e çmimeve të jetë më e kënaqshme për popullin. Është më mirë që fshatarësisë t'i japim mallra me çmime më të ulëta.

Dëshiroj tani të shfaq disa mendime më konkrete për disa sektorë. Po e filloj nga minierat.

Çështja e parë për të cilën flitet këtu është ajo e shpenzimeve të mëdha që bëhen lidhur me karburantet. Më duket se kjo ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe.

Ne nxjerrim naftë, por mendoj që, me disa investime të vogla, të prodhojmë më shumë artikuj që tani i importojmë, pse duhet të përpiqemi të bëjmë ekonomi në çdo çështje. Por parashikimi për prodhimin e naftës, mendoj se është i vogël, prandaj duhet rritur. E them këtë, pse te ne vështirësitë më të mëdha janë kaluar, kuadrot janë më të kualifikuar, po bëhen edhe shpime të reja. Veç kësaj planet që ishin caktuar, janë tejkaluar dhe, sigurisht, nuk janë marrë të gjitha masat për shfrytëzimin e puseve të reja. Prandaj mendimi im është që të kërkojmë më shumë nga shokët e naftës. Në këtë prizëm duhen rishikuar si çështja e karburanteve ashtu dhe ajo e automobilave dhe e gazeve që janë probleme shumë të rëndësishme. Në projektplan këto vihen si çështje të studjuara, por mendoj se ky studim duhet bërë më mirë dhe, në bazë të tij, të vendosim një sërë masash, pse gjërat nuk mund t'i futim në plan pa pasur të dhëna konkrete. Prandaj duhet t'i vëmë detyrë vetes që këto çështje t'i shohim në frymën e kursimeve.

Minierat kanë edhe probleme të tjera. Kështu për shembull çështja e ferro-kromit paraqitet interesante por as këtë nuk mund ta futim në plan pa e studjuar mirë. Mendoj që, pasi të bëhet ky studim, kjo çështje mund të futet në plan në pesëvjeçarin e tretë. Ekonominë tonë nuk duhet ta rëndojmë në një kohë kaq të shkurtër me ndërtime kaq të mëdha, të ecim përpara duke shfrytëzuar hekurin, të kemi fitime në fillim, shpenzimet t'i bëjmë gradualisht, mos t'i zëmë frymën ekonomisë dhe të ardhurat t'i përfitojmë vonë. Duhet pasur parasysh se në fund të vitit 1960 na bëhen 16 vjet çlirim dhe populli thotë: «Mirë është të ndërtohen fa-

brika, hekurudha, po ne akoma nuk kemi vaj dhe triskat nuk na janë hequr».

Përsa i përket hekur-nikelit, ne kemi filluar të hedhim hapat e parë. Jemi marrë vesh me çekët, ata i kanë pranuar të gjitha kushtet tona, na kanë dhënë kredi të re dhe përpara nesh hapet një perspektivë me rëndësi të madhe. Lidhur me këtë ne nuk duhet të shpejtohem dhe të rëndojmë planin, po mendoj të kemi parasysh ngritjen e tri fabrikave të pastrimit, aglomeracionit dhe të metalurgjisë së mineraleve, pse këto janë të leverdisshme. Në rast se konstatojmë që plani ecën, se detyrat e bujqësisë realizohen, venë mirë rendimentet etj., atëhere mund t'i bëjmë atij edhe shtesa për një ose dy fabrika të tjera, por këtë ta shohim, pse duhet studjuar si leverdia ekonomike, ashtu dhe koha e ndërimit të tyre.

Kam edhe një vërejtje konkrete për çështjen e Minierës së Alarupit. Është thënë se qymyri i kësaj miniere nuk vlen, pse nuk ka kalori, ndërsa tani na thuhet se atij cilësitë e mira nuk i mungojnë, pra është shumë i leverdisshëm. Si është kjo punë? Kemi të drejtë të themi që studimeve duhet t'u kushtojmë kujdes dhe të sigurohem mirë. Na del që Miniera e Alarupit dhe e Mborjes janë dy miniera nga më të rëndësishmet. Prandaj, kur shfrytëzojmë miniera të tilla duhet ta kemi të qartë se minerali do të transportohet në largësi të madhe. Veç kësaj është e domosdoshme të shikohet edhe leverdia ekonomike e mineralit, sasia dhe cilësia e tij.

Unë jam dakord me Mehmetin që ta shtojmë qymyrin në Memaliaj, pse kam bindjen se në këtë minierë ka një pellg të tërë me qymyr. Prandaj ta shfrytëzojmë:

më intensivisht atë, bile edhe të eksportojmë prodhime të saj. Edhe për Minierën e Selenicës duhet ta kemi më të qartë studimin për bitum. Unë kam shpresë të madhe se në këtë minierë ka rezerva bitumi. Por, ajo që ka rëndësi për minierat është edhe fakti se në çfarë shkalle do të bëhet mekanizimi i tyre dhe, a janë paraparë masat që duhen marrë për plotësimin e nevojave minimale të punëtorëve, sidomos në Memaliaj dhe në Mborje, që s'kanë as maqina as shtëpi as mensë. Po të ecim kështu, shokë, do të bëjmë gabim. Prandaj me këtë plan punonjësve të këtyre minierave duhet t'u sigurohen të paktën kushtet minimale të jetesës dhe të punës, ndryshe nuk jemi në rregull.

Kisha një mendim të përgjithshëm për gjeologjinë. Në këtë sektor të përqëndrojmë në radhë të parë forcat kryesore për të përcaktuar minierat më të rëndësishme për industrinë e vendit dhe për eksport dhe të mos i shpërndajmë forcat për të bërë zbulime në të gjithë Republikën ku ka dhe ku nuk ka minerale. Gjatë kësaj rruge të vihen edhe disa detyra për të kërkuar dhe minerale të tjera. Pra, të forcojmë bazën ekzistuese, pastaj dalëngadalë të zbulojmë edhe të tjera që do ta pasurojnë edhe më shumë industrinë tonë. Çështjen e gjeologjisë ne nuk mund ta zgjidhim në pak vjet dhe të kemi rezultate menjëherë. Edhe parashikimi për bakër blister më duket se është pak, prandaj duhet parë. Kromi mendoj që të shtohet.

Këto kisha për çështjen e industrisë minerare.

Çështja e dytë është ajo e energjisë elektrike. Kjo duhet studjuar nga shumë anë, sidomos nga pikëpamja e leverdisë ekonomike. Projekti për hidrocentralin e

Matit arriti dyfishin, po edhe kur të vijë fundi do të shohim se sa do të jetë, pse sigurisht do të na duhen fonde të tjera. Që të shpejtohemi në këtë drejtim, pa studime, nuk jam dakord.

Energjia elektrike ka shumë rëndësi dhe pa të nuk mund të ecet përpara, por sipas mendimit tim për çështjen e elektrifikimit të mos ecim pa një perspektivë. Në BS kanë bërë planin e madh të elektrifikimit. Edhe ne duhet të kemi një plan të vogël, modest, me një perspektivë shumëvjeçare (10-15 vjet), sepse ekonomia jonë e tanishme nuk mund që brenda 7-8 vjetëve të mbajë peshën për të elektrifikuar gjithë Shqipërinë. Spirua thotë le të prodhojmë korent e të shesim, po përpara se ta shesim atë, duhet ta blejmë. Prandaj, lidhur me këtë çështje të rëndësishme, për të cilën Lenini ka thënë se «*Pushteti sovjetik, plus elektrifikimi, baras komunizmi*»¹, ne duhet të hartojmë një plan perspektiv. Të kemi parasysh që të elektrifikojmë vendin duke shfrytëzuar sa më shumë forcat hidrike. Të plotësojmë gradualisht dhe me perspektivë si nevojat e zhvillimit të industrisë, ashtu dhe nevojat e tjera të popullsisë që po rriten.

Tani për tani te ne nuk bëhet fjalë për të ndërtuar hidrocentrale shumë të mëdhenj, ajo që mund të shesim ne është një gjë e vogël, prandaj kapaciteti i prodhimit të energjisë duhet t'i përgjigjet zhvillimit të industrisë duke mbajtur rezerva aq sa nevojiten. E them këtë se kam dëgjuar që ne mbajmë shumë rezerva, gjë që na dëmton ekonomikisht. Të nxjerrim, por edhe të ekono-

¹ Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 480.

mizojmë energji elektrike. Të modernizojmë rrjetin elektrik që të mos humbasim shumë korent. Për këtë çështje nuk bëhet fare fjalë në plan. Prandaj rrjetin kryesor duhet ta zëvendësojmë me plan dhe, me rrjetin e vjetër, të elektrifikojmë fshatrat etj. Prandaj propozoj të shikohet çështja e riparimit të rrjetit të vjetër elektrik. Veç kësaj, për çdo central që do të ngrihet të shikohet leverdia, rentabiliteti dhe shitja e energjisë, po ne duhet të shohim edhe burimet e tjera të energjisë.

Hydrocentrali i Bistricës, siç na është paraqitur, është i leverdisshëm. Mendoj që ne duhet ta parashikojmë atë që në vitin 1962 ose 1963. Ka gjëra që mund t'i heqim nga plani, megjithëse për to kemi nevojë, por hydrocentralin e Bistricës ta vëmë në plan. Edhe disa materiale elektrike që sot i sjellim nga importi, si llamba elektrike etj., mendoj se kemi mundësi t'i prodhojmë në vend duke krijuar një industri të vogël dhe të shpëtojme kështu një farë devize.

Çështja e tretë është ajo e transportit. Si do ta sigurojmë këtë, me ndërtimin e linjave hekurudhore apo me anë të transportit automobilistik? Kjo është një çështje që duhet parë. Nuk jam për atë që të hapim miniera dhe të mos mendojmë ç'do të bëjmë për transportimin e mineralit të tyre. Propozoj që për këtë të studjohen tri variante: së pari, të ndërtohen hekurudha, veçse puna për studimin e këtij varianti të mos jetë si «flaka e kashtës». Në këtë drejtim kemi një eksperiencë, se është thënë të bëhet hekurudha Memaliaj-Vlorë, pastaj na del që kjo nuk është e leverdisshme. Varianti i dytë është transporti automobilistik. Në kuadrin e përgjithshëm të këtij sektori mendoj se duhet të

kemi një përqëndrim më të mirë, duhet studjuar mirë ky problem që enteve kryesore t'u lihen aq maqina sa janë nevojat e tyre të brendshme. Kjo masë duhet marrë, sepse kështu si është organizimi tani, ky lloj transporti nuk shfrytëzohet si duhet. Për nevojat e popullit ne duhet të shtojmë taksitë, autobuzat dhe mjettet e tjera. Çdo gjë në transport duhet parë mirë, me llogari. E them këtë pse ne nuk e planifikojmë si duhet transportin, nuk e koordinojmë mirë atë, e kemi të decentralizuar dhe vazhdimisht na thuhet se të gjitha këto na shkaktojnë shpenzime. Atëhere të vëmë rregull dhe disiplinë, sepse dobësitë dhe mungesat vijnë nganjëherë edhe nga planifikimi i keq. Edhe për panxharin e sheqerit, përse të mos ndërtojmë një dekovil të vogël? Shinat i kemi, nëse jo, atëhere ç'u bënë gjithë ato që kemi sjellë? Janë prishur? Në qoftë se është kështu, shumë keq. Por panxhari na kërkon transport të madh dhe për të mendoj se nuk është parashikuar asgjë. Varianti i tretë është studimi për të shfrytëzuar ujët, transportin detar. Studimi dhe përcaktimi i detyrave të këtyre varianteve duke vënë në bazë leverdinë ekonomike duhet të përfshihet në plan. Shtoj se në pesëvjeçarin e parë është neglizhuar transporti detar, kurse në të dytin nuk duhet të ndodhë një gjë e tillë.

Edhe unë mendoj se plani për ndërtimet është shumë i madh dhe nuk jepet një orientim sa më i drejtë i përdorimit të shumanshëm të materialeve të ndryshme që ka vendi ynë. Është fakt se ndërtimet me gurë na kushtojnë shtrenjt, por në qoftë se do ta mekanizojmë nxjerrjen e gurit, natyrisht mund të ndërtojmë. Ndërsa

ndërtimet me materiale të tjera vendi si thupra dhe kallama në këtë projekt nuk përmenden fare.

Mungesa e një orientimi të drejtë, do të na çojë në ndërtime shumë të kushtueshme dhe antiekonomike. Prandaj duhet të largohemi patjetër nga rruga e ndërtimeve shumë të kushtueshme që bëjmë sot. Të marrim si shembull lëndën e drurit. Megjithëse themi që kjo të ekonomizohet, më duket se përsëri parashikohet të shpenzohet shumë. Unë mendoj që të mos shpenzohet kaq shumë dru, bile atë mund ta zëvendësojmë; për shembull, dyshemetë të mos i bëjmë me dërrasa, por me pllaka. Mendimet se pllakat «na ftohin», «po marrim plevit» etj., nuk janë të drejta. Vendi ynë ka një klimë si ajo e Italisë ku shtëpitë nuk bëhen kryesisht me parket, por me pllaka. Kështu mund të veprohet edhe tene. Prandaj, të zhvillojmë industrinë e prodhimit të pllakave me çimento. Edhe tavanet, pse t'i bëjmë me dërrasa dhe jo me kallama, llaç e gëlqere? Pse të përdorim dërrasa sidomos në ndërtesa të lehta banimi, kur mund t'i zëvendësojmë ato me material të lehtë, të pastër dhe të shëndetshëm?

Duke kursyer lëndën e drurit, mendoj se nuk është nevoja të investojmë shumë, siç paraqitet në plan, për të krijuar stabilimente të reja sharrash. Mund të krijojmë sharra të vogla, siç ka dhënë orientim Byroja Politike, sharra uji dhe dore në qendra ku ka pyje, gjë që nuk kërkon shpenzime të mëdha. Në këtë rrugë plotësojmë jo vetëm nevojat lokale, por edhe një pjesë të nevojave kombëtare. Përveç kësaj me një organizim më të mirë të punës për shfrytëzimin e pyjeve në qendra të ndryshme, do të kemi edhe përfitime të tjera: evitoj-

më shpenzime të mëdha në rrugët pyjore, ekonomizojmë transportin, banesat, gomat, vlerësojmë kafshët për të cilat këtu nuk jepet ndonjë orientim, por çdo gjë kërkohet të bëhet me maqina; kursejmë fuqinë punëtore, bëhet më mirë furnizimi i punëtorëve, nuk dobësojmë bujqësinë, pse punëtorët do t'i nxjerrim nga qytetet etj. Është shumë më lehtë që qarku të nxjerrë punëtorë për veten e vet, kurse po t'i thuash fshatarit të vejë në objekte që ndodhen në qarqe të tjera, kjo është më e vështirë. Në këtë mënyrë qarqet ose rrethet do të lidhen më konkretisht me pyllëzimin, pse kur t'u vejë plani për shfrytëzimin e pyjeve, do t'u caktohen edhe detyra që t'i shtojnë e t'i përmirësojnë ato. Të gjitha këto mendoj se duhet t'i rishikojmë. Çështja e leverdisë të mbahet parasysh edhe për ndërtimin e fabrikës së likusit, për të cilën jam dakord, por vendi për ngritjen e saj duhet të studjohet lidhur ngushtë me lëndën e parë. Më mirë të transportojmë kompensatën nga Elbasani se sa koçan nga e gjithë Shqipëria.

Për ngritjen e fabrikës së plehrave kimike, në parim nuk jam kundër. Një fabrikë e tillë është shumë e nevojshme për ne. Çështja është që të na paraqitet e studjuar se çfarë fabrike do të bëjmë, me gaz apo me qymyr, sa do të jetë kapaciteti i saj etj., pastaj ta futim në plan. Po të bëhen disa shkurtime, siç u tha dhe po të sigurojmë energjinë elektrike për këtë fabrikë, mund të krijohen mundësi që ndërtimin e saj ta fillojmë që në këtë pesëvjeçar. Por duhet t'i bëjmë mirë llogaritë që të mos rëndohemi shumë.

Nuk është një ide e keqe edhe ngritja e një fabrike për pregatitje betoni, por më duket se neve na duhet:

fabrika e eternitit për të zëvendësuar në shumë raste tjegullat dhe tullat si dhe ngritja e një fabrike të vogël për fabrikimin e pupulitit si ajo me të cilën është bërë Teatri Popullor. Mendoj që këto të vihen në plan e të ndërtohen afër Fabrikës së Çimentos në Vlorë. Këto dy fabrika ose punishte pllakash, me ngjyra ose pa ngjyra, për dysheme, janë të domosdoshme, të manovrueshme dhe ekonomike dhe do të ndihmojnë që ndërtimet të shpejtohen dhe populli të kënaqet.

Jam i mendimit që për investimet dhe ndërtimet e mëdha duhen parë të gjitha vërejtjet që bëhen dhe të arrijmë në një përfundim të përbashkët. Të biem dakord ç'do të heqim dhe ç'do të lemë duke u nisur nga orientimi që ato të ulen.

Sipas mendimit tim ndërtimet janë të fryra, prandaj duhet t'i lehtësojmë duke marrë masa që të mos bëhen ndërtime të rënda, të ekonomizojmë materialet, të kursejmë punëtorët dhe specialistët. Mendoj që në këtë situatë të shtojmë banesat për popullin në qytete. Por populli ka dhe nevoja të tjera. Njëri kërkon të vërë një gozhdë në dysheme, tjetri do disa tulla pse po i bie shtëpia etj. Edhe në fshatra ka nevoja të tilla për të bërë meremetime. Prandaj për këto gjëra ne duhet të mendojmë e të japim orientimet përkatëse.

Në plan nuk shikohet asnjë ndërtim në vendet ku ka ujëra minerale. Si do të bëhet për ata që vuajnë nga reumatizma, nga veshkat, a nuk duhet parë kjo çështje? Në Glinë, ku uji mineral është kaq i mirë, ka vetëm një godinë që është më tepër një han. Po kështu edhe në Peshkopë, prandaj këto vende duhet të bëhen qendra ku të kurohen të sëmurët.

Për Tiranën duhet menduar edhe për ndërtimin e një frigoriferi, ndërsa në Gjirokastrë, në vend të frigoriferit, mund të shfrytëzohen bodrumet e kalasë, që janë të përshtatshme për ruajtjen e freskët të ushqimeve.

Është e qartë se në sektorin e ndërtimeve duhen bërë sforcime të mëdha, të vendoset rregull e disiplinë dhe të luftohet për t'i kapërcyer vështirësitë që paraqiten.

Në lidhje me industrinë e lehtë të veshmbathjes bashkohem me mendimin e Gogos, se ne duhet të përpiqemi për të shfrytëzuar në maksimum mundësitë e brendshme dhe kapacitetet e fabrikës, të mos u qëndrojmë skllëvër projekteve, por ka mundësi që t'i kapërcëjmë ato. Megjithatë populli është i veshur shumë më mirë se përpara, ne nuk duhet të kënaqemi me gjendjen që kemi, por duhet t'i japim atij akoma më shumë dhe me cilësi të mirë.

Shoku Hysni e shtroi këtu shumë mirë çështjen e shfrytëzimit të rezervave të brendshme. Fshatarët t'ne bëjnë vetë shumë veshmbathje si fanella, çorape, shajak etj. Këta artikuj i bën çdo ekonomi me leshin e vet duke e pastruar, krehur, tjerrur e thurur leshin në mënyrë primitive. Unë mendoj të japim orientimin që të merren masa të forta për të dalë nga kjo fazë primitive dhe këto punime t'i prodhojë artizanati. Në këtë mënyrë do të ekonomizohet lënda e parë dhe do të lehtësohet gruaja fshatare për t'iu kushtuar më shumë bujqësisë. Përveç kësaj do të krijohen edhe fronte të reja pune për forcat e lira në qytete. Në artizanat mund të organizohen grupe grash për të tjerrë lesh me disa maqina tjerrëse. Fshatari të vejë atje dhe të blejë artikuj leshi, ose të bëjë gjëra me porosi duke sjellë leshin e

vet dhe, pas ca kohe, të marrë rroben, fanellat ose çorapet e porositura. Kështu do të ekonomizohet edhe leshi, pasi kështu si punojnë tani fshatarët përdorin shumë lesh, ndërsa po të kemi mundësi t'ia marrim dhe ta punojë artizanati do të ekonomizohet. Edhe rrobat që priten e qepen, të mos përgatiten e të mos shpërndahen njëlloj në të gjithë Shqipërinë, pse ndryshe vishet korçari, ndryshe fieraku dhe ndryshe gjirokastri.

Një formë e tillë organizimi, ku fshatari duke bërë mallra me porosi do të shohë leverdinë, mendoj, ta fillojmë dhe të vazhdohet derisa njerëzit e fshatit të krijojnë një shije të re dhe ne të jemi në gjendje të furnizojmë fshatin me çdo lloj malli. Pra, kjo është një fazë tranzitore ndihme për industrinë tonë shtetërore, por me një formë më të organizuar.

Përsa i përket industrisë së lehtë ushqimore kisha vërejtjen që për prodhimet e sheqerit të mendohet varianti më i përshtatshëm, në mënyrë që të krijohet mundësia për të shfrytëzuar të gjitha mbeturinat e panxharit të sheqerit. Gjithashtu jam dakord për prodhimin e lëngut të frutave dhe për ngritjen e industrisë së verërave e të rakisë, të cilat do të bëhen burime të rëndësishme për të shtuar artikujt e eksportit. Për nevojat e popullit, të zgjerohet edhe konservimi i frutave në zonat e brendshme dhe me interesimin e Partisë të punohet që përpunimi i tyre të bëhet në një shkallë më të kulturuar se tani. Gjithashtu të zgjerohet konservimi i zarzavateve, qoftë edhe në forma primitive. Fermat shtetërore kanë shumë perime dhe ato po prishen. Për t'i shfrytëzuar të tëra ato, ne do të ndërtojmë fabrika

dhe të kemi kujdes që perimet të mos na i hanë kafshët siç ndodh nganjëherë.

Kam mendimin që t'i heqim nga eksporti disa sende ushqimore siç janë ullinjtë, vezët, bile edhe konservat e peshkut, me të cilat duhet të ushqejmë si duhet popullin. Për një kohë akoma nuk është mirë t'i eksportojmë këto sende ushqimore, sepse kemi vetë nevoja të tilla. Derisa kemi gjëra të tjera që mund të eksportojmë, atëherë përse duhet të eksportojmë, për shembull, ullinj?

Jam dakord me masat që u propozuan për industrializimin e qumshit, djathit, gjalpit e gjizës. Këto janë ushqime bazë të rëndësishme. Mendoj se mund të shtohet edhe më shumë rendimenti i qumshit nga sa është parashikuar në plan dhe të zgjerohet më tepër rrjeti i bazave të grumbullimit sa më afër qumshit. Me këtë detyrë duhet të merren seriozisht kooperativat e konsumit.

Rritja e kafshëve prej 1 për qind është e vogël. Edhe lopët duhet të shtohen më shumë se 13 për qind, sidomos tani që kolektivizimi po ecën me ritme më të shpejta. Shtesën e dhive mendoj të mos ia lemë spontaneitetit. Unë nuk jam kundër dhisë, po të kesh dhi që të mos të japin qumësht, kjo s'na intereson.

Ka rëndësi të përhapet më shumë mishi i derrit. Numri i derrave, nga 250 mijë që parashikohet në plan, propozoj të shtohet në 300 mijë. Kjo do të bëjë që të ndryshojë struktura e ushqimit të popullit në qytete dhe në qendrat e punës, ku mishi i derrit të zërë vendin e parë. Natyrisht, në kohët e nxehta duhet të përdoret peshku e pastaj shpendët dhe mishi i bagëtive të tjera,

kurse në periudhat e tjera të vitit mishi i derrit duhet të zëvendësojë llojet e tjera të mishit. Jam dakord me mendimin që të kemi autofrigoriferë për transportimin e mishit dhe të peshkut.

Detyra për shtimin e derrave duhet t'u shtrohet enteve shtetërore të bujqësisë deri te ekonomitë ndihmëse, duke përjashtuar këtu ndërmarrjet blegtorale. Në sektorët e tjerë të ndryshojë plani i bagëtisë së hollë dhe të zhvillohet sa më shumë derri. Mishi i derrit jo vetëm që duhet të shitet i njomë, por të mendojmë më seriozisht edhe për industrializimin e tij, të ndryshojë gjendja e tanishme, të ketë më shumë nga të gjitha llojet e sallameve dhe këto të jenë më të lira.

Veç kësaj është edhe çështja e rikuperimit të sallos, e cila është shumë e shëndetshme për organizmin. Tani edhe muslimanët kanë arritur ta përdorin sallon si drejt-përsëdrejti, ashtu edhe për të gatuar byreqet etj. Tharjen, grumbullimin dhe shitjen e sallos ne duhet ta organizojmë mirë, sepse shtimi i saj do të zëvendësojë një mungesë të madhe të yndyrnave. Prandaj mendoj që salloja të planifikohet bashkë me yndyrnat.

Në lidhje me shtimin e artikujve ushqimorë mendoj që edhe gjuetia të mos ketë vetëm karakter sportiv, por të organizohet më mirë dhe të ndihmojë për shtimin e të ardhurave dhe për eksport. Të mos mjaftohemi vetëm me rosat e egra ekzistuese, por të krijohen mundësitë që të mbushet vendi me shpendë të gjalla, të cilat t'i ruajmë për një kohë, pse kështu do të sigurohen të ardhura të mëdha.

Jam dakord për të shtuar sipërfaqet e mbjella për kullotat e bagëtive. Në rast se nuk merren masa për

sigurimin e ushqimit të bagëtive, do të kemi humbje. Silloset dhe mjetet e tjera me fondet që disponojmë, më duket se do ta ndihmojnë bujqësinë që, disa sektorë të ndërmarrjeve bujqësore dhe të kooperativave bujqësore, të mos mbeten vetëm në parulla, por të sigurojnë bazën ushqimore për bagëtinë. Ndryshe, tokat që hapim do të mbeten djerrë dhe nuk do të jemi kështu në gjendje të rritim sa duhet bagëti dhe, për pasojë, në bagëtitë e imta do të kemi rënie, pse fshatari është mësuar që t'i kullotë ato jashtë, në natyrë. Por me shtimin e të ardhurave, me shtimin e misrit, ato mund t'i zëvendësojmë me derrat. Pra edhe një herë them se në planet tona duhet të kemi një shtesë më të madhe derrash, duke kompensuar tokat që hapen dhe të krijojmë më shumë fonde drithërash. Është e domosdoshme që kjo të bëhet, pse duhet menduar seriozisht edhe për sigurimin e mishit dhe të dhjavit, për të cilat ka nevojë populli. Prandaj ne nuk duhet të mendojmë vetëm për bukë, po edhe për mish. Këtej del detyra që t'i jepet rëndësi e madhe zhvillimit të misrit, një pjesë e mirë e të cilit duhet të shërbejë për rritjen e derrave.

Në lidhje me rendimentet, unë isha për ato që janë paraqitur në projektplan, po tani bashkohem me mendimin e Hysniut, që ato të ngrihen, sepse, në bujqësi po marrim gjithë këto masa e, po të jetë nevoja, mund të marrim edhe masa të tjera duke shtuar më tej mekanizimet, plehrat kimike, ujin, kuadrot etj., të cilat shpien në arritjen e rendimenteve më të larta në kulturat bujqësore. Ndërsa rendimenti i panxharit, edhe mua më duket se është parashikuar shumë i lartë, prandaj jam dakord me Mehmetin që të ulet. Patatet dhe

fasulet duhet të shtohen pse ato zënë një vend të rëndësishëm si bukë dhe si gjellë për popullin. Shtimi i patates duhet të bëhet një problem i madh dhe kjo të rritet jo vetëm në Korçë, por në të gjithë vendin tonë. Përse të mos e ngremë me forcë këtë problem kaq të rëndësishëm si për të zëvendësuar bukën, ashtu edhe për ushqimin e kafshëve, që të kemi sa më shumë mish? Po kështu, unë mendoj që fasulet të mos i ndajmë nga misri, pse rritja në një vend e tyre është bërë traditë në vendin tonë.

Edhe rritjen e bletës ne duhet ta inkurajojmë, por në këtë drejtim nuk është vendimtare vetëm çështja e kosheres. Nuk është kosherja që e pengon njeriun që ka dashuri për rritjen e bletës. Kryesorja është se ne nuk kemi krijuar kuadro të veçantë për zhvillimin e bletës. Për rritjen dhe shtimin e bletëve kanë dalë shumë libra, po këtë problem nuk e kemi shikuar si duhet. Sipas mjekëve, mjalti është ushqimi më i mirë për fëmijët dhe për pleqtë, ndërsa ne, çështjen e bletëve e kemi lënë si një problem të dorës së dytë, megjithëse kushtet i kemi shumë të favorshme. Prandaj të propagojmë në popull rritjen e bletëve dhe njëkohësisht të krijojmë edhe kuadrot e nevojshëm.

Për çështjet e arësimit jam dakord me Manushin që të realizohet norma e caktuar në Plenumin e Komitetit Qendror të prillit 1955 në lidhje me kuadrin. Nuk mendoj t'i japim aq shumë precedencë arësimit të përgjithshëm, gjimnazeve dhe jo teknikumeve. Ne kemi e do të kemi shumë nevojë për teknikë të mesëm.

Për kulturën, mendoj që planifikimi të bëhet më mirë. Unë nuk them që të ngrihen 300 salla leximi, po

të planifikohen më shumë kinema, ndonjë teatër etj., vepra më të përqëndruara se sa objekte të shumta e të shpërndara. Në fshat aktivitetet kulturele mund të zhvillohen fare mirë edhe për një kohë pranë shkollave. Prandaj të shihet edhe një herë plani i zhvillimit të kulturës. Të ketë më shumë fonde dhe mjete për kërkime arkeologjike. Gjithashtu të japim fonde edhe për të sjellë laboratorë farmaceutikë, si dhe për të blerë vegla.

Mendoj që problemin e importit ta rishikojmë në drejtim të shkurtimit, pse është shumë i madh. Më duket se shumë po importojmë 100 mijë ton pleh kimik, pse ka edhe vështirësi transporti detar. Kjo është tri herë më shumë se pesëvjeçari i parë. Edhe importimi i kamionave është i madh. Mendoj se duhet shtërnguar pak dora dhe të jemi rigorozë në importimin e tyre, sepse shikohet që po sjellim shumë maqina dhe bëhet pak për shfrytëzimin e tyre. Ndërsa vegla këmbimi të sjellim, ndryshe te ne do të mbeten pa u shfrytëzuar shumë maqina. Po të sjellim maqina të reja, atëhere të vjetrat do të hidhen poshtë. Prandaj çështja e kamionave duhet të rishikohet.

Sasitë e yndyrnave, fasuleve, djathit etj., janë të pamjaftueshme. Për këtë arsye nuk është e thënë që në këtë situatë ne të mos importojmë nga këta artikuj. Prandaj në importimet tona ne duhet të bëjmë parashikime sidomos për yndyrna, por edhe për artikuj të tjerë ushqimorë. Një pjesë të importit ta përballojmë duke shtuar eksportin, pse vetëm me kredi nuk ia dalim dot. Përse themi të prodhojmë më shumë hekur? Këtë e bëjmë jo vetëm për të ndërtuar fabrikat e reja, por për të sjellë edhe gjëra të tjera për popullin. Kështu do të krijojmë kushte më të mira për të.

Është me vend mendimi që një sasi e mirë e pjesëve të këmbimit të fabrikohet këtu. Uzina «Enver» kërkon të specializohet sidomos për prodhimin e veglave të këmbimit për transport, por Ministria e Industrisë nuk u përgjigjet kërkesave të punëtorëve dhe të dikastereve të tjerë. Të gjithë kanë gjetur rehat duke e sjellë çdo gjë nga importi, pse ato që bëhen këtu «nuk janë të mira». Por edhe në qoftë se uzinat tona një vegël do ta prodhojnë keq në fillim, nuk duhet t'u mbetet nami që te ne asgjë nuk bëhet mirë. Ky nuk është mendim i drejtë dhe ul moralisht punëtorët tanë. Është në interesin tonë që shumë detale të prodhohen në vend. Kjo çështje duhet të merret seriozisht, pse kemi shumë vjet që e shtrojmë, por tani ka ardhur koha që ta vëmë një herë e mirë në rrugë.

Te ne mund të prodhohen edhe artikuj të pasur me vitamina duke shfrytëzuar materialet e vendit, një pjesë nga të cilat t'i shesin bruto dhe një pjesë t'i përpunojnë. Kështu do të kemi fitime të mëdha. Për këto çështje nuk është treguar interesimi i duhur nga ana e Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme. Në të gjithë Shqipërinë ka një florë të madhe të panjohur, prandaj për ta studjuar e shfrytëzuar nuk është e mjaftueshme vetëm ardhja e ndonjë specialisti nga jashtë, por ne duhet të pregatim njerëzit tanë, të cilët të mësojnë e të hapin punishte dhe në këtë mënyrë të kemi fitime. Po kështu ne mund të dërgojmë jashtë vendit për t'u specializuar kuadro për prodhimin e djathit, gjalpët etj. Ne po hapim baxho, por deri tani jashtë nuk kemi dërguar asnjëri që të specializohet për përpunimin e bulmetrave.

Bilanci financiar i pesëvjeçarit nuk është në rregull.

Siç tha Beqiri, ai nuk duhet të dalë me deficit, por me suficit. Kjo do të thotë të kemi rezerva. Plani ynë duhet të jetë sa më real dhe të bëhen të gjitha përpjekjet që të realizohet. Balancimi financiar me suficit duhet të arrihet duke futur edhe rezervat shtetërore. Pra bazë të mos jetë deficit, por rezervat.

Në këtë mbledhje anëtarët e Byrosë Politike bënë një sërë propozimesh shumë të vlefshme për të përmirësuar planin e dytë pesëvjeçar. Unë mendoj që të caktojme një komision, detyra e të cilit të jetë: rishqyrtimi i të gjitha propozimeve që u bënë këtu për t'ia dhënë Komisionit të Planit të Shtetit, i cili të shikojë mundësinë e rregullimit të shifrave. Rezultatet e kësaj pune t'i paraqiten për t'i rishikuar Byrosë Politike, e cila t'i çojë në Plenumin e Komitetit Qendror. Ky komision duhet të përpiqet të shqyrtojë pikëpamjet që u shfaqën në Byronë Politike si për shembull çështjen e investimeve që janë të mëdha dhe që duhen ulur, përcaktimin e objekteve që duhen ndërtuar, problemet e bujqësisë, të rendimenteve, të shtesave në bujqësi, të grumbullimeve, çështjet e arësimit, të tregëtisë së jashtme, të ndërtimeve të vogla me rendiment të shpejtë ekonomik etj.

Në fund shoku Enver Hoxha propozoi anëtarët e komisionit që do të ngarkohet me studimin e propozimeve të bëra në Byronë Politike.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH.
që gjendet në AQP.*

**FJALA E MBYLLJES MBAJTUR NË PLENUMIN
XVIII TË KQ TË PPSH MBI SHQYRTIMIN E
PROJEKTDIREKTIVAVE TË PLANIT TË DYTË
PESËVJEÇAR DHE TË PROJEKTSTATUTIT
TË PPSH¹**

7 prill 1956

Ne e mbaruam fazën e parë, me dy çështje shumë të rëndësishme, atë të planit dhe atë të projektstatutit. Tani për rëndësinë e planit më duket s'është nevoja të flasim, se këtu u shohit rëndësia dhe të mirat që do t'i sjellë popullit realizimi i tij dhe u vunë në dukje edhe detyrat e Partisë, të cilat do të theksohen edhe në kongres. Por me këto që bëmë këtu, puna nuk është mbaruar. Prandaj për përpunimin e gjithë këtyre gjërave, të gjithë shokët e Komitetit Qendror dhe të qeverisë duhet t'i përvishen punës, të marrin pjesë në diskutimin e

¹ Ky plenum i zhvilloi punimet prej 5 deri 7 prill 1956. Mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga shoku Spiro Koleka mbi planin e dytë pesëvjeçar dhe projektdirektivat e këtij plani për zhvillimin e ekonomisë popullore të RPSH për vitet 1956-1960 si dhe projektstatutin e PPSH që do t'i paraqiteshin për shqyrtim dhe aprovim Kongresit III të PPSH.

këtyre problemeve se si të organizohet ndjekja dhe zgjidhja e tyre nga Komiteti Qendror dhe nga qeveria.

Prandaj propozoj që çështja e përpunimit të këtyre problemeve që thamë, duhet të lidhet me çështjet aktuale, siç janë punimi i tokave dhe mbjelljet. Të dyja këto probleme janë jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë sonë. Por që të zgjidhen këto kërkohet që udhëheqja të mobilizohet tërësisht dhe të braktisë zyrat në një përqindje të madhe, sepse këto tri ditë-pune në plenum ne pamë sa të komplikuar janë këto çështje dhe megjithkëtë akoma nuk jemi në gjendje t'i dimë si duhet. Merrni, pastaj, parasysh bazën, së cilës duhet t'ia bëjmë të qarta këto probleme, të marrim prej saj eksperiencë dhe të japim edhe ndihmën tonë. Partia dhe pushteti në bazë duhet të mobilizohen për këto që thamë, ndryshe nuk do të kemi përfitime të shumta.

Vërejtjet e Byrosë Politike dhe të Komisionit të Planit duhet të na bëhen mësim që tani dhe të mos harrojmë çështjen e mbjelljeve që duhet ta marrim seriozisht, sepse nga këto varet sigurimi i prodhimeve bujqësore. Edhe kontrolli ynë në këtë drejtim duhet të orientohet.

Një problem tjetër me rëndësi është ai i kooperativave bujqësore aktuale që po ngremë. Këto kooperativa, jo vetëm t'i ngremë, po duhet të marrim masa dhe t'i forcojmë. Domethënë jo vetëm të kuptojmë se do të dërgojmë atje 100 ose 200 ish-oficerë që u çmobilizuan, por t'i forcojmë kooperativat e reja bujqësore pa i harruar kooperativat e vjetra. Në mënyrë praktike ne duhet të organizojmë punën për realizimin e detyrave

aktuale që na kanë dalë. Partia të mos e harrojë këtë detyrë, ndryshe do të dëmtohem në drejtim të prodhimit e sidomos do të tronditet besimi dhe dashuria e fshatarit për kooperativën. Vitet që po kalojmë janë vite përfundimtare për ngritjen e kooperativave të reja, si dhe për hyrjen e fshatarëve që nuk janë futur akoma në rrugën e kolektivizimit.

Në çdo rreth ka kooperativa të vjetra, të cilat kanë fituar eksperiencë. Prandaj të organizohet puna që kjo eksperiencë të përhapet. Partia të mësohet që ta organizojë mirë punën në këtë drejtim. Nuk duhet pritur që të dërgohen njerëz të tjerë në kooperativa, por të fillohet nga puna me ata njerëz që janë.

Po e përsëritim edhe një herë çështjen që, me rastin e diskutimit të direktivave të planit të dytë pesëvjeçar, në bazë të mos futet një frymë e tillë që «o burra, ç'të na vijë në kokë t'i kërkojmë qeverisë». Të jeni të sigurtë se këto kërkesa nuk do të pranohen. Për gjëra të tilla edhe në Kuvendin Popullor ne votuam kundër jo se nuk duam, por sepse këto janë miliona. Ju e dini tani planin që çdo gjë është llogaritur shtërnguar, prandaj po të bëni kërkesa në mënyrë të tepëruar, ato nuk do të pranohen. Baza duhet sqaruar drejt për kërkesat që mund të ketë, përndryshe do të krijohet një situatë jo e mirë ndaj Partisë dhe udhëheqjes.

Çdo masë që marrim, këtë nuk e bëjmë për sy e faqe, po për të ndihmuar popullin, por nëse kjo ndihmë që i vete është e vogël, kjo ndodh se aq është fuqia jonë. Të mos kërkojnë p.sh. rrugë për të lidhur kooperativat bujqësore me njëra-tjetrën. Sikur ta bëjnë të tërë këtë kërkesë, nuk kemi mundësi t'ua plotësojmë. Por të lihen

kooperativat kështu siç janë, edhe kjo është e gabuar, prandaj do të ndërtojmë rrugë për t'i lidhur ato me njëra-tjetrën, aq sa të kemi mundësitë.

Ka rëndësi që çështja e planit të kuptohet drejt nga populli, t'i thuhet popullit që të shtojë përpjekjet për të shumëfishuar prodhimin. Prandaj po të ketë ndonjëri propozim në këtë drejtim, atë do ta marrim parasysh duke shkurtuar nga ndonjë sektor tjetër joprodhues. Kjo është njëkohësisht një çështje politike që duhet pasur parasysh.

Gjatë këtij një muaji e gjysmë që na mbetet deri në kongres shokët udhëheqës të Partisë dhe ata të bazës duhet të mendojnë dhe të përgatiten që tani. Kjo përgatitje nuk do të thotë që Komiteti Qendror të përgatitë dy ose tri raporte dhe anëtarët e plenumit të Komitetit Qendror si dhe sekretarët e komiteteve të Partisë të vijnë në kongres me duar në xhep. Prandaj shokët, e në radhë të parë anëtarët e Komitetit Qendror, sekretarët e parë dhe ministrat duhet të përgatiten mirë, po kështu edhe kryetarët e komiteteve ekzekutive. Shokët e bazës duhet të vijnë në kongres me raportet e tyre dhe këto raporte nuk duhet të bëhen të thata, sa për të shkuar radhën. Kryetari i pushtetit, sekretari i parë i komitetit të Partisë ose ministri ose një anëtar i Komitetit Qendror, për çdo gjë që do të flasë, duhet ta lidhë me punën. P.sh. sekretari i parë i një komiteti të Partisë do të raportojë mbi gjithë aktivitetin e Partisë në rreth brenda tre-katër vjetëve, mbi luftën që ka bërë Partia në bazë, mbi sukseset, të metat dhe gabimet, mbi kritikën e punës së tyre dhe të udhëheqjes së Partisë dhe të dikastereve e më në fund mbi propozimet përkatëse.

Pra, kur të flasë një sekretar përpara kongresit të Partisë, ai duhet të raportojë për punën e Partisë në rrethin e tij, në bazë të një analize marksiste-leniniste.

Po kështu duhet të ngrenë probleme për sektorët që drejtojnë edhe ministrat, edhe anëtarët e plenumit të Komitetit Qendror. Edhe këta duhet të përqëndrohen më shumë në punën e tyre.

Raporti që po përgatit Byroja Politike për Kongresin III të Partisë do të paraqitet për shqyrtim në plenumin e ardhshëm të Komitetit Qendror dhe aty do të diskutohet i gjithë aktiviteti i Komitetit Qendror të Partisë. Në këtë mbledhje të Komitetit Qendror do të marrin pjesë edhe sekretarët e komiteteve të Partisë për të diskutuar gjerësisht mbi gjithë aktivitetin e Partisë gjatë periudhës midis dy kongreseve. Raporti do të votohet, por pasi të aprovohet, ai duhet të mbështetet. Mirëpo për të gjitha këto probleme të mendohet që tani dhe të mos pritet sa të vijë 15 maji dhe pastaj të fillojë secili të përgatitë diskutimin; secili të fillojë që tani, menjëherë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MARKSIZËM-LeninIZMI MËSON SE POPULLI ËSHTË KRIJUESI I HISTORISË¹

13 prill 1956

Marksizëm-leninizmi, duke zbuluar ligjet e zhvillimit të shoqërisë, argumenton në mënyrë shkencore se populli është jo vetëm prodhuesi i të mirave materiale, por edhe krijuesi i vlerave shpirtërore, është forca lëvizëse vendimtare e ndryshimeve rrënjësore në shoqëri. Zhvillimi i historisë njerëzore e provon këtë në mënyrë të qartë. Kuptohet, pra, se ngritja e rolit të individëve të shquar mbi atë të masave është e huaj për marksizëm-leninizmin, sepse është në kundërshtim me vetë jetën, ul rolin e partisë e të masave dhe krijon kushte për gabime që dëmtojnë rëndë partinë dhe masat. Marksizëm-leninizmi nuk e mohon rolin e individëve në histori derisa ata i kuptojnë nevojat e shoqërisë dhe me veprimtarinë e tyre lehtësojnë zgjidhjen e problemeve të ecjes së saj përpara. Por, kur individët e shquar, duke e vënë veten mbi masat, fillojnë e shkëputen prej tyre, atëhere krijohen kushtet për gabime që dëmtojnë rëndë masat.

¹ Artikulli i botuar në gazetën «Zëri i Popullit».

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë në korrik të vitit 1954 shqyrtoi çështjen e luftës kundër kultit të individit që i sjell dëme Partisë, pse dobëson besimin e masave në forcat e tyre krijuese, ul rolin e Partisë dhe të udhëheqjes së saj, Komitetit Qendror. Komitetit Qendror dhe gjithë Partisë në praktikë i mbetet për të bërë akoma më shumë për forcimin e udhëheqjes kolegjiale. Zhvillimi i kultit të individit ka rrënjë të thella edhe në vendin tonë. Janë disa faktorë që e ushqejnë atë, si ekzistenca e shumë mbeturinave të feudalizmit e të patriarkalizmit, niveli i ulët ideologjik i kuadrove e i Partisë dhe lehtë mund të shfaqet tendenca për të veshur me fuqi të jashtzakonshme persona të veçantë. Është një detyrë e përhershme e Partisë të luftojë kultin e individit, në çdo formë që të shfaqet ai, dhe të zbatojë kolegjalitetin si një parim udhëheqës i Partisë.

Partia jonë e Punës ka marrë masat për të ngritur rolin udhëheqës të Partisë në gjithë jetën e vendit dhe për të forcuar më tej lidhjet e saja me popullin. Gjatë 15 vjetëve të jetës së saj, duke i qëndruar kurdoherë besnike marksizëm-leninizmit dhe duke i njohur thellë kushtet objektive të zhvillimit të shoqërisë sonë, dëshirat e interesat e popullit tonë, ajo është lidhur ngushtë me masat punonjëse dhe i ka udhëhequr ato në Luftën nacional-çlirimtare e për fitoren e socializmit. Zbatimi i parimeve leniniste në punën e Partisë, respektimi i përpiktë i Statutit që do të aprovojë Kongresi III i PPSH, udhëheqja kolegjiale e Komitetit Qendror, eksperiencia e përbashkët e të cilit siguron përpunimin e drejtë të vijës së saj e marrjen e vendimeve të drejta

dhe zhvillimi i kritikës e i autokritikës, janë masa të domosdoshme për të ngritur rolin udhëheqës të Partisë dhe për forcimin e lidhjeve të saja me masat.

Ne duhet të zhdukim çdo gjë që dobëson demokracinë e brendshme të Partisë dhe prek të drejtat e anëtarit të saj, që krijon frikë për të kritikuar e për të shprehur hapur mendimet. Tani, me rastin e zgjedhjeve, në disa organizata të Partisë është vërejtur se disa shokë, që kanë vende me përgjegjësi në ndërmarrje ose në dikastere, megjithëse kundër tyre nuk janë bërë kritika, nuk kanë marrë votat e shumë komunistëve. Kjo të bën të mendosh se në këto organizata është ngurruar të bëhet hapur kritikë, duke pasur frikë se mos kritika ndaj përgjegjësive ka pasoja për anëtarin e Partisë. Ndoshta në këto qendra pune ka pasur raste që ndonjëri e ka pësuar kur ka kritikuar hapur. Komiteti Qendror i Partisë ka shqyrtuar dhe do të shqyrtojë me vëmendje të madhe çdo rast të tillë të shëmtuar. Por e rëndësishme është që çdo anëtar partie ta kuptojë se në Parti nuk mund të ketë frikë; çdo anëtar partie mund dhe është e domosdoshme të shprehë në Parti mendimin e të kritikojë me forcë të metat në punë dhe ata që janë përgjegjës për këto të meta. Komitetit Qendror i rezulton se disa organizata bazë dhe komitete të Partisë në rrethe e në qarqe nuk shqyrtojnë kurdoherë me dashuri çështjet e komunistëve. Por Partia jonë duhet të dënojë ashpër të gjithë ata që, nën maskën e kritikës, shpifin dhe denigrojnë njerëz të ndershëm e të devotshëm për Partinë e popullin. Shkelja e parimeve leniniste të Partisë dhe vendosja e metodave të komandimit në Parti, të çon në mbytjen e inisiativës së komunistëve dhe të or-

ganizatave të Partisë, në vënien e disa udhëheqësve mbi Partinë, gjë që dobëson rolin udhëheqës të Partisë në masat.

Duhet thënë se disa njerëz në ndërmarrje, në fshatra ose në dikastere, që me forma të ndryshme përpiqen t'i shpëtojnë kontrollit të Partisë dhe që ia arrijnë këtij qëllimi, bëjnë padrejtësi ndaj punëtorëve, fshatarëve e punonjësve të tjerë, kryejnë arbitraritete dhe janë në gjendje të kurdisin shpifje e akuza kundër atyre që nuk u pëlqejnë, duke krijuar kështu edhe në masat një farë frike dhe mënjanimin e tyre nga pjesëmarrja e gjerë në jetën e vendit. Shpeshherë ngjet që këto lloj veprimesh, që s'kanë asgjë të përbashkët me vijën e Partisë dhe e dëmtojnë rëndë atë, maskohen me pretekstin e «luftës së klasave», duke arritur deri në gabime të atilla sa të cilësohet kulak edhe ndonjë fshatar i mesëm, ose t'i hiqet atij triska e Frontit, të quhet armik etj. Është e qartë se veprime të tilla nuk përputhen aspak me zhvillimin e drejtë të luftës së klasave, përkundrazi janë arbitraritete që çojnë deri në shkeljen e të drejtave të qytetarëve.

Përsa i përket luftës së klasave, sigurisht, neve nuk na lejohet të dobësojmë vigjilencën, por ne nuk jemi as për ta nxitur e ashpërsuar atë artificialisht. Komiteti Qendror i Partisë, sidomos këto kohët e fundit, në konferencat e Partisë të rretheve ka sqaruar se kuptimi i ngushtë mbi ashpërsimin e vazhdueshëm të luftës së klasave në kohën e ndërtimit të socializmit nuk është i drejtë. Jeta provon se përherë e më shumë rriten forcat e socializmit, ndërsa shkon duke u dobësuar baza ekonomike e influenca politike e klasave të përmbysura dhe

ato nuk janë në gjendje ta çojnë zhvillimin e luftës së tyre drejt formash gjithnjë më të ashpra. Kjo, sigurisht, nuk do të thotë aspak se lufta e klasave shuhet e vullnetarisht klasat e përmbysura heqin dorë nga lufta kundër socializmit. Pa dyshim, ato ndërrojnë format e luftës së tyre, por kjo luftë nuk është tani më e ashpër se sa që ajo në vitet e para pas çlirimit, kur klasat e përmbysura kishin një bazë më të mirë ekonomike, kishin akoma influencë politike dhe lidheshin e kishin gjithë ndihmën e reaksionit të jashtëm. E vërteta është se në procesin e zhvillimit të kësaj lufte, në vendin tonë janë bërë edhe gabime, duke kaluar edhe në likuidimin ekonomik të një numri kulakësh në fshat. Në raste të ndryshme janë dhënë dënime me akuza të fryra, sidomos në periudhën deri në Kongresin I të Partisë sonë, në nëntor 1948, kur Partia dënoi përpjekjet për të vënë Sigurimin e Shtetit mbi Partinë, për të vendosur metoda policore në Parti dhe për të shkelur të drejtat e qytetarëve duke kryer arbitraritete, persekutime e dënime pa vend.¹ Është e qartë se, me gjithë kthesën që u bë, çështjes nuk i është shkuar deri në fund dhe mbetet shumë për të bërë akoma. Sigurimi u vu nën kontrollin e Partisë, por ka akoma qëndrime jo të drejta nga ana e disa punonjësve të këtij sektori. U rivendos demokracia në Parti, por duhet forcuar akoma ajo, sepse në mjaft raste shkelet. Dhe sidomos ka akoma arbitraritete ndaj disa qytetarëve, që më parë nuk kanë pasur qëndrim të mirë

¹ Është fjala për periudhën e ndërhyrjes jugosllave dhe të kopjimit të formave e metodave trockiste të saj nga ana e grupit të Koçi Xoxes etj.

ndaj luftës së popullit. Komiteti Qendror i Partisë ka marrë masa dhe e gjithë Partia duhet të luftojë për të zhdukur çdo padrejtësi të tillë që është bërë e mund të bëhet, sepse kjo dëmton Partinë dhe ka një efekt të keq, meqë jo vetëm nuk është njerëzore e nxit artificialisht luftën e klasave, por edhe u heq mundësinë atyre që do të donin t'i vinin gishtin kokës e të lidheshin me pushtetin dhe mund të ushtrojë influencë të keqe në disa njerëz të lëkundshëm, të cilët largohen pastaj nga pjesëmarrja e tyre e gjerë në të gjitha çështjet, ashtu si kërkon Partia. Është fakt se qëndrimet e padrejta, si qëndrimet sektare në Frontin Demokratik, goditjet pa vend që u janë bërë disa njerëzve, nuk janë kuptuar gjithnjë nga masat. Ne duhet t'i likuidojmë sa më parë të gjitha këto dhe të ecim përpara, drejt demokratizimit të mëtejshëm të jetës sonë.

Demokratizimi i mëtejshëm i jetës në vendin tonë është një detyrë që shtron me forcë Partia. Pushteti popullor ka siguruar demokracinë e gjerë për masat. Në fakt, te ne është siguruar një pjesëmarrje e gjerë e masave në drejtimin e shtetit, gjë që realizohet me sigurimin e të drejtave të qytetarëve nga Kushtetuta e Republikës dhe me mbrojtjen e tyre nëpërmjet mijëra njerëzve që marrin pjesë në organet e zgjedhura të pushtetit etj. Pushteti ynë popullor krijon të gjitha kushtet për zhvillimin e demokracisë për masat e gjera të popullit punonjës. Për punonjësit demokracia jonë është e plotë, pse pushteti popullor është pushteti i masave punonjëse. Pushteti ynë popullor ushtron funksionet e diktaturës së proletariatit kundër atyre që i bëjnë rezistencë e që do të donin të zhduknin fitoret që ka arritur

populli punonjës me luftën e tij, nën udhëheqjen e Partisë, për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e socia'izmit. Partia dënon dhe do të dënojë përherë e më shumë çdo veprim që cënon demokracinë tonë popullore. Traditat e demokracisë, qoftë edhe formale, në vendin tonë nuk kanë ekzistuar, sepse regjimet shtypëse të së kaluarës nuk e kanë lejuar një gjë të tillë, aq më pak për popullin, por gjatë këtyre viteve pas çlirimit Partia ka zhvilluar një punë të madhe për të ngritur ndërgjegjen politike të masave dhe për të bërë që ato të marrin pjesë gjerësisht në pushtet, në drejtimin e jetës së vendit. Partia ka për detyrë të zhdukë çdo pengesë në zhvillimin e demokracisë për punonjësit dhe për këtë ajo duhet të luftojë kundër shkeljes së ligjeve, kundër veprimeve të paligjshme të disa njerëzve të organeve të pushtetit, kundër hatëreve e privilegjeve.

Në periudhën e ndërtimit të socializmit që kalon tani vendi ynë, në periudhën e një ngritjeje të përgjithshme të ekonomisë e të kulturës popullore, që parashikojnë direktivat e planit të dytë pesëvjeçar, në periudhën e transformimeve të mëdha socialiste në fshat dhe në gjithë jetën e vendit, ku kërkohet pjesëmarrja sa më e gjerë e masave të popullit, ngritja e ndërgjegjes së tyre politike dhe e veprimtarisë së tyre në të gjitha fushat e jetës është jetike. Nga marksizëm-leninizmi mësojmë se roli i masave ngrihet shumë në periudha revolucionare. V. I. Lenini ka shkruar se

«Asnjëherë masa e popullit nuk është në gjendje të veprojë si krijuese kaq aktive e një rendi të ri

shoqëror, sa në kohë revolucionari. Në këto kohëra populli mund të bëjë çudira. . . »¹.

Dhe sa më të thella janë ndryshimet që duam të bëjmë, aq më e gjerë duhet të jetë pjesëmarrja e masave në realizimin e këtyre ndryshimeve.

Po t'i hedhim një sy periudhës së Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë, do të shohim se si asnjëherë tjetër më parë u ngrit në këtë periudhë veprimtaria e masave të gjera të popullit, si asnjëherë tjetër u ngrit ndërgjegjia politike e masave, të cilat nën udhëheqjen e Partisë, morën pjesë gjerësisht në luftën revolucionare që çoi në çlirimin e vendit, në vendosjen e pushtetit popullor dhe në ndërtimin e socializmit.

Po ta shohim këtë çështje sot, në luftën për ndërtimin e socializmit, karakteristika dalluese e kohës është ngritja e gjithanshme e ndërgjegjes politike dhe e veprimtarisë së masave më të gjera të popullit për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës, për gjithë transformimet e thella shoqërore që po bëhen në vendin tonë. Është e qartë se pa pjesëmarrjen e gjerë të masave ekonomia e kultura jonë popullore nuk do të arrinin atje ku kanë arritur. Eksperienca historike e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të demokracisë popullore tregojnë se socializmi rrit shumë veprimtarinë e masave, sepse punonjësit gëzojnë liri të plotë dhe frutet e punës së tyre, prandaj lindin shumë inisiativa, ngrihen aftësitë krijuese të masave, dalin talente të mrekullueshme, zbulohen energji të pashtershme, të cilat më parë shtypeshin. Nga të gji-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 9, f. 119.

tha këto kuptohet se përpara Partisë del si një detyrë e madhe të heqë çdo gjë që pengon shtimin e veprimtarisë së masave, të zgjerojë punën e saj edukative, në mënyrë që të ngrihet ndërgjegjia e masave dhe të rritet veprimtaria e tyre.

Ne gjendemi përpara Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë, ku do të aprovohen edhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar. Projektdirektivat parashikojnë që më 1960 prodhimi industrial të rritet 98 për qind në krahasim me vitin 1955, që të prodhohet gjithë buka në vend, që paga reale e punëtorëve të rritet rreth 23 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë të rriten rreth 38 për qind. Këto janë detyra të mëdha, për realizimin e të cilave duhet të ngrihet akoma më shumë veprimtaria e masave. Të jetë e qartë se pa pjesëmarrjen akoma më të gjerë të masave, këto detyra nuk mund të realizohen me sukses. Duke qenë se jemi përpara Kongresit III të Partisë, Komiteti Qendror po përpunon konkretisht problemet shumë të rëndësishme që do t'i paraqiten kongresit mbi të gjitha këto çështje. Diskutimi i gjerë krijues që do të bëjnë Partia dhe masat në lidhje me projektin e Statutit të Partisë dhe projektin e direktivave të Kongresit III për planin e dytë pesëvjeçar do t'i japë një ndihmë të madhe Kongresit III të Partisë për të marrë vendime sa më të drejta, për ta çuar më përpara vendin tonë në rrugën e fitoreve të socializmit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 90 (2359), 14 prill 1956

Botohet me shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**ATA QË NUK E DUAN TË MIRËN E PARTISË NUK
DO T'I LËMË TË VEPRËJNË. PARTINË DUHET
TA MBROJMË**

*Fjala e mbajtur në Konferencën e Partisë të qytetit të
Tiranës për dhënie llogari e zgjedhje*

15-16 prill 1956

Shokë,

Të më falni që nuk erdha më parë, pse nuk kam qenë këtu. Vendosa të vij, sepse dëgjova që kjo konferencë është ca si e elektrizuar. Këtu janë bërë kritika ndaj udhëheqjes dhe kjo nuk është gjë e keqe. Te ne ka shumë anë të mira, po ka edhe disa dobësi, që ne të gjithë së bashku duhet të përpiqemi t'i zhdukim. Partia jonë duhet të karakterizohet nga fryma luftarake për të gjitha problemet, pse vetëm kështu ato do të zgjidhen në rrugën e drejtë. Por duhen pasur kurdoherë parasysh shtrembërimet, se ju e dini që kur nxehen gjakrat, edhe fjalët nuk zënë vend. Sigurisht, është më mirë që çka kemi të rrokullisen brenda Partisë se sa të thuhen jashtë saj.

Në fillim dëshiroj të theksoj disa çështje parimore, të cilat nuk duhen harruar kurrë, sepse ka edhe shokë që, megjithëse i dinë përmendësh si formula këto parime, kur vjen çështja për t'i zbatuar në jetë, bëjnë gabime.

Në radhë të parë e kam fjalën për atë që çështjet e Partisë nuk duhet të bëhen asnjëherë çështje rruge. Në Parti, çdo komunist, ka plotësisht të drejtë të bëjë pyetje, bile në rast se nuk e bën një gjë të tillë, është gabim, po ai duhet njëkohësisht t'u japë edhe një zgjidhje të drejtë problemeve, kurdoherë, me qëllim që puna të ecë përpara, që gabimet të ndreqen.

Çështja e demokracisë duhet kuptuar mirë. Te ne kjo demokraci duhet të jetë efektive. Demokraci në Parti do të thotë që të gjithë komunistët kanë të drejtë të shprehin mendimet e tyre. Po nuk përjashtohet që ka edhe njerëz, të cilët bëjnë kritika jo me frymë partie. Ndaj këtyre Partia duhet të jetë kurdoherë vigjilente. Mos harroni se në disa kthesa, mjaft elementë, që kanë çaluar gjatë gjithë jetës së Partisë, nxjerrin brirët. Përpara gabimeve këta mbyllin gojën, nuk kanë kurajën të flasin dhe për këtë faji nuk është i Partisë, por i vetë atyre, që tregohen servilë përpara përgjegjësve dhe, kur vjen puna të përdorin votën, të drejtë që ua ka dhënë Partia, ata kanë votuar kundër udhëheqjes, megjithëse në realitet nuk kanë bërë asnjë farë kritike. Ka të tjerë që kanë kryer faje gjatë rrugës së Partisë. Ata tani mendojnë se u bë deti kos dhe «të gjitha fajet tona, o burra, të lahen, të fshihen». Edhe këta janë në rrugë të gabuar. Ka edhe disa që, në jetën dhe në praktikën e tyre kanë shkëlur rregullat e Partisë dhe, kur shohin një situatë që nuk është e shëndoshë, bëhen

mbrojtësit më të flaktë të marksizmit. Këta janë marksistë pas akshamit dhe ndaj tyre Partia duhet të jetë shumë vigjilente.

Mund të ketë ndonjë komunist që thotë se «kjo ose ajo detyrë nuk është kryer», se «në punën drejtuese të Partisë ka të meta» etj. etj. Udhëheqja e shëndoshë e Partisë kritikën e gabimeve të saj duhet ta presë me ballë hapët. Atje ku janë vërtetuar gabime, ne nuk kemi frikë nga kritika që zhvillohet, por kur disa elementë kërkojnë t'u atribuojnë komunistëve, udhëheqësve ose drejtuesve të ndryshëm, faje që nuk i kanë, të jenë të sigurtë se do të marrin përgjegjen e merituar nga çdo anëtar partie dhe kjo nuk duhet të konsiderohet aspak si mbytje e kritikës, si prerje e inisiativës, si shkelje e demokracisë, sepse çdo komunist e ka për detyrë ta mbrojë me vendosmëri vijën e drejtë të Partisë.

Kur bën autokritikë një komunist? Sigurisht kur ka kryer një gabim. Dhe kur s'bën gabim, nuk ka pse bën autokritikë. Në qoftë se udhëheqja ka gabuar dhe këtë nuk e njeh, atëhere thuaja që ti ke gabuar. Kjo është metoda më e drejtë marksiste. Në qoftë se udhëheqja nuk të dëgjon, atëhere ajo ka faj.

Unë besoj dhe jam i bindur se nuk ka komunist të vërtetë që t'i kundërshtojë këto parime leniniste, për të cilat gjithë Partia duhet të luftojë, t'i mbrojë ato deri në fund, sepse pa to ajo nuk mund të rrojë. Në këtë frymë le të analizojmë tani disa nga çështjet që u ngritën.

Një nga çështjet për të cilën kanë pyetur disa në këtë konferencë është: A e ka bërë Komiteti Qendror një analizë të thellë të punës së Partisë sonë në dritën

e Kongresit XX? Para se ta sqaroj këtë çështje dua të theksoj që të ruhem nga shablonizmi. Nuk është e thënë që partitë të kopjojnë njëra-tjetrën dhe të veprojnë njëlloj. Te ne, Byroja Politike ka diskutuar dhe e ka analizuar veprimtarinë e vet duke pasur parasysh edhe Kongresin XX.

Këtu u grrit çështja e kultit të individit me të gjitha aspektet e tij. Në lidhje me këtë, përse i përket personit të J. V. Stalinit, janë marrë masa si në Bashkimin Sovjetik e në demokracitë popullore, ashtu dhe te ne. Kjo është një çështje që e ka preokupuar dhe e preokupon Partinë tonë. Po këtu u bë pyetja: A e ka parë te ne këtë çështje Komiteti Qendror në dritën e Kongresit XX? Unë dua ta shpjegoj këtë pak më gjerë.

Kulti i individit duhet parë si nga pikëpamja subjektive, ashtu edhe nga pikëpamja objektive, sepse ai rrjedh nga mbeturinat mikroborgjeze që ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve pavarësisht nga dëshira dhe vullneti i tyre. Kult i individit do të thotë të të pëlqejë mendja jote, të mendosh se ajo që bën ti është më e mirë nga ajo që bëjnë të tjerët, do të thotë të mos i peshosh si duhet njerëzit, të mos dëgjosh zërin e tyre etj. Kështu, ka drejtorë ndërmarrjesh që pa të drejtë pushojnë njerëz nga puna, marrin masa arbitrare; ka sekretarë organizatash bazë që sillen në mënyrë arrogante, ka edhe shokë ministra që nuk sillen mirë me punonjësit, ka sekretarë partie që nxehen, bëhen nervozë. Po pse të nxehen, për ç'arësye? Këto janë mbeturina që krijojnë besim të madh në vetëvete. Njerëz me këto mbeturina të lajnë e të lyejnë dhe fitojnë pozita në Parti.

Kur flasim për kultin e individit kemi parasysh jo vetëm shfaqjet e jashtme, që nuk janë vështirë të duken, por edhe shkaqet e brendshme, objektive dhe subjektive, që kërkojnë një punë të vazhdueshme, të përditshme për t'u kuptuar dhe për t'i luftuar, se kulti i individit është kurdoherë një rrezik, ku më i vogël e ku më i madh ose bëhet akoma më i madh në rast se Partia nuk i hap sytë. Prandaj është e domosdoshme të kuptohet mirë se shfaqjet e kultit të individit nuk çrrënjosen me një deklaratë, me një referat. Në këtë çështje duhet kujdes e pjekuri, sepse armiku do të përpigjet ta kultivojë e ta shfrytëzojë kultin e individit për interesat e tij dhe nga ana tjetër do të derdhë edhe lot krokodili.

Si procedoi Partia jonë në lidhje me kultin e individit? Në raportin e mbajtur nga Hrushovi në Kongresin XX bëhet fjalë se çështja e kultit të individit duhet të shtrohet edhe në partitë komuniste të vendeve të tjera. Partia jonë u kufizua që këtë çështje ta shtrojë në Komitetin Qendror dhe më duket se veprimi në rregull¹. Konferencat që u zhvilluan në lidhje me materialet e Kongresit XX, diskutuan pak gjëra për kultin e individit, bile unë këtu po them një çikë më

¹ Me fushatën e luftës kundër të ashtuquajturit kult të individit, Hrushovi kishte për qëllim që, ashtu si në Bashkimin Sovjetik, të veçonte e të largonte nga udhëheqja elementët e shëndoshë dhe të siguronte shërbëtorë besnikë për të vepruar lirisht në çdo vend. PPSH nuk ra në këtë kurth dhe nuk e revizionoi vijën politike të saj për të përgatitur terrenin e ndërrimit të udhëheqjes, por ajo e dënoi kultin e individit «si një praktikë antimarksiste e të dëmshme».

shumë. Megjithkëtë nuk mund të themi se në këtë drejtim s'ka të meta. Të meta te ne ka, po ka edhe arsëye që i kanë shkaktuar ato dhe kjo duhet të kuptohet.

Është e vërtetë që partia gjermane i lëshoi bateritë për çështjen e kultit të individit, kështu bëri edhe partia poloneze e disa parti të tjera. Bënë mirë ose jo ato parti, le ta shikojnë vetë. Kjo nuk do të thotë se ne s'kemi të drejtë të bëjmë vërejtje në rrugë marksiste, por në radhë të parë ne gjykojmë punën tonë. Siç e thashë edhe te ne ka pasur shfaqje të kultit të individit, po vendimet kryesore janë marrë në mënyrë kolegjinale. Kolegjialiteti në Komitetin tonë Qendror është zbatuar me rigorozitet. Nuk ka vendime të Komitetit Qendror që të jenë marrë nëpër këmbë nga njëri ose tjetri, çdo gjë është vendosur kolegjisht. Megjithkëtë, në propagandën e Partisë sonë, duke kopjuar nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera mike, janë bërë disa teprime, është folur sidomos për personin tim në një shkallë të madhe, janë ndërtuar buste etj. Nuk e them për modesti, po mua personalisht këto nuk më kanë pëlqyer dhe, siç jeni në dijeni, jam shfaqur kundër, sepse kjo e dëmton punën e Partisë. Kur disa nga populli thonë: «Ujët nga lart buron i kulluar, po turbullohet poshtë», ne duhet të shqetësohemi. Sipas tyre të gjitha çështjet duhet t'i shikojë Enveri, se këtu poshtë problemet nuk të zgjidhen si duhet. Pra, gjëra të tilla janë pasojë e shfaqjeve të kultit të individit.

Pyetja tjetër që disave u ka mbetur merak është se si qëndron puna që ndërsa partitë e tjera si në Hungari, Poloni etj., e analizuan edhe një herë çështjen e elemen-

tëve të dënuar, te ne kjo analizë nuk u bë. Ta shikojmë edhe këtë çështje:

Po e filloj me tradhëtarin Koçi Xoxe. Unë mund të them se ka një ndryshim të madh në mes të Koçi Xoxes në Shqipëri dhe Rajkut në Hungari. Siç thuhet, procesi kundër Rajkut paska qenë i kurdisur dhe është kështu apo jo, kjo është punë e tyre. Koçi Xoxe, veprimtarinë e tij armiqësore, fraksionin në kokë të Partisë, e ka filluar që në vitin 1944, përpara çlirimit të Shqipërisë. Në Berat ai dhe njerëzit e fraksionit të tij goditën unitetin e Partisë, vijën e saj. Partia u quajt prej tyre si një Parti Komuniste jo e vërtetë, me një vijë dhe udhëheqje jomarksisteleniniste, që ka ndjekur një rrugë plot gabime dhe shtrembërime, që luhatej nga sektarizmi në oportunizëm dhe anasjelltas!

Pas çlirimit Koçi Xoxe vazhdoi punën armiqësore kundër Partisë. Ai mori pozita në Parti, futi në radhët e saja dhe në udhëheqje njerëz oportunistë, të dobët politikisht, karrieristë, duke dobësuar kështu unitetin në Parti dhe në udhëheqje. Në gjirin e udhëheqjes filloi një luftë fraksioniste, karrieriste, antimarksiste nga ana e Koçi Xoxes, Pandi Kristos e Sejfulla Malëshovës. Po asnjërit prej tyre nuk iu realizuan qëllimet e errëta. Qëndrimi konsekuent dhe lufta e Partisë bëri që ky fraksion të çahet.

Siç e dini, në punën fraksioniste të Koçi Xoxes, ishte pleksur edhe Nako Spiru, i cili, megjithëse kishte bërë një kthesë dhe mbronte vijën e Partisë, nuk pati guximin ta zbulonte haptazi veprimtarinë e vet dhe të pjesëtarëve të tjerë të grupit fraksionist të Koçi Xoxes. Ai vrau veten dhe i dha kështu një armë Koçi Xoxes.

Më vonë u zhvilluan punimet e Plenumit VIII të Komitetit Qendror, që i hapën rrugën arbitraritetit dhe Partia e kuadrat u vunë nën vëzhgimin e sigurimit, gjë që pati pasoja të rënda, për të cilat nuk është nevoja të zgjatemi, sepse këto çështje janë sqaruar gjerësisht në Plenumin e XI të Komitetit Qendror dhe në Kongresin I të Partisë.

Dua të theksoj edhe këtë se në çështjen e Koçi Xoxes, Partia jonë ka qenë shumë gjakftohtë dhe tepër e matur. Shumë njerëz ishin implikuar me punën e Koçi Xoxes. Megjithkëtë, disa prej tyre thonë se «nuk kemi bërë gabime».

Shokët që e duan Partinë i kanë njohur mirë gabimet, prandaj Partia u ka dhënë e u jep besim dhe i respekton, se kanë qëndruar në vijën e saj. Mund të them se një nga këta shokë është Kristo Themelko. Kur mori dekoratë, ai më tha: «Shoku Enver, kam menduar se nuk ia kam larë akoma Partisë». Ja qëndrim i ndershëm partie. Partia, pra, nuk i ka zënë njerëzit me gurë, përkundrazi i ndihmon që të ndreqen.

Të marrim Tuk Jakovën. Nuk jam dakord me Vandush Vinçanin, i cili kërkon të rishikohet çështja e tij. Ju mund ta rishikoni, shoku Vandush, kjo është çështja juaj. Për ne ky problem është i qartë. Bile Komiteti Qendror është treguar shumë zemërgjerë për Tuk Jakovën e Bedri Spahinë dhe, megjithatë, prapë Tukun nuk e përjashtoi nga Partia. Komiteti Qendror i dha edhe një herë dorën, po organizata bazë e përjashtoi dhe sipas pikëpamjes sonë bëri mirë, sepse qëllimet e tij nuk ishin aq të thjeshta. Për Tukun nuk ishte hera e parë që binte në gabime. Atij i ishte rritur mendja. Tuku fliste

gjoja për kultin e individit, për fotografitë e shokëve udhëheqës dhe të të tjerëve, po hallin e kishte për vete. Qëllimi i tij ishte revizionimi i gjithë vijës së Partisë, si për shembull kërkesa për të rishikuar vlerësimin e veprimtarisë së grupeve, që u ngrit edhe këtu. Kush është ai veç Tukut, i cili, 14 vjet pas formimit të Partisë, del e të thotë tani se nuk është vlerësuar tamam Grupi i Shkodrës, se duhet të thuhet më shumë për të etj. Kjo do të thotë se Tuku nuk është në rrugë partie, po mendon vetëm për kokën e tij. Këto gjëra janë shpjeguar në gjithë Partinë me kohë, atëhere unë kam të drejtë të kërkoj përse shoku Vandush Vinçani ngre këtu që të shihet çështja e Tuk Jakovës?

Po Manol Konomit çfarë t'i analizojë Komiteti Qendror? Ai ka kërkuar disa herë dorëheqjen nga detyra e rëndësishme e ministrit të drejtësisë! Cili është ai komunist që pasi i jepet një vend me rëndësi kërkon dorëheqjen? Një njeri i tillë ka frikë nga përgjegjësia. Ose të marrim Abedin Shehun. Ai me shokë kanë dashur të godasin udhëheqjen, unitetin e Partisë. Atëhere si t'i mbajë Partia në Komitetin Qendror këta njerëz? Po Partia është treguar e durueshme dhe e matur ndaj njerëzve të tillë. Ne mendojmë se vendimet që janë marrë kundër tyre kanë qenë të drejta në parim dhe në praktikë dhe nuk ka përse t'u kthehemi e t'i analizojmë përsëri vendimet që kemi marrë.

Vendimet që janë marrë për Tukun, Abedin Shehun etj., kanë qenë të drejta. Këtë e thonë edhe të gjithë njerëzit e shëndoshë, që përbëjnë masën dërmuese të Partisë. Por ka edhe elementë të tjerë që duan të përfitojnë nga ujërat e turbullta, siç ndodh në organiza-

tën bazë të Partisë pranë Ministrisë së Industrisë, ku Pajo Islami ngre çështjen se janë apo jo të drejta dënimet që janë dhënë nga Komiteti Qendror. Po të isha unë në atë organizatë do të thoshja se përderisa Komiteti Qendror nuk na ka thënë ndonjë gjë të re, është e qartë se vendimet e marrura deri sot janë të drejta dhe ti, shok, që ngre këtë çështje në organizatën bazë, pa na thuaj, për cilin e ke fjalën, ç'mendon ti, cilat vendime nuk kanë qenë të drejta? Kështu organizata bazë do të luftojë ta sqarojë problemin dhe pastaj të vijë këtu në konferencë delegati i saj, se shokët folën dhe bënë pyetje gjoja në emër të organizatave bazë. Do të ishte më mirë të thoshin që «organizata bazë e Partisë ku unë bëj pjesë, pas një analize të hollësishme, ka arritur në këto konkluzione». Kështu do të mësonte edhe Komiteti Qendror. Po të diskutohej më parë në organizatën bazë, pyetjet do të shoshiteshin mirë dhe atëhere ato do të katandiseshin pak e, në këtë konferencë, do të vinin pyetjet e drejta. Jo vetëm që kjo nuk është bërë në këtë mënyrë, por këtu pati edhe pyetje që gjoja i bën organizata bazë, kurse në realitet ato pikëpamje i shfaq një anëtar partie.

Tani të vijmë në çështjen jugosllave. Ne kemi thënë dhe do të themi që Partia jonë me atë jugosllave kanë pasur marrëdhënie të mira që përpara çlirimit, të cilat më vonë u shtrembëruan nga ana e udhëheqjes jugosllave. Partia jonë është përpjekur deri në fund, që të ruhej miqësia me Jugosllavinë dhe marrëdhëniet me të. Këtë e dëshmojnë të gjitha dokumentat zyrtare që ka Komiteti Qendror dhe qeveria. Fakti është se marrëdhëniet tona tregëtare me Jugosllavinë janë zgjeruar

dhe vitin që vjen ato do të shtohen edhe më shumë. Mund të grijë një farë Hulusi Spahiu në legatën jugosllave, që flet kundër Partisë sonë, dhe, kur merren masa kundër tij, ai thotë: «po persekutohem». Në legatën jugosllave kishte njerëz që e dëgjuan dhe i thanë: «ngadalë, ç'bën ashtu», por ai në vend që të heshtë, tha: «do flas haptazi». Anëtarët e Partisë që e dëgjuan, që në mëngjez erdhën menjëherë dhe ia thanë Partisë. Në qoftë se edhe Nesti Zotos¹ nuk i mbushet mendja, sepse sipas tij nuk po ecet shpejt në përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, le të na thotë se ç'duhet bërë më shumë? Sugjerimet me vend janë kurdoherë të mira. Fakti është se përpjekje po bëhen, po këto çështje nuk varen vetëm nga ne, kanë dhe ata pikëpamjet e tyre, planet dhe dëshirat e tyre.

Shoku Vandush Vinçani ngriti edhe një problem tjetër, atë që në Komitetin Qendror të mos jenë burrë dhe grua. Ne jemi komunistë dhe duhet ta shohim edhe këtë çështje drejt. Është e vërtetë se kur unë i bëj kritikë shoqes sime që është anëtare e Komitetit Qendror, natyrisht ajo pikëllohet, por kur ia bëj kritikën një shoqeje tjetër partie, edhe ajo pikëllohet dhe ndoshta e ndjën më thellë, kurse me shoqen time mund të mos ndodhë kështu dhe ka rrezik të zbutet një çikë puna. Në Komitetin Qendror nuk duhet të krijohet një frymë familjariteti. Pra, kjo që ngrihet në parim është e drejtë, po të mos harrojmë se në fakt, në Komitetin

¹ Në Konferencën e Tiranës, ishte një nga përkrahësit e ideve revizioniste të elementëve antiparti. Si i tillë u përjashtua nga Partia.

Qendror ka kritikë dhe autokritikë të fortë edhe ndaj shoqeve, edhe ndaj shokëve dhe nuk ka ndonjë shenjë që të tregojë hatër. Megjithatë them që edhe në Komitetin Qendror duhet të ketë akoma më shumë kritikë dhe sidomos autokritikë. Po bashkë me këtë, duhet kuptuar edhe ana tjetër. Ne tani i kemi këto shoqe në Komitetin Qendror dhe ato nuk janë zgjedhur nga Partia për ne ose për sytë e tyre të bukur, por se e kanë merituar, se edhe ato kanë luftuar dhe kanë punuar. Për këto arsye i ka zgjedhur kongresi. Në rast se ato e meritojnë besimin për të qenë anëtare të Komitetit Qendror, kongresi i ardhshëm i Partisë le t'i zgjedhë, atje do të bëhet biografia dhe do të vlerësohet aktiviteti i tyre. Po nuk është e drejtë që shoqet që janë tani në Komitetin Qendror t'i heqim.

E drejtë dhe e domosdoshme është që Komiteti Qendror i ri të zgjerohet më shumë me elementë të klasës punëtore. Këtë duhet ta vëmë në zbatim. Më kanë thënë se nëpër konferencat e qarqeve ka mjaft rezistencë për të zgjedhur në udhëheqje shokë të rinj punëtorë. «I mirë është ky, thonë ata, po nuk është i ngritur». Le të mos jetë i ngritur, shokë, ne duhet ta rritim atë, pse Partia jonë nuk do të rrojë pesë ose dhjetë vjet. Ne duhet të punojmë me perspektivë, puna kolegjiale e Partisë do ta mësojë shumë shpejt edhe atë që sot ndoshta s'është shumë i zoti, por që i ka të gjitha të dhënat të ecë përpara, atë që ka pak fjalë e shumë punë dhe e mbron Partinë deri në fund.

Përsa u përket çështjeve të tjera, siç janë ato ekonomike, të bujqësisë, të industrisë etj., Partia jonë i ka shtruar të gjitha dhe mendoj se nuk i ka lidhur keq

me jetën dhe detyrat praktike që dalin për zhvillimin e vendit tonë në rrugën e socializmit. Por me sa kam kuptuar unë, disa njerëz në këtë konferencë, sidomos dje, nuk i kanë ngritur drejt këto çështje. Me këtë s'dua të them se nuk duhet të shtrohen disa probleme ose pyetje për mungesat tona, po çështja është se disa njerëz, duke diskutuar janë kufizuar vetëm me këto. Në qoftë se janë të vërteta fjalët e tyre se te ne ka varfëri të madhe në popull, më duket se është e drejtë të rrihen problemet edhe se si të zhduket kjo varfëri, se vetëm Partia është ajo që duhet të marrë masat për ta zgjidhur këtë problem të vështirë dhe askush tjetër, as një, as dy vetë.

Këtu u ngrit pyetja nëse e di udhëheqja gjendjen e mjerueshme të popullit apo jo. Shtruarja e çështjes në këtë mënyrë nuk është e drejtë. E para, udhëheqja e di mirë gjendjen, bile mund të themi se e di më mirë nga ata që e bëjnë këtë pyetje dhe, gjendja e popullit nuk është e mjerueshme, si thonë ata njerëz, të cilët gabojnë rëndë. Sigurisht, nuk mund të themi se gjendja ekonomike te ne është e shkëlqyer se do të gabonim përsëri. Partia kurrë nuk ka thënë se bollëku mund të krijohet pa luftë, pa përpjekje, pa vështirësi. Të mos harrohet gjithashtu se ku kemi qenë dhe ku jemi. Ka ndryshim jashtëzakonisht të madh, sukseset janë të shumta. Kush e mohon këtë, ai gabon rëndë. Po që të arriheshin këto suksese, që të mund të kishim bezen tonë do të bëheshin edhe shpenzime; që të punonin të gjitha fabrikat e ngritura, duheshin ndërtuar edhe hidrocentrale. Prandaj zhvillimi e përparimi i vendit tonë ka kërkuar të bëhen sakrifica, të cilat populli i pranoi,

se ishte i sigurtë që jeta e tij do të përmirësohej. Dhe në fakt jeta është përmirësuar, sukseset tona janë të mëdha. Këtu u tha pse të bëhen këto menjëherë. Është e vërtetë se heqja e triskave mund të bëhej edhe me etapa për të mos rënduar jetën e punonjësve, por të mos harrojmë se kjo masë është një fitore e madhe, se përveç të tjerave, ne likuiduam çmimet e tregjeve të ndryshme dhe u futëm në rrugën normale të çmimeve.

Masat që u morën për kategorizimet dhe normat ishin shumë të drejta. Mundet që disa punëtorëve u ka ardhur hidhur se ranë nga kategoria që kishin dhe nuk marrin më sa përpara, kur shpërblimi i tyre nuk ishte në baza socialiste. Në socializëm sa jep, aq edhe merr. Këto masa, pra, kanë prekur një numër punonjësish, po ato duheshin zbatuar se ishin të drejta. Pse ishte krijuar një situatë e tillë ku një punëtor i ri, që s'kishte shumë kualifikim, të merrte sa një punëtor me stazh më të gjatë pune dhe me aftësi më të mëdha teknike? Këtë situatë nuk e krijuam me dashje. Ne kemi pasur librezat të caktuara për normat dhe kategorizimet. Janë vendosur rregulla se si duhet të kalojnë njerëzit nga një kategori më e ulët, në një më të lartë nëpërmjet punës dhe provimeve. Po këto rregulla nuk u zbatuan si duhet, në radhë të parë nga organet e Partisë, pastaj dhe nga organet shtetërore. Po pse? Mos vallë deshën shokët tanë të Partisë dhe të pushtetit të ishin hovardarë? Natyrisht, jo. Po atëhere e tillë ishte situata dhe s'mund të veprohej ndryshe. Dihet se në atë kohë ne nuk kishim krahë pune, vinte ai tjetri fare i ri, 17-vjeçar nga fshati dhe kishte raste që i jepej menjëherë kategoria e pestë. Sot, që kushtet kanë ndry-

shuar, a do të lejojmë më që ky djalë 17-vjeçar, që posa ka ardhur nga fshati, të marrë njëllë sa një mjeshtër nga Golloborda, që i ka rënë bretku në zanat dhe që bën punë speciale? Këtë ne nuk mund ta lejojmë më. Ja që rregullimet në kategorizime janë të drejta.

Edhe çështja e heqjes së triskave deri në një farë mase e ka rënduar jetën e disa kategorive punonjësish. Që të mos vazhdonte më ajo gjendje e vështirë, ne duhet të jepnim kompensim të plotë, pra më shumë të holla, gjë që do të shkaktonte inflacionin dhe ngritjen e çmimeve nga ana e fshatarësisë. Prandaj morëm parasysh që të bënim një kompensim vetëm për punëtorët dhe nëpunësat me rrogë deri në 12 000 lekë, por jo edhe për pjesëtarët e familjeve. Për rrogat më të larta ne nuk dhamë asnjë kompensim. Pastaj menduam të ndjekim rrugën e uljes së çmimeve. Në fakt është vendosur ulja e çmimeve deri në një miliard e gjysmë lekë. Po a e kompensojmë të tërë deficitin? Jo. Nga llogaritë që kemi bërë do të duhet edhe një tjetër ulje çmimesh që të vijmë në situatën ku ishim në fund të vitit 1955 dhe këtë do ta bëjmë në vitin 1957. Kemi menduar që ulje çmimesh të bëhen herë pas here. Ngritja e nivelit të jetesës në lidhje me pagat me norma në vitin 1960 do të arrijë mesatarisht 23 për qind. Por deri atëhere, përveç kompensimit, punëtorëve do t'u rritet më shumë paga reale dhe me rrogën që do të marrin ata, në fund të pesëvjeçarit të dytë do të blejnë mallra shumë më tepër se 23 për qind. Për nëpunësit ky përfitim do të jetë shumë i paktë. Po natyrisht Komiteti Qendror dhe qeveria këtë çështje do ta shohin dhe do të marrin masa.

Dihet se shumica e popullit tonë përbëhet nga fshatarësia. Të thuash se fshatarësia te ne është në gjendje të vajtueshme, do të thotë të sjellësh këtu dhe të përhapësh parullat e Radio Londrës, të «Zërit të Amerikës» etj. Nuk është ashtu realiteti. Natyrisht, fshatarësia jonë nuk rron në bollëk të madh, po jeta e saj është shumë më e mirë nga ç'ka qenë më parë. Një ditë më tregoi një shok se një gazetar «kompetent» i kishte thënë: «Nuk është mirë që Komiteti Qendror të përcaktojë në projektdirektivat e planit të dytë pesëvjeçar detyrën që ta bëjmë bukën medoemos në vend». Ja, «argumentonte» ai, edhe Polonia e blen bukën. Ky gazetar nuk është fare në të. Ne kemi 10 vjet që po importojmë disa milion rubla bukë në vit dhe megjithatë, mund të themi se nuk ka vend në botë që ta shesë bukën aq lirë sa e shesim ne. Për të sjellë bukën, ne kemi shpenzuar çdo vit gjysmën e devizës në rubla, llogaritni pastaj sa materiale të tjera na duhen për sektorët e ndryshëm të ekonomisë, atëhere ç'duhet të bëjmë për të përballuar situatën? Tuk Jakova na thoshte se «nafta është e paleverdisshme, prandaj duhet mbyllur!»! Le që nafta nuk është e paleverdisshme, po me gjithë leverdinë që ka, ne prapë jemi të detyruar të sjellim miliona lekë karburant, ndryshe nuk ecën ekonomia jonë. Sikur të bënim siç na thoshte Tuk Jakova, ose si ai gazetari që përmenda, lumi që na mori. Na doli edhe një i mençur në Kërrabë dhe na thotë se «nuk shkon mirë situata ekonomike, më lini mua një muaj në krye të qeverisë dhe të shihni». Po në qoftë se ai është kaq i zoti ne e lëmë jo një muaj, po një vit e më shumë.

Zhvillimi i ekonomisë dhe përmirësimi i jetës së

popullit tonë kërkojnë që ne t'i caktojmë vetes detyrë që bukën ta bëjmë në vend. Ne duhet patjetër të realizojmë rendimente të larta dhe të sigurojmë bukën në vend. Kjo detyrë ka mundësi të realizohet. Po kush do ta realizojë këtë detyrë të madhe? Do ta realizojë në radhë të parë Partia. Ne do të sjellim traktorë, do të marrim masa për të tharë kënetat etj., por kryesorja është që t'i kuptojmë drejt detyrat që shtron Partia dhe të mobilizojmë popullin për zbatimin e tyre. Këtë qëllim kanë edhe masat që po merren nga Partia për të vajtur në fshat komunistë dhe shokë oficerë të çmobilizuar, shumë nga të cilët janë treguar e tregohen të gatshëm dhe luftojnë për mirëqenien e popullit. Por ka edhe raste negative. Ja një rast: Isha një ditë në Komitetin e Partisë të Vlorës. Aty takova një oficer, të cilin e pyeta si i kishte punët, çfarë donte. Ai më tha: «Jam kapiten dhe dua punë». Sekretari i komitetit të Partisë më informoi se i kishin dhënë katër vende për të punuar dhe ai nuk shkoi në asnjërin prej tyre. Përpara se të bëhej oficer ky shok ka qenë kasap, zanat tjetër s'kishte. I thanë të vinte përgjegjës i një dyqani, po ai u përgjegj se nuk dua të dal deficit e të futem në burg. Mua atëhere nuk m'u durua dhe i thashë, shko shpejt në dyqan. Një tjetri i kanë thënë të punojë në depon e Kombinatit të Tekstileve «Stalin» dhe ai gjithashtu nuk shkoi. Një ditë një tjetri i thashë: «Po ç'të bëjmë me ty, more djalë?» Dhe ai më tha: «Më mbani me rrogë». Kjo do të thotë që oficerët e çmobilizuar të bredhin nëpër pazar, të mos bëjnë asgjë dhe të marrin rrogën kot. Natyrisht, ky nuk është mendimi i të gjithë oficerëve, kështu mendojnë vetëm disa elementë

të shkëputur. Këto qëndrime nuk janë të drejta. Ne jemi Parti dhe çështjet duhet t'i kuptojmë e t'i shtrojmë drejt. Nuk jemi dakord me frymën si u ngrit këtu kjo çështje se gjoja Partia i mbajti oficerët sa kishte nevojë dhe tani i çmobilizon e i lë rrugëve. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Oficerët luftuan për atdheun e tyre, për jetën e popullit. Tani Partia u thotë atyre: Shkoni dhe ngrini kooperativat bujqësore, merrni në dorë kamionin ose dyqanin. Këtë thirrje të Partisë ata duhet ta bëjnë realitet si gjithnjë.

Situata te ne, shokë, nuk është e shkëlqyer, po as e zezë nuk është. Duke realizuar planin pesëvjeçar, gjendja jonë ekonomike do të forcohet edhe më shumë. Këtë objektiv do ta arrijmë në rast se do të mobilizohemi si duhet për të zbatuar gjithë detyrat që kemi përpara. Këto që themi të mos i lëmë si parulla dhe fjalë bombastike, po secilit t'i rrahë ndërgjegjia, të mendojë për popullin dhe të thotë se këtë detyrë unë do ta realizoj medoemos. Kritikkat e drejta që bëhen duhet të vihen mirë në vesh nga ne edhe nga ju dhe të gjithë t'i përvishemi punës për të vënë në jetë detyrat e caktuara nga Partia. Ministrat, sekretarët dhe anëtarët e Komitetit Qendror të lidhen më tepër me bazën. Puna e Partisë me masat është një art dhe kjo nuk bëhet as me urdhëra, as duke shkuar në bazë si era. Kritikkat të bëhen hapur, pa drojtje, si vëllezër dhe kur është puna për të kërkuar llogari, të kërkojmë, vetëm duhet të jemi korrektë, të drejtë, bindës, siç thotë Lenini. Për një punë që thuhet një herë dhe nuk bëhet, Partia nuk gabon të jetë e ashpër dhe të kritikojë. Prandaj të kritikohen të gjitha instancat kur nuk kryhen detyrat.

Çështjen e funksionarëve ne duhet ta shohim në frymën marksiste. Partia ka përgjegjësi përpara popullit për kuadrot, që janë një thesar i çmuar për të dhe për popullin. Natyrisht Partia dhe Komiteti Qendror nuk do të lejojnë lukse, por kjo s'do të thotë që të mos tregohet kujdes për shëndetin e kuadrove. Komiteti Qendror duhet të bëjë autokritikë në këtë drejtim se nuk ka punuar si duhet. Është e vërtetë që ka pasur edhe vështirësi, por interesimi për kuadrot nuk ka qenë si duhet, pavarësisht se çfarë thonë disa vagabondë, të cilëve Partia po u tregon vendin. Ne e dimë se cila është gjendja e kuadrove tanë kryesorë, si punojnë, si jetojnë dhe sa lodhen ata. Shumë prej tyre nuk kanë as shtëpi, pa le të kenë edhe ndonjë dhomë të veçantë ku të punojnë. Pse do të ndjekim ne rrugën që na tregojnë armiqtë, të cilët thonë të jemi të tërë njësoj? Jo, në socializëm ekziston parimi «secilit sipas punës», prandaj në rast se ty të takon triska «A», tjetrit i përket ajo e kategorisë «B». Ne as luks nuk lejojmë, as në barazitizëm nuk biem, as shfrytëzim nuk lejojmë, po ndihmë kuadrove duhet t'u japim, gjë për të cilën deri tani kemi bërë pak. Prandaj «kritikat» e armiqve në këtë drejtim të mos na bëjnë që të hidhemi në ekstrem e të mos tregojmë kujdesin e duhur për kuadrot. Komiteti Qendror do të interesohet për kuadrot kryesorë të Partisë dhe të shtetit. Kjo nuk do të thotë se kështu po krijohet një kastë, një shoqëri pasanikësh. Jo, në asnjë mënyrë, Komiteti Qendror do t'u bjerë në kokë shfaqjeve të tilla. Lufta e Partisë ka qenë dhe është që të ngrihet vazhdimisht niveli material dhe kultural i gjithë popullit.

Këtu u bë edhe një pyetje për luftën e klasave. Pa hyrë shumë në teori duhet thënë se nuk është e drejtë të mendohet që lufta e klasave po shuhet dhe që klasat e përmbysura do të heqin dorë vullnetarisht nga lufta. Këtë e ka provuar dhe e provon jeta. Neve nuk na lejohet të flemë mbi dafina, sepse armiku nuk i ka hedhur armët. Sejfulla Malëshova u përjashtua nga Partia, por në rast se ndonjëri del sot dhe thotë pse është marrë në atë kohë kjo masë kundër tij, është e qartë se ai nuk e ka kuptuar drejt çështjen. Kur Partia pas çlirimit kërkonte të formonte sektorin shtetëror të ekonomisë, Sejfulla Malëshova kërkonte të mbronte fabrikantë e tregëtarë si Pogun me shokë; kur Partia shtronte çështjen që tregëtinë e jashtme ta marrë shteti në dorë, ai thoshte ta marrin tregëtarët e mëdhenj, të cilët, sipas tij, jo vetëm që nuk duhen kufizuar, po t'u jepen edhe kredi, si fjala vjen Shefqet Bejës me shokë, që më vonë komplotuan kundër pushtetit popullor. Veç këtyre, Sejfulla Malëshova thoshte që t'i konsiderojmë njësoj si Bashkimin Sovjetik ashtu dhe Amerikën e Anglinë. Po historia e ka provuar se po të bënim ashtu siç thoshte Sejfulla Malëshova, këtu nuk do të kishte Parti të Punës as pushtet popullor, po do të ishin në fuqi Ali Këlcyrët me shokë, me gjithë teoritë e mëdha të Sejfulla Malëshovës. Prandaj çështjet duhet t'i vëmë drejt.

Në drejtim të luftës kundër kulakëve është shkelur direktiva e Partisë, ecet në mënyrë sektare. Parulla e Partisë për «kufizimin ekonomik dhe izolimin politik» të kulakëve është thënë e përsëritur shumë herë, por megjithatë ka raste që në praktikë është zbatuar me

gabime duke u shtrembëruar kështu politika e drejtë e Partisë. Politikisht kulakun duhet ta izolojmë. Atë nuk duhet ta bëjmë, për shembull, kryetar të këshillit popullor të fshatit, por kjo nuk do të thotë që të mos e thërrasim as në një mbledhje të Frontit. Nuk është gabim, bile bën një punë të mirë ai që në disa mbledhje thërrret edhe kulakë, me qëllim që ata të dëgjojnë, ndonjëri edhe mund të reflektojë e të rehabilitohet. Partia do të përpiqet të rehabilitojë çdo njeri derisa të jetë e mundur, por kur ndonjë mbush kupën, t'i tregojmë vendin. Partia ka qenë konsekuente në këtë drejtim. Ajo u bën thirrje për të ardhur në Shqipëri edhe disa njerëzve ballistë, zogistë dhe kjo punë është në vijën e Partisë, atëhere përse të mos përpiqemi të shpëtojmë edhe njerëz të tjerë që mund të shpëtojnë duke i larguar nga rruga armiqësore? Njerëz të tillë ne duhet t'i edukojmë, po jo me dru kokës. Sigurisht, në rast se ndonjëri prej tyre do të përpiqet t'i bëjë varrin shtetit tonë, kundër tij do të veprojnë ligjet dhe gjykatat tona. Prandaj duhet të jemi vigjilentë, po duhet gjithashtu dhe e kemi për detyrë t'i edukojmë dhe t'i bindim ata. Kështu edhe për kulakët. Veç duhet të kemi parasysh që të mos hidhemi në anën tjetër, në oportunitizëm, duke rehabilituar edhe ata që nuk e meritojnë. Rehabilitimi duhet bërë me kujdes, me vigjilencë, jo në grupe, por individualisht, shkallë-shkallë, dalëngadalë. Ka njerëz që pyesin: A i lejohet një komunisti të martohet me vajzën e kulakut? Unë them se nuk bën mirë ai komunist që martohet me vajzën e kulakut. Te ne ka plot vajza të punëtorëve e të fshatarëve që janë të mira, të bukura, të ndershme.

Po deshe, ti merre për grua vajzën e kulakut, po Partia do të të shkruajë në dokumentat e tua se ti nuk e ke të zhvilluar urrejtjen e klasës. Edhe për fëmijët e kulakëve duhet të kemi kujdes, atyre nuk u duhet vënë përjetë damka e babait të tyre kulak, por të bëhet diferencim.

Duke i shtruar kështu këto çështje, unë nuk them se tani ne duhet të heqim dorë nga lufta kundër kulakëve. Çështja është që të mos biem as në oportunizëm as në sektarizëm. E them këtë se ndodhin raste të tilla. Ja për shembull, në një fshat, kulaku kishte një hall dhe shkoi në këshillin popullor të fshatit. Por ç'ndodhi? Meqenëse me kulakun bisedoi kryetari i këshillit, këtij të fundit tani nuk i flet njeri me gojë dhe jo vetëm kaq, por i thonë se do të të heqim triskën e Frontit! Këto gabime nuk duhet të ndodhin, ne duhet kurdoherë të jemi vigjilentë, por kjo s'do të thotë të jemi sektarë.

Unë kisha edhe shumë gjëra të tjera, por ne shokët e Byrosë Politike jemi të bindur se gjërat e vogla ju vetë do t'i kuptoni dhe realizoni. Çështja më me rëndësi është që secili të jetë i qartë dhe ta kuptojë drejt vijën e Partisë. Kjo është e domosdoshme. Në rast se ndonjë çështje nuk është e qartë sa duhet, çdo njeri ka të drejtë ta kërkojë, po kurdoherë në frymën e shëndoshë të Partisë. Këtë e them se disa shokë i kanë marrë punët pak me të nxehur. Duhet thënë të katër të vërtetat në sy, drejt, hapur, por jo të çorientohet konferenca në një kohë kur neve na vihen detyra kaq të mëdha përpara. Çështjet që kritikohen me të drejtë, duhen zgjidhur dhe për këtë kërkohet që të mobilizohemi të gjithë, me të dy duart, se me dekret ato nuk realizohen.

Edhe një herë e përsërit se çështjet e Partisë janë çështje partie, që kanë të bëjnë me parime të rëndësishme politike, ideologjike dhe organizative dhe përbëjnë palcën, kolonën vertebrale të Partisë. Mua më kanë thënë se përjashta kanë arritur të mësojnë se ç'po bisedohet në organizatën bazë të Partisë të Ministrisë së Industrisë. Pra, disa komunistë po i bisedojnë çështjet poshtë e lart, aq sa janë alarmuar edhe disa plaka, të cilat na pyesin: Ç'ka ngjarë në organizatën bazë të Ministrisë së Industrisë?

Në Parti diskutimet të jenë të zjarra, kritika e ashpër, por në frymë të shëndoshë parimore. Sigurisht mendimet e njerëzve me frymë të shëndoshë të Partisë nuk kanë qenë kurrë në kundërshtim me mendimet e veprimet e udhëheqjes dhe ky s'ka qenë një pajtim borgjez. Po ja që ka shokë në këtë konferencë që tani mendojnë dhe thonë: «po dale, si gabuam e u vumë në kundërshtim me udhëheqjen?» Kjo ngjet, shokë, se në disa raste, çështjet dhe diskutimet nuk zhvillohen në frymë të shëndoshë. Veç kësaj dua të theksoj edhe një herë se çështjet e Partisë nuk duhet të bëhen në asnjë mënyrë fjalë pazari. Kur të jenë për pazar, Komiteti Qendror i boton në shtyp. Dekonspirimet, prishja e unitetit të Partisë, mosmarrëveshjet në radhët e saja, në mes të komunistëve dhe të udhëheqjes së tyre, të gjitha këto janë në interes të armikut. Nuk duhet të mendohet se në Parti nuk ka edhe njerëz të lëkundshëm. Por lufta parimore e Partisë, puna në baza të drejta, ose do t'i vërë në rrugë të drejtë këta elementë të lëkundshëm, ose do t'i skartojë, sidomos në këtë kohë qetësie. Komiteti Qendror ka thënë se në këto momente qetësie duhet

me qenë shumë vigjilentë, se në këto momente anëtarë i Partisë, jo i kalitur si duhet thotë: «Pse kjo çështje u bë kështu dhe jo ashtu», «pse ta bëjmë këtë kritikë aq të fortë», ose «hajde tani e të flasim si të duam, se kemi demokraci!» Këto nuk janë pikëpamjet tona si Parti. Ne kemi një demokraci të shëndoshë, shumë më të lartë se demokracia borgjeze; demokracia jonë është e bazuar në marksizëm-leninizmin dhe ne do ta forcojmë atë gjithnjë e më shumë.

Meqenëse u bë vonë, konferenca i ndërpreu punimet e ditës dhe do të vazhdonte të nesërmen. Qysh në mëngjezin e datës 16 prill 1956, shoku Enver Hoxha, në vijim të fjalës së vet tha:

Do të flas pak edhe sot në vazhdim të atyre që thashë mbrëmë. Ne, si kurdoherë, Partisë do t'i flasim hapur. Edhe mbrëmë fola hapur, edhe sot ashtu do të flas, hapur. Unë jam i bindur që ju, anëtarë të Partisë, mbrëmë nuk ju ka zënë gjumi, ashtu sikurse nuk na ka zënë edhe ne. Kjo është e sigurtë, se ju e ndjeni që është dëmtuar Partia nga mënyrat se si u shtruan çështjet në këtë konferencë. Ju e doni me gjithë zemër ndreqjen e gabimeve. Kjo është shumë e vërtetë. Disa nga ju me të drejtë kritikuan dobësi e të meta që janë vërtetuar në punën e Partisë e të udhëheqjes.

Po dua të them se në konferencë ka pasur elementë që kanë mashtruar besimin tuaj ndaj udhëheqjes së Partisë, frymën tuaj të drejtë, që të kritikoni disa gabime dhe të meta të udhëheqjes. Ata kanë mashtruar vullnetin tuaj të drejtë leninist dhe Komiteti Qendror

e ndjeu këtë dhe erdhi menjëherë në konkluzionin se Konferencën e Partisë të Tiranës disa elementë po e çojnë në rrugë të gabuar, në një rrugë kryq. Komiteti Qendror mendoi se kjo çështje do të ndreqet me siguri.

Mbrëmë delegatëve u folëm hapur dhe ata po e kuptojnë se si kanë ngjarë çështjet, se si është realiteti. Po tani që konferenca ka hyrë në rrugën e vërtetë, ajo duhet të thellohet, të gjykojë dhe të zbulojë frymën dhe qëllimet e këtyre elementëve që e çuan konferencën në këtë rrugë.

Komiteti Qendror më ka ngarkuar që ta ndihmoj konferencën në këtë drejtim. Tani, ashtu si mjaft prej jush që i bënë pyetje nga salla udhëheqjes, edhe unë kam të drejtë t'u bëj pyetje disa shokëve «shumë të zellshëm» që janë këtu, që t'i shpjegojnë konferencës pse dhe ç'i shtyu ata të sulmonin udhëheqjen në tërësi. Besoj se e kam këtë të drejtë. *(Të gjithë janë dakord)*. E di që ju i keni të qarta çështjet për të cilat unë do të pyes, po dua të pyes ata «flamurtarët e vërtetë të demokracisë» që folën këtu.

Ne thamë se përse nuk u shpejtuam për ta shtruar në Parti çështjen e kultit të individit, siç u veprua në Bashkimin Sovjetik dhe siç kërkoi këtu shoku Vehib Demi¹. Unë e shpjegoja se udhëheqja nuk duhej të shpejtohej, por duhej të dilte para Partisë me një analizë të thellë marksiste të punës në vendin tonë. A bëmë

¹ Në Konferencën e Tiranës u tregua nga elementët më aktivë kundër udhëheqjes së Partisë. Qëllimi i tij ishte të revizionohej vija e Partisë dhe të rehabilitoheshin Tuk Jakova, Bedri Spahiu etj. U përjashtua nga Partia si element antiparti.

vallë ndonjë krim që nuk u shpejtua? E dini ç'thonë buletinet e lajmeve të Perëndimit, të cilat na i do puna që t'i lexojmë, por nuk rekomandojmë që t'i lexoni, sidomos njerëz si Vehib Demi, që i kanë nervat në cipën e lëkurës? Ato thonë se të gjithë kanë folur për gabimet e Stalinit, kurse Shqipëria, Rumania, Kina, Koreja, nuk po flasin akoma, prandaj, thonë ata, këta janë stalinistë, kundër Kongresit XX. Atëhere vihet pyetja: Cila është arsyeja, shoku Vehib Demi, që të shtyu të ngutesh kaq shumë dhe të akuzosh udhëheqjen e Partisë për gjëra të paqena, ose «pse nuk u shtyp nga ne artikulli i Ohabit»? Cilat kanë qenë arsyet që ti ke arritur në dyshime karshi udhëheqjes së Partisë sonë? Të ngrihesh këtu dhe t'ia thuash konferencës.

Ju e dini se në Rumani, në Kinë, në Kore e në ndonjë vend tjetër janë demaskuar ose janë hedhur jashtë Komitetit Qendror dhe janë dënuar si armiq disa elementë. Lidhur me këtë problem, shokët Vandush Vinçani dhe Nesti Zoto thanë këtu në konferencë se «Partia Komuniste Kineze e analizoi edhe një herë çështjen e këtyre elementëve dhe nxori konkluzionin që ky dhe ai janë dënuar padrejtësisht». Ne nuk e dimë një gjë të tillë, se asnjë nga këto vende nuk na e ka thënë. Po edhe sikur të ishte e vërtetë, kjo u përket atyre, ne nuk kemi pse të kopjojmë të tjerët. Atëhere ç'i shtyn këta shokë që i kërkojnë llogari udhëheqjes se nuk e paska sqaruar Partinë? Në qoftë se nuk është i qartë shoku Vandush Vinçani, të mos e konfundojë Partinë me veten e tij. Por kuptohet se të gjitha këto ai kërkon t'i përdorë si «argumenta» me qëllim që të rishqyrtohet problemi i Tukut etj. Ne kemi të drejtë të

pyesim: Pse shoku Vandush nuk e ngriti këtë mendim qysh atëhere, kur u shtrua kjo çështje në Parti dhe të thoshte se «nuk jam dakord»?

Ç'e shtyu Nesti Zoton që t'i kërkonte llogari udhëheqjes gjoja në emër të organizatës bazë? Këto çështje ne duhet t'i analizojmë dhe t'i shohim se janë jashtëzakonisht serioze. Është interesante të dijë Konferenca e Partisë e Tiranës se ç'qëllime kanë këta elementë, që akuzojnë shtabin udhëheqës të Partisë se nuk po i përmirëson marrëdhëniet me Jugosllavinë.

Përveç këtyre, këtu u bënë edhe një sërë sulmesh kundër udhëheqjes së Partisë lidhur «me shkëputjen nga baza», se «populli vuan», kurse «udhëheqja rron në bollëk të madh» etj. Këto i shpjeguem dje, por çështja ka vajtur deri atje saqë në intervale në ndonjë çerek ore, shokë të organizatës bazë të Komisionit të Planit kërkojnë shpejt e shpejt të bëhet mbledhja e organizatës bazë për t'i rekomanduar konferencës që të pyesë udhëheqjen pse është kjo situatë kaq e mjeruar e popullit! Pa të na thonë e t'i dëgjojë pak konferenca këta shokë se ç'i ka shtyrë të dalin me këto teza?

Me gjithë sqarimet që u bënë këtu në konferencë, hipi në tribunë dhe foli shoku Iljaz Ahmeti ¹. Ai përsëri filloi sulmin frontal kundër udhëheqjes, duke thënë se «kjo udhëheqje po majmet»! Ç'janë këto gjëra këtu në kon-

¹ Element i pakënaqur e karricrist. Me diskutimin e tij thellësisht armiqësor në Konferencën e Tiranës, doli kundër udhëheqjes së Partisë dhe kërkoi rishikimin e vijës politike. Si të tillë konferenca e demaskoi dhe më vonë organizata bazë e përjashtoi nga Partia.

ferencë shoku Iljaz? Nga i ke marrë ti këto të dhëna, që bën hesap se sa shpenzon një anëtar i Komitetit Qendror? Si sekretar i Partisë, nuk të lejoj të na dalësh me kalem në dorë dhe të bësh llogari, se këtu nuk është vendi; në qoftë se kërkon llogari se sa shpenzohet për anëtarët e Komitetit Qendror, këtë mund ta bëjmë nesër, pasnesër. Fjalët dhe llogaritë e tua janë tendencioze, janë për diskreditimin e udhëheqjes së Partisë.

Partia i njeh Iljazit dhëmbë e dhëmballë dhe nuk i zë besë atij. Prandaj do të ishte më mirë që ai të diskutonte për punën e tij, të mësonte atje ku e dërgoi Partia dhe të bënte autokritikë, pasi në jetën e tij ka bërë shumë gabime. Shokët e tij janë vërtet gjeneralë dhe Iljazi akoma major, por kjo nuk është për shpifje, ose për inat, siç thotë ai, kjo ka lidhje me qëndrimet dhe punën e tij.

Kur foli Iljazi para kësaj konference tha se «jam agjent». Tani konferenca ka të drejtë ta pyesë, pse e akuzon veten si agjent ngaqë i hipi «rastësisht» automobilin të një përfaqësie të huaj? Një oficer i Ushtrisë Popullore bie në një gabim të tillë? Prandaj t'i përgjigjet akuzës, që i vuri vetes. Këtë akuzë nuk ia bëri Partia, e cila nuk i ka thënë agjent, se po të ishte i tillë, ai do të ndodhej në burg e jo këtu në konferencë. Unë atë që thashë se Partia i njeh Iljazit dhëmbë e dhëmballë, e them përsëri.

Partia do që t'i ndihmojë njerëzit që kanë qenë shumë të sëmurë, se kjo është në interesin e saj, por kur thotë Iljazi se nuk ka biseduar gjë me Hulusi Spahiun, këtë nuk e beson njeri.

Jo vetëm këto, por shoku Iljaz filloi sulmet edhe

kundër meje duke thënë se Sekretari i Parë i Partisë as që ia ka vënë veshin fare një anëtarë të Partisë. Ai ka dashur të takohet me mua, unë s'e dija përse e kërkon këtë takim, po sikur ta dija se kishte këtë mendje, do ta prisja jo një minutë, por një ditë të tërë. Po ai vajti dhe më tutje dhe tha se «Komiteti Qendror interesohet më shumë për armiqët e popullit që janë të arratisur, të cilët u lejuan të vijin në Shqipëri, për ta bërë edhe komisione, se sa për oficerët e ushtrisë, që kanë derdhur gjakun për interesat e popullit!»! Këtë pikëpamje të shtrembër ai e ka në një kohë, kur tërë Komiteti Qendror dhe qeveria, udhëheqësit kryesorë, e kanë marrë vetë në dorë çështjen e shokëve tanë oficerë, që kanë dalë në lirim, të cilët janë nga shokët më të mirë të Partisë.

Shoku Nj.M. u prek në sedër sepse unë i ndërhyra gjatë diskutimit të tij dhe i thashë «zotrote». Unë nuk desha ta prekja në sedër këtë shok, po fakti është se ia thashë me tallje, ironia në këtë rast nuk është e mirë dhe do t'i kërkoj ndjesë, po unë dua t'i them se ai nuk di ta mbrojë Partinë.

Në qoftë se shoku Nj.M. ngrihet këtu dhe na flet për demokraci duhet të dijë mirë se nuk jam unë, po janë këta elementë që e prishin demokracinë, prandaj ata duhet t'i japin llogari konferencës. Armiqët e Partisë nuk mund t'i lejojmë të veprojnë si të duan. Kjo nuk është demokraci. Ky është provokacion. Unë kam shumë respekt për shokun Neço Konomi. Ai këtu foli shumë mirë dhe bëri kritikë, po ai të mos trembej nga ndërhyrja ime, të mos ketë frikë për të mbrojtur Partinë. Ai nuk është trembur në kohën e luftës dhe është nga

shokët më të mirë që lodhet, përpiqet, organizon punën, prandaj të mos trembet nga ato që thotë shoku Nj.M.

Jam i bindur se këtu ka disa shokë, që thanë se «edhe shoku Enver u nxe». Unë nuk e fillova fjalën time me të nxehtë, po me të butë. Po kur shoh një anëtar partie që vazhdon ta sulmojë udhëheqjen dhe ta turbullojë organizatën, nuk mund ta lëmë të livadhisë. Ata që nuk duan të mirën e Partisë, nuk do t'i lëmë të veprojnë. Partinë duhet ta mbrojmë.

Po cila është kjo udhëheqje që u sulmua këtu? Është ajo udhëheqje që organizoi Partinë, që organizoi Luftën nacional-çlirimtare, ajo që drejton popullin tonë në rrugën e ndërtimit të socializmit, janë ata shokë që i ka zgjedhur Partia jo për sytë e tyre të bukur, po për luftën që kanë bërë. Ndaj kësaj udhëheqjeje është shfaqur vullneti i kongreseve të Partisë. Kurse këta njerëz të sëmurë çdo goditje e drejtojnë kundër udhëheqjes. Mos vallë kjo udhëheqje luftoi për një kile oriz ose vaj, apo për disa kupona, që tha Iljaz Ahmeti? A e dini se ç'thotë shtypi i verdhë? Armiku lëshon vrer e llum çdo ditë kundër udhëheqjes sonë. E ç'nuk thonë armiqtë për ne: «Po rjepin popullin», «e shtypin», «e kanë lënë pa bukë», «populli vuan» e të tjera. Ato që na servir Iljaz Ahmeti dhe njerëz të tjerë kundër udhëheqjes, i thotë përnatë «Zëri i Amerikës».

Pra, kjo udhëheqje këtu u sulmua. Fare lehtë mund t'i bëhej Komitetit Qendror një letër ku t'i thuhej se po ndodhin këto gjëra, prandaj mblidhni veten, merrni masa. Pse këta njerëz i ruajtën këto gjëra derisa të vijë kjo konferencë? Ç'i shtyu ata të veprojnë kështu? Pse, aq kollaj mendonin këta njerëz se do të vihej Partia

kundër udhëheqjes? Sa shumë gabojnë! A mendonin ata se do të gënjenin lehtë gjithë këta bij të Partisë, që marrin pjesë në këtë konferencë, të cilët kanë derdhur gjakun e tyre për Partinë, janë vrarë e kanë pritur në gjokset e tyre shokë të gjakosur nga armiku? Këta njerëz kanë bërë llogaritë gabim dhe dikush i ka shtyrë në këtë punë. Po flitet rrugëve se ç'po ndodh në këtë konferencë. Njerëz të dyshimtë gjatë gjithë jetës së tyre të Partisë po presin në bulevard për rezultatet e kësaj konference dhe janë në sulm kundër udhëheqjes. Çështjet që diskutohen këtu janë bërë llafe pazari dhe këtë e bëjnë pikërisht ata që flasin për familjaritet në udhëheqje. Ata vetë me gratë e në familjet e tyre dhe qosheve të rrugës po i bisedojnë. Me siguri do të dalin shokë këtu që t'i thonë këto gjëra dhe t'i vënë me shpatulla për muri ata që s'ruajnë sekretet e Partisë. Prandaj ju, që po na flisni këtu si bilbila, mos mendoni se konferenca do t'ju lërë të kaloni aq kollaj.

Të flas një çikë tani për sekretarin e Komitetit të Partisë të Tiranës, shokun N.J. Do të shes edhe unë një grosh dituri, se edhe ai i shiti ca konferencës. Në mitologji, drejtësia përfytyrohej me një perëndeshë, që e quanin Denis. Borgjezia atë e ka marrë si simbol dhe i ka bërë një statujë në figurën e një gruaje. Asaj i kanë lidhur sytë dhe i kanë vënë një peshore në dorë. Edhe ky shok, sekretar i Komitetit të Partisë të qytetit të Tiranës, këtu edhe mund të ironizoj pak, po nuk do të kërkoj ndjesë, them se i përngjet Denisit dhe me balancën e tij, ai i peshoi fjalët e shokut Beqir Balluku, anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, që i tha shumë mirë, por që s'u pëlqejnë njerëzve të sëmurë, të

cilët kërkojnë t'i bëjnë varrin Partisë dhe kanë muaj të tërë që po punojnë duke thyer rregullat organizative, duke përgatitur një sulm të padrejtë antimarksist kundër shtabit udhëheqës të Partisë. Këta shokë dhe të tjerë i ka zënë gjumi i rëndë dhe po flenë. Ata i kanë sytë mbyllur.

Kjo situatë e vështirë në këtë konferencë u krijua edhe për shkak se Komiteti i Partisë i qytetit të Tiranës, nuk është treguar vigjilent, ai nuk pa se si po manevronin qysh përpara konferencës disa elementë në dëm të interesave të Partisë. Tani, ti shoku N.J., a i shikon këta njerëz? Ja, kjo është drejtësia e Partisë, po kjo drejtësi nuk e ka shaminë të lidhur në sy dhe në dorë nuk mban një peshore, po mban drapërin dhe çekanin. Partia nuk i mbyll sytë, po i ka si të shqiponjës.

Në gjendjen e krijuar këtu në konferencë edhe shoku Beqir Balluku u vu në pozita të vështira. Shoku Beqir është një punëtor, ka luftuar dhe lufton për Partinë, është nga shokët më të mirë. Unë nuk thashë gjë më tepër nga shoku Beqir, po si pak me gramë më shumë që jam, ndoshta e zbukurova ca më tepër fjalën time. Shoku Beqir nuk e ka ngatërruar aspak konferencën me pikëpamjet e sëmura të disa njerëzve. Jo. Kur ai foli për mendime të dyshimta e kishte fjalën për ata që gabuan në këtë konferencë dhe për të cilët folëm edhe ne të tjerët, prandaj i gjykoni drejt këto çështje, shokë.

Ne menduam edhe një gjë tjetër. Do të ketë njerëz që do të thonë: «Pasi foli këtu shoku Beqir, erdhi foli edhe shoku Enver, prandaj ka unitet në udhëheqje apo jo, apo mos vallë ata nuk janë në një mendje?» Pra disa

elementë të sëmurë do të mendojnë se në udhëheqje nuk ka unitet, kurse e vërteta është se në udhëheqjen tonë uniteti është i plotë. Këtë e thashë se disa flasin edhe për ato që ndodhën në Kuvendin Popullor, ku u ngritën anëtarë të qeverisë dhe anëtarë të tjerë partie e udhëheqës dhe u shfaqën kundër mendimeve të qeverisë dhe të disa udhëheqësve të tjerë të Komitetit Qendror, sikur këta janë kundër përparimit dhe lehtësimit të grave, kurse të tjerët duan demokracinë dhe thonë: «të-mam, kjo është demokraci, një pjesë votoi pro, një pjesë kundër...» Pra sipas shokut Nj.M. kjo është demokraci dhe sipas disa të tjerëve del se këtu nuk ka unitet. Jo shokë, në udhëheqjen e Partisë uniteti është i çelniqtë dhe ky unitet nuk dobësohet nga zhvillimi i kritikës parimore, përkundrazi forcohet dhe demokracia zhvillohet.

Në kushtetutën sovjetike thuhet se formohet grupi parlamentar komunist. Ne nuk e kemi, prandaj le ta studjojmë nëse duhet ose jo ta kemi edhe ne grupin komunist në gjirin e Kuvendit Popullor. Ju e dini se në Parti predominon mendimi i shumicës, çështjet më parë diskutohen, pastaj vihen në votë dhe vendimi që merret, zbatohet nga të gjithë. Këto janë rregulla, që na i ka mësuar marksizëm-leninizmi.

Mundet që ndonjëri, kur diskutohet, të mos jetë dakord me ndonjë çështje, por në praktikë ai duhet të punojë për zbatimin e vendimit të shumicës. Në rast se ndonjëri nuk është dakord me mendimin e shumicës dhe ngul këmbë në pikëpamjen e vet, atëhere mund të shkojë deri në Komitetin Qendror dhe të kërkojë përse nuk është mbajtur parasysh mendimi i tij dhe, në fund,

çështjen e zgjidh Komiteti Qendror e jo njerëzit e rrugëve dhe armiqtë e Partisë, të cilët në këto situata mendojnë se «nuk janë në rregull ata të udhëheqjes, prandaj, o burra, të sulmojmë udhëheqjen dhe ta thellojmë përçarjen». Që nga themelimi i Partisë, ju e dini se ku i ka drejtuar sulmet e tij armiku: për të thyer unitetin e udhëheqjes së Partisë. Edhe sot, ai vazhdon përpjekjet për të likuiduar udhëheqjen e shëndoshë marksiste-leniniste.

Vehip Demi e di mirë se armiku mund të përdorë më lehtë në shërbim të tij elementë oportunistë si Tuk Jakova, por me udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë e ka kufinë te thana. Ne duam të kemi marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimi tregëtar me Jugosllavinë, po interesat e atdheut dhe të popullit janë të shenjta për Partinë dhe udhëheqjen e saj. Dhe kjo ngjet sepse në Partinë dhe udhëheqjen tonë ekziston unitet i çel-niktë mendimi, unitet ideologjik, politik dhe organizativ, unitet të cilin Partia e ka mbrojtur dhe do ta mbrojë me të gjitha forcat, sepse është thesari më i madh, është forca dhe jeta e saj. Po të mos ekzistojë ky unitet, po të dobësohet ai, zhduken të gjitha fitoret e popullit tonë. Prandaj e përsërit edhe një herë se këto që them, nuk kanë të bëjnë aspak me kritikën tuaj të drejtë që i keni bërë udhëheqjes. T'i bëni dhe akoma më shumë kritika udhëheqjes, ne kemi gabime, të cilat duhet t'i ndreqim dhe për këtë kemi përgjegjësi. Po ama ne nuk jemi ashtu si na akuzojnë elementët që përmenda. Prandaj, konferenca duhet të thellohet për çështjet që diskutojmë dhe të marrë vendime, sepse kjo që ngjau këtu në Tiranë, nuk ka ngjarë kurrë në Partinë tonë. Po mos vallë:

Partia është vetëm në Tiranë? Mos vallë të gjithë komunistët e Shqipërisë janë kaq budallenj dhe jo «të zgjuar», si thonë Iljaz Ahmeti, Nesti Zoto, Vehip Demi? Është fakt se anëtarët e Partisë sonë janë shumë më të zgjuar, më të ndershëm e shumë më të disiplinuar, jo raja dhe kur kanë për të kritikuar, kritikojnë pa frikë, ndërsa elementëve të turbullt u turbullohet koka dhe kujtojnë se erdhi momenti i tyre. Ata nuk janë marksistë, nuk janë njerëz me frymë partie. Partia jonë marksiste nuk gabon, janë ata që gabojnë kurdoherë.

Kur filloi konferenca në mëngjez, sigurisht këta njerëz ishin me shpatë të madhe në dorë. Mbrëmë ata thanë: «Mirë, erdhi shoku Enver e dha disa sqarime në emër të Komitetit Qendror, ne do të bëjmë punën tonë, ne do të vemë në organizatën bazë e do të flasim. Në konferencë erdhi udhëheqja dhe bëri autokritikë». Jo, shokë delegatë, nuk duhet vajtur në organizatën bazë si mendojnë këta «miq», duhet të vendosë konferenca se si duhet shkuar në organizatat bazë dhe kjo ngjarje të bëhet një mësim i madh për të gjithë Partinë tonë dhe nga kjo Partia të marrë gjallëri dhe hov akoma më të madh. Ta ruajmë, shokë, si sytë e ballit unitetin e Partisë. Të vëmë të gjitha forcat tona për realizimin e planit të shtetit që t'i plotësojmë popullit më me bollëk çdo nevojë që ka. Për të gjitha këto, në radhë të parë është përgjegjëse Partia. Prandaj kështu duhet të vemë në organizatat bazë.

Kaq kisha për të thënë. Komiteti Qendror është i bindur plotësisht se këto situata Partia i kupton drejt, i kuptojnë drejt edhe gjithë komunistët besnikë dhe

trima, që kanë luftuar dhe vazhdojnë të luftojnë tërë jetën e që janë gati të derdhin gjakun e tyre për çështjen e madhe të Partisë dhe të popullit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Konfe-
rencës së Partisë të qytetit të
Tiranës që gjendet në AQP*

**MBI KREDINË QË QEVERIA E REPUBLIKËS
ÇEKOSLLOVAKE DUHEJ T'I JEPTË QEVERISË
SË RPSH PËR PERIUDHËN 1956-1960**

*Letër drejtuar Byrosë Politike të Komitetit Qendror
të Partisë Komuniste Çekosllovake*

17 prill 1956

**BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË
PARTISË KOMUNISTE ÇEKOSLLOVAKE**

P r a g ë

Të dashur shokë,

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së
Punës të Shqipërisë mori njoftim për letrën¹ drejtuar
Këshillit të Ndhmës Ekonomike Reciproke nga zëven-

¹ Është fjala për një letër që KQ i PKÇ i dërgoi sekretarit të KNER-it në Moskë në të cilën thuhej se kredia prej 50 milion rublash që qeveria çekosllovake duhej t'i jepte qeverisë së RPSH ishte një barrë e rëndë për të.

dësperfaqësuesi i Republikës Çekosllovake, me anën e së cilës ai bën të ditur pikëpamjen tuaj rreth çështjes së kredisë prej 50 milion rublash që Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka kërkuar nga Qeveria e Republikës Çekosllovake për periudhën 1956-1960.

Ne e shqyrtoam me vëmendje këtë dokument dhe çmojmë kujdesin që ju tregoni për masat që duhen marrë për zhvillimin e mëtejshëm dhe të shpejtë të ekonomisë sonë popullore. Ne dëshirojmë të vëmë në dukje se ndihma vëllazërore, që na ka dhënë partia dhe qeveria juaj në formë kredish si dhe në forma të tjera, ka qenë dhe është e vlefshme për ndërtimin dhe zhvillimin ekonomik të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe për këtë ju shprehim mirënjohjen tonë të singertë. Një ndihmë veçanërisht e çmuar do të jetë pa dyshim edhe ajo që Republika Çekosllovake do t'i japë Republikës Popullore të Shqipërisë në shfrytëzimin e minereleve të hekur-nikelit dhe që përmendet në dokumentin në fjalë. Ne kemi besim se shfrytëzimi dhe përpunimi i hekur-nikelit shqiptar do të jetë në dobi të Shqipërisë si dhe në dobinë e përbashkët të kampit tonë socialist.

Por ju jeni në dijeni mbi gjendjen reale dhe nevojat e mëdha të ekonomisë sonë dhe, sikundër pati rast të vërë në dukje edhe Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, në mbledhjen që u mbajt në Moskë në janar të këtij viti, fakt që është përmendur edhe në letrën e qeverisë sonë dërguar qeverisë çekosllovake më 23 janar 1956, edhe planin e dytë pesëvjeçar Republi-

ka Popullore e Shqipërisë nuk është në gjendje ta realizojë vetëm me forcat e saja pa ndihmën e vendeve mike. Në mbledhjen e Moskës ne parashtruam nevojën për një kredi prej 250 milion rublash nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore për periudhën 1956-1960; në këtë shumë komplekse është llogaritur edhe kredia prej 50 milion rublash që kemi kërkuar nga Republika Çekosllovaqe. Deri sot, shumica e qeverive mike i kanë dhënë në përgjithësi përgjegje të favorshme kërkesës së qeverisë shqiptare. Vlen të përmendet se mosakordimi i plotë i kredisë komplekse prej 250 milion rublash do ta vinte ekonominë e Republikës Popullore të Shqipërisë përballë vështirësish serioze dhe në pamundësi të zgjidhë detyrat që shtrën pesëvjeçari i dytë i zhvillimit ekonomik dhe kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Në këto kushte, Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë e konsideron të nevojshme t'i drejtohet Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Çekosllovaqe dhe t'i lutet që mundësisht ta marrë edhe një herë në shqyrtim kërkesën tonë për kredinë prej 50 milion rublash, akordimi i së cilës do të influencojë në mënyrë pozitive në realizimin e planit të dytë pesëvjeçar të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Ne kemi bindje se, me gjithë barrën e madhe që përbëjnë për Republikën Çekosllovaqe kreditë e akorduara vendeve të demokracisë popullore, Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Çekosllovaqe nuk do të mungojë t'i përgjigjet në mënyrë të fa-

vorshme kësaj kërkesë të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Me përshëndetje vëllazërore
Për Byronë Politike të KQ të PPSH
Sekretari i Parë i KQ të PPSH

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**MËSIMET QË DUHET TË NXJERRIM NGA
KONFERENCA E PARTISË E QYTETIT
TË TIRANËS**

Letër drejtuar gjithë organizatave të Partisë

21 prill 1956

GJITHË ORGANIZATAVE TË PARTISË

Në Konferencën III të PPSH për qytetin e Tiranës që zhvilloi punimet e saj prej 14-19 prill 1956 u zbulua se disa elementë të sëmurë me qëndrim të theksuar antiparti si Vehip Demi, Nesti Zoto, Iljaz Ahmeti, Ihsan Budo e disa të tjerë u përpoqën ta çorientojnë konferencën dhe të goditin unitetin e Partisë, vijën e përgjithshme të saj, udhëheqjen e saj. Ata u munduan që konferenca të linte krejt pasdore detyrat më të rëndësishme të realizimit të planit të shtetit.

Siç u vërtetua plotësisht në konferencë dhe nga vetë pohimet e disa prej këtyre elementëve, kjo punë armiqësore përgatitej prapa shpinës së Partisë dhe nxitej nga elementët antiparti, që kanë qenë kurdoherë në opozicion me vijën e Partisë dhe në pozita të theksuara ar-

miqësore si Pëllumb Dishnica, Hulusi Spahiu, Pajo Islamaj, Peço Fidhi.

Këta elementë antiparti duke shpërdoruar për qëllime arriviste armiqësore demokracinë e brendshme të Partisë u përpoqën ta denigronin politikën e Partisë, t'i mohonin sukseset e arritura nga Partia dhe populli ynë nën udhëheqjen e Komitetit Qendror, t'i reviziononin vendimet e drejta që ka marrë Partia kundër elementëve dhe grupeve të ndryshme armiqësore dhe antiparti, ta reviziononin politikën ekonomike të Partisë sonë, t'i goditnin kuadrot e Partisë, ta dobësonin disiplinën dhe vigjilencën e Partisë dhe të krijonin konfuzion në radhët e saja.

Siç rezultoi nga punimet e konferencës, kjo punë armiqësore kishte filluar të përgatitej nga elementë antiparti, intelektualë të sëmurë, me prejardhje borgjeze dhe mikroborgjeze, të cilët, duke shkelur rregullat më elementare të Partisë, pëshpëritnin lart e poshtë kundër vijës së Partisë, kundër udhëheqjes dhe vendimeve të saj. Në prakun e konferencës ata nxitën elementët e sëmurë të shtronin në konferencë pikëpamjet e tyre antiparti gjoja si porosi të organizatave bazë ku ata bënin pjesë.

Byroja provizore e Komitetit të Partisë për qytetin e Tiranës kishte rënë në gjumë të rëndë, nuk ishte aspak në korrent për tërë këtë punë armiqësore që zhvillohej prapa krahëve të saj. Kjo për arsye se puna e saj ishte karakterizuar nga një burokratizëm i theksuar, nga ndjenja e vetëkënaqësisë, fryma e justifikimit, nga familjariteti i sëmurë, nga mungesa e kritikës dhe e autokritikës bolshevike.

Kjo gjendje në punën e byrosë provizore të Komi-

tetit të Partisë për qytetin e Tiranës, pa dyshim krijoi terren të favorshëm për punën armiqësore, që përgatitej nga këta elementë antiparti. Byroja provizore e Komitetit të Partisë për qytetin e Tiranës nuk u tregua në lartësinë e detyrës. Nuk e kryen detyrën e tyre edhe disa organizata bazë të Partisë si ajo e Ministrisë së Industrisë, e Radio Tiranës, e Kinostudios, të cilat nuk i kanë goditur me forcë pikëpamjet antiparti, armiqësore të shfaqura nga elementët e përmendur më sipër, nuk i kanë vlerësuar ato dhe nuk kanë marrë masat e duhura.

Kjo punë armiqësore mundi të përgatitej sepse nga disa organizata bazë dhe sidomos nga byroja provizore e Komitetit të Partisë për qytetin e Tiranës u lejuan të shkeleshin normat leniniste të jetës së Partisë, të shkelej disiplina dhe konspiracioni i Partisë, të shpërdorohej demokracia e brendshme e Partisë.

Konferenca III e Partisë e qytetit të Tiranës, e ndihmuar nga Komiteti Qendror, e dënoi me vendosmëri këtë punë të theksuar armiqësore dhe mbrojti me besnikëri vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë, drejtësinë e vendimeve të saj, unitetin e saj. Ajo shprehu kompaktësinë e organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës rreth Komitetit Qendror, udhëheqjes leniniste të Partisë sonë. Konferenca vendosi që organizatat bazë ku bëjnë pjesë këta elementë, si dhe organizatat e tjera ku ka shfaqje të tilla, të analizojnë thellë gabimet e tyre dhe të mbajnë qëndrimin e duhur. Njëkohësisht konferenca, duke pasur parasysh përgjegjësinë e madhe të byrosë së Komitetit të Partisë për qytetin e Tiranës dhe në mënyrë të veçantë të sekretarëve të saj, shkarkoi sekretarin e parë të komitetit të Partisë dhe e zgjodhi atë

sekretar të dytë, kurse sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë nuk i zgjodhi në Komitetin e ri të Partisë për qytetin e Tiranës.

Mësimet kryesore që duhet të nxjerrë e gjithë Partia nga analiza e kësaj çështjeje janë:

1. — Duhet pasur gjithnjë parasysh se edhe në situata qetësie armiqtë e klasës dhe të Partisë do të përpigën me të gjitha format dhe mjetet të luftojnë Partinë. Prandaj në asnjë mënyrë nuk lejohet të dobësohet sado pak vigjilenca, nuk lejohet të pushtohemi nga ndjenja e vetëkënaqësisë dhe t'u lëmë fushë të lirë veprimi armiqve.

2. — Të luftohet me vendosmëri kundër çdo shkeljeje të normave leniniste në jetën e Partisë. Të respektohen dhe të zbatohen me rigorozitetin më të madh rregullat organizative të Partisë. Të forcohet disiplina e hekurt e Partisë. Çështjet të diskutohen në rrugë partie dhe në frymë të shëndoshë partie. Të dënohen ashpër shfaqjet e sëmura të diskutimit të çështjeve të brendshme të Partisë nëpër rrugë. Të forcohet akoma më shumë demokracia e brendshme e Partisë, kritika, autokritika, sidomos kritika nga poshtë. Organizatat e Partisë të jenë vigjilente dhe të godasin me vendosmëri çdo shpërdorim të demokracisë së brendshme kundër interesave të Partisë.

3. — Të forcohet puna për edukimin ideologjik të anëtarëve të Partisë, për formimin komunist të tyre dhe të luftohen shfaqjet e sëmura të liberalizmit borgjez, mbeturinat mikroborgjeze, shfaqjet e mendjemadhësisë etj.

4. — Të forcohet puna e gjallë me njerëzit, kon-

takti i ngushtë e i shpeshtë me ta dhe jo vetëm në forma zyrtare. Organet e Partisë dhe aparatet e tyre duhet t'u japin fund një herë e mirë metodave burokratike të drejtimit, mbledhjeve të shpeshta e të gjata, drejtimit nëpërmjet letrave dhe formularëve. Të qëndrohet më afër bazës, të dëgjohet zëri i masave dhe të zgjidhen kërkesat e tyre. Të zhvillohet një punë më konkrete për të sqaruar më me hollësi masat rreth vendimeve të Partisë dhe të shtetit. Të përdoren për këtë punë sidomos shokët me përgjegjësi në Parti dhe në pushtet.

5. — Të forcohet kujdesi për avancimin dhe ngritjen në përgjegjësi të elementëve punëtorë. Të forcohet puna për edukimin e punëtorëve dhe për shtimin e radhëve të Partisë me anëtarë të rinj të dalë nga radhët e klasës punëtore. Në rrethet ku kemi një industri pak a shumë të zhvilluar, përqindja dërmuese e atyre që do të pranohen në Parti duhet të jenë punëtorë.

6. — Të përmirësohet puna për edukimin dhe vendosjen e kuadrove. Të ruhen me kujdes kuadrot dhe të ndihmohen ata nga afër për të kryer detyrat e ngarkuara.

*

* *

Edhe një herë porositen organizatat bazë të Partisë që me rastin e punimit të kësaj letre të ruajnë me vigjilencë dhe zgjuarësi Partinë, vijën e përgjithshme të saj, unitetin e saj, nga kushdo që do të përpiqet dhe nën çfarëdo mënyre që do t'i cënojë këto. Të ruajnë dhe të forcojnë përditë e më tepër lidhjet e Partisë me po-

pullin. Të udhëhiqemi vazhdimisht e në çdo punë nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Edhe pak kohë na ndan nga Kongresi III i Partisë. E gjithë Partia të mobilizojë të gjitha forcat e saja, për të realizuar me sukses dhe për të tejkaluar detyrat e rëndësishme që na shtron plani i shtetit për vitin 1956, viti i parë i pesëvjeçarit të dytë, që të vemë në Kongresin III të Partisë me duar plot. Realizimi me sukses i detyrave në lëmin e ekonomisë duhet të konsiderohet nga të gjitha organizatat e Partisë si detyra kryesore e tyre.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TË JEMI KURDOHERË VIGJILENTË NDAJ SYNIMEVE, PËRPJEKJEVE DHE METODAVE TË STËRHOLLUARA TË ARMIKUT

Diskutim në mbledhjen e organizatës bazë të Partisë pranë aparatit të Komitetit Qendror të PPSH. me rastin e punimit të Rezolucionit të Konferencës së Partisë të qytetit të Tiranës

26 prill 1956

Edhe unë, si anëtar partie, solidarizohem me letrën e Komitetit Qendror dhe me Rezolucionin e Konferencës së Partisë të qytetit të Tiranës. Me këtë rast, dëshiroj të ngre disa çështje që mund të na shërbejnë neve, punonjësve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Në radhë të parë ne duhet të kuptojmë mirë se ç'qëllime ka armiku kundër Partisë. Vetë jeta dhe lufta e Partisë e rrit komunistin dhe e bën atë të kuptojë qëllimet e armikut. Ky qëllim ka qenë, është dhe do të jetë të godasë udhëheqjen e Partisë, Komitetin Qendror. Kur armiku ka goditur Komitetin Qendror të Partisë, ai ka goditur vijën e Partisë. Prandaj ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë ndaj synimeve, përpjekjeve dhe

metodave të stërholluara të armikut. Po të mos mprehet çdo ditë nga ana e Partisë vigjilenca e komunistëve, atëhere armiku na shkakton dëme të mëdha.

Të gjithë e dimë se armiku kërkon të sjellë në krye të Partisë sonë një Komitet tjetër Qendror dhe kështu të realizohen qëllimet e tij: të zhvillohet në Parti gradualisht një punë oportuniste dhe Partia e vendi ynë të shkojnë atje ku do armiku, në greminë. Këto qëllime armiku nuk mund t'i arrijë me këtë Komitet Qendror që është sot, sepse ky është një Komitet Qendror marksist-leninist dhe mbron me vendosmëri Partinë dhe vijën e drejtë të saj, por kërkon dhe lufton që në krye të Partisë të vijë njerëz jomarksistë.

Nuk përjashtohet rasti që ndonjë nga ne, që jemi në Komitetin Qendror, të ketë edhe gabime, po këtu është çështja për udhëheqjen kolegjiale, për Komitetin Qendror, që ka mbrojtur me vigjilencë dhe pa u lëkundur vijën marksiste-leniniste të Partisë, vijën e drejtë të Partisë, interesat e popullit tonë. Pikërisht këtu kërkon të godasë armiku, i cili, duke marrë shkas nga gabimet që janë vërtetuar në partitë komuniste dhe punëtorë motra, mendoi se erdhi tani momenti i përshtatshëm për të goditur edhe udhëheqjen e Partisë sonë, në një kohë kur ajo nuk ka bërë të tilla gabime serioze sikurse janë vërtetuar në vende të tjera. Dhe filloi sulmin jo kundër individëve veç e veç, por frontalisht kundër gjithë udhëheqjes. Pra, këtu nuk është çështja e goditjes së një personi, po e një udhëheqjeje të tërë monolite. Për armikun kjo udhëheqje duhet të hiqet e tëra dhe, natyrisht, në vend të saj, të vijë njerëz të tjerë si Tuk Jakova e Bedri Spahiu me shokë, sepse këta njerëz, në

këto situata, që mendojnë se u bë deti kos, gabimet e tyre nuk i konsiderojnë gabime, pra, gabimet e tyre duhet të fshihen. Ata mendojnë se në këto situata të qeta, kur po ulet tensioni ndërkombëtar, duhet të ndërrohet vija marksiste-leniniste e Partisë sonë, se kjo vijë për ta nuk ka qenë e drejtë, ka qenë sektare dhe lufta e klasës ka qenë e ashpër.

Por, shokë, ne nuk kemi bërë gabim që e kemi zhvilluar të ashpër luftën e klasës dhe nuk lejuam të bëhej si thoshte Sejfulla Malëshova, domethënë të linim të lirë tregëtarët dhe të mos ishim të ashpër kundër tyre. Të kishte shkuar Komiteti Qendror pas pikëpamjeve të Sejfulla Malëshovës, gjendja tani në vendin tonë do të ishte si në Greqi. Në kohën që populli shqiptar ishte akoma i rjepur dhe i gjakosur, Sejfulla Malëshova kërkonte që edhe ato 5 fabrika që ishin në vend të mos i merrte shteti ynë, por tregëtarët e mëdhenj, të cilët të merrnin në dorën e tyre tregëtinë e jashtme dhe banka t'u jepte atyre kredi. Përveç kësaj ai donte që elementët e borgjezisë të gjenin kushte të favorshme dhe të krijonin partinë e tyre në Frontin tonë, pra t'u lejoheshin këto gjëra atyre që komplotuan kundër pushtetit tonë popullor. E si duhej bërë atëhere? Si duhej mëkëmbur ky vend, me politikën e Sejfulla Malëshovës? Ata që mendojnë kështu nuk janë në të, ata janë të gabuar. Dënimi i Sejfulla Malëshovës ka qenë i drejtë, bile Partia ka qenë shumë e gjerë me të. Partia, duke vepruar në mënyrë të drejtë, ka shpëtuar vijën e saj, drejtësinë e saj. Por këtë vijë revolucionare të Partisë borgjezia nuk e duron dot dhe në çdo moment përpiqet të kthejë ujët nga mulliri i saj kundërrevolucionar. Prandaj, marksis-

të-leninistët duhet të jenë kurdoherë të zgjuar dhe në këmbë.

E gjithë puna armiqësore që u shfaq në Konferencën e Tiranës kishte për qëllim shkatërrimin e Komitetit Qendror të Partisë sonë. Zbulimi i veprimtarisë armiqësore në këtë konferencë është një fitore e madhe për ne, por njëkohësisht Partia mëson nga gabimet e veta. Shikoni se si u shkund organizata e Partisë e Tiranës nga kjo ngjarje. Pra, të tëra këto janë mësimë. Po mos kujtoni se armiku nuk fitoi fare në këtë çështje. Ai fitoi, pavarësisht se disa njerëz i humbi e disa të tjerë i dogji. Armiku krijoi një situatë që e shfrytëzon reaksioni, i cili thotë: «filloi kritika e fortë dhe e ashpër kundër njerëzve të udhëheqjes, që nuk panë rrugën nga vanë, që mezi merrnin frymë etj». Po kjo nuk është gjë, shokë. Ne, punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror që vemë në bazë, duhet të bisedojmë me shokët, t'i edukojmë ata, të kemi kujdes dhe të mbajmë parasysh se armiku do të përpiqet ta shfrytëzojë situatën duke ngjallur frikë në ndonjë shok partie, ai do të përpiqet të mbjellë ftohtësinë dhe një farë drojtje te njerëzit.

Është e pamundur që problemet ekonomike dhe politike të Partisë të mos kenë preokupuar çdo anëtar të saj, në qendër e në bazë. Anëtarët e Partisë duhet të interesohen për problemet, se, po të ndodhë e kundërta, atëherë kemi një parti të fishkur. Partia jonë është një Parti luftarake dhe di përse lufton dhe flet. Ajo përpiqet t'i bindë dhe t'i sqarojë masat për vijën e saj të drejtë dhe të demaskojë armikun që kërkon ta përbuzë këtë vijë. Pra, Partia jonë nuk mund ta mbyllë gojën, ajo është kurdoherë në pararojë dhe, anëtarët e saj, kush më shu-

më e kush më pak, të tërë bisedojnë mbi këto çështje. Por, në këtë situatë, edhe armiku flet dhe duke folur, ai përpiqet të komprometojë edhe njerëzit tanë, për t'i bërë kontingjent të tij, prandaj duhet kujdes dhe vigjilencë.

Tani dëshiroj të qëndroj në disa çështje që u ngritën në organizatën tonë.

Mendoj se kur u përmendën emrat e disa shokëve, atyre u ka shkuar me siguri si ujë të ftohtë nëpër trup (*Nga salla: ashtu është*).

Kur doli dje në organizatë emri i E.N. me siguri tërë natën ai ka qenë i shqetësuar. Natyrisht, ajo që ka thënë ky shok se «meqë njerëzve nuk po u shpjegohen këto gjëra, atëhere ata dëgjojnë Radio Londrën», nuk është e mirë, bile është e dënueshme. Kjo tregon një gjendje shpirtërore jo të qetë të shokut E.N., jo se ai është me Londrën. Ndryshe është puna e Peço Fidhit, të cilin si shumë të tjerë e njoh edhe unë.

Më kujtohet mirë se si 40 vjet më parë kur unë isha akoma i vogël (dhe ngjarjet e vegjëlisë mbahen mend shumë), në kohën që Greqia okupoi Gjirokastrën, shumë nga Fidhajt dhe Litajt thërrisnin nëpër rrugët e qytetit: «Zito i Elladhas» (Rroftë Greqia), «Zito o Vasileos» (Rroftë mbreti), «Kato i Allvania» (Poshtë Shqipëria). Në mos babai, gjyshi i Peço Fidhit i ka bërë këto gjëra. Kështu në Korçë në atë kohë korofillaqia vriste patriotin Papa Kristo Negovanin, dhe Ballaurët me shokë persekutonin familjet patriote të Gramenove, të Germenjëve, të Pepollarëve, të Tashkollarëve etj. Pra, kur Peço Fidhi flet mirë për Londrën, ai e bën këtë se ka simpati për të. Populli dhe Partia nuk e harrojnë të ka-

luarën. Po Partia jonë është Parti marksiste-leniniste dhe nuk i fut të gjithë Fidhajt në një thes. Shumë elementë të borgjezisë, të klasave sunduese, kur shpërthen revolucioni, shkëputen nga klasa e tyre dhe edukohen nga proletariati. Ka prej tyre që shkojnë deri në fund me proletariatin, ka dhe që bien nga kali. Peço Fidhi është pikërisht një nga ata që ra nga kali. Të kemi parasysh se elementët e borgjezisë bien më shpejt nga kali, por ka edhe nga radhët e proletariatit elementë që degjenerojnë. Prandaj Partia ka detyrë t'i edukojë të gjithë njerëzit, të ketë kujdes për të gjithë komunistët sidomos për ata me prejardhje borgjeze, mikroborgjeze e intelektuale, të cilët t'i ndihmojë që të mos lëkunden, por të kaliten gjithnjë e më shumë me ideologjinë revolucionare të Partisë.

Në këto situata që po kalojmë ne duhet të dimë mirë të dallojmë se cilët janë armiq të vërtetë të Partisë sonë dhe cilët kanë gabuar rëndë, por s'janë armiq. Ka njerëz që u ka munguar vigjilenca, këtyre t'u hiqet pak veshi. Ka të tjerë që kanë folur në rrugë partie dhe jashtë saj, po fundi me shokët e Partisë kanë biseduar, këta duhet t'i dallojmë mirë nga elementët armiq. Zemra e Partisë, shokë, është si zemra e nënës. Kur je i ri dhe bën një gabim, vete ia thua nënës dhe ajo sipas fajit herë të heq një çikë veshin, nganjëherë të fut edhe ndonjë dackë, po kurdoherë të do. Prandaj Partisë duhet t'i hapim zemrën, të jemi të sinqertë me të, sado i rëndë dhe i jashtëzakonshëm të jetë faji që kemi bërë. Ai që nuk është i sinqertë, do të nxjerrë brirë në mos sot, nesër dhe atëhere Partia do t'i tregojë vendin. Partia ia fali një herë fajin Tukut. Pas disa kohe, kur ai mori në dorë

teserën e re u drejtua me këto fjalë: «Shoku Enver, Tuk Jakova nuk do ta njollosë më këtë tesër». Po ja që e njollosi dhe Partia me të drejtë e hodhi jashtë radhëve të saja. Prandaj të jemi të sinqertë dhe të hapur me Partinë që të marrim ndihmën e saj. Të mos bëjmë demagogji, se, siç thotë populli, «gënjeshtria i ka këmbët e shkurtëra». Asgjë nuk mund t'i fshihet dhe t'i mbulohet Partisë, se ajo nuk rron e izoluar, por rron me popullin, i cili e do dhe e mbron Partinë e tij të dashur. Nuk ka rrugë më të drejtë se sa të shkosh dhe t'i thuash Partisë «e bëra këtë gjë, u gënjeva» dhe Partia të thotë «mos e bën më, shko e puno më mirë».

Partia na mëson që të kemi shumë kujdes me shokët. Të jemi sa më të ngrohtë me ta. Po kjo nuk do të thotë të mbyllësh sytë përpara gabimeve që bëhen, nuk do të thotë t'i flasësh urtë e butë Vandush Vinçanit, i cili duhet të shkundet mirë dhe t'ia thotë hapur Partisë gabimet e tij të rënda. Partia të jetë kurdoherë e zgjuar, e dashur, e ngrohtë, t'i heqë veshin atij që ka gabuar dhe ta ndihmojë të ndreqet. Në të njëjtën kohë të gjykojmë edhe më gjerë, të mendojmë se përgjegjësi nuk kanë vetëm ata që kanë bërë faje, por edhe ne. Cilido nga ne që mendon se unë nuk jam përzierë në këtë ose atë punë, prandaj dhe s'kam gabuar nuk gjykon drejt. Vërtet të nuk je përzierë, po këtu është puna e Partisë, se këta elementë armiq kanë kapur disa momente, disa gabime, të cilat i kanë shfrytëzuar në interesin e tyre armiqësor, kundër Partisë.

A mund të themi ne se nuk kemi gabime në punën tonë? Jo. Po të thoshim «s'kemi gabime», do të gënjenim veten. Por ne jemi komunistë dhe nuk duhet të the-

mi vetëm me fraza se «kemi gabime». Sigurisht, edhe në punën tonë ka të meta. Pa u zgjatur në këtë çështje, mendoj të them se këtu në aparat ka të meta serioze, kundër të cilave duhet të luftojmë me këmbëngulje.

Në radhë të parë është çështja se baza e Partisë nuk sqarohet sa duhet si nga ana e aparatit të Komitetit Qendror, inspektorëve, instruktorëve etj., ashtu edhe nga ana e komiteleve të Partisë. Nuk është e drejtë të thuhet se në bazë s'ka pyetje. Fakti është se atje nuk ka pyetje tendencioze, po pyetje ka. Sikur të mos kishte pyetje, atëhere i duhet vënë gishti kokës dhe të themi: ose ne jemi «në rregull» ose Partinë e ka zënë gjumi. Ekzistojnë kontradikta, të cilat sjellin zhvillim, luftohet për kapërcimin e tyre, por në jetë lindin kontradikta të tjera. Jeta tregon se në bazë ka pyetje, ka mendime edhe të kundërta, ka nevojë për sqarim, por ky sqarim nga ana e Partisë nuk bëhet si duhet, qoftë nëpërmjet aparateve të Partisë, qoftë edhe nëpërmjet shtypit dhe gjithë propagandës sonë.

Lexova raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit dhe pashë se atje kishte vetëm 7 radhë për gjendjen ndërkombëtare. Kjo flet qartë për atë se puna për sqarimin politik të masave nuk zë vendin e merituar dhe ka rrezik që, duke u marrë me çështjet ekonomike, gjë që është shumë pozitive, të neglizhohet ana tjetër e rëndësishme, puna politike me masat. Në këto situata kur armiku vepron, në qoftë se Partia nuk është e armatosur mirë dhe nuk i sqaron si duhet njerëzit, do të bëhen me mijëra pyetje, nga të cilat do të ketë që elementët armiq t'i lidhin edhe me çështje ekonomike e t'i shfrytëzojnë për hesap të tyre. Po t'i neglizhojmë këto

orientime kaq të rëndësishme të Partisë, puna jonë do-bësohet dhe dëmtohet. Të mos çuditemi se bëhen pyetje. Pyetje do të ketë dhe ne duhet t'i sqarojmë ato, ndryshe njerëzit do të jenë të paqartë dhe do të pyesin të tjerët. Sa më dobët ta bëjmë ne punën sqaruese me masat, aq më lehtë e ka armiku të veprojë. Të mos mendojë ndonjë se, duke lexuar gazetën e duke zhvilluar një konferencë, puna mbaroi me kaq. Jo, kërkohet një veprimtari e dendur politike. Nuk duhet të ndodhë që kush bën një pyetje të quhet armik. Kjo nuk është e drejtë. Njeriu duhet të shihet në punë, në jetë. Të mos krijohen menjëherë dyshime për atë që drejton këtë ose atë pyetje. Sqarimi politik i njerëzve është i domosdoshëm. Kjo detyrë kurrë nuk duhet neglizhuar.

Po pse nuk bëhet mirë sqarimi politik i njerëzve në bazë? Nuk bëhet mirë se instruktazhi organizohet dobët, problemeve në bazë nuk u shkohet thellë, në qendër sillen vetëm disa gjëra të përgjithshme dhe nuk ngrihen si duhet probleme që shqetësojnë Partinë. Shpeshherë, na vijnë gjëra që nuk është nevoja fare të vijnë, se ato nuk zgjidhen këtu lart. Gjërat e vogla zgjidhen në bazë. Po ka edhe «gjëra të vogla» që duhen parë e analizuar, se shumë herë ato sinjalizojnë për probleme të mëdha. Pikërisht këto konkluzione, që janë rezultat i analizave, i duhen sjellë nga baza udhëhoqjes, e cila do të marrë masat e nevojshme për të sqaruar ose për të zgjidhur një situatë të caktuar. Kjo nuk bëhet sa duhet në aparatet e Komitetit Qendror dhe gjithashtu nuk shfrytëzohet si duhet informacioni. Çështjet ecin mengadalë dhe për këtë ne kemi përgjegjësi të madhe. Armiaqtë janë armiq dhe duhen luftuar, ata janë kundër nesh, po edhe

ne duhet të luftojmë që të mos i lëmë armikut asnjë shteg për të na luftuar. Nga të gjitha këto ne duhet të shkundemi sa më parë.

Sigurisht puna e instruktorëve është përmirësuar dhe nuk mund të themi se është si përpara, se tani ata konsultohen më shumë me sekretarët e Komitetit Qendror e me drejtorët, megjithatë puna është akoma e pakënaqshme. Fakti është se Byroja Politike nuk ka pasur dijeni për gjërat që u përgatitën dhe dolën në Konferencën e Tiranës. Komiteti i Partisë i qytetit të Tiranës ka fjetur, prandaj ka përgjegjësi të rëndë. Këtu ka gjithë këta inspektorë dhe instruktorë të Komitetit Qendror, anëtarë të Komitetit Qendror, ministra dhe kuadro të tjerë që mund të aktivizohen. Të gjithë këta njerëz rrojnë me masat e popullit, me Partinë, në qoftë se do t'i nuhatnin qoftë edhe ditën e fundit pikëpamjet e huaja të atyre që u ngritën në Konferencën e Partisë, do të veprimej menjëherë, do t'u shkohej çështjeve deri në fund dhe nuk do të kishte ngjarë ajo që ndodhi. Pra këtu ne kemi faj. Fakti që shokë të aparatit informuan se çfarë flitet, është një anë pozitive, por udhëheqja nuk mori masa të menjëhershme. Prandaj duhet më shumë kujdes, shokë, për gjëra të tilla, të shkundemi mirë të gjithë ne, duke filluar nga instruktorët, inspektorët, drejtorët dhe sekretarët e Komitetit Qendror.

Edhe shtypi ynë duhet të ndihmojë më shumë Partinë. Ai është mjaft i dobët dhe nuk pasqyron si duhet problemet që ngre jeta. Duhet thënë se edhe eksperiencat pozitive që trajtohet në shtyp nuk studjohet si duhet në bazë, sidomos nga anëtarët e Partisë. Për këtë kanë faj komitetet e Partisë, por faj kemi edhe ne e shokët

që kanë më tepër kontakte me bazën, të cilët, kudo që shkojnë, duhet t'i lidhin më mirë këto gjëra me gjendjen, me jetën, me punën, me ngjarjet, që zhvillohen.

Të kuptojmë mirë se mossqarimi politik i njerëzve shpie në atë që disa të lëkunden dhe të flasin, duke mos e quajtur të drejtë, për shembull, qëndrimin që është mbajtur ndaj Tukut e Bedriut. Por, në qoftë se në këtë çështje Komiteti Qendror do të kishte gabuar, ai do të bënte patjetër autokritikë. Derisa Komiteti Qendror nuk ka thënë gjë atëhere secili e ka vijën e Partisë dhe s'ka pse të mendojë ndryshe. Bile Komiteti Qendror, kur doli çështja e Jugosllavisë, i ka thënë shqip këto gjëra. Megjithatë, në qoftë se ndonjërit i vjen një mendim, dhe mendime njerëzve u vijnë, nuk është krim ta thotë, por jo në rrugë antiparti, se një gjë e tillë çon ujë në mullirin e armikut. Kush s'i thotë mendimet në rrugë partie, nuk vepron drejt. Armiku rrokullis gurë, prandaj në çdo situatë shokët komunistë duhet të jenë me nerva të fortë dhe të kenë besim në vijën e Partisë. Po të shikojmë edhe një herë rrugën nëpër të cilën kemi ecur, do të vëmë re se cilët kanë qenë dhe janë ata që kanë dashur dhe duan ta çojnë Partinë në greminë. Këta kanë qenë dhe janë armiqtë e saj. Por në situata të tilla kthese ka edhe elementë të paqartë që lëkunden. Prandaj, pikërisht në këto situata, Partia duhet të jetë në krye të punës për të sqaruar masat, për të ndihmuar secilin që të kuptojë drejt zhvillimin e ngjarjeve.

Kam përshtypjen se çështjet ekonomike që janë nga më të rëndësishmet nuk i kemi të tërë të qarta si duhet. Na duket sikur i dimë, mirëpo nuk është kështu. Kemi nevojë t'i njohim më thellë, t'i kuptojmë, t'i shpjego-

gojmë. e të mos lëkundemi në asnjë situatë. Vështirësi kemi dhe nga këto armiku përfiton. Por në qoftë se nesër mbushim pazarin me gjalpë, djathë etj., atëhere e tërë propaganda e armikut dërmohet. Po çështjet ekonomike duhet të jenë të qarta në radhë të parë nga Partia. Ne mund të themi se Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës pranë Komitetit Qendror zhvillon një propagandë të shkëputur nga çështjet ekonomike. Deri në një farë shkalle kjo dobësi vihet re edhe në Drejtorinë e Organizimit, po sidomos në atë të agjitacionit e të propagandës. Shoku Vandush Vinçani e ndonjë tjetër mund ta heqin veten të ditur, por unë mund të them se ata dinë vetëm formulat e marksizëm-leninizmit, formula këto që nuk të çojnë larg, ata nuk janë në gjendje t'i lidhin si duhet ato me praktikën, me jetën, me kushtet, me situatën tonë. Por në aparatën e Komitetit Qendror kemi edhe shokë të tjerë që i kuptojnë më mirë çështjet ekonomike dhe vendimet që merr Komiteti Qendror, prandaj të dy palët të qëndrojnë më afër njëri-tjetrit, të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë që të kuptohen mirë nga Partia problemet e politikës ekonomike të saj. Pse të ketë njerëz që të thonë se situata në vendin tonë është e rëndë, ose që Komiteti Qendror nuk ka bërë mirë që ka marrë këtë apo atë masë? Le t'i analizojmë pak këto çështje.

Duhet kuptuar se heqja e pjesshme e sistemit të triskëtimit është një fitore e madhe. Sistemi i triskëtimit është një sistem parazitari, sepse kishte njerëz që hanin në kurriz të ekonomisë. Kur hoqi triskat Komiteti Qendror nuk pa nevojën e këtij ose atij njeriu, por pa nevojat e popullit. Kush fitoi me masat që u morën du-

ke hequr triskëtimin? Me këto masa fituan mbi një milion vetë, jeta e të cilëve u përmirësua. Dhe këta janë prodhuesit kryesorë të fshatit. Ata tani blejnë më mirë se sa blenin më parë në treg të lirë.

Shteti u dha kompensim të gjithë atyre që ishin në marrëdhënie pune me të. Ky është një parim i drejtë socialist, të cilin nuk duhet ta përmendim vetëm si formulë, por ta kuptojmë e ta vëmë në praktikë, pse kemi të bëjmë me familje, me kalamanë, që duhen ushqyer medoemos. Por midis familjeve që përfitonin nga triskat ka pasur edhe njerëz që tundin derën, të cilëve nuk u duhet dhënë kompensim. Partia dha një kompensim me qëllim që të mos rëndoheshin ekonomikisht familjet e punëtorëve e të nëpunësve. Kështu, atyre që marrin më pak rrogë, që janë më nevojtarë, u jepet një kompensim më i madh. Megjithëse u dha ky kompensim, prapë gjendja është e vështirë, prandaj këto ditë do të procedohet në uljen e çmimeve. Kompensim nuk është dhënë as në demokracitë popullore as në BRSS, bile në BRSS kur kanë likuiduar sistemin e triskëtimit nuk kanë kompensuar fare, por të mos harrojmë se çmimet e tregjeve atje kanë qenë me diferenca më të vogla, sigurisht ngaqë ata janë më të pasur se ne, kanë industri më të zhvilluar dhe bujqësi më të përparuar, ndërsa te ne çmimet kanë pasur diferencë më të madhe.

Po mos vallë është shpejtuar Komiteti Qendror në masat që ka marrë? Jo, shokë. Komiteti Qendror ka ndenjur me ditë e netë të tëra duke menduar për këto masa. U bënë 12 vjet që jemi çliruar dhe kemi vështirësi. A do të vazhdojmë më në këtë gjendje? Do të ecim më me këto norma të ulëta? Kjo nuk është socialiste. Po

të mos merrnim këto masa do ta rëndonim më shumë ekonominë tonë. Për shembull kategorizimi i vjetër nuk ishte më i përshtatshëm për gjendjen e re. Ai i përgjigjej një situatë të caktuar, kur një i ri vinte nga fshati dhe shpeshherë merrte kategorinë e pestë. Kjo nuk ishte e drejtë, por bëhej nga nevoja se kishim mungesa specialistësh. Do të vazhdonim në një rrugë të tillë në kushte të reja kur gjendja kishte pësuar ndryshime? Natyrisht jo. Gjatë planit të dytë pesëvjeçar shteti nuk mund të mbante në kurriz njerëz parazitë dhe të dëmtohej ekonomia jonë me miliona lekë. Sigurisht, atij që merrte më shumë të ardhura, sot nuk i vjen mirë. Por, nuk duhet harruar se për disa vjet ka marrë shpërblyimin e kategorisë së gjashtë kur meritonte të kategorisë së tretë. Një njeri i ndershëm e kupton se kjo s'është e mirë dhe duhet korrigjuar. Prandaj me masat që mori Komiteti Qendror nuk gaboi, pavarësisht se duheshin marrë këto masa një muaj më parë ose më pas.

Pas heqjes së pjeshme të triskave populli i shtoi depozitat e tija në arkat e kursimit dhe këtë e bëri, se ai ka besim te Partia, te politika e saj e drejtë, ai e kuptoi drejt se kompensimin e ka për veshmbathje, prandaj i vuri paret në librezën e kursimit. Këtë nuk e themi me fjalë, po e tregojnë shifrat.

Po kush qahet që u hoq triskëtimi? Siç tha edhe shoku Salë Sheshi, qahen ata që janë mësuar, ata që në të kaluarën (dhe kanë akoma edhe sot) hanin me bollëk, ndërsa populli vuante dhe shkante të blente sheqer jo me kile, por me kokrra, atëhere kur punëtori dhe fshatari i binin groshit me kobure. Në kohën që borgjezia blente ç'të donte dhe deputeti fuste në xhep 25 verdhur

shka në muaj, punëtori merrte një lek e një çerek ose dy lekë në ditë dhe nuk i tepronte asgjë për fëmijët. Po shtëpia, drita, drutë e të tjera nevoja për punëtorin? Ç'të hyjmë, shokë, në këto hesape.

Të tërë ne, komunistët, duhet t'u vëmë rëndësi të madhe çështjeve ekonomike. Por më duket se shokët sekretarë të Komitetit Qendror kur mbledhen me punonjësit e aparatit nuk po i sqarojnë në thellësi këto çështje. Kjo është e domosdoshme të bëhet mirë. Nuk mjafton që shokët komunistë të aparatit vetëm të punojnë në bazë të direktivave të Komitetit Qendror së bashku ose veç e veç. Në Byronë Politike ka diskutime, vërejtje, propozime dhe kur del një vendim, është e domosdoshme që ky të zërthehet e të kuptohet thellë, me qëllim që gjatë punës për zbatimin e tij të mos ketë asnjë lëkundje pavarësisht nga vështirësitë dhe pengesat që mund të hasen në bazë.

Disa pengesa e vështirësi ekonomike që ka vendin në etapën e sotme, armiku kërkon t'i shfrytëzojë me qëllim të caktuar për llogari të tij. Kështu ai thotë se në vendet e Perëndimit dyqanet janë mbushur plot. Po kush blen në këto dyqane? Këtë armiku nuk e thotë, sepse nuk i intereson. Por le ta themi ne. Në këto dyqane blejnë vetëm elementët e borgjezisë, kurse populli, proletariati, vuan, jeton në mizëri, në varfëri. Besoj se këtë e shihni edhe ju, shokë, në filmat italianë, të cilët, megjithëse kalojnë nga censura e borgjezisë, tregojnë qartë jetën e rëndë të popullit dhe të punëtorëve në botën kapitaliste. Po realiteti është akoma më i keq. veçse censura nuk lejon të paraqitet ashtu siç është në vërtetë. Ndërsa në vendet tona jeta e popullit përmirëso-

het gjithnjë e më shumë. Është kollaj të ushqesh 5 frymë në një familje, por të ngresh nivelin e më se 1 milion e 300 mijë njerëzve, kjo punë nuk bëhet me frymën e shenjtë, por bëhet me djersë, me heroizma dhe duke zbatuar një vijë të drejtë, siç është vija e Partisë sonë, që ka qenë dhe është kurdoherë e drejtë.

Disa gabime në praktikë ka dhe do të ketë edhe pas-këtaj, por Partia do të luftojë me të gjitha forcat që t'i zhdukë ato. Të marrim për shembull kultin e personit. Mua më duket se emri im është ekzaltuar, kudo janë vendosur parulla e buste. Kjo nuk është e mirë. Po gabime të rënda nuk janë bërë, se në KQ të Partisë sonë ka ekzistuar kolegjaliteti. Por kjo nuk është një çështje që duhet parë vetëm lart, po duhet parë edhe në bazë se ka njerëz që u rritet mendja, që bëhen arrogantë. Njëri thotë se unë jam sekretar i Partisë, tjetri thotë se unë jam kryetar i pushtetit, kryetar i degës së punëve të brendshme etj. Këto gjëra ngjasin dhe armiku kërkon t'i shfrytëzojë për llogari të tij duke thënë: «Bini udhëheqjes, se atje ka kult të individit». Ose armiqtë bërtasin: «Është mendimi yt ky apo i Byrosë Politike». Është fakt se armiku do të përpiqet edhe në të ardhshmen që të veprojë kundër udhëheqjes së Partisë, për të na dëntuar, për të ulur autoritetin e saj.

Ne i shohim vetë se ku i kemi gabimet e dobësitë dhe kundër tyre luftojmë përditë në rrugë të drejtë. Kështu do të luftojmë edhe në të ardhshmen, pse këto janë çështje që duhen shikuar vazhdimisht në tërë jetën e Partisë. Dhe nga gabimet ne nxjerrim mësim, reflektojmë, luftojmë për të mbrojtur unitetin e Partisë dhe të Komitetit Qendror pa bërë lëshime ndaj gabimeve.

Drejt veproi në Konferencën e Tiranës punëtori Boris Ilo i Ndërmarrjes së Ndërtimeve «21 Dhjetori», që kritikoi në mënyrë bolshevike dhe të tërë e duartrokitën. Ai kritikoi me emër ministra, kritikoi edhe shokë të Byrosë Politike dhe kjo në rrugë të drejtë partie. Ndërsa elementët antiparti në konferencë kishin të tjera qëllime, ata ishin kundër udhëheqjes, për denigrimin e diskreditimin e saj.

Është e domosdoshme që ne, si anëtarë partie dhe punonjës të aparatit të Komitetit Qendror, t'i kuptojmë thellë këto çështje. Natyrisht, ne bëmë gabim që ndonjë problem nuk e sqaruam më mirë qysh më parë, por këtë nuk e bëmë për arsye që të mos lejonim kuriozitetet. Për shembull lidhur me çështjen e Stalinit, mendojmë se ato që duhej të mësonte Partia dhe populli, ne ua thamë dhe do t'ua themi. Ndërsa si janë zhvilluar ngjarjet në BRSS dhe rrjedhimet e tyre janë çështje që i përkasin PK të BS e popullit sovjetik dhe jo neve. Po kështu edhe krimet e fajet e Koçi Xoxes janë çështje që na përkasin neve dhe në detaje, s'ka pse t'i marrin vesh vendet e tjera. Partitë e tjera le të dinë ato që dinë, hollësitë i dinë populli dhe Partia jonë, se këto janë çështje që na përkasin neve.

Siç e thashë edhe më parë, nga këto situata, nga mungesa e një sqarimi të plotë, nga mungesa e kritikës dhe e autokritikës së duhur, elementi armik përfitoi. Sigurisht duhet të kritikohet kush ka faj, i madh ose i vogël qoftë, po gjithnjë duke ruajtur normat e Partisë. Thuhet se mos ka familjaritet në Komitetin Qendror. E kush e thotë këtë? E thonë disa njerëz të shturur për vete, të cilët punët e tyre i bisedojnë nëpër sokakë e de-

ri në familje me gruan, me nënën e hallën duke shkelur kështu të gjitha normat dhe rregullat e Partisë. Pra një-rëz të tillë vinin çështjen se mos ka familjaritet në Komitetin Qendror të Partisë!

Është e domosdoshme që shokët t'i analizojnë mirë të metat dhe gabimet, të armatosen me të gjitha vendimet e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit dhe të venë në bazë të përgatitur mirë, me qëllim që të mos gjendemi në befasi. Në qoftë se shokët që punojnë në aparatin e Komitetit Qendror nuk do të jenë më parë të sqaruar vetë, atëhere njerëzit do të kërkojnë të takohen për çdo gjë vetëm me Enverin, në vend që të takohen me ndonjë shok tjetër.

Këtu u ngrit dhe foli shoku T.M., të cilin e dëgjova me vëmendje se ç'tha dhe ç'ka bërë. Po unë nuk e kuptoj pse e bëri ai autokritikën, që u takua me Vehip Demin, para se të zhvillohet Konferenca e Tiranës? Po Vehip Demi në atë kohë ishte anëtar partie, pavarësisht se doli armik. T.M. i foli mirë, i tha se për të ngritur jetën e popullit duhet punuar, duhet rritur rendimenti etj. Unë nuk pashë ndonjë gjë të gabuar në këtë veprim të tij.

Po kështu mund të them edhe për diskutimin e shokut M. R. Gjysmë ore foli ai për të pohuar se i ka thënë shokut M. rusisht «Kak djella?»¹ dhe M.R. i shkretë në këtë situatë ka menduar «dale more se mos ma marrin shtrembër» dhe u mundua të na e thoshte si ishte çështja. M.R. jo vetëm ta pyeste këtë shok si venë punët në konferencë, po bile mund t'i kërkonte edhe hollësira, pse

¹ Si venë punët.

këta janë shokë të aparatit të Komitetit Qendror. Po të binte në pozitë e shokut që gaboi në Konferencën e Tiranës, atëhere ishte një gjë tjetër dhe autokritikë duhej bërë.

Çështja e konspiracionit të kuptohet mirë. Në Parti ka konspiracion, por kjo nuk do të thotë që të mos flasim. Ne do të flasim, se punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror janë propagandistë dhe do të flasin për punët e shtetit dhe të popullit, sigurisht jo për sekretet, po për çështjet që populli duhet t'i dijë. Ne do të sqarojmë situatën dhe do të mobilizohemi bashkë me popullin për të realizuar detyrat kudo që punojmë. Por populli është popull, ai do të pyesë dhe pikërisht këtu është zotësia e secilit që të sqarohë dhe po të jetë në mes të popullit ndonjë njeri i lig, të jemi në gjendje t'i mbyllim gojën jo duke mos e lejuar të flasë, pse po u bë kështu ai do të vejë të pyesë ose të flasë gjatë. Prandaj më mirë të flasë në mbledhje përpara të gjithëve dhe të sqarohet, ose të demaskohet, sipas rastit. Këto çështje duhen kuptuar mirë. Për shembull, në rast se një shok flet në një vend për çështjet ekonomike, dikush mund ta pyesë: «Unë mëre shok, këtë çështje nuk e kam të qartë». Në këtë rast shoku ynë e ka për detyrë të japë shpjegime. Këto janë rregulla të domosdoshme që duhet të zbatohen. Një nga inspektorët e Komitetit Qendror tha këtu si me drojtje se çështjet e Konferencës së Tiranës ia tha edhe shokut Sadik Bocaj, sekretarit të parë të Partisë të rrethit të Shkodrës. Medoemos t'ia thoshte dhe jo vetëm sekretarit të parë, po dhe të dytit dhe të theksonte se ajo është një punë armiqësore etj. Kështu duhet bërë. Në qoftë se ne nuk i kuptojmë drejt

këto çështje, atëhere edhe në bazë nuk do t'i kuptojnë si duhet dhe pastaj mund të ndodhë që njëri të ngrejë një problem e t'i thuhet: «Pusho ti, shok, këtë thuaje në organizatën bazë». Mirëpo ne jemi shokë dhe do të bisedojmë për këtë ose për atë çështje, do të kritikojmë bashkë, për shembull edhe sektorin e bujqësisë që nuk shkon mirë. Dhe këtë s'po e bëjmë me një njeri të huaj, po ne me njëri-tjetrin. Po nuk diskutuam, atëhere ç'do të themi me shokët që takojmë, vetëm: «Oh, sa e mirë është koha?» Bisedojmë e kritikojmë që shokët e bujqësisë të shkunden, që tokat të punohen në kohë, të ngrihen rendimentet etj. Këtë duhet ta bëjmë dhe ca më mirë, se jemi si familje e madhe me shumë njerëz dhe nga ne baza pret shumë. Sigurisht diskutimet duhet të jenë të shëndosha dhe medoemos në rrugë partie. Po i kuptuam si duhet këto çështje, të mos kemi frikë të diskutojmë me njëri-tjetrin. Në rast se një shok thotë një gjë të shtrembër, unë ia kundërshtoj, e vë në vend dhe, kur e shoh se ai vazhdon, informoj edhe superiorët e tij.

Tani përsa i përket autokritikës së shokëve që kanë gabuar¹ nuk kam ç'të them. Vetëm duhet pasur parasysh se kjo autokritikë është puna e parë, çështja është që secili ta tregojë me punë se e ka kuptuar me të vërtetë gabimin dhe se nuk do të bjerë më në gabime të tilla. Partia i konsideron këta njerëz të sëmurë, që për një kohë duhet të kalojnë në konvaleshencë Prandaj

¹ Është fjala për dy anëtarët e organizatës bazë të aparatit të Komitetit Qendror që mbajtën qëndrim të gabuar në Konferencën e Tiranës. Duke marrë parasysh autokritikën e tyre, ata nuk u përjashtuan nga Partia.

Shokë delegatë,

Në kongres marrin pjesë 15 delegacione të parti-ve komuniste e punëtore motra: delegacioni i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës, delegacioni i Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze, delegacioni i Partisë Komuniste të Bullgarisë, delegacioni i Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, delegacioni i Partisë Punëtore Rumune, delegacioni i Partisë së Punonjësve Hungarezë, delegacioni i Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, delegacioni i Partisë së Punës të Koresë, delegacioni i Partisë Revolucionare Popullore të Mongolisë, delegacioni i Partisë Komuniste Franceze, delegacioni i Partisë Komuniste Spanjolle, delegacioni i Partisë Komuniste të Turqisë, delegacioni i Partisë Komuniste të Siri-Libanit, delegacioni i Partisë Komuniste të Austrisë.

Pjesëmarrja e tyre në kongresin tonë është një shprehje e gjallë e solidaritetit ndërkombëtar të partive tona motra dhe e internacionalizmit proletar. Më lejoni, shokë, që në emër të Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë, të përshëndes delegacionet e partive komuniste e punëtore motra dhe t'u uroj edhe një herë mirëseardhjen në vendin tonë, në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 126 (2395), 26 maj 1956

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**RAPORT NË KONGRESIN III TË PPSH
«MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»**

25 maj 1956

Shokë,

Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë po mblidhet në kushte shumë të favorshme të jashtme dhe të brendshme. Nga Kongresi II i Partisë kanë kaluar katër vjet. Ju e mbani mend se në atë kohë gjendja ndërkombëtare ishte mjaft e nderë, imperialistët nga pregatitja për agresion ishin hedhur në agresion të hapur në Kore, vazhdonte gjakderdhja në Indokinë. Kongresi III i Partisë sonë mblidhet në një kohë kur, në saje të politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera të kampit të socializmit, në saje të lëvizjes së fuqishme të popujve kundër luftës, për mbrojtjen e paqes, lufta në këto vende pushoi dhe tensioni ndërkombëtar po shkon drejt uljes.

Pozita e jashtme dhe e brendshme e Republikës Popullore të Shqipërisë që nga Kongresi II i Partisë është forcuar. Kanë dështuar të gjitha përpjekjet e shteteve imperialiste për ta shkëputur Shqipërinë nga gjiri i kampit të socializmit dhe për t'i mohuar të drejtat e saja të ligjshme në arenën ndërkombëtare si shtet sovran e i pavarur.

Shokë delegatë,

Në kongres marrin pjesë 15 delegacione të partive komuniste e punëtore motra: delegacioni i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës, delegacioni i Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze, delegacioni i Partisë Komuniste të Bullgarisë, delegacioni i Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, delegacioni i Partisë Punëtore Rumune, delegacioni i Partisë së Punonjësve Hungarezë, delegacioni i Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, delegacioni i Partisë së Punës të Koresë, delegacioni i Partisë Revolucionare Popullore të Mongolisë, delegacioni i Partisë Komuniste Franceze, delegacioni i Partisë Komuniste Spanjolle, delegacioni i Partisë Komuniste të Turqisë, delegacioni i Partisë Komuniste të Siri-Libanit, delegacioni i Partisë Komuniste të Austrisë.

Pjesëmarrja e tyre në kongresin tonë është një shprehje e gjallë e solidaritetit ndërkombëtar të partive tona motra dhe e internacionalizmit proletar. Më lejoni, shokë, që në emër të Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë, të përshëndes delegacionet e partive komuniste e punëtore motra dhe t'u uroj edhe një herë mirëseardhjen në vendin tonë, në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 126 (2395), 26 maj 1956

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**RAPORT NË KONGRESIN III TË PPSH
«MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»**

25 maj 1956

Shokë,

Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë po mbledhet në kushte shumë të favorshme të jashtme dhe të brendshme. Nga Kongresi II i Partisë kanë kaluar katër vjet. Ju e mbani mend se në atë kohë gjendja ndërkombëtare ishte mjaft e nderë, imperialistët nga përgatitja për agresion ishin hedhur në agresion të hapur në Kore, vazhdonte gjakderdhja në Indokinë. Kongresi III i Partisë sonë mbledhet në një kohë kur, në saje të politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera të kampit të socializmit, në saje të lëvizjes së fuqishme të popujve kundër luftës, për mbrojtjen e paqes, lufta në këto vende pushoi dhe tensioni ndërkombëtar po shkon drejt uljes.

Pozita e jashtme dhe e brendshme e Republikës Popullore të Shqipërisë që nga Kongresi II i Partisë është forcuar. Kanë dështuar të gjitha përpjekjet e shteteve imperialiste për ta shkëputur Shqipërinë nga gjiri i kampit të socializmit dhe për t'i mohuar të drejtat e saja të ligjshme në arenën ndërkombëtare si shtet sovran, e i pavarur.

Gjatë kësaj periudhe, në bazë të detyrave kryesore që caktonte plani i parë pesëvjeçar, Shqipëria nga një vend agrar i prapambetur u kthye në një vend agraro-industrial. Kongresi III i Partisë sonë gjatë pesëvjeçarit të dytë duke u mbështetur në realizimet e planit të parë pesëvjeçar do të caktojë rrugët e zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë e të kulturës sonë popullore.

Të gjitha këto suksese janë arritur në saje të patriotizmit të lartë të popullit tonë trim e punëtor, të udhëheqjes së Partisë sonë heroike, në saje të doktrinës ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit e në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera mike.

Kongresi ynë III po zhvillohet pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik...¹

¹ Kongresi XX i PK të BS u mbajt në shkurt 1956. Në këtë kongres grupi i Hrushovit shpërtheu një sulm të ashpër kundër parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe shtroi një sërë tezash revizioniste, që sollën çoroditje të thellë ideologjike në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Në raportin «sekret» «Mbi kultin e individit dhe pasojat e tija» mbajtur në Kongresin XX nga Hrushovi, u godit J. V. Stalini e vepra e tij e madhe revolucionare. Qëllimi i kësaj goditjeje ishte të përligjej asgjësimi i vijës marksiste-leniniste të Partisë Bolshevike, të zëvendësohej ajo me një vijë të re politike revizioniste dhe të revizionohej marksizëm-leninizmi. J. V. Stalini ka qenë dhe mbetet një revolucionar e marksist-leninist i madh dhe një udhëheqës i shquar i lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Stalini udhëhoqi me urtësi e zotësi 30 vjet rresht partinë dhe shtetin sovjetik, në luftë të ashpër me të gjithë armiqtë e Bashkimit Sovjetik e të socializmit, dha një kontribut të çmuar në formimin dhe konsolidimin e kampit socialist, në forcimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, zhvilloi një luftë të ashpër

I

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Shokë,

Tipari kryesor i epokës sonë është dalja e socializmit nga kuadri i një shteti të vetëm dhe shndërrimi i tij në një sistem botëror. Forcat imperialiste, me gjithë përpjekjet e tyre dhe luftërat e përgjakshme që provokuan, ishin të pafuqishme për ta ndaluar këtë transformim historik të shoqërisë njerëzore.

Bashkimi Sovjetik, i pari shtet socialist në botë, u bë baza e sistemit botëror socialist.

kundër imperializmit dhe reaksionit ndërkombëtar.

Pas Kongresit XX grupi revizionist i Hrushovit ushtroi një presion të gjithanshëm mbi udhëheqjet e partive komuniste e punëtoresh për t'i detyruar ato të ndiqnin kursin revizionist të këtij kongresi.

Gjatë përgatitjes për Kongresin III, PPSH u ndodh përpara këtyre problemeve të mprehta që nxori Kongresi XX i PK të BS për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, si dhe nën presionin që udhëheqja sovjetike ushtroi mbi të për t'i imponuar kursin e vet revizionist.

Megjithëse në Kongresin III PPSH nuk i dënoi hapur tezat

Populli sovjetik, pasi mbrojti në luftën civile fitoret e mëdha të Revolucionit socialist të Tetorit, rimëkëmbi ekonominë e shkatërruar dhe brenda një kohe të shkurtër, që s'ka shembull, ndërtoi shtetin e parë socialist në botë. Në luftën e vështirë dhe të përgjakshme, populli sovjetik korri fitoren e shkëlqyer mbi ushtrinë fashiste gjermane të armatosur deri në dhëmbë. Sistemi socialist kaloi provat më të rënda dhe vërtetoi epërsinë e tij mbi

antimarksiste të Kongresit XX, të gjitha konkluzionet dhe vendimet e kongresit u përshkuan nga një frymë revolucionare marksiste-leniniste. Në atë kohë Partia jonë nuk mund të dilte hapur kundër tezave të Kongresit XX, sepse kjo do t'u shërbente vetëm armlqve të komunizmit, që ishin hedhur në sulm të tërbuar kundër marksizëm-leninizmit dhe kampit socialist dhe se Partia e Punës e Shqipërisë nuk kishte krijuar plotësisht bindjen se Hrushovi me grupin e tij kishin tradhëtuar marksizëm-leninizmin, shpresonte se udhëheqja sovjetike do t'i kuptonte gabimet e do t'i korrigjonte ato. Komiteti Qendror i Partisë sonë, në të njëjtën kohë, në rrugë partie, ia kishte bërë të njohur Komitetit Qendror të PK të BS të gjitha rezervat e kundërshtimet që kishte për tezat e Kongresit XX dhe për veprimtarinë revizioniste të udhëheqjes sovjetike.

Kur u bë krejtësisht e qartë tradhëtia revizioniste sovjetike, Partia e Punës e Shqipërisë u ngrit hapur kundër saj. Në mbledhjen e partive komuniste e punëtore të Moskës në nëntor 1960 delegacioni i Partisë sonë, i kryesuar nga shoku Enver Hoxha, kritikoi drejtpërdrejt tezat revizioniste të Kongresit XX, udhëheqjen revizioniste hrushoviane, pikëpamjet dhe veprimtarinë e saj antimarksiste, antisocialiste e antikomuniste.

PPSH, ndryshe nga ajo që ndodhi në mjaft parti të tjera komuniste e punëtore, nuk bëri lëshime parimore përpara presionit të udhëheqjes revizioniste sovjetike dhe ruajti të paprekur vijën e saj të përgjithshme marksiste-leniniste.

sistemin kapitalist. Kjo solli kriza të rënda për sistemin kapitalist dhe i hapi njerëzimit perspektiva të shkëlqyeshme për ndërtimin e një bote të lirë, pa shfrytëzues e të shfrytëzuar.

Në saje të Luftës së madhe patriotike të popullit sovjetik kundër fashistëve gjermanë e japonezë, të luftës së shumë popujve të Evropës dhe të Azisë, që ishin ngritur kundër fashistëve okupatorë për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tyre, u krijuan shtetet e demokracisë popullore në Evropë dhe në Azi.

Krijimi i vendeve të demokracisë popullore të Evropës dhe të Azisë dhe kalimi i tyre gradual nga kapitalizmi në socializëm u bë i mundur, së pari, sepse lufta nacional-çlirimtare e këtyre popujve, që grumbulloi të gjitha masat punonjëse dhe patriotët e vendit, u udhëhoq nga klasa punëtore me pararojën e saj, partinë komuniste ose punëtore në krye; së dyti, sepse popujt e këtyre vendeve e lidhën ngushtë luftën e tyre çlirimtare kundër okupatorëve fashistë dhe borgjezisë reaksionare të vendit me luftën çlirimtare të Bashkimit Sovjetik; së treti, sepse pas çlirimit, gjatë reformave të mëdha ekonomike dhe shoqërore që u kryen në vendet e demokracisë popullore dhe gjatë zbatimit të formave të ndryshme të kalimit nga kapitalizmi në socializëm, klasa punëtore, me pararojën e saj në krye, ishte udhëheqësja politike konsekuente, kusht i domosdoshëm dhe vendimtar për të kaluar në socializëm; së katërti, sepse kalimi i vendeve të demokracisë popullore në socializëm dhe forcimi i regjimit socialist në këto vende u kryen me sukses në saje të fitores së socializmit në Bashkimin Sovjetik, të

bashkëpunimit të ngushtë dhe vëllazëror të vendeve të demokracisë popullore me Bashkimin Sovjetik dhe të ndihmës së tij të shumanshme.

Kampi botëror i socializmit është një realitet i fuqishëm shtetesh me Bashkimin Sovjetik në krye. Vendet që formojnë kampin e socializmit janë shtete të pavarura ekonomikisht dhe politikisht, janë vende sovrane. Në mes të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, ekziston një bashkëpunim ekonomik i ngushtë. Zhvillimi ekonomik i Bashkimit Sovjetik dhe i vendeve të demokracisë popullore bëhet i koordinuar dhe i harmonishëm, duke pasur për objekt interesat e veçanta të çdo shteti në veçanti dhe të kampit në përgjithësi. Në mes të vendeve të kampit të socializmit ekzistojnë lidhje të fuqishme miqësore dhe vëllazërore, sepse në bazë të kësaj miqësie qëndrojnë interesat e përbashkëta të popujve tanë. Burimi për realizimin e drejtë dhe më të shpejtë të këtyre interesave është shkenca pararojë marksiste-leniniste, e cila përbën armën më të fuqishme dhe busullën e partive komuniste e punëtore që drejtojnë fatet e popujve tanë në rrugën e socializmit. Interesat jetike të popujve tanë për të mbrojtur lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin, të fituara me vuajtje dhe me sakrifica, gjejnë shprehjen më të gjallë në aleancën e ngushtë vëllazërore të vendeve tona. Vendet tona të kampit të socializmit dëshirojnë paqen dhe miqësinë në mes të popujve dhe luftojnë për to. Kjo gjë, që është një faktor i rëndësishëm dhe një shprehje e fuqishme e qindra milion njerëzve me vullnet të mirë, të cilët përbëjnë kampin e socializmit, i vëllazëron popujt tanë dhe koordinon çdo veprim të tyre, qoftë në çështjet e brend-

shme për sigurimin e mirëqenies së popujve tanë, qoftë në politikën ndërkombëtare.

Zhvillimi ekonomik i vendeve të kampit të socializmit bëhet pa ndërprerje. Ekonomia socialiste nuk njihet kriza, siç ndodh në ekonominë kapitaliste. Bashkimi Sovjetik, duke kapërcyer edhe periudha jashtëzakonisht të vështira, siç ishte Lufta e dytë botërore, që prej vitit 1927 e ka rritur vëllimin e prodhimit industrial 20 herë, kurse të gjitha vendet kapitaliste, po në të njëjtën periudhë e kanë rritur vëllimin e prodhimit industrial vetëm 193 për qind. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë rritur prodhimin industrial pak më shumë se dy herë, por edhe kjo rritje i detyrohet garës së shfrenuar të armatimeve dhe luftës në Kore.

Direktivat e Kongresit XX për planin e gjashtë pesëvjeçar.....

Shokë,

Faktet e pamohueshme historike vërtetojnë se Bashkimi Sovjetik, i mbështetur që në ditët e para të jetës së tij në parimet leniniste të bashkekzistencës paqësore, është përpjekur vazhdimisht për përmirësimin e marrëdhënieve në mes të shteteve të mëdhenj e të vegjël, për vendosjen e marrëdhënieve normale midis shteteve me sisteme të ndryshme politike. Vendet e demokracisë popullore kanë ndjekur gjithashtu në çdo kohë një politikë të tillë ndërkombëtare. Në vendet ku sundon kapitali, ku pjesën më të madhe të buxhetit shtetëror ia kushtojnë armatimeve dhe ku shtetet imperialiste e drejtojnë eko-

nominë e tyre drejt militarizimit, atje jeta e masave punonjëse është e mjerueshme, kurse në vendet e kampit tonë socialist i gjithë kujdesi drejtohet në ndërtimin e ekonomisë socialiste, në ngritjen e prodhimit industrial, bujqësor dhe të nivelit material e kultural të masave punonjëse. Shtetet imperialiste që i kanë imponuar vetes një barrë kolosale në drejtim të armatimeve, me politikën e tyre «nga pozitativ e forcës» dhe me «luftën e ftohtë» të tyre, mundohen që një gjë të tillë t'ia imponojnë edhe kampit tonë të socializmit. Imperialistët amerikanë dhe partnerët e tyre krijuan Paktin agresiv të Atlantikut Verior, Bashkimin e Evropës Perëndimore dhe filluan armatimin e militaristëve gjermanë. Veprime të tilla të imperialistëve ngjajnë si dy pika uji me veprimet e imperialistëve dhe të fashistëve gjermanë-italianë dhe japonezë që përgatitën dhe shpërthyen Luftën e dytë botërore... Imperialistët amerikanë vazhduan krijimin e pakteve të tjera agresive: atë të Azisë Juglindore ose SEATO dhe Paktin e Bagdadit që u krijua më vonë nën drejtimin e imperialistëve anglezë. Të gjitha këto pakte ushtarake, të gjitha bazat ushtarake të krijuara nga amerikanët rreth vendeve të socializmit dhe armatimi i vazhdueshëm në një shkallë të madhe, vërtetojnë qartë qëllimet agresive të imperialistëve kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Kurse nga ana e Bashkimit Sovjetik janë bërë vazhdimisht propozime paqësore konstruktive në interes të të gjitha shteteve, si ato për zhdukjen e vatrave të luftës, për rregullimin e marrëdhënieve me një varg shtetesh dhe për uljen e tensionit, për krijimin e një sistemi të sigurimit kolektiv në Evropë, për çarmatimin, për problemin gjerman, për

zgjerimin e kontakteve dhe lidhjeve ndërkombëtare në të gjitha drejtimet etj.

Kjo politikë paqësore, pati efektet e saj në lëmin ndërkombëtar. Pas kaq vjet gjakderdhjeje populli korean e fitoi luftën dhe atje u nënshkrua armëpushimi; gjithashtu edhe populli i Vietnamit e fitoi luftën dhe atje u nënshkrua armëpushimi. Shteteve imperialiste, natyrisht, nuk u pëlqente që gjendja të rrokullisej në disfavorin e tyre; ato janë përpjekur me të gjitha mjetet për ta vazhduar politikën e tyre të «luftës së ftohtë». Por përpjekjet e tyre nuk patën sukses dhe u arrit Konferenca e katër fuqive të mëdha në Gjenevë. Fryma e Gjenevës, me gjithë përpjekjet e propagandës që zhvillojnë shtetet imperialiste në favor të politikës «nga pozitrat e forcës», nuk është shuar. Përkundrazi, politikën paqësore të kampit të socializmit e përkrahin shumë shtete të tjera të Evropës, të Azisë e të Afrikës. Të gjithë popujt dhe shtetet paqëndashëse e kanë të qartë se duhet të realizohen tri problemet më të rëndësishme: sigurimi kolektiv në Evropë, sigurimi kolektiv në Azi dhe çarmatimi, zgjidhja e të cilave mund të krijojë bazën për një paqe të qëndrueshme dhe të gjatë.

S'ka asnjë dyshim se marrëveshjet e Parisit, që kanë për qëllim armatimin e revanshistëve gjermanë, nuk i përgatitin asgjë të mirë botës, veçse katastrofën. Marrëveshjet e Parisit janë vdekjeprurëse për popujt gjerman, francez dhe anglez. Bashkimi Sovjetik bëri përpjekje të mëdha dhe propozime të shumta që këto marrëveshje të mos bëheshin realitet. Jehona e përpjekjeve paqësore të Bashkimit Sovjetik ishte e madhe në Francë, në Angli, në Gjermaninë Perëndimore. Forcat përparim-

tare të këtyre vendeve, me klasën punëtore në krye, luftuan me heroizëm kundër planeve të imperialistëve dhe të militaristëve gjermanë. Përpara këtij rreziku të luftës dhe të ringjalljes së Vermahtit gjerman, vendet e kampit të socializmit përfunduan Traktatin e Varshavës, si një faktor i rëndësishëm stabilizimi dhe paqëje në Evropë, si një akt për të mbrojtur jetën paqësore të vendeve tona nga një agresion i mundshëm. Vendosja e një sistemi të mbrojtjes kolektive në Evropë, të propozuar nga Bashkimi Sovjetik dhe të mbështetur fuqimisht nga shtetet e demokracisë popullore dhe njerëzit me vullnet të mirë e paqedashës të Evropës dhe të të gjitha kontinenteve, po rrënjohet thellë në ndërgjegjen e njerëzve, sepse është një mjet i fuqishëm për të shpëtuar njerëzimin nga një luftë tjetër. Gjithashtu propozimet sovjetike për zgjidhjen e problemit gjerman, për bashkimin e tij në një shtet demokratik dhe paqësor, janë e vetmja zgjidhje e drejtë e këtij problemi kaq të rëndësishëm, jo vetëm për të ardhshmen e një populli të madh, siç është populli gjerman, por edhe për fatet e Evropës.

Përpyekjet e Bashkimit Sovjetik për të arritur në një zgjidhje pozitive për problemin e çarmatimit dhe për ndalimin e bombës atomike dhe me hidrogjen, janë të njohura nga të gjithë popujt e botës. Propozimet e Bashkimit Sovjetik në lidhje me këtë problem kaq të rëndësishëm, natyrisht, gjejnë pengesa të mëdha nga imperialistët dhe militaristët, nga ata që rrojnë me tregëtinë e armëve dhe me gjakun e njerëzve...

Parimi leninist mbi bashkekzistencën paqësore të dy sistemeve, të sistemit socialist dhe atij kapitalist, ka

udhëhequr kurdoherë politikën paqësore të Bashkimit Sovjetik. Shteti socialist s'ka asnjë arësyje të shpërthejë një luftë agresive, sepse shteti socialist nuk ka as një-rëz as grupe që të kenë interesa agresive për t'u pasuruar në kurriz të shteteve të tjera. Sistemi socialist ka për qëllim të zhdukë shfrytëzimin e njeriut prej njeriut, të ndërtojë një shoqëri pa shfrytëzues dhe të shfrytëzuar. Bashkekzistenca paqësore në mes të dy sistemeve të ndryshme, nuk do të thotë aspak se nga ana e komunistëve ose e shteteve socialiste duhet të bëhen lëshime parimore; përkundrazi, këto do të mbrohen me vendosmërinë më të madhe. Lufta kundër ideologjisë borgjeze, kundër mbeturinave mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve do të vazhdohet me të gjitha fuqitë tona. Ne, komunistët, jemi kundër kapitalizmit dhe luftojmë e do të luftojmë deri në fund për ta shkukur atë nga rrënjët dhe këtu ne ndryshojmë nga elementët oportunistë dhe reformistë, të cilët me anë reformash kërkojnë gjoja të ndryshojnë sistemin kapitalist, kurse në të vërtetë ata ndihmojnë në këtë mënyrë forcimin e tij, i zgjatin atij jetën në dëm të klasës punëtore dhe të masave punonjëse. Sistemi socialist do të fitojë mbi sistemin kapitalist dhe triumfi i komunizmit është i pashmangshëm. Kjo e vërtetë e madhe u provua nga jeta, ajo po përqafohet nga qindra milion njerëz.

Jeta e re, socializmi, ndërtohet nga vetë popujt kur janë pjekur kushtet në vend. Revolucioni nuk eksportohet nga një vend në tjetrin, siç pretendojnë kapitalistët... S'ka asnjë dyshim se komunistët janë kundër kapitalizmit dhe luftojnë për ta zhdukur atë, por kjo

nuk do të thotë, që shteti ku ka triumfuar socializmi të ndërhyjë në punët e brendshme të një shteti tjetër. Në çdo vend, masat punonjëse me klasën e tyre punëtore në krye, në kushtet dhe në rrethanat e posaçme të atij vendi, do të ndërmarrin veprime për të ndërtuar jetën socialiste.

Le të marrim për shembull vendin tonë, ku populli me luftë të armatosur mori fuqinë në dorë, vendosi demokracinë popullore dhe hyri në rrugën e socializmit. Populli ynë ka vuajtur me shekuj në robëri dhe ka luftuar për lirinë dhe pavarësinë e tij. Në vitin 1939 vendi ynë u sulmua e u pushtua dhe populli u gjakos nga armiqtë e nga tradhëtarët. Ç'bëri populli ynë? Rroku armët si gjithmonë për të luftuar dhe për të fituar lirinë. Komunistët shqiptarë, bij të popullit të vuajtur, që s'kishin tjetër interes përveç interesave të larta të atdheut dhe të popullit, u udhëhoqën nga marksizëm-leninizmi, formuan Partinë Komuniste, e cila, me besnikërinë më të madhe dhe me heroizëm e sakrificë të papërshkrueshme, e çoi popullin në fitore. Populli shqiptar pati besimin më të madh te Partia e tij dhe e ndoqi atë deri në fund. Partia jonë ishte kundër okupatorëve, kundër regjimit shtypës të ish-mbretit, të bejlerëve dhe të borgjezisë reaksionare, ishte për vendosjen e pushtetit popullor. Rruga dhe programi i Partisë ishin shpresat dhe aspiratat e popullit, prandaj Partinë e ndoqi populli. Duhet thënë se regjimi i reaksionit dhe i kapitalit, bejlerët dhe agallarët e vendit tonë që formuan «Ballin Kombëtar» dhe organizata të tjera tradhëtare, kishin të gjithë mbështetjen morale dhe materiale të okupatorëve italianë dhe gjermanë. Megjithkëtë

ata u thyen. Reaksioni në vendin tonë, përveç mbësh-tetjes së hitlerianëve, u përkrah dhe u ndihmua hapët nga qarqet imperialiste reaksionare angleze dhe ameri-kane, të cilat ndërhyjnë vazhdimisht në punët e brend-shme të popullit tonë, për të mos e lënë këtë të merrte fuqinë. Pra, revolucioni popullor në vendin tonë, kon-kretisht, nuk u importua nga Bashkimi Sovjetik, por u bë nga populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij heroike Komuniste, besnike e ideve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit. Pra, shpëtimi i popullit shqip-tar nga robëria shekullore i detyrohet luftës së tij dhe luftës së Bashkimit Sovjetik. Këto të dyja janë të li-dhura ngushtë si mishi me thoin. Bashkimi Sovjetik e mbrojti popullin tonë dhe e ndihmoi atë të përforconte fitoren që kërkonin t'ia rrëmbenin nga duart imperia-listët e ndryshëm. Vazhdimisht ndërhyjnë imperialistët amerikanë, anglezë etj. në punët e brendshme të popu-llit tonë, por ndihma morale dhe materiale e Bashkimit Sovjetik në të gjitha fushat, bëri që planet e imperialis-tëve të dështonin të gjitha dhe vendi ynë të ecte për-para i sigurtë në rrugën e ndërtimit të socializmit. Si-gurisht, imperialistët dhe reaksionarët e vendit tonë dëshironin dhe përpiqeshin që Shqipëria e re të izolo-hej, që ta gëlltitnin lehtë. Por kjo s'ngjau, sepse populli ynë u lidh me një miqësi të sinqertë me mbrojtësin e tij të lavdishëm, Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të demokracisë popullore, sepse Partia e Punës e Shqipërisë është frymëzuar dhe do të frymëzohet vazh-dimisht nga marksizëm-leninizmi dhe nga eksperiencia e Partisë së lavdishme Bolshevike, sepse vendi ynë i ka

lidhur fatet e tij me kampin e socializmit dhe të paqes.

.....
 Teza leniniste se përderisa ekziston imperializmi mbetet edhe baza ekonomike për shpërthimin e luftërave, qëndron në fuqi, prandaj forcat e socializmit dhe të paqes duhet të jenë kurdoherë vigjilente.

Shokë,

Që në ditët e para pas Luftës së dytë botërore në politikën ndërkombëtare u dukën dy vija politike në kundërshtim me njëra-tjetrën: politika e kampit të paqes e të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye, politikë paqësore e bashkëpunimi në mes të shteteve dhe zhvillimi normal të marrëdhënieve tregëtare e kulturele etj. dhe politika e kampit imperialist me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, politikë agresive, politikë e bloqeve ushtarake të drejtuara kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore, politikë skllavërimi ekonomik dhe politik të popujve, politikë shantazhesh, frikësimesh, provokimesh dhe luftërash të hapëta. Pa dyshim një politikë e tillë agresive, një politikë e buxheteve kolosale të luftës, një politikë e «luftës së ftohtë dhe të nxehtë» njëkohësisht e bërë nga qarqet imperialiste agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të partnerëve të tjerë, solli si rezultat acarimin e gjendjes ndërkombëtare dhe ngritjen e tensionit ndërkombëtar. Zhvillimi i gjendjes ndërkombëtare në një rrugë të tillë të rrezikshme, ku kërkohnin ta çonin njerëzimin në monopolin imperialist të SHBA-së, krijoi një shqetësim të madh në popujt, të cilët

shikonin afrimin e një katastrofe tjetër botërore. Përpara një gjendjeje të tillë kritike, popujt nuk qëndruan me duar lidhur, por u çuan peshë, u grumbulluan, u organizuan në një lëvizje të fuqishme botërore të paqes, që nuk është parë kurrë ndonjëherë në historinë e popujve të botës. Politika paqësore e Bashkimit Sovjetik u mbështet me të gjitha forcat nga të gjithë njerëzit paqedashës dhe vullnetmirë të botës. Kjo nuk ishte e rastit. Arësyeja ishte se politika e Bashkimit Sovjetik shprehte ndjenjat dhe dëshirat e qindra milion njerëzve të thjeshtë në botë me pikëpamje të ndryshme politike e shoqërore dhe me besime fetare të ndryshme. Kjo lëvizje e fuqishme për mbrojtjen e paqes u bë një pengesë e madhe për realizimin e planeve të luftës së imperialistëve. Parulla e tyre se gjoja kjo lëvizje botërore e paqes ishte një lëvizje thjesht komuniste, nuk pati sukses. Për çdo njeri u bë e qartë se përgatitja e «luftës së ftohtë dhe e luftës së nxehtë» dhe politika nga pozitat e forcës ishin pjellë e monopoleve imperialiste të etura për fitime kolosale në kurriz të popujve, ishte politika e tyre imperialiste, që përpiqen të kthejnë prapa rrotën e historisë, duke ëndërruar shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik dhe të shteteve të demokracisë popullore. Sigurisht, te lufta ata shohin të vetmin mjet për t'ia arritur këtij qëllimi. Kundërshtimi i rreptë i popujve kundër këtyre planeve është i ligjshëm dhe i pashmangshëm. Kjo rezistencë e vendosur e popujve kundër përgatitjes së një lufte të re nga imperialistët e ngriti prestigjin e Bashkimit Sovjetik në botë, e forcoi dashurinë e madhe të popujve për atdheun e socializmit dhe të komunizmit, ku ata gjetën, si kurdoherë,

mbështetjen e madhe morale e materiale për realizimin e çështjes më të bukur të njerëzimit, të socializmit dhe të paqes në botë. Kjo rezistencë e popujve kundër pregtitjes së luftës nga imperialistët bëri që të demaskohen qëllimet djallëzore të luftënxitësve imperialistë, të izolohen ata politikisht nga masat e popujve dhe të vërte-tohen lëkundje e të çara çdo ditë e më të mëdha midis pjesëmarrësve të ndryshëm të pakteve ushtarake agresive, të krijuara për qëllime lufte nga luftënxitësit imperialistë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Arësyet e luftërave, që janë fatkeqësia më e madhe e njerëzimit, qëndrojnë në qëllimet e monopoleve që drejtojnë ekonominë kapitaliste, e cila synon në pasurimin kurdoherë më të madh të një grupi milionerësh dhe miliarderësh në kurrizin e masave punonjëse, në shfrytëzimin mizor të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve, në kërkimin e tregjeve të reja, në konkurrencën e shfrenuar në mes të grupeve dhe shteteve kapitaliste, në militarizimin e ekonomisë dhe, më në fund, në ndarjen e re të botës dhe të pasurive materiale me anë konfliktesh dhe luftërash të përgjakshme. Ekonomia kapitaliste nuk mund të gjejë stabilitet dhe të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe të harmonishme, si zhvillohet ekonomia socialiste. Krizat e vazhdueshme, krizat në prodhimin industrial dhe krizat financiare, krizat në lëmin e prodhimit bujqësor përbëjnë një gjë të vetme dhe të pandarë me ekonominë kapitaliste. Një zhvillim i tillë shkakton që kriza e përgjithshme e kapitalizmit të shkojë kurdoherë duke u thelluar. Lufta për të zotëruar tregjet e vendeve kapitaliste, ato të vendeve koloniale dhe të varura po zhvillohet

me ashpërsinë më të madhe nga monopolistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë, Francës, Gjermanisë Perëndimore, Japonisë e të tjera. Natyrisht, kjo ka shkaktuar një konkurrencë të fortë e cila shkon duke u rritur. Monopolistët amerikanë dhe qarqet drejtuese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me planin e tyre Marshall, mundën të krijojnë pas Luftës së dytë botërore, një gjendje të favorshme për veten e tyre, duke shfrytëzuar dobësimin e Anglisë dhe të Francës, si edhe dëbimin e përkohshëm të monopolistëve gjermanë dhe japonezë nga tregjet botërore. Por një gjendje e tillë e favorshme për kapitalistët amerikanë nuk mund të ishte e vazhdueshme për arsye se prodhimi industrial si në Angli, ashtu edhe në Francë, megjithëse në një përqindje të vogël, e ka tejkaluar prodhimin e paraluftës dhe Gjermania Perëndimore si dhe Japonia janë bërë tani konkurrente të rrezikshme të monopoleve amerikane, angleze dhe franceze në tregjet botërore kapitaliste, si edhe në ato të vendeve koloniale dhe gjysmëkoloniale. Për këtë arsye lufta ekonomike në mes të shteteve të ndryshme kapitaliste shkon dita-ditës duke u thelluar. Kontradikta dhe kundërshtime çdo ditë e më të mëdha po duken në mes të pjesëmarrësve të Paktit famëkeq të Atlantikut. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumë më të favorizuar nga çdo shtet tjetër që ka marrë pjesë në luftën antihitleriane, jo vetëm që mundën të shfrytëzojnë deri në fund situatat e vështira ekonomike të vendeve të Perëndimit dhe t'ia nënshtrojnë degë të tëra të ekonomisë së këtyre vendeve diktatit të monopoleve amerikane, por ata mundën të krijojnë pakte agresive kundër

Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore, të marrin koncesione të mëdha tokësore nga partnerët e tyre të dobët dhe, duke shkelur sovranitetin e këtyre vendeve, të ndërtojnë baza ushtarake në të gjitha anët përreth Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Gjithashtu vendet kapitaliste me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, si pjesë përbërëse e pakteve agresive që ata krijuan, filluan në shkallë të gjerë militarizimin e ekonomisë së tyre, duke lënë pasdore zhvillimin e prodhimit industrial dhe bujqësor. Ata filluan garën e armatimeve. Buxhetet e luftës u rritën jashtëzakonisht shumë dhe kjo, natyrisht, jo vetëm që nuk sillte asgjë të mirë për njerëzimin, por, veçanërisht në vendet e Perëndimit, solli varfërimin e madh, mjerimin, urinë dhe papunësinë për masat e gjera punonjëse. Klasa punëtore dhe punonjësit e vendeve Perëndimore e panë qartë se politika e armatimit që bëhej në kurrizin e tyre, kishte për qëllim vetëm pasurimin e monopolistëve dhe aspak vendosjen e «stabilitetit të forcave në mes të shteteve të ndryshme». Ata e panë qartë se kërcënimi i një «sulmi komunist», i trilluar nga histerikët e luftës, as që ekzistonte fare. Popujt e botës kanë provuar në kurrizin e tyre, se, kur kapitalistët armatosen dhe armatimin e tyre e veshin me formulat e mirënjohura «mbrojtja e atdheut», «mbrojtja kundër sulmit komunist», ecet drejt luftës, përgatitet hedhja e popujve në kasaphana të përgjakshme për interesat e klikave sunduese kapitaliste. Këtë gjë popujt e kanë paguar me gjakun e tyre. Luftërat dhe përgatitjet për luftë sjellin varfëri dhe mjerim. Në Amerikë shpenzimet e shtetit për pajisje ushtarake

brenda këtyre pesë vjetëve të fundit janë katërfishuar; ato janë katërfishuar gjithashtu në Angli dhe trefishuar në Francë. Këto shuma kolosale jo vetëm që nuk kanë shkuar në dobinë e ekonomisë dhe të përmirësimit të jetesës së popujve të këtyre vendeve, por janë hequr nga goja e popullit për armë dhe mjete të tjera të shfarosjes në masë.

Është e kuptueshme se sistemi kapitalist me kontraktat e mëdha që ekzistojnë në gjirin e tij, me orientimin e tanishëm drejt përgatitjes së një lufte të re, me krijimin e aleancave dhe të pakteve agresive në një rrugë të tillë pa krye dhe sidomos zhvillimi i tanishëm i gjendjes ndërkombëtare drejt uljes së tensionit ndërkombëtar, bën që kriza e kapitalizmit të thellohet, me gjithë shtimin e prodhimit industrial që nga periudha e paraluftës të shkaktuar nga faktorët artificialë dhe pa një perspektivë jete të vazhdueshme. Tani është rënduar jashtëzakonisht barra e armatimeve kolosale, që u është imponuar popujve të vendeve Perëndimore nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj zëri i tyre po ngrihet gjithnjë e më i fuqishëm kundër garës së armatimit. Kufizimet drakoniane që u janë vënë nga monopolistët amerikanë partnerëve të tyre perëndimorë në lidhje me tregëtinë ndërkombëtare me Bashkimin Sovjetik, me Kinën dhe me vendet e tjera të demokracisë popullore po shturen seriozisht. Dumpingu amerikan dhe kufizimet doganore të njëanshme amerikane janë vënë kundër prodhimeve industriale të partnerëve të tjerë; gllabërimi i tregjeve kapitaliste nga monoilet amerikane ka hasur në kundërshtimet e hapëta të Anglisë dhe të Francës, të cilat

kërkojnë t'i shpëtojnë lakut amerikan që po u zë frymën dhe kërkon t'i mbytë. Kështu që tani po vihet re se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po e humbasin pak nga pak monopolin e viteve të para të pasluftës, për arsye se partnerët e tyre perëndimorë janë mëkëmbur dhe s'lejojnë që amerikanët t'u shkelin këmbët. Pra, amerikanët, duke dashur të mbjellin erën, po korrin furtunën. Qarqet sunduese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në radhë të parë, si edhe ato të Francës e të Anglisë, gjejnë vështirësi të mëdha për shitjen e armatimeve të tyre; tregjet e tyre të dikurshme në vendet koloniale dhe të varura po ngushtohen, për arsye se popujt e këtyre vendeve janë zgjuar dhe po bëjnë një luftë të vendosur kundër kolonializmit, po mëkëmbin industrinë e tyre kombëtare, po zhvillojnë prodhimin bujqësor... Ata po qëndrojnë me vendosmëri kundër pakteve agresive të kurdisura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e partnerët e saj Anglia dhe Franca. Vendet e Azisë dhe të Afrikës po zbatojnë me këmbëngulje vendimet historike të Konferencës së Bandungut dhe pesë parimet e bashkëkzistencës paqësore në mes të popujve. Vendet e çliruara nga zgjedha koloniale dhe ato që luftojnë për ta hedhur tej këtë zgjedhë të urryer dhe këtë turp të njerëzimit shohin te kampi socialist miqtë e tyre, që i duan e i ndihmojnë për të forcuar pavarësinë, lirinë e sovranitetin, për të ngritur ekonominë dhe për të përmirësuar jetën e popujve të tyre. Më kot imperialistët përpiqen me Paktin e Bagdadit të armiqësojnë popullin e madh indian me atë të Pakistanit, të futin përsëri nën zgjedhën e tyre shtetet arabe të lira dhe sovrane, siç janë Egjipti, Siria,

Arabia Saudite, Jordania, Libani etj. Më kot imperialistët dhe kolonialistët francezë përpiqen të mbajnë nën zgjedhë popujt e Afrikës Veriore. Sinjali i zhdukjes së zgjedhës koloniale dhe i fitores së lirisë së popujve tingëlloi që në ditët historike të Tetorit të madh, që hapi për njerëzimin një epokë të ndritur. Politika agresive e imperialistëve pëson disfata çdo ditë e më shumë. Detyra jonë, si edhe e gjithë popujve të botës, është që të luftojmë me të gjitha fuqitë tona që politika agresive e imperialistëve të dështojë plotësisht dhe bota të gëzojë paqen dhe të lulëzojë.

Shokë,

Republika Popullore e Shqipërisë është një shtet paqedashës. Populli shqiptar tërë jetën e tij ka qenë i etur për paqe e liri, ka luftuar për pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar. Dëshira e tij ka qenë kurdoherë të rrojë në miqësi të ngushtë e të sinqertë me të gjitha shtetet fqinje dhe me shtetet e tjera të botës. Por shumë shtete nuk kanë pasur qëllim të tilla kundrejt vendit tonë, përkundrazi, shumë shtete imperialiste kanë dashur ta copëtonin dhe e kanë copëtuar Shqipërinë, që të skllavëronin popullin shqiptar. Populli ynë u ka rezistuar me sukses këtyre sulmeve dhe ka shkatërruar planet agresive të shteteve imperialiste. Kuptohet lehtë se qarqeve imperialiste agresive të Perëndimit nuk u ka ardhur aspak mirë që një vend i vogël si Shqipëria të fitonte pavarësinë dhe sovranitetin, të shpallte republikën dhe të vendoste regjimin e

demokracisë popullore. Është e natyrshme që në këto rrethana propaganda imperialiste të kurdiste kundër vendit tonë shpifje, shantazhe dhe kërcënime të shumta, të cilat duhet thënë se nuk patën asnjë sukses. Që iu mohuan popullit shqiptar për një kohë të gjatë të drejtat e tija të ligjshme në lëmin ndërkombëtar nga shumë shtete imperialiste, kjo është e vërtetë, por këto qëndrime të tyre të padrejta bënë në opinionin botëror efektin e kundërt nga ai që prisnin ata. Këto qëndrime vunë më shumë në dukje padrejtësitë dhe politikën arbitrare të këtyre shteteve kundrejt të drejtave sovrane dhe të ligjshme të popujve, ndërsa popullit shqiptar iu rrit prestigji ndërkombëtar dhe iu shtuan miqtë nga të katër anët e botës.

Armiqtë e popullit shqiptar i bënë llogaritë duke u bazuar në dëshirat e tyre, pa llogaritur mundësitë që kishin për realizimin e këtyre dëshirave. Ata, natyrisht, do të dështonin, siç dështuan, në saje të heroizmit të popullit tonë, të udhëheqjes së Partisë, të vigjilencës dhe të heroizmave të ushtrisë dhe të Sigurimit të Shtetit.

Pa marrë parasysh zhurmën shurdhuese, shpifjet dhe kërcënimet e imperialistëve, por duke qenë kurdoherë i gatshëm dhe vigjilent, populli shqiptar forcoi me sukses pushtetin e tij popullor dhe filloi ndërtimin e bazave të socializmit.

Aleanca dhe miqësia e popullit shqiptar me popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik janë faktorë të rëndësishëm për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Ndihma politike dhe ekonomike e Bashkimit Sovjetik ka bërë që vendi ynë i prapambetur të përparojë me hapa të

mëdhenj, të forcohet ekonomia e Republikës sonë popullore. Ëndrra shekullore e popullit shqiptar po realizohet në kohën e brezit tonë, që pati fatin e madh të rrojë dhe të luftojë në shekullin e triumfit të marksizëm-leninizmit. Me krenari ne mendojmë sot në këtë kongres për heroizmat e popullit tonë me klasën punëtore në krye, për Partinë tonë të dashur, për popullin sovjetik dhe Partinë e lavdishme Bolshevike, kur shohim se veprat e mëdha të pesëvjeçarit të parë u realizuan me sukses. Mendoni ditën kur ne vumë gurin e parë në Kombinatin e Tekstileve «Stalin». Entuziazmi i punëtorëve ishte i papërshekrueshëm dhe i patundur ishte besimi i tyre te Partia që i udhëhiqte në fitore, te ndihma dhe përkrahja e Bashkimit Sovjetik. Ne e ngritëm kombinatin. Maqinaria erdhi nga Bashkimi Sovjetik. Ne s'kishim punëtorë e kuadro të specializuar, prandaj erdhën me qindra kuadro sovjetikë dhe me dashuri e kujdes ata mësuan kuadrot tanë. Sot në Kombinatin e Tekstileve «Stalin» punojnë aq inxhinierë sa kishte gjithsejt Shqipëria para çlirimit. Kështu ndodhi edhe me kombinatin e sheqerit, me kombinatin e drurit, me fabrikën e çimentos. Kjo ndodh edhe në pusët e naftës, në minierat e qymyrit, të kromit dhe në gjithë industrinë tonë. Mijëra inxhinierë, traktoristë, agronomë, veterinerë, zooveterinerë dhe teknikë të ndryshëm punojnë në bujqësi. Doktorë, profesorë, shkencëtarë, njerëz të artit e të kulturës kanë mbaruar shkollat dhe universitetet në vendin tonë, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore dhe sot udhëheqin ndërtimin e socializmit. Ndihma e madhe materiale që iu dha popullit shqiptar nga Bashkimi Sovje-

tik, Çekoslovakia, Polonia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjermania Demokratike, ndihma që na u dha nga Kina e madhe etj., janë nga faktorët kryesorë të sukseseve të mëdha që ne korrëm në realizimin e planit të parë pesëvjeçar, të ngritjes së industrisë, të zhvillimit të bujqësisë dhe të krijimit të një baze të fuqishme për planin e dytë pesëvjeçar, direktivat e të cilit ne po i përcaktojmë sot. Populli shqiptar dhe Partia e tij u janë mirënjohës Bashkimit Sovjetik, Republikës Popullore të Kinës dhe vendeve të demokracisë popullore për këtë ndihmë e përkrahje dhe do të dinë ta shfrytëzojnë si duhet në të mirën e vet dhe në interesat e përbashkëta të forcimit të kampit të socializmit dhe të paqes. Vendi ynë, si pjesëtar i këtij kampi, po i zhvillon me hapa të shpejtë dhe të sigurtë ekonominë e tij dhe forcat prodhuese, në harmoni dhe në koordinim me të gjitha vendet miq dhe aleatë. Koordinimi i planeve ekonomike të vendeve tona në kuadrin e Këshillit të Ndhimës Ekonomike Reciproke i sjell përfitime vendit tonë, sepse në këtë mënyrë do të zhvillohen dhe do të përparojnë të gjitha degët e ekonomisë sonë. Në këtë politikë të drejtë e të koordinuar të kampit socialist, vendi ynë do të ndihmojë me të gjitha fuqitë e tija.

Në arenën ndërkombëtare Republika jonë popullore është përkrahur fuqimisht dhe kurdoherë me sukses për të drejtat e saja nga Bashkimi Sovjetik, nga vendet e demokracisë popullore dhe nga shtetet e tjera që na simpatizojnë dhe që luftojnë për të mbrojtur paqen. Fakti është që vendi ynë, me gjithë pengesat e qarqeve reaksionare imperialiste, sot ka marrëdhënie të mira

miqësore dhe diplomatike me 18 shtete të Evropës, të Lindjes së Afërme dhe të Azisë. Lidhje të tilla miqësore me shtete të ndryshme do të shtohen dhe në të ardhshmen.

Për një kohë shumë të gjatë vendit tonë i ishin mbyllur pa të drejtë dhe arbitrarisht dyert e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ky ishte një qëndrim i palejueshëm. Drejtësia, natyrisht, triumfoi dhe vendi ynë u pranua si anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kjo ngjarje ka një rëndësi të madhe, sepse vendi ynë ka luftuar dhe ka derdhur gjak për lirinë, pavarësinë e sovranitetin; ai i ka mbrojtur me të gjitha forcat e tija parimet dhe kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara edhe paqenë anëtar i saj. . . Me pranimin e Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara armiqve të popullit tonë iu dogj edhe një kartë, që e përdornin për pretendimet e tyre të mbrapshta dhe shpifëse.

Popullin shqiptar dhe qeverinë shqiptare i preokupojnë, po aq sa i preokupojnë popujt dhe shtetet e tjera të botës, çështjet e mëdha ndërkombëtare dhe zgjidhja e drejtë e tyre. Politika e jashtme e qeverisë sonë është një politikë paqësore dhe shpreh dëshirat dhe aspiratat e popullit shqiptar. Kjo politikë udhëhiqet nga parimet leniniste për një bashkekzistencë paqësore në mes të dy sistemeve, për një bashkëpunim miqësor në mes të shteteve, për respektimin e të drejtave, të lirive dhe të sovranitetit të çdo populli, për mosndërrhyrje në punët e brendshme të shteteve të tjera. Populli shqiptar dhe qeveria e tij kanë luftuar dhe do të luftojnë me të gjitha fuqitë e tyre për të mbrojtur paqen në botë. Ata i kanë

përkrahur propozimet paqësore të Bashkimit Sovjetik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që preokupojnë njerëzimin, siç janë: sigurimi kolektiv në Evropë dhe në Azi, problemi i çarmatimit dhe i ndalimit absolut të përdorimit të energjisë atomike për qëllime luftarë, problemi për bashkimin e Gjermanisë në një shtet të vetëm demokratik dhe paqësor etj.

Vendi ynë, si të gjitha vendet e tjera të kampit të socializmit, lufton konkretisht për paqen dhe për çarmatimin. Ne i pakësuam forcat e armatosura. Kjo masë e drejtë në gjendjen e tanishme lehtësoi edhe ekonominë tonë popullore. Një veprim i tillë, siç u bë nga shtetet socialiste, akoma nuk është bërë nga shtetet e Perëndimit, të cilat deri tani vetëm me fjalë flasin për paqen dhe për çarmatimin.

Republika Popullore e Shqipërisë është pjesëtare e Traktatit të Varshavës që, siç dihet, u përfundua nga shtetet tona paqedashëse pas ratifikimit të marrëveshjeve famëkeqe të Parisit, me anën e të cilave qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë dhe të Francës vendosën ringjalljen e militarizmit gjerman, riarmatimin e Gjermanisë Perëndimore dhe futjen e saj në bloqet ushtarake agresive të Atlantikut Verior dhe të Bashkimit të Evropës Perëndimore, duke krijuar kështu një kërcënim të drejtëpërdrejtë kundër sigurimit të Bashkimit Sovjetik dhe vendeve evropiane të demokracisë popullore, kundër paqes në Evropë. Traktati i Varshavës është traktat mbrojtjeje nga agresioni dhe faktor paqeje e stabiliteti në Evropë...

Populli shqiptar dhe qeveria shqiptare përshëndetën nënshkrimin e traktatit të shtetit me Austrinë.

Populli shqiptar përshëndeti Konferencën e Gjenevës të kryetarëve të katër fuqive të mëdha dhe dëshiron që fryma e Gjenevës për zgjidhjen e drejtë të çështjeve ndërkombëtare të vazhdohet edhe më tej.

Populli shqiptar dhe qeveria e tij mbështetin me të gjitha fuqitë e tyre të drejtat e ligjshme të popullit vëlla kinez mbi tokën e tij, Taivanin. Ne kemi një dashuri dhe admirim të madh për popullin heroik kinez dhe indinjohemi për manevrat e turpshme të imperialistëve që ndërhyjnë në mënyrë brutale në punët e brendshme të Republikës Popullore të Kinës në çështjen e Taivanit dhe i mohojnë asaj vendin e merituar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Kina është një nga fuqitë e mëdha të botës. Pa të, nuk mund të zgjidhen problemet e mëdha ndërkombëtare. Qeveria jonë, duke shprehur vullnetin e pathyeshëm të popullit shqiptar, do ta mbrojë me të gjitha forcat e veta pranimin e Republikës Popullore të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Populli shqiptar përshëndeti Konferencën historike të Bandungut dhe është me gjithë shpirt me të gjithë popujt e Azisë dhe të Afrikës që akoma janë të robëruar dhe luftojnë për të zhdukur përgjithmonë zgjedhën e urryer të kolonializmit. Populli shqiptar dhe qeveria e tij kanë deklaruar aderimin e tyre në të pesë parimet e mirënjohura mbi bashkekzistencën paqësore midis shteteve me sisteme shoqërore të ndryshme, që janë shpallur nga qeveritë e Republikës Popullore të Kinës dhe të Republikës së Indisë dhe që janë pranuar nga Bashkimi Sovjetik, si dhe nga shumë shtete të tjera paqedashëse që luftojnë për forcimin e paqes në botë.

Marrëdhëniet tona miqësore me popujt vëllezër të Jugosllavisë kanë hyrë në rrugën normale dhe forcohen çdo ditë... Me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë kemi përfunduar dhe vënë në jetë një numër marrëveshjesh në interesin e përbashkët, kemi vendosur marrëdhënie tregëtare e kulturele.

Me Italinë dhe me Francën ne kemi prej kohësh marrëdhënie diplomatike dhe dëshirojmë që këto marrëdhënie të mos jenë vetëm thjesht diplomatike, po të zgjerohen drejt shkëmbimeve tregëtare dhe kulturele. Populli shqiptar e konsideron mik popullin francez dhe italian. Në këto vende njerëz demokratë e përparimtarë, me pikëpamje të ndryshme politike, e kanë dashur dhe e duan popullin shqiptar dhe Republikën Popullore të Shqipërisë. Në Francë dhe në Itali ekzistojnë shoqëritë e miqësisë Francë-Shqipëri dhe Itali-Shqipëri, të cilat punojnë pa u lodhur dhe me sukses të madh për njohjen e vendit tonë dhe për forcimin e miqësisë. Shkrimtarët e mëdhenj klasikë francezë dhe letërsia përparimtare franceze janë të njohura për inteligjencien shqiptare. Mjaft turistë francezë do të vizitojnë sivjet vendin tonë.

Disa qarqe reaksionare italiane flasin se gjoja qeveria jonë nuk tregohet e gatshme për t'i zgjeruar marrëdhëniet në mes të dy vendeve. Kjo, natyrisht, nuk është aspak e vërtetë. Ne kemi simpati të madhe për popullin italian dhe jemi të interesuar që me të të kemi marrëdhënie të mira miqësore, tregëtare dhe kulturele. Ne me Italinë dëshirojmë të bëjmë tregëti, kjo është në interesin e përbashkët. Kush e pengon zhvillimin normal të marrëveshjeve tregëtare që ne kemi nënshkruar prej

kohësh? Është e qartë që s'jemi ne. Mallrat tona të caktuara për shkëmbimet me Italinë në bazë të marrëveshjes po presin në depot tona. Kush i pengon përfundimet e marrëveshjes në lidhje me çështjen e Traktatit të Paqes? S'jemi ne. Ne i bëmë bile koncesione qeverisë italiane në lidhje me dëmshpërblimin që Italia i detyrohet popullit shqiptar, erdhëm në ujdi dhe tani që duhet të nënshkruhet marrëveshja, nxirren pretekste të kota dhe pa bazë, që pengojnë përfundimin e kësaj çështjeje. Ne i liruam të gjithë kriminelët italianë të luftës që gjendeshin në burgjet tona dhe ata u riatdhesuan. Në vendin tonë po shfaqen filma italianë, vijnë gazeta përparimtare italiane. Në programet e radios dhe të koncerteve tona është vënë edhe muzikë italiane për të njohur publikun shqiptar me veprat e artistëve të shquar të Italisë.

Duket se disa qarqe reaksionare në Itali, të cilat në të kaluarën kanë vepruar kundër popullit tonë dhe nuk kanë nxjerrë mësim nga historia e afërt, do të dëshironin të pengonin një zhvillim pozitiv të marrëdhënieve midis dy vendeve tona fqinje. Duket se ato ushqejnë akoma qëllime djallëzore ndaj vendit tonë, por Shqipëria sot është një vend që nuk preket dot nga askush dhe zhvillimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë është sa në interes të Shqipërisë aq edhe në atë të Italisë. Ne dëshirojmë dhe shpresojmë se në të ardhshmen qeveria italiane do t'i përgjigjet më gjallërisht vullnetit të mirë të treguar nga qeveria jonë në vendosjen e marrëdhënieve të mira dhe të bashkëpunimit ekonomik e kultural midis dy vendeve tona.

Populli shqiptar ushqen një simpati të madhe për

popullin heroik grek, që për shekuj ka luftuar për lirinë dhe pavarësinë e tij. Greqia ka qenë djepi i qytetërimit. Të dy popujt tanë kanë vuajtur nën robërinë e zaptuesve imperialistë, kanë luftuar së bashku dhe kanë ndihmuar njëri-tjetrin për t'u çliruar nga zgjedha e shtypësve. Populli shqiptar e njeh popullin grek si një popull të kulturuar, të thjeshtë, punëtor dhe liridashës dhe hidhërohet pa masë kur shikon se marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me të po pengohen nga shovinistët grekë, të cilët pretendojnë se Shqipëria me Greqinë janë gjoja në gjendje lufte. Një pretendim kaq absurd pengon normalizimin e gjendjes në mes të vendeve tona. Po kush e sulmoi Greqinë, populli shqiptar apo Italia fashiste? Dihet shumë mirë se populli shqiptar luftoi krah për krah me popullin grek kundër agresorëve fashistë italianë dhe nazistëve gjermanë. Populli shqiptar derdhi shumë gjak kundër fashistëve italianë dhe tradhëtarëve shqiptarë derisa i theu ata dhe i shporri nga vendi i tij. Arësyeja tjetër, që pengon marrëdhëniet normale të vendeve tona, është pretendimi i shovinistëve grekë mbi Shqipërinë e Jugut. Si është e mundur që në shekullin XX të bëhen pretendime të tilla fantastike, pa baza dhe grabitqare kundër një vendi dhe një populli, që tërë jetën ka luftuar për tokën, për lirinë dhe për pavarësinë e tij? Por ja që ekziston në Greqi një klikë shovinistësh reaksionarë, të cilët, për qëllime krejt të huaja për popullin grek, kanë pretendime mbi tokën thjesht shqiptare, mbi atdheun e shqiptarëve. Sigurisht, të tilla pretendime do të ngelin vetëm dëshira që nuk do të realizohen kurrë, pse kufitë e Shqipërisë janë dhe do të qëndrojnë të paprekshëm.

Por, ne shpresojmë dhe dëshirojmë që njerëzit me vullnet të mirë në Greqi, njerëzit demokratë e përparimtarë dhe vetë qeveria greke t'i shohin më realisht dhe drejt çështjet, sepse marrëdhëniet e miqësisë e të fqinjësisë së mirë midis Shqipërisë dhe Greqisë janë në interesin e përbashkët dhe të paqes në Ballkan. Intrigat e imperialistëve, që nuk ia duan të mirën as popullit grek as popullit shqiptar dhe intrigat e atyre që synojnë të krijojnë dhe të mbajnë një situatë të nderë në mes të dy vendeve tona, duhet të marrin fund. Ne kemi vuajtur shumë nga zgjedha dhe intrigat e imperialistëve. Po aq shumë ka vuajtur dhe po vuan sot populli grek nga imperialistët. Populli shqiptar dhe qeveria shqiptare mendojnë se ka ardhur koha të hidhen poshtë këto trillime që pengojnë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në mes të vendeve tona. Ne dëshirojmë që me Greqinë të kemi marrëdhënie diplomatike normale, të zhvillojmë tregëti brenda mundësive tona, të njohim më mirë shoqi-shoqin dhe të vendosim mirëbesimin reciprok që ka rëndësi të madhe. Ne kemi shpresa se do t'ia arrijmë kësaj gjëje.

Në muajt e fundit Republika Popullore e Shqipërisë vendosi marrëdhënie diplomatike me Austrinë, me Republikën e Indisë dhe me Egjiptin. Qeveria jonë njohu gjithashtu Republikën e Sudanit dhe qeverinë e saj, si edhe shtetet e Tunizisë e të Marokut. Me të gjitha këto shtete ne po shkëmbejmë edhe përfaqësues diplomatikë. Megjithëse nuk kemi akoma marrëdhënie diplomatike me Zvicrën, po zhvillojmë shkëmbime tregëtare, të cilat do të përpiqemi t'i shtojmë.

Ne do të zhvillojmë dhe do të zgjerojmë marrëdhë-

niet tona me popujt miq të Azisë dhe të Afrikës, si edhe me shtetet e tjera të Lindjes së Afërme, si Siria, Libani, Arabia Saudite etj. Ne do të dëshironim të shkëmbenim delegacione midis vendeve tona për t'u njohur më mirë me njëri-tjetrin. Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, që ndjek një politikë paqeje dhe miqësie midis popujve, është e gatshme të ketë marrëdhënie të mira dhe normale në baza reciprociteti me të gjitha shtetet. Dëshirës së qeverisë angleze mbi mundësinë për të lidhur marrëdhënie diplomatike, qeveria jonë iu përgjeggj në mënyrë pozitive. Kurdoherë qeveria jonë ka qenë e gatshme që në mes Britanisë së Madhe dhe Republikës Popullore të Shqipërisë të ekzistonin marrëdhënie normale, por kjo nuk varej vetëm nga ne. Që në vitet e para pas çlirimit, qeveria e atëhershme angleze vuri kushte të kota dhe të papranueshme për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis vendeve tona dhe vazhdimisht mbajti kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë, një qëndrim negativ dhe jomiqësor, pa asnjë arsye. Incidenti i Korfuzit, ku u vranë disa marinarë anglezë dhe për të cilët u ka ardhur shumë keq popullit dhe autoriteteve shqiptare, u përdor nga qeveria angleze e asaj kohe si një armë kundër vendit tonë. Por të gjithë e dinë se për këtë incident nuk kanë faj Shqipëria dhe autoritetet shqiptare.

Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ne nuk kemi marrëdhënie sepse qeveria amerikane ka mbajtur vazhdimisht një qëndrim jomiqësor ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë. Që në ditët e para pas çlirimit të Shqipërisë, misioni amerikan në Tiranë, përkundrejt sjelljes dashamirëse dhe miqësore të qeverisë shqiptare,

jo vetëm që mbante qëndrime jomiqësore, por ndërhyri në punët e brendshme të vendit tonë. Natyrisht, këto ishin veprime të dënueshme dhe krejt të palejueshme. Për njohjen e qeverisë së popullit shqiptar dhe të regjimit popullor, qeveria amerikane vuri kushte të papranueshme, të cilat prekin të drejtat sovrane të popullit tonë. Është fakt se të gjitha këto kanë qenë pretekste për të luftuar popullin shqiptar dhe për ta dëmtuar atë në jetën e tij të lirë dhe paqësore. Qarqet drejtuese amerikane kanë marrë nën mbrojtjen e tyre të hapët një grusht tradhëtarësh shqiptarë që bashkëpunuan haptazi tërë kohën me fashistët italianë dhe gjermanë, që tok me ta vranë dhe dogjën popullin shqiptar dhe s'lanë gjë pa thënë e pa bërë kundër vetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aleatëve të popullit tonë në luftën e përbashkët kundër fashizmit. Dhe tragjedia është se qarqet drejtuese amerikane i ngatërrojnë këto plehra me popullin shqiptar. Kjo nuk i nderon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nuk pajtohet me traditat demokratike të presidentëve Uashington, Abraham Lincoln etj.

Populli shqiptar ka simpati për popullin punëtor amerikan, por është shumë i indinjuar për këto qëndrime të padrejta dhe armiqësore të përgjegjësve të politikës së jashtme të qeverisë amerikane. Zoti Ajzenhauer i propozoi një ndihmë popullit shqiptar, por ajo nuk mund të pranohej nga populli ynë, kur nga qeveria amerikane atij i mohohet lufta e tij heroike, gjaku dhe sakrificat e panumërta, kur i shkelen të drejtat e tija të ligjshme në lëmin ndërkombëtar, kur i cënohet integriteti tokësor i atdheut, kur i hedhin diversantë për t'i

prishur qetësinë e vendit dhe për të sabotuar e për të shkatërruar pasurinë e popullit, të ngritur me djersë e me vuajtje, kur lëshohen rrëke shpifjesh nga Radio «Zëri i Amerikës», kur vetë ministri i jashtëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Dalles, ndërhyr në punët e brendshme të vendit tonë të pavarur e sovran dhe i predikon e i «uron» popullit shqiptar zgjedhën e robërinë e bejlerëve dhe të agallarëve, kundër të cilëve ai ka derdhur gjak brez pas brezi. Amerikanët e dinë fare mirë se për shqiptarët s'ka gjë më të shenjtë se liria dhe pavarësia. Populli shqiptar nuk vuan nga uria dhe nga sëmundjet, siç pretendohet në mesazhin e ndihmës të zotit president Ajzenhauer. Atë e kanë informuar keq. Populli shqiptar rron i lumtur dhe i gëzuar nën regjimin që e vendosi vetë duke luftuar. Populli shqiptar do miqësi të sinqertë dhe do që miqtë të respektojnë të drejtat, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tij. Amerikanët e dinë mirë që shqiptarët s'e kanë zakon të lypin miqësinë e atyre që nuk e dëshirojnë atë. Shqipëria rron edhe papasur marrëdhënie me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por ne mendojmë se ky s'është as vullneti dhe dëshira e popullit amerikan dhe as vullneti dhe dëshira e popullit dhe e qeverisë shqiptare.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës jeton një emigracion ekonomik shqiptar, të cilit i thuhet se qeveria shqiptare nuk dëshiron të ketë lidhje miqësore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, kjo është një gënjeshtër trashanike. Kurrë populli shqiptar dhe qeveria e tij nuk e hedhin poshtë miqësinë e popullit amerikan, por të tjerë dhe jo shqiptarët e pengojnë këtë miqësi që të zhvillohet në rrugën e drejtë. Aty-këtu ndonjë

shqiptar, që banon në Amerikë dhe është bërë nënshtetas amerikan, po çirret duke bërë titur, se qeveria shqiptare nuk lejon shqiptarët e Amerikës të kthehen në atdheun e tyre. Asnjë ligj i Republikës Popullore të Shqipërisë nuk ndalon shtetasit shqiptarë në mërgim të kthehen në atdhe. Përkundrazi, qeveria shqiptare kërkon që të gjithë, po të jetë e mundur, të kthehen sa më parë, sepse atdheu ka nevojë për bijtë dhe bijat e tija në çdo anë që janë, të larguar nga kushtet e mjerueshme të krijuara prej regjimit shtypës antipopullor. Tani atdheu ynë po lulëzon, ai ka nevojë dhe vend që të punojnë dhe të rrojnë të lumtur të gjithë bijtë e tij të ndershëm. Shumë emigrantë kanë ardhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e vendet e tjera dhe vazhdojnë të vijnë. Ne i presim me krahë hapët të gjithë ata shqiptarë që ruajnë shtetësinë shqiptare, ne do t'i mbrojmë kurdoherë ata, pse është detyra e shtetit popullor të mbrojmë shtetasit e tij; ne do t'i ndihmojmë me të gjitha forcat tona si jashtë edhe brenda kur të kthehen në atdhe. Për nënshtetasit amerikanë çështja, natyrisht, qëndron ndryshe dhe vetë vëllezërit tanë shqiptarë, që kanë qenë të detyruar të marrin nënshtetësinë amerikane, e kuptojnë se ne nuk mund të pranojmë një veprim të njëanshëm domethënë që ne të lejojmë nënshtetasit amerikanë të vijnë lirisht në Shqipëri dhe njerëzit tanë të mos lejohen të hyjnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të drejtat duhet të jenë reciproke. Shumë herë, ose më mirë të themi vazhdimisht, qeveria amerikane nuk ka pranuar që shtetasit shqiptarë të hyjnë në Amerikë; bile ajo ka shkuar edhe më tej, ajo shkeli marrëveshjen e përfunduar me Organizatën e

Kombeve të Bashkuara, duke i mohuar delegatit tonë në këtë organizatë vizën diplomatike që i përkiste dhe deshi ta trajtojë si person pa atdhe, përfaqësuesin e një shteti sovran e të pavarur, anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili shkonte të përfaqësonte kombin e tij në këtë organizatë. Kjo është një fyerje që u bëhet popullit shqiptar dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Dhe pas një qëndrimi të tillë të qeverisë amerikane, a nuk del fare e qartë se sa pa themel janë kritikrat që disa njerëz në Amerikë i drejtojnë qeverisë shqiptare që nuk u jep vizë hyrjeje nënshtetasve amerikanë? Ne e kuptojmë mallin e atdheut, që zien në zemrat e emigrantëve shqiptarë me nënshtetësi amerikane dhe jemi gati që edhe ata t'i presim si vëllezër, të vijmë të shohim atdheun e tyre; ne jemi gati të merremi vesh edhe për këtë çështje, por duhet të ekzistojë vullneti i mirë në qeverinë amerikane dhe të korrigjohen qëndrimet e saj të padrejta dhe jomiqësore kundrejt popullit dhe atdheut tonë. Kjo është edhe udha që mund të shpjerë në normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve tona.

Shokë,

Në marrëdhëniet tona ndërkombëtare, në gjendjen e sotme, përpara Partisë, qeverisë dhe gjithë popullit shqiptar dalin këto detyra të rëndësishme:

Të vazhdojmë të ndjekim me konsekuencë, si kurdoherë, një politikë paqësore dhe të mbështetim vazhdimisht të gjitha iniciativat e mira që kanë për qëllim forcimin e paqes në botë.

Të forcojmë çdo ditë e më shumë aleancën dhe miqësinë në mes të popullit shqiptar dhe popullit sovjetik.

Të forcojmë çdo ditë e më shumë aleancën dhe miqësinë e ngushtë me Republikën Popullore të Kinës dhe me popullin vëlla kinez, me popujt e Polonisë, Çekosllovakisë, Hungarisë, Rumanisë, Bullgarisë, Republikës Demokratike Gjermane, Mongolisë, Republikës Demokratike Popullore të Koresë, Republikës Demokratike të Vietnamit.

Të forcojmë marrëdhëniet miqësore me popujt e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.

Të forcojmë në të gjitha fushat marrëdhëniet me vendet e kampit të socializmit, në interes të popujve tanë, në interes të socializmit dhe të paqes.

Të bëjmë të gjitha përpjekjet për t'i përmirësuar akoma më tej marrëdhëniet miqësore me Italinë, me Francën dhe me shtete të tjera të Evropës në interesin reciprok të popujve tanë dhe të paqes.

Të përpiqemi vazhdimisht të vendosim marrëdhënie normale dhe fqinjësie të mirë me Greqinë në interes të popujve tanë dhe të paqes në Ballkan dhe në botë.

Të forcojmë marrëdhëniet miqësore me popullin indian, egjiptian, sirian dhe me të gjithë popujt e tjerë të Lindjes së Afërme e të Mesme, të Afrikës, të Azisë dhe të kontinenteve të tjera në interes të paqes në botë.

Ne jemi për vendosjen e marrëdhënieve normale me Britaninë e Madhe dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe që këto marrëdhënie të zhvillohen në bazën e barazisë dhe të respektit reciprok të të drejtave, të lirisë dhe të sovranitetit.

Duke punuar me vendosmëri për forcimin e marrë-

dhënieve dhe të pozitës ndërkombëtare të Republikës sonë popullore, ne nuk do të ulim për asnjë çast, por do ta mprehim kurdoherë e më shumë vigjilencën revolucionare të popullit tonë, do t'i kushtojmë kujdes të veçantë forcimit të aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë të shtrenjtë, do të forcojmë edhe më shumë unitetin e çelniktë të popullit tonë trim e të pamposhtur rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Politikën paqësore të Partisë dhe të qeverisë sonë e mbështet me të gjitha forcat i gjithë populli shqiptar, sepse ajo shpreh aspiratat dhe dëshirat e tija të zjarra që të rrojë në paqe dhe të ndërtojë socializmin.

REZULTATET E ARRITURA NË LËMIN EKONOMIK E KULTURAL GJATË PESËVJEÇARIT TË PARË DHE DREJTIMET KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS PËR PESË VJETËT E ARDHSHËM

A. — ZHVILLIMI I INDUSTRIËS DHE I TRANSPORTIT

Partia e Punës e Shqipërisë e mbështetur në teorinë e lavdishme të marksizëm-leninizmit, ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme vijën e rritjes së prodhimit në të gjitha degët e ekonomisë popullore. Masat e rëndësishme që janë marrë në kuadrin e detyrave që shtroi Kongresi II i Partisë për shtimin e mëtejshëm të prodhimit dhe zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë, treguan drejtësinë e vijës së Partisë, domosdoshmërinë e këtyre masave. Në këtë drejtim ne kemi arritur rezultate të kënaqshme. Detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar për të transformuar vendin tonë nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial, në përgjithësi, është realizuar. Partia jonë e konsideron industrinë si bazën kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore, për përparimin e

bujqësisë dhe për rritjen e vazhdueshme të mirëqenies materiale e të nivelit kultural të popullit tonë.

Në saje të zhvillimit të vrullshëm të industrisë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit pesha specifike e prodhimit industrial ndaj prodhimit industrial e bujqësor të marrur së bashku, siç duket në të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	1938	1950	1955
<i>Në milion lekë</i>				
	<i>Prodhimi i përgjithshëm industrial e bujqësor</i>	14 213	21 072	37 102
1)	Prodhimi i përgjithshëm industrial	1 387	5 793	16 152
2)	Prodhimi i përgjithshëm bujqësor	12 826	15 279	20 950
<i>Pesha specifike në përqindje</i>				
	<i>Prodhimi i përgjithshëm industrial e bujqësor</i>	100,0	100,0	100,0
1)	Prodhimi i përgjithshëm industrial	9,8	27,5	43,5
2)	Prodhimi i përgjithshëm bujqësor	90,2	72,5	56,5

Realizimi i planit të parë pesëvjeçar tregon se detyrat kryesore për prodhimin industrial janë plotësuar. Pesëvjeçari i parë mund të quhet pesëvjeçari i krijimit të industrisë së re dhe moderne, e cila është baza e zhvillimit të ekonomisë popullore, baza e forcimit të aftësisë

mbrojtëse të atdheut tonë dhe e përmirësimit të vazhdueshëm të mirëqenies së popullit. Procesi i shpejtë dhe i kënaqshëm i industrializimit të vendit u bë i mundshëm në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë, në saje të vrullit dhe të heroizmit të klasës sonë punëtore, si dhe të ndihmave të dhëna nga Bashkimi i madh Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore. Vënia në shfrytëzim e objekteve të reja industriale dhe rikonstruksioni e shfrytëzimi më i mirë i industrisë ekzistuese krijuan kushte për një prodhim më të madh, për një rritje të vazhdueshme të prodhimit industrial.

1. — Sukseset në industrializimin socialist të vendit

Në periudhën midis dy kongreseve Partia ka siguruar një zhvillim të mëtejshëm të të gjitha degëve të prodhimit industrial. Në vitin 1955 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial (në bazë të çmimeve të krahasueshme të vitit 1956) arriti 16 miliard e 152 milion lekë, ose 179 për qind më shumë se në vitin 1950 dhe rreth 10,5 herë më shumë se në vitin 1938, me një ritëm mesatar vjetor prej 22,8 për qind.

Suksese të mëdha janë arritur në disa degë të prodhimit industrial, si në industrinë e qymyr gurit, ku vëllimi i prodhimit i realizuar në vitin 1955 është rritur afërsisht 54 herë kundrejt vitit 1938 dhe afro 5 herë në krahasim me vitin 1950. Prodhimi i mineralit të kromit i realizuar në vitin 1955 ka qenë rreth 17 herë më shumë në krahasim me vitin 1938 dhe 234 për qind në krahasim me vitin 1950; prodhimi i industrisë mekanike në vitin

1955 ishte rreth 5 herë më shumë në krahasim me vitin 1950. Industria elektrike në vitin 1955 ka qenë afro 10 herë më shumë në krahasim me vitin 1938 dhe 5 herë më shumë në krahasim me vitin 1950. Në vitin 1955 prodhimi në industrinë e drurit u rrit 3,5 herë më shumë në krahasim me vitin 1950 etj.

Krahas me rritjen e prodhimit të mjeteve të prodhimit, është shtuar edhe prodhimi i mallrave të konsumit. Vëllimi i prodhimit të realizuar në industrinë e lehtë në vitin 1955 ka qenë mbi 26 herë më shumë kundrejt vitit 1938 dhe afro 7 herë më shumë kundrejt vitit 1950. Në industrinë lokale prodhimi në vitin 1955 ishte mbi 2 herë më shumë kundrejt vitit 1950 dhe në artizanatin e kooperuar mbi 8 herë më shumë.

Shumë degë të industrisë, si industria e kromit, industria mekanike, industria e lëndës së drurit, industria lokale, artizanati i kooperuar etj., realizuan dhe tejkaluan me sukses planin e parë pesëvjeçar.

Megjithkëtë, duhet të theksojmë, se jo të gjitha degët e prodhimit industrial, kanë ecur me ritmin e parashikuar në plan. Më dobët janë paraqitur industria e naftës, e bakrit, e material-ndërtimit dhe industria ushqimore.

Arësyet kryesore të mosrealizimit të disa detyrave që shtroi Kongresi II i Partisë lidhur me planin e parë pesëvjeçar mund të përmbliidhen:

Së pari, hartimi i planit të parë pesëvjeçar për disa degë të ekonomisë dhe të prodhimit nuk ka qenë i bazuar plotësisht në studime të mjaftueshme dhe, si rrjedhim, janë bërë gabime në planifikimin e detyrave për zhvillimin proporcional dhe në harmoni të degëve të ndrysh-

me të ekonomisë e të prodhimit. Këto gabime duhet t'i shërbejnë si mësim Komisionit të Planit të Shtetit, i cili duhet të përmirësojë punën, të lidhet më mirë me bazën dhe të punojë për përpunimin e disa planeve perspektive me afat të gjatë për disa degë të rëndësishme të ekonomisë.

Së dyti, drejtimi i ekonomisë nga organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë ka pasur të meta dhe dobësi. Janë lejuar shkelje të rënda të disiplinës së planit dhe nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për shfrytëzimin e kapaciteteve ekzistuese dhe të rezervave të tjera të brendshme. Në këto çështje Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Ministria e Komunikacioneve dhe sidomos Ministria e Ndërtimit duhet të marrin masa serioze për zhdukjen e gabimeve e të dobësive dhe të përmirësojnë punën e drejtimit.

Vëllimi i madh i investimeve që parashikonte plani i parë pesëvjeçar për krijimin dhe zgjerimin e degëve të ndryshme të ekonomisë kërkonte, pa dyshim, zhvillimin në stil të gjerë të ndërtimeve, të cilat morën një përpjesëtim të paparë ndonjëherë në vendin tonë.

Realizimi i vëllimit të përgjithshëm të investimeve gjatë pesëvjeçarit të parë arriti në 17 miliard e 246 milion lekë (me çmimet e vitit 1955).

Komiteti Qendror i PPSH ka pasur gjithmonë parasysh që shpërndarja e investimeve të drejtohet, në radhë të parë, në sektorin prodhues, në të cilin janë investuar 14 miliard lekë, ndërsa në sektorin joprodhues vetëm 3 miliard e 246 milion lekë, me peshë specifike përkatëse 81,2 për qind dhe 18,8 për qind. Investimet e mëdha që u përdorën për ndërtime bënë të mundur fillimin e më

tepër se 50 veprave të rëndësishme. Gjatë pesëvjeçarit të parë janë përfunduar dhe janë vënë në veprim 31 objekte të mëdha, nga të cilat 11 kombinate, fabrika e hidrocentrale, 11 vepra bonifikimi etj. Kjo do të thotë se vetëm ndërmarrjet nacionale të ndërtimit gati çdo dy muaj kanë përfunduar një vepër të madhe dhe për çdo ditë pune kanë ndërtuar 2,5 apartamente.

Krahas me vënien në shfrytëzim të objekteve të reja industriale, investimet e mëdha që u bënë në ekonominë popullore, e veçanërisht në industri, krijuan mundësi për pajisjen e industrisë së re dhe asaj ekzistuese me mjete të teknikës moderne, të cilat përsosën më tej format dhe metodat e organizimit të punës e të prodhimit, përmirësuan teknologjinë dhe zgjeruan bazën materiale të prodhimit.

Komiteti Qendror i PPSH ka ndjekur vazhdimisht me kujdes zhvillimin e minierave dhe ka marrë masa të rëndësishme për zgjerimin e tyre, si bazë e rëndësishme për ngritjen e mëtejshme të degëve të tjera të ekonomisë. Gjatë pesëvjeçarit të parë, e veçanërisht gjatë dy-tre vjetëve të fundit të pesëvjeçarit, si rezultat i investimeve të mëdha që u bënë në këtë sektor, pesha specifike e të cilave arriti 24 për qind të vëllimit të përgjithshëm të investimeve, si edhe i përgatitjes së kuadrit, janë arritur suksese të rëndësishme në rritjen e prodhimit dhe në zbulimin e rezervave minerare, duke siguruar kështu bazën materiale për prodhimin në vjetët e ardhshëm. Industria e naftës dhe minierat janë pajisur me maqineri moderne dhe e kanë të siguruar bazën elektro-mekanike. Forcimi i shërbimit gjeologjik si dhe shtimi i studimeve dhe i kërkimeve u kanë hapur perspek-

tiva të mëtejshme minierave, i kanë vënë ato në kushte më normale pune dhe kanë krijuar kushtet për një prodhim më rentabël.

U likuidua në kohë rreziku që i dilte përpara industrisë nga mungesa e lëndës djegëse dhe e energjisë elektrike dhe u krijuan kushte të favorshme për vënien në shfrytëzim të kapaciteteve prodhuese, si dhe mundësitë për zgjerimin, rikonstruksionin, mekanizimin dhe elektrifikimin e mëtejshëm të industrisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë.

Rezultatet e arritura gjatë planit të parë pesëvjeçar janë të lidhura ngushtë me përpjekjet heroike të klasës sonë punëtore, me entuziazmin dhe mobilizimin e saj për të kapërcyer çdo pengesë dhe vështirësi. Në luftë për realizimin e detyrave të planit u formuan mijëra luftëtarë të rinj, të kalitur dhe të edukuar nga Partia me tiparet e njeriut socialist.

Një rëndësi të veçantë i ka kushtuar Partia edukimit politik, kultural dhe profesional të klasës punëtore për të rritur pjesëmarrjen e saj në prodhim, për të zhvilluar më gjerë te ajo ndërgjegjen e klasës.

Gjithë kjo punë e madhe që është kryer nga Partia gjatë periudhës midis dy kongreseve tregon se organizatat e Partisë kanë luftuar më mirë për zbatimin e porosive dhe të detyrave që u kanë dalë. Ato, të ndihmuara nga Komiteti Qendror i PPSH, kanë forcuar më tej punën me njerëzit dhe janë mbështetur më gjerë te masat. Organizatat e Partisë, në saje të eksperiencës që kanë fituar dhe në saje të ngritjes së nivelit politik dhe profesional të komunistëve, duke u marrë më shumë me drejtimin praktik të ekonomisë dhe duke e kombi-

nuar më mirë punën politike me atë ekonomike, e kanë udhëhequr më me kompetencë prodhimin.

Sukseset e mëdha që kanë arritur Partia dhe populli ynë në zbatimin e detyrave kryesore të planit të parë pesëvjeçar, kanë siguruar një zhvillim të mëtejshëm të prodhimit industrial dhe kanë ngritur në një shkallë më të lartë ekonominë dhe kulturën. Vendi ynë ka bërë hapa të mëdhenj në ndërtimin e socializmit dhe ne po hyjmë në pesëvjeçarin e dytë në kushte shumë të favorshme dhe me një potencial shumë më të fuqishëm se sa në pesëvjeçarin e parë. Duke zbatuar detyrën ekonomike kryesore që na shtroi Kongresi II i Partisë për kalimin nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial, ne përgatitemi për detyra të reja për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, sidomos të industrisë minerare, kryesisht në bazë të përdorimit të plotë të kapaciteteve prodhuese ekzistuese dhe të mobilizimit të rezervave të brendshme. Sot ne kemi mundësi t'u shtrojmë industrisë dhe gjithë degëve të prodhimit industrial detyra të reja dhe të mëdha, realizimi i të cilave do të sigurojë një ngritje akoma më të lartë të fuqisë ekonomike dhe të mirëqenies së popullit.

Detyrat kryesore të planit të dytë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë janë:

ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I INDUSTRIËS, SIDOMOS I INDUSTRIËS MINERARE, KRYESISHT NË BAZË TË PËRDORIMIT TË PLOTË TË KAPACITETEVE PRODHUESE EKZISTUESE E TË SHFRYTËZIMIT TË REZERVAVE TË BRENDSHME DHE ZHVILLIMI I SHPEJTË I BUJQËSISË, KRYE-

*SISHT NË BAZË TË RIORGANIZIMIT TË PRODHIMIT BUJ-
QËSOR MBI BAZA' SOCIALISTE, DUKE U MBËSHTETUR
NË KËTO, TË ARRIHET PËRMIRËSIMI I MËTEJSHËM I
GJENDJES MATERIALE DHE NGRITJA E NIVELIT KUL-
TURAL TË POPULLIT SHQIPTAR.*

Komiteti Qendror i PPSH ka marrë masa të rëndësishme për përmirësimin e mëtejshëm të punës në industri e në degët e tjera të ekonomisë dhe në radhë të parë për zbulimin e shfrytëzimin e mëtejshëm të rezervave të brendshme, sepse gjatë kësaj kohe, duke u zhvilluar industria në gjerësi, ku janë arritur rezultate, disa drejtues janë kënaqur me këto dhe kanë lënë pasdore shfrytëzimin e saj në thellësi, nëpërmjet përdorimit më intensiv të kapaciteteve ekzistuese, të zbatimit më të gjerë të teknikës dhe të teknologjisë së re, të mekanizimit të mëtejshëm të proceseve të punës, të vendosjes së një regjimi të rreptë kursimi, të ngritjes në një nivel më të lartë të drejtimit tekniko-ekonomik të prodhimit, të përmirësimit të furnizimit dhe të planifikimit, të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe të zgjerimit të asortimentit të prodhimit.

Zhvillimi i mëtejshëm i prodhimeve minerare, me të cilat vendi ynë është i pasur, është penguar nga prapambetja e madhe që kemi trashëguar përse u përket studimeve gjeologjike të nëntokës. Vitet e fundit i është kushtuar një kujdes më i madh forcimit dhe zgjerimit të këtij sektori, por megjithatë ritmi i studimeve dhe i punimeve të kërkimit ka qenë i pamjaftueshëm, nuk i është përgjegjur kudo rritjes së prodhimit. Mungesa e kuadrove dhe e një organizimi të mirë të prodhimit ka

bërë që disa miniera të mos i plotësojnë detyrat e planit të parë pesëvjeçar.

Detyra më e rëndësishme gjatë pesëvjeçarit të dytë në sektorin e industrisë të jetë rritja e mëtejshme e prodhimeve minerare, duke zgjeruar studimet dhe kërkimet gjeologjike. Të rriten rezervat e shfrytëzueshme të mineraleve në minierat ekzistuese dhe të bëhen punime zbulimi në vendburime të reja. Të shtohet prodhimi i naftës dhe veçanërisht përpunimi i saj, të rritet me ritme më të shpejta prodhimi i mineraleve: i qymyr gurit, bakrit, bitumit e në mënyrë të veçantë i kromit, duke shfrytëzuar minierat ekzistuese dhe duke vënë në përdorim miniera të reja. Gjatë pesëvjeçarit të dytë të fillojë për herë të parë prodhimi i mineralit të hekur-nikelit, i cili në vitin 1960 të arrijë 200 mijë ton.

Të ngrihet në një shkallë më të lartë mekanizimi i prodhimit dhe i transportit, të shfrytëzohen më racionalisht minierat, të ulen firot dhe të përmirësohet cilësia duke zbatuar metoda më të përparuara të punës. Të tregohet më shumë kujdes për rritjen e koeficientit të përdorimit të puseve dhe të debitit të tyre në industrinë e naftës.

Në përgjithësi industria e material-ndërtimit vazhdon akoma prodhimin stinor dhe niveli i mekanizimit është akoma i ulët. Është e domosdoshme që t'u jepet fund të metave të pajustificueshme që janë lejuar në sektorin e sharrave, të krijohen me kohë rezervat e trupave dhe të respektohen normativat e harxhimit. Të tregohet kujdes më i madh për shfrytëzimin racional të pyjeve dhe përdorimi racional i lëndës së drurit të konsiderohet detyrë jo vetëm e konsumatorëve, por edhe e

organeve të planifikimit. Të sigurohet një rritje e vrullshme në prodhimin e çimentos, duke zgjeruar fabrikat ekzistuese dhe të shtohet prodhimi i tullave e i tjegullave për të plotësuar nevojat e ndërtimeve dhe kërkesat e masave punonjëse.

Duhet theksuar se puna në sektorin e ndërtimit nuk është e kënaqshme. Objektet ndërtohen shtrenjtë, afati i përfundimit të tyre zgjatet shumë dhe luftohet në mënyrë të pamjaftueshme për një cilësi të lartë. Në këtë sektor i duhet dhënë fund ngadalësisë që ekziston në përdorimin e teknikës së re në shkallë të gjerë. Mekанизimi i proceseve të punës të konsiderohet një nga detyrat kryesore që lehtëson dhe zëvendëson fuqinë punëtore dhe rrit rendimentin. Është e domosdoshme të forcohet administrimi i ndërmarrjeve të ndërtimit dhe të ecet mbi projektorganizimin e kantierëve, sepse kështu i jepet mundësi ndarjes më të drejtë dhe më racionale të forcave, të materialeve dhe të mekanizmave. Të prodhohen dhe të përdoren materiale sipas standardeve e me kosto të lirë dhe të forcohet kontrolli teknik.

Të luftohet akoma më me këmbëngulje për uljen e koston. Më topër kujdes dhe vëmendje t'u kushtohet hartimit të projekteve dhe preventivave dhe këto të bëhen në baza shkencore dhe të eksperiencës së deritanishme, duke shfrytëzuar labororet dhe duke studjuar mirë gjeologjinë dhe topografinë e terrenit. Ato të studjohen në kompleks në mënyrë që të dalin më racionale dhe të shfrytëzohen më mirë burimet lokale. Ne kemi nevojë që gjërat të projektohen mirë dhe lirë. Arkitektët dhe inxhinierët tanë duhet të bëhen edhe ekonomistë të mirë, të zhvishen nga formalizmi, nga tendenca e gjërave

të tepërta e të panevojshme pa çenuar komoditetin dhe kushtet teknike.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të fillojë industrializimi i punimeve të ndërtimit dhe për këtë të tipizohen më shumë projekte dhe të standardizohen detajet e konstruksionit.

Më tepër kujdes e përgjegjësi të ketë në ndërtim për furnizimin e pandërprerë të vendit të punës me materiale dhe më tepër vëmendje t'i kushtohet trajtimit e jetesës së punëtorëve.

Në industrinë ushqimore e të veshmbathjes, në industrinë lokale dhe në artizanatin e kooperuar rritja e pandërprerë e prodhimit nuk është shoqëruar me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, me zgjerimin e asortimenteve për të kënaqur më mirë kërkesat gjithnjë në rritje të konsumatorëve. Janë bërë përpjekje të pamjaftueshme për zëvendësimin e lëndëve deficitare, për uljen e normativave të konsumit si dhe për të shfrytëzuar më racionalisht dhe më shumë burimet lokale të lëndës së parë.

Në projektdirektivat për planin e dytë pesëvjeçar detyrë e parë kryesore për ndërmarrjet e industrisë ushqimore dhe të veshmbathjes, si edhe për gjithë sektorët që prodhojnë mallra të konsumit të gjerë, duhet të jetë kthesa rrënjësore në drejtim të shtimit dhe të zgjerimit të asortimenteve, të përmirësimit të cilësisë së prodhimit nëpërmjet forcimit të drejtimit teknik, përdorimit të proceseve të reja teknologjike, respektimit të standardeve shtetërore dhe përmirësimit rrënjësor të kushteve higjienike dhe shëndetësore gjatë prodhimit. Në industrinë lokale dhe në artizanatin e kooperuar është i domos-

doshëm forcimi i drejtimit teknik, si në qendër, ashtu edhe në bazë; komitetet ekzekutive t'i udhëheqin më operativisht dhe më me perspektivë këta sektorë për të plotësuar më mirë nevojat e popullit.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë na shtrohet si detyrë përvetësimi i kapaciteteve industriale të ndërtuara për një shfrytëzim më racional. Ndërsa në pesëvjeçarin e parë kemi pasur një shtrirje të industrisë, domethënë një zhvillim të saj në gjerësi, sipas projektdirektivave, në planin e dytë pesëvjeçar do të synojmë në radhë të parë për një zhvillim të industrisë në thellësi.

Vëllimi i prodhimeve kryesore industriale në pesëvjeçarin e dytë parashikohet të arrijë si më poshtë:

Në vitin 1960 kundrejt vitit 1955

(në përqindje)

Çimento	292
Lëndë druri e sharruar.....	182
Energji elektrike	186
Tekstile të pambukta	113
Tekstile të leshta	180
Këpucë e sandale	161
Sheqer	207
Makarona	122
Gjalpë	553
Djathëra	386
Vaj ulliri	132
Peshk	232
Mobilje	238
Qelqurina	697
Prodhime poçerie etj.	586

Në caktimin e detyrave për zhvillimin e mëtejshëm të degëve të ndryshme të ekonomisë dhe të prodhimit është pasur parasysh gjithashtu vëllimi i madh i investimeve që janë kryer e do të kryhen gjatë këtij pesëvjeçari, si edhe rezervat e mëdha që ekzistojnë në ekonominë tonë.

Në projektdirektivat për planin e dytë pesëvjeçar parashikohet të investohen 21 miliard e 900 milion lekë (me çmimet e vitit 1955) ose 27 për qind më shumë kundrejt pesëvjeçarit të parë: nga këto në ndërtime do të investohen 13 miliard lekë me peshë specifike 59,4 për qind, ose 16 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë. Në radhë të parë dhe në mënyrë dërmuese investimet parashikohet të kryhen në sektorët prodhues dhe në ata sektorë ku efekti është i shpejtë, duke ruajtur përpjesëtimin me peshë specifike 80,4 për qind ose 126 për qind kundrejt pesëvjeçarit të parë në sektorin prodhues dhe 19,6 për qind ose 132 për qind në sektorin joprodhues.

Detyrat që na shtrohen në projektdirektivat për planin e dytë pesëvjeçar janë të mëdha, por të realizueshme. Për t'i plotësuar me sukses këto detyra ne duhet të zgjidhim një varg problemesh që kanë të bëjnë me punën e industrisë, për të cilat Partia duhet të përqëndrojë vëmendjen dhe përpjekjet e saja.

2. — Për një drejtim të kualifikuar dhe prodhim rentabël

Rruga e vetme që duhet të ndjekin ndërmarrjet tonë shtetërore dhe kooperativiste është që të prodhojnë më shumë, më mirë dhe më lirë. Ne kemi shembuj të

shkëlqyer që tregojnë se kolektivat punonjëse të shumë ndërmarrjeve kanë bërë përparime të dukshme dhe kanë përvetësuar prodhimin e shumë artikujve të rinj në një kohë relativisht shumë të shkurtër. Por vlen të theksohet se vrullit dhe inisiativës krijuese të klasës punëtore nuk është duke iu përgjegjur gjithnjë një drejtim i kualifikuar. Ne kemi akoma shumë drejtues, të cilët e shikojnë shumë ngushtë punën e sektorit të tyre. Ata, duke mos u bërë merak se ku e shpien rentabilitetin e prodhimit, paraqitin lloj-lloj justifikimesh dhe kur u numërohen dobësitë, janë në gjendje të ngarkojnë gjithë botën me përgjegjësi dhe vetë të kalojnë me një autokritikë të përgjithshme. Ata bien në këto gabime, natyrisht, jo se duan, por pandehin se është e mjaftueshme të drejtosh sot ekonominë, si disa vjet më parë, vetëm me një udhëheqje të përgjithshme, duke ndjekur realizimin e planit sipas shifrave mesatare dhe nuk shohin se prapa këtyre fshihen të meta të rëndësishme dhe serioze. Kjo pikërisht është arsyeja që nuk i është kushtuar vëmendja e duhur përmirësimit të treguesve cilësorë të planit. Lejimi i mëtejshëm i këtyre dobësive dëmton rëndë ekonominë.

Përmirësimi i mëtejshëm i drejtimit të ekonomisë është i lidhur ngushtë me organizimin e ndihmës sistematike dhe të kualifikuar nga organet qendrore për bazën. Kjo ndihmë nuk duhet të mbulohet me shkresa, relacione dhe mbledhje pas mbledhjesh siç është vepruar në zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara dhe të rëndësishme tekniko-ekonomike. Kjo do të arrihet duke forcuar akoma më shumë lidhjet me kolektivat punonjëse, duke dëgjuar me kujdes zërin e tyre dhe duke inkurajuar

inisiativën krijuese. I duhet dhënë fund ndihmës «rrufe», siç bëjnë disa drejtues që bredhin poshtë e lart, që mbyllen në zyra e mbledhje, duke hartuar plane pas planesh dhe që rrallë konsultohen me punonjësit, me ata që i zbatojnë këto plane.

Organet qendrore duhet ta ngrenë në një nivel më të lartë punën teknike, të shkunden nga javashllëku ku janë futur dhe të zbatojnë më me vendosmëri e kurajë teknikën dhe teknologjinë e përparuar në prodhim. Ato duhet të dalin nga guaska e formave të ngushta dhe, në mjaft raste formale e të ngrenë në një nivel më të lartë punën e kolegjiuemeve, veçanërisht tani kur ne kemi kuadro të kualifikuar dhe specialistë për sektorë të ndryshëm. Kolegjiuemet të vlerësohen si duhet, ato të trajtojnë probleme të rëndësishme, duke u krijuar më shumë kondita anëtarëve për të shfaqur mendimet dhe të ndihmohen ata për t'i shikuar problemet në kompleks dhe në kuadrin e përgjithshëm, duke luftuar kështu pikëpamjet sektare dhe të ngushta dikasteriale, që janë vërejtur mjaft herë.

Përmirësimi i mëtejshëm i metodës së drejtimit nga organet qendrore do t'i hapë më shumë perspektiva kuadrin inxhiniero-teknik, brigadierëve, mjeshtërve, novatorëve, do të rritë më shumë aktivitetin dhe rolin e tyre si komandantë dhe organizatorë të drejtëpërdrejtë të prodhimit.

Eksperiencia e fituar gjatë këtyre vjetëve dhe eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i ka armatosur kuadrot e Partisë për suksese të reja. Realizimi i planit i ka preokupuar vazhdimisht organizatat e Partisë, por duhet thënë se niveli i njohjes së treguesve

cilësorë të planit është akoma i ulët. Organizatat e Partisë duhet ta kuptojnë tani se qendra e gravitetit të punës së tyre në ekonomi nuk qëndron më në njohjen dhe në ndjekjen në përgjithësi të planit, por në njohjen e thellë dhe në brëndësi të çdo problemi. Ato ta kuptojnë mirë rolin udhëheqës që kanë në ekonomi, ta ushtrojnë plotësisht këtë dhe ta ndjejnë përgjegjësinë.

Organizatat e Partisë duhet ta rritin më shumë inisiativën, ato nuk duhet t'i lejojnë vetes që çdo gjë ta presin nga lart dhe nga i deleguari, por të vetëveprojnë. Ato duhet t'i preokupojë më shumë puna me njerëzit, edukimi i tyre për rritjen e ndërgjegjes dhe forcimin e disiplinës, për përhapjen e eksperiencës së përparuar, për kualifikimin dhe organizimin e emulacionit socialist, rezultat i të cilave do të jetë përmirësimi i treguesve cilësorë të prodhimit. Rentabiliteti ekonomik i ndërmarrjes, ku ato veprojnë, duhet të jetë epiqendra e luftës së tyre të përditshme. Të hiqet dorë nga preokupimi me shumë probleme, të kapen dhe të zgjidhen ato që janë kryesoret, nga të cilat varet suksesi i punës. Organizatave të Partisë nuk u lejohet të ambientohen me të metat që shfaqen në qendrën ku ato punojnë.

Organizatat e Partisë të luftojnë më shumë për zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të mos lejojnë thyerjen e rregullave që janë vendosur, të tregohen shumë më të durueshme me kuadrot, me përgatitjen dhe me ndihmën që duhet t'u japin atyre, të lidhin gjithmonë rezultatet e realizimit të planit me njerëzit, sepse shpesh vihet re një farë sektarizmi në ngritjen e elementëve të rinj e të sprovuar.

3. — Për një studim më të drejtë të investimeve dhe për një shfrytëzim më të plotë të kapaciteteve prodhuese

Gjatë viteve të pesëvjeçarit të parë është bërë një punë e madhe për sigurimin e bazës tekniko-materiale të prodhimit. Organizimi më i mirë i punës, përvetësimi i teknikës dhe ngritja e ndërgjegjes socialiste janë të lidhura ngushtë me rezultatet e arritura gjatë këtij pesëvjeçari, me vënien e shpejtë në shfrytëzim të kapaciteteve të reja dhe me shfrytëzimin më të plotë të kapaciteteve ekzistuese.

Por, me gjithë sukseset, duhet të pranojmë se nga drejtimi i dobët dhe nga njohuritë e pamjaftueshme teknike, ne nuk i kemi shfrytëzuar plotësisht kapacitetet ekzistuese të prodhimit, kemi pasur të meta në studimin e investimeve.

a) *Mbi studimet komplekse, të koordinuara dhe me perspektivë*

Gjatë viteve të pesëvjeçarit të parë janë projektuar ose ndërtuar disa ndërmarrje, kapaciteti ose domoshmëria e të cilave kanë qenë të parakohshme.

Mungesa e një koordinimi midis dikastereve dhe shpesh brenda për brenda dikasterit ka shkaktuar që shumë kapacitete të mos shfrytëzohen me ngarkesë të plotë dhe në mënyrë ekonomike. Është krijuar një numër i madh bazash mekanike të shpërndara, rezultat ky i prirjes që kanë pasur dikasteret dhe ndërmarrjet që secila të ketë ofiçinën e vet. Edhe në sektorin e energjistikës ka munguar koordinimi.

Me ngadalësi po arrihen kapacitetet e projektuara të disa ndërmarrjeve të reja, si në Kombinatin e Tekstileve «Stalin», në Kombinatin e Drurit «Nako Spiru» etj., bile ekziston tendenca për t'iu përmbajtur kapaciteteve të projektuara dhe nuk bëhen studimet e përpjekjet e nevojshme për t'i tejkaluar ato, siç po bëhet në Fabrikën e Çimentos «V.I.Lenin» në Vlorë.

Ndërmarrjet e transportit dhe Ministria e Komunikacioneve, me gjithë porositë e dhëna, kanë nënvlefësuar çështjen e përdorimit të rimorkiove dhe punën me dy turne. Vetëm në vitin e fundit të pesëvjeçarit u vunë në përdorim disa rimorkio, duke rritur në 5,14 për qind kapacitetin e transportit.

Është e domosdoshme që organet shtetërore t'i japin fund një gjendjeje të tillë në harxhimin e lekut, të studjojnë thellë dhe në kompleks investimet dhe të njohin më mirë zhvillimin perspektiv të degëve të ndryshme të ekonomisë e të prodhimit. Të arrihet përvetësimi i plotë i kapaciteteve të projektuara dhe të luftohet për kapërcimin e tyre duke likuiduar vazhdimisht pikat e dobëta.

b) Mbi planifikimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese

Dikasteret dhe ndërmarrjet ekonomike përdorin forma të ndryshme në lidhje me përcaktimin e kapaciteteve prodhuese, të bazuara në realizimin e prodhimit të vjetëve të mëparshëm. Planifikimi dhe vlerësimi i shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, shpeshherë kanë pasur dobësi. Plane të tilla nuk kanë

qenë mobilizuese dhe kanë penguar shtimin e mëtejshëm të prodhimit.

Planet e prodhimit të ndërmarrjeve, në të shumtën e rasteve, nuk shprehin mundësitë maksimale të prodhimit, sepse në hartimin e tyre nuk merren parasysh sa duhet shfrytëzimi i të gjithë inventarit të maqinerisë, vendosja e normave progresive, tekniko-ekonomike, si edhe përvetësimi i teknologjisë e përmirësimi i organizimit të prodhimit. Përveç kësaj repartet ndihmëse zakonisht nuk kanë punuar me plan.

Normat eksperimentalno-statistikore, që janë vendosur në bazë të evidencave statistikore për periudhat e kaluara ose në bazë të eksperiencës personale të punëtorëve e të normistëve, kanë penguar shfrytëzimin më të plotë dhe më intensiv të kapaciteteve prodhuese.

Shumë maqineri, sidomos të ndërtimit, punojnë në fronte të paorganizuara dhe si rrjedhim nuk shfrytëzohen me kapacitet të plotë. Humbje të mëdha kohe kanë automjetet në ngarkim-shkarkim. Duke marrë për bazë automjetet në gatishmëri, Ministria e Komunikacioneve, gjatë vitit 1955 ka kryer 1 534 000 orë, duke përfshirë këtu edhe kohën që maqinat kanë qëndruar në pritje, ndërsa shfrytëzimi i maqinerisë në lëvizje është 1 024 000 orë, domethënë 34 për qind të kohës maqina e ka humbur për arsye të organizimit jo të mirë të punës dhe të mosmekanizimit të ngarkim-shkarkimit.

Anomalitë në furnizimin e ndërmarrjeve me lëndë të parë etj. si edhe moskoordinimi i planeve të furnizimit me ato të prodhimit kanë bërë që të punohet me hope dhe me ndërprerje. Tipik është rasti i Kombinatit të Drurit «Nako Spiru» në Elbasan, i cili prej vjetësh

nuk ka shfrytëzuar kapacitetin e plotë, për shkak të mungesës së transportit të rregullt për furnizimin e tij me lëndë të parë.

Organet ekonomike, shtetërore dhe të planifikimit të njohin më thellë kapacitetet prodhuese, në mënyrë që të bëhet planifikimi më i drejtë i tyre dhe mbi këtë të vendosen normat progresive tekniko-ekonomike. T'u jepet fund anomalive në furnizim dhe të mos lejohet që nga këto të dëmtohet prodhimi dhe të ulet rentabiliteti ekonomik.

c) Mbi mirëmbajtjen e maqinerisë

Me gjithë përmirësimet e arritura duhet të themi se në të shumtën e rasteve shërbimi teknik që i bëhet maqinerisë akoma nuk është në lartësinë e duhur. Në ndërmarrjet tona nuk është bërë ligj planifikimi i remonteve dhe zbatimi i tyre në mënyrë që maqinaria të jetë vazhdimisht në gatishmëri teknike.

Mjaft ndërmarrje paraqiten dobët me mirëmbajtjen e maqinerisë. Në vitin 1955, remonti kapital i automjeteve të Ministrisë së Komunikacioneve është realizuar 59 për qind, ndërsa Parku Automobilistik i Vlorës planin e remontit e realizoi vetëm 19 për qind. Shpesh cilësia e remonteve lë shumë për të dëshiruar. Në Parkun Automobilistik të Korçës ka pasur raste që një remont të përsëritet deri tetë herë. Shumë parqe nuk i kryejnë shërbimet profilaktike të automjeteve sipas planit. Gjatë katër vjetëve të fundit të pesëvjeçarit shërbimi teknik nr. 1 është realizuar vetëm 50 për qind dhe shërbimi teknik nr. 2 është realizuar 60 për qind.

Të metat në ritmet e prodhimit të ndërmarrjeve kanë influencuar negativisht në shërbimin teknik të maqinerisë. Zakonisht gjatë dhjetëditorit të tretë maqinerisë i bëhen shumë pak shërbime profilaktike dhe për më tepër këto shtyhen në dhjetëditorin e parë të muajit. Kjo punë me hope i detyron maqineritë të punojnë jashtë masës dhe bën të pamundur shfrytëzimin normal të bazave mekanike.

Organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë duhet t'i japin fund shikimit të njëanshëm të problemit të maqinerisë dhe ta konsiderojnë mirëmbajtjen e shfrytëzimin e saj si një detyrë të vetme e të pandarë. Ato të kujdesen më tepër për të shkurtuar afatet e remontit dhe kohën joproductive në punën e maqinerisë. Organizatat e Partisë të punojnë më shumë me njerëzit që drejtojnë maqineritë, të mos lejojnë thyerjen e rregullave dhe të kërkojnë me këmbëngulje zbatimin e përpiktë të grafikëve të remonteve.

ç) Mbi vendosjen e proceseve teknologjike dhe ritmet e prodhimit

Megjithëse sot pjesa më e madhe e ndërmarrjeve janë të pajisura me teknikë moderne dhe kanë mjaft kuadro të mesëm e të lartë, pak punohet për respektimin e proceseve teknologjike, për përmirësimin e tyre të mëtejshëm dhe për shkurtimin e ciklit të prodhimit, gjë kjo që ngadalëson mjaft shtimin e prodhimit mbi bazën e shfrytëzimit më të plotë të kapaciteteve prodhuese.

Një ndihmë e madhe na jepet nga Bashkimi Sovje-

tik dhe vendet e demokracisë popullore në kuadrin e bashkëpunimit tekniko-shkencor. Por të metat që kanë ekzistuar në këtë drejtim kanë zvogëluar efektin e kësaj ndihme, sepse ka pasur raste që nuk është zbatuar teknika dhe teknologjia e re në prodhim.

Partia ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen mbi domosdoshmërinë e respektimit të ritmeve të prodhimit dhe e ka dënuar punën me hope si metodë josocialiste dhe të dëmshme për ekonominë tonë. Me gjithë përmirësimet që kemi pasur, ka akoma shumë ndërmarrje dhe degë prodhimi, të cilat ecin me shumë zigzage në nxjerrjen e prodhimit. Zakonisht shumica e këtyre ndërmarrjeve planet e muajit i realizojnë në dhjetëditorin e tretë të muajit dhe planin tremujor në muajin e fundit e kështu me radhë. Një praktikë e tillë ka dëmtuar rëndë ekonominë, ka sjellë anomali në furnizimin e popullit dhe të ndërmarrjeve me lëndë të parë, keqësimin e cilësisë së prodhimeve, përdorimin jashtë masës të maqinerisë dhe të fuqisë punëtore, ngritjen e kostos. Së fundi, kjo tregon se këto ndërmarrje dhe degë prodhimi kanë rezerva të mëdha të brendshme që rrinë pa u shfrytëzuar dhe se organet shtetërore dhe organizatat e Partisë janë treguar të pakujdesshme për t'i kapur këto. Është e domosdoshme që organet ekonomike, shtetërore e të Partisë të organizojnë në shkallë më të gjerë përhapjen e eksperiencës së përparuar, kuadri inxhiniero-teknik të marrë plotësisht drejtimin teknik të prodhimit, të vendosen procese të reja teknologjike dhe regjime optimale të prodhimit dhe të përfitohet më shumë nga zhvillimi i teknikës në vendet e tjera. T'i jepet fund punës me hope

në nxjerrjen e prodhimit dhe të luftohet me vendosmëri për respektimin e ritmeve.

d) *Mbi shfrytëzimin e industrisë mekanike*

Kapacitetet prodhuese që shfrytëzohen më keq janë ato të industrisë mekanike. Gjendja e krijuar në industrinë tonë mekanike nuk mund të konsiderohet normale; po të merret parasysh se me gjithë numrin relativisht të madh të kapacitetit të saj, ne vazhdojmë të importojmë akoma sasi të konsiderueshme pjesësh këmbimi, del se remonti i maqinerisë mbi këtë sistem të organizimit të industrisë mekanike është shumë i shtrenjtë.

Decentralizimi i tepruar i bazave mekanike ka sjellë shpërndarjen jo të rregullt të kuadrit mekanik. Cilësia e prodhimeve të industrisë mekanike vazhdon të jetë akoma e dobët. Ndërmarrjet konsumatore e kanë gjetur lehtë të porositin nga importi edhe gjëra që mund të prodhohen në vend. Pak është luftuar për të përmirësuar cilësinë dhe për të stimuluar më mirë prodhimin. Gati të gjitha ndërmarrjet e mëdha si Kombinati i Tekstileve «Stalin», Kombinati i Naftës, Kombinati i Drurit «Nako Spiru», Rafineria e Përpunimit të Naftës në Cërrik, ndërmarrjet kryesore të ndërtimit dhe të komunikacionit, megjithëse kanë ofiçina relativisht të pajisura mirë, nuk i shfrytëzojnë ato me kapacitet të plotë, por kërkojnë sasi të mëdha pjesësh këmbimi nga importi.

Është urgjente që t'i jepet fund një herë e mirë shfrytëzimit të pakënaqshëm të bazës mekanike dhe porositjes nga importi të pajisjeve të këmbimit, të cilat

mund të prodhohen në vend. Pa prekur bazën mekanike të domosdoshme për mirëmbajtjen e maqinerisë së ndërmarrjeve, të bëhet centralizimi i pajisjeve të industrisë mekanike, të organizohet prodhimi i specializuar dhe në seri i saj. Bazat mekanike të shpërndara në vendin tonë, që nuk do t'i nënshtrohen specializimit dhe organizimit të prodhimit në seri, të kryejnë shërbime jo vetëm për ndërmarrjen pranë së cilës gjenden, por për të gjithë rajonin ekonomik ku ato ndodhen.

4. — Për një ngritje të vazhdueshme të rendimentit të punës, për uljen e kostos dhe për një regjim të rreptë kursimi

Një nga problemet më të rëndësishme që duhet të na tërheqë vëmendjen është rendimenti i punës, i cili siguron ritme të larta të akumulimit socialist dhe është një nga burimet kryesore të rritjes së vëllimit të prodhimit industrial dhe të uljes së kostos. Me gjithë sukseset që kemi pasur në rritjen e rendimentit, duhet theksuar se është punuar në mënyrë të pamjaftueshme për mekanizimin e proceseve të punës kudo e veçanërisht në ato degë prodhimi e ndërmarrje ndërtimi ku puna e krahut ka një peshë të madhe.

Stabilizimi i fuqisë punëtore dhe kualifikimi i saj janë lidhur ngushtë me rritjen e mëtejshme të rendimentit të punës. Komiteti Qendror i PPSH ka marrë masa të rëndësishme për rregullimin e sistemit të pagave, përmirësimin e konditave materiale, teknike dhe

kulturale etj., por në këtë drejtim duhet bërë akoma më shumë, pasi përqindja e punëtorëve të qëndrueshëm vazhdon të jetë e ulët.

Me gjithë përmirësimet e arritura, përqindja e punëtorëve të kualifikuar kundrejt të gjithë punëtorëve është akoma e ulët dhe kjo bëhet akoma më serioze po të marrim parasysh se ekonomia jonë është duke u pajisur vazhdimisht me maqineri dhe pajisje të një teknike të lartë. Është koha që t'i jepet fund preokupacionit të pamjaftueshëm për kualifikimin e punonjësve dhe të merren masa për të dalë nga puna e përciptë, formale dhe larg praktikës, që shpesh zhvillohet në kurset e kualifikimit dhe të perfeksionimit të punëtorëve.

Rritja e mëtejshme e rendimentit është penguar edhe nga të metat që kanë ekzistuar në planifikimin e normave dhe të pagave. Në shumë ndërmarrje e degë prodhimi punohet akoma me norma eksperimentalostatistikore, të cilat nuk kanë krijuar kondita të përshtatshme për ngritjen e rendimentit të punës, për tërheqjen e të prapambeturve në nivelin e masave të përparuara.

Si rezultat i të metave të mësipërme në shumë ndërmarrje e degë prodhimi është vërtetuar një fenomen shumë i dëmshëm në ekonomi, i cili qëndron në rritjen jo të harmonishme të rendimentit dhe të pagës mesatare. Në shumë ndërmarrje e degë prodhimi paga mesatare është rritur po me të njëjtat përpjesëtime dhe ngandonjëherë me përpjesëtime më të larta se sa rendimenti i punës, gjë që ka influencuar në dëm të ri-prodhimit të zgjeruar socialist.

Klasa jonë punëtoare dhe organet ekonomike, shte-

tërore e të Partisë kanë shtuar vazhdimisht përpjekjet e tyre dhe kanë arritur rezultate të mira në përdorimin dhe kursimin e lekut të popullit, në uljen e kostos së prodhimit. Këto kurse kanë siguruar burime suplementare materiale dhe financiare për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore. Por këtij problemi shumë të rëndësishëm, i cili kërkon mobilizimin e të gjitha rezervave për të prodhuar maksimumin e produkteve, duke shpenzuar minimumin e mjeteve të prodhimit, nuk i është kushtuar vëmendja dhe kujdesi i duhur. Janë vërtetuar lëshime të palejueshme në përdorimin me nikoqirllëk të lëndëve të para e ndihmëse, të karburanteve etj. dhe është bërë pak për shkurtimin e shpenzimeve administrative.

Si rezultat i njohjes së paktë të elementëve përbërës dhe të strukturës së kostos, lufta për uljen e vazhdueshme të saj nuk ka qenë e organizuar mirë. Nuk janë kapur dhe nuk janë zgjidhur në kohë hallkat kryesore, të cilat kanë peshën specifike më të madhe në vëllimin e shpenzimeve. Vigjilenca për ruajtjen e pronës socialiste nuk ka qenë e vazhdueshme dhe si pasojë janë vërtetuar dëmtime, shpërdorime dhe abuzime.

Organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë dhe në radhë të parë Komisioni i Planit të Shtetit të merren më thellë me studimin e drejtë të nevojave për kadro të kualifikuar në përputhje me kërkesat konkrete dhe perspektive të prodhimit. Të sigurohet më mirë baza materiale e kurseve, të lidhet më mirë teoria me praktikën dhe t'i jepet fund moszbatimit të detyrave që cakton plani për përgatitjen e kuadrove.

Të kuptohet drejt se regjimi i kursimit nuk është fushatë e përkohshme, por karakteristikë e metodës socialiste të drejtimit të ekonomisë, domosdoshmëri objektive e ecjes sonë përpara. Prandaj, të luftohen pa mëshirë të metat që vërehen në këtë drejtim. Çdo lek i popullit të harxhohet me kursimin më të madh për zhvillimin e ekonomisë popullore, për përmirësimin e mirëqenies materiale dhe kulture të masave punonjëse. Çdo komunist dhe punonjës pa parti duhet ta ketë të qartë se lufta për vendosjen e një regjimi të fortë kursimi në administrimin e fondeve materiale e monetare është çështje e madhe nderi dhe patriotizmi. Me frymën e regjimit të kursimit duhet të edukohet e gjithë Partia dhe populli ynë.

5. — Mbi transportin dhe komunikacionin

Zgjerimi dhe forcimi i vazhdueshëm dhe i mëtejshëm i transportit dhe i komunikacionit është lidhur ngushtë me zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë popullore. Transporti, me gjithë vështirësitë, ka mundur t'i përgjigjet vëllimit, gjithnjë në rritje, të qarkullimit të mallrave dhe të shërbimit të popullit. Gjatë pesëvjeçarit të parë është shtuar inventari i mjeteve të transportit, është përmirësuar dhe zgjeruar rrjeti rrugor e hekurudhor dhe është forcuar baza mekanike për shërbimet teknike.

Në të gjitha llojet e transportit vëllimi i punës në pesëvjeçarin e parë është rritur dhe vazhdimisht ka ardhur duke u shtuar. Në vitin 1955, në krahasim me

vitin 1950, vëllimi i transportit automobilistik të mallrave arriti 263 për qind, vëllimi i transportit hekurudhor arriti 222 për qind dhe i transportit detar — 160 për qind, ndërsa numri i pasagjerëve arriti 802 për qind.

Por me gjithë këto suksese në këtë sektor vazhdohet të ketë mjaft të meta. Në të tri llojet e transportit është punuar dobët për shfrytëzimin e rregullt të mjeteve sipas detyrave të caktuara dhe nga kjo koeficientet nuk janë realizuar dhe pikërisht në transportin automobilistik të mallrave koeficienti i gatishmërisë është realizuar 78,5 për qind dhe kilometrazhi mesatar 86 për qind. Në transportin detar koeficienti i përdorimit u realizua 68 për qind dhe mila mesatare 83 për qind etj.

Për të përballuar gjithë lëvizjen e mallrave dhe për të plotësuar përgjithësisht nevojat e ekonomisë dhe të popullit gjatë planit të dytë pesëvjeçar është e domosdoshme që në sektorin e transportit të vihet një rregull i fortë në organizimin e punës për përdorimin dhe shfrytëzimin e mjeteve, për kryerjen e shërbimeve teknike dhe të tregohet një kujdes më i madh nga organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë për zbulimin dhe përdorimin e rezervave të mëdha të brendshme që ekzistojnë në këtë sektor.

Vazhdon të jetë serioze për transportin gatishmëria teknike. Me gjithë përmirësimet që kanë filluar të duken, përgjithësisht, automjeteve nuk u bëhen shërbimet e nevojshme teknike dhe të remontit kapital. Gjendja në shumicën e parqeve nuk është e kënaqshme, cilësia e punës lë mjaft për të dëshiruar dhe mjaft automjete rrinë pa u shfrytëzuar.

Organizatat e Partisë dhe organet ekonomike, shte-

tërore duhet të shtojnë më shumë punën për edukimin e punonjësve, për forcimin e ndërgjegjes socialiste në kryerjen më mirë të detyrave, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e mjeteve, për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, për kursimin e karburanteve, të gomave, të pjesëve të këmbimit dhe për një shërbim më të mirë të popullit, në të cilin gjatë pesëvjeçarit të parë kemi çaluar.

Gjatë pesëvjeçarit të parë është zgjeruar dhe është përmirësuar puna në ndërlidhje, por niveli i shërbimit është akoma i ulët. Duhet të përmirësohet më tej ndërlidhja, duke e pajisur me mjete dhe duke i shfrytëzuar më mirë ato ekzistueset.

B. — ZHVILLIMI I BUJQËSISË

Shokë,

Ekonomia jonë do të kishte përparuar më shumë, në qoftë se zhvillimi i bujqësisë do të kishte ecur me një ritëm më të shpejtë.

Edhe në të ardhshmen zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë dhe përmirësimi i kushteve materiale dhe kulture të punonjësve do të jetë i lidhur me ngritjen e shpejtë të bujqësisë.

Duke e kuptuar kështu çështjen e bujqësisë del qartë se sa e madhe dhe urgjente është detyra që na shtrohet në pesëvjeçarin e dytë për zhvillimin me një ritëm më të shpejtë të këtij sektori kaq të rëndësishëm për ekonominë popullore.

Komiteti Qendror i Partisë, gjatë periudhës që ndan të dy kongreset, është preokupuar seriozisht për zbatimin e detyrave që shtroi Kongresi II për bujqësinë, ka zbuluar me guxim të metat dhe gabimet që ka pasur në drejtimin e bujqësisë dhe ka marrë masa për t'i ndrequr ato. Është fakt që në këta tre vjetët e fundit të pesëvjeçarit të parë shihet një kthesë në lëmin e bujqësisë, përsa i përket shtimit të prodhimit bujqësor dhe lidhjes së ngushtë të fshatarësisë me ekonominë bujqësore. Për t'i ardhur në ndihmë bujqësisë, që në vitin 1953, Komiteti Qendror i Partisë vendosi të pakësojë investimet në sektorët e tjerë të ekonomisë dhe shtoi investimet në bujqësi. Masat që kanë marrë Komiteti Qendror dhe qeveria për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, aprovimi i planeve me afat të gjatë për zhvillimin e olivikulturës, të apikulturës, të frutikulturës, për sistemimet agrare etj., kanë një rëndësi të madhe për të ardhshmen e bujqësisë në vendin tonë.

Komiteti Qendror dhe qeveria me qëllim që të stimulohej më mirë prodhimi bujqësor, për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë, që në vitin 1953, vendosën uljen e detyrimeve në natyrë të fshatarësisë, uljen e tatimit të ekonomisë bujqësore si dhe stimulime e çmime të favorshme për bimët industriale. Kujdes i veçantë, gjatë kësaj periudhe, i është kushtuar forcimit dhe zgjerimit të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore si dhe mekanizimit të bujqësisë. Fshatarësia është furnizuar me më shumë vegla bujqësore, farëra, damazë, me inventar bujqësor, me kredit agrar dhe me më shumë mallra industriale, lëndë ndërtimi etj.

Gjatë këtyre vjetëve në bujqësi është bërë mjaft punë për sistemimet agrare, për futjen e agroteknikës dhe të metodave të përparuara në bujqësi, për organizimin e prodhimit, të shërbimit dhe të kontrollit të farërave, janë hedhur themelet e punës për mbrojtjen e bimëve, është shtuar ritmi i përgatitjes së kuadrove të lartë dhe të mesëm brenda dhe jashtë shtetit. Është vendosur një sistem më i drejtë planifikimi në bujqësi, që u lë inisiativë ekonomive bujqësore. Kooperativat bujqësore janë forcuar ekonomikisht dhe politikisht, ato kanë dhënë shembullin përpara ekonomive fshatare individuale.

Në fshatin tonë po bëhet një kthesë rrënjësore. Politika e Partisë për kolektivizimin e bujqësisë po përfaqohet me entuziazëm nga masat punonjëse të fshatarësisë.

Rezultatet e punës që janë arritur në lëmin e bujqësisë gjatë pesëvjeçarit të parë mund t'i shohim në rritjen e prodhimit bujqësor.

Prodhimi i drithërave të bukës, i bimëve industriale, i perimeve dhe i patateve gjatë pesëvjeçarit të parë paraqitet si vijon:

në përqindje kundrejt vitit 1950

	1951	1952	1953	1954	1955
Drithëra buke	103	93	146	123	153
Pambuk	142	135	173	113	177
Panxhar sheqeri	1 137	777	1 189	665	1 779
Duhan	149	121	273	238	432
Perime e patate	78	66	121	142	164

Shifrat e mësipërme dëshmojnë se gjatë pesëvjeçarit të parë, me përjashtim të viteve 1951 dhe 1952, që kanë pasur thatësi të madhe, në vitet e tjera, ka një rritje të vazhdueshme të prodhimeve bujqësore, megjithëse ritmi i rritjes ka pasur lëkundje nga një vit në tjetrin.

Por rezultatet e arritura në bujqësi, në përgjithësi, nuk janë të kënaqshme. Në sektorin e bujqësisë nuk u realizuan plotësisht disa detyra të rëndësishme që caktoi Kongresi II i Partisë. Shteti ka qenë i detyruar të importojë sasi të mëdha drithi, janë krijuar deficite në furnizimin e popullit me prodhime bujqësore dhe blegtorale. Pesëvjeçari i dytë do të jetë pesëvjeçari i zhvillimit të bujqësisë, pesëvjeçari i transformimit socialist të bujqësisë, i kolektivizimit të saj, duke kaluar nga prodhimi i vogël individual në riprodhimin e zgjeruar socialist, pesëvjeçari i punimeve të mëdha të bonifikimeve dhe të sistemimeve agrare në shkallë të gjerë, i zgjerimit të mekanizimit të bujqësisë, i futjes më shumë të agroteknikës së përparuar në bujqësinë tonë.

1. — Prodhimi i drithërave është baza e prodhimit bujqësor

Në planin e dytë pesëvjeçar ne duhet të rritim në mënyrë të dukshme prodhimet bujqësore dhe blegtorale, të sigurojmë në vend bukën e nevojshme, të plotësojmë nevojat e industrisë me lëndë të parë, të sigurojmë prodhime bujqësore dhe blegtorale për të furnizuar popullin rregullisht.

Të zgjidhësh këto detyra do të thotë të merren

masa rrënjësore për zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë bujqësore. Por zhvillimi i të gjitha degëve të bujqësisë dhe të blegtorisë është i lidhur ngushtë me shtimin e prodhimit të drithit. Pa siguruar prodhime të bollshme drithi, pa siguruar bukën, nuk ka si të zhvillohet si duhet asnjë degë e bujqësisë ose e blegtorisë, megjithëse për zhvillimin e këtyre degëve ka kushte klimatike shumë të përshtatshme në vendin tonë.

Prandaj prodhimi i bukës në vend për të plotësuar nevojat e popullit është detyra më e rëndësishme në bujqësi për pesëvjeçarin e dytë.

A janë mundësitë për të zgjidhur me sukses detyrën për sigurimin e bukës në vend? Nuk ka dyshim se janë. Investimet e mëdha që parashikon plani i dytë pesëvjeçar për bonifikimet, ujitjen dhe sistemimet agrare, për hapjen e tokave të reja dhe për ndërtimin e objekteve të mëdha bujqësore, si tharja e kënetës së Tërbufit, bonifikimi i Fushës së Krujës dhe i rrethit të Delvinës, tharja e kënetës së Roskovecit etj., për zgjerimin e mekanizimit të bujqësisë gjatë pesë vjetëve të ardhshëm, për zgjerimin e kolektivizimit në bujqësi, për vënien në jetë të shkencës dhe të agroteknikës së përparuar si dhe për ndihmat e tjera me farëra, vegla e maqineri bujqësore, ashtu edhe me kredit agrar, janë një mbështetje e fortë që na bën të themi me bindje se detyrat që shtrohen për sigurimin e bukës në vend dhe për zhvillimin e bujqësisë në përgjithësi janë të realizueshme.

Për të siguruar nevojat e vendit me drithë dhe për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale në atë shkallë që parashikon plani pesëvjeçar duhet të luftohet në dy drejtime:

a) Të zgjerohen sipërfaqet e mbjella, duke vënë nën kulturë toka të reja. Në këtë drejtim ka rezerva të mëdha. Nga 2 558 250 ha. tokë që ka Republika, sot janë nën kulturë vetëm 380 000 ha., ndërsa, sipas të dhënave kadastrale, rezulton se 371 600 ha. tokë është e punueshme me traktor, përveç rreth 180 000 ha. tokë në zonat kodrinore dhe malore ku nuk punon dot traktori, të cilat shumë pak shfrytëzohen. Plani i dytë pesëvjeçar parashikon që sipërfaqja nën kulturë më 1960 të arrijë 450 000 ha., domethënë të vihen nën kulturë 70 000 ha. tokë e re. Siç shihet, ka mundësi jo vetëm për ta realizuar detyrën e hapjes së tokave të reja, por edhe për ta tejkaluar atë. Ne duhet të kthejmë në toka buke kullotat, livadhet, prozimet dhe pyjet e degraduar që deri dje përdorëshin për ushqim të blegtorisë. Njëkohësisht duhet të marrim masa që me një shfrytëzim më racional të tokës, atje ku ka mundësi, të marrim dy prodhime në vit, duke praktikuar në shkallë të gjerë mbjelljen e ushqimeve të gjelbëra për bagëtinë, si: hasëll, misër foragjer etj.; të marrim gjithashtu masa për përmirësimin e kullotave ekzistuese. Vetëm po ta bëjmë si duhet këtë punë do t'i zëvendësojmë kullotat e kthyera në toka buke dhe do ta shtojmë shumë bazën ushqimore për blegtorinë.

Përvetësimi i tokave të reja është një nga aksionet më të rëndësishme që duhet ndër marrë me guxim dhe duhet kryer në planin e dytë pesëvjeçar.

b) Shtimi i rendimenteve në bujqësi është një nga detyrat kryesore, ku duhet të përqëndrohet vëmendja jonë për të rritur prodhimin e përgjithshëm bujqësor. Të pallogaritshme janë mundësitë për rritjen e rendimentit të drithërave dhe të kulturave të tjera bujqësore në ve-

ndin tonë. Eksperienca e mijëra punonjësve të përparuar të bujqësisë në vendin tonë na bind për mundësitë e mëdha që ekzistojnë për marrjen e rendimenteve të larta në bujqësi. Në vitin 1955 Ndërmarrja Bujqësore Shtetërore e Maliqit ka marrë 15,2 kv./ha. misër në 123 ha., ose 16 kv./ha. grurë në 1 320 ha., kooperativa e Libonikut (Maliq) ka marrë 23,6 kv./ha. grurë, kooperativa e Moravës (Berat) ka marrë 35 kv./ha. misër, rrethi i Peshkopisë ka marrë 22 kv./ha. misër, ndërsa qarku i Korçës — 12,75 kv./ha. grurë. Sikur të gjitha ndërmarrjet bujqësore shtetërore, kooperativat bujqësore dhe ekonomitë individuale t'u afroheshin atyre rendimenteve që janë marrë nga punonjës të dalluar të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, të kooperativave bujqësore dhe të ekonomive individuale, ne do ta kishim zgjidhur me kohë problemin e bukës nga prodhimi i vendit.

Për të zgjidhur me sukses detyrën që shtron plani i dytë pesëvjeçar për sigurimin e bukës në vend duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë kulturës së misrit. Vendi ynë ka tradita për kulturën e misrit, ai e do këtë kulturë, di ta kultivojë dhe i ka parë përfitimet. Ka qenë gabim planifikimi nga zyra i strukturave të kulturave bujqësore, duke dashur të ndreqet përpjesëtimi i bimëve prashitëse dhe joprashitëse në dëm të kulturës së misrit. Kjo mënyrë planifikimi ka bërë që të largohet kujdesi për kulturën e misrit, të kufizohet kjo kulturë, bile edhe në zona ku eksperienca qindravjeçare e fshatarësisë ka treguar se misri ka dhënë rendimente të larta. Planifikimi mekanik nga lart i kulturave bujqësore, pa pasur parasysh eksperiencën e bazës dhe kushtet tokësore e klimatike të çdo zone, të çon në gabime që dëmtojnë

ekonominë popullore. Ky gabim është ndrequr kohët e fundit, por megjithatë duhet thënë se akoma nuk përqëndrohet sa duhet vëmendja për misrin.

Misri duhet të zërë vendin më me rëndësi në kulturat e drithërave që mbillen në vendin tonë, sepse është kulturë me vlerë të madhe jo vetëm për ushqimin e popullit, por edhe për ushqimin e gjësë së gjallë e për nevoja industriale. Nuk është e rastit që, me gjithë orientimin jo të drejtë që ka qenë dhënë për kufizimin e kësaj kulture, fshatarësia jonë punonjëse nuk e ka lënë pasdore misrin. Faktet tregojnë se misri jep rendiment më të lartë nga kulturat e tjera të drithërave. Në vendin tonë ka zona të tëra që për vite me radhë kanë marrë mesatarisht rendimente të larta në misër: p.sh. rrethi i Peshkopisë ka marrë 22 kv./ha., rrethi i Pukës 18,3 kv./ha., qindra ekonomi kooperativiste dhe individuale kanë marrë nga 40 deri 100 kv/ha.

Partia duhet ta marrë më seriozisht në dorë kultivimin e misrit në shkallë të gjerë në zonat më të përshtatshme, të sigurojë mbjelljen e misrit në fole katrore dhe me farëra hibride, të përgjithësojë eksperiencën e përparuar, të praktikojë gjerësisht mbjelljen e misrit për së dyti në tokat hamullore, për kokërr dhe për misër foragjer. Vetëm kështu do ta zgjidhim më shpejt problemin e bukës në vend, do të shtojmë shumë sasinë e ushqimit për blegtorinë. Misri do të na sigurojë më shumë bukë, mish, qumësht dhe gjalpë.

Detyrë kryesore në sektorin e bujqësisë gjatë pesëvjeçarit të dytë është që, duke u mbështetur në zgjerimin e kolektivizimit të bujqësisë, në shtimin e mekanizimit, në rritjen e rendimenteve dhe në zgjerimin e si-

përfaqeve të mbjella, duke çelur jo më pak se 75 000 ha. tokë të re, të sigurojmë deri në vitin 1960 jo më pak se 450 000 ton drithëra buke. Duhet të rriten rendimentet dhe të zgjerohen sipërfaqet e mbjella me bimë industriale gjatë pesëvjeçarit të dytë, veçanërisht sipërfaqet e mbjella me duhan, pambuk dhe panxhar sheqeri. Përveç problemit të bukës, që është detyra themelore në bujqësi, ne duhet të sigurojmë patjetër edhe lëndën e parë për industrinë tonë, për shfrytëzimin e plotë të kombinateve dhe të fabrikave tona. Ne duhet të sigurojmë pambukun, panxharin e sheqerit dhe më shumë duhan për nevojat tona e për eksport.

Shtimi i prodhimit të këtyre kulturave gjatë pesëvjeçarit të dytë, në bazë të shifrave të caktuara në projekt, tregon se përpjekjet dhe lufta më e madhe duhet të bëhen për rritjen e rendimentit. Për të arritur këtë rezultat del e nevojshme që, përveç masave të tjera, këto kultura të mbillen në tokat më të përshtatshme, të mekanizohen në shkallë të gjerë punimet dhe shërbimet kulturale, të përdoren në sasi më të madhe dhe në mënyrë më racionale plehrat kimike dhe të shfrytëzohet më drejt ujët për ujitje. Për të gjitha këto dhe për të përcaktuar më drejt masat për një zhvillim të mëtejshëm të kulturës së pambukut, është e nevojshme që të bëhen studime mbi baza më të thella shkencore për këtë kulturë. Studimet e bëra në lidhje me duhanin janë të vlefshme dhe është e nevojshme që të ngulmohet për zbatimin e tyre, natyrisht, duke i përsosur dhe duke i korrigjuar ato në punë e sipër. Gjithashtu është e nevojshme të bëhet vazhdimisht seleksionimi i farës së panxharit të sheqerit dhe të arrihet të sigurohet në vend

fara e nevojshme, për të mos importuar më farë të zgjedhur, siç bëhet sot. Të ngrihet në mënyrë të ndieshme rendimenti i perimeve, i patateve dhe i kulturave të tjera bujqësore për të plotësuar sa më mirë nevojat e popullit. Duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë zhvillimit të frutikulturës, vitikulturës, olivikulturës dhe mbjelljes së agrumeve, duke shfrytëzuar në mënyrë maksimale të gjitha tokat e pjerrëta dhe tokat e tjera, që nuk përdoren për kultura të arave. Në çdo kooperativë e në çdo fshat të bëhet një punë e organizuar për kryerjen e shërbimeve kulturele pemëve frutore dhe për të krijuar bloqe të reja pemësh frutore, vreshtash, ullinjsh, agrumesh etj. Fshatarësia jonë duhet të kujdeset akoma më shumë për pemët frutore dhe të mos e konsiderojë këtë një çështje të dorës së fundit. Frutat janë një ushqim shumë i mirë për njeriun dhe, kur kushtet tokësore dhe klimatike janë kaq të favorshme si te ne, është një humbje e madhe kur lihet pasdore prodhimi i tyre. Fshatarësia të mbjellë pemë frutore sa më shumë, t'u bëjë atyre shërbimet e nevojshme. Të studjohet nga qeveria lehtësimi i tatimit financiar për një kategori pemësh frutore, në mënyrë që të përkrahet kultivimi i tyre.

Fshatarësia dhe shteti, duhet t'i kushtojnë një kujdes të veçantë kulturës së ullirit, portokalleve, limonave, mandarinave. Këto përfaqësojnë një bazë ushqimore shumë të rëndësishme për popullin. Rëndësi të madhe ka çështja e shërbimeve që duhet t'u bëhen ullinjve dhe agrumeve. Përveç masave të tjera që merren në këtë drejtim, duhet të krijohen kuadro specialistësh për këto kultura.

Rritja e bletëve nuk është e kënaqshme. Populli

duhet t'i vërë rritjes së bletëve rëndësi të madhe për prodhimin e mjaltit, ushqim i mrekullueshëm për të gjithë e veçanërisht për të vegjëlit e të rinjtë. Në vendin tonë ekzistojnë të gjitha kushtet për ta zhvilluar bletën.

Rinia jonë duhet të marrë pjesë aktive, si në punën për realizimin me sukses të planit të frutikulturës, ashtu edhe për ruajtjen, përmirësimin dhe shtimin e pyjeve në vendin tonë.

Për zgjidhjen me sukses të detyrave që shtron kongresi në lëmin e bujqësisë gjatë planit të dytë pesëvjeçar, është i domosdoshëm shfrytëzimi sa më i mirë i mundësive dhe i rezervave të mëdha që ekzistojnë në bujqësi. Të shfrytëzohen sa më shumë plehrat organike, të cilat shkojnë dëm në sasi të konsiderueshme, të organizohet lufta kundër insekteve që dëmtojnë bimët si dhe lufta kundër barërave të këqia; të shfrytëzohet sa më mirë uji për ujitjen e tokave, të kryhet me kohë sistemimi agrar në zonat fushore të Republikës, të futet në bujqësi agroteknika e përparuar dhe të përhapen gjërrësisht metodat e përparuara të bujqësisë sovjetike dhe eksperiencia e punonjësve të përparuar të vendit tonë. Të zgjerohet mekanizimi kompleks i punimeve bujqësore, me qëllim që të shpejtohen si punimet bujqësore, ashtu edhe mbledhja e prodhimeve. Të organizohet prodhimi dhe mbjellja e farërave të zgjedhura që janë të përshtatshme për kushtet e vendit tonë dhe që japin rendimente të larta. Zbatimi i këtyre masave do të sigurojë rritjen e rendimenteve të drithërave dhe të të gjitha kulturave të tjera bujqësore.

2. — Detyrat e ngritjes së mëtejshme të blegtorisë

Shokë,

Blegtoria është një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë bujqësore, pa të cilën do të pengohej seriozisht zhvillimi i bujqësisë dhe plotësimi sa më i mirë i nevojave të popullit. Ky sektor kaq me rëndësi e ka preokupuar Komitetin Qendror të Partisë dhe vazhdimisht ai ka ngulur këmbë për kujdesin që duhet t'i kushtojnë organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit çështjes së blegtorisë. Si rezultat i punës që ka bërë Partia dhe i masave favorizuese që janë marrë për blegtorinë, me gjithë dëmtimet e shumta gjatë viteve të thatësisë dhe dimrit të viteve 1953 dhe 1955, sot e kemi tejkaluar në mënyrë të dukshme nivelin e paraluftës në të gjithë sektorët e blegtorisë. Por duhet thënë se detyra që shtronte plani i parë pesëvjeçar për shtimin e prodhimeve blegtorale dhe për rritjen numerike të gjësë së gjallë nuk u realizua për të gjitha llojet.

Akoma në blegtorinë tonë nuk është bërë kthesa. Gjëja e gjallë në vendin tonë mbahet në mënyrë krejt primitive, pa strehë, nuk i sigurohet ushqimi për dimër, por lihet të kullotë në natyrë. E dobët është lufta kundër sëmundjeve dhe fare pak kujdes i kushtohet përmirësimit të racës.

Vendi ynë ka mundësi të mëdha jo vetëm për shtimin e krerëve të gjësë së gjallë, por edhe për shtimin e prodhimtarisë së saj. Duke u nisur nga këto mundësi, plani i dytë pesëvjeçar parashikon të shtohet shumë

gjëja e gjallë dhe të rritet prodhimi blegtoral. Në rast se do të shfrytëzohen mirë në favor të blegtorisë të gjitha mundësitë që ekzistojnë, me siguri në vitet e ardhshme do të merren prodhime blegtorale të bollshme për plotësimin e nevojave të popullit. Të marrim p.sh., rritjen e derrit. Në krahasim me vitin 1950, në vitin 1955 kemi një rritje prej 84 për qind. Kjo është një rritje e kënaqshme, por po të shohim se si është shtrirë rritja e derrit në të gjithë Republikën, del se 58 për qind e numrit të përgjithshëm të derrave rriten në sektorin shtetëror, i cili zë 7 për qind të sipërfaqes së mbjellë në Republikë, ndërsa vetëm 42 për qind rriten në sektorin kooperativist dhe privat. Mendoni sa shumë mund të rritet derri në vendin tonë, në qoftë se edhe këta dy sektorë do të merreshin seriozisht me rritjen e derrit, sikurse sektori shtetëror. Një rritje e tillë do të siguronte sasi të mëdha mishi për ushqimin e popullit. Po kështu mund të thuhet edhe për llojet e tjera të blegtorisë. Në vendin tonë janë të gjitha mundësitë që të shtohen akoma më shumë gjedhi, dhentë ose dhitë dhe, në mënyrë të veçantë, derrat, shpendët dhe bletët, sidomos në zonat fushore. Por kujdesi për blegtorinë nuk duhet të përqëndrohet vetëm në shtimin e krerëve, ajo që ka rëndësi për ekonominë është shtimi i prodhimtarisë së blegtorisë.

Prodhimtaria e blegtorisë sot është shumë e ulët, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në sektorin shtetëror dhe kooperativist. Kooperativat bujqësore në vitin 1955 prodhuan mesatarisht 35 kv. mish për çdo 100 ha. tokë të punueshme, kullotë e livadh, 6 378 litra qumësht, 219 kg. lesh dhe 2 278 vezë për çdo 100 ha. tokë të mbje-

llë me drithëra. Këto të dhëna tregojnë se as në sektorin kooperativist nuk shfrytëzohen si duhet mundësitë ekzistuese për shtimin e prodhimeve blegtorale, ndërsa në sektorin privat dobësitë janë akoma më të mëdha.

Ne duhet të shtojmë prodhimet blegtorale gjatë pesëvjeçarit të dytë, të marrim sa më shumë qumësht, mish, lesh, vezë për çdo 100 ha. tokë.

Sigurimi i një baze të shëndoshë ushqimore është kushti i domosdoshëm për shtimin numerik të blegtorisë dhe të prodhimeve blegtorale gjatë planit të dytë pesëvjeçar. Duhet të bëhet kthesë në këtë drejtim. Të merren të gjitha masat për pastrimin e kullotave, për përmirësimin e tyre, për mbjelljen e ushqimeve të gjelbëra, veçanërisht për mbjelljen e misrit dhe të hasëlleve, për grumbullimin dhe manipulimin e mirë të barit dhe të kashtës së të lashtave e të misrit, t'i vihet rëndësi silazhimit të ushqimeve për blegtorinë, të përhapet mbjellja e barërave shumëvjeçare dhe njëvjeçare si: jonxha, tërfili, sudangrasi, sorgumi etj., t'i kushtohet kujdes mbjelljes së tagjive, grumbullimit të nënprodhimeve dhe mbeturinave të industrisë që kanë një vlerë të madhe për ushqimin e gjësë së gjallë.

Përmirësimi i racës së gjësë së gjallë duhet të konsiderohet si një nga detyrat më me rëndësi që shtrohet për blegtorinë gjatë pesëvjeçarit të dytë. Ne duhet të arrijmë të përmirësojmë racën e gjësë së gjallë, duke bërë kryqëzime me racat më të mira, që u përshtaten kushteve të vendit tonë. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet kryqëzimit të dhenve me racën «rude», «cigaja», leshi i të cilave ka vlerë të madhe për industrinë tonë, të eksperimentohet raca «karakul», e cila siguron shumë

mish, lesh, qumësht dhe lëkurë me vlerë të madhe; deri në vitin 1960 ne duhet të kemi jo më pak se 30 për qind të dhenve të Republikës të kryqëzuara me racën «rude» dhe «cigaja». Të merren masa për përmirësimin e strukturës së blegtorisë, duke rritur numrin e pëllejave për qumësht, të shkohet drejt një rajonizimi më të mirë të blegtorisë dhe t'i vihet rëndësi e veçantë zhvillimit të lopës në kooperativat bujqësore të zonave fushore. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet përhapjes së dhisë në zonat malore, rritjes së derrave si një kafshë me leverdi të madhe, shtimit të shpendëve në përgjithësi, veçanërisht të shpendëve të ujit dhe pulave të detit, të merren seriozisht rritja e bletës dhe e krimbit të mëndafshit, të cilët gjejnë kushte shumë të favorshme në vendin tonë. T'i kushtohet kujdes strehimit të gjësë së gjallë, mbrojtjes së shëndetit e luftimit të sëmundjeve të saja. Të gjithë punonjësit e blegtorisë, teknikët dhe specialistët duhet të përqëndrojnë forcat e tyre për ngritjen e blegtorisë në atë shkallë që të plotësojë në mënyrë të kënaqshme nevojat e popullit.

3. — Mbi kolektivizimin e bujqësisë

Kolektivizimi i bujqësisë është e vetmja rrugë për ta nxjerrë bujqësinë tonë nga prapambetja. Në këtë rrugë të lavdishme që na tregon leninizmi e udhëheq Partia jonë fshatarësinë punonjëse.

Duke vlerësuar kushtet objektive të vendit, në bazë të vijës së caktuar nga Kongresi II, Partia ka ecur me hapa të matur në çështjen e kolektivizimit të bujqë-

qësisë. Si rezultat i zbatimit të drejtë të kësaj vije; i punës së kujdesshme edukative që ka bërë Partia me masat punonjëse të fshatit për kolektivizimin e bujqësisë, i punës për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave ekzistuese dhe i masave të favorshme që ka marrë pushteti në lidhje me kooperativat bujqësore, këto janë forcuar ekonomikisht dhe organizativisht, janë ngritur çdo vit kooperativa të reja dhe është shtuar numri i tyre, janë krijuar kushte të favorshme për të ecur me ritme më të shpejta përpara.

Ja si ka shkuar ritmi i kolektivizimit në bujqësi:

Viti	Numri i kooperativave bujqësore	Numri i familjeve në kooperativat bujqësore	% në krahasim me ekonomitë e Ishatarësisë së Republikë	Sipërfaqja e tokave arë në kooperativat bujqësore në ha.	% në krahasim me tokat e mbjella (ara) të Ishatarësisë në Republikë
1950	90	4 517	3,00	20 236	5,55
1951	94	4 668	3,08	20 744	5,69
1952	103	5 824	3,80	24 277	6,74
1953	129	7 972	5,16	29 702	8,30
1954	150	8 902	5,71	33 898	9,62
1955	318	15 313	9,84	51 118	14,48
Deri më					
15. V. 1956	694	29 478	18,94	93 616	26,16

Nga këto të dhëna del qartë se vija politike që caktoi Kongresi II i Partisë në lidhje me kolektivizimin është zbatuar drejt. Në të tre vjetët e parë, siç shihet, ritmi i kolektivizimit është i ngadalshëm. Kjo ka ndodhur sepse i është kushtuar kujdes i veçantë forcimit të kooperativave ekzistuese, ndërsa në të dy vjetët e fun-

dit, me stabilizimin e gjendjes së kooperativave, është shpejtuar ritmi i ngritjes së kooperativave të reja. Vetëm në vitin 1955 u ngritën 87 për qind më shumë kooperativa bujqësore se sa ishin në vitin 1950.

Një gjë tjetër që të bie në sy nga pasqyra e mësipërme është fakti se përqindja e tokës së kolektivizuar është më e lartë se sa përqindja e ekonomive të kooperuara. Kjo tregon se kolektivizimi është bërë në zonat fushore, që kanë shumë tokë dhe që kanë rëndësi të veçantë për bujqësinë.

Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe, jo vetëm që nuk ka pasur raste të prishet ndonjë kooperativë, por janë futur në kooperativat bujqësore mjaft familje që qëndronin jashtë në kohën e formimit të tyre. Edhe ato kooperativa bujqësore që në përgjithësi ishin të prapambetura kanë ecur përpara.

Vendimi i Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, i dhjetorit të vitit 1955, është pritur me entuziazëm nga fshatarësia jonë punonjëse. Ajo po futet vullnetarisht në rrugën e kolektivizimit. Që prej daljes së vendimit deri më 15 maj janë ngritur 376 kooperativa të reja bujqësore, përveç 235 kolektivave bujqësore. Janë futur në kooperativa dhe kolektiva bujqësore gjithsej 35 440 ekonomi fshatare; sipërfaqja e tokave arë të kolektivizuara, duke llogaritur të dy tipet, arrin në 27,91 për qind dhe si ekonomi që janë organizuar të punojnë kolektivisht 22,8 për qind në krahasim me ekonomitë fshatare të Republikës. Ky është një sukses i madh. Politika e drejtë e Partisë sonë për ndërtimin socialist të fshatit gjen mbështetje të plotë në fshatarësinë tonë punonjëse. Është për t'u nënvizuar fakti se në koo-

perativat bujqësore futet jo vetëm fshatarësia e varfër, por edhe fshatarësia e mesme. Në 565 kooperativa me 15 587 ekonomi bujqësore të kolektivizuara, rreth 42,4 për qind ishin fshatarë të mesëm. Zhvillimi i jetës në fshat tregon se sa e drejtë dhe aktuale është politika e Partisë në lidhje me kolektivizimin e bujqësisë, se sa e drejtë është politika që ka ndjekur Partia jonë kundrejt fshatarësisë së mesme, se si po realizohen edhe në vendin tonë mësimet e Leninit të madh, i cili thoshte:

«Të dimë të biem në marrëveshje me fshatarin e mesëm — pa hequr dorë për asnjë minutë nga lufta kundër kulakut dhe duke u mbështetur në mënyrë të shëndoshë vetëm te fshatarësia e varfër...»¹.

Duke ndjekur një politikë të drejtë kundrejt fshatarësisë së mesme, Partia jonë po e tërheq atë gradualisht dhe sistematikisht në ndërtimin socialist të vendit tonë, bashkë me fshatarësinë e varfër, nën udhëheqjen e klasës punëtore.

Tani kooperativat bujqësore në vendin tonë kanë treguar se duke u shndërruar ekonomitë individuale në ekonomi të mëdha kolektive, krijohen kushte të favorshme për të siguruar prodhime më të mëdha bujqësore, për rritjen e rendimentit në punë, krijohen mundësitë për futjen në shkallë të gjerë të mekanizimit, për zbatimin e shkencës agroteknike dhe të eksperiencës së përparuar në bujqësi.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 207.

Nga viti në vit është rritur pasuria kolektive e kooperativave bujqësore, është shtuar fondi i tokës dhe janë marrë rendimente të larta për çdo ha. tokë në krahasim me ekonomitë fshatare individuale. Po të krahasojmë rendimentet e arritura në kooperativat bujqësore gjatë tre vjetëve të fundit me ato të sektorit privat, del se çdo vit kooperativat bujqësore kanë marrë mesatarisht më shumë nga sektori privat: 2,8 kv/ha. grurë, 2,2 kv/ha. misër, 3,4 kv/ha. pambuk, 110,3 kv/ha. panxhar sheqeri. Megjithëse toka e mbjellë e kolektivizuar në Republikë ishte 14,48 për qind, kooperativat bujqësore gjatë vitit 1955 siguruan 13 për qind të prodhimit të grurit, 26 për qind të pambukut, 73 për qind të panxhar sheqerit që prodhohet nga fshatarësia në gjithë Republikën.

Edhe përsa i përket blegtorisë, kooperativat bujqësore qëndrojnë më lart se ekonomitë individuale. Ndërsa në vitin 1955 në krahasim me vitin 1954, blegtoria kooperativiste pati një shtesë: në gjedhe 65 për qind, në njëthundrakë 48 për qind, në dhen e dhi 44 për qind, në derra 13 për qind, në sektorin privat shtesa ka qenë përkatësisht për dy të parët 3 për qind dhe për dy të fundit 8 për qind. Edhe në shtimin e prodhimeve blegtoriale për çdo kokë, në zhvillimin e frutikulturës dhe të aktiviteteve të tjera bujqësore, kooperativat bujqësore dallohen nga ekonomitë private nga kujdesi që ato tregojnë për shfrytëzimin e rezervave në bujqësi. Ato çdo vit i kanë shtuar të ardhurat për çdo 100 ha. tokë bujqësore. Më 1955 ato morën për çdo 100 ha. tokë 86 200 lekë të ardhura më shumë se sa në vitin 1954. Ndër kooperativat e dalluara, ajo e Rrëmbecit dhe e

Bulgarecit në Korçë kanë marrë respektivisht për çdo 100 ha. tokë bujqësore 1 771 200 dhe 1 676 900 lekë të ardhura, e Cakranit — 1 440 018 lekë të ardhura për çdo 100 ha. tokë bujqësore. Të ardhura të tilla që sigurohen nga ekonomia kooperativiste as nuk i ka ëndërruar kurrë më parë fshatarësia jonë. Në vitin 1955 më se 90 kooperativa bujqësore siguruan 1-5 milion lekë të ardhura vjetore dhe 11 të tjera — 5 deri 10 milion lekë në vit. Në vitin 1955 ato e rritën fondin e pandashëm 155 milion lekë më shumë nga gjendja e vitit 1954.

Me forcimin e vazhdueshëm të ekonomisë kolektive gjendja ekonomike dhe kulturele në kooperativat bujqësore ka ndryshuar në mënyrë të dukshme. Të marrim si shembull fshatin e Verrisë, i cili në të kaluarën ishte çiflik i bejlerëve Vrionas. Populli atje vuante për bukën e gojës dhe jetonte si mos më keq, në kasolle dhe në padituri. Pushteti popullor u dha tokë fshatarëve të Verrisë, Partia i edukoi dhe u tregoi atyre rrugën e kolektivizimit. Më 1947 njëqind e shtatë familje të këtij fshati bashkuan ekonomitë e tyre dhe organizuan kooperativën. Sot në kooperativën bujqësore të Verrisë, që mban emrin e Leninit, jeta ka ndryshuar krejtësisht. Më se 121 anëtarë kanë ndërtuar shtëpi të reja. Kooperativistët kanë shkollën e tyre, kanë ngritur 2 çerdhe fëmijësh, sallën e leximit e 15 ndërtesa për ekonominë e përbashkët; kanë pasuruar inventarin bujqësor, përdorin në punë mbi 80 maquina të ndryshme bujqësore, përveç ndihmës që u jep shteti me anën e mekanikës bujqësore, kanë zgjeruar fondin e tokës, kanë bërë sistemin e tokave, zbatojnë me kujdes agroteknikën e përparuar. Kooperativa «Lenin» e Verrisë dallohet nga eko-

nomitë individuale për rendimente të larta në bujqësi. Ajo në vitin 1955 mori 13,2 kv/ha. grurë, 15 kv/ha. pambuk, ndau për çdo ditë-pune 3,23 kg. drithë dhe 35 lekë dhe e shtoi fondin e pandashëm në 1 598 230 lekë.

Sukseset që kanë arritur deri sot kooperativat bujqësore duhet të shërbejnë si nxitje për ta shpënë gjithmonë përpara ekonominë kolektive dhe për t'i tërhequr masat e fshatarësisë punonjëse në rrugën e kolektivizimit.

Duhet thënë se në kooperativat bujqësore ka edhe të meta serioze që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë kolektive.

Para së gjithash në kooperativat bujqësore duhet të punohet për respektimin me përpikëri të statutit dhe puna e tyre të udhëhiqet në bazë të këtij statuti. Ka mjaft raste që statuti shkelet nga kryesia e kooperativës, veprohet pa pyetur asamblenë, ndahen të ardhurat jo sipas ditëve të punës, por sipas nevojës, përdoren fondet e pandashme jo sipas qëllimeve të caktuara, çënohet fondi i tokës kolektive, çënohet organizimi i punës, bëhen lëvizje të vazhdueshme të tokave dhe të njerëzve, të skuadrave dhe të brigadave. Në kooperativat bujqësore duhet të punohet që të shkohet drejt vendosjes së normave individuale të punës. Në disa kooperativa, për-sa i përket pjesëmarrjes në punë të të gjithë anëtarëve dhe plotësimit të sasisë minimale të ditëve të punës nuk respektohet kudo statuti. Duhet t'u jepet fund këtyre shfaqjeve të dëmshme që ndodhin në kooperativat bujqësore. Shkelja sado e vogël e statutit dobëson ekonominë kolektive bujqësore, lejon shthurjen e disiplinës, dëmton ngritjen e ndërgjegjes socialiste të kooperati-

vistëve. Organizatat e Partisë dhe organet shtetërore që merren me bujqësinë duhet të ndihmojnë për zbatimin e drejtë të statutit në kooperativat bujqësore. Çdo dobësi në këtë drejtim pengon forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave.

E metë tjetër e madhe në kooperativat bujqësore është zhvillimi i njëanshëm i ekonomisë kooperativiste. Kooperativat u kushtojnë më shumë kujdes disa çështjeve kryesore të bujqësisë, si prodhimin të drithërave dhe bimëve industriale, ndërsa tregojnë pak kujdes për zhvillimin e blegtorisë, të frutikulturës dhe të aktiviteteve të tjera ndihmëse. Nuk studjohen si duhet mundësitë që kanë kooperativat për zhvillimin e gjithanshëm dhe harmonizimin e degëve të ndryshme të ekonomisë kooperativiste. Kjo mungesë bën që të mos shfrytëzohet si duhet pasuria kolektive.

Është e domosdoshme që në të ardhshmen të përqëndrohet vëmendja e organeve të Partisë e të pushtetit dhe e vetë udhëheqjes së kooperativave bujqësore në zhvillimin perspektiv të ekonomisë kolektive. Duhet të bëhen studime të thelluara për zhvillimin dhe harmonizimin e degëve të ndryshme në kooperativat bujqësore sidomos të bujqësisë dhe të blegtorisë. Gjëja e gjallë duhet të shtohet më shumë në kooperativat bujqësore dhe të rritet prodhimtaria e saj për çdo 100 ha. tokë. Duhet të studjohen mundësitë dhe kushtet konkrete për çdo kooperativë dhe të caktohet drejtimi kryesor që ajo duhet të ketë si dhe degët ndihmëse.

Kooperativat bujqësore janë akoma prapa në zbatimin e agroteknikës së përparuar dhe në futjen e metodave të reja në bujqësi e blegtori, në futjen e meka-

nizimit në bujqësi. Kjo është një dobësi e madhe që e pengon seriozisht forcimin e ekonomisë kooperativiste dhe përmirësimin e jetës së anëtarëve të kooperativave bujqësore. Teknikët dhe specialistët duhet t'i ndihmojnë nga afër kooperativistët për njohjen e agroteknikës dhe të çështjeve të zooteknisë. Duhet të hiqet dorë nga shablonizmi në zbatimin e agroteknikës dhe të metodave të përparuara. Çdo krahinë dhe çdo zonë ka specifikën e saj, prandaj edhe zbatimi i agroteknikës në bujqësi duhet t'u përshtatet kushteve të vendit. Kjo gjë është e mundshme të bëhet, veçanërisht në kooperativat bujqësore.

Lufta për të marrë prodhime sa më të larta në bujqësi dhe në blegtori në kooperativat bujqësore nuk është në lartësinë e duhur. Në mjaft drejtues të kooperativave bujqësore ka pikëpamje të gabuara në lidhje me planifikimin e prodhimeve. Ata planifikojnë rendimente të ulëta për të qenë brenda dhe për ta realizuar planin më me lehtësi. Këto, në disa raste, bëhen edhe me qëllim që të rritet shpërblimi i tyre si udhëheqës ose që të sigurohen më tepër teprica. Ka gjithashtu tendenca për uljen e normave me qëllim që të realizohen më shumë ditë-pune. Këto pikëpamje janë të dëmshme dhe në kundërshtim me interesat dhe mbarëvajtjen e kooperativave bujqësore. Të planifikosh për të qenë brenda do të thotë të mos vësh në pozita luftarake anëtarët e kooperativës bujqësore, të lejosh të mos shfrytëzohen mundësitë dhe rezervat në bujqësi, të sigurosh më pak prodhime bujqësore dhe blegtorale. Duhet dënuar si pikëpamje antishtetërore dhe në dëm të kooperativave bujqësore tendenca e planifikimit për të qenë brenda

ose tendenca e uljes së normave. Ulja e normave nuk e shton vlerën e ditës së punës, përkundrazi e pakëson rendimentin në punë, ngre koston e prodhimit dhe i edukon shtre mbër kooperativistët.

Kooperativistët duhet të marrin masa për të krijuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e mekanikës bujqësore, të përdorin mirë farërat e zgjedhura, plehrat kimike dhe ndihmat e tjera. Duhet luftuar pikëpamja që kanë disa anëtarë të kooperativave bujqësore, të cilët e mbështetin përmirësimin e gjendjes vetëm në ndihmën e shtetit, pa e lidhur këtë ngushtë me punën e tyre. Jeta e kooperativistëve do të përmirësohet duke shfrytëzuar mirë pasuritë e kooperativës. Kooperativat bujqësore kanë mundësi të mëdha të plotësojnë në mënyrë të kënaqshme jo vetëm nevojat e tyre, por edhe të sigurojnë prodhime të bollshme drithërash, perimesh, frutash dhe prodhime blegtorale për të furnizuar qytetet dhe qendrat e punës. Nga ana e kooperativave bujqësore duhet të organizohet më mirë shitja e tepricave shtetit.

Shokë,

Drejtimi i ekonomisë kolektive është i vështirë, kërkon kuadro të përgatitur që të njohin mirë parimet e organizimit të ekonomisë kolektive, të njohin statutin e kooperativave bujqësore, të dinë ta organizojnë dhe ta udhëheqin mirë punën në kooperativat bujqësore, jo me metoda komandimi, por duke respektuar statutin, vendimet e kryesisë e të asamblesë së kooperativës. Ata duhet t'i njohin çështjet e agrono-

misë dhe të zooteknisë. Kuadro me një përgatitje të tillë pothuajse mungojnë në kooperativat tona bujqësore. Kolektivizimi i bujqësisë në atë masë që parashikon plani pesëvjeçar e bën akoma më të ngutshme nevojën e përgatitjes së kuadrit. Partia dhe qeveria duhet të marrin masa të veçanta për përgatitjen e kuadrit drejtues të kooperativave bujqësore, për përgatitje teknikësh dhe specialistësh, traktoristësh dhe brigadierësh për nevoja të kooperativave bujqësore dhe të bujqësisë në përgjithësi, në masën që parashikohet në direktivat e planit të dytë pesëvjeçar. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive duhet të mendojnë seriozisht për zgjedhjen e kuadrit të përshtatshëm që duhet përgatitur për bujqësinë, të vënë në drejtimin e kooperativave bujqësore njerëz të shëndoshë me përbërje të mirë, të aftë dhe të ndërgjegjshëm. Duhet të ndihmohen nga afër shokët, të cilëve u është besuar drejtimi i ekonomisë kolektive, të mos lëvizin pa vend kryetarët dhe drejtuesit e kooperativave bujqësore siç ka ndodhur deri tani. Në qoftë se ata kanë dobësi në punë, të ndihmohen me durim, të ndreqen gabimet, por jo të bëhen lëvizje të shpeshta sikurse është vepruar në mjaft raste.

Cilat janë detyrat që na dalin në lidhje me kolektivizimin e bujqësisë? Në projektdirektivat mbi planin e dytë pesëvjeçar theksohet qartë se deri në fund të pesëvjeçarit të dytë duhet të bëhet kolektivizimi i plotë i të gjitha zonave fushore të Republikës dhe i një pjese të mirë të zonave kodrinore, në bazë të organizimit të kooperativave bujqësore të tipit të artelit. Të arrijmë të kolektivizojmë 70 për qind të sipërfaqes së

mbjellë (arë) në Republikë dhe, duke organizuar kolektiva bujqësore të tipit të ulët në zonat malore, sipërfaqja e kolektivizuar të arrijë mbi 85 për qind. Ky është një revolucion i tërë që ka filluar të bëhet në fshatin tonë.

Nuk ka dyshim se fshatarësia jonë punonjëse dhe patriote do të vazhdojë si gjithmonë të ndjekë me besnikëri rrugën që i tregon Partia. Ritmi i kolektivizimit në fshat është më i shpejtë nga parashikimet tona dhe ne jemi të bindur se detyra që shtrohet për kolektivizimin e bujqësisë ka mundësi të realizohet para afatit. Kjo do të jetë një fitore e madhe.

Por a duhet të kënaqemi me punën që bëhet në fshat për kolektivizimin e bujqësisë? A është e mjaftueshme ndihma që japin organet e Partisë dhe të pushtetit për kolektivizimin e bujqësisë? Nuk duhet të kënaqemi me punën që është bërë, as me ndihmën që është dhënë deri tani. Këto kanë qenë të pamjaftueshme.

Së pari, çështja e kolektivizimit të bujqësisë nuk është ngritur si një problem i madh nga të gjitha organet e Partisë në qarqe e rrethe. Në disa zona, si në Shkodër, Elbasan, Krujë dhe Tiranë, kolektivizimi shkon me ngadalë. Problemi i kolektivizimit nuk u ka tërhequr sa duhet vëmendjen organeve shtetërore dhe veçanërisht organeve qendrore. Ato nuk kanë nxjerrë detyrat dhe nuk kanë dhënë ndihmën e duhur. Këtë problem të madh ato e konsiderojnë më tepër si një punë që duhet ta kryejnë organet e Partisë dhe organet shtetërore që merren me bujqësinë. Kjo detyrë e madhe duhet t'u tërheqë vëmendjen të gjitha orga-

neve të Partisë dhe të shtetit, se ka të bëjë me zbatimin e vijës së Partisë.

Së dyti, duhet të ruhet me rreptësinë më të madhe parimi leninist i futjes së fshatarëve në kooperativa bujqësore vullnetarisht, pa presion dhe me bindje. Kjo është garancia më e madhe për fitoren e vijës së Partisë dhe për të ardhshmen e ekonomisë kolektive. Disa komitete partie rrethi, si ato të Krujës, të Lezhës dhe të Koplikut, të shtyra nga dëshira për të organizuar kooperativa bujqësore, kanë rënë në gabime të rënda, duke shkelur vijën e Partisë; ato, pa bërë një punë politike sqaruese paraprake me fshatarët, bile pa sqaruar mirë as organizatat bazë të Partisë, kanë përdorur metoda jo të drejta. Për t'i bashkuar fshatarët në kooperativa është përdorur presioni dhe me pretekst se do të krijohen bloqe të kooperativës, janë bërë spostime pa vend të atyre ekonomive që qëndrojnë akoma jashtë kooperativave. Këto veprime janë të dënueshme nga Partia, janë në kundërshtim me vijën e drejtë të saj dhe dëmtojnë rëndë politikën e drejtë të kolektivizimit të bujqësisë. Duhet t'u jepet fund një herë e përgjithmonë shtrembërimeve të tilla dhe të vihen përpara përgjegjësisë të gjithë ata që shkelin vijën e Partisë për kolektivizimin e fshatit. Sot sektori privat i bujqësisë zë një vend të konsiderueshëm në ekonominë e vendit, prandaj krahas me kolektivizimin këtij sektori duhet t'i jepet përkrahje dhe ndihmë në mënyrë që të kryejë detyrat e caktuara për sigurimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale sa më të bollshme. Kjo ndihmë e vazhdueshme e shtetit dhe e Partisë për sektorin privat të bujqësisë është një ndihmë për forcimin

dhe shpejtimin e kolektivizimit. Ndiham që i jepet këtij sektori me kredit agrar, plehra kimike, farëra të zgjedhura, vegla bujqësore dhe me anë të SMT-ve, duhet të përdoret dhe të shfrytëzohet sa më mirë nga fshatarësia individuale. Fshatarët duhet të përdorin në shkallë të gjerë agroteknikën e re, ta bëjnë të tyre eksperiencën e më të mirëve dhe të ocin me guxim drejt kolektivizimit që është e ardhshmja e ndritur e bujqësisë.

Së treti, krahas me punën për ngritjen e kooperativave të reja bujqësore, Partia duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë forcimit të mëtejshëm ekonomiko-organizativ të kooperativave ekzistuese. Duhet të studjohet thellësisht gjendja ekonomike e kooperativave bujqësore, të zbulohen burimet dhe mundësitë që ato kanë për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, duhet jo vetëm të merren masa për shtimin e prodhimit në këto kooperativa, por edhe të sigurohen prodhime të bollshme e me kosto të ulët për popullin. Vëmendja e organizatave të Partisë dhe e organeve të pushtetit duhet të përqëndrohet në ato fshatra ku janë ngritur kooperativa bujqësore për t'i bindur të futen në kooperativat bujqësore ekonomitë individuale që qëndrojnë jashtë tyre. Kjo detyrë duhet të konsiderohet jo më e vogël se ajo e ngritjes së kooperativave të reja bujqësore.

Së katërti, duhet të studjohet mundësia e shpërndarjes së të ardhurave mujore në formë paradhënieje për kooperativistët. Praktika e derisotme në kooperativat bujqësore nuk është plotësisht e përshtatshme. Anëtarët e kooperativave bujqësore do të stimulohe-

shin më mirë dhe do të plotësonin më mirë nevojat e përditshme të tyre, po të vendosej sistemi i paradhënieve mujore për punën që bëjnë. Kjo çështje, si edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me ngjalljen e interesit material të kooperativistëve për shtimin e pasurisë kolektive, për ngritjen e rendimentit në punë, duhen studjuar. Duhet të mbahen mirë parasysh kushtet objektive të vendit tonë përsa i përket organizimit të punës në kooperativat bujqësore dhe në pronën individuale të anëtarëve. Të gjitha këto çështje duhet të studjohen thellësisht nga organet përkatëse dhe në rast nevoje, të bëhen ndryshimet e duhura në statutin e kooperativave bujqësore.

4. — Mbi mekanizimin e bujqësisë

Mekanizimi i bujqësisë mbetet gjithmonë një nga problemet kryesore, zgjidhja e plotë e të cilit do të influencojë rrënjësisht jo vetëm për mbarëvajtjen e bujqësisë sonë, por do të luajë një rol të rëndësishëm në transformimin socialist të fshatit.

Gjatë planit të parë pesëvjeçar, numri i parkut të traktorëve dhe të maqinave bujqësore është rritur në mënyrë të dukshme. Komiteti Qendror i Partisë, duke e çmuar rëndësinë e madhe që ka për bujqësinë mekanika bujqësore, ka marrë masa për shtimin e mekanizimit të bujqësisë. Për këtë gjë janë sjellë rreth 390 traktorë fizikë më shumë se sa parashikonte plani, përveç maqinave bujqësore e agregateve të shumta. Rrjeti i SMT-ve u shtua duke ngritur 10 SMT të reja

në zonat bujqësore më me rëndësi të Republikës. SMT-të u kanë dhënë një ndihmë të madhe ekonomive bujqësore, kooperativiste dhe individuale. Këto ekonomi kanë parë nga afër kujdesin e posaçëm që tregon Partia për ngritjen e ekonomisë së tyre. Sot ne mund të konstatojmë me kënaqësi se fshatarësia punojëse e çmon vlerën e madhe që ka për bujqësinë mekanika bujqësore. Traktoristët dhe mekanikët tanë, bij punëtorësh dhe fshatarësh, me punën që bëjnë në fshat, ndihmojnë për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë. Gjendja e vështirë që ishte krijuar në bujqësinë tonë tre vjet më parë, për mungesë të fuqisë tërheqëse, nuk është më në atë shkallë. Ekonomitë e fshatarëve të varfër pa kafshë pune në zonat fushore gjejnë një ndihmë të madhe në mekanikën bujqësore. Por, me gjithë masat që janë marrë për shtimin e mekanikës bujqësore mbi nivelin që parashikonte plani i parë pesëvjeçar, nevojat e bujqësisë janë të mëdha, mekanika bujqësore është e pamjaftueshme, punimet bujqësore për mungesën e mekanizimit nuk kryhen me kohë dhe zgjatin shumë. Mekanika nuk është futur në të gjitha proceset e punës bujqësore, kështu që nuk sigurohen prodhimet e duhura bujqësore dhe ka humbje të mëdha gjatë mbledhjes së tyre.

Duke marrë parasysh këtë gjendje, si dhe detyrat që caktohen për bujqësinë në planin e dytë pesëvjeçar, del i nevojshëm shtimi i mekanizimit të bujqësisë. SMT-të duhet të pajisen me maqineri bujqësore, në mënyrë që këto jo vetëm të kryejnë punimet e para në bujqësi, por të përdoren në shkallë të gjerë në të gjitha proceset e punës. Duhet të sigurohet mekanizimi kom-

pleks i punimeve bujqësore në të gjitha zonat ku vepronë SMT-të. Deri në vitin 1960 numri i traktorëve me 15 kuaj-fuqi duhet të arrijë 212 për qind në krahasim me vitin 1955. Gjithashtu në një masë të konsiderueshme do të rritet numri i agregateve, i maqinave bujqësore për korrje, shirje e për mbledhjen e prodhimeve bujqësore.

Për futjen në shkallë të gjerë të mekanizimit në bujqësi është e domosdoshme të krijohen në fushat tona kushte të përshtatshme, kështu që maqinaria bujqësore të përdoret me kapacitet të plotë. Duhet të zbatohet në kohë sistemimi agrar, të pastrohen gjerdhet, të bëhet unifikimi dhe zgjerimi i parcelave. Në këto drejtime organet e Partisë, të pushtetit, kooperativat bujqësore dhe fshatarësia individuale duhet të bëjnë një punë të madhe në të ardhshmen.

Në mjaft rrethe, si në Durrës, Lushnjë, Berat dhe kohët e fundit në Krujë është bërë një punë e mirë për pastrimin e fushave dhe zgjerimin e parcelave të tokave, gjë që lejon një shfrytëzim më të mirë të mekanikës bujqësore.

Duhet thënë se mekanika bujqësore që kemi nuk përdoret në mënyrë racionale, nuk shfrytëzohet kapaciteti i plotë i saj dhe kjo nuk vjen vetëm për shkak të gjendjes së papërshtatshme të fushave tona, por më tepër për shkak të dobësive në udhëheqjen e punës së stacioneve të mekanikës bujqësore. Ministria e Bujqësisë duhet të tregojë më shumë kujdes për mekanikën bujqësore, ajo duhet ta drejtojë nga afër atë dhe t'u japë ndihmë konkrete në vend punonjësve të SMT-ve. Drejtuesit dhe specialistët e mekanikës bujqësore duhet

t'i njohin problemet ekonomike dhe organizative të SMT-ve. Organizatat e Partisë dhe Ministria e Bujqësisë duhet të edukojnë në mënyrë të veçantë dhe me kujdesin më të madh kuadrot e SMT-ve si nga ana e ngritjes së tyre politike e ideologjike ashtu dhe nga ana tekniko-profesionale. Shkollat, kurset e traktoristëve duhet të jënë qendra të rëndësishme edukimi teknik. Organizatat bazë dhe komitetet e Partisë përsa i përket punës së Partisë me fshatin, punën me traktoristët duhet ta konsiderojnë si nga më të rëndësishmet. Traktoristët të ndihmohen konkretisht në terren, ata duhet të forcojnë lidhjet dhe bashkëpunimin me organizatat bazë të Partisë në fshatrat ku punojnë. Traktoristët përsa i përket kolektivizimit në fshat janë detashment pararojë i klasës punëtore. Duke e parë në këtë prizëm Partia duhet të kuptojë rëndësinë e madhe të çështjes dhe detyrat e mëdha që i vihen përpara për forcimin e punës në SMT-të. Nuk mund të quhet drejtues i mirë i SMT-ve ai drejtor ose agronom që nuk di sa shpenzime i ka kushtuar puna në 1 ha. tokë, sa i kushton 1 kv. drithë që ka marrë SMT-ja për efekt shpërblimi të punës së kryer, sa i kushton 1 kv. drithë ekonomisë që ka punuar me SMT-në. Drejtuesit e SMT-ve duhet të merren më tepër me problemet ekonomike.

Stacionet e mekanikës bujqësore punën e tyre duhet ta vlerësojnë jo nga realizimi i vëllimit të punës që kryejnë, por nga cilësia e punimeve dhe nga rendimentet e larta që kanë realizuar ekonomitë bujqësore, ku kanë punuar traktorët. Vetëm duke e vlerësuar kështu punën, ata do të gëzojnë dashurinë e respektin e koope-

rativistëve dhe të fshatarësisë punonjëse, do të ndihmojnë për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë dhe për ndërtimin e socializmit në fshat. Mjaft punonjës të SMT-ve nuk i mbajnë parasysh këto mësimë, punojnë sa për të realizuar planin e punimit të tokës, nuk i vënë rëndësi cilësisë së punimeve dhe nuk ndjekin efektin që ka në shtimin e prodhimit punimi me anë të mekanikës. Një qëndrim i tillë duhet goditur rëndë. Drejtuesit e SMT-ve, veçanërisht brigadierët, agronomët e zonave si dhe teknikët e specialistët që punojnë pranë seksioneve të bujqësisë, teknikët bujqësorë dhe kryesitë e kooperativave bujqësore duhet të ushtrojnë një kontroll të vazhdueshëm në punimet që kryhen nga SMT-të, të qëndrojnë afër traktoristëve dhe t'i mësojnë ata si të punojnë.

Mekanika bujqësore nuk shfrytëzohet me kapacitetin e plotë të saj. Kjo vjen sepse traktorët nuk mbahen mirë, prishen dhe nuk riparohen mirë e me kohë; për këtë arsye humbet shumë kohë dhe traktorët nuk shfrytëzohen plotësisht. Mosorganizimi i mirë i punës në brigadë dhe mungesa e disiplinës, që ekziston në disa punonjës të SMT-ve është një faktor tjetër që influencon në shfrytëzimin e dobët të maqinerisë. Kjo mungesë e madhe vonon kryerjen me kohë të punimeve bujqësore, shkakton mosrespektimin e kontratove në afat dhe ngjall pakënaqësi në ekonomitë bujqësore që kanë kontraktuar të punojnë me traktor. Nuk mund të lejohet një shturje e tillë ndaj përdorimit të mekanikës bujqësore. Ministria e Bujqësisë dhe organet e Partisë e të pushtetit në bazë duhet të marrin masa që të shfrytëzohet me tërë kapacitetin e saj mekanika bujq-

qësore. Duhet të luftohet tendenca e dëmshme, që shfaqet në disa punonjës të mekanikës bujqësore, të cilët lënë mënjanë traktorët e përdorur dhe ngarkojnë jashtë masës traktorët e rinj. Një veprim i tillë antishtetëror shkakton daljen para kohe jashtë përdorimit të maqinerisë bujqësore. Duhet të kontrollohen dhe të zbatohen në mënyrë të përpiktë kontratat e lidhura midis SMT-ve dhe ekonomive bujqësore. Të goditen rëndë, deri në vënien përpara përgjegjësisë ligjore, shkaktarët e shkeljes së kontratove. SMT-të duhet të orientohen të punojnë në radhë të parë në tokat e ekonomive kolektive; nuk duhet të lejohen pakujdesi të tilla si të disa punonjësve të mekanikës bujqësore, të cilët, të tërhequr nga interesa personale megjithëse nevojat e ekonomive kolektive janë të mëdha, bëjnë punime me mekanikën bujqësore, që është pasuri shtetërore, në tokat e ekonomive individuale, përpara atyre kooperativiste, ose nuk shkojnë të ndihmojnë ekonomitë individuale të varfëra. Një veprim i tillë nuk ndihmon për zbatimin e vijës së Partisë.

Puna e SMT-ve është me përgjegjësi të madhe. Nga puna e tyre varet shumë fati i prodhimit bujqësor, veçanërisht në pesëvjeçarin e dytë, kur mekanizimi i punimeve në bujqësi do të rritet shumë. Del e nevojshme që të përmirësohet rrënjësisht drejtimi i punës në SMT-të, të hiqet dorë nga drejtimi i përgjithshëm dhe me anë shkresash e udhëzimesh që u dërgohen SMT-ve. Si organet qendrore të bujqësisë, ashtu dhe udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në zonat ku punojnë SMT-të duhet t'i njohin mirë problemet e SMT-ve, t'i ndihmojnë ato, të ngrenë në shkallën e duhur rolin e tyre, që

ato të jenë në gjendje ta kryejnë mirë misionin ekonomik e politik që u është besuar.

Duhet të vendoset një regjim më i fortë kursimi në mekanikën bujqësore, sepse nga shpenzimet e mëdha dhe çrregullimet e shkaktuara nga drejtimi i pamjaftueshëm i punëve, kostoja e punimeve në SMT-të është e lartë. Pak luftë bëhet nga punonjësit e SMT-ve për shfrytëzimin e rezervave të brendshme dhe kjo vjen, sepse SMT-të deri sot janë financuar nga buxheti. Financimi i SMT-ve, pavarësisht nga puna që bëjnë, krijon kushte që njerëzit të jetojnë në kurriz të të tjerëve dhe nuk i mobilizon punonjësit e SMT-ve për pakësimin e shpenzimeve të shumta që bëhen. Ka ardhur koha që të fillohen provat e para për t'i bërë SMT-të ndërmarrje me baza hozrashoti.

5. — Mbi zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore

Ndërmarrjet bujqësore shtetërore përfshijnë 5 për qind të sipërfaqes nën kulturë të Republikës. Siç shihet, pesha specifike e tyre në bujqësi është e vogël. Por, duke marrë parasysh se ndërmarrjet bujqësore shtetërore përfaqësojnë formën më të lartë të organizimit të bujqësisë socialiste dhe rolin që duhet të luajnë si ekonomi të mëdha socialiste për edukimin e fshatarësisë e tërheqjen e saj në rrugën e kolektivizimit si dhe detyrat e veçanta që u ka ngarkuar Partia, ato kanë rëndësi të madhe, prandaj Komiteti Qendror i Partisë u ka kushtuar atyre një kujdes të veçantë. Gjendja e

tyre nga viti në vit është përmirësuar, ato kanë shtuar prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Në vitin 1955 ato prodhuan dhe i dorëzuan shtetit 10 për qind të drithit, 42 për qind të perimeve, 17 për qind të panxhar sheqerit, 30 për qind të qumshtit, 6 për qind të mishit, mbi sasi të e grumbulluara prej shtetit në të gjithë Republikën. Nga viti në vit ky sektor ka ecur duke u forcuar.

Megjithëse u janë plotësuar kushtet e nevojshme, si ndërtimet, mekanizimi dhe në pjesën më të madhe fuqia punëtore është stabilizuar, ndërmarrjet bujqësore shtetërore kanë dobësi të theksuara në drejtimin dhe organizimin e punës. Në to ka mungesë disipline dhe pakujdesi në studimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e ekonomisë bujqësore, siç janë studimi i tokave dhe vendosja e qarullimit bujqësor, studimi i problemeve ekonomike dhe organizative të tyre për zhvillimin e degëve kryesore dhe të degëve ndihmëse. Këto mungesa kanë sjellë si pasojë mosshfrytëzimin si duhet të mundësive të mëdha që kanë ndërmarrjet bujqësore për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Në ato ndërmarrje bujqësore ku ka një drejtim më të shëndoshë të punës dhe ku është bërë një studim më i thellë ekonomiko-organizativ, ka një rritje të dukshme në prodhim për çdo 100 ha. tokë.

Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë prodhimit të drithit, të shkohet nga viti në vit drejt rritjes së sipërfaqes me kulturë drithi, në mënyrë që drithërat të zënë vendin kryesor në krahasim me kulturat e tjera. Të studjohet

leverdisshmëria e zëvendësimit të kulturave foragjere që mbillen sot në ndërmarrjet bujqësore shtetërore me kulturën e misrit, që jep prodhim të lartë dhe ka vlerë të madhe ushqimore, si edhe me foragjere të tjera si lule dielli dhe sorgum për të siguruar një bazë ushqimore të bollshme për blegtorinë.

Duke marrë parasysh detyrën e madhe që shtron plani i dytë pesëvjeçar për shfrytëzimin racional të tokës, ndërmarrjet bujqësore shtetërore duhet të praktikojnë në shkallë të gjerë marrjen e dy dhe, atje ku ka mundësi, të tri prodhimeve në vit nga e njëjta tokë, duke kombinuar kultura të ndryshme që kanë cikël veçjetativ të shkurtër dhe që japin rendiment të lartë, veçanërisht për ushqimin e blegtorisë. Eksperienca e vitit të kaluar në Ndërmarrjen Bujqësore të Sukthit, ku nga çdo hektar në një sipërfaqe prej 36 ha. u morën 420 kv. ushqim për kafshë, tregon se mbjellja tri herë në vit duhet të përhapet kudo në ndërmarrjet bujqësore. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore duhet të përqëndrohet një vëmendje e veçantë, sidomos në prodhimin e farërave të zgjedhura, në prodhimin e damazëve për përmirësimin e racës së gjësë së gjallë, në zbatimin e agroteknikës së përparuar dhe të zbulimeve të shkencës në bujqësi. Këto ndërmarrje duhet të bëhen përhapëse të së resë në fshat. Rritja e rendimentit të kulturave të drithërave, të bimëve industriale, të perimeve dhe të patateve, shtimi i sipërfaqes së mbjellë, zgjerimi i frutikulturës, lufta kundër insekteve dhe dëmtuesve të bimëve, përdorimi me ekonomi i pasurisë së ndërmarrjes, në mënyrë që të sigurohen prodhime me sa më pak shpenzime, vendosja e një disipline të fortë shtetë-

rore dhe forcimi i drejtimit të ndërmarrjes, përbëjnë detyrat kryesore, për të cilat duhet të luftohet me këmbëngulje që ndërmarrjet bujqësore të shkojnë përpara.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet organizimit më të mirë të ndërmarrjeve të grumbullimit për majmërinë dhe rritjen e derrit. Organet e grumbullimit duhet të marrin masa për shfrytëzimin sa më shumë të ushqimeve natyrale, të prodhimeve pyjore për ushqimin e derrave; ato duhet ta shfrytëzojnë mirë dhe me ekonomi tokën që kanë në dispozicion; në të ardhshmen ato duhet të sigurojnë ushqimet e nevojshme nga burimet e tyre për mbajtjen e derrave.

Shokë,

Dëshiroj të prek edhe një çështje tjetër, që ka të bëjë shumë me plotësimin e detyrave që shtrohen për bujqësinë në planin e dytë pesëvjeçar. E kam fjalën për çështjen e farërave të zgjedhura. Partia e ka shtruar vazhdimisht me forcë këtë problem. Rëndësia e farërave dihet nga të gjithë, megjithatë ky problem akoma nuk ka gjetur zgjidhje të plotë. A mund të sigurohen prodhimet dhe rendimentet e planifikuara pa farëra të zgjedhura? Çdo punë që të bëhet, sado e mirë, nuk mund të ketë suksesin e duhur, në qoftë se nuk do të zgjidhet drejt problemi i farës. Prodhimi i farës është një hallkë me rëndësi për ngritjen e bujqësisë. Para tre vjetësh janë hedhur bazat organizative të prodhimit të farërave, janë caktuar ekonomitë që duhet të prodhojnë

farëra, është krijuar dhe shërbimi i posaçëm që merret me kontrollimin dhe inspektimin e farërave, por kjo punë është e pamjaftueshme; rezultati i prodhimit të farërave nuk është ai që duhet. Ka ndodhur që vetë ekonomitë e caktuara për prodhim farërash nuk kanë plotësuar as nevojat e tyre dhe shteti ka qenë i detyruar të mendojë për to. Duhet të kuptohet mirë nga të gjithë, në radhë të parë nga udhëheqja, se kështu nuk mund të shkohet më tutje. Ministria e Bujqësisë nuk po kujdeset për këtë problem me kaq rëndësi. Gjithashtu duhet ta kuptojnë mirë këtë çështje edhe komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive, ndryshe nuk ka si të pritët sigurimi i farërave të zgjedhura as nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore as nga kooperativat ose ekonomitë bujqësore të dalluara as nga Instituti i Bujqësisë dhe i Biologjisë, i cili është kufizuar me eksperimente në parcelat eksperimentale. Ministria e Bujqësisë dhe organet drejtuese të Partisë dhe të pushtetit në qarqe e rrethe duhet të kujdesen vazhdimisht për problemin e farërave, duke i kontrolluar ekonomitë që janë caktuar për prodhim farërash, duke i ndihmuar ato për plotësimin e nevojave që kanë. Pa u ndjekur kështu, që nga lart, problemi i farërave nuk ka si të zgjidhet.

Ku duhet ta përqëndrojmë punën tonë për prodhimin e farërave? Ne kemi ndërmarrje bujqësore të përparuara, kemi gjithashtu kooperativa bujqësore të dalluara në zonat e ndryshme të vendit, ne e kemi ngritur edhe shërbimin e farërave. Nëse është e nevojshme të riorganizohet më mirë ky shërbim, përse të mos caktojmë ndërmarrje bujqësore të posaçme dhe kooperativa bujqësore për prodhimin e farërave të zgjedhura

për të plotësuar nevojat e zonës së tyre? Këtë gjë ne duhet ta bëjmë patjetër. Nuk është e drejtë të vazhdohet më me praktikën e gabuar që është ndjekur deri sot, duke marrë farërat e një zone dhe duke i çuar në një zonë tjetër. Kjo nuk mund të bëhet për çdo lloj fare, bile edhe fara e grurit «mentana», që është e përhapur në të gjithë Shqipërinë, në të tjera kushte klimatike zhvillohet në Korçë dhe në të tjera në Lushnjë. Prandaj duhet të prodhohmë farëra, qoftë edhe të një lloji, sipas zonave. Ekonomitë që do të caktohen për prodhim farërash duhet të përgjigjen për të siguruar farën e nevojshme për zonat e tyre.

Duhet të merret seriozisht në dorë prodhimi i farës së misrit hibrid, duhet të dilet nga eksperimentet në parcela të vogla të veçuara. Punonjësit e Institutit të Bujqësisë dhe të Biologjisë, agronomët dhe specialistët e bujqësisë në ndërmarrjet bujqësore shtetërore duhet ta marrin me guxim prodhimin e farës së misrit hibrid, duke eksperimentuar shumë kryqëzime çiftesh të llojeve të ndryshme të misrit për të parë se cilat japin rezultatet më të mira. Brenda vitit duhet të importohen sasi të nevojshme të farës së misrit hibrid për të mbjellë me të gjatë vitit 1957 sipërfaqe të mëdha. Ministria e Bujqësisë duhet të studjojë mundësitë që janë për organizimin e prodhimit të farës së misrit në një ndërmarrje bujqësore dhe në disa kooperativa të dalluara për kultivimin e misrit. Kjo do ta zgjidhë më shpejt problemin e prodhimit të vazhdueshëm të farës së misrit hibrid. Me qëllim që të stimulohen ekonomitë, që do të caktohen për prodhim farërash, të shihen në mënyrë të veçantë çmimi i blerjes së farërave, ndihmat

e posaçme që duhet të japë shteti me kuadro specialistësh, plehrat kimike dhe materialet e tjera që kanë të bëjnë me prodhimin e farërave.

6. — Mbi drejtimin e punëve të bujqësisë

Shokë,

Problemet e bujqësisë janë të mëdha, sepse i madh e i gjerë është vetë sektori i bujqësisë. Bujqësia ka të bëjë me gjithë fshatin dhe ne e dimë se në fshat jeton dhe punon pjesa më e madhe e popullsisë së vendit. Të arrihet të zgjidhen drejt problemet e bujqësisë, ashtu si e shtron Partia, do të thotë që puna e Partisë për edukimin e fshatarësisë punonjëse ta ketë bërë efektin e saj. Në qoftë se ne themi se bujqësia qëndron akoma prapa në një zonë ose në një tjetër, në krahasim me masat që janë marrë nga ana e shtetit, kjo tregon se puna e organeve të Partisë, e organeve të pushtetit dhe e atyre të bujqësisë në lidhje me fshatin është akoma e dobët në ato zona. Këtu nuk përjashtohen nga përgjegjësia organet qendrore të bujqësisë, sepse dihet se ndihma që ato japin është e pamjaftueshme. Organet qendrore të pushtetit, veçanërisht ato të bujqësisë, kanë dobësi të theksuara në drejtimin e punës. Akoma puna drejtohet me anën e shkresave, në mënyrë burokratike, me formula dhe udhëzime të përgjithshme; nuk mbahen parasysh veçoritë e njërës ose të tjetrës zonë, sepse ato nuk janë studjuar si duhet, nuk njihen mirë, as nuk mbahen parasysh kushtet e reja që krijo-

hen në bujqësi si pasojë e faktorëve të natyrës. Fryma e burokratizmit, që ka mbuluar organet qendrore të bujqësisë, shkon edhe në organet e saj në bazë. Nuk është e rastit që njerëzit ankohen poshtë pse merren aq shumë me shkresa dhe formularë sa që edhe specialistët mbyllen nëpër zyra.

Duhet t'i jepet fund drejtimit të punëve të bujqësisë dhe të fshatit me anë shkresash, qarkoresh dhe në forma të përgjithshme. Organet drejtuese të Partisë, të pushtetit dhe të bujqësisë në qarqe e në rrethe dhe organet qendrore duhet të ndihmojnë konkretisht bazën, të njohin prodhimin, të njohin nga afër problemet dhe të merren me prodhimin. Për një ndihmë të tillë ka nevojë baza, një ndihmë të tillë kërkojnë bujqësia dhe fshati; në këtë drejtim ne duhet ta bëjmë kthesën.

Për t'i dhënë një hov akoma më të madh bujqësisë, organet e Partisë dhe ato shtetërore të orientojnë ushtarët dhe oficerët e çmobilizuar dhe banorët e qytetit që nuk merren me punë prodhuese të shkojnë në fshat, të merren me bujqësi, blegtori e frutikulturë, të shfrytëzojnë pasurinë e madhe që ka toka, të prodhojnë e të përmirësojnë jetën e tyre.

Qyteti është në gjendje të plotësojë nevojat për punëtorë dhe të ndihmojë edhe bujqësinë me forca, që në kaluarën ishin në fshat, por, të detyruar nga lufta, zbritën në qytete. Kooperativat bujqësore do t'i presin me krahë hapët bashkëfshatarët e tyre që kthehen nga qyteti dhe do t'u japin çdo përkrahje për t'i vendosur familjarisht në to

Ndërmarrjet bujqësore shtetërore ekzistuese dhe

ato që do të ngrihen në të ardhshmen kanë nevojë për mijëra krahë pune. Ja ku është fronti i punës, ku duhet të vendosen punëtorët! Shteti do të vërë në dispozicion të atyre, që duan të kthehen në fshat dhe të merren me punë bujqësore, toka që tani janë të lira ose toka të hapura rishtas. Nuk ka dyshim se kësaj thirrjeje të Partisë do t'i përgjigjet, si kurdoherë, rinia jonë heroike, ushtarët dhe oficerët tanë trima të çmobilizuar, komunistët dhe patriotët, qytetarët dhe qytetarët tona që nuk merren me punë në prodhim. Shteti do t'i ndihmojë me të gjitha mundësitë: me kredit agrar, me mjete dhe vegla pune, me kafshë prodhimi, me farëra të zgjedhura, me materiale ndërtimi për t'u vendosur përfundimisht në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, në kooperativat bujqësore ose në tokat e reja.

C. — RRITJA E MIRËQENIES MATERIALE DHE E NIVELIT KULTURAL TË MASAVE PUNONJËSE GJATË PESEVJEÇARIT TË DYTË

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë kanë treguar një kujdes të vazhdueshëm për përmirësimin e mirëqenies materiale dhe ngritjen e nivelit kultural të masave tona punonjëse. Ato gjatë këtyre vjetëve të fundit kanë marrë një sërë masash të ndryshme në dobi të punonjësve të vendit tonë.

Në bazë të rritjes së prodhimit industrial dhe bujqësor u rritën edhe mundësitë për një furnizim më të mirë të popullsisë me artikuj të konsumit të gjerë. Në

vitin 1955, në krahasim me vitin 1950, xhiroja e tregëtisë socialiste për frymë është rritur 80 për qind.

Gjatë këtij pesëvjeçari tregëtia është zgjeruar, populli është furnizuar me sasi të mëdha artikujsh industrialë dhe ushqimorë. Tregëtia me artikuj industrialë është shtuar dhe mund të thuhet se detyrat në këtë drejtim janë plotësuar më mirë. Vështirësitë në lidhje me plotësimin e nevojave të popullit me artikuj të veshmbathjes në të dy vjetët e parë të periudhës së planit të parë pesëvjeçar u kapërcyen. Në furnizimin e popullit me artikuj ushqimorë ka pasur përmirësime të dukshme, populli është furnizuar me më shumë mish, yndyrna, sheqer, makarona, fruta, zarzavate etj. Por edhe në këtë drejtim, me gjithë përmirësimet, kërkesat e popullit për disa artikuj ushqimorë janë të mëdha dhe, si rrjedhim, në treg është ndjerë nevoja për më shumë artikuj të tillë.

Sigurimi i bukës me çmim shumë të lirë për punonjësit është një provë e madhe që tregon se Partia dhe qeveria përsa i përket këtij artikulli kryesor kanë bërë gjithshka në mënyrë që punonjësit të përballojnë pa asnjë vështirësi nevojat për bukë.

Gjatë planit të parë pesëvjeçar një rëndësi e veçantë i është kushtuar furnizimit të fshatit. Për shembull gjatë vitit 1955 fshatarësia ka marrë nga rrjeti i kooperativave të konsumit 136 për qind më tepër tekstile të leshta se në vitin 1950, — 68 për qind më tepër tekstile të pambukta dhe 99 për qind më tepër këpucë dhe opinga. Gjithashtu gjatë kësaj kohe fshati është furnizuar me sasi më të mëdha çimentoje, tullash, tjegullash, xhamash, gozhdësh, litarësh, me më shumë

lëndë druri, enë kuzhine, radio, biçikleta e artikuj të tjerë, të cilët kanë ndihmuar për përmirësimin e jetesës në fshat.

Si rezultat i përmirësimit të furnizimit të fshatit me artikuj industrialë u rrit në një masë të konsiderueshme blerja e prodhimeve bujqësore e blegtorale, u shtuan sasi të e prodhimeve bujqësore e blegtorale të përpunuara, të cilat kanë shërbyer për të inkurajuar prodhimin në zonat e largëta dhe për të furnizuar më mirë popullin me këta artikuj. Por në këtë drejtim, me gjithë sukseset e arritura, kooperativat e konsumit nuk po i kryejnë mirë detyrat e tyre. Ato nuk janë shtrirë sa duhet në zonat e thella. Shumë prodhime të këtyre zonave dëmtohen për shkak se nuk janë krijuar bazat materiale për grumbullimin dhe përpunimin e tyre. Këto dobësi duhet të marrin fund gjatë vjetëve të ardhshëm. Në planin e dytë pesëvjeçar do të bëhen investime më të mëdha për të ngritur fabrika dhe punishte, që do të merren me përpunimin dhe konservimin e qumshtit, të frutave dhe të perimeve, duke zgjeruar kështu bazat materiale për shfrytëzimin e këtyre burimeve, me qëllim që tregu të pasurohet me artikuj ushqimorë.

Gjatë planit të parë pesëvjeçar është zhvilluar ushqimi social dhe xhiroja e këtij sektori në tregëtinë socialiste është rritur gati 2 herë në krahasim me vitin 1950. Ushqimi në mensat e qendrave të punës dhe në shkollat është përmirësuar. Përmirësime janë bërë edhe në zgjerimin e asortimenteve dhe të cilësisë, por, megjithkëtë, ushqimi social është akoma prapa nga kërkesat. Duhet të bëhen akoma përpjekje për zgjerimin

e prodhimeve kryesore dhe për uljen e kostos. Lokalet e ushqimit social dhe sidomos mensat dhe restorantet janë prapa nga detyrat e tyre për t'u bërë qendra të ushqimit familjar dhe kështu të ndihmojnë për lehtësimin e punëve të gruas në shtëpi dhe për pjesëmarrjen e saj gjerësisht në prodhim.

Vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe i Komitetit Qendror të PPSH i mbështetur në vendimin e Kongresit II të PPSH mbi heqjen e pjesshme të sistemit të triskëtimit dhe unifikimin e çmimeve është një fitore e ekonomisë sonë socialiste, një fitore që vërteton drejtësinë e politikës ekonomike që ka ndjekur Partia jonë gjatë kësaj periudhe.

Më 30 prill të këtij viti u bë një ulje e rëndësishme e çmimeve për disa artikuj industrialë dhe ushqimorë në një shumë prej 1 miliard e 500 milion lekësh. Kështu fuqia blerëse e popullit u rrit. Partia dhe qeveria edhe në të ardhshmen do ta kenë në qendër të vëmendjes së tyre përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve materiale dhe kulturale të masave punonjëse dhe kjo pa dyshim do të arrihet me shtimin e prodhimit, me uljen e kostos dhe me uljen e shpenzimeve. Kjo gjë do të na lejojë të bëjmë ulje të tjera të vazhdueshme të çmimeve për rritjen e mëtejshme të pagës reale. Kjo është rruga më e drejtë për të përmirësuar gjendjen materiale të masave punonjëse.

Heqja e kufizimit të tregëtisë në fshat do t'i forcojë marrëdhëniet ekonomike midis qytetit dhe fshatit. Partia dhe qeveria i kanë kushtuar dhe do t'i kushtojnë vazhdimisht edhe në të ardhshmen kujdes të posaçëm forcimit të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë

punonjëse, si në të gjitha fushat e tjera, ashtu edhe në fushën e qarkullimit të mallrave.

Me gjithë përmirësimet që ka pasur në furnizimin e popullit, duhet thënë se në tregëti ka mjaft të meta, të cilat janë bërë pengesë për rezultate më të mira. Organet e tregëtisë, duke filluar që nga Ministria e Tregëtisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit, punojnë keq për njohjen e nevojave të popullit; ato nuk njohin mirë ndjenjat estetike dhe shijen e konsumatorëve, nuk njohin nevojat për artikuj lë-mijësh dhe për shumë artikuj të tjerë, nuk vlerësojnë mirë furnizimin sipas stinëve të vitit dhe sipas zonave. Për më tepër organet e tregëtisë nuk u përshtaten me shpejtësi ndryshimeve që pëson kërkesa dhe si rrjedhim bëjnë një shpërndarje mekanike të mallrave. Këto dobësi kanë krijuar pranë ndërmarrjeve tregëtare mallra stoqe dhe tej normativës. Organet e tregëtisë nuk kanë ushtruar influencën e duhur mbi prodhuesit për përmirësimin e cilësisë e të asortimentit dhe në shumë raste rrjeti tregëtar ka furnizuar popullin me mallra jashtë standardit dhe kushteve teknike. I pakënaqshëm ka qenë tregëtimi me fruta dhe perime. Gjithashtu puna e organeve të tregëtisë për ruajtjen e vlerave materiale dhe monetare nuk ka qenë e mirë; ka pasur vjedhje dhe dëmtime të vazhdueshme.

Është e nevojshme që të kuptohet se vjedhja dhe dëmtimet janë forma kryesore e luftës së klasave në sektorin ekonomik dhe prandaj duhet të forcohet kontrolli, të ngrihet vigjilenca e punonjësve në një shkallë më të lartë, të merren masa për të mbyllur të gjitha shtigjet që krijojnë mundësi për vjedhje dhe dëmtime.

Përmirësimi i mëtejshëm i furnizimit të popullsisë me artikujt e konsumit të gjerë është dhe mbetet një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë dhe të qeverisë sonë. Prandaj sektorëve të prodhimit të tregëtisë në planin e dytë pesëvjeçar u shtrohen detyra akoma më të mëdha që në bazë të rritjes së prodhimit të krijojnë mundësi për të hequr krejtësisht sistemin e triskëtimit dhe për të ulur vazhdimisht çmimet në bazë të uljes së kostos.

Gjatë planit të dytë pesëvjeçar furnizimi i popullit do të përmirësohet më tepër; populli do të marrë më shumë artikuj ushqimorë dhe artikuj veshmbathjeje. Në vitin 1960, në krahasim me vitin 1955, populli do të marrë më shumë: sheqer 39 për qind, yndyrna 45 për qind, makarona 37 për qind, mish e peshk 81 për qind, djathë e gjizë 264 për qind, fasule e oriz 60 për qind, perime e patate 93 për qind, qumësht 195 për qind, tekstile të pambukta 21 për qind, të leshta 35 për qind, këpucë e opinga 79 për qind, kadife e drillë 379 për qind etj.

Gjatë këtij pesëvjeçari do të përmirësohet furnizimi i fshatit me material ndërtimi dhe me artikuj të tjerë për fshatin, gjë që do të ndihmojë për shpejtimin e ritmit të kolektivizimit në fshat dhe për forcimin e kooperativave bujqësore. Kooperativat bujqësore do të ndihmohen kështu për të kryer ndërtimet e nevojshme për nevojat e tyre kolektive dhe për ekonominë individuale. Në fund të pesëvjeçarit të dytë furnizimi i fshatit do të jetë më shumë se në pesëvjeçarin e parë: me gozhdë 83 për qind, me lëndë druri të sharruar 676

për qind, me xhama 123 për qind, me çimento 345 për qind, me tulla 221 për qind, me tjegulla 200 për qind etj.

Përmirësimi i furnizimit të popullit dhe zgjerimi i qarkullimit të mallrave kërkojnë që tregëtia jonë socialiste ta përmirësojë punën e saj për planifikimin dhe shpërndarjen e mallrave dhe të largohet nga shpërndarja mekanike që ka ekzistuar deri tani, të njohë më mirë nevojat e popullit dhe t'u përshtatet me shpejtësi ndryshimeve që pëson kërkesa, sepse vetëm kështu ajo do të jetë në gjendje të influencojë në mënyrë aktive mbi prodhimin. Është e nevojshme të bëhet një shpërndarje më e drejtë e rrjetit të tregëtisë, të ecet drejt specializimit të rrjetit në qytetet kryesore, të përmirësohet shërbimi e të ulët kostoja në sektorët e ushqimit social. Sot, më tepër se kurrë, para punonjësve të tregëtisë shtrohet problemi që të mësojnë të bëjnë tregëti dhe kjo nuk është një punë e lehtë, por kërkon vullnet e lodhje për të ngritur kulturën tregëtare në një nivel më të lartë. Të zgjerohet dhe të forcohet rrjeti i grumbullimeve dhe i punishteve të përpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale në zonat e thella të vendit, si edhe baza materiale e grumbullimeve. Partia duhet të ndihmojë që të forcohen kooperativat e konsumit nga ana ekonomike dhe organizative, që të mund ta zgjerojnë veprimtarinë e tyre dhe të shërbejnë më mirë si hallka të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse.

Të përmirësohen kushtet e tregëtimit në tregun fshatar. Ky treg të shërbejë edhe në të ardhshmen për furnizimin e popullit. Në kushtet e sotme të zhvillimit të ekonomisë popullore tregëtia e vogël dhe artizanati

privat, nën kontrollin dhe influencën e shtetit, duhet të vazhdojnë të ndihmojnë për furnizimin e popullit, sidomos atje ku ndihet nevoja më e madhe, si në artikujt ushqimorë, në prodhimet bujqësore e blegtorale, në zgjerimin e aktiviteteve të artizanatit dhe të shërbimeve të ndryshme.

Një tregues i rëndësishëm i mirëqenies materiale dhe kulturele të masave punonjëse është rritja e të ardhurave kombëtare. Gjatë pesëvjeçarit të parë të ardhurat kombëtare janë rritur rreth 70 për qind në krahasim me vitin 1950. Si rezultat i ndryshimit të strukturës shoqërore në vendin tonë shpërndarja e të ardhurave kombëtare bëhet në përputhje me interesat e masave punonjëse.

Sikurse në të gjitha vendet socialiste edhe në vendin tonë zhvillimi i ekonomisë popullore ka krijuar kushte për zhdukjen e papunësisë një herë e përgjithmonë. Kjo ka sjellë rritjen e mirëqenies së masave punonjëse dhe, si rrjedhim, rritjen e popullsisë. Gjatë pesëvjeçarit të parë popullsia është rritur mesatarisht çdo vit në 2,7 për qind. Asnjëherë nuk është parë një rritje kaq e madhe e popullsisë së vendit tonë.

Gjatë planit të parë pesëvjeçar kooperativave bujqësore dhe fshatarësisë individuale u është dhënë një kredi prej më shumë se 1 miliard lekësh dhe vetëm për vitin 1956 do t'u jepet një kredi prej 535 milion lekësh ose 23 për qind më shumë se në vitin 1955. Me mijëra ndërtesa banimi të reja janë ngritur në fshatrat tona; vetëm gjatë kësaj periudhe që po shqyrtojmë janë ngritur 17 152 shtëpi banimi në fshatra dhe në kooperativa bujqësore dhe me mijëra të tjera do të

ngrihen gjatë planit të dytë pesëvjeçar. Kështu çdo vit jeta e fshatit do të përmirësohet.

Një burim plotësues për rritjen e të ardhurave të masave punonjëse janë shpenzimet buxhetore për arsim, shëndetësi, sigurimet shoqërore, për pensione dhe ndihmë nënave me shumë fëmijë etj. Në vitin 1955 shpenzimet për masa shoqërore-kulturale përbënin 1 miliard e 867 milion lekë ose 193 për qind kundrejt vitit 1950. Shpenzimet për sigurimet shoqërore në vitin 1955 ishin 249 milion lekë ose 215 për qind kundrejt vitit 1950. Gjatë kësaj periudhe është rritur numri i punonjësve dhe i fëmijëve që janë çlodhur në shtëpitë e pushimit, është shtuar numri i kopshteve, i çerdheve, i spitaleve etj.

Plani i dytë pesëvjeçar shënon një rritje të mëtejshme të mirëqenies materiale dhe kulture të masave punonjëse. Të ardhurat kombëtare në fund të vitit 1960 do të rriten 53 për qind kundrejt vitit 1955. Paga reale e punëtorëve dhe nëpunësve do të rritet kundrejt vitit 1955 jo më pak se 25 për qind, ndërsa të ardhurat e fshatarësisë do të rriten rreth 38 për qind. Ndërsa gjatë planit të parë pesëvjeçar u shpenzuan për masa shoqërore-kulturale 1 miliard e 867 milion lekë, gjatë planit të dytë pesëvjeçar ato do të arrijnë shumën prej 3 miliard e 150 milion lekësh. Gjatë planit të dytë pesëvjeçar do të shtohet numri i nxënësve në shkollat e larta dhe të mesme, do të çelen 119 shkolla 7-vjeçare të reja dhe do të arrihet që në shumicën e fshatrave ku ka mbi 25 nxënës, të ketë shkollë 7-vjeçare dhe do të shtohet numri i shkollave fillore. Partia dhe qeveria kanë gjithnjë parasysh detyrën për të krijuar vazhdi-

misht kushte më të mira jetese për fëmijët e vegjël dhe për këtë arsye gjatë planit të dytë pesëvjeçar numri i çerdheve në krahasim me vitin 1955 do të rritet 113 për qind, do të çelen 221 kopshte të reja dhe do të rritet numri i kopshteve me drekë në qytetet dhe në qendrat e punës. Fonde të konsiderueshme do të shpenzohen për shëndetin e popullit; numri i shtretërve më 1960, në krahasim me vitin 1955 do të rritet në 23 për qind më shumë.

Megjithëse gjatë planit të parë pesëvjeçar janë shpenzuar 1 miliard e 712 milion lekë për ngritjen e ndërtesave të banimit me një sipërfaqe prej 450 500 m², përsëri problemi i banesave për punonjësit mbetet një problem i rëndësishëm, duke pasur parasysh se nevojat shtohen vazhdimisht. Prandaj gjatë planit të dytë pesëvjeçar, për ngritjen e ndërtesave të reja në qendrat e punës dhe në qytete do të shpenzohen rreth 2,5 miliard lekë ose 45 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë. Sipërfaqja e banesave do të rritet në 47 për qind më shumë. Është detyrë e të gjithë punonjësve që të tregojnë një interesim të madh për mirëmbajtjen e ndërtesave, sepse kjo çështje lë shumë për të dëshiruar. Problemi i ndërtimit të banesave duhet të marrë një karakter më të gjerë dhe të ndërtohen më shumë banesa nga kooperativat bujqësore, nga fshatarët dhe nga punonjës të tjerë, duke përdorur kredinë që u jep shteti si edhe kursimet e tyre.

Shokë,

Sukseset e mëdha të arritura në zhvillimin e ekonomisë sonë popullore që parashtruam më lart janë të lidhura ngushtë me transformimet e mëdha revolucionare ekonomiko-shoqërore që u kryen nga ana e pushtetit tonë popullor që në vjetët e parë pas çlirimit, të cilat kanë sjellë ndryshime në strukturën ekonomiko-shoqërore të vendit tonë.

Sot në vendin tonë kemi dy tipe pronësie: pronën socialiste dhe pronën private. Prona socialiste ekziston në dy forma: në formën e pronës shtetërore dhe në formën e pronës kooperativiste. Prona shtetërore socialiste është forma kryesore e pronësisë në ekonominë e vendit tonë. Ajo përfshin industrinë, pasuritë e nëntokës, pyjet, transportin automobilistik, hekurudhor e detar, ndërmarrjet bujqësore shtetërore, bankat, tregëtinë e jashtme, tregëtinë e brendshme me shumicë, pjesën dërmuese të tregëtisë me pakicë etj. Prona kooperativiste përfshin pronën e kooperativave të artizanatit, të kooperativave bujqësore dhe të kooperativave të konsumit. Prona private nga ana e saj ndahet gjithashtu në dy kategori: në pronën private të prodhuesve të vegjël dhe në pronën kapitaliste-private që bazohet në shfrytëzimin dhe spekulimin.

Në përputhje me format e ndryshme të pronësisë, ekonomia jonë karakterizohet nga ekzistenca e këtyre sektorëve kryesorë ekonomikë: e sektorit socialist shtetëror e kooperativist, e sektorit të prodhimit të vogël të mallrave dhe e sektorit kapitalist.

Sot sektori socialist shtetëror ka në duart e veta

pozitat komanduese. Ai zotëron absolutisht në sferën e industrisë e veçanërisht të minierave, të financave, të transportit, të tregëtisë së jashtme dhe të tregëtisë së brendshme me shumicë. Ai shtrihet gjithashtu edhe në sektorin e bujqësisë. Por në bujqësi është akoma i madh sektori i prodhimit të vogël privat që përfaqësohet nga ekonomitë e copëtuara të fshatarëve individualë. Sektori kooperativist është sundues në artizanat dhe shkon drejt rritjes me hapa të shpejtë në bujqësi. Sektori kapitalist është jashtëzakonisht i kufizuar.

Si rezultat i zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në vendin tonë është arritur që pesha specifike e sektorit socialist (shtetëror dhe kooperativist) në të ardhurat kombëtare ka ardhur gjithnjë duke u rritur. Në vitin 1955 ajo zinte rreth 48 për qind të të gjitha të ardhurave kombëtare dhe në vitin 1960 parashikohet të arrijë në rreth 84 për qind.

Pesha specifike e sektorit socialist në industri mbi prodhimin e saj të përgjithshëm në vitin 1955 ishte 98,1 për qind me çmimet e vitit 1956, ndërsa e sektorit privat ishte vetëm 1,9 për qind, në vitin 1960 parashikohet që kjo përqindje të kalojë respektivisht në 99 për qind dhe 1 për qind. Kjo do të thotë se problemi i pronësisë socialiste dhe private në industri është zgjidhur definitivisht në dobi të sektorit socialist.

Edhe në tregëti ky problem është duke u zgjidhur definitivisht me sukses. Në vitin 1955 tregëtia socialiste ka realizuar mbi 82 për qind të qarkullimit të mallrave, ndërsa tregëtia e vogël private bashkë me tregun fshatar realizoi më pak se 18 për qind. S'ka dyshim se për nevojat e furnizimit të popullsisë sektori

privat në tregëti ka për të luajtur edhe gjatë pesëvjeçarit të dytë një rol deri diku të ndjeshëm. Por, sidoqoftë, me forcimin e sektorit socialist në tregëti dhe me kolektivizimin e bujqësisë do të ngushtohet patjetër sfera e veprimit të tij. Kështu parashikohet që në vitin 1960 nëpërmjet sektorit socialist të tregëtisë t'i shiten popullit rreth 86 për qind të mallrave, kurse nëpërmjet tregëtisë së vogël private dhe të tregut fshatar vetëm 14 për qind.

Në bujqësi sektori socialist ka ardhur nga viti në vit duke u zgjeruar dhe duke u forcuar. Ndërsa në vitin 1950 pesha specifike e sektorit socialist në vëllimin e përgjithshëm të prodhimit bujqësor, pa pyjet (në bazë të çmimeve të vitit 1956) përfaqësonte rreth 6 për qind dhe sektori privat — 94 për qind, në vitin 1955 pesha specifike e sektorit socialist në vëllimin e përgjithshëm të prodhimit bujqësor arriti rreth 14 për qind dhe e sektorit privat — 86 për qind. Në vitin 1955 sektori socialist zinte mbi 15 për qind të sipërfaqes së përgjithshme nën kulturë, nga e cila sektori kooperativist — rreth 13 për qind, ndërsa më 15 maj 1956 vetëm kooperativat bujqësore zinin mbi 24 për qind të sipërfaqes së mbjellë. Me zhvillimin me ritme të shpejta të kolektivizimit të bujqësisë, siç parashikohet në projekt-direktivat e Kongresit III të Partisë për planin e dytë pesëvjeçar, në vitin 1960 kooperativat bujqësore do të përfshijnë mbi 70 për qind të sipërfaqes së punëshme dhe kolektivat bujqësore — mbi 15 për qind. NBSH-të nga ana e tyre do t'i shtojnë tokat e punëshme që kanë pasur në vitin 1956 në 56 për qind.

Me zgjerimin e sektorit shtetëror dhe kooperativist në bujqësi pesha specifike e sektorit socialist në pro-

dhimin e përgjithshëm bujqësor, pa pyjet, në vitin 1960 (në bazë të çmimeve të vitit 1956) do të jetë 78 për qind, ndërsa sektori privat do të bjerë në 22 për qind.

Kështu, pra, edhe në bujqësi po sigurohet fitorja e plotë e pronës socialiste mbi atë private.

Ç — ZHVILLIMI I ARËSIMIT, I KULTURËS DHE I SHKENCËS

Krahas punës së madhe për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë po zhvillohet me sukses edhe revolucioni kultural. Në kuadrin e këtij revolucioni një vend të rëndësishëm zë zhvillimi i arësimit popullor.

Detyrat që i shtroi arësimit popullor Kongresi II i Partisë, në përgjithësi, janë realizuar me sukses. Gjatë periudhës që po shqyrtojmë, analfabetizmi deri në moshën 40 vjeç mori fund. Kjo është një fitore e madhe e Partisë sonë dhe e pushtetit popullor.

Gjatë planit të parë pesëvjeçar është zgjeruar në mënyrë të kënaqshme rrjeti i institucioneve shkollore. Në vitin 1955 në të gjitha kategoritë e shkollave tona mësonin mbi 189 000 nxënës e studentë ose 9 për qind më shumë se në vitin 1950 dhe 3,3 herë në krahasim me vitin 1938.

Në bazë të direktivave të Kongresit II të Partisë dhe të vendimeve të veçanta që ka marrë Komiteti Qendror i Partisë për arësimin, shkolla jonë e re ka pasur mjaft përmirësime edhe përsa i përket përmbajtjes së punës së saj. Është luftuar në shkollë kundër mbeturinave të dëmshme të influencës së vjetër, është

përmirësuar procesi mësimor-edukativ, është forcuar puna nga ana ideologjike, shkollat janë pajisur me një numër më të madh tekstesh të bazuara në metodologjinë marksiste-leniniste dhe është përmirësuar e forcuar baza materiale.

Plani i dytë pesëvjeçar parashikon një zgjerim më të madh të rrjetit të shkollave dhe forcimin e përmirësimit të bazës materiale të tyre.

Në vitin 1960, në shkollat fillore, 7-vjeçare e të mesme do të mësojnë jo më pak se 249 000 nxënës ose 59 000 nxënës më shumë se në vitin 1955. Gjithashtu numri i studentëve në institutet e larta, brenda dhe jashtë shtetit në vitin 1960 do të arrijë në rreth 3 000 vetë ose 31 për qind më shumë se në vitin 1955.

Por në shkollën tonë ka të meta serioze, të cilat duhet të zhduken. Lidhja e teorisë me praktikën, e shkollës me jetën, është krejt e pamjaftueshme dhe njohuritë e nxënësve kanë mjaft karakter abstrakt e të përciptë.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës duhet të marrë masa serioze për të përmirësuar përmbajtjen e punës mësimore-edukative në shkollë. Shkolla jonë e arësimit të përgjithshëm, ku kalojnë çdo vit mijëra të rinj, duhet t'i edukojë nxënësit me dashurinë për punë dhe t'u japë atyre shprehitë e nevojshme për të. Është koha që të fillohet të futen në shkollën tonë gradualisht elementët e arësimit politeknik.

Në radhë të parë duhet të merren masa për të lidhur më mirë teorinë me praktikën, mësimin me jetën. Për këtë është e domosdoshme që të rishikohen programet e shkollave, jo vetëm për t'i lehtësuar ato

nga gjërat e tepërta e të panevojshme, por për të futur gradualisht disa lëndë të reja, të cilat do t'i pajisin me njohuritë e duhura teknike nxënësit tanë dhe do t'u lënë vend më shumë punëve praktike e laboratorike në kabinetet e kopshtet eksperimentale pranë shkollave.

Në mënyrë të veçantë duhet të përmirësohet puna mësimore në shkollat e fshatit, ku nxënësit duhet të fitojnë aftësitë dhe shprehitë praktike për punët bujqësore dhe të pajisen me njohuritë elementare agroteknike.

Plani i dytë pesëvjeçar parashikon që të rritet më shumë numri i nxënësve dhe i studentëve të shkollave profesionale e të instituteve të larta, në mënyrë që deri në vitin 1960 të pregatiten rreth 6 200 teknikë të mesëm me arësim profesional dhe rreth 2 300 specialistë të lartë. Por duhet theksuar se Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe dikasteret, nga të cilat varen shkollat profesionale, duhet të marrin masa serioze për të planifikuar më drejt llojet e specialiteteve dhe profilet e këtyre shkollave në bazë të nevojave reale të vendit tonë, sepse planifikimi i përgatitjes së teknikëve të mesëm e të lartë deri sot ka mjaft të meta dhe është bërë shpeshherë pa studjuar mirë perspektivat e zhvillimit të degëve të ndryshme të ekonomisë sonë. Gjithashtu duhet të përmirësohet cilësia e përgatitjes së teknikëve të mesëm e të lartë, për t'iu përgjegjur si duhet kërkesave të teknikës së re që po futet në vendin tonë.

Shkollat profesionale e institutet e larta duhet të forcohen me pedagogë më të kualifikuar dhe laborato-

ret e tyre të pasurohen. T'i kushtohet më shumë kujdes praktikës së prodhimit dhe puna e shkollave profesionale të lidhet më mirë me qendrat e punës, fabrikat, uzinat, SMT-të, ndërmmarrjet e kooperativat bujqësore, në mënyrë që teknikët e ardhshëm, të mesëm e të lartë, krahas mësimit në klasë, të njohin më mirë edhe procesin e punës e të prodhimit të sektorëve për të cilët përgatiten nga ana praktike.

Kujdes i veçantë duhet treguar sidomos për shkollat bujqësore. Programet e tyre duhet të spastrohen nga gjërat që nuk lidhen me kushtet e vendit tonë, nga çdo gjë e marrur shablon. Këto shkolla duhet të sigurohen me ekonomi të mjaftueshme për punën praktike bujqësore.

Vendi ynë po ecën me hapa të shpejtë drejt kolektivizimit. Prandaj Ministrisë së Bujqësisë dhe organeve të arësimit u dalin detyra të rëndësishme për të përgatitur kuadrin e nevojshëm teknik që do të udhëheqë punën në kooperativat tona të reja. Duhet të merren masa që rrjeti i shkollave të ndryshme bujqësore të përballojë me sukses përgatitjen e të gjithë teknikëve e të specialistëve të ndryshëm të bujqësisë.

Problemi më i rëndësishëm për zgjerimin dhe përmirësimin e punës së arësimit popullor është përgatitja e kuadrit. Sot kemi rreth 7 300 arësimitarë në të gjitha kategoritë e shkollave. Gjatë pesëvjeçarit të parë janë përgatitur në institutet e shkollat pedagogjike mbi 2 000 kuadro, 2 200 të tjerë kanë kaluar në kurse kualifikimi dhe rreth 1 400 vazhdojnë mësimet me korrespondencë. Por, megjithkëtë, niveli kultural e profesional i kuadrove të arësimit është akoma i ulët.

Detyrë e dorës së parë për Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës është të marrë masa që me anë të shkollave dhe të instituteve pedagogjike, me anë të kurseve të kualifikimit e të arësimit me korrespondencë, të sigurojë që në fund të pesëvjeçarit të dytë të ngrihen në mënyrë të konsiderueshme niveli kultural i mësuesve dhe aftësitë e tyre profesionale për të vënë në jetë orientimin e Partisë, për futjen gradualisht të arësimit politeknik në shkollat tona.

Rëndësi e madhe duhet t'i jepet arësimit për të rriturit. Pas realizimit me sukses të detyrës kryesore të luftës kundër analfabetizmit që caktonte Kongresi II i Partisë, gjatë këtij pesëvjeçari duhet të merren masa për të vazhduar më tej luftën kundër analfabetizmit për moshat mbi 40 vjeç dhe sidomos për të organizuar e për të tërhequr në kurse e shkolla nate ata që kanë dalë nga kurset kundër analfabetizmit.

Arësimi i natës e me korrespondencë duhet të zgjerohet, pa u shkëputur nga prodhimi. Sot në këtë sistem mësojnë mbi 19 000 vetë. Por rrjeti i arësimit që po shtohet në vendin tonë lehtëson në një masë më të madhe tërheqjen e punëtorëve, të nëpunësve e të fshatarësisë punonjëse në shkollat e natës e me korrespondencë. Prandaj zgjerimi i arësimit të natës e me korrespondencë, pa u shkëputur nga prodhimi, duhet të konsiderohet edhe si një mjet i fuqishëm për të ngritur nivelin kultural e aftësitë profesionale të punonjësve tanë.

Një çështje me shumë rëndësi për gjithë shoqërinë tonë është edukimi i drejtë i fëmijëve të moshës parashkollore. Organet e pushtetit duhet të marrin masa

që në të ardhshmen të zgjerohet sa më shumë rrjeti i çerdheve dhe i kopshteve për fëmijë dhe të përmirësohet puna edukuese në to. Bashkë me organet e pushetit, për këtë qëllim, duhet të punojnë edhe kooperativat bujqësore. Gjatë planit të dytë pesëvjeçar çerdhet dhe kopshtet do të shtohen 183 për qind në krahasim me vitin 1955. Në këtë mënyrë jo vetëm do të sigurohet edukimi më i mirë i fëmijëve, por edhe do të krijohen mundësitë për gratë e vendit tonë që të hidhen në prodhim.

Gjatë planit të dytë pesëvjeçar do të zgjerohet rrjeti i konvikteve. Kjo ka rëndësi të madhe për prepatitjen e kuadrit për fshatin dhe për edukimin e brezit të ri. Zgjerimi i rrjetit të konvikteve do të krijojë mundësi që të ndjekin rregullisht shkollat 7-vjeçare dhe të mesme edhe ata fëmijë, familjet e të cilëve banojnë në zona ku nuk është shtrirë akoma rrjeti i këtyre kategorive shkollash. Të realizohet arësimi i përgjithshëm 7-vjeçar në fund të pesëvjeçarit të tretë (1965), duke përfshirë 80 për qind të fëmijëve që mbarojnë shkollën fillore. Për këtë qëllim gjatë pesëvjeçarit të tretë do të hapen 200 shkolla të tjera 7-vjeçare dhe 35 shkolla konvikte, gjë që do të thotë të shtrihemi deri në fshatrat e zonave më të thella ku të sigurojmë të paktën 15 nxënës për klasën e pestë. Për këto shkolla do të duhet të prepatiten rreth 1 000 kuadro të rinj. Prandaj vitin e ardhshëm shkollor të hapet edhe një institut tjetër i lartë pedagogjik në Shkodër. Për të gjitha këto organet e arësimit duhet të marrin masa për zgjerimin e rrjetit të konvikteve, duke organizuar njëkohësisht zhvillimin më të mirë të punës edukuese

në to. Fëmijët që mbahen në konviktet tona, me bur-sën e shtetit ose me pagesë, duhet të jenë shembull si në mësim, ashtu edhe me sjelljet e tyre në shoqëri.

Si rezultat i zbatimit të detyrave që ngarkoi Kongresi II i Partisë janë shënuar suksese të rëndësishme edhe në zhvillimin e kulturës dhe të artit në vendin tonë. Është rritur rritja e qendrave kulturele në qytet e në fshat. Një hov të madh ka marrë lëvizja artistike diletante në masat punonjëse. Janë shtuar botimet e ndryshme me karakter artistik, shkencor, teorik dhe politik.

Duke punuar për detyrat që shtron plani i dytë pesëvjeçar, i cili parashikon një zhvillim shumë të madh të aktivitetit kultural, rritjen e qendrave kulturele si kinematë, teatrot, shtëpitë e kulturës etj., punonjësit e kulturës dhe të artit duhet ta përmirësojnë akoma më shumë punën kulturele me masat. Ata, në radhë të parë, duhet ta forcojnë aktivitetin kulturalo-artistik në drejtim të fshatit, sidomos tani që Partia shtron atje detyra shumë të rëndësishme në lidhje me kolektivizimin dhe përparimin e bujqësisë sonë. Qendrat tona kulturele duhet ta zhvillojnë edhe më mirë propagandën e prodhimit, punën për përhapjen e metodave të përparuara si në sektorin e industrisë, ashtu edhe në atë të bujqësisë.

Aktiviteti kultural me masat duhet të synojë në propagandimin e ideve të Partisë sonë, në krijimin e botëkuptimit materialist. Në këtë drejtim i duhet kështu kujdes luftës kundër paragjykimeve dhe besimeve të kota, duke përhapur njohuritë shkencore në masat punonjëse.

Partia i ka kushtuar kujdes zhvillimit të sportit dhe të fiskulturës. Gjatë periudhës që nga Kongresi II është shtuar baza materiale e nevojshme për zhvillimin e fiskulturës dhe lëvizja sportive është zgjeruar.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë parashikohet shtimi më i madh i fondeve për fiskulturën. Lëvizja fiskulturale duhet të zgjerohet edhe më shumë, të përfshijë në radhët e saja masat e gjera të rinisë sonë, me qëllim që ta bëjë atë të gatshme për punë dhe mbrojtje.

Kongresi II i Partisë i vinte Institutit të Shkencave si detyrë kryesore që të lidhte sa më ngushtë punën e tij me praktikën e ndërtimit socialist. Për të realizuar këtë detyrë të madhe Komiteti Qendror i Partisë ka marrë vendime të rëndësishme, të cilat kanë bërë që të zgjerohet aktiviteti i Institutit të Shkencave. Gjatë kësaj periudhe janë ngritur tre institute të reja shkencore: ai i bujqësisë, i zooteknisë dhe i historisë e i gjuhësisë dhe janë marrë masa të rëndësishme për t'u krijuar kushte më të mira punonjësve të shkencës për punën e tyre krijuese.

Në fushën e bujqësisë punonjësit e Institutit të Shkencave kanë bërë disa studime për probleme të agroteknikës, të rajonizimit të misrit, të bimëve industriale, si edhe disa studime për përmirësimin e racës së gjësë së gjallë.

Në fushën e shkencave shoqërore janë arritur disa rezultate të rëndësishme në studimin e gjuhës sonë, të folklorit, në zbulimet arkeologjike dhe po punohet për hartimin e historisë së Shqipërisë, historisë së letërsisë shqipe dhe për përpunimin e ortografisë së re të gjuhës shqipe.

Por puna e Institutit të Shkencave është akoma prapa kërkesave të mëdha që ka ekonomia jonë. Me ngadalë tërhiqen në punën shkencore njerëzit që kanë aftësi e perspektivë dhe i dobët është bashkëpunimi me dikasteret dhe institutet tona të larta.

Vështirësia kryesore në zhvillimin e punës shkencore në vendin tonë qëndron në faktin se kuadrot që merren me punë shkencore janë të rinj, sapo kanë filluar të merren me këtë punë, atyre u mungon eksperiencia e duhur. Prandaj ata duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për t'u farkëtuar si punonjës të vërtetë të shkencave, të studjojnë me këmbëngulje rezultatet e shkencës së përparuar botërore e sidomos të asaj sovjetike, t'i japin rëndësi të madhe kalitjes së tyre ideologjike, përvetësimit të botëkuptimit materialist-marksist, të ndjekin e të studjojnë në mënyrë të thellë e pa u lodhur eksperiencën e prodhimit, faktet e dokumentat, për të arritur në përgjithësi e konkluzione të drejta shkencore.

Organet e Partisë dhe të pushtetit duhet të kujdesen më shumë për përgatitjen shkencore dhe ideologjike të punonjësve shkencorë, sepse ky është kushti kryesor për të siguruar zhvillimin e punës shkencore në vendin tonë si sasi dhe për ta ngritur në nivelin e duhur cilësinë e saj.

Organet shtetërore dhe në mënyrë të veçantë dikasteret e interesuara duhet ta ndihmojnë më shumë Institutin e Shkencave për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë e të kulturës në vendin tonë. Më shumë kuadro dhe më shumë mundësi materiale duhet t'i jepen Institutit të Shkencave për të përballuar më

mirë kërkimet shkencore, për të zgjidhur më mirë problemet e rëndësishme dhe të ngutshme të ekonomisë e të kulturës sonë socialiste që shtron plani i dytë pesëvjeçar.

Në fushën e shkencave bujqësore e biologjike duhet të zgjerohen kërkimet shkencore në të gjitha drejtimet. T'u jepet një rëndësi e veçantë problemeve të rritjes së rendimenteve në bujqësi, problemeve të drithërave të bukës, të bimëve industriale, të misrit në mënyrë të veçantë, të rajonizimit, problemeve të ekonomisë bujqësore etj.

Gjithashtu është e nevojshme që Instituti i Zooteknisë të zgjerojë studimet e tij, duke i dhënë rëndësi të dorës së parë studimit të problemeve të përmirësimit e të ngritjes së prodhimit të blegtorisë, të përmirësimit të bazës ushqimore etj.

Tematika e studimeve të pesëvjeçarit të dytë në fushën e shkencave teknike të jetë e lidhur me probleme të rëndësishme të industrisë e të minierave tona, zgjidhja me sukses e të cilave do t'i sjellë vendit përfitime të mëdha ekonomike.

Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, të punojë për hartimin e tekstit të historisë së Shqipërisë, të historisë së shtetit dhe të së drejtës dhe të historisë së letërsisë shqipe, botimi i të cilave do të jetë një ngjarje e rëndësishme në jetën ideologjike të vendit tonë. Përveç kësaj të bëhen studime për përgatitjen e tekstit të gramatikës së gjuhës shqipe, e cila do të jetë një kontribut i vlefshëm për përpunimin e gjuhës letrare kombëtare, si edhe punime përgatitore për hartimin e fjalorit normativ të gjuhës shqipe.

Një rëndësi e veçantë t'u jepet gërmimeve arkeologjike të cilat do të nxjerrin në dritë pasuritë e mëdha kulturale të popullit tonë.

Një detyrë e rëndësishme e Institutit të Historisë e të Gjuhësisë në këtë pesëvjeçar do të jetë zgjerimi i punës për mbledhjen dhe studimin e krijimtarisë së pasur popullore në fushën e folklorit e të etnografisë dhe ruajtja e studimi i monumenteve të kulturës. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për kualifikimin e kuadrove shkencorë dhe ngritjen e tyre ideo-politike.

D. — DEMOKRATIZIMI DHE FORCIMI I MËTEJSHËM I PUSHTETIT POPULLOR

Gjatë periudhës në mes të dy kongreseve janë bërë përparime në forcimin e pushtetit popullor.

Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria kanë marrë masa të rëndësishme për ta afruar sa më shumë pushtetin me masat, për ta ngritur rolin e tij drejtues e organizues.

Por, megjithkëtë, duhet të kemi parasysh se detyrat për forcimin e pushtetit tonë popullor janë akoma shumë të mëdha, në to ka akoma shumë të meta dhe gabime që duhet të ndreqen.

Në përgjithësi aktiviteti i këshillave popullore, qofshin këto të qarqeve ose të rretheve dhe aq më tepër i atyre të fshatrave, është akoma i kufizuar. Ato mblidhen herë pas here vetëm për të dëgjuar raporte të përgjithshme dhe nuk u shtrohen problemeve konkrete të ndërtimit ekonomik e kultural të vendit. Këshillat e fshatra-

ve nuk mblidhen aspak në rregull dhe puna është përqëndruar vetëm në duart e kryetarit. Po kështu mund të thuhet edhe për format e tjera të punës, nëpërmjet të cilave duhet të aktivizohen e të japin ndihmën e tyre anëtarët e këshillave popullore dhe masat e gjera të punonjësve, siç janë komisionet pranë këshillave popullore, aktivet e gjera të punonjësve etj.

Natyrisht, këto nuk mund t'i quajmë thellësisht të meta organizative. Mosfunksionimi dhe mosaktivizimi i anëtarëve të këshillit janë në radhë të parë shkelje të parimit themelor mbi të cilin ndërtohet pushteti ynë popullor. Është e qartë se një këshill popullor formal, që mblidhet herë pas here për të dëgjuar ndonjë raport të përgjithshëm, nuk mund të ushtrojë funksionet e tij të rëndësishme të udhëheqjes mbi organet ekzekutive. Që këtej rrjedh pastaj që komitetet ekzekutive fillojnë ta ndjejnë veten të shkëputur nga këshilli që i ka zgjedhur, të mbeten jashtë kontrollit të tij, të mos e quajnë veten të detyruar t'u japin llogari zgjedhësve kështu që zhduket gradualisht kontrolli i masës mbi pushtetin e tyre. Kjo është shumë e rrezikshme dhe e dëmton rëndë pushtetin tonë popullor, pengon forcimin e tij, pengon demokratizimin e tij.

Detyra e deputetit dhe e këshilltarit për të marrë pjesë aktive në zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe konkrete të ndërtimit ekonomik e kultural të vendit dhe dhënia llogari para zgjedhësve, është një nga parimet kryesore të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës sonë, që ka të bëjë me karakterin demokratik e popullor të pushtetit tonë.

Por disa deputetë shpesh nuk e ndjejnë veten të de-

tyruar të vënë në jetë këtë detyrë të madhe e themelore. Më keq ndodh me anëtarët e këshillave popullore.

Nuk duhet të lejohet një gjendje e tillë si në ish-qarkun e Tiranës, ku vitin e kaluar, nga 75 anëtarë të këshillit popullor të qarkut vetëm 20 prej tyre kishin marrë takim me zgjedhësit, ose si në rrethin e Kukësit, ku komiteti ekzekutiv, për dy vjet rresht, as që u bë merak t'u përgjigjej kërkesave të anëtarëve të këshillit.

Pjesëmarrja e masave në zgjedhje është me rëndësi shumë të madhe dhe parimore, është në themelin e ndërtimit të një pushteti demokratik e popullor si yni, por kjo është vetëm një anë e karakterit popullor të pushtetit tonë. Ana tjetër, po kaq parimore dhe e rëndësishme, është tërheqja e masës në punët e pushtetit, aktivizimi i përfaqësuesve të popullit në qeverisjen e vendit, kontrolli i masës mbi deputetët e mbi organet e zgjedhura të pushtetit.

Prandaj është e domosdoshme që Partia t'u kushtojë një kujdes të veçantë këtyre problemeve, që kanë një rëndësi shumë të madhe për forcimin dhe demokratizimin e mëtejshëm të pushtetit popullor dhe të shikojë në funksionimin e gjallë të këshillave popullore, në aktivizimin e deputetëve, në gjallërimin e formave të ndryshme, mjetet më të fuqishme dhe të vetme për të rritur pjesëmarrjen dhe veprimtarinë e masave të gjera të popullit në zgjidhjen e detyrave shumë të mëdha të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Një kujdes shumë i madh duhet t'i kushtohet forcimit të aparatit shtetëror, duke ngritur rolin organizues e drejtues të tij. Komiteti Qendror i Partisë ka marrë

masa të rëndësishme për të përmirësuar strukturën e aparatit shtetëror, për ta afruar atë sa më shumë me bazën, për ta bërë më operativ dhe sa më pak të kush-tueshëm.

Për këtë arsye u bë ndarja e re administrative, duke ia përshtatur atë sa më mirë nevojave dhe detyrave të sotme të pushtetit lokal, u shkrinë ose u hoqën hallkat e tepërta në institucionet dhe në organet e ndryshme shtetërore, të cilat ishin bërë pengesë për një punë më operative e më të lidhur me nevojat e prodhimit, u shkurtuan mbi 3 000 vetë në organikat e aparatit shtetëror qendror dhe në atë lokal, duke hequr të gjithë njerëzit e tepërt që frynin aparatet tona dhe ngrinin pa arsye shpenzimet administrative, u shtuan kompetencat e aparatit lokal dhe u hoq centralizimi i tepruar në planifikimin e bujqësisë.

Si rezultat i të gjitha këtyre masave është përmirësuar puna dhe metoda e drejtimit në aparatin tonë shtetëror. Por do të ishte gabim i madh të kënaqeshim me marrjen e këtyre masave sepse këto do të mbeten në letër, në rast se Partia nuk do të jetë vigjilente për të zbuluar të metat e mëdha që kemi akoma në punën e aparatit tonë shtetëror dhe në rast se ajo nuk do të vazhdojë edhe në të ardhshmen të luftojë me këmbëngulje për forcimin e vazhdueshëm e në mënyrë sistematike të tij, për perfeksionimin e strukturës e të punës së tij.

Aparati ynë shtetëror do të jetë i aftë të çojë në masat punonjëse vijën e Partisë e të luftojë për ta vënë atë drejt në jetë, në rast se do të forcojë lidhjet e tija me masat.

«...ne kemi një «mjet të mrekullueshëm» — thoshte Lenini — për ta dhjetëfishuar menjëherë, me një të lëvizur të dorës, aparatit tonë shtetëror, mjet të cilin nuk e ka pasur kurrë dhe nuk mund ta ketë asnjë shtet kapitalist. Ky mjet i mrekullueshëm është tërheqja e punonjësve, tërheqja e të varfërve në punën e përditshme të qeverisjes së shtetit»¹.

Ky mësim i madh i Leninit, që e bazon forcën e aparatit shtetëror popullor në lidhjen e tij të ngushtë me masat e gjera të punonjësve, përbën parimin nga i cili duhet të niset Partia në përpjekjet për të forcuar e për të përmirësuar punën e aparatit shtetëror.

Por pikërisht këtu, në mungesën e një lidhjeje të fortë me masat, qëndrojnë dobësitë kryesore të aparatit tonë shtetëror.

Mjafton të përmendim se kemi mbi 18 000 anëtarë të këshillave popullore, mjafton të kemi parasysh ndihmën e madhe që kanë dhënë konsultat e aktivet e organizuara nga Komiteti Qendror i Partisë për disa probleme të rëndësishme, si për shembull, për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, konferencat me punonjësit e bujqësisë, të SMT-ve, të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore ose propozimet e vlefshme të kolektivave të ndryshme punonjëse. kur u janë shtruar atyre detyra konkrete për të shtuar prodhimin, për të ulur koston etj., për të kuptuar sa forca kolosale ruajnë në gjirin e tyre masat tona punonjëse dhe sa shumë mund të ndih-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 26, f. 109.

mojnë ato për realizimin e tejkalimin e planeve të shtetit, për zhvillimin më të madh të vendit tonë në rrugën e ndërtimit të socializmit. Por këto aktive dhe konsulta janë shumë të pakta dhe komitetet ekzekutive janë shumë prapa në tërheqjen e masave punonjëse për zgjidhjen e detyrave konkrete të ndërtimit ekonomik e kultural.

Moskuptimi i drejtë e sa duhet i parimit të madh leninist të lidhjes së ngushtë të aparatit shtetëror me masat, të shpie patjetër në shtimin e burokratizmit, në rritjen e fryrjen e aparatit administrativ.

Partia duhet të ketë parasysh se me kaq nuk ka mbaruar detyra e thjeshtimit dhe e përmirësimit të aparatit tonë.

Përmirësimi i punës së aparatit shtetëror kërkon që të luftohet më me ashpërsi kundër burokratizmit dhe të rritet operativiteti i organeve shtetërore. Lufta kundër burokratizmit nuk është akoma në lartësinë e duhur. Në aparatet tona shtetërore, qendrore e lokale, ka shumë shkresa e qarkore. Ka shumë drejtues që merren më tepër me shkresa, se sa me organizimin e punës, me udhëheqjen operative të çështjeve dhe me organizimin e masave punonjëse për të zbatuar detyrat e mëdha që u janë ngarkuar. Kështu, ndërsa shkresat vazhdojnë, çështjet zvarriten. Zvarritje të mëdha ka në zgjidhjen e kërkesave të popullit.

Një pikë akoma shumë e dobët është kontrolli i zbatimit të vendimeve. Kontrollat janë të shumta. Shumë njerëz lëvizin lart e poshtë dhe shteti harxhon shuma të konsiderueshme për këto lëvizje. Por punët e kontrollit të zbatimit të vendimeve nuk shkojnë mirë. Arësyeja kryesore është se kontrolli u është lënë krye-

sisht nëpunësve të shkallës më të ulët, kurse përgjegjësit kryesorë nuk merren me kontrollin e zbatimit të vendimeve, ata merren pak me rezultatet e kontroleve. Këtu e ka burimin edhe cilësia e dobët e kontrollit. Kjo situatë duhet të ndreqet.

Ne duhet të kemi parasysh se organizimi i mirë i kontrollit të zbatimit të vendimeve është mjeti më i fuqishëm për të ndihmuar në ndreqjen e të metave dhe në realizimin e detyrave. Forcimi i kontrollit të zbatimit të vendimeve kërkon që t'i jepet rëndësi e madhe edhe kontrollit nga poshtë.

Prandaj organizatat e Partisë duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë që të zhvillojnë kritikën e masave, kritikë që do t'i shërbejë forcimit të mëtejshëm të pushtetit popullor.

Një parim tjetër i rëndësishëm leninist, që duhet të ketë Partia parasysh, është lufta për forcimin e udhëheqjes kolegjiale në organet e zgjedhura të pushtetit. Në ministritë dhe në ndërmarrjet duhet të funksionojnë në rregull kolegjiemet.

Njëkohësisht duhet forcuar më shumë përgjegjësia personale, në mënyrë që çdo drejtues, çdo punonjës i aparatit tonë shtetëror ta ndjejë veten plotësisht përgjegjës për detyrat që i janë ngarkuar. Ky është një kusht i domosdoshëm për të forcuar disiplinën shtetërore dhe për të siguruar zbatimin e mirë të detyrave.

Kuadrot që punojnë në aparatën shtetëror luajnë rol vendimtar në çuarjen e punëve përpara.

Shumë kuadro studjojnë dhe përpigën ta ngrenë nivelin e tyre kultural e profesional, por ka edhe shumë të tjerë, që nuk tregojnë kujdes për ngritjen e tyre.

Organet qendrore shtetërore duhet ta organizojnë më mirë punën e tyre në këtë drejtim, të organizojnë kurse të veçanta për ngritjen e kuadrove të pushtetit lokal, sidomos për ato të rretheve e të lokaliteteve; ato duhet t'i organizojnë më mirë seminarët me punonjësit e aparatit të komiteteve ekzekutive.

Detyra e Partisë është të sigurojë zbatimin e të gjitha masave për edukimin e kuadrove të pushtetit, në mënyrë që ato të rriten, të perfeksionohen e të zotërojnë eksperiencën e drejtimit.

Forcimi i shtetit tonë është i lidhur ngushtë me forcimin e ligjshmërisë socialiste. Ligjshmëria jonë ndihmon për forcimin e bazës socialiste dhe për zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore socialiste. Ajo mbron dhe zhvillon rendin politik e shoqëror, mbron interesat e të gjithë punonjësve.

Eksperienca e Partisë sonë ka treguar se armiqtë janë orvatur të shfrytëzojnë çdo dobësim të ligjshmërisë sonë. Masat e marrura nga Partia e kanë forcuar më tepër ligjshmërinë tonë socialiste, kanë forcuar udhëheqjen dhe kontrollin e saj. Por ka akoma dobësi në fushën e ligjshmërisë.

Nga ana e komiteteve ekzekutive të rretheve dhe sidomos nga organet lokale më të ulëta ka raste të shumta të shkeljes së ligjeve, të veprimeve arbitrare dhe të shkeljes të së drejtës së qytetarëve.

Organet e drejtësisë, të hetuesisë etj., të cilat janë ngarkuar me mbrojtjen e ligjshmërisë socialiste, në punën e tyre praktike shpesh nuk tregohen në lartësinë e duhur dhe lejojnë shkelje të ligjeve.

Mosrespektimi dhe moszbatimi i ligjeve dhe i ven-

dimeve të Partisë janë shkaku kryesor i çrregullimeve, i mungesës së administrimit të mirë të pasurisë socialiste, i vjedhjeve, i dëmtimeve etj.

Të gjitha këto tregojnë se punohet akoma pak për t'i bërë të njohura ligjet, punohet pak për të edukuar kuadrot dhe punonjësit me frymën e ligjshmërisë sonë socialiste, me frymën e respektimit të rreptë të ligjeve, të vendimeve të Partisë e të qeverisë.

Organet qendrore të drejtësisë akoma nuk e kanë ngritur në nivelin e duhur ndihmën e kontrollin për forcimin e ligjshmërisë socialiste. Gjithashtu ato kanë bërë pak për të forcuar luftën preventive kundër krimeve. Puna e tyre për edukimin e ngritjen e kuadrove të tyre është e dobët. Të gjitha këto janë çështje shumë të rëndësishme, që luajnë një rol vendimtar për përmirësimin e punës së organeve tona të drejtësisë dhe për forcimin e ligjshmërisë sonë socialiste. Prandaj organet e drejtësisë duhet të marrin masa serioze për ndreqjen e këtyre të metave, sepse pa një kontroll të organizuar mirë, pa përmirësuar ndihmën, pa një punë sistematike e të kualifikuar për ngritjen e kuadrit, nuk mund të mbrohet e të forcohet ligjshmëria jonë. Njëkohësisht është e domosdoshme që Partia t'i vërë një rëndësi të madhe forcimit të ligjshmërisë socialiste. Duhet të forcohet kontrolli i Partisë mbi të gjitha organet, që u është ngarkuar ruajtja e kësaj ligjshmërie. Duhet t'i kushtohet rëndësi e madhe zgjedhjes së kuadrit, forcimit të organeve të drejtësisë me kuadër të aftë, të ngritur politikisht, të pastër, të ndershëm e të ndërgjegjshëm. Organizatat e Partisë duhet të demaskojnë dhe të luftojnë pa mëshirë çdo shkelje e çdo shkelës të ligjeve

tona, të luftojnë me ashpërsinë e vendosmërinë më të madhe shkeljen e të drejtave të qytetarëve dhe veprimet arbitrare, sepse vetëm në këtë mënyrë do të forcohet drejtësia jonë dhe pushteti ynë popullor.

Shokë,

Gjendja e brendshme e vendit tonë është forcuar shumë dhe do të forcohet çdo ditë e më tepër. Kjo fitore e madhe i detyrohet Partisë së Punës të Shqipërisë, besnike e marksizëm-leninizmit, e cila me politikën e saj të urtë dhe largpamëse siguroi për popullin tonë heroik, punëtor dhe paqedashës të gjitha këto suksese politike, ekonomike, kulturale dhe shoqërore.

Populli dhe Partia jonë gjatë këtyre viteve të pasçlirimit, vite plot luftë dhe fitore, kanë krijuar baza të shëndosha për të hedhur hapa të rëndësishëm përpara. Sigurisht, as populli ynë as Partia e tij nuk dehen dhe nuk do të dehen nga sukseset. Ato e dinë se çdo gjë fitohet me luftë, me përpjekje, me heroizma.

Për ta forcuar më tepër Republikën Popullore të Shqipërisë, ekonominë e saj, aftësinë mbrojtëse të saj, Partisë dhe popullit u vihen detyra të mëdha përpara për realizimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar:

1. — Të shfrytëzohen në maksimum kapacitetet prodhuese të industrisë sonë dhe të zgjerohen akoma më shumë prodhimet industriale, të prodhohet sa më shumë, sa më mirë dhe sa më lirë për popullin. Të shfrytëzohen në maksimum mundësitë e brendshme, të kursethet leku i popullit, të ruhet pasuria socialiste e popullit.

2. — Të organizohet kudo puna në mënyrë të përsosur, të forcohet disiplina e planit, të rritet vazhdimisht rendimenti në punë, faktor i rëndësishëm për suksese të mëdha në ngritjen dhe zhvillimin e ekonomisë, në përmirësimin e jetës së popullit.

3. — T'i vihet rëndësi e madhe zhvillimit më të shpejtë të bujqësisë, të plotësohen detyrat e bujqësisë në lidhje me kolektivizimin, të rriten prodhimet bujqësore dhe blegtorale. T'i vihet rëndësi e madhe prodhimit të drithërave, veçanërisht kulturës së misrit, për ta prodhuar bukën në vend. Të luftohet me këmbëngulje për hapjen e tokave të reja dhe për rritjen e rendimenteve në të gjitha kulturat, si në drithëra ashtu edhe në ato të bimëve industriale. T'i vihet rëndësi e madhe zhvillimit të blegtorisë për të siguruar prodhime të bollshme blegtorale për popullin. Për këtë të tregohet kujdes i posaçëm për sigurimin e bazës ushqimore të bagëtisë.

4. — Në çdo gjë duhet të udhëhiqemi nga qëllimi kryesor dhe i vetëm: të shtohet mirëqenia e popullit, të ngrihet standardi i jetesës së punonjësve. E gjithë lufta e Partisë, e klasës punëtore, e rinisë dhe e të gjithë punonjësve duhet të udhëhiqet nga ky qëllim i shenjtë.

5. — Të luftohet çdo ditë për forcimin dhe modernizimin e pushtetit popullor dhe ky të bëhet i aftë dhe i dashur për popullin, të forcohet ligjshmëria socialiste, të luftohen pa mëshirë armiqtë, shkelësit e ligjeve dhe të të drejtave të qytetarëve. Të luftohet burokratizmi dhe të punohet vazhdimisht për thjeshtimin e aparateve shtetërore nga parazitët, nga shpenzimet e panevojshme. Aparati shtetëror të jetë sa më i thjeshtë, shumë pak i kushtueshëm dhe tepër operativ. Funksio-

narët e shtetit të jenë shembull disipline, ndershmërie, drejtësie.

6. — Të forcohet çdo ditë e më shumë aleanca midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, baza e pushtetit popullor. Të forcohet uniteti politik, ideologjik dhe organizativ i popullit tonë. Të frymëzohen dhe të edukohen si kurdoherë masat punonjëse të vendit me frymën e patriotizmit më të lartë, të edukohen klasa punëtore, rinia, intelektualët me traditat heroike të popullit dhe të Partisë sonë, me traditat e heroizmit, të bujarisë, të drejtësisë, që kanë karakterizuar kurdoherë popullin tonë të lavdishëm, të edukohen ata me frymën e internacionalizmit proletar. Populli shqiptar, më shumë se kurdoherë tjetër, të çelnikosë radhët e tija rreth Partisë së tij të dashur, që e çliroi nga skllavëria e rëndë shekullore, që po e çon në fitoren e socializmit, nën flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit.

III

PARTIA

Shokë,

Të gjitha fitoret që ka korrur populli shqiptar që nga Lufta nacional-çlirimtare dhe deri sot u arritën në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë. Partia e mobilizoi dhe e udhëhoqi popullin në fitoren e çlirimit të vendit, ajo e mobilizon dhe e udhëheq popullin tonë në veprën e madhe historike të ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Partia e Punës e Shqipërisë është forca drejtuese, frymëzuese dhe organizuese e jetës së vendit tonë. Për Partinë nuk ka interesa më të lartë se interesat e klasës punëtore, interesat e të gjithë punonjësve të vendit.

Forcimi i unitetit ideologjik, politik dhe organizativ që përbëjnë forcën e pathyeshme të Partisë ka qenë dhe mbetet kushti kryesor për zbatimin me sukses të rolit udhëheqës dhe drejtues nga ana e Partisë sonë. Partia jonë është mbështetur dhe do të mbështetet në parimet marksiste-leniniste dhe që nga dita e themelimit të saj ajo ka luftuar kundër çdo shfaqjeje dhe orvatjeje për të shtrembëruar vijën e saj marksiste-leniniste, për të

prishur ose për të dobësuar unitetin e Partisë. Ajo ka luftuar kundër të gjithë armiqve të marksizëm-leninizimit, nën çdo maskë që janë paraqitur ata. Partia jonë, kurdoherë, ka konsideruar se politika parimore është e vetmja politikë e drejtë dhe, duke luftuar, ajo ka ruajtur pastërtinë e radhëve të saja, ka ruajtur të paprekur unitetin e saj.

Partia jonë vjen sot, në Kongresin III më e fortë, kompakte, monolite dhe e grumbulluar si një trup i vetëm rreth Komitetit Qendror.

Forca e pathyeshme e Partisë sonë qëndron në lidhjet e saja të pazgjidhshme me masat, të cilat, duke parë në Partinë e Punës të Shqipërisë Partinë e tyre, e kanë rrethuar atë me një dashuri të zjarrtë dhe me besim të patundur. Zgjerimi dhe forcimi akoma më i madh i organizatave të masave që udhëhiqen nga Partia, gjatë periudhës që po analizojmë, e shpreh këtë realitet. Partia jonë mban lidhje të ngushta dhe drejton në mënyrë të organizuar pothuajse të gjitha masat punonjëse të vendit tonë. Nëpërmjet këtyre organizatave Partia jonë edukon dhe mobilizon masat punonjëse për zbatimin e detyrave, dëgjon nga afër zërin e tyre, kërkesat dhe propozimet e tyre.

Rritja e Partisë nga radhët e klasës punëtore dhe të masave punonjëse është një shprehje tjetër e lidhjeve të ngushta të Partisë me masat. Më 1 prill 1956 Partia jonë kishte 41 372 anëtarë dhe 7 272 kandidatë, domethënë 4 226 komunistë më shumë se në Kongresin II. Njerëzit më të vendosur, luftëtarët më të dalluar në punën për realizimin e detyrave të Partisë kanë mbushur radhët e saja.

Le të shikojmë tani më konkretisht disa nga problemet më të rëndësishme të punës së Partisë.

1. — Forcimi i përbërjes së Partisë

Siç na mëson marksizëm-leninizmi dhe eksperiencia e Partisë sonë, forca e partisë dhe uniteti i çelniktë i radhëve të saja qëndron, para së gjithash, në përbërjen shoqërore të partisë, në cilësinë dhe pastërtinë e radhëve të saja. Është për këtë arsye që forcimi i përbërjes së Partisë sonë ka qenë dhe mbetet një nga problemet kryesore.

Gjatë kësaj kohe, që na ndan nga Kongresi II, organizatat e Partisë kanë zhvilluar një punë më të kujdeshme për të sjellë në radhët e Partisë njerëzit më të mirë, më besnikë e më të vendosur, në radhë të parë nga klasa punëtore, nga radhët e fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore. Si rezultat i kësaj pune janë shënuar disa suksese në përmirësimin e përbërjes së Partisë. Ndërsa në Kongresin II të Partisë ne kishim në Parti me gjendje shoqërore punëtor vetëm 11,5 për qind të efektivit të Partisë, sot punëtorët zënë 17,7 për qind të efektivit të saj, domethënë ka një rritje prej 6,2 për qind. Në pranimet në Parti, që janë bërë gjatë kësaj periudhe punëtorët zënë 23,55 për qind, anëtarët e kooperativave bujqësore 6,18 për qind, anëtarët e kooperativave të artizanatit 2,61 për qind, fshatarët e varfër dhe të mesëm 37,5 për qind, ndërsa nëpunësit e studentët etj., 30,15 për qind.

Nga shifrat e mësipërme del se, me gjithë disa për-

mirësime që kemi pasur në krahasim me të kaluarën, përsëri në punën për rregullimin e përbërjes së Partisë, sidomos përsa i përket shtimit më të shpejtë të radhëve të saja me punëtorë, nuk kemi ecur mirë. Punëtorët e pranuar në Parti jo vetëm që nuk zënë vendin e parë mbi të gjithë të pranuarit, po për më tepër përqindja e tyre, në krahasim me përqindjen e të pranuarve nga shtresat e tjera, veçanërisht nga nëpunësit, është akoma krejt e pakënaqshme.

Në vendin tonë janë krijuar të gjitha mundësitë për të forcuar vazhdimisht përbërjen e Partisë, sepse është ngritur dhe është zmadhuar industria jonë. Shtimi i radhëve të Partisë me elementë nga gjiri i klasës punëtore është një çështje jetike për Partinë. Por vërehet se disa komitete dhe organizata partie nuk e drejtojnë si duhet problemin e përgatitjes së elementëve të klasës punëtore për t'i pranuar në Parti, por u nënshtrohen shpeshherë kërkesave të njerëzve të zyrave dhe gënjen nga frazat dhe nga paraqitjet që e kanë zanat t'i bëjnë më shpejt e më mirë ata. Organizatat e Partisë duhet ta kuptojnë mirë se ka ardhur koha që të rritin në mënyrë më të dukshme përqindjen e punëtorëve mbi efektivin e përgjithshëm të Partisë, të edukojnë në një veprimtari aktive elementët e klasës punëtore. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se këtej e tutje duhet t'u hapim pa asnjë kujdes dyert e Partisë të gjithë punëtorëve që do të dëshironin të hynin në Parti. Pranimi në Parti bëhet gjithnjë në mënyrë individuale dhe pas një verifikimi të kujdesshëm të të gjitha aftësive që ka çdo njeri që dëshiron të hyjë në radhët e Partisë. S'duhet harruar se klasa punëtore nuk rron e veçuar nga klasat dhe

shtresat e tjera të popullit tonë. Ajo plotësohet dhe zgjerohet çdo ditë me elementë të rinj që vijnë nga radhët e fshatarësisë punonjëse ose të shtresave të qytetit, të cilët sjellin me vete mentalitetin mikroborgjez, psikologjinë e pronës private etj. Prandaj nga radhët e klasës punëtore duhet të zgjidhen për në Parti, kryesisht, elementë, të cilët me përpjekje të vazhdueshme, me një punë pak a shumë të gjatë në industri e në miniera, me një punë të organizuar për edukimin e tyre, të kenë forcuar ndërgjegjen e klasës pararojë.

Nuk ka dyshim se duke kërkuar që t'i kushtohet vëmendja kryesore çështjes së pranimit të punëtorëve në Parti, Partia nuk duhet të lërë krejt pasdore pranimin në Parti të punonjësve të shtresave të tjera, sidomos të anëtarëve të kooperativave bujqësore dhe të atyre që vijnë nga shtresat e varfëra, elementë të vendosur dhe të sprovuar, me të kaluar të pastër, të gatshëm për të luftuar me vetëmohim për çështjen e Partisë. Por, duhet pasur parasysh që përqindjen dërmuese mbi numrin e të pranuarve ta zënë punëtorët dhe që organizatat e Partisë, për t'i vënë fre depërtimit të burokratizmit në Parti, të rritin akoma më shumë kërkesat ndaj nëpunësve, fshatarëve të mesëm etj., që kërkojnë të pranohen në Parti.

Një çështje tjetër me rëndësi në punën për forcimin e përbërjes së Partisë është ajo e përmirësimit të punës me kandidatët për anëtarë partie.

Të bazuara në vendimet e Kongresit II të Partisë dhe në vendimet e Plenumit VII të Komitetit Qendror, organizatat e Partisë, gjatë periudhës që analizojmë, kanë zhvilluar një punë më të kujdesshme me kandi-

datët për anëtarë partie. Tanimë është zgjidhur çështja e përpjesëtimit jo të drejtë që ekzistonte midis numrit të anëtarëve dhe numrit të kandidatëve për anëtarë partie. Nga 32,6 për qind të efektivit, që përfaqësonin kandidatët në Kongresin II të PPSH, më 1 prill 1956, ata përfaqësonin gjithsej 14,9 për qind. Krahas me këtë organizatat e Partisë kanë punuar më mirë edhe për pregatitjen dhe edukimin e kandidatëve për anëtarë partie, duke i tërhequr ata gjallërisht në veprimtarinë që zhvillojnë.

Por në punën me kandidatët për anëtarë partie vërtetohen të meta të rëndësishme. Në organizatat tona të Partisë jo vetëm që nuk është çrrënjësuar akoma praktika e zvarritjes për disa vjet me radhë të stazhit të kandidatëve, por ka akoma një numër të konsiderueshëm kandidatësh, të cilët e kanë kryer me kohë ose e kanë kaluar afatin e stazhit të kandidatit dhe çështja e tyre nuk po zgjidhet. Një gjë e tillë tregon në mënyrë të qartë jo vetëm dobësitë në punën me kandidatët nga ana e këtyre organizatave, por edhe dobësi serioze në vetë jetën e brendshme të tyre. Kjo gjendje tregon se këto organizata partie nuk e kanë organizuar punën e tyre në një nivel të tillë që vala e aktivitetit, puna e përditshme, kritika dhe autokritika të nxjerrin në pah anët negative dhe pozitive të kandidatit, ta kalitin atë gjatë afatit të caktuar të stazhit për ta bërë të aftë për anëtar partie. Kjo tregon gjithashtu se mjaft organizata partie nuk e konsiderojnë stazhin e kandidatit si një kohë prove, gjatë së cilës organizata vërteton cilësitë personale të kandidatit dhe e kontrollon atë nëse ai e meriton të pranohet anëtar partie.

Gjendja e organizatës së Partisë të rrethit të Beratit, ku 72,9 për qind e kandidatëve e kanë kaluar afatin e stazhit dhe ku ka akoma 107 kandidatë që nga viti 1948 e 1949, tregon se jo vetëm organizatat bazë e kanë harruar afatin e stazhit të kandidatit, por edhe vetë kandidatët e «kanë harruar» se janë në provë.

Puna për përgatitjen dhe edukimin e kandidatëve për anëtarë partie është e lidhur ngushtë me gjithë punën që zhvillon Partia për edukimin e komunistëve të rinj. Dihet se pranimet në Parti duhet të shoqërohen nga një punë intensive e organizatave të Partisë për edukimin e komunistëve të rinj, për t'i ngritur ata në lartësinë e detyrave të tyre. Por, duhet thënë se shpeshherë kujdesi për komunistët e rinj mbaron menjëherë porsa merr vendim organizata për pranimin e tyre në Parti. Dhe kur veprohet kështu, natyrisht, ndodhin dobësi serioze në vetë jetën e organizatave të Partisë. Vendin e përgatitjes dhe të edukimit të kujdesshëm të komunistëve e zënë masat ndëshkimore dhe ankesat për thyerjen e disiplinës së Partisë, për moszbatimin e detyrave etj.

2. — Zhvillimi i kritikës dhe i autokritikës dhe forcimi i disiplinës së Partisë dhe të shtetit

Që nga Kongresi II i Partisë e këtej janë shënuar suksese edhe në lidhje me zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës në Parti. Duke krijuar kushte më të ngrohta, duke u vënë më shumë kujdes vërejtjeve dhe sugjerimeve të masës së Partisë dhe të masave pa parti, du-

ke forcuar edukimin e komunistëve, janë krijuar mundësitë për të zhvilluar më gjerësisht dhe më drejt kritikën nga poshtë. Kjo ka ndihmuar për të rritur veprimtarinë dhe inisiativën e anëtarëve të Partisë, të vetë organizatave bazë të Partisë dhe njëkohësisht ka rritur kontrollin e masave të Partisë dhe të atyre pa parti mbi organet e zgjedhura. Diskutimi i problemeve të rëndësishme në Parti, në organizatat bazë, në plenumë, në aktive, në konferenca dhe sidomos në mbledhjet për dhënie llogari dhe zgjedhje, kanë qenë tribuna të vërteta për zhvillimin më të gjerë të kritikës dhe të autokritikës. Mjafton të përmendim se në zgjedhjet e vitit të kaluar morën pjesë në diskutime, duke bërë vërejtje për punën e byrove të komiteteve të Partisë dhe përgjithësisht të organeve të zgjedhura, më tepër se 59 për qind të pjesëmarrësve në mbledhje. Në disa qarqe si në Gjirokastrë, ky numër arriti në më tepër se 80 për qind. Këto fakte tregojnë jo vetëm se është rritur guximi i komunistëve për të kritikuar pa drojtje, por edhe se është rritur ndjenja e përgjegjësisë të komunistët për mbarëvajtjen e punës së përgjithshme, për ndreqjen e të metave dhe të dobësive në punë. Kjo është një çështje me shumë rëndësi që shpreh gjallërinë luftarake të Partisë.

Por zhvillimi më i gjerë i kritikës dhe i autokritikës dhe sidomos i kritikës nga poshtë, ndesh shpesh në disa pengesa, të cilat duhet t'i zhdukim patjetër dhe pa humbur kohë.

Para së gjithash, duhet të forcohet më tepër përgjegjësia në komunistët dhe dhënia llogari nga ana e organeve të zgjedhura para zgjedhësve duhet të jetë e hapët dhe konkrete, pse shpeshherë ndodh që në raportet

ku jepet llogari nga organet e zgjedhura, të metat dhe gabimet kalohen shumë lehtë dhe me fraza të përgjithshme, shpërndahet e zvogëlohet përgjegjësia e shokëve kryesorë për dobësitë në punë. Si pasojë, të gjithë shkopinj të bien mbi njerëzit e bazës. Një veprim i tillë, pa dyshim, i vë fre kritikës nga poshtë dhe i vë në pozita të privileguara byrotë, sekretarët e komiteteve të Partisë dhe shokët e tjerë me përgjegjësi. Masat e Partisë dhe punonjësit, përgjithësisht, kanë nevojë të shohin shembullin e shokëve përgjegjës në lidhje me zhvillimin e autokritikës. Njohja seriozisht e gabimeve sjell si pasojë përmirësimin e vetë kuadrit dhe të punës. E kundërta ngjet kur autokritika bëhet formale dhe, për fat të keq, ka shumë shokë që e kanë bërë zakon të bëjnë çdo herë «autokritikë» dhe vazhdimisht të bëjnë gabime për të njëjtat gjëra. Kuptohet se të tilla «autokritika» nuk janë konstruktive dhe nuk i shërbejnë as përmirësimit të kuadrit as përmirësimit të punës, prandaj duhet hequr dorë sa më parë nga këto.

Kritika dhe autokritika, armë të fuqishme të partive marksiste-leniniste, nuk janë parulla boshe dhe pa kuptim. Në punë komunistët edhe do të gabojnë dhe nuk është e thënë se komunistët janë të pagabueshëm, por ata duhet të gabojnë më pak se të tjerët, sepse ata i edukon Partia me luftën e saj dhe nëpërmjet proceseve të punës. Komunistët e thjeshtë dhe të devotshëm s'kanë drojtje t'i njohin gabimet e tyre; gjithashtu këta kanë guximin e madh t'ia thonë në sy të katër të vërtetat cilitdo qoftë. Po nuk ndodh kështu me elementët që kanë mbeturina të mëdha mikroborgjeze, si megalomanët, mburravecët, gënjeshtarët, mashtruesit e të tjerë, që

kanë hyrë gabimisht në Parti, ose që nuk kanë dhe nuk bëjnë përpjekje të përfitojnë nga mësimet dhe lufta e Partisë për t'i zhdukur këto vese. Është e domosdoshme që përpara Partisë dhe masave të analizohen thellë gabimet dhe të metat, të dalë e plotë përgjegjësia e kujtdo qoftë për moszbatimin e detyrave dhe të vendimeve. Vetëm kështu masat do ta ngrenë më me forcë zërin për të kritikuar këdo, pa marrë parasysh pozitën. Kështu do të ndreqen gabimet dhe do të kuptohet më mirë nga cilido ç'vlerë të madhe ka kritika dhe autokritika bolshevike.

Komiteti Qendror i Partisë ka treguar kujdes për forcimin e kritikës dhe të autokritikës edhe në organizatat e Ushtrisë Popullore e të reparteve të kufirit dhe në këtë drejtim janë shënuar mjaft suksese, por duhet pasur gjithnjë parasysh që të respektohen me rreptësi normat e caktuara nga Komiteti Qendror i Partisë për zhvillimin e kritikës.

Masa e Partisë duhet të jetë njëkohësisht vigjilente jo vetëm kundrejt autokritikës formale, por edhe kundrejt kritikës denigruese, pa baza dhe shpifëse, që synon në diskreditimin e njerëzve të ndershëm të Partisë.

Është një nga detyrat më elementare të komiteteve të Partisë dhe të organeve të pushtetit tonë, kujdesi i përhershëm për të dëgjuar me vëmendje zërin e bazës, çdo kritikë që vjen nga poshtë qoftë edhe me pak rëndësi. Ta verifikosh atë me kujdes, ta zgjidhësh gjithnjë drejt dhe të informosh rregullisht organizatat ose njerëzit që i bëjnë ato mbi zgjidhjen e tyre, kjo është një nga kushtet kryesore për zhvillimin më të gjerë të kritikës nga poshtë.

Më në fund, një çështje serioze, që pengon zhvillimin e kritikës nga poshtë, është edhe persekutimi që u bëhet nga ana e disa pergjegjësve atyre që i kritikojnë. Kjo është një gjë e rëndë, shokë, po për fat të keq ka akoma njerëz të tillë, të cilët hakmerren kundrejt atyre që i kritikojnë.

Para ca kohësh, në bisedim me një punëtor të vjetër të transportit, midis të tjerash ai më tha se ndërmjet punëtorëve ka akoma drojtje, ka frikë për të kritikuar hapët pergjegjësit, sepse ata e gjejnë mënyrën të hakmerren e shpeshherë e bëjnë këtë jo hapët, jo drejtpërsëdrejti, por për «mirë», për «nevojë pune» ose për «shkurtim organike» etj., të transferojnë ose të nxjerrin fare nga puna. Tipik është rasti i drejtorit të NIL Prodhimeve të ndryshme në Vlorë, i cili merr nëpër këmbë vendimet e organizatës bazë, kërcënon punëtorët, nuk pranon aspak kritikë që i bëhen dhe hakmerret duke i pushuar nga puna punëtorët që e kritikojnë. Veprime të tilla janë pa dyshim veprime antiparti dhe antishtetërore. Këtyre shfaqjeve të dëmshme, që ndrydhin inisiativën krijuese të masave, u duhet dhënë fund. Të tillë njerëz që mbytin kritikën, qoftë edhe me metoda të stërholluara, nuk duhet të qëndrojnë kurrsesi në vende me pergjegjësi dhe të merren masa kundër tyre.

Organizatata e Partisë kanë për detyrë t'ia nënshtrojnë veprimtarinë e çdo komunisti, me çdo pergjegjësi qoftë ai, kritikës së Partisë. Të gjithë, pa përjashtim, duhet të kaliten në një kudhër, në organizatën bazë të Partisë. Disa shokë pergjegjës hedhin shqelma, vetëm nga negalomania, kur organizata bazë i kritikon me plot të drejtë, kurse, kur thërrihen para organeve më të larta,

i pranojnë gabimet duke thënë njëqind herë si urdhëron. Në këtë mënyrë, në këta njerëz jo të shëndoshë, plekset kapadaillëku bosh me servilizmin.

Detyra e gjithë Partisë është të spastrojë rrugën për t'i dhënë mundësi zhvillimit të gjithanshëm të kritikës. Lufta e vazhdueshme, e paprerë me të metat dhe dobësitë në tërë punën e Partisë, të pushtetit, të ekonomisë e të sektorëve të tjerë është garancia e sukseseve tona. Çdo komunist, çdo punonjës i Republikës duhet ta kuptojë se e ka për detyrë ta ngrejë zërin deri në Komitetin Qendror të Partisë, kundër të metave që vë re kudo dhe te kushdo. Vetëm me kujdesin e të gjithëve për të gjitha punët, do të sigurohet zhvillimi më i shpejtë i vendit në rrugën e caktuar nga Partia.

Partia jonë vazhdimisht i ka edukuar kuadrot dhe përgjithësisht masat punonjëse me frymën e gatishmërisë për t'i shërbyer atdheut, me frymën e zbatimit të rreptë të disiplinës së Partisë dhe të shtetit. Dhe, pa dyshim, sukseset e arritura në vendin tonë në lëmin e ekonomisë, kulturës etj., shpjegohen në radhë të parë me faktin se kuadrot, komunistët dhe punonjësit, përgjithësisht, kanë luftuar me ndërgjegje për zbatimin e plotë të vendimeve dhe të detyrave që kanë shtruar Partia dhe qeveria.

Forcimi i mëtejshëm i disiplinës së ndërgjegjshme të Partisë dhe të shtetit është një detyrë me shumë rëndësi për Partinë në periudhën që kalojmë, sepse, siç na mëson V. I. Lenini, dobësimi sado i vogël i saj i shërben armikut të klasës, borgjezisë. Dhe duhet thënë se në disa organizata dhe kuadro ka shfaqje krejtësisht të papërshtatshme me disiplinën e hekurt të Partisë. Ndodh

shpeshherë me disa shokë ministra ose përgjegjës ndër-marrjesh që të marrin zotime me plot entuziazëm në fillim të vitit apo të tremujorit, ose kur thirren në raport para organeve të larta të Partisë dhe të shtetit për realizimin e tejkalimin e planeve etj., mirëpo, kur vjen fundi, zotimet e tyre i merr era. Dhe e keqja më e madhe është se këto gjëra përsëriten vazhdimisht nga të njëjtat organizata dhe nga të njëjtët njerëz, sepse asnjëri nuk ndalet mbi këtë çështje për ta parë si shfaqje të thyerjes së disiplinës. Tani është bërë si rrugë në disa shokë që, po t'i thërresësh në raport e t'i kritikosh për dobësi e të meta, bëjnë një autokritikë formale, marrin një zotim të mirë, ndoshta të pastudjuar fare, sa për të dalë nga gjendja e vështirë dhe vazhdojnë përsëri punën e mëparshme me të meta. Kësaj i thonë të ngopesh me lugë të zbratur!

Ne duhet t'u vëmë pikë shfaqjeve të tilla. Detyrat që ngarkohen ose zotimet që merren pas një studimi të hollësishëm dhe të bazuar mirë mbi mundësitë reale, duhet të konsiderohen si ligj dhe të kërkohet zbatimi i rreptë dhe pikë për pikë i tyre.

Me këtë rast duhet theksuar edhe dobësia e punës sonë të kontrollit mbi zotimet e marrura dhe përgjithësisht mbi zbatimin e detyrave. Te ne flitet shumë për rëndësinë e kontrollit në punën e organizimit dhe të zbatimit të detyrave, për rolin e tij të madh etj., po në të vërtetë bëhet shumë pak. Nuk ka kudo një kontroll të rregullt, sistematik, kontroll për të gjitha detyrat edhe për ato me më pak rëndësi, por merren vendime, ngarkohen njerëzit me detyra dhe për një kohë të gjatë harrohet krejt fati i tyre. Vetëm kur vjen fundi, kujtohen

njerëzit të shikojnë ç'u bë me vendimet e marrura. Kjo është shumë e dëmshme. Nuk mund të rrënjohet thellë në shpirtin e njerëzve disiplina e hekurt, në rast se mungon kontrolli i rregullt dhe sistematik nga ana e organeve eprorë. Në rast se duam të realizohen me kohë dhe si duhet detyrat dhe në rast se duam t'i ruajmë edhe kuadrot, patjetër duhet të forcojmë kontrollin, të përmirësojmë cilësinë e tij.

Një shfaqje tjetër e rrezikshme, lidhur me shkeljen e disiplinës së Partisë dhe të asaj shtetërore, është qëndrimi që mbajnë disa shokë kundrejt ligjeve të shtetit, kundrejt vendimeve kolegjiale të marrura nga organet e ndryshme. Ka shokë që, si pa gjë të keq, i shkelin këto, sidomos ligjet financiare, duke lënë të kuptohet se këto ligje nuk janë bërë për ta. Kështu për shembull, zëvendësministri i tregëtisë vendos të ngrejë çmimin e peshkut etj., krejt në kundërshtim me vendimet e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë. Po kështu sekretari i dytë i kombinatit të naftës pezullon dhe anulon fare vendime të ndryshme të marrura kolegjialisht nga byroja e komitetit të Partisë së rrethit, vetëm sepse nuk i pëlqejnë atij. Lidhur me këto shfaqje nxjerr kërkime edhe pikëpamja, që me shumë forcë e ka dënuar Partia: çështja e dy disiplinave në Parti dhe në shtet. Ka edhe organizata partie që me tjetër rreptësi e kërkojnë respektimin e disiplinës së Partisë nga anëtarët e thjeshtë dhe krejt ndryshe e kërkojnë këtë nga anëtarët më me përgjegjësi. Kjo shfaqet edhe në gjërat më të thjeshta. Në organizatat bazë të Partisë të dikastereve, fjala vjen, kur nuk paguan kuotizacionin një anëtar i thjeshtë, bëhet çështje e madhe, kurse kur ministri harron ta krye-

jë këtë detyrë, sekretari dhe byroja e organizatës hesh-tin. Mos vallë shokëve përgjegjës, për faktin se janë më të ngarkuar me punë, u lejohet që të shkelin disiplinën e Partisë? A nuk tregojnë në fakt zbatimin e dy lloj disiplinave, vendimi i byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Krujës që dënon fare lehtë ish-shefin e degës së punëve të brendshme të rrethit, që kishte shkelur ligjet duke arrestuar pa të drejtë një komunist, kurse komunistin e arrestuar pa të drejtë e dënon shumë rëndë vetëm se i kishte kundërshtuar «shefit»?

Këto janë qëndrime shumë të rrezikshme që e dobësojnë disiplinën e Partisë e të shtetit dhe ulin frymën luftarake e rreptësinë në zbatimin e detyrave nga ana e të gjithë njerëzve, në çdo pozitë qofshin.

Lidhur me këtë çështje vlen të përmendet edhe një farë fryme liberalizmi e lëshimi, që vihet re në disa shokë me përgjegjësi kundrejt thyerjes së disiplinës.

Ky liberalizëm e kjo frymë butësie në kërkimin e llogarisë dëmton pa masë punën dhe vetë kuadrin, prandaj atyre duhet t'u jepet fund një herë e mirë. As lëshimi më i vogël nuk duhet të bëhet kundrejt atyre që nuk zbatojnë urdhërat dhe detyrat e ngarkuara, kushdo qoftë personi i ngarkuar me zbatimin e tyre. Duhet të forcohet shumë e te kushdo ndjenja e përgjegjësisë.

Në disa organizata partie ka një kuptim shumë të ngushtë e të kufizuar mbi disiplinën: respektimi i mbledhjeve të Partisë, pagimi i rregullt i kuotizacioneve, respektimi i orarit të punës dhe ndonjë gjë tjetër si këto. Kurse mosrealizimi i detyrës së prodhimit, nxjerrja e mallit me cilësi të keqe, rritja e kostos, mosshfrytëzimi si duhet i rezervave të brendshme dhe i kohës së punës

etj., nuk shikohen si shkelje të disiplinës së Partisë dhe të shtetit. Kjo nuk është aspak e drejtë.

Duhet kuptuar se respektimi i rreptë i disiplinës së Partisë dhe të shtetit do të thotë zbatimi pa lëkundje i të gjitha detyrave të Partisë e të shtetit në tërë kompleksin e tyre, i detyrave për realizimin e planit të shtetit me të gjitha pjesët e tija përbërëse, i detyrave organizative dhe politike të Partisë që rrjedhin nga Statuti i Partisë, i detyrave shoqërore. Respektimi i disiplinës së Partisë dhe të shtetit do të thotë, mbajtja e një qëndrimi të drejtë, të ndershëm e shembullor në punë, në shoqëri e në familje, sipas kërkesave të moralit komunist. Prandaj çdo shfaqje në kundërshtim me këto duhet konsideruar shkelje e disiplinës së Partisë dhe të shtetit dhe duhet ndëshkuar shumë rëndë.

Komunistët, në radhë të parë, duhet të japin shembullin në respektimin e përpiktë të disiplinës së Partisë e të shtetit dhe me shembullin e tyre të mësojnë e të edukojnë edhe masat pa parti me frymën e respektimit të disiplinës së shtetit.

Një kujdes të veçantë duhet të tregojnë organizatat e Partisë në Ushtrinë Popullore dhe në repartet e kufirit për forcimin dhe respektimin pikë për pikë të disiplinës ushtarake. Urdhëri i eprorit në ushtri është ligj. Ai duhet të zbatohet pa diskutim.

Respektimi i disiplinës së Partisë dhe të shtetit, nënkupton gjithashtu që vendimet e organeve më të ulëta të jenë gjithnjë të mbështetura mbi vendimet e organeve eprore dhe kurrësi të mos bien në kundërshtim me to.

Veprime si të ish-sekretarit të parë të Komitetit të

Partisë të Rrethit të Kotës, i cili, në kundërshtim me vendimet e Komitetit Qendror dhe të qeverisë, udhëzon organizatat bazë që të marrin masa administrative, masa konfiskimi, heqjen e triskës së Frontit etj., kundër të gjithë atyre që nuk kishin shlyer detyrimet, janë jo vetëm thyerje flagrante të disiplinës së Partisë, të centralizmit demokratik, por edhe provokuese e shumë të rrezikshme për Partinë.

Inisiativa dhe vetëveprimi në zgjidhjen e problemeve lokale, duhet të kombinohen patjetër drejt me direktivat e Partisë, me centralizmin demokratik dhe me disiplinën e hekurt të Partisë.

3. — Të përmirësojmë metodën e punës së komiteteve dhe të organizatave bazë të Partisë në lidhje me zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të shtetit

Çështja e përmirësimit të metodës së punës të komiteteve dhe të organizatave bazë të Partisë në lidhje me kryerjen e detyrave dhe me zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të shtetit është një problem shumë i rëndësishëm. Në punën tonë duhet të na udhëheqin parimet leniniste

«...se për të drejtuar me sukses duhet jo vetëm të dish të bindësh... por edhe të dish të organizosh praktikisht»¹,

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 27, f. 267.

sepse nga mënyra se si drejton apo udhëheq komiteti ose organizata e Partisë varet shumë fati i zbatimit të vendimeve të Partisë ose të qeverisë. Komiteti Qendror i Partisë i ka kushtuar një kujdes të posaçëm kësaj çështjeje dhe ka marrë masa për përmirësimin e metodës së punës në punën e drejtimit. Në fakt, periudha që analizojmë që nga Kongresi II i Partisë e deri sot, është një periudhë e rritjes dhe e përmirësimit të drejtimit të problemeve ekonomike dhe shoqërore nga ana e Partisë. Roli drejtues i organizatave bazë si dhe ai i komiteteve të Partisë dhe i byrove të tyre është forcuar. Ne mund të themi se janë bërë përmirësime të dukshme nga e kaluara përse i përket zbatimit të normave leniniste të Partisë në drejtimin e udhëheqjes kolegjiale, të mbledhjeve të rregullta të aktiveve, të plenumeve dhe të konferencave në të gjithë gamën e Partisë. Por, njëkohësisht, duhet theksuar se ekzistojnë akoma shumë të meta dhe gabime, të cilat Partia duhet t'i korrigjojë me kujdes dhe shpejt. Njëkohësisht puna që kryhet nga komitetet, plenumet dhe aktivet e Partisë në drejtim të studimit më të thellë, më konkret dhe më shkencor të problemeve që diskutohen dhe vendosen në këto mbledhje duhet të përmirësohet dhe të merren masa të rrepta për zbatimin në praktikë të vendimeve të marrura.

Duhet theksuar që tani se parimi leninist me rëndësi të madhe, që duhet t'i bindësh masat, nuk ka gjetur kurdoherë dhe kudo zbatimin e dëshirueshëm, qoftë nga ana e komiteteve kundrejt bazës së Partisë, qoftë nga baza kundrejt masave punonjëse. Në mjaft raste përdoret metoda e komandimit, e cila, jo vetëm që nuk sqaron dhe nuk kënaq njerëzit, por të çon në rrugën e

gabuar të marrjes së masave administrative ose arbitrarre kundër atyre që nuk janë të sqaruar dhe të bindur.

Me gjithë përmirësimin që ka në ngritjen e kuadrove të rinj duhet të pranojmë se këta janë akoma prapa dhe nuk e ndejnë si duhet përgjegjësinë e madhe që kanë para Partisë dhe popullit që i ka zgjedhur në udhëheqje. Partia na mëson se ka rëndësi të madhe jo vetëm studimi i drejtë i problemit, marrja e një vendimi të drejtë, por edhe organizimi i punës. Për ta vënë në jetë dhe në praktikë këtë ose atë vendim, rol vendimtar luan organizimi i punës. Në këtë drejtim, në punën tonë, vërçen dobësi të mëdha. Shumë herë drejtohet në përgjithësi, me fraza të përgjithshme ose me urdhëra, pa u futur si duhet në praktikën e gjërave. Prandaj në këtë drejtim kuadrot e Partisë dhe organet drejtuese të saj duhet ta përmirësojnë rrënjësisht metodën e punës, nga e cila varet suksesi i ndërtimit të ekonomisë socialiste.

Një e metë në metodën e punës së komiteteve të Partisë është besimi jashtë masës që ato vazhdojnë të kenë në letra dhe në vendime. Me gjithë luftën e madhe që zhvillohet në Parti kundër burokratizmit, kundër shkresave të tepërta dhe mbledhjeve pa vend, prapëseprapë ka akoma mjaft komitete partie që nuk shkëputen lehtë nga këto. Dymbëdhjetë herë gjatë vjetëve 1954 dhe 1955 e ka marrë në shqyrtim ish-Komiteti i Partisë i qarkut të Durrësit çështjen e kolektivizimit. Dymbëdhjetë herë janë marrë vendime për këtë çështje, natyrisht, të ngjashme si dy pika uji. Sa punë dhe sa letër është harxhuar nga njerëzit e aparatit të këtij komiteti dhe më në fund ç'u nxuar në shesh? Ritmi i kolektivizimit në Durrës ka qenë dhe vazhdon të jetë i ngadal-

shëm. Kurse krejt ndryshe ka punuar organizata e Partisë e qarkut të Gjirokastrës po për problemin e kolektivizimit. Kjo mori vetëm një vendim për këtë çështje, të bazuar në vendimin e Komitetit Qendror të Partisë dhe e ndoqi, e ndihmoi me një punë konkrete të vazhdueshme zbatimin e tij. Ajo i dha rëndësi punës së gjallë individuale, krijuese, bindëse me fshatarët dhe arriti të ngrejë brenda vitit 1955 më se tri herë më shumë kooperativa nga ç'ishin ngritur gjatë dhjetë vjetëve pas çlirimit. Prandaj tërë vëmendjen kryesore organet dhe organizatat e Partisë duhet t'ia kushtojnë punës së gjallë në terren, në praktikë, punës për organizimin dhe kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe të mos i ndrydhin kurrsesi forcat e gjalla të Partisë në një punë të ngushtë zyre, në një punë burokratike. S'ka dyshim se komitetet dhe organizatat bazë të Partisë edhe duhet të mbliidhen, të dëgjojnë raporte, të marrin vendime të studjuara dhe të përgatitura mirë, por në asnjë mënyrë nuk duhet që kjo të zërë pjesën më të madhe të kohës së punës së tyre.

Për të marrë vendime të studjuara mirë, për të organizuar punën në drejtim të zbatimit të këtyre vendimeve është e domosdoshme dhe e ngutshme përsosja e aparateve të komiteteve të Partisë. Kjo do të thotë që drejtuesit, njerëzit që punojnë në aparatet e Partisë dhe të gjithë komunistët, në përgjithësi, duhet të studjojnë teknikën, agrotechnikën, ose çfarëdo zanati ku ata punojnë, sepse vetëm kështu mund të drejtosh me sukses. Shumë udhëheqës dhe shokë të bazës kënaqen me pak gjëra që kanë mësuar në praktikë dhe nuk bëjnë përpjekje sa duhet të zgjerojnë njohuritë e tyre. S'ka dy-

shim se ata do të shterojnë dhe atëhere për të mësuar masat, për të punuar si duhet me to, për t'i bindur dhe për t'i organizuar ato, ata do të përdorin fraza të përgjithshme, metoda të vjetëruara në punë që as nuk bindin dhe as nuk kënaqin njeri, por frenojnë ndërtimin e mëtejshëm të ekonomisë.

Prakticizmi është një dobësi për kuadrot, që kufizohen vetëm me kaq dhe s'mësojnë sa duhet për të zgjeruar njohuritë e tyre. Duhet të mos harrojmë se fabrikat e reja dhe moderne që ne kemi ngritur, kolektivizimi që po zhvillohet me ritme të shpejta në vendin tonë, i vë komunistët përpara problemeve të rëndësishme që duhet të zgjidhin. Ata duhet të mësojnë dhe të organizojnë masat pa parti. Prandaj t'i kuptosh në mënyrë të thjeshtuar detyrat e anëtarëve të Partisë në ndërtimin e ekonomisë së re socialiste, siç bëjnë disa kadro të Partisë ose të pushtetit, është një e metë shumë serioze që duhet zhdukur; Partia dhe pushteti ynë popullor kanë krijuar mundësi të gjera për të mësuar.

Çështje me rëndësi në punën e drejtimit të organeve dhe të organizatave të Partisë, që akoma s'ka gjetur zgjidhje, është ajo e drejtimit të ekonomisë nëpërmjet organeve të pushtetit dhe jo duke i zëvendësuar ato. Një punë e tillë, siç është theksuar vazhdimisht, është e dëmshme dhe e rrezikshme, sepse organet e ngarkuara drejtpërsëdrejti me zbatimin e këtyre detyrave fillojnë të tërhiqen si mënjanë dhe në një farë mase e shkarkojnë përgjegjësinë e tyre. Nuk duhet të lejohet në asnjë mënyrë që të ngjasë kështu. Por, nga ana tjetër, komitetet e Partisë nuk duhet të mendojnë se puna e Partisë, puna politike dhe organizative e saj është e ndarë nga

veprimtaria ekonomike. Ata që mendojnë kështu gabojnë rëndë. As ka, as mund të ketë një ndarje të tillë në punën e Partisë.

Partia duhet ta ketë kurdoherë si pikësypnim organizimin dhe edukimin e të gjitha masave punonjëse që të përmirësojnë drejtimin e ekonomisë dhe gjithë aktiviteti tjetër i shtetit të ketë si pikësypnim përmirësimin e gjendjes materiale dhe kulturele të popullit. Vlerësimi i kuadrove udhëheqës të Partisë, i funksionarëve të Partisë dhe i çdo komunisti duhet të bëhet në bazë të rezultateve konkrete të punës së tyre në prodhimin e të mirave materiale dhe jo të fjalimeve të mbajtura në konferenca. Në këtë drejtim punëtorët e Partisë duhet ta braktisin punën e përciptë dhe s'duhet të shkojnë më në bazë si era duke dhënë vetëm urdhëra e pa lënë asnjë gjurmë. Ata duhet t'u qepen problemeve, të japin ndihmë konkrete, të mësojnë njerëzit, pastaj të largohen.

Shpeshherë komitetet e Partisë, të shkëputura nga baza, thërresin në mbledhje sekretarët e organizatave bazë në vend që të venë dhe t'i ndihmojnë konkretisht atje ku ata punojnë e luftojnë me vështirësitë. Një praktikë e tillë, në vend që ta forcojë punën, e dobëson atë. Kemi pasur jo një rast, po dhjetëra raste që, kur bëheshin zgjedhjet në Parti, sekretarë organizatash bazë kanë kërkuar të mos rizgjidhen, jo se nuk u pëlqen të punojnë për Partinë dhe të mbajnë përgjegjësitë që u ngarkon organizata e tyre, por sepse kanë pasë mbetur rrugëve e nëpër mbledhje dhe i vret ndërgjegjia se me një metodë pune të tillë nuk mund të përmbushin detyrat që u ngarkon Partia.

Pra, të shkohet më shumë poshtë dhe në vend që të

thirret baza sipër, të ndihmohen dhe të udhëzohen në bazë sekretarët, duke përmirësuar sa më shumë cilësinë e instruktimit nga ana e komiteteve të Partisë. Duhet pasur më tepër besim në njerëzit e bazës dhe, qoftë puschiteti, qofshin organizatat e masave, duhet t'u besojnë njerëzve të bazës për detyrat që u vihen përpara; t'u lihet atyre inisiativë e gjerë në veprime, duke i ndihmuar për organizimin e punës.

Në metodën e punës të disa komiteteve të Partisë dhe të disa organizatave bazë vihet re një farë pune mekanike një farë pune e ngurtë, jo e gjallë dhe krijuese, një formalizëm i theksuar dhe një dogmatizëm në çështjet organizative që do të bëhen të mërëzishme dhe të rrezikshme për Partinë, në qoftë se nuk do të luftohen dhe nuk do të zhduken sa më parë. Karakteristikë e organizatave të Partisë që punojnë mirë është pikërisht se ato dinë të nxjerrin vetë nga vendimet e drejta, nga jeta, nga vetë kërkesa e zhvillimit të prodhimit dhe të ndërtimit të ekonomisë socialiste problemet kryesore, kyçe, që duhen zgjidhur deri në fund. Një zgjidhje e tillë e problemeve do të influencojë në rrugë të drejtë dhe në zgjidhjen e të gjitha problemeve të tjera. Të bësh mbledhje për mbledhje, siç bëjnë disa organizata bazë, të shtrosh në çdo mbledhje po ato probleme, këto nuk japin rezultate. Mbledhjet formale si dhe moszhvillimi i inisiativës dhe i vetëveprimit të organeve dhe të organizatave të Partisë, i ndrydh forcat e Partisë, mbyty vruillin e tyre. Mendohet sikur kështu aktivizohen njerëzit, por përkundrazi ata hidhen në pasivitet. Kjo metodë pune është e rrezikshme për Partinë, prandaj duhet luftuar me të gjitha forcat.

Le të marrim, si shembull pozitiv në këtë drejtim, organizatën bazë të Partisë të Uzinës «Enver». Vitin e kaluar ajo u muar konkretisht me një çështje të caktuar të planit, me çështjen e njohjes së shfrytëzimit të rezervave të brendshme dhe jo me planin në përgjithësi. Organizata e gjykoi shumë drejt se kjo ishte hallka kryesore që do të influenconte drejtpërsëdrejti në realizimin para kohe të planit, në uljen e kostos së prodhimit etj. Dhe ajo përpunoi masa konkrete për këtë çështje. Duke bashkëpunuar me drejtorinë, duke mobilizuar organizatat e masave në uzinë, ajo mundi ta kthejë iniciativën e saj për njohjen dhe shfrytëzimin e rezervave të brendshme në një lëvizje të vërtetë që përfshiu mbarë kolektivin. Dhe rezultatet e kësaj pune ne i kemi dëgjuar të gjithë. Uzina e realizoi planin e vitit në 106,7 për qind dhe i kurseu arkës së shtetit 4 336 000 lekë. Kjo ishte njëra anë e suksesit. Ana tjetër, me shumë rëndësi, ishte fryma që ngjalli në organizatën bazë një metodë e tillë pune. U rrit aktiviteti i komunistëve, u shtua kujdesi i secilit për mbarëvajtjen e punëve në uzinë. Kjo i rriti njerëzit, i bëri më të gjallë, më luftarakë.

Ndërtimi i bazave të socializmit në vendin tonë ngre para Partisë çdo ditë detyra të reja dhe të mëdha, ekonomia jonë forcohet dhe zmadhohet vazhdimisht. Krahas kësaj duhet të rriten dhe të forcohen kuadröt që të ecin me situatën, të rritet aftësia dhe iniciativa e çdo funksionari, e çdo organizate dhe komiteti partie dhe ata të mos bëhen vetëm zbatues të thjeshtë të direktivave që vijnë nga lart, por t'i bëjnë të tyret këto, të veprojnë në lidhje me to në mënyrë krijuese dhe jo në mënyrë formale.

Puna e Partisë, më tepër se çdo punë tjetër, nuk e duron shablonizmin dhe formalizmin, ajo nuk mund të futet në kallëpe të caktuara një herë e përgjithmonë. Në kohë dhe në vende të ndryshme nuk mund të përdoren të njëjtat metoda. Komitetet e Partisë, organizatat bazë dhe çdo funksionar duhet ta kombinojnë vendosmërinë për zbatimin e direktivave të Partisë me elasticitetin dhe iniciativën në punë, me aftësinë për të gjetur forma dhe metoda të tilla pune për zgjidhjen e problemeve që t'i përshtaten vendit dhe punës.

Udhëheqja e Partisë është udhëheqje politike, ajo nuk mund të jetë e tillë pa u lidhur ngushtë me jetën, me ndjenjën e së resë, me perspektivën. Kërkesa kryesore që shtron Partia para organeve dhe organizatave të saja, para kuadrove të saj është që ata të punojnë në mënyrë krijuese dhe me iniciativë.

4. — Të forcohet kontrolli i përgjithshëm i Partisë në punën me kuadrot dhe të përmirësohet puna për zgjedhjen dhe edukimin e tyre

Problemi i kuadrit ka qenë dhe mbetet një nga çështjet më të rëndësishme që e ka preokupuar dhe e preokupon shumë Partinë, sepse kuadri është faktori vendimtar për zgjidhjen e detyrave që na shtrohen përpara. Me kuadro besnikë dhe të aftë për detyrën e ngarkuar, nuk ka kala që të mos merret. Duke u udhëhequr, si në çdo fushë, nga mësimet e marksizëm-leninizmit, me besim të patundur në vlerat krijuese të masave të gjera popullore, Partia mundi të përgatitë

dhe të rritë në zjarrin e luftës dhe të punës kuadro të zot, të guximshëm, luftëtarë për vënien në jetë të detyrave që shtron Partia.

Në luftën për realizimin e pesëvjeçarit të parë, janë rritur, edukuar dhe forcuar kuadrot tanë. Ata kanë mësuar të drejtojnë më mirë sektorët që u janë besuar, janë kalitur në luftën kundër të metave dhe vështirësive, kanë forcuar ndërgjegjen në punë e në mbrojtjen e interesave të Partisë e të shtetit. Në punë e sipër, nëpërmjet kurseve e shkollave është kualifikuar një numër i konsiderueshëm kuadrosh dhe punëtorësh.

Por, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për kuadro, që vijnë duke u rritur çdo ditë e më shumë, sidomos tani kur vendi ynë hyn në një fazë të re, në luftën për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar, problemi i edukimit të kuadrit, puna për zgjedhjen dhe edukimin më të drejtë të tij, merr një rëndësi akoma më të madhe.

Para së gjithash, duhet të rritet më shumë se deri sot kujdesi i drejtëpërdrejtë dhe kontrolli i të gjitha hallkave të Partisë për të gjithë punën që zhvillohet në tërë vendin për përgatitjen dhe vendosjen e kuadrove. Duhet të kuptohet mirë nga të gjitha komitetet e Partisë se ato kanë përgjegjësinë kryesore për tërë politikën e kuadrit që bëhet në juridiksionin e tyre, pavarësisht nga nomenklatura.

Disa komitete partie punën e tyre me kuadrin e kanë kufizuar shpeshherë në një punë mekanike për emërimin dhe transferimin e tyre dhe nuk e shikojnë atë në tërë kompleksin e saj. S'ka dyshim se duke vepruar kështu edhe vetë puna e emërimit dhe e shpër-

ndarjes së kuadrove nuk mund të bëhet kurrësi e drejtë. Që të bëhet politikë e drejtë në shpërndarjen e kuadrove, është e domosdoshme që të njihen nga afër, në punë e sipër e të ndihmohen konkretisht ata. Duhet të punohet gjithashtu për përgatitjen e kuadrove të rinj, për të siguruar burim të pashtershëm kuadrosh.

Kuadrot, nuk nxirren nga ndonjë «furrë speciale», ata i nxjerr puna madhështore e Partisë, ata i nxjerr lufta për realizimin e vendimeve të Partisë, ata i nxjerr vetë jeta. Prandaj atje ku zhvillohet lufta për realizimin e planeve, atje duhen kërkuar kuadrot. Vetëm se duhet një punë më e kujdesshme, një punë e vazhdueshme për zgjedhjen e përgatitjen e tyre. Të heqim dorë nga metodat burokratike në punën me kuadrot, nga vendosja e tyre vetëm duke u bazuar në dokumentat, nga lëvizja pa kriter dhe kohë e pa kohë e kuadrove, duke u ardhur gjithnjë rreth e rrotull disa kuadrove të njohur etj. Duhet të jetë e qartë, që, nëse ka punë që nuk mund ta durojë burokratizmin, është puna me njerëzit, me kuadrot.

Në kushtet tona, kur mijëra e mijëra njerëz marrin pjesë drejtpërsëdrejti në qeverisjen e vendit, kur mijëra e mijëra punonjës aktivizohen në detyra shoqërore dhe i kryejnë ato me ndërgjegje, kur në luftën për realizimin e planeve dalin njerëz të mrekullueshëm që me guxim thyejnë normat e vjetra dhe vendosin norma të reja, kur janë krijuar të gjitha mundësitë për zhvillimin e inisiativës krijuese të masave të gjera, ka me qindra e mijëra njerëz që mund të drejtojnë edhe sektorët më të vështirë. Veçse këta duhen gjetur, duhen njohur, duhen pre-

gatitur e duhen ngritur me guxim. Dhe këtë mundet dhe duhet ta bëjë kryesisht Partia.

Duhet pasur durim në punën për përgatitjen e kuadrit. Është e vërtetë se elementët e rinj, por të shëndoshë, të dalë nga radhët e klasës punëtore dhe të punonjësve të tjerë, nuk e kanë që ditën e parë eksperiencën e duhur në punën e sektorit ku vendosen dhe as që mund ta kenë. Asnjëri nuk lind i mësuar për të drejtuar. Eksperienca e sektorit, arti i të drejtuarit mësohet në punë e sipër. Prandaj duhet kujdes e durim dhe ngrohësi për të rritur kuadro të rinj.

Puna për zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit është shumë delikate dhe me mjaft përgjegjësi. I vetmi parim i drejtë për zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit është parimi i zgjedhjes dhe i vendosjes së tyre duke u mbështetur në besimin politik dhe aftësitë në punë. Prandaj, për ta zbatuar drejt këtë parim është e domosdoshme që të sigurohet njohja e dyanshme e kuadrit, njohja nëpërmjet dokumentave dhe njohja në punë. Njëra pa tjetrën, nënvleftësimi i njerës ose i tjetrës anë, të çon patjetër në gabime, të cilat ngandonjëherë i kushtojnë shumë Partisë dhe shtetit tonë.

E kemi thënë edhe herë tjetër dhe po e përsëritim se vendosja e kuadrove duke marrë parasysh besimin e tyre politik, vigjilenca në punën tonë në këtë drejtim, veçanërisht për kushtet tona, ka një rëndësi të veçantë. Prandaj s'duhet të lejohet as lëshimi më i vogël. Njëkohësisht duhet forcuar kontrolli për njohjen e kuadrit në punë. Duhet patjetër ta lidhim më mirë se deri sot kontrollin e zbatimit të vendimeve me punën e kuadrit. Faktet tregojnë se në këtë drejtim nuk jemi fort mirë.

Vetë lëvizjet e shpeshta të kuadrit që bëhen nga mjaft komitete partie dhe dikastere tregojnë se nuk njihen mirë dhe nga afër njerëzit.

Ministria e Shëndetësisë, për shembull, gjatë vitit 1955, ka lëvizur më tepër se 23 për qind të kuadrit: më se 70 për qind i ka lëvizur në mënyrë paralele, kurse afërsisht një të pestën e tyre me ulje. Një gjendje e tillë tregon jo vetëm se nuk njihen kuadrot, por edhe i dëmton pa masë ata, s'i lë të specializohen në një punë të caktuar, të ambientohen me punën. Ata kurdoherë mbehen të rinj në punë, të porsaardhur dhe, nën këtë pretekst, fshihen edhe plot të meta të tjera.

Prandaj, njohja e thellë e kuadrove, studimi i kujdesshëm i tyre, stabilizimi i tyre në punë, dhënia e një profili të caktuar, si edhe ndihma konkrete dhe e vazhdueshme në punë, këto janë detyra të rëndësishme të Partisë dhe të organeve shtetërore.

Me shumë rëndësi në punën për vendosjen e kuadrit është kujdesi për ngritjen e kuadrove të rinj nga radhët e punëtorëve të prodhimit. Vihet re një ngurrim, krejt i pajustificueshëm, për ngritjen dhe rritjen e kuadrove punëtorë. Në rrethin e Durrësit, për shembull, në 494 kuadro që kanë në nomenklaturën e tyre të gjitha ndërmarrjet, nuk ka asnjë punëtor, kurse ka 139 kuadro me origjinë nga shtresat e pasura.

Partia duhet të luftojë të tilla shfaqje dhe dobësi me qëllim që të ngrihen e të rriten me guxim e durim kuadrot punëtorë të prodhimit dhe gratë.

Një praktikë shumë e dëmshme në punën për vendosjen e kuadrove është vendosja e tyre në bazë miqësie e akraballëku. Një politikë e tillë, krejt në kundërshtim

me çdo direktivë të Partisë, i shkatërron kuadrot, dëmton rëndë punën. Në një ambient të tillë familjar s'ka kritikë e autokritikë, pra s'ka luftë për ta çuar përpara punën. Në një ambient të tillë lindin dhe zhvillohen lajkat, mburrjet, përruljet ndaj «të parit të familjes». Dhe pastaj, pas tyre, vijnë përvetësimet e vjedhjet. . .

Partia duhet të tregohet e kujdesshme dhe syhapur për të goditur me forcë që në lindje çdo shfaqje që dëmton rëndë tërë punën. Në asnjë mënyrë të mos lejohet që qendrat tona të prodhimit e të shërbimit dhe zyrat tona, të kthehen në familje.

Një problem tjetër me rëndësi të madhe në punën me kuadrin është ai i ngritjes së nivelit teknik dhe profesional të tij. Akoma niveli teknik e profesional i kuadrit nuk u përgjigjet plotësisht nevojave të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë.

Kongresi II i Partisë na vuri si detyrë të zhdukim disproporcionin që ekzistonte midis nivelit shumë të ulët të kuadrove tanë dhe teknikës moderne, me të cilën po pajiset me të shpejtë industria jonë. Dhe ne gjatë këtyre katër vjetëve, kemi bërë mjaft punë në këtë drejtim; numri i teknikëve është shtuar mbi 240 për qind në krahasim me vitin 1950. Me vendim të qeverisë është zgjeruar rrjeti i shkollave të natës dhe me korrespondencë. Për t'u dhënë mundësi punonjësve tanë të fitojnë një arësim më të lartë, janë hapur disa degë të shkollave të natës: pranë Teknikumit të Naftës në Qytetin «Stalin», pranë Politeknikut «7 Nëntori» në Tiranë, pranë Institutit Politeknik dhe atij Ekonomik; është organizuar mësimi me korrespondencë për shkollat e mesme, për teknikumin bujqësor etj., ku vazhdojnë mësimet 8 649

vetë, është zgjeruar rrjeti i shkollave të rezervave të punës dhe i kurseve të kualifikimit, ku ata që kanë mbaruar dhe ata që po vazhdojnë mësimet arrijnë në 43 940 vetë etj. Por në punën për ngritjen e nivelit teknik e profesional të kuadrit kemi deficite të ndjeshme dhe detyra e mësipërme e kongresit nuk është zbatuar plotësisht. Ritmi i përgatitjes së kuadrove nuk është përgjegjës për ritmin të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës.

Nga një studim jo shumë i plotë rezulton se ne kemi deficite të ndjeshme për kuadro të përgatitur në mjaft sektorë pune. Kështu, për shembull, në sektorin e ndërtimit ne punojmë me 34 për qind të teknikëve të lartë për të cilët kemi nevojë, në sektorin e bujqësisë me 30 për qind dhe në atë të komunikacionit — me 21 për qind etj. Në mënyrë të veçantë nevojat janë më të ndjeshme për disa lloje specialistësh të lartë si për inxhinierë mekanikë, inxhinierë transporti e bonifikimi, zooteknikë, veterinerë, mjekë etj. Gjithashtu mjaft nga sektorët tanë punojnë me mungesa të ndjeshme për teknikë të mesëm. Kështu bujqësia punon me 37 për qind të nevojave, ndërtimi — me 55 për qind, minierat — me 56 për qind.

Kjo gjendje, natyrisht, ka ardhur si rezultat i prapambetjes së madhe që trashëguam nga e kaluara, por këtu ka influencuar gjithashtu edhe puna jonë e pamjaftueshme në këtë drejtim.

Ne nuk kemi pasur një studim të saktë shkencor të nevojave për të gjithë sektorët dhe akoma sot nuk kemi bërë ndonjë gjë serioze në këtë drejtim. Kjo gjendje i ngarkon me përgjegjësi të madhe dikasteret dhe sidomos Komisionin e Planit të Shtetit.

Duke mos i pasur të qarta nevojat për kuadro, edhe

masat e marrura për përgatitjen e tyre kanë qenë jo të plota, bile në disa raste këto janë lënë pasdore dhe është ecur pa perspektivë. Ministria e Bujqësisë, për shembull, në vitin 1953, pushon si të panevojshëm 970 teknikë të ulët, ndër ta edhe 150 traktoristë. Në të vërtetë, këta teknikë ishin mjaft të ulët, por sidoqoftë ata dinin disa gjëra dhe mund të përgatiteshin më lehtë për teknikë të mesëm se sa elementët e tjerë që s'dinin asgjë. Shumica dërmuese e teknikëve që u flakën ishin elementë të rinj, të përgatitur në kurse pas çlirimit.

Ka munguar kujdesi i duhur nga organizatat e Partisë dhe nga pushteti për zgjedhjen e elementëve për në shkolla e kurse, për plotësimin e tyre me këta elementë, për zhvillimin e mësimin në to dhe për përfitimin konkret prej tyre. Në fakt, kur kanë dalë njerëzit nga shkollat e kurset është parë se ka pasur edhe njerëz të papërshtatshëm, që kanë mësuar shumë pak gjëra etj. Programet e këtyre kurseve janë aprovuar në mënyrë fare burokratike, nga zyra, pa parë në praktikë nëse dëgjuesit i marrin, apo nuk i marrin të gjitha ato elemente që u duhen për ta bërë mirë punën kur të mbarojnë mësimet.

Detyra e Partisë është t'i japë fund sa më parë kësaj gjendjeje.

Duke pasur parasysh ritmin e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës gjatë pesëvjeçarit të dytë dhe deficitet që kemi, duhet t'i kushtohet kujdes shumë i madh problemit të përgatitjes së kuadrove për të gjithë sektorët e jetës së vendit. Për gjithë Partinë dhe organet shtetërore problemi i kuadrit duhet të bëhet problemi më i rëndësishëm ndër më të rëndësishmit.

Duhet të marrim masa për të bërë sa më parë një studim më shkencor të nevojave për kadro, të studjohen me saktësi normativat për çdo sektor, duke u bazuar në eksperiencën sovjetike dhe në gjendjen e perspektivat e zhvillimit të degëve të ekonomisë dhe të kulturës të ne, duke ruajtur përpjesëtimin e drejtë për të gjitha degët dhe duke u dhënë precedencë sektorëve më të prapambetur. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive duhet të tregojnë kujdes të veçantë për plotësimin e kontingjenteve sipas planit, duke e pasur perspektivën të qartë dhe të mos dërgojnë në kurse e shkolle njerëz pa kriter.

Të përmirësohet seriozisht puna në kurset e kualifikimit sidomos përsa i përket cilësisë së punës në to, duke u udhëhequr nga parimi që t'i japim shtetit sa më shumë kadro dhe të pregatitur sa më mirë. Në programet e kurseve e të shkollave t'i jepet rëndësi e madhe lidhjes së mësimin me praktikën.

Edhe disa fjalë në lidhje me shpërndarjen e forcave të Partisë. S'ka dyshim se gjatë kohës që nga Kongresi II i Partisë e deri sot edhe në këtë drejtim janë shënuar suksese. Kështu p.sh. në krahasim me vitin 1952 numri i komunistëve në sektorët e industrisë, të minierave, të ndërtimit, të komunikacioneve, të tregëtisë e të artizanatit është shtuar në 40,5 për qind; në sektorin socialist të bujqësisë është shtuar 137,1 për qind dhe në sektorin individual të bujqësisë — 4,19 për qind. Por, megjithëkëtë, ne duhet të themi se shpërndarjen e forcave të Partisë nuk e kemi në rregull. Më tepër se 40 për qind e komunistëve janë me punë në administratë, nëpunës dhe pjesa më e madhe e tyre kryen funksione ndihmëse,

të dorës së dytë. Kjo gjendje e ka preokupuar Komitetin Qendror të PPSH, i cili ka udhëzuar organizatat e Partisë që të marrin masa për të kaluar më shumë komunistë nga administrata në prodhim. Dhe disa rezultate të para janë arritur. Por, duhet thënë që tani, se në disa komunistë të administratës është dukur një shfaqje krejt e huaj për Partinë, një qëndrim borgjez, qëndrim prej aristokrati ndaj punës në prodhim. Ka pasur disa komunistë në organizatën e Shkodrës, si edhe në atë të Tiranës, që kanë ngulur këmbë pa asnjë arsye për të mos shkuar në prodhim. Kështu nga 51 komunistë që organizata e Partisë e rrethit të Shkodrës e pa plotësisht të mundshme të dërgoheshin nga administrata në prodhim, 27 nuk shkuan. Këtë qëndrim ata e justifikojnë me kontributin e madh që kanë dhënë gjatë luftës dhe në punën për rindërtimin e vendit, me mungesën e profesionit ose me dobësi fizike të paqena etj. Por ky qëndrim i tyre, në fakt, nuk shpreh asgjë tjetër, veçse mbeturinat e moralit të vjetër në këta shokë, qëndrimin e tyre përbuzës ndaj punës.

Partia jonë duhet të luftojë me forcë kundër çdo shfaqjeje të këtillë te komunistët.

Puna në vendin tonë është një çështje nderi, lavdie dhe heroizmi dhe ata që duhet ta kuptojnë më mirë se kushdo tjetër këtë gjë janë komunistët. Për komunistin vendi më i përshtatshëm është balli i luftës, vendi ku vendoset fati i zbatimit të politikës së Partisë. Dje në luftë vendi i komunistit që atje ku ishte pika më e rrezikshme, në krye të shokëve. Dhe komunistët gjatë luftës e kryen me nder detyrën, duke u dhënë guxim me shembullin e tyre heroik gjithë luftëtarëve. Sot balli

i luftës, vendi kryesor ku duhet të qëndrojë komunisti, është fronti i prodhimit. Atje ku prodhohen të mirat materiale, në ballë të punëtorëve dhe të fshatarëve punonjës, atje është sot vendi i nderit për komunistin dhe atje, me shembullin e vet personal, ai duhet të mobilizojë punonjësit për vepra heroizmi.

Ngritja e pareshtur e ekonomisë së vendit dhe, lidhur me këtë, forcimi i punës në prodhim kërkon që këtu të përqëndrohen forcat kryesore të Partisë. Organizatat e Partisë duhet të arrijnë ta bëjnë patjetër këtë gjë.

5. — Forcimi i lidhjeve të Partisë me masat dhe puna që duhet bërë për mobilizimin më të madh të tyre në zgjidhjen e detyrave të reja

Klasikët e marksizëm-leninizmit kanë theksuar me një forcë të veçantë rëndësinë e madhe të lidhjeve të partisë me masat. Ata kanë vënë në dukje se asnjë transformim i madh shoqëror nuk mund të kryhet pa pjesëmarrjen e gjerë dhe aktive të masave. Partia jonë e ka konsideruar lidhjen me masat dhe forcimin e vazhdueshëm të këtyre lidhjeve si një nga parimet themelore organizative të saj.

Kongresi II i PPSH na porositi që të përmirësojmë shumë punën e Partisë me masat, të forcojmë dhe të gjallërojmë organizatat e masave, të rritnim inisiativën krijuese dhe të siguronim mobilizimin më të madh të tyre për realizimin e detyrave që shtron Partia dhe shteti.

Dhe që nga Kongresi II i Partisë e deri sot, në të gjitha këto drejtime, janë arritur suksese të dukshme. Veçanërisht është bërë një kthesë e vërtetë në drejtim të problemeve ekonomike nga të gjitha organizatat e masave: Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, Bashkimi i Grave të Shqipërisë dhe Fronti Demokratik. Bashkimet profesionale, duke rritur më shumë kujdesin për organizimin dhe ndjekjen e emulacionit socialist, rinia me anën e takimeve të rinisë punëtore dhe të garave të rinisë në fshat, gruaja me anën e aksioneve të saj konkrete etj., kanë mundur të sigurojnë një mobilizim më të madh të masave për realizimin me sukses të detyrave të ndryshme në fushën ekonomike dhe politiko-shoqërore.

Por në punën e Partisë për forcimin e organizatave të masave dhe në vetë punën e këtyre organizatave ka akoma mjaft dobësi e të meta, të cilat do të ishte gabim të mos i shikonim, të mos i zbulonim dhe të mos i luftonim. E meta më serioze në punën e organizatave të masave është se puna organizative dhe edukative, puna drejtuese e tyre nuk i përgjigjet vrullit, entuziazmit dhe kërkesave të masave. Puna e tyre nuk është në atë nivel që të mund të kanalizojë sa më mirë dhe plotësisht tërë këto energji në drejtim të zgjidhjes së detyrave më të rëndësishme që preokupojnë Partinë dhe shtetin. Formalizmi, sektarizmi dhe burokratizmi që ekzistojnë, ku më shumë dhe ku më pak, në punën e këtyre organizatave, ndrydhnin deri diku energjitë krijuese dhe inisiativën e gjerë të masave. Prandaj lufta kryesore e organizatave të Partisë dhe e vetë organizatave të masave duhet të drejtohet kundër këtyre metodave në punën

e tyre, për një punë më të gjallë, më elastike e më konkrete.

Detyrat e mëdha që shtrojnë direktivat e planit të dytë pesëvjeçar që do të diskutojë ky kongres, janë një program i madh pune për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë. Zbatimi i detyrave për rritjen e prodhimit industrial, për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, për rritjen e ritmit të kolektivizimit të bujqësisë, nuk mund të zgjidhet me sukses pa veprimtarinë e punëtorëve dhe të personelit inxhinieroteknik në ndërmarrjet ekonomike, pa siguruar mobilizimin e gjithanshëm të punonjësve të fshatit, të rinisë e të gruas, pa zhvilluar më tej inisiativën e tyre krijuese.

Partia ka theksuar vazhdimisht se në qendër të vëmendjes së organizatave të Partisë, përsa i përket zbatimit të detyrave të planit, duhet të qëndrojë puna me masat, zhvillimi i emulacionit socialist. Emulacioni socialist zhvillon inisiativën krijuese të masave, vullnetin e tyre për të ngritur ekonominë popullore e për të ndrequr të metat në punë. Të udhëheqësh emulacionin socialist do të thotë të punosh vazhdimisht me njerëzit, të tregosh kujdes për ta e të zhdukësh çdo pengesë në rrugën e tyre. Kur punëtori, inxhinieri e tekniku shohin se për sukseset e tyre në prodhim tregohet interesim, se inisiativat e tyre përkrahen dhe inkurajohen, ata tregojnë një inisiativë dhe mençuri akoma më të madhe në punë.

Por në organizatat tona dhe veçanërisht në ato të bashkimeve profesionale, të cilat janë ngarkuar ta udhëheqin emulacionin socialist, vihet re se puna e kujdeshme dhe e gjallë që duhet bërë në këtë drejtim, shpesh-

herë zëvendësohet me mbledhjen e shifrave të ndryshme mbi numrin e atyre që marrin pjesë në garat socialiste, me ndarjen e çmimeve për fituesit e garave, me ndarjen e shpërblimeve në të holla etj.

Partia na mëson se qëllimi kryesor i emulacionit socialist është të nxitë punonjësit për plotësimin e detyrave të caktuara nga plani dhe për realizimin e normave të punës nga ana e të gjithë punëtorëve, pra të shërbejë që të përhapet gjerësisht eksperiencia e më të mirëve. Por shpeshherë organizatat e Partisë dhe veçanërisht organizatat profesionale dhe të rinisë, merren kryesisht me persona të veçantë ose me grupe të vegjël punëtorësh të përparuar dhe harrojnë masën kryesore të pjesëmarrësve në garë. Një gjë të tillë e shohim edhe në shtypin tonë. Në vend të punës së gjallë me masat, preferohet të bëhet zhurmë rreth sukseseve të veçuara. Kjo nuk është e drejtë dhe as e plotë. Kujdesi për punëtorët e përparuar është një gjë e domosdoshme, por nuk duhet harruar se ajo që vendos për realizimin e planit është masa e gjerë e punëtorëve. Prandaj duhet përqëndruar vëmendja në mënyrë të veçantë te ata, të ndihmohen ata, të vihet në dukje puna e tyre, t'u transmetohet atyre eksperiencia e punëtorëve të përparuar. Organizatave profesionale duhet t'u tërheqë vëmendjen fakti se zakonisht ata që mbeten jashtë lëvizjes së emulacionit socialist, ata që mbeten prapa, janë punëtorët e ardhur rishtas në punë. Ata kanë nevojë për një kujdes të posaçëm, të mësohen, të familjarizohen me kushtet e punës, të edukohen dhe të ndihmohen për të kapërcyer vështirësitë e fillimit.

Njohja e përciptë e problemeve ekonomike nga

kuadrot e bashkimeve profesionale dhe kërkesa nga ana e tyre që ta drejtojnë emulacionin socialist me receta të diktuara nga lart, shkakton patjetër formalizmin në emulacion, nuk nxit zhvillimin e inisiativës së organizatave bazë. Detyra e kuadrove dhe në radhë të parë e komunistëve që punojnë në bashkimet profesionale, është që të futen më thellë në problemet tekniko-ekonomike të prodhimit dhe të orientojnë emulacionin socialist drejt problemeve kyçe të prodhimit. Aftësia e organizatave profesionale për të zbuluar çdo gjë të re e përparimtare që lind në prodhim, për të gjetur format dhe mjetet më të përshtatshme për zhvillimin e tij, është një nga kushtet më të domosdoshme për drejtimin e emulacionit socialist. Bashkimet profesionale duhet të përdorin shumë lloj formash dhe metodash për zhvillimin e mëtejshëm të emulacionit socialist. Por një nga format më të përshtatshme në këtë drejtim janë mbledhjet e prodhimit. Problemet që preokupojnë ndërmarrjet nuk mund të zgjidhen në qoftë se ato nuk bëhen probleme të vetë punëtorëve. Nuk mund të zbatohen detyrat e caktuara nga Partia për zbulimin dhe shfrytëzimin e rezervave të brendshme, në qoftë se në këtë lëvizje nuk marrin pjesë aktive vetë punonjësit.

Në ndërmarrjet tona ekonomike ka burokratizëm, shtrembërime, çorganizim, mungesë disipline, dëmtime, avari e të tjera. A nuk janë këto probleme të rëndësishme për Partinë, për organet ekonomike dhe për bashkimet profesionale? A nuk mund të zgjidheshin më shpejt dhe më mirë këto në qoftë se do të bëheshin probleme të mbledhjeve të prodhimit, në qoftë se do të shqyrtoheshin me pjesëmarrjen e punëtorëve, për të thënë edhe

ata fjalën e tyre dhe për të marrë zotime për të zhdukur të metat që vërtetohen?

Një shfaqje tjetër e formalizmit në garat socialiste është gjithashtu edhe pakujdesia që tregohet nga organet dhe organizatat profesionale për të siguruar në çdo ndërmarrje kushtet e domosdoshme për plotësimin e zotimeve të marrura. Shpeshherë organet e bashkimeve profesionale e kufizojnë detyrën e tyre me mbledhjen e zotimeve që marrin përsipër punëtorët dhe e shumta me mbajtjen e evidencave të rregullta mbi realizimin e tyre, kurse çështjen kryesore, që duhet të zinte pjesën më të madhe të punës së tyre të përditshme: kujdesin e vazhdueshëm për zhdukjen e të gjitha pengesave që hasen në rrugën e realizimit të zotimeve, e lënë krejt pasdore. Në fakt, nga ana e tyre mungon shpirti luftarak, i domosdoshëm për të siguruar kushtet për një punë normale e ritmike nga ana e punëtorëve.

Në praktikë hasen vështirësi në punën e realizimit të zotimeve. Shpeshherë ndodh që administrata e ndërmarrjeve nuk ua siguron punëtorëve me kohë dhe në masën e nevojshme të gjitha materialet dhe mjetet që duhen për zbatimin e zotimeve të marrura, ose u nxjerr vështirësi punëtorëve që punojnë për shpikje, racionalizime etj., në vend që t'i lehtësojë ata. Dhe bashkimet profesionale në vend që të luftojnë dhe ta ngrenë zërin deri në qeveri e në Komitetin Qendror, pajtohen me justifikimet e drejtorëve. Kjo gjendje, pa dyshim, ul entuziazmin e punëtorëve, pengon vrullin e tyre, prandaj, edhe zotimet e marrura mbeten në mes të rrugës. Në punën për realizimin e zotimeve të marrura nga ana e punëtorëve hasen edhe vështirësi lidhur me krijimin e

kushteve më të mira të jetesës. S'ka dyshim se për krimin e kushteve më të mira në punën dhe në jetën e punëtorëve te ne interesohet direkt shteti. Por kjo, në asnjë mënyrë nuk duhet ta pakësojë kujdesin e bashkimeve profesionale për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të punonjësve, që rrjedhin nga legjislacioni i punës dhe nga ligjet e vendimet e tjera të Partisë e të shtetit. Bashkimet profesionale duhet të luftojnë patjetër kundër qëndrimeve burokratike, që mbajnë disa drejtorë ndërmarrjesh në lidhje me çështjen e mbrojtjes së interesave të punëtorëve, gjoja nën pretekstin e mbrojtjes së interesave të shtetit. Duke folur për këtë çështje V. I. Lenini ka thënë:

«...bashkimet e humbën një bazë të tillë, si lufta ekonomike e klasës, por nuk e kanë humbur, dhe mjerisht për shumë vjet akoma nuk do të mund ta humbin një bazë të tillë si «lufta ekonomike» jo e klasës në kuptimin e luftës kundër shtrembërimeve burokratike të aparatit sovjetik, në kuptimin e mbrojtjes së interesave materiale dhe shpirtërore të masës së punonjësve me mjete dhe mënyra që nuk mund t'i përdorë ky aparat. . .»¹.

S'ka dyshim se ata drejtorë që kërkojnë vetëm realizimin e planit nga punëtorët e tyre dhe nuk kujdesen aspak për jetën e punëtorëve, ata nuk janë drejtorë me frymë partie, ata nuk e meritojnë besimin e dhënë. Por

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 103.

edhe ata shokë që punojnë në organizatat profesionale, që i shohin këto dobësi dhe të meta, dëgjojnë ankesat e punëtorëve për kërkesa të drejta që mund të realizohen dhe nuk bëjnë asnjë përpjekje për zgjidhjen e tyre, edhe ata nuk punojnë në rrugë partie, edhe ata nuk e meritojnë besimin e punëtorëve. Partia e ka për detyrë t'i shkundë, t'i zgjojë këta burokratë. Të luftohen te punëtorët prapambetja, dembellëku, tendencat e individualizmit dhe të anarkisë në punë, psikologjia e pronës private dhe të kalitet në ta qëndrimi socialist ndaj punës dhe pronës socialiste.

Një klasë punëtore e çliruar nga shfrytëzimi, siç është klasa jonë punëtore, e ndërgjegjshme për rolin e saj të madh në zhvillimin e shoqërisë, është e zonja të bëjë mrekullira.

Për realizimin me sukses të detyrave të planit të shtetit, sidomos në fshat, një rol shumë i madh u takon organizatave të tjera të masave, rinisë, gruas dhe Frontit Demokratik. Duke ndjekur eksperiencën e viteve të fundit për organizimin e garave socialiste për çështje konkrete, organizatat e rinisë, të gruas dhe të Frontit duhet të luftojnë njëkohësisht kundër shfaqjeve të zhurmës së kotë, kundër bujës dhe anës deklarative në këtë punë. Partia duhet të sigurojë me anë të këtyre organizatave një punë më të gjallë dhe më konkrete për rritjen e entuziazmit dhe të inisiativës së masave fshatare, për zbatimin e detyrave. Duke pasur parasysh detyrën kryesore që na shtrohet tani për transformimin socialist të bujqësisë, ne duhet patjetër ta forcojmë akoma më shumë udhëheqjen e Partisë mbi organizatat e masave në fshat dhe vetë punën e këtyre organizatave,

me qëllim që të sigurohet mobilizimi i tyre për përhapjen e së resë në fshat, për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për realizimin e planeve të bonifikimit dhe për shpejtimin e ritmit të kolektivizimit të bujqësisë.

Forcimi i lidhjeve të Partisë me masat kërkon që të zhvillohet një punë e vazhdueshme dhe sistematike për edukimin e tyre politik. Masat punonjëse duhet të sqarohen rregullisht mbi çështjet aktuale të politikës së Partisë.

E meta kryesore në tërë punën për edukimin politik të masave qëndron në cilësinë e dobët të saj. Edukimi politik i masave bëhet me fraza të përgjithshme, shpeshherë të pakuptueshme, nuk u përgjigjet sa duhet kërkesave dhe nevojave të kategorive të ndryshme të masave punonjëse.

Duhet të rritet, pra, niveli i punës sonë politike me masat, të përmirësohet cilësia e leksioneve, e bisedave dhe e leximeve.

Me shumë rëndësi dhe shumë më delikate është edhe puna për edukimin komunist të rinisë. Ndërsa kur fiasim për të edukuar punëtorët e fshatarët tanë, kemi gjithnjë parasysh riedukimin e tyre, luftimin e mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e tyre etj., kur flasim për edukimin e rinisë, kemi parasysh pikërisht edukimin e saj nga e para, mbujtjen e saj me ndërgjegjen socialiste. Prandaj është jashtëzakonisht i madh roli i organizatës së rinisë, sepse ajo, në bashkëpunim me shtetin dhe nën udhëheqjen e drejtëpërdrejtë të Partisë, duhet ta edukojë rininë që në moshën e saj më të njomë me vetitë e larta të njeriut të shoqërisë së re socialiste.

Që nga puna me fatosat e pionierët dhe deri në bankat e shkollave të larta, kudo që punon rinia, duhet të ndjehet dora e Partisë dhe e organizatës së rinisë që kalit me durim njeriun e ri.

Organizatata e Partisë duhet të kujdesen më shumë për edukimin e rinisë dhe të përpiqen të gjejnë format më të përshtatshme për edukimin komunist të saj.

Rinisë, prej natyre, i pëlqen çdo gjë e re, atë e mër-zitin format e vjetëruara. Prandaj të mos u qëndrojmë skllëvër disa formave të punës sonë që i kemi gjetur prej kohësh. T'i krijojmë rinisë mundësinë që të kalitet dhe të edukohet në format që ajo vetë do t'i gjejë më të përshtatshme.

Duke marrë parasysh prapambetjen e madhe të trashëguar nga e kaluara në radhët e grave, ngritja e nivelit politik dhe kultural të tyre është një punë me shumë përgjegjësi për organizatat e Partisë dhe për organizatën e Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Niveli i ulët kultural dhe teknik i grave është bërë sot një pengesë serioze për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në prodhim dhe për ritmin e zhvillimit të shoqërisë. Prandaj duhet të merren masa më efektive për forcimin e punës edukative me gratë, për të ngritur nivelin e tyre në përshtatje me kërkesat e zhvillimit ekonomik të vendit.

Forca dhe gjallëria e organizatave të masave buron nga drejtimi i urtë i Partisë. Por duhet thënë se jo të gjitha organizatat dhe organet e Partisë kujdesen si duhet për të udhëhequr nga afër dhe vazhdimisht të gjitha organizatat e masave.

Partia i drejton organizatat e masave kryesisht nëpërmjet anëtarëve të saj, që bëjnë pjesë në këto orga-

nizata. Por ka komunistë që, ndonëse marrin pjesë në organizatat e masave, bile janë zgjedhur edhe në organet e tyre, japin shumë pak ndihmë, ose nuk aktivizohen fare në punët e këtyre organizatave. Ky është një qëndrim krejt i palejueshëm për komunistët. Çdo komunist e ka për detyrë të bëjë patjetër një punë shoqërore.

Duhet të jetë e qartë se ai komunist që i shmanget një detyre kaq me rëndësi dhe kaq elementare, siç është puna me masat, ai ka hyrë para kohe në Parti.

Nga ana e tyre, organizatat dhe organet e Partisë duhet t'i udhëheqin organizatat e masave më konkretisht dhe më operativisht.

6. — Mbi disa çështje të punës ideologjike të Partisë

Në të gjithë veprimtarinë e saj Partia jonë është udhëhequr dhe udhëhiqet nga teoria marksiste-leniniste. Për këtë arsye edukimi marksist-leninist i komunistëve në radhë të parë e i gjithë punonjësve dhe zbatimi i kësaj teorie në mënyrë krijuese ka qenë dhe është për Partinë tonë kushti i domosdoshëm për të ecur përpara.

Gjatë këtyre katër vjetëve që na ndajnë nga Kongresi II, Komiteti Qendror i Partisë ka marrë një radhë masash të rëndësishme për forcimin e punës ideologjike të Partisë. Vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë të Prillit 1955 i kanë dhënë një orientim më të përcaktuar punës ideologjike të Partisë dhe kanë luajtur një rol efektiv në zhvillimin dhe përmirësimin e saj.

Rezultate të rëndësishme janë arritur në arësimin

e Partisë, në arësimin politik të rinisë dhe në edukimin komunist të intelektualëve. Në fshat numri i komunistëve që marrin pjesë në format e edukimit është rritur shumë. Si rrjedhim, në këtë vit arësimor 48,32 për qind e komunistëve marrin pjesë në format e ndryshme për studimin e marksizëm-leninizmit dhe 42 për qind ndjekin shkolla të ndryshme shtetërore.

Për përgatitjen e kuadrove të Partisë dhe të pushetit një rol i rëndësishëm i është caktuar Shkollës së Partisë «V. I. Lenin», e cila me vendim të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë të Prillit 1955 u bë tre-vjeçare. Kjo shkollë armatos kuadrot me shkencën marksiste-leniniste, i njeh me problemet ekonomike të vendit, me kuptimin e drejtë të çështjeve ndërkombëtare etj. Sot në shkollën tre-vjeçare të Partisë dhe në kursin një-vjeçar, që është ngritur pranë saj mësojnë gati 300 vetë dhe 251 të tjerë e ndjekin shkollën me korrespondencë. Në vitet e fundit, në programet e edukimit të Partisë dhe të intelektualëve është futur edhe studimi i filozofisë marksiste dhe i ekonomisë politike. Të gjitha këto masa kanë ndihmuar që kuadrot t'i kryejnë më mirë detyrat që u janë ngarkuar.

Një punë shumë e dobishme është bërë në lëmin e botimeve. Janë vënë në qarkullim në broshura të veçanta veprat më të rëndësishme të Marksit, të Engelsit dhe të Leninit. Janë shtypur vepra të Stalinit, teksti i ekonomisë politike etj. Me vendim të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë të Prillit 1955 do të fillojë menjëherë botimi i veprave të plota të V.I. Leninit.

Sukses i rëndësishëm në lëmin e edukimit të Partisë, pas Kongresit II, duhet konsideruar fakti që një

numër i madh kuadrosh dhe anëtarësh partie kanë filluar të ndjekin shkollat e natës dhe me korrespondencë Komiteti Qendror i Partisë e ka quajtur të domosdoshme dhe ka marrë vendime përkatëse, në bazë të të cilave komunistët dhe kuadrot me arësim të përgjithshëm të pamjaftueshëm detyrohen të ngrenë nivelin e tyre kultural e arësimor, sepse vetëm kështu do të jenë në gjendje të përvetësojnë më mirë teorinë marksiste-leniniste dhe të rritin aftësitë e tyre në punë. Në këtë mënyrë Partia jonë i është përveshur sot në një shkallë të gjerë dhe në forma më të organizuara studimit të marksizëm-leninizmit dhe përvetësimit të kulturës së përgjithshme.

Në bazë të këtij orientimi dhe zellit të mirë të shumë komunistëve niveli arësimor i Partisë është përmirësuar. Numri i atyre që kanë mbaruar filloren e 7-vjeçaren u rrit nga 29 155 në 34 100 vetë, i atyre që kanë mbaruar shkollën e mesme u rrit nga 2 800 në 3 360 dhe numri i komunistëve me arësim të lartë — nga 119 në 626.

Por, megjithëse kemi pasur këto suksese, ne duhet të pranojmë se niveli ideo-politik, kultural dhe arësimor i anëtarëve të Partisë sonë dhe i masave punonjëse mbetet akoma shumë i ulët. Prandaj, në të ardhshmen, forcimi i mëtejshëm i punës ideologjike mbetet një nga detyrat kryesore për Partinë tonë. Ne duhet të luftojmë me këmbëngulje kundër moskokëçarjes dhe vetëkënaqësisë që shfaqin disa kuadro dhe komunistë përse i përket studimit të marksizëm-leninizmit dhe edukimit politik e kultural në përgjithësi. Ka shokë me funksione të rëndësishme në Parti dhe në shtet, të cilët nuk stu-

djojnë ose studjojnë shumë pak, ka të tjerë që janë regjistruar në format e arësimit, por nuk mësojnë rregullisht, ka kuadro që kanë mbaruar studimet në shkolla të larta dhe që me marrjen e diplomës mendojnë se kanë studjuar mjaft.

Duhet theksuar se përpjekjet e punonjësve të artit dhe të letërsisë për edukimin e tyre ideologjik janë të pakënaqshme. Kjo pakujdesi nga ana e këtyre shokëve bëhet kur jeta dhe ndërtimi i shoqërisë socialiste në vendin tonë ngrenë përpara Partisë sonë detyra të mëdha që nuk mund të zgjidhen pa u armatosur me shkencën e pararojës, me teorinë marksiste-leniniste.

Duke marrë parasysh detyrat e mëdha që i shtrohen vendit tonë në planin e dytë pesëvjeçar, Partia jonë duhet të luftojë për përmirësimin e mëtejshëm të punës ideologjike. Kjo luftë duhet të konsistojë në ecjen akoma më përpara dhe në sigurimin e një lidhjeje të pandarë të teorisë me praktikën, në forcimin e rolit efektiv të agjitacionit dhe të propagandës së Partisë.

Duhet të pranojmë se propaganda dhe agjitacioni i Partisë vazhdojnë të qëndrojnë larg jetës dhe t'i shërbejnë në mënyrë të pamjaftueshme zhvillimit të ekonomisë dhe ndërtimit kultural të vendit tonë. Faktet vërtetojnë se shumë herë puna ideologjike ka një karakter të përgjithshëm dhe abstrakt. Në zhvillimin e mësimave në format e edukimit marksist-leninist në mjaft raste vihet re se shpjegimi i marksizëm-leninizmit është një gjë më vete dhe politika e Partisë dhe e qeverisë, domethënë problemet konkrete të ndërtimit të socializmit janë diçka tjetër. Këto raste i shohim në Shkollën e Lartë të Partisë, në shkollat politike, në mësimet që jepen në shkollat shtë-

tërore, në leksione, artikuj etj. Në letërsi dhe në arte paraqiten shumë zbetë realiteti, puna madhështore dhe heroike e popullit tonë, puna e njeriut të ri. Kështu, teoria me praktikën lidhen pak dhe puna ideologjike e Partisë merr karakter abstrakt. Të gjithë e dinë se parimi i mirënjohur i shpërndarjes në socializëm është: «Secili sipas aftësive, secilit sipas punës», por kur u morën masa praktike nga qeveria për ta zbatuar drejt këtë parim dhe për të korrigjuar gabimet, që ishin bërë në lidhje me klasifikimin dhe me normat, pati njerëz me Parti e pa parti, që thanë: «Pse të bëhen këto gjëra». Ose ka anëtarë partie në fshat që me ditë të tëra mund të të flasin për të mirat e kolektivizmit, po, kur vjen puna në praktikë, ata i bëjnë bisht punës në kooperativa bujqësore. Kuptohet qartë, pra, se Partisë dhe popullit nuk i vlen aspak ajo punë ideologjike, e cila nuk i armatos komunistët dhe punonjësit me dije të shëndosha dhe nuk i mobilizon ata në luftë për ngritjen e ekonomisë socialiste.

Që në vitin 1920, kur fliste për detyrat e propagandës në kushtet e kalimit në ndërtimin paqësor, Lenini i madh thoshte se

«Propaganda e tipit të vjetër tregon, jep shembuj se ç'është komunizmi. Por kjo propagandë e vjetër nuk është aspak e vlefshme, sepse duhet treguar në praktikë se si mund të ndërtohet socializmi. Gjithë propaganda duhet të mbështetet në eksperiencën politike të ndërtimit ekonomik. Kjo është detyra jonë kryesore, prandaj në qoftë se ndokujt do t'i shkonte mendja ta

merrte këtë në kuptimin e vjetër të fjalës, ai do të ishte i prapambetur dhe nuk do të ishte në gjendje ta zhvillonte punën e propagandës për masën e fshatarëve dhe të punëtorëve. Politika jonë kryesore tani duhet të jetë ndërtimi ekonomik i shtetit, që të mbledhim ca pud më shumë drithë, që të japim ca pud më shumë qymyr guri, që të vendosim se si mund të shfrytëzohen më mirë këta pud drithi dhe qymyr guri... Dhe mbi këtë bazë duhet të organizohet gjithë agjitacioni dhe gjithë propaganda»¹.

Në punën e saj ideologjike Partia jonë duhet të udhëhiqet nga këto mësimë të mençura të Leninit. Ne duhet të bëjmë me çdo kusht një përmirësim rrënjësor përsa i përket lidhjes së propagandës me praktikën, me jetën. Agjitorët, propagandistët, lektorët, gazetarët, arësimitarët dhe të gjithë punonjësit e tjerë të frontit ideologjik nuk duhet vetëm të shpjegojnë teorinë marksiste-leniniste dhe të propagandojnë tezat e saja mbi ndërtimin e socializmit, por ata duhet t'u japin anëtarëve të Partisë dhe punonjësve të vendit tonë ndihmë praktike, shembuj konkretë, vërejtje dhe këshilla të atilla, që t'u vlejné për të përvetësuar mirë ideologjinë e Partisë dhe për të përmirësuar vazhdimisht punën në fabrikë, në zyrë, në fshat e kudo.

Agjitor dhe propagandist i mirë i Partisë është ai që di jo vetëm të japë mësimë, të mbajë leksione dhe konferenca, por që njëkohësisht i ndihmon njerëzit të

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 424-425.

vënë në jetë mësimet e marksizëm-leninizmit, vendimet e Partisë dhe të qeverisë.

Në kushtet e sotme, kur vendi ynë po ndërton socializmin, kur përpara Partisë sonë qëndron detyra kryesore e shtimit dhe e përmirësimit të prodhimit, agjitacioni dhe propaganda e Partisë, me të gjitha mjetet dhe format e saja duhet të ndihmojë konkretisht në luftën për rritjen e rendimentit të punës, për uljen e kostos, për krijimin e të mirave materiale e kulture, për forcimin e ndërgjegjes komuniste të punonjësve.

Pra, në këtë drejtim duhet të përqëndrohen dhe të forcohen mjetet dhe format e ndryshme të agjitacionit dhe të propagandës së Partisë, për të ndihmuar në zbatimin konkret të vendimeve të saj. Kështu duhet të peshohet vlera e punës ideologjike të Partisë. Është e domosdoshme që të rishikohen me kujdes të gjitha programet e tanishme të edukimit, literatura që përdoret në përgatitjen e kuadrove dhe të merren masa rrënjësore që të sigurohet lidhja e shëndoshë e punës ideologjike të Partisë me jetën, me praktikën, me hallet dhe detyrat tona.

Një rëndësi shumë të madhe ka sot ana ekonomike e teorisë marksiste-leniniste në çështjet konkrete të ndërtimit të socializmit, në industri, bujqësi, tregëti, transport, ndërtim etj. Prandaj, shkenca ekonomike marksiste-leniniste, duhet të lidhet ngushtë me praktikën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë dhe të vihet në qendër të propagandës së Partisë. Vetëm kështu do ta forcojmë ndërgjegjen e lartë socialiste ndaj punës dhe pronës shoqërore, do ta organizojmë më mirë propagandën e prodhimit dhe emulacionin socialist, do ta

forcojmë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, baza e pushtetit tonë popullor.

Duhet të merren masa që kuadrot e Partisë dhe të shtetit të studjojnë ekonominë politike; për anëtarët e kooperativave bujqësore të hartohen programe të veçanta mbi problemet e bujqësisë, të drejtimit ekonomik të saj dhe mbi çështjet e organizimit dhe të funksionimit të kooperativave bujqësore. Pranë bibliotekave të Partisë të organizohen kurse, të cilat të kenë për qëllim t'u shpjegojnë kuadrove dhe propagandistëve të Partisë vendimet e Partisë dhe të qeverisë.

Në punën ideologjike të Partisë dhe sidomos në punën për zhvillimin e letërsisë dhe të arteve duhet që përmbajtja socialiste dhe forma nacionale të jenë dy gjëra të pandara për kulturën tonë të re. Detyra jonë kryesore është të zbulojmë, të zhvillojmë dhe të ngremë në një nivel më të lartë kulturën tonë nacionale dhe artin e mrekullueshëm të popullit tonë. Punonjësit e frontit tonë ideologjik, shkrimtarët, kompozitorët, arkitektët e të tjerë duhet të përfitojnë më shumë nga kultura sovjetike, nga ajo e popujve të demokracisë popullore e të popullit kinez dhe nga gjithshka që është e mirë dhe përparimtare në jetën dhe në kulturën e vendeve të tjera, por duhet të hiqet dorë nga shablonizmi dhe mënyra mekanike në zbatimin e eksperiencës së huaj. Me guxim dhe me vendosmëri punonjësit e frontit ideologjik duhet të orientohen drejt punës krijuese dhe formave origjinale, duke u frymëzuar nga historia e lavdishme dhe puna heroike e popullit shqiptar. Duhet të ndihmohen shkrimtarët e rinj, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmueshëm, por ata duhet të kuptojnë mirë

se veprat e tyre, po të shkëputen nga jeta dhe lufta e popullit dhe e Partisë, s'do të kenë shumë vlerë. Prandaj ata duhet të lidhen më ngushtë me masat që luftojnë, që krijojnë, që ndërtojnë socializmin. Duhet të ndihmojnë zhvillimin e folklorit tonë popullor. Muzikantët tanë popullorë të ndihmojnë në zhvillimin e dramës popullore, të baletit, të operas, të estradës etj. Është inkurajues zhvillimi që kanë marrë në vendin tonë arti, muzika, teatri etj. T'i çojmë akoma më përpara këto. Një rëndësi të madhe t'i vëmë arkeologjisë dhe të ndihmojmë më shumë arkeologët tanë në punën e tyre shumë të vlefshme në lëmin e historisë e të luftës së popullit tonë. Duhet të zgjerojmë rrjetin e kinemave tona dhe ta bëjmë atë një mjet edukues të rëndësishëm të masave punonjëse.

Për ta bërë punën ideologjike të Partisë sonë më të dobishme, më interesante dhe më luftarake dhe për t'i hapur rrugë të reja zhvillimit të shkencës, letërsisë, arteve dhe kulturës, Partia duhet të përkrahë në maksimum punën krijuese, iniciativat e mira, zhvillimin e diskutimeve të lira, kritikën dhe autokritikën. Po në të njëjtën masë Partia duhet të jetë vigjilente dhe të luftojë me vendosmëri pikëpamjet antimarksiste, kozmopolite dhe të dëmshme për shoqërinë tonë të re. Partia duhet të përhapë më mirë në masat fshatare njohuritë shkencore dhe të luftojë zakonet prapanike dhe të dëmshme që pengojnë zhvillimin e shoqërisë përpara.

Kujdes i madh i duhet kushtuar forcimit të shtypit dhe të radios. Shtypi ynë i kushton sot një vend të rëndësishëm trajlimit të problemeve ekonomike, po, për të luajtur një rol më të rëndësishëm në edukimin dhe

mobilizimin e masave në ndërtimin e socializmit, shtypi dhe radioja duhet të qëndrojnë më afër jetës, të zbulojnë me kohë gabimet dhe të metat në punë dhe të organizojnë në mënyrë sistematike përhapjen e eksperiencës së përparuar. Shtypi ynë duhet të jetë më i thjeshtë, më konkret dhe më shumë afër masave punonjëse.

Si në çdo fushë tjetër, ashtu edhe në lëmin e agjilacionit dhe të propagandës, udhëheqja e drejtë e Partisë është faktori kryesor për suksese të vazhdueshme dhe të mëdha. Gjatë periudhës që analizojmë, komitetet e Partisë në qarqe e në rrethe e kanë përmirësuar punën e tyre të drejtimit të propagandës. Megjithkëtë, ajo përsëri nuk është e kënaqshme. Komiteti Qendror i Partisë mendon se pas vendimit të Plenumit të Prillit 1955 duhej të ishte bërë më shumë për forcimin e punës ideologjike të Partisë. Ka raste që tregojnë shkujdesjen e organeve udhëheqëse për çështjet e agjilacionit dhe të propagandës. Në mjaft aktive e konferenca të Partisë që janë bërë muajt e fundit, puna politike dhe kulturele me masat u la krejt mënjanë, kurse ajo duhej të çmohej si një nga çështjet kryesore.

Drejtimi konkret i punës ideologjike të Partisë do të sigurohet, në qoftë se kuadrot kryesorë të Partisë dhe të shtetit do të heqin dorë nga metodat burokratike, në qoftë se ata marrin pjesë aktive dhe të drejtëpërdrejtë në jetën e shkollave, në format e arësimit të Partisë, në mbajtjen e leksioneve, të konferencave dhe të bisedave me masat e gjera. Një punë e tillë është e domosdoshme të fillohet me ritme të shpejta, sepse kjo do t'i shërbejë forcimit të lidhjeve me masat, do të ngrejë

prestigjin e Partisë dhe të komunistit, do të zhvillojë inisiativën dhe kritikën e autokritikën. Teoria marksiste-leniniste, arma më e fuqishme e Partisë sonë, e kuptuar mirë nga kuadrot dhe e zbatuar në mënyrë krijuese dhe jodogmatike, duke iu përshtatur realitetit të vendit tonë, do ta forcojë Partinë tonë dhe do të sigurojë ecjen përpara drejt socializmit.

Pra, duhet të forcohet dhe të konkretizohet më shumë drejtimi i punës ideologjike. Me atë kujdes dhe vullnet që do të përpiqemi të kryejmë detyrat tona ekonomike, duhet të kujdesemi njëkohësisht edhe për forcimin e agjitacionit dhe të propagandës së Partisë, duke e çmuar gjithmonë këtë si mjetin më të fuqishëm për edukimin komunist të masave dhe për mobilizimin e tyre në ndërtimin e socializmit...

Shokë,

Marksizëm-leninizmi na mëson se krijuesit e historisë janë popujt. Masat punonjëse, prodhuesit, janë krijuesit e vlerave materiale të shoqërisë dhe socializmi e komunizmi janë produkti i vetë masave punonjëse. Lenini i madh ka thënë në këtë drejtim se

«Të gjitha sukseset që ne kemi arritur tregojnë se ne mbështetemi në forcën më të mrekullueshme në botë — në forcën e punëtorëve dhe të fshatarëve»¹.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 166.

Marksizmi, duke përpunuar bazat e komunizmit shkencor, duke shpjeguar dhe argumentuar rolin historik botëror të klasës punëtore si ndërtuese pararojë e shoqërisë komuniste, bën një luftë të pamëshirshme kundër pikëpamjes se gjoja historia krijohet nga personalitetet e shquara. Marksizëm-leninizmi përballë këtyre pikëpamjeve të gabuara mbi historinë vuri doktrinën materialiste se populli është krijuesi i vërtetë i historisë dhe sa më të gjera që janë transformimet shoqërore, aq më të shumta janë masat popullore që marrin pjesë në to. Këtë e vërteton historia e revolucioneve të mëdha që bënë popujt e vendeve të ndryshme, si për shembull në Rusi, në Kinë, në vendet e demokracisë popullore etj., revolucione që kanë sjellë ndryshime të thella ekonomike, politike dhe shoqërore në rrugën e përparimit shoqëror. Ky kuptim i drejtë materialist i historisë përcaktoi gjithashtu drejt rolin e personaliteteve të shquara në histori, rolin e udhëheqësve të punonjësve në drejtimin e lëvizjes çlirimtare revolucionare në ndërtimin e një shoqërie të re. Rolin e personaliteteve marksizëm-leninizmi nuk e mohon, por e çmon drejt. Këto personalitete dalin nga gjiri i popullit, i krijojnë dhe i inkurajojnë popullin, ai i edukon dhe i bën të aftë për t'u shërbyer interesave shoqërore dhe këta mund të luajnë, pa dyshim, një rol të rëndësishëm në përparimin shoqëror si organizatorë dhe udhëheqës masash.

Themeluesit e komunizmit shkencor, kanë luftuar me të gjitha forcat dhe në të gjitha trajtat e tija shfaqjet e kultit të individit, si thellësisht të huaja, të pavlefshme dhe të dëmshme për marksizmin.

Kulti i individit do të thotë ekzaltimi i tepruar i individëve, dhënia atyre e karakteristikave dhe e cilësive të mbinatyrshe, shndërrimin e tyre në njerëz që bëjnë mrekullira dhe më në fund gjunjëzimi përpara tyre. Këto koncepte jo të drejta, jomarksiste mbi individin janë të huaja e të dëmshme për marksizëm-leninizmin.

Partia e Punës e Shqipërisë ka kritikuar në rrugën marksiste shfaqjet e mbivlerësimit të rolit të personaliteteve dhe të udhëheqësve, sepse ato dobësojnë rolin e Partisë, të bazës së Partisë e të masave dhe krijojnë, deri në një farë shkalle, pikëpamjen e «pagabueshmërisë së udhëheqësve».

Kulti i individit është një mbeturinë e kalbur dhe prodhim i klasave shfrytëzuese e i prodhuesve të vegjël. Duke e shikuar çështjen në këtë drejtim dhe duke marrë parasysh kushtet shoqërore të vendit tonë, ku çështja e trimërisë individuale, e heronjve, vihet lehtë mbi heroizmat e masave të popullit, që kanë luftuar gjatë shekujve për pavarësinë e atdheut, kulti i individit nxit nga njëra anë në të gjitha hallkat e Partisë dhe të pushtetit mendjemadhësinë dhe arrogancën në kuadrot e elementët akoma jo të kalitur dhe jo të edukuar si duhet me frymën marksiste-leniniste, krijon në këta kuadro, ku më shumë e ku më pak, ndjenjën e kryelartësisë së sëmurë, të mburrjeve, të veprimeve arbitrare, zhvillon sedrën e sëmurë mikroborgjeze dhe ndjenjën e epërsisë e të pagabueshmërisë së tyre, nga ana tjetër dobëson udhëheqjen kolegjiale të Partisë në të gjitha hallkat e saja, dobëson kritikën e shëndoshë parimore e autokritikën dhe largon udhëheqjen nga masat.

Komiteti Qendror i Partisë sonë vazhdimisht ka ngritur zërin që t'i jepej fund çdo shfaqjeje të dëmshme dhe jomarksiste të kultit të individit. Në raportin e mbajtur në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë të 12 Korrikut 1954 thuhet:

«Në Komitetin Qendror dhe në instancat e tjera udhëheqëse të Partisë sonë ka ekzistuar shpirti i kolegjalitetit dhe është luftuar vazhdimisht që puna kolegjiale të forcohet çdo ditë. Shokët e Byrosë Politike kanë rastin t'i thonë Komitetit Qendror se për shumë herë rresht përpara Byrosë Politike dhe shokëve të tjerë të udhëheqjes, Sekretari i Përgjithshëm e ka shtruar kurdoherë drejt çështjen e dëmeve që sjell kulti i individit dhe ka kërkuar që t'u jepej fund një herë e përgjithmonë disa manifestimeve të tepruara që janë shfaqur në praktikën e jashtme nga masat e popullit ndaj personit të tij, siç janë thirrjet me skandencë të emrit të tij, ngritja e busteve nëpër qytete, vënia pa rast dhe pa arsye e fotografive të tija në gazeta dhe revista dhe ndonjë shfaqje tjetër e këtij lloji. Po e vërteta është të thuhet se këto çështje që ai i shtronte në bazë të parimeve leniniste në mjaft raste janë marrësi shfaqje të thjeshtësisë së karakterit të tij. Tani është e nevojshme që Komiteti Qendror të orientojë Partinë në radhë të parë, që t'i japë fund një praktike të tillë»¹.

Është një detyrë me shumë rëndësi për Partinë tonë të luftojë në të gjitha instancat e saja për respekti-

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 11, f. 452-453.

min me rreptësi të parimit të kolegjalitetit në udhëheqje dhe për respektimin e plotë të normave leniniste të Partisë. Të zhvillohen në rregull dhe të karakterizohen nga një frymë luftarake marksiste-leniniste mbledhjet e organizatave bazë të Partisë, ato të byrove dhe të komiteteve, aktivet dhe konferencat e Partisë. Partia dhe gjithë deputetët e këshilltarët të luftojnë për afrimin e pushtetit sa më shumë me masat, për demokratizimin sa më shumë të tij. Partia të luftojë me të gjitha fuqitë për respektimin me rreptësi të Kushtetutës dhe të ligjshmërisë, të luftojë burokratizmin dhe çdo element që-ndihmon në ngjalljen e kultit të individit. Komunisti më i thjeshtë duhet të kuptojë qartë se zhvillimi i kultit të individit do të thotë dobësimi i rolit drejtues të Partisë, dobësimi i drejtimit kolegjal të udhëheqjes, dobësimi i kritikës ndaj gabimeve të njerëzve që i bëjnë ato, dobësimi i autokritikës dhe zhvillimi i veseve të huaja te komunistët, si mendjemadhësia, arroganca, vetëkënaqësia, ndjenja e pagabueshmërisë etj. Partia s'duhet të lejojë që të errësohet roli i masave punonjëse në historinë e popullit tonë dhe ai i Partisë si udhëheqëse e tyre. Ajo duhet ta kalitë pa pushim ndërgjegjen socialiste te njerëzit tanë me anë të kudhrës së Partisë. Ndërgjegjia dhe veprimet e komunistëve duhet të përputhen plotësisht me frymën e doktrinës marksiste-leniniste, me direktivat, me vendimet dhe me Statutin e Partisë.

Armiqtë e çdo lloji do të përpiqen në çdo mënyrë të dobësojnë zbatimin e normave leniniste në jetën e brendshme të Partisë, ata do të përpiqen t'i shfrytëzojnë në interesin e tyre gabimet dhe autokritikat e

Partisë dhe të komunistëve. Presioni i borgjezisë dhe i mbeturinave mikroborgjeze e kapitaliste në ndërgjegjen e njerëzve do të sulmojë. Kundrejt tyre Partia duhet të jetë vigjilente dhe t'i luftojë pa mëshirë se qëllimi i këtyre armiqve mbetet kurdoherë përçarja e unitetit të radhëve të Partisë, dobësimi i saj dhe, më në fund, shkatërrimi i saj.

Partia duhet ta forcojë vigjilencën revolucionare, sepse armiku punon pa pushim për ta vënë në gjumë vigjilencën e anëtarëve të Partisë. Armiku përpiqet të zhvillojë te komunistët ndjenjën e rreme të qetësisë, të zbutjes së kritikës dhe të autokritikës bolshevike. Do të ketë elementë jo të shëndoshë, të cilët deri sot kanë çaluar rëndë në rrugën e Partisë dhe janë lëkundur në mbrojtjen e parimeve leniniste që udhëheqin Partinë tonë, që do t'i nxjerrin brirët e dobësive të tyre në punë dhe në kuptimin e vijës së Partisë dhe që mund të mendojnë se tani duhet të ndërrojë disiplinën e Partisë, vigjilencën e Partisë dhe se çdo gjë të zëvendësohet, sipas pikëpamjeve të tyre, me një butësi oportuniste në vijë, me një shuarje të luftës së klasave etj. Do të ketë të tjerë që do të mendojnë se tani gabimet dhe fajet e rënda që kanë bërë përpara Partisë dhe popullit u duhen fshirë. Të tjerë marksistë të orës 11, do të mendojnë se tani, nën maskën e demokracisë mund të shqelmojnë demokracinë e vërtetë të Partisë dhe të dobësojnë disiplinën e hekurt të saj. Partia duhet të zhvillojë një luftë të pamëshirshme kundër këtyre njerëzve dhe të jetë shumë vigjilente kundër shfaqjeve oportuniste dhe rreziqeve të djathtizmit.

Përsa i përket luftës së klasave, sigurisht, neve

nuk na lejohet ta dobësojmë vigjilencën, por ne nuk jemi as për ta nxitur e ashpërsuar atë artificialisht. Lenini na mëson se

«Diktatura e proletariatit është një formë e veçantë aleance klase midis proletariatit, si pararojë e punonjësve, dhe shtresave të shumta jo-proletare të punonjësve (borgjezia e vogël, pronarët e vegjël, fshatarësia, inteligjencia etj.). . .»¹.

Duke e pasur parasysh kurdoherë këtë mësim të Leninit të madh, Komiteti Qendror i Partisë sidomos këto kohët e fundit, në konferencat e Partisë të rretheve ka sqaruar se kuptimi i ngushtë mbi ashpërsimin e vazhdueshëm të luftës së klasave në etapën e ndërtimit të socializmit nuk është i drejtë. Jeta provon se përherë e më shumë rriten forcat e socializmit, ndërsa shkon duke u dobësuar baza ekonomike e influenca politike e klasave të përmbysura dhe ato nuk janë në gjendje ta çojnë zhvillimin e luftës së tyre drejt formave gjithnjë më të ashpra. Kjo, sigurisht nuk do të thotë aspak se lufta e klasave shuhet dhe se klasat e përmbysura heqin dorë vullnetarisht nga lufta. Pa dyshim, ato ndërrojnë format e luftës së tyre, por kjo luftë tani nuk është më e ashpër nga sa që në vitet e para pas çlirimit, kur klasat e përmbysura kishin një bazë më të mirë ekonomike, kishin akoma influencë politike dhe

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 422-423.

lidheshin me reaksionin e jashtëm, duke pasur gjithë ndihmën e tij.

Lufta e komunistëve për mbrojtjen e parimeve të drejta të Partisë duhet të jetë detyra më e rëndësishme në punën tonë të përditshme.

Duke gjykuar dhe interpretuar nga pozitat anti-parti, antimarksiste, revizioniste dhe karrieriste zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu, të cilët morën dënimin e merituar nga Partia, kanë pasë formuar bindjen se duhej përmbysur vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë e të zëvendësohej ajo me një vijë të përgjithshme oportuniste, trockiste, nacionaliste borgjeze dhe kapitulluese. S'ishte hera e parë që këta dy elementë shfaqnin pikëpamje thellësisht oportuniste në jetën e tyre në Parti. Ndihma që u është dhënë atyre vazhdimisht nga Partia, nuk u kishte shërbyer dhe ata, duke shkelur çdo parim organizativ të Partisë, shkuan deri atje sa u orvatën të përçanin unitetin e udhëheqjes, të denigronin këtë udhëheqje, të përçanin unitetin e Partisë, duke mbrojtur tezat armiqësore, si revizionimin e vijës së Partisë në lidhje me vendimet historike të spastrimit të radhëve të Partisë nga elementët trockistë, antiparti dhe armiq, duke dashur të reviziononin vijën e Partisë në drejtimin e shuarjes së luftës kundër tendencave anti-parti. Këta elementë ishin për një bashkëjetesë paqësore me tendencat antiparti në gjirin e Partisë dhe për shndërrimin e Partisë sonë marksiste-leniniste në një parti borgjeze oportuniste.

Partia ka mbrojtur dhe do të mbrojë me të gjitha forcat parimet e marksizëm-leninizmit që përbëjnë for-

cën dhe jetën e Partisë sonë, të ardhshmen dhe sigurimin e popullit shqiptar. Partia jonë do ta ashpërsojë dhe nuk do ta dobësojë luftën kundër tendencave oportuniste dhe deviatore të çdo kallëpi dhe nën çdo maskë që të paraqiten ato.

Kohët e fundit disa elementë me origjinë borgjeze dhe intelektualë të sëmurë, me pikëpamje antiparti dhe kundër forcimit të pushtetit popullor dhe ndërtimit të socializmit në vendin tonë, të ushqyer nga propaganda shpifëse dhe armiqtësore e huaj, u përpoqën në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës të luftonin Partinë e Punës të Shqipërisë, vijën dhe udhëheqjen e saj. Këta aventurierë që kishin hyrë kontrabandë në Parti, që kishin gabuar shumë herë në vijën e Partisë, që s'u pëlqente ecja e pandërprerë e vendit tonë drejt socializmit, duke menduar se gjendja ndërkombëtare ishte në favorin e tyre e duke marrë dëshirat e tyre për realitet në drejtim të kapitullimit të Partisë sonë përpara propagandës armike ose elementëve të lëkundshëm, luftuan dhe u përpoqën që Partia jonë të njohë veprimtarinë armiqtësore, antiparti, antipushtet, trockiste e revizioniste të grupeve ose të individëve të ndryshëm që janë dënuar me të drejtë nga Partia, si një veprimtari të drejtë patriotike, në vijën marksiste-leniniste.

Është e kuptueshme se këta elementë antiparti s'janë veçse vazhdimi i vargut të grupeve ose të individëve antiparti dhe kundër pushtetit popullor që Partia jonë i ka flakur jashtë me kohë. Këta s'kanë asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin, me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me popullin tonë. Lufta pa-

rimore e Partisë, sukseset e saj në të gjitha aktivitetet e jetës së vendit, lufta heroike e popullit tonë, i cili i udhëhequr nga Partia po ndërton me sukses socializmin, do të bëjnë që në çdo çast e në çdo etapë të dalin elementë të tillë aventurierë, karricistë, armiq që përpiqen të frenojnë ecjen përpara të shoqërisë sonë socialiste. Ky është ligji i kontradiktave. Në këtë luftë gjithnjë fitorja do të jetë e Partisë dhe e popullit. Këta elementë antiparti, edhe kur sulmojnë Partinë nga pozitrat e tyre antiparti, edhe kur grushti i drejtësisë së Partisë bie mbi ta, përdorin dhe do të përdorin demagogjinë, shpifjet, do të ulurijnë ose do të rënkojnë «se u shkel demokracia, u shkel liria e fjalës, u përdorën masa arbitrare» etj.

Kanë një eksperiencë të madhe partitë marksiste-leniniste nga të tilla veprime të këtyre hipokritëve të shekullit të triumfit të marksizëm-leninizmit. Elementët antiparti që nxorën veshët në Konferencën e Tiranës, pretenduan për marrëdhënie miqësore me Jugosllavinë.

Këta elementë antiparti që u shfaqën në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës, duke ëndërruar se ishte çasti i përshtatshëm, me fraza bombastike për të çorientuar konferencën, filluan të flasin për normat leniniste të Partisë sonë: për demokracinë e brendshme, për kritikën dhe autokritikën, për disiplinën, për unitetin dhe kolegjalitetin e udhëheqjes. Por konferenca shumë shpejt i vuri në vend gjërat, ajo zbuloi dhe demaskoi gjithë veprimtarinë e tyre. Ata pohuan me gojën e tyre se kishin shqelmuar me një përbuzje prej antimarksisti të gjitha normat leniniste të Partisë sonë

që i reklamoni aq shumë. Ata guxuan në konferencë, jo vetëm t'i errësonin, por edhe t'i mohonin sukseset e mëdha ekonomike në ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe këtë falsifikim, këtë shpifje ose më mirë të themi këtë tezë të radios «Zëri i Amerikës» dhe të të gjithë propagandës së reaksionit ndërkombëtar kundër Shqipërisë, ata e përdorën për të luftuar e për të diskredituar Partinë heroike të Punës të Shqipërisë, vijën e saj të drejtë dhe Komitetin Qendror leninist të saj, ashtu si «Zëri i Amerikës» dhe qindra stacione të radiove Perëndimore.

Sigurisht, po këto radio do të fillojnë britmat për të mbrojtur pasuesit e tyre të zellshëm që hëngrën grushtin e merituar nga Partia jonë, ata do të çirren së thëni se në Shqipëri «ka terror, kurse në vendet e tjera po rehabilitohen njerëz që ishin dënuar gabimisht». Kjo s'do të gënjejë njeri. Partia jonë s'ka pasur kurrë frikë t'i njohë gabimet e saj, kur këto vërtetohen në jetë dhe kështu do të ngjasë edhe në të ardhshmen. Njohja e gabimeve do të thotë ndreqja e mospërsëritja e tyre, do të thotë ecja përpara me sukses në socializëm dhe në komunizëm. Ky është ligji i Partisë sonë, vetëm kështu forcohet Partia, dhe pse ka vepruar kështu është e fortë Partia jonë dhe gëzon dashurinë e pakufishme të popullit të vet.

Shokë, ajo që ngjau në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës duhet të bëhet një mësim i madh për gjithë Partinë. Por duhet theksuar se kësaj pune armiqësore i dha shkas dhe fushë veprimi puna shumë e dobët dhe pa perspektivë e byrosë provizore të Komitetit të Partisë për qytetin e Tiranës. Komitetin e

Partisë për qytetin e Tiranës dhe sidomos byronë provizore të tij, me të gjithë sekretarët e komitetit, i kishte mbuluar një punë çikërrimash, një punë burokratike e theksuar. Sekretarët e komitetit dhe anëtarët e byrosë provizore ishin shkëputur nga puna e gjallë e Partisë dhe e masave. Ata e kishin zëvendësuar punën me masat me një punë shkresurash e evidencash statistikore, kishin krijuar një frymë të sëmurë familjariteti në byro e në komitet, me një kritikë dhe autokritikë formale. Ata nuk njihnin jetën reale të organizatave, ku elementët e sëmurë, të lëkundshëm dhe armiq të vjetër të Partisë përfituan dhe punuan kundër saj. Këta elementë shfrytëzuan dobësitë, mungesat e vështirësitë në punën e Partisë për të thyer disiplinën, kritikën e autokritikën, për të dobësuar vigjilencën e Partisë dhe luftën e saj.

Duhet forcuar lufta në organizatat bazë dhe në hallkat drejtuese të të gjithë Partisë, për ta bërë Partinë tonë akoma më luftarake; të forcohet përgjegjësia te komunistët, të forcohet disiplina e Partisë dhe çështjet e Partisë të mos bëhen muhabet rruge; të forcohet kritika dhe autokritika dhe të luftohet pa mëshirë formalizmi dhe familjariteti në këtë drejtim. Të ruhet konspiracioni i shëndoshë dhe të ruhen si sytë e ballit sekretet e shtetit. Komunistët të dinë t'i njohin elementët armiq ose me tendencë të huaja që, nën maskën e demokracisë së Partisë, kërkojnë ta shpërdorjnë këtë në dëm të Partisë. Kundër këtyre shtrembëruesve të demokracisë të përdoret demokracia e vërtetë e Partisë, për t'i demaskuar dhe për t'i dërmuar ata.

Komunistët, kudo që janë, kudo që punojnë, duhet

të lidhen ngushtë me masat, me punën e gjallë dhe të jenë shembull pune dhe luftëtarë të ashpër kundër burokratizmit.

Partia jo vetëm që demaskoi veprimtarinë e theksuar antiparti të disa elementëve që u shfaqën në Konferencën e Partisë për qytetin e Tiranës, por edhe mësoi nga gabimet e saj. Këto gabime të na bëhen mësim për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë.

Uniteti politik, ideologjik dhe organizativ i Partisë duhet të ruhet si sytë e ballit, sepse armiqtë e Partisë dhe të popullit shqiptar do të synojnë me të gjitha mjetet ta shkallmojnë këtë unitet. Me siguri e si kurdoherë, ata do të dështojnë, sepse Partia jonë është më e fortë se kurrë dhe ka një eksperiencë të madhe nga lufta që ajo ka bërë vazhdimisht, kundër deviatorëve dhe fraksionistëve.

Në analizën e thellë që u bëri Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, mbajtur më 10 e 11 maj 1956, të gjitha çështjeve të Partisë dhe veçanërisht, masave që janë marrë kundër të gjitha grupeve dhe elementëve antiparti e deviatorë, rezultoi se këto kanë qenë plotësisht të drejta. Veprimtaria e Koçi Xoxes dhe e shokëve të tij ishte armiqtë kundër Partisë dhe shtetit. Koçi Xoxe dhe shokët e tij krijuan dhe vunë në veprim një nga fraksionet më të rrezikshme kundër Partisë, fraksion që synonte përçarjen e unitetit dhe likuidimin e Partisë. Koçi Xoxe e vuri veprimtarinë e Partisë nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit, përgatiti likuidimin politik dhe fizik të udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit, shkeli egërsisht ligjshmërinë shtetërore etj. Akuzat kundër Koçi Xoxes dhe shokëve të tij janë plotësisht të

faktuara dhe dënimi i tyre nga Partia dhe shteti ynë ka qenë plotësisht i drejtë.

Këto vendime të drejta janë marrë në mënyrë kolegjiale nga plenumet e Komitetit Qendror, nga kongreset, konferencat dhe aktivet e Partisë. Këto vendime të drejta kanë marrë aprovimin e plotë të Partisë, për arsye se kanë qenë të bazuara në normat leniniste dhe të argumentuara me fakte.

Partia jonë marksiste-leniniste nuk ka gabuar, sepse është udhëhequr drejt nga Komiteti Qendror, sepse ajo ka qenë kurdoherë kompakte, sepse në çdo gjë e në çdo hap ajo është udhëhequr nga interesat e larta të popullit tonë dhe e ka ndërtuar vijën e saj të përgjithshme mbi bazat e marksizëm-leninizmit e të eksperiencës së Partisë Komuniste të lavdishme të Bashkimit Sovjetik, politika leniniste e së cilës ka qenë kurdoherë e drejtë.

Shokë,

Për forcimin organizativ dhe për kalitjen e mëtejshme ideo-politike të Partisë sonë dalin këto detyra:

1. — Të forcohet dhe të gjallërohet akoma më shumë jeta e brendshme e Partisë; të zbatohen pikë për pikë normat leniniste të jetës së Partisë; të përmirësohet përbërja e saj, duke synuar që përqindjen dërmuese të atyre që do të pranohen në Parti ta zenë punëtorët; të forcohet demokracia e brendshme e Partisë, të forcohet kritika dhe autokritika e sidomos kritika nga poshtë, të goditet me forcë çdo shfaqje për ta

shpërdoruar demokracinë e Partisë në dëm të Partisë; të forcohet disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme e Partisë.

2. — Të përmirësohet puna drejtuese dhe të forcohet roli udhëheqës i organeve dhe i organizatave të Partisë në gjithë jetën e vendit. T'u jepet fund drejtimit në mënyrë të përgjithshme e metodave administrative dhe burokratike në punën drejtuese të Partisë. Organizatat e Partisë të studjojnë më me kujdes ekonominë dhe teknikën e ndërmarrjeve të ndryshme, që të mund të udhëheqin me kompetencë punën e tyre. Të përmirësohet puna e kontrollit të Partisë për zbatimin e vendimeve, si edhe puna për zgjedhjen, edukimin dhe vendosjen e kuadrove. Të shpërndahen më drejt forcat e Partisë, duke pasur parasysh shtimin e numrit të komunistëve që punojnë në prodhim.

3. — Të forcohen lidhjet e Partisë me masat; të përmirësohet puna për mobilizimin më të madh të organizatave të masave, në mënyrë të veçantë të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, të Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, për zgjidhjen e detyrave të ndërtimit socialist; të rritet kujdesi për edukimin komunist të masave.

4. — Të ngrihet niveli i punës ideologjike në Parti; të lidhet më mirë puna e propagandës së Partisë me detyrat konkrete të ndërtimit të socializmit; të luftohen me forcë mbeturinat e ideologjisë borgjeze dhe mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve; të përmirësohet puna e shtypit, e radios, e institucioneve kulturalo-artistike, e letërsisë etj.

Shokë,

Populli shqiptar po ecën në vitin e dymbëdhjetë të çlirimit. Ai korri fitoren e madhe historike të çlirimit, pse u udhëhoq nga Partia e lavdishme Komuniste e Shqipërisë. Dymbëdhjetë vjet kanë kaluar nga dita kur Ushtria heroike Nacional-Çlirimtare hyri ngadhënjimtare në kryeqytetin e atdheut tonë. Gjatë gjithë kësaj periudhe populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij besnike, ka luftuar e ka punuar me këmbëngulje e me heroizëm për të ndërtuar atdheun, për të ndërtuar socializmin, për të ndërtuar një jetë më të lumtur dhe të begatshme për njerëzit e vendit tonë. Kjo rrugë e lavdishme që ka përshkuar populli ynë, s'ka qenë e shtruar me lule, por ka qenë një rrugë shumë e vështirë, plot me pengesa. Popullit dhe Partisë u është dashur të luftojnë në të gjitha frontet, kundër mjerimeve dhe shkatërrimeve të luftës, kundër urisë, prapambetjes, kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Por fakti është se populli dhe Partia jonë, kurrë s'u përkulën përpara vështirësive të panumërta, kurrë nuk u trembën nga sulmet e armiqve, por i thyen këta, triumfuan mbi vështirësitë dhe mbi armiqtë dhe ecën kurdoherë përpara. Vendi ynë, ishte vendi më i mjeruar, më i varfër i Evropës. Imperialistët, fashistët, bejlerët, feudalët dhe tregëtarët ia kishin pirë gjakun popullit shqiptar, e kishin katandisur në pikën e hallit. Lufta shkatërroi edhe atë që kishte mbetur në këmbë. Çdo gjë duhej ndërtuar nga e para. Pa sakrifica, pa heroizma nga ana e popullit, pa udhëheqjen e drejtë

dhe të guximshme të Partisë, asgjë s'mund të ndërtohej.

Kundër këtyre përpjekjeve vigane të popullit, armiku përdori të gjitha forcat e tija djallëzore: terrorin, komplotet, sabotimet, kërcënimet e demagogjinë. Ata që deri dje kishin rjepur, vrrarë e djegur popullin dhe Shqipërinë, i qanin hallin popullit që gjoja jettonte keq e që i mungonte çdo gjë, që gjoja punët nuk shkonin mirë e që jeta e popullit nuk përmirësohej etj. Por populli atyre ua ka dhënë kurdoherë përgjegjen e merituar, sepse populli që luftoi dhe derdhi gjak e dinte mirë se kush ishin shkaktarët e këtij mjerimi dhe e dinte gjithashtu se kush do t'i dilte për zot vendit. Parazitët dhe shushunjat janë mësuar të rrojnë në kurrizin e të tjerëve, kurse populli e dinte se pas fitores së lirisë, duhej të ndërtonte vetë jetën e tij. Shtëpia e djegur nuk ndërtohet në një ditë, ekonomia e shkatërruar nuk mëkëmbet në një kohë të shkurtër dhe përmirësimi i jetës së popullit do të bëhej gradualisht, do të bëhej me mundime, me lodhje, me djersë, me sakrifica, siç u bë. Kurrë Partia nuk i ka thënë popullit se bollëku do të bjerë nga qiejt dhe çdo gjë do të rregullohet duke hapur një kyç. Me punë të palodhur do të ngjiten një nga një shkallët e përparimit në rrugën e socializmit e të komunizmit. Dhe përparime kolosale janë bërë në zhvillimin e ekonomisë sonë popullore, në përmirësimin e jetës së popullit. Sukseset e arritura në të gjitha fushat e jetës së vendit tonë mbushin me entuziazëm, me gëzim, me shpresa dhe me besim zemrat e punonjësve të Shqipërisë së re. Këto janë disfata për armiqtë, të cilët janë vrerosur

dhe janë egërsuar. Ne vazhdojmë të kemi shumë mungesa, të hasim në vështirësi. Këto nuk i fshehim, përkundrazi luftojmë t'i zhdukim dhe do t'i zhdukim. Pikërisht për këtë hartohen planet tona pesëvjeçare të cilat kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të jetesës së të gjithë punonjësve të Shqipërisë. Në asnjë vend ku ndërtohet socializmi bollëku nuk ka zbritur nga qiejt, atë e ka krijuar puna ndërtuese e masave. Por epërsia e sistemit socialist mbi atë kapitalist, nuk mund të mohohet. Në vendet ku sundon kapitali mbretërojnë mjerimi, vuajtjet e papunësia. Atje ka bollëk vetëm për pasanikët.

Në vendin tonë, si në të gjitha vendet ku ndërtohet socializmi, qëllimi kryesor është që të gjitha masat punonjëse dhe jo disa të përfitojnë nga të mirat e kësaj toke dhe nga frutet e punës së përbashkët. Është lehtë të ushqesh disa frymë, por të ngresh nivelin e jetesës së një populli të tërë, kjo është një detyrë e lavdishme dhe jo aq e lehtë siç mendojnë disa mendjelehtë. Një industri të tërë moderne ka ngritur populli shqiptar; një revolucion i madh po bëhet në bujqësinë tonë të prapambetur, e cila nga viti në vit po shton prodhimet; një përmbysje rrënjësore është bërë në arësimin dhe në kulturën e popullit. Vetëm armiqtë dhe qorrat s'duan ta njohin këtë, ata e kanë helmin në majë të gjuhës.

Të gjitha këto përparime të mëdha, që janë bërë nga puna frutdhënëse e popullit tonë, janë një bazë e fuqishme për të bërë hapa akoma më të mëdhenj përpara. Na është dashur të bënim kursime, na është dashur të bënim dhe na duhet të vazhdojmë të bëjmë

edhe për një kohë sakrifica. Jemi të shtërnguar të mbajmë edhe për një kohë sistemin parazitarr të triskëtimit. Por populli dhe Partia e tij, me besim të madh në punën dhe në politikën e drejtë të tyre, do t'i zhdukin pengesat. Gjallëria e madhe e popullit dhe drejtësia e vijës së Partisë do t'i shëmbin njëra pas tjetrës të gjitha pengesat që do të ndeshin në rrugë, do t'i dërmojnë të gjitha përpjekjet e armiqve të popullit që do të përpiqen të vënë gurë në rrotat e punës sonë krijuese.

Shqipëria e vogël, si një shkëmb graniti, u qëndroi furtunave që i turreshin nga jashtë dhe nga brenda. Vetëm ky fakt tregon, në mes të shumë të tjerave, forcën e madhe të popullit tonë, drejtësinë e vijës së Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë.

Sukseset e korrura nga populli shqiptar në lëmin politik, ekonomik dhe kultural tregojnë sa i lidhur e sa monolit është populli ynë rreth Partisë dhe qeverisë së tij. Armiqtë e çdo kallëpi s'kanë mundur të gjejnë dhe s'do të gjejnë kurrë asnjë të çarë në mes të popullit e të Partisë dhe prandaj kurdoherë kanë thyer kokën. Një fenomen i tillë nuk është i rastit. Ai shpjegohet vetëm me faktin se politika e Partisë dhe e qeverisë sonë shpreh e realizon me sukses dëshirat dhe vullnetin e popullit heroik shqiptar.

Partia jonë është e lidhur si mishi me thuan me popullin dhe këtu e ka burimin forca e drejtësia e saj. Partia jonë frymëzohet dhe do të frymëzohet në çdo hap të saj nga idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit dhe këtu qëndron forca dhe pjekuria e saj.

E brumosur me idetë e marksizëm-leninizmit, e dalë nga gjiri i popullit të vuajtur, e kalitur në luftërat për mbrojtjen e interesave të popullit, Partia e Punës e Shqipërisë është më e fortë se kurrë, është plot gjallëri, luftarake dhe e çon popullin shqiptar me vendosmëri drejt jetës së lumtur, drejt socializmit.

Partia e Punës e Shqipërisë, që shpreh vullnetin e pathyeshëm të popullit, e lidhi popullin tonë me një miqësi vëllazërore me Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, me vendet e demokracisë popullore, me Kinën e madhe. Një e ardhshme akoma më e ndritur e më e begatshme e pret popullin shqiptar në rrugën që i hapi njerëzimit Partia e lavdishme e bolshevikëve dhe Lenini i madh. Populli ynë punëtor dhe paqedashës po ndërton socializmin. Ai ka mbrojtës besnikë e të fuqishëm që e duan, e respektojnë dhe e ndihmojnë. Populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e lavdishme e Punës së Shqipërisë po ecën përpara me vrull në rrugën e socializmit, me besim të madh në forcat e tija, në drejtësinë e rrugës së tij, në drejtësinë e politikës paqësore të kampit të socializmit, pjesëtar i të cilit ai është.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 126 (2395), 26 maj 1956

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALA E MBAJTUR NË SEANCËN E MBYLLJES SË KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

3 qershor 1956

Shokë,

Më lejoni që në emër të shokëve të Komitetit Qendror që u zgjodh nga Kongresi III i Partisë t'ju falenderoj, shokë delegatë, për besimin e madh që treguat ndaj nesh, duke na zgjedhur në udhëheqjen e Partisë. Ky është një nder i madh që na bëhet. Ne i premtojmë Partisë sonë të dashur se do t'i kryejmë me nder, deri në fund, detyrat që na ngarkohen. Me besnikërinë më të madhe dhe pa u lodhur asnjë çast, ne do të shkrijmë të gjitha energjitë tona për kauzën e lavdishme të Partisë dhe të popullit, do të ruajmë me vigjilencën më të madhe interesat e shenjta të Partisë dhe të popullit tonë. Ne do të punojmë dhe do të luftojmë pa u lodhur, ashtu siç na mëson Partia dhe doktrina e saj e pavdekshme, marksizëm-leninizmi, për të çelnikosur edhe më shumë unitetin e Partisë, normat leniniste të saja, unitetin e çelniktë të popullit tonë heroik rreth Partisë së tij të Punës. Ne do të luftojmë me të gjitha forcat që ta

ruajmë, si kurdoherë, pastërtinë e radhëve të Partisë, ta kalitim atë akoma më shumë, ta ngremë akoma më lart nivelin e saj ideo-politik dhe aftësitë organizative të saja, ta bëjmë atë akoma më të zonjën, më dinamike, për rolin e saj të lavdishëm, për misionin e saj historik, si udhëheqëse e popullit tonë në ndërtimin e socializmit.

E gjithë Partia dhe udhëheqja e saj do të frymëzohen, si kurdoherë, në çdo çast dhe në çdo veprim, nga idetë e lavdishme të marksizëm-leninizmit, do t'u qëndrojnë besnike këtyre deri në fund dhe do të luftojnë pa mëshirë kundër të gjithë atyre që do të orvaten të dëmtojnë Partinë, popullin dhe Republikën tonë popullore.

Partia jonë do të frymëzohet dhe do të mësojë vazhdimisht nga eksperiencia e Partisë së lavdishme Bolshevike. Partia Komuniste që themeloi Lenini i madh, partia e Leninit që ndërtoi shtetin e parë socialist në botë dhe i hapi njerëzimit një epokë të re, epokën e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, që udhëhoqi popujt sovjetikë në luftën legjendare patriotike, që shkatërroi fashizmin e u dha një sërë popujve të Evropës e të Azisë ndihmën vendimtare për t'u çliruar përgjithmonë nga zgjedha fashiste, është dhe do të mbetet përjetë në zemrën e Partisë dhe të popullit tonë.

Ditë të paharrueshme janë këto për popullin tonë kur ai sheh se, në saje të Partisë së tij të dashur që e çliroi përgjithmonë nga robëria, e udhëhoqi në luftën më heroike që ka bërë populli shqiptar dhe tani e udhëheq atë në rrugën e begatisë e të socializmit, ai ka miq të shumtë, të fuqishëm, miq besnikë që e duan, e ndihmojnë dhe e mbrojnë.

Forca madhështore ka frymëzuar dhe frymëzon marksizëm-leninizmi, i cili vëllazëron popujt, i bën këta të duhen si fëmijët e një nëne, të ecin së bashku për ndërtimin e jetës së lirë dhe të lumtur, të luftojnë së bashku për triumfin e paqes në botë. I fuqishëm është kampi i socializmit dhe i paqes që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik.

Partia jonë dhe populli shqiptar janë krenarë dhe të lumtur që, në këto çaste historike për vendin tonë, kanë në gjirin e tyre përfaqësuesit e partive komuniste dhe punëtores të Bashkimit Sovjetik, të vendeve të demokracisë popullore të Evropës dhe të Azisë, të Francës, Spanjës, Austrisë, Siri-Libanit, të Turqisë. Ne i falenderojmë edhe një herë për zemërsisht përfaqësuesit e këtyre partive, si edhe të gjitha partitë e tjera komuniste dhe punëtores të shumë vendeve të botës që me telegramet e tyre i urojnë suksese Partisë sonë. Miq të dashur, ne ju jemi mirënjohës partive tuaja, ju e ndihmuat Partinë dhe popullin tonë, ju u dhatë atyre forca, kurajë dhe besim në punën paqësore të ndërtimit të socializmit. Ndjenjat e thella të internacionalizmit proletar, na frymëzojnë, na lidhin e na bashkojnë.

Shokë,

Kongresi III i Partisë aprovoi unanimitisht vijën e përgjithshme që ka zbatuar Partia gjatë periudhës që u analizua dhe shprehu kompaktësinë e plotë të Partisë rreth Komitetit Qendror të saj.

Kongresi III i Partisë sonë ka qenë një shkollë e

madhe për ne. Ai na armatosi me dijëni, me forca të reja për të ecur përpara në rrugën e socializmit, ku e udhëhoq Partia popullin tonë. Është e natyrshme të gëzohemi, populli dhe ne, komunistët, kur shohim se ç'forcë e madhe është bërë Partia jonë, kur shohim se ajo është rritur, është kalitur, kur shohim se ajo është monolite dhe e fortë si çeliku.

Shokë, ne jemi komunistë, ne nuk e kemi zakon të mburremi, por faktet nuk i fshehim dhe kongresi ynë e faktoi se Partia jonë ka bërë hapa shumë të mëdhenj përpara.

Kuadrot tanë kanë ecur përpara, janë ngritur nga ana ideo-politike, kulturele dhe profesionale. Kuadrot e Partisë sonë i kuptojnë tani më mirë problemet e koklavitura dhe të rënda të ndërtimit të socializmit, luftojnë më mirë për zgjidhjen e tyre, iu futën më thellë se kurdoherë tjetër problemeve ekonomike, politike e kulturele. Me dhjetëra shokë kaluan në tribunën e Kongresit III të Partisë. Ata sollën zërin e Partisë, frymën e saj luftarake e besnikërinë e saj të pakufishme ndaj popullit. Në këtë kongres ne nuk sollëm vetëm sukseset, por kritikua ashpër edhe gabimet e të metat tona dhe shprehëm vendosmërinë tonë për t'i zhdukur ato në të ardhshmen. Uniteti i çelniktë i mendimit dhe i veprimit e karakterizoi kongresin tonë. Kjo është garancia më e madhe dhe përbën forcën e pamposhtur të Partisë.

Kritika dhe autokritika bolshevike e hapët, pa drojtje, përshkoi të gjitha punimet e Kongresit III të Partisë. Kjo duhet mbajtur gjithmonë ngrehur, pse është një garanci e madhe e gjallërisë dhe e frymës luftarake

të Partisë. Fryma luftarake dhe etja për të mësuar karakterizuan gjithashtu Kongresin III të Partisë, por ne e dimë se kemi shumë dobësi, ne duhet të mësojmë e të mësojmë shumë, se socializmi për t'u ndërtuar lyp kuadro të aftë nga çdo pikëpamje. Çdo gjë në vendin tonë bëhet për të përmirësuar jetën e popullit, për t'ia bërë atij jetën sa më të lumtur, sa më të gëzuar. Ky është qëllimi i vetëm i Partisë. Për këtë gjë Partia jonë në krye të masave punonjëse do të luftojë me të gjitha forcat e saja. Partia mban në supe detyra të rënda, por të lavdishme. Partia me anëtarët e saj, do t'i kryejnë këto me nder. Ne betohemi përpara popullit tonë për këtë gjë. S'ka kala që s'mund ta marrin komunistët. Kongresi III i Partisë aprovoi dhe vendosi direktivat e planit të dytë pesëvjeçar. Kjo është një tjetër fitore e shkëlqyer. Populli shqiptar, me Partinë e tij në krye, këtë plan do ta bëjë realitet. Kjo do t'i sjellë popullit shumë të mira dhe kjo do të jetë kënaqësia më e madhe për Partinë tonë.

Shokë, ne jemi të ndërgjegjshëm se rruga për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar nuk është e shtruar me lule. Duhet të luftojmë bile të luftojmë me vetëmohim, me guxim, të luftojmë kundër vështirësive që do të ndeshim në këtë rrugë, kundër të metave, kundër gabimeve, sepse vetëm kështu do ta realizojmë dhe tejkalojmë planin. Prandaj Partia dhe populli duhet të mobilizohen tërësisht në punë e ta organizojnë atë më së miri, të vendoset disiplina e hekurt në punë e në çdo gjë dhe komunistët të jenë në ballë të luftës e të punës, në vendet më të vështira dhe si kurdoherë të jenë shembull për të tjerët. Komunistët të jenë të rreptë

kundër të metave dhe gabimeve të tyre, të lidhen ngushtë dhe të jenë të dashur me masat, t'u shërbejnë atyre me vetëmohim. Lidhja e Partisë me masat punonjëse është kyçi i fitoreve. Komunistët me të gjitha forcat e tyre të punojnë dhe të luftojnë për çelnikosjen e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë dhe me masat e tjera punonjëse, pse kjo është garancia e fitoreve. Partia jonë heroike, në krye të masave punonjëse, të hidhet në sulm për realizimin dhe tejkalimin e planit të dytë pesëvjeçar, të hidhet në sulm për realizimin e planit të këtij viti që është viti i parë i planit të dytë pesëvjeçar. Realizimi dhe tejkalimi i planit të këtij viti do t'ia shtojë mirëqenien popullit, prandaj Parti dhe popull, si kurdoherë, si një trup i vetëm, në fabrika, në ara, në miniera, në shkolla e kudo ku punohet, t'i përvishemi më fort se kurrë punës, se fitorja është e jona. Partia jonë e lavdishme e prin popullin shqiptar në rrugën e ndritur të socializmit. Ta mbajmë kurdoherë lart flamurin e Partisë, flamurin e popullit dhe të ecim përpara.

Lavdi marksizëm-leninizizmit!

Lavdi Partisë sonë heroike, farkëtueses së të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi Partisë Bolshevike dhe popujve sovjetikë!

Lavdi popullit tonë heroik!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 135 (2404), 4 qershor 1956

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA E MBAJTUR NË MITINGUN E KRYEQYTETIT
ME RASTIN E MBYLLJES SË PUNIMEVE TË
KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË**

3 qershor 1956

Të dashur shokë dhe shoqe,
Qytetarë të Tiranës,

Sot u dha fund me sukses punimeve të tij Kongresi III i Partisë sonë të lavdishme. Ky kongres ka një rëndësi të madhe në historinë e Partisë dhe të popullit tonë heroik, sepse ai bëri bilancin e punës që nga Kongresi II i Partisë dhe u mbledh në një kohë kur në botë janë duke fituar forcat e paqes e të socializmit.

Kongresi III tregoi forcën e madhe të Partisë sonë, unitetin e saj të çelniktë dhe besnikërinë e saj të pafund ndaj popullit. Kongresi aprovoi vijën që ka ndjekur Partia jonë, e cila ka qenë kurdoherë e drejtë, sepse ajo është mbështetur në parimet e mëdha të marksizëm-leninizmit dhe është udhëhequr nga interesat e larta të popullit. Kongresi tregoi se sa është forcuar Partia, se sa janë rritur kuadrot e saj. Ai tregoi edhe se sa janë

ngritur masat punonjëse në përpjekjet e tyre për ndërtimin e socializmit.

Kongresi III i Partisë sonë aprovoi direktivat e planit të dytë pesëvjeçar, që është një program madhështor për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore, për përmirësimin e mëtejshëm të jetës së popullit tonë.

Plani i dytë pesëvjeçar i hap popullit tonë perspektiva të reja, të shkëlqyera. Ai përfaqëson dëshirat e popullit dhe qëllimin e Partisë, të cilat janë një e të pandara.

Klasa jonë heroike punëtore, fshatarësia punonjëse e inteligjencia popullore, si kurdoherë, të udhëhequra nga pararoja e sprovuar, Partia e Punës e Shqipërisë, edhe gjatë këtij pesëvjeçari do të mobilizohen pa u kursyer, me të gjitha forcat e tyre, për plotësimin me sukses të detyrave të reja, të rënda, por të realizueshme, të planit të dytë pesëvjeçar, i cili do ta bëjë vendin tonë më të bukur, më të fortë, më të begatshëm dhe jetën e popullit tonë më të mirë dhe më të lumtur.

Realizimi i planit të parë pesëvjeçar i solli popullit tonë shumë të mira. Sa larg jemi nga ditët e para të çlirimit kur na mungonin edhe gjërat më të nevojshme! Plani i dytë pesëvjeçar do ta fuqizojë industrinë tonë, do t'i japë një hov të ri bujqësisë dhe do ta ngrejë akoma më shumë mirëqenien e masave punonjëse.

Për realizimin e këtij plani madhështor duhet që i gjithë populli, me Partinë në krye, të luftojë me vetëmohim që ky plan jo vetëm të realizohet, por edhe të tejkalohet. Planet, siç dihet, s'realizohen vetëvetiu, por Partia dhe populli nuk u tremben vështirësive, ata do të ecin përpara dhe do të fitojnë si kurdoherë.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Komiteti Qendror i saj kanë besim të plotë në vendosmërinë e popullit tonë trim dhe punëtor, në vendosmërinë e komunistëve tanë, se detyrat e mëdha e të rënda që na vihen përpara nga Kongresi III do t'i kryejmë me nder. Për këtë dëshmojnë realizimet e shkëlqyera që janë arritur deri sot, dëshmojnë zotimet shumë të guximshme të delegatëve të kongresit dhe qindra e qindra letra e telegrame që kolektivat punonjëse i drejtuan kongresit.

Si kurdoherë, edhe në të ardhshmen, nuk do të na mungojë ndihma e Bashkimit Sovjetik, ne do të na ndihmojnë gjithashtu pa u kursyer Kina e madhe popullore e vendet vëllezër të demokracisë popullore.

Qytetarë dhe qytetare të kryeqytetit tonë të dashur,

Midis nesh ndodhen në këtë miting përfaqësuesit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, përfaqësuesit e Partisë Komuniste të Kinës së madhe, të partive komuniste e punëtoresh motra të vendeve të demokracisë popullore, si dhe të Francës, Spanjës, Austrisë, Siri-Libanit, të Turqisë, që e nderuan dhe e ndihmuan Partinë dhe popullin tonë me pjesëmarrjen e tyre në punimet e Kongresit III. Ardhja e tyre në vendin tonë i jep guxim dhe e shumëfishon besimin e vendosmërinë e popullit tonë në rrugën e lavdishme të ndërtimit të socializmit. Më lejoni, të dashur qytetarë dhe qytetare, që në emrin tuaj t'i falenderoj miqtë tanë dhe partitë e tyre për ndërrin e madh që na bënë me pjesëmarrjen e tyre në Kongresin III të Partisë. Partia dhe populli ynë u janë

mirënjohës për jetë miqve tanë, partive motra që dërguan në kongresin tonë përfaqësuesit e tyre dhe uruan me letra e telegrame Kongresin tonë III. Partia dhe populli ynë e çmojnë jashtëzakonisht shumë dashurinë dhe solidaritetin vëllazëror komunist të partive motra dhe të popujve që ato përfaqësojnë. Ne u premtojmë miqve tanë se populli dhe Partia jonë do të vënë të gjitha forcat e tyre që ta meritojnë miqësinë, dashurinë dhe përkrahjen e partive dhe të popujve të tyre me punë të palodhur për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, të patundur për të kapërcyer çdo pengesë që do të na dalë përpara, se do t'u qëndrojnë besnikë deri në fund ideve ngadhnjimore të marksizëm-leninizmit, se do të frymëzohen, si kurdoherë, nga ndjenjat e zjarrta të internacionalizmit proletar që ne na lidhin e na bashkojnë, se do të mbrojnë pa u tundur me vigjilencë dhe urtësi të madhe interesat e larta të popullit dhe të atdheut tonë të bukur, të lirë, dhe sovran.

Garancia e fitoreve tona të reja edhe në të ardhshmen janë vendosmëria dhe patriotizmi i lartë i popullit tonë, është Partia jonë e lavdishme që udhëheq popullin tonë në rrugën e socializmit, është udhëheqja e saj leniniste, Komiteti Qendror që zgjodhi Kongresi III, është ndihma e vendeve socialiste.

Shokë, Partia jonë ka besim në forcën dhe në rrugën e saj, sepse burimi i kësaj force jeni ju, janë masat e popullit, sepse rruga e saj është vullneti juaj, vullneti i masave. Ju e lindët Partinë, ju e mbrojtët atë në ditët më të vështira, ju i dhatë asaj gjak të ri dhe nga një bërthamë luftëtarësh e rritët dhe e bëtë të pathyeshme e të papërkulur, siç është e pathyeshme dhe e

papërkulur fuqia e popullit. E mbështetur në fuqinë tuaj, e frymëzuar nga aspiratat tuaja, Partia jonë nuk do ta ketë kurrë vështirë të ecë përpara dhe ta udhëheqë popullin me sukses në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Rroftë populli ynë trim e punëtor!

Rroftë Partia heroike e Punës e Shqipërisë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 135 (2404), 4 qershor 1956

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 13 V—VII

1955

TË NGREMË NË NJË NIVEL MË TË LARTË CILË-
SINË E PUNËS IDEOLOGJIKE, KULTURALE DHE
ARËSIMORE ME RININË — Nga fjala e mbaj-
tur në Plenumin X të Komitetit Qendror të BRPSH
(8 shtator 1955) 1—11

MBI ZHVILLIMIN E ARTIZANATIT NË QARKUN
E KUKËSIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretaria-
tit të KQ të PPSH (16 shtator 1955) 12—15

FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT
TË PËRGJITHSHËM TË FRONTIT DEMOKRATIK
ME RASTIN E HAPJES SË FUSHATËS SË ZGJEDH-
JEVE TË KËSHILLAVE POPULLORE TË FSHIA-
TRAVE DHE MBI DETYRAT E FRONTIT DEMO-
KRATIK (26 shtator 1955) 16—44

FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA
AMBASADA E REPUBLIKËS POPULLORE TË
KINËS NË TIRANË ME RASTIN E 6-VJETORIT TË
SHPALLJES SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KI-
NËS (1 tetor 1955) 45—49

FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA GJERMANE NË TIRANË ME RASTIN E 8-VJETORIT TË KRIJIMIT TË REPUBLIKËS DEMOKRATIKE GJERMANE (7 tetor 1955)	50—52
PËRSHËNDETJA NË KONGRESIN E KATËRT TË BGSH (13 tetor 1955)	54—70
MBI SISTEMIMIN NË PUNË TË USHTARAKËVE TË ÇMOBILIZUAR — Letër udhëzuese drejtuar sekretarëve të parë të komiteteve të Partisë në qarqe (29 tetor 1955)	80—82
LETËR DREJTUAR OFICERËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË QË KALOJNË NË REZERVË (8 nëntor 1955)	83—89
FJALA E MBAJTUR NË CEREMONINË E ORGANIZUAR ME RASTIN E DORËZIMIT TË DEKORATËS «YLLI I ARTË GARIBALDIN» NGA PARTIA KOMUNISTE ITALIANE (1 dhjetor 1955)	90—94
TELEGRAM FALENDERIMI DREJTUAR DY MIQVE TË SHQIPËRISË, ZOTËRINJVE ZHYSTEN GODAR DHE ADMIRAL MULEK PËR URIMET ME RASTIN E 11-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT TONË (2 dhjetor 1955)	95—96
FJALA E MBAJTUR NË PLENUMIN XVI TË KQ TË PPSH «MBI REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT TË SHTETIT PËR VITIN 1955 DHE MASAT PËR SIGURIMIN E REALIZIMIT TË PLANIT TË SHTETIT TË VITIT 1956» (28 dhjetor 1955)	97—110

1956

- KUADROT E ORGANEVE TË PUNËVE TË BRENDSHME TË JENË SHOKË LUFTE E PUNE, KOMUNISTË TË MIRË, ME KULTURË TË LARTË E MORAL TË PASTËR — Letër drejtuar organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme (5 janar 1956) .. 120—128
- FJALA E MBAJTUR NË KONSULTËN E PËRFAQËSUESVE TË PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE TË VENDEVE SOCIALISTE TË EVROPËS MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK DHE KOORDINIMIN E PLANEVE (7 janar 1956) 129—145
- TË PËRMIRËSOJMË UDHËHEQJEN E PARTISË NË SEKTORIN SHTETËROR BUJQËSOR — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 shkurt 1956) 146—149
- LETËR MBI DISA PROBLEME TË KUADRIT (7 shkurt 1956) 150—158
- MBI DISA TË META NË LIDHJE ME PËRPARIMIN NË MËSIMË DHE DISIPLINËN SHKOLLORE E JASHTËSHKOLLORE — Letër drejtuar organizatave të Partisë të studentëve e kursantëve që studjojnë jashtë shtetit (13 mars 1956) 159—164
- NE KEMI NEVOJË PËR NJË PLAN MË TË LIDHUR ME JETËN, MË AFËR REALITETIT DHE KËRKËSAVE TË POPULLIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 mars 1956) 165—187
- FJALA E MBYLLJES MBAJTUR NË PLENUMIN XVIII TË KQ TË PPSH MBI SHQYRTIMIN E PRO-

JEKTDIREKTIVAVE TË PLANIT TË DYTË PESË- VJEÇAR DHE TË PROJEKTSTATUTIT TË PPSH (7 prill 1956)	188—192
MARKSIZËM-LENINIZMI MËSON SE POPULLI ËSHTË KRIJUESI I HISTORISË (13 prill 1956)	193—201
ATA QË NUK E DUAN TË MIRËN E PARTISË NUK DO T'I LËMË TË VEPROJNË. PARTINË DU- HET TA MBROJMË — Fjala e mbajtur në Konferen- cën e Partisë të qytetit të Tiranës për dhënie llogari e zgjedhje (15-16 prill 1956)	202—237
MBI KREDINË QË QEVERIA E REPUBLIKËS ÇE- KOSLLOVAKE DUHEJ T'I JEPTË QEVERISË SË RPSH PËR PERIU DHËN 1956-1960 — Letër drejtuar Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Ko- muniste Çekosllovake (17 prill 1956)	238—241
MËSIMET QË DUHET TË NXJERRIM NGA KONFE- RENCA E PARTISË E QYTETIT TË TIRANËS — Letër drejtuar gjithë organizatave të Partisë (21 prill 1956)	242—247
TË JEMI KURDOHERË VIGJILENTË NDAJ SYNI- MEVE, PËRPJEKJEVE DHE METODAVE TË STËR- HOLLUARA TË ARMIKUT — Diskutim në mbledh- jen e organizatës bazë të Partisë pranë aparatit të KQ të PPSH me rastin e punimit të Rezolucionit të Konferencës së Partisë të qytetit të Tiranës (26 prill 1956)	248—263
FJALA E HAPJES NË KONGRESIN III TË PPSH (25 maj 1956)	269—270

RAPORT NË KONGRESIN III TË PPSH «MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR TË PPSH» (25 maj 1956)	271—488
---	---------

I

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË	273—308
---	---------

II

REZULTATET E ARRITURA NË LËMIN EKONOMIK E KULTURAL GJATË PESËVJEÇARIT TË PARË DHE DREJTIMET KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS PËR PESË VJETËT E ARDHSHËM	309—414
---	---------

A. — ZHVILLIMI I INDUSTRISË DHE I TRANSPORTIT	309—337
---	---------

1) SUKSESET NË INDUSTRIALIZIMIN SOCIALIST TË VENDIT	311
2) PËR NJË DREJTIM TË KUALIFIKUAR DHE PRODHIM RENTABEL	322
3) PËR NJË STUDIM MË TË DREJTË TË INVESTIMEVE DHE PËR NJË SHFRYTËZIM MË TË PLOTË TË KAPACITETEVE PRODHUESE	326
a) Mbi studimet komplekse, të koordinuara dhe me perspektivë	326
b) Mbi planifikimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese	327
c) Mbi mirëmbajtjen e maqinerisë	329

c) Mbi vendosjen e proceseve teknologjike dhe ritmet e prodhimit	330
d) Mbi shfrytëzimin e industrisë mekanike	332
4) PER NJË NGRITJE TË VAZHDUESHME TË RENDIMENTIT TË PUNËS, PER ULJEN E KOSTOS DHE PER NJË REGJIM TË RREPTE KURSIMI	333
5) MBI TRANSPORTIN DHE KOMUNIKACIONIN	336
 B. — ZHVILLIMI I BUJQËSISË	338—379
1) PRODHIMI I DRITHERAVE ESHTË BAZA E PRODHIMIT BUJQËSOR	341
2) DETYRAT E NGRITJES SË MËTEJSHME TË BLEGTORISË ..	349
3) MBI KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË	352
4) MBI MEKANIZIMIN E BUJQËSISË	366
5) MBI ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË NDERMARRIEVE BUJQËSORE SHTËTËRORE	372
6) MBI DREJTIMIN E PUNËVE TË BUJQËSISË	378
 C. — RRRITJA E MIRËQENIES MATERIALE DHE E NIVELIT KULTURAL TË MASAVE PUNONJËSE GJATË PESËVJEÇARIT TË DYTË	380—392
 Ç. — ZHVILLIMI I ARËSIMIT, I KULTURËS DHE I SHKENCËS	393—402
 D. — DEMOKRATIZIMI DHE FORCIMI I MËTEJSHËM I PUSHTETIT POPULLOR	403—414

III

PARTIA	415—488
1) FORCIMI I PËRBERJES SË PARTISË	417
2) ZHVILLIMI I KRITIKËS DHE I AUTOKRITIKËS DHE FORCIMI I DISIPLINËS SË PARTISË DHE TË SHTETIT ..	421
3) TË PËRMIRËSOJME METODËN E PUNËS SË KOMITETEVE DHE TË ORGANIZATAVE BAZË TË PARTISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E VENDIMEVE TË PARTISË DHE TË SHTETIT	431
4) TË FORCOHET KONTROLLI I PËRGJITHSHËM I PARTISË NË PUNËN ME KUADROT DHE TË PËRMIRËSOHET PUNA PËR ZGJEDHJEN DHE EDUKIMIN E TYRE	439
5) FORCIMI I LIDHJEVE TË PARTISË ME MASAT DHE PUNA QË DUHET BËRË PËR MOBILIZIMIN MË TË MADH TË TYRE NË ZGJIDHJEN E DETYRAVE TË REJA	449
6) MBI DISA ÇËSHTJE TË PUNËS IDEOLOGJIKE TË PARTISË	459
FJALA E MBAJTUR NË SEANCËN E MBYLLJES TË KONGRESIT III TË PPSH (3 qershor 1956)	489—494
FJALA E MBAJTUR NË MITINGUN E KRYEQYTETIT ME RASTIN E MBYLLJES SË PUNIMEVE TË KONGRESIT III TË PPSH (3 qershor 1956)	495—499